

[Type here]

REVISTA STUDIME JURIDIKE

NR. 1, 2025

Fontespig – si koopertina

(Faqja pas Kopertinës)

Botim i parë: shtator 2001

Revista “Studime Juridike”, botim i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Adresa: Rruga ‘Milto Tutulani’, 1001, Tiranë

www.fdut.edu.al

ISSN: 2220-3990

© Të drejtat e autorit i përkasin Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Drejtori i revistës

Prof. Asoc. Dr. Ela Kerka

Bordi Editorial

Prof. Dr. Artan Hoxha

Prof. Dr. Dorina Hoxha

Prof. Dr. Skënder Kaçupi

Prof. Dr. Altin Shegani

Prof. Dr. Aurela Anastasi

Prof. Dr. Eralda (Methasani) Çani

Prof. Dr. Ardian Nuni

Prof. Dr. Argita Malltezi

Prof. Dr. Nada Dollani

Prof. Dr. Eriona Katro

Prof. Dr. Iva Zajmi

Prof. Asoc. Dr. Kristinka Jançe

Prof. Asoc. Dr. Enkeleda Olldash

Prof. Asoc. Dr. Flutura Tafaj

Prof. Asoc. Dr. Lirime Çukaj

Sekretariati teknik

Dr. Eniana Qarri

Elida Qershori

Shtypur në shtypshkronjën e Shtëpisë

Botuese.....

Tiranë, 2025

Pasyra e lëndës

Prof. Dr. Aurela ANASTASI, Prof.Asoc.Dr. Erind MËRKURI, Dr. Pjereta AGALLIU, Doktorante Nadia GUNI

Jurisprudenca kushtetuese dhe përafrimi i legjilacionit shqiptar me të drejtën e Bashkimit Evropian

.....2

Doktorante Elena FILIP, Prof. Dr. Kestrin KATRO

Tendencat e reja dhe llojet e përgjegjesisë civile në epokën e digjitalizimit.....20

Msc. Etien ISAK, Msc. Elidjana BREGU

Ngritja e padisë direkte në kontratat e sigurimit të përgjegjesisë.Probleme të praktikës gjyqësore shqiptare.....40

Dr. Eniana QARRI

Dimensioni digjital i dhunës me bazë gjinore.....53

Olti SKRAME

Vendimet e gjyqtarit të hetimeve paraprake, të gjyqtarit të seancës paraprake dhe të gjyqtarit të themelit.....75

Doktorant Xhei ÇELIKU, Msc. Eni BELLO, Msc. Ornela NIKOLLI

Si po përshtatet Shqipëria me standardet e Bashkimit Evropian për parandalimin e pastrimit të parave?.....83

Msc. Bora TOTOLAKU

Roli ndihmës i sekretarit gjyqësor në procesin penal për zhvillimin e gjykimit brenda një kohe të arsyeshme.....93

Av. Eler VALISHTI

Cybercrimes in Albania.....106

Dr. Vera SHTJEFNI

Sigurimi i detyrueshëm i pronës, standartet kushtetuese dhe ligjore.....116

LLM. Aldi KASMI

E drejta për të mos migruar.....130

Doktorant Klei KAÇUPI, Prof.Asoc.Dr. Engjell LIKMETA

Organizimi gjyqësor sipas së drejtës zakonore në krahinën e Labërisë.....143

Doktorante Klaudia REKA, Dr. Enekeleida SHYLE (PETANAJ)

Sfidat e bizneseve shqiptare në kontekstin e ndryshimeve të legjilacionit tatimor dhe strategjitë për përshtatje.....157

Prof.Asoc.Dr. Saimir SHATKU, Msc. Marinel PRENGA

Përshtatja dhe harmonizimi i ligjit mbi arbitrazhin në Shqipëri:Krahasimi me praktikën e vendeve të Bashkimit Evropian dhe sfida të integrimit në kuadër të standarteve ndërkombëtare.....169

Phd. Eda JAUPI

Environmental taxation in the international legal framework.....186

JURISPRUDENCA KUSHTETUESE DHE PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR ME TË DREJTËN E BASHKIMIT EVROPIAN*

Prof.Dr. Aurela ANASTASI**

Prof.Asoc.Dr.Erind MERKURI***

Dr.Pjereta AGALLIU****

Doktorante Nadia GUNI*****

THE CONSTITUTIONAL CASE LAW AND THE APPROACH OF ALBANIAN LEGISLATION WITH THE EUROPEAN UNION' LAW

Abstract

Albania is in an intensive phase of the process of its integration into the European Union, progressing through the negotiations chapter by chapter. This political process serves as support for the democratization of Albania and the consolidation of the rule of law. A key priority remains the alignment of Albanian legislation with that of the European Union. This study aims to highlight the impact of constitutional reviews of laws exercised by the Constitutional Court, in support of legislative alignment. The Constitutional Court can be engaged in judicial dialogue with the European Court of Justice, as well as apply comparative interpretation of European Union acts to support the harmonization of legislation. The implementation of the Stabilization and Association Agreement also plays an important role. Through monitoring and analysis of the Constitutional Court's decisions, this paper draws several conclusions regarding the contributions from the Albanian Constitutional Court's jurisprudence in this area.

Keywords: *European integration; approximation of legislation; Constitutional Court of Albania; judicial dialogue; Stabilization and Association Agreement; European Court of Justice*

1. Hyrje

Shqipëria ndodhet në një fazë intensive të procesit që synon anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE), duke përparuar me negociatat kapitull pas kapitulli. Ky proces politik përfaqëson mbështetje për demokratizimin dhe për konsolidimin e Shtetit të së Drejtës. Ligji nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian”,¹ i ndryshuar, ka përcaktuar rregullat për marrëdhëniet e Kuvendit të Shqipërisë me Këshillin e Ministrave dhe institucionet e tjera për procesin e integritimit. Ndërsa, Këshilli i Ministrave, me vendimin Nr. 88, datë 22.2.2023² “Për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim

* Ky artikull është përgatitur në kuadër të zbatimit të Projektit “Përafrimi i legjislacionit me standardet europiane përmes gjykimit kushtetues”, i cili po zbatohet nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor (AKKSHI) në periudhën 2024-2025.

** Professore e së Drejtës Kushtetuese në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

*** Prof. Asoc.Dr.,i së Drejtës Kushtetuese në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

**** Lektore e së Drejtës Kushtetuese në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

***** Asistent pedagoge e së Drejtës Kushtetuese në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

¹ Ligj nr. 15, datë 05.03.2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”. Fletorja Zyrtare, 38, i gjindshëm në linkun: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/03/05/15>

² Vendim Nr. 88, datë 22.02.2023, për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030. Fletorja Zyrtare, 31. Gjeni në linkun: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/02/22/88>

evropian”, vendosi Integrimin European si prioritet. Në këtë kuadër, përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, përbën një nga veprimtaritë themelore. Ai kryhet përmes hartimit të ligjeve dhe ndryshimeve ligjore dhe synon rritjen e shkallës së harmonizimit të legjislacionit shqiptar me *Acquis Communautaire*. Në këtë fazë, është shumë e rëndësishme që institucionet politike, sipas detyrave përkatëse, të kontribuojnë për përafrimin e legjislacionit. Vëmendje marrin edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese (GJK-së) shqiptare që kanë kontrolluar pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, përse ato qasen me të drejtën e Bashkimit European. Prandaj, në këtë punim kemi analizuar disa nga kontributet kryesore të Gjykatës Kushtetuese në kuadrin e kontrollit të kushtetutshmërisë që lidhen me përafrimin e legjislacionit. Pyetja kërkimore që shtrojmë është: Si ndikon jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese për përafrimin e legjislacionit? Çfarë u ofron jurisprudenca e saj institucioneve përgjegjëse për përafrimin?

Gjykata Kushtetuese është organ kushtetues që procedon si një gjykatë, prandaj si rregull, ushtron kontrollin e akteve pasi ato janë miratuar (*a posteriori*). Shqipëria nuk është vend anëtar i Bashkimit European, prandaj formalo-juridikisht duket se nuk ka detyrimin të zbatojë legjislacionin e BE-së. Por, në saje të jurisprudencës kushtetuese, teoria e së drejtës arrin të shohë disa mënyra përmes të cilave Gjykata Kushtetuese mund të japë ndihmesë në këtë proces. Në mënyrë të veçantë, ajo e realizon këtë, përmes zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit të Bashkimit Evropian me Shqipërinë. Përpos kësaj, në disa raste Gjykata ka përdorur dialogun gjyqësor me Gjykatën Evropiane të Drejtësisë (GJED) dhe gjykatat e vendeve anëtare të BE-së, si dhe interpretimin krahasimor me aktet e legjislacionit të BE-së.

Interpretimi krahasimor, i cili në thelb, krahason kuptimin e një ligji të një shteti me atë të një shteti tjetër, ka marrë sot një përhapje nga gjykatat kushtetuese dhe ato të larta, edhe në botë. Ka autorë që e konsiderojnë atë si metoda e pestë e interpretimit, krahas metodave të përpunuara nga shkolla historike gjermane e së drejtës.³ Nga ana e tij, “dialogu gjyqësor” është një pjesë e interpretimit krahasimor. “Dialogu gjyqësor”, i mbiquajtur edhe si “kryqëzimi gjyqësor” ose “qarkullimi i jurisprudencave”, etj., në thelb përfaqëson referimin e vendimeve gjyqësore të gjykatave të huaja në interpretimin gjyqësor, për arsyetimin e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes. Ky fenomen i ka dhënë një tipar të dallueshëm të ashtuquajturës “koha e artë” në të drejtën Kushtetuese të Krahasuar, nga viti 1990 e vijim.⁴ Zhvillimi i këtij dialogu nga gjyqtarët e gjykatat, është nxitur nga mjaft studiues, që sintetizojnë këtë praktikë dhe shtrojnë çështje teorike e praktike. Për këtë “dialog global” të gjyqtarëve, janë krijuar shkolla mendimi me argumente të ndryshme: disa shprehen në favor, kurse disa të tjerë kundër përdorimit të së drejtës së huaj si një ndihmë për zgjidhjen e çështjes ose si një metodë e interpretimit kushtetues.⁵

Në Shqipëri, teoria kushtetuese ka shprehur pikëpamje të hapura për rolin e gjykatave për zbatimin e akteve të BE-së. Ajo ka nxjerrë në dukje jurisprudencën gjyqësore në lidhje me kufijtë e zbatimit të legjislacionit evropian nga gjykatat kombëtare. Në fakt, vihet re edhe një ndërgegjësim i gjykatave shqiptare për të përfshirë aktet ligjore të BE-së si dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në vendimet e tyre.⁶ Ka autorë që theksojnë edhe zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave të BE-së. “Nga ana praktike, nëse gjyqtarët shqiptarë do të hasin ndonjë papajtueshmëri midis ligjit shqiptar (të cfarëdolloj hierarkie) dhe të drejtës së BE-së, ata kanë për detyrë

³ Shih: Gustavo Zagrebelsky, “Cinquanta anni di attivita della Corte Costituzionale”, Campidoglio, (2006), 5, available at https://www.cortecostituzionale.it/documenti/filesDoc/Zagrebelsky_22_aprile_2006_2.pdf

⁴ Shih: Tania Groppi, Marie-Claire Ponthoreau, Irene Spigno, *Introduction. Assessing the Use of Foreign Precedents by Constitutional Justices: Ten Years Later*, në “Judicial Bricolage. The Use of Foreign Precedents by Constitutional Judges in the 21st Century”, (eds. Tania Groppi, Marie-Claire Ponthoreau, Irene Spigno), Hart Studies in Comparative Public Law, 2025, Vol.32, f.1.

⁵ Shih: “The use of foreign precedents by constitutional judges”, Edited by Tania Groppi and Marie-Claire Ponthoreau, Hart Publishing, Oxford and Portland, Oregon 2013; si dhe “Judicial Bricolage. The Use of Foreign Precedents by Constitutional Judges in the 21st Century”, (eds. Tania Groppi, Marie-Claire Ponthoreau, Irene Spigno), Hart Studies in Comparative Public Law, 2025, Vol.32.

⁶ Shih më gjerë: Tefta Zaka, *Sfidat e gjykatave shqiptare në procesin e integritimit European*, në “Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë, nga identiteti kombëtar tek vlerat universale”, Botim i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, *Dhjetor 2023*, f.194-226.

që të lënë mënjanë ligjin shqiptar dhe të zbatojnë me përparësi normat e BE-së.”⁷ Gjithashtu, studiuesit e vendit e kanë nxitur interpretimin krahasimor të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së. “Në vendimet e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese vihet re një tendencë e interpretimit konsistent të legjislacionit shqiptar me të drejtën dytësore të BE-së, kryesisht me Direktivat apo Rregulloret. Megjithatë, numri i vendimeve ku ofrohet një interpretim konsistent është ende i ulët dhe rastet janë sporadike.”⁸

Ky punim ka në vëmendje studimin e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe ndikimin e saj për përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet e BE-së. Studimi është kryer përmes monitorimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë në periudhën 2009-2024 dhe analizës së zbatimit të MSA-së, si dhe të interpretimit krahasimor që Gjykata jonë Kushtetuese ushtron me legjislacionin e BE-së dhe veçanërisht, “dialogut gjyqësor” me vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Autorët zgjedhën pikërisht këtë metodologji studimi, pasi interpretimi krahasimor i Gjykatës Kushtetuese me standardet e Bashkimit Evropian i shërben procesit për përafrimin e legjislacionit dhe në tërësi, të integritimit evropian të Shqipërisë. Sidomos, referimi e citimi i tyre në vendimet gjyqësore, ndihmon për të përqafuar standardet e Bashkimit Evropian për Shtetin e së Drejtës, si dhe për harmonizimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian. Në këtë studim, analiza e autorëve bazohet në metoda sasiore dhe cilësore. Në vijim paraqiten të sintetizuara disa nga gjetjet e tij, si dhe konkluzionet e arritura.

2. Referimi në aktet e be-së nga gjykata kushtetuese: të dhëna sasiore

Me mbështetjen e studentëve të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës,⁹ u monitoruan 815 vendime gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese. Grupi i punës hartoi skemat e monitorimit dhe fjalët kyçe për kërkimin. Për të evidentuar referimin e Gjykatës në aktet e legjislacionit të BE-së, si dhe në vendimet e GJED-së, kishim mjete të kufizuara: leximi i vendimit dhe evidentimi i akteve ndikohej edhe nga subjektivizmi i lexuesit. Fjalët kyçe të përdorura për kërkimin mund të mos mjaftonin. Sidoqoftë, nga 815 vendime të GJKA-së, me mjetet e kërkimit që standardizua, u evidentuan 97 akte të BE-së, përfshirë edhe MSA-në (e cila është edhe akt juridik i brendshëm), si dhe vendime gjyqësore të vendeve anëtare. Edhe pse mund të mos kemi një numërim të saktë të të gjitha referencave, ato janë të mjaftueshme për t’u orientuar mirë dhe për të nxjerrë disa konkluzione.

Konkretisht, rendisim në vijim, disa nga të dhënat sasiore që gjetëm:

- **Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA)** është një akt i brendshëm në korpusin e legjislacionit të Shqipërisë si marrëveshje ndërkombëtare, ashtu sikurse njëkohësisht përfaqëson edhe një akt i BE-së. Grupi i punës vlerësoi se monitorimi i zbatimit të saj nga Gjykata Kushtetuese do të ishte shumë i vlefshëm për të realizuar gjetjet dhe konkluzionet e studimit. Përsa kemi evidentuar nga monitorimi, rezulton se MSA-ja është referuar vetëm 8 herë nga 97 referenca të gjetura. Shprehur në përqindje, vetëm në 8 % akteve të referuara janë MSA. (Shih grafikun nr.1).


Tabela nr.1

Referimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA)

⁷ Klodian Rado, *Rëndësia dhe roli i pushtetit gjyqësor në integritetin European të Shqipërisë*, në “Shteti i së drejtës në proceset integruese të Shqipërisë, ASHSH, Tiranë, 2023, f. 107.

⁸ Shih: Evis Alimehmeti, Fjoralba Caka, *The Relationship between International and Domestic Law in the Albanian Legal System*, në *International Constitutional Law*, editor Luca Mezzetti, et al. G. Giappichelli Editore Publishing House, 2014, Turin, Italy.

⁹Autorët falenderojnë studentët e FDUT-së që mbështetën monitorimin: Aurelio Kodra, Elisabeta Jaupi, Manjola Xhaferi, Marinel Prenga, Nikola Mahmutaj, Nosiana Burnazi, Ornela Nikolli, Regis Shyti, Selvi Sinaj, Uendi Dino, Kristjana Gora, Alem Bedhija, Alush Çela, Alesia Dodaj, Teojorg Gogu, Ema Dako, Jonida Kanushi, Emanuel Xhindi, Arba Ollomani, Arla Shqarri, Fjona Qafzezi, Mariana Dulla, Zarife Brahaj, Valbona Çajka, Bjorn Kasapi, Kevin Dervishalaj




Emri i Autorit

- **Vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED-së)**, u gjetën të referuara në 6 raste, kurse në 2 raste ishte referuar Gjykata e Përgjithshme, që në përqindje zënë 8.2% të vendimeve. (Shih grafikun nr. 2).

Tabela nr. 2


Referimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë



- **Traktati për Funkionimin e Bashkimit Evropian** u gjet i referuar vetëm në dy raste, në pjesën e kërkimit të palëve. Sidoqoftë referimi i tij përmes jurisprudencës së GJED-së, nuk është përfshirë në këtë grafik. (Shih grafikun nr. 3).

Tabela nr.3

Referimi i TFBE-së¹⁰



Konkluzione paraprake. Të dhënat e mësipërme dëshmojnë se Gjykata Kushtetuese e ka pasur në vëmendje referimin e akteve të BE-së dhe ka zhvilluar një interpretim krahasimor me to, në disa raste. Pavarësisht se të dhënat sasiore nuk japin të dhëna thelbësore për studimin tonë, ato janë mjaft të vlefshme për të orientuar analizën që vijon. Në vijim do të analizojmë disa prej çështjeve të trajtuara nga ky këndvështrim dhe ndikimin e tij, për përafrimin e legjislacionit shqiptar.

3. Marrëveshja e stabilizim asociimit në gjykimin kushtetues

Në kuadër të procesit të integrit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, në vitin 2006, midis BE-së dhe Shqipërisë u nënshkrua Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA). Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje nga të gjitha vendet anëtare të BE-së, kërkoi rreth 3 vjet kohë dhe përfundimisht, kjo marrëveshje hyri në fuqi në vitin 2009.¹¹

MSA-ja ka në themel të saj idenë e konsolidimit të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe BE-së, përmes një procesi

¹⁰ Në lidhje me këtë proces, shih: Aurela Anastasi, *Using Foreign Precedents to Meet the European Standards: The case of the Constitutional Court of Albania*, në "Judicial Bricolage. The Use of Foreign Precedents by Constitutional Judges in the 21st Century", (eds. Tania Groppi, Marie-Claire Ponthoreau, Irene Spigno), Hart Studies in Comparative Public Law, 2025, Vol.32, fq. 207-231.

¹¹ Ligj nr. 9590, datë 27.07.2006, "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare." Fletorja Zyrtare, 87. Gjeni ne linkun: https://www.qbz.gov.al/share/ZTJ1_Xi1SEKgzF5TDkeeMQ

që ndërthur qëndrueshmërinë politike dhe institucionale, me zhvillimin ekonomik dhe integrimin gradual të vendit në Tregun e Përbashkët Evropian. Në aspektin politik, ajo synon forcimin e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Përpos të tjerave, në këtë proces ka rëndësi themelore që Shqipëria të realizojë përafrimin e legjislacionit shqiptar me të drejtën e Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*), duke e drejtuar procesin normativ të vendit drejt standardeve evropiane.¹² Marrëveshja krijon një kuadër normativ të përcaktuar qartë për monitorimin e përparimit dhe vlerësimin periodik të reformave, përmes mekanizmave që krijon, ku spikasin: Këshilli i Stabilizim-Asociimit dhe Komiteti i Përbashkët. Në literaturën juridike, roli i Gjykatës Kushtetuese është parë i lidhur ngushtë me këtë mision: “...ndërveprimi i ndërlikuar midis ligjit të BE-së, MSA-së dhe kuadrit ligjor vendas të Shqipërisë, thekson rolin e Gjykatës Kushtetuese në sigurimin e angazhimeve të Shqipërisë në respektimin e marrëveshjes ligjore ndërkombëtare.”¹³

Studimi që ndërmorëm synoi të kërkonte nëse referimi në dispozitat e MSA-së ka shërbyer si një urë, për të siguruar edhe përafrimin e dispozitave me legjislacionin e BE-së. Duke e lidhur ngushtë zbatimin e nenit 11 të Kushtetutës (liria ekonomike) me zbatimin e standardeve të BE-së, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se, në bazë të MSA-së, e drejta e shtetit për të ndërhyrë në rregullimin e ushtrimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike njeh një kufizim të ri, të përcaktuar në pikën 2 të nenit 33 të saj, i cili parashikon: “*Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk vendosen kufizime sasiore të reja për importet ose eksportet, apo masa të reja me efekt të njëjtë me to, dhe as nuk bëhen kufizime të mëtejshme mbi ato ekzistuese në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.*”¹⁴ Gjykata arsyeton se, në zbatim të dispozitës së mësipërme shteti mund të kufizojë ushtrimin e lirisë ekonomike për aq sa nuk krijohen kufizime të mëtejshme mbi ato ekzistuese në tregtinë ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shqipërisë.¹⁵

Në vendimin e saj nr. 24, datë 24.7.2009¹⁶, ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese, theksoi nevojën për zbatimin e nenit 42 të MSA-së, në lidhje me shkallën e kufizimit të veprimtarisë ekonomike. Më konkretisht theksoi: *Gjykata vëren se vendimi objekt shqyrtimi, duke ndryshuar rregullat ligjore mbi importin e lëndës djegëse Diezel D2 dhe tregtimin e lëndës djegëse Diezel D1, krijon kufizim total për importet e lëndës Diezel D2 dhe vështirëson tregtimin e lëndës djegëse Diezel D1 edhe nëse këto lëndë importohen nga vendet anëtare të Komunitetit Evropian, duke kufizuar kështu tregtinë ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shqipërisë...*¹⁷ Subjekti i interesuar (Këshilli i Ministrave) pretendonte se ky kufizim lejohej në zbatim të nenit 42 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Por, Gjykata arriti në përfundimin se, vendimi i kundërshtuar nuk është i marrë në zbatim të nenit 42 të MSA-së. Sipas saj, subjekti i interesuar nuk paraqiti prova se vendimi objekt shqyrtimi është marrë në zbatim të rasteve të parashikuara në pjesën e parë të këtij neni dhe as arriti të argumentojë që ky vendim nuk përbën diskriminim arbitrar në tregtinë ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shqipërisë. Kështu, Gjykata konstatoi se Vendimi nr.52, datë 14.01.2009 i Këshillit të Ministrave, është në kundërshtim me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, konkretisht me nenet 33 dhe 42 të saj. Ajo renditi disa pika të vendimit të mësipërm që duhet të shfuqizoheshin (1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 11). Bazuar në nenin 42 të MSA-së, Gjykata Kushtetuese konsideroi se “barra e provës”, që të justifikonte këtë ndërhyrje në tregtinë e lirë midis BE-së dhe Shqipërisë, binte mbi Këshillin e Ministrave.

¹² Neni 1 i MSA-së.

¹³ Beqiraj, Pranvera & Dorina Gjipali, ‘Stabilization and Association Agreement in the Jurisprudence of the Albanian Constitutional Court’, *Juridical Tribune – Review of Comparative and International Law* 14, no. 3 (October 2024): 452-464 (PDF) *Stabilization and Association Agreement in the Jurisprudence of the Albanian Constitutional Court*. Available from: https://www.researchgate.net/publication/386331033_Stabilization_and_Association_Agreement_in_the_Jurisprudence_of_the_Albanian_Constitutional_Court [accessed Apr 09 2025].

¹⁴ Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.24, datë, 24.7.2009.

¹⁵ Shih: Zaganjori Xh., Anastasi A., Methasani E., “Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, Tiranë, 2011, f. 69.

¹⁶ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 24, datë 24.07.2009 “*Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.01.2009.*”

https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/vend.24__date_24.07.2009.doc

¹⁷ Po aty.

Në një rast tjetër, në kuadër të gjykimit kushtetues për vlerësimin e kushtetutshmërisë së mbajtjes së një referendumi shfuqizues, Gjykata Kushtetuese, u ndodh përballë pretendimit të ngritur nga subjekti i interesuar (Këshilli i Ministrave), se mund të cenoheshin detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë, në kuadër të MSA-së. Në lidhje me këtë, në vendimin nr.8, datë 8.3.2013¹⁸, gjejmë shpjegimin vijues: *“Po ashtu, përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, ka pretenduar se shfuqizimi i neneve 22, pika 3 dhe 49 të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, bie ndesh me detyrimet ndërkombëtare që burojnë nga neni 6 i MSA-së për përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së, konkretisht me Direktivën 2008/98/KE të Bashkimit Evropian, Rregulloren 1013/2006 “Për transferimin e mbetjeve” dhe me kërkesat e nenit 108 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.”*¹⁹ Gjykata Kushtetuese nuk e mori në konsideratë këtë pretendim. Ajo, duke u bazuar në natyrën e këtij lloji gjykimi kushtetues, theksoi se, në këtë proces nuk mund të shprehej për pajtueshmërinë e këtyre normave me marrëveshjet ndërkombëtare.²⁰

GJK-ja e ka lidhur zbatimin e MSA-së vetëm me veprimtaritë ekonomike në kuptimin e ngushtë të fjalës, për respektimin e parimeve të konkurrencës dhe të lirisë ekonomike. Gjykata nuk e ka konsideruar kërkesën e palëve dhe nuk është shprehur për përafrimin e legjislacionit. Në lidhje me parimet e konkurrencës, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se: *“-Praktikat në kundërshtim me nenin 71 (konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike) vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës së aplikueshme në Komunitet, sidomos të neneve 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian, dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit. Në këto kushte, ashtu si edhe në gjykime të mëparshme, Gjykata e sheh me vend t’i referohet jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED), lidhur me zbatimin e rregullave të konkurrencës në respektim të kësaj marrëveshjeje”*.²¹

Në këtë çështje, kundërshtojë dhënia me koncesion e procesit të markimit të karburanteve, një shoqërie tregtare. Gjykata Kushtetuese, konstatoi se neni 71 i MSA-së u referohej rregullave të parashikuara në traktatet e Bashkimit Evropian. Prandaj, vendosi të mos interpretojë ajo vetë këto dispozita, por iu referua jurisprudencës së GJED-së, si autoriteti i vetëm i ngarkuar për interpretimin e tyre. Ndoshta, kjo është edhe arsyeja që Gjykata Kushtetuese ka bërë një tërheqje nga qëndrimet e saj të mëparshme. Ajo ka reflektuar një qasje më të matur ndaj marrëdhënies ndërmjet të drejtës së brendshme dhe detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Ajo e ka konsideruar MSA-në më shumë si një Traktat udhëzues, se sa si një akt që zbatohet drejtpërdrejt. Në një rast të gjykuar në vitin 2022, GJK-ja ka theksuar shprehimisht: *“... MSA-ja është një marrëveshje kuadër për marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, nga njëra anë dhe BE-së dhe shteteve anëtare të saj nga ana tjetër... Ajo synon mbështetjen e Shqipërisë për forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, dhënien e kontributit për stabilitetin politik, ekonomik dhe social në Shqipëri, dhe në rajon, përafrimin e legjislacionit shqiptar me të drejtën komunitare dhe mbështetjen e Shqipërisë për të përfunduar tranzicionin drejt një ekonomie tregu funksionale...”*²²

Në këtë vendim, konstatojmë se Gjykata Kushtetuese e sheh MSA-në si një marrëveshje kuadër që parashikon bashkëpunim dhe përafrim gradual ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Gjykata Kushtetuese thekson se MSA-ja është një marrëveshje afatgjatë, që synon ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe ligjore për t’i afruar standardet shqiptare me ato evropiane, veçanërisht në fusha si mbrojtja e konsumatorit. Ajo përmend se, përafrimi

¹⁸ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 8, datë 08.03.2013 “Kushtetutshmëria e kërkesës për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e nenit 22, pika 3, dhe nenit 49 të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011...”

https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/ep-content/uploads/2024/12/vend_0813.doc

¹⁹Po aty, parag. 26 *“Nisur nga natyra dhe karakteristikat e gjykimit kushtetues konkret, Gjykata vlerëson se objekt i tij është shqyrtimi, paraprakisht, i kushtetutshmërisë së kërkesës për referendum të përgjithshëm shfuqizues dhe jo pajtueshmëria e neneve, objekt i referendumit, me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara”*

²⁰ Po aty, parag.27.

²¹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 14 datë 21.03.2014 (V-14/14) *Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.200, datë 13.03.2013, “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G.”*

²² Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 2.11.2022, f.74.

nuk ndodh menjëherë, por nëpërmjet një procesi të dakordësuar ndërmjet palëve, i cili përfshin masa ligjore, politike dhe administrative. Pra, për Gjykatën Kushtetuese, MSA-ja është një marrëveshje që rregullon bashkëpunimin e Shqipërisë me BE-në, por nuk mund të konsiderohet një standard juridik absolut që mund të përdoret për të kundërshtuar çdo legjislacion kombëtar.

Në një rast vijues, Gjykata Kushtetuese, pranoi se do të shqyrtonte përputhshmërinë e aktit normativ me fuqinë e ligjit,²³ me këtë Marrëveshje. Sidoqoftë, nuk vijoi më tej me analizë thelbësore, pasi konstatoi probleme në procedurën që ishte ndjekur për miratimin e tij, dhe arsyetimi i vendimit u mbyll me to.²⁴

Situata u përsërit në mënyrë identike kur Gjykata Kushtetuese shqyrtoi përsëri një akt normativ me fuqinë e ligjit.²⁵ Edhe në këtë rast, Gjykata rithekson natyrën e MSA-së si një marrëveshje kuadër me qëllim stabilizimin dhe përafrimin gradual të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Ajo e përshkruan atë si një instrument që nuk prodhon efekte të menjëhershme, por vendos një proces për bashkëpunimin dhe transformimin e institucioneve dhe legjislacionit të brendshëm shqiptar, në funksion të integritimit evropian. Pavarësisht kësaj, Gjykata Kushtetuese bën edhe një analizë përputhshmërie të normave të kundërshtuara, me ato të MSA-së. Në lidhje me pretendimet për shkelje të nenit 71 të MSA-së mbi konkurrencën, Gjykata vërejtë se në atë rast, nuk kemi të bëjmë me marrëveshje midis ndërmarrjeve, abuzim me pozitë dominuese apo ndihmë shtetërore, të cilat janë objekt i ndalimeve të nenit në fjalë. Ajo theksoi se institucioni i përfshirë, Bordi i Transparencës, ishte një organ publik, i krijuar me ligj dhe jo një subjekt privat apo sipërmarrës që ndikon drejtpërdrejt në konkurrencë përmes praktikave të ndaluara. Gjykata u shpreh mbi zbatimin e MSA-së, duke arsyetuar se: *...nënparagrafët “ii” dhe “iii” të pikës 1 të nenit 71 të MSA-së nuk gjejnë zbatim në rastin konkret, pasi pretendimet e kërkuarit nuk ngrihen për abuzimin me pozicionin dominues, nga një ose më shumë sipërmarrje, ose dhënien e ndihmës shtetërore që shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se nuk bëhet fjalë as për situatat e parashikuara në nënparagrafin “i” të këtij neni, pasi në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me sipërmarrje, por me një organ të krijuar me ligj, ..., si dhe për propozimin e marrjes së masave administrative në rast të moszbatimit të vendimeve të Bordit të Transparencës, nga ana e operatorëve që veprojnë në këtë sektor. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar.”*²⁶ Me këtë arsyetim, Gjykata rrëzoi pretendimin se dispozitat e aktit normativ me fuqinë e ligjit, ishin në kundërshtim me detyrimet e MSA-së për konkurrencën.

MSA-ja rezulton që të jetë thirrur edhe nga subjekte “individë”, të cilët kanë paraqitur ankim kushtetues individual ndaj vendimeve gjyqësore. Kështu, në një nga çështjet e shqyrtuara, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit përmendet si bazë ligjore, në mbështetje të kërkesës së paraqitur.²⁷ Megjithatë, vetë Gjykata nuk duket ta ketë analizuar zbatimin e MSA-së në këtë vendim.

Në një rast tjetër, duke zbatuar parimin “*curia novit iura*” (gjykata e njeh ligjin), në lidhje me pretendimin për cenimin e MSA-së nga ana e gjykatave të zakonshme, Gjykata Kushtetuese, mbajti qëndrimin që vijon: *“...Kërkuarja ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e parimit të epërsisë së marrëveshjeve ndërkombëtare dhe zbatimit të drejtpërdrejtë të tyre, pasi Gjykata e Lartë ka shpërfillur nenin 7 të shtojcave 2 dhe 3 të marrëveshjes së lidhur midis qeverisë italiane dhe asaj shqiptare dhe ajo kishte detyrimin ta zgjidhte çështjen dhe ta interpretonte ligjin në përputhje me MSA-në, duke u dhënë operatorëve ekonomikë të njëjtin nivel mbrojtjeje dhe sigurie si traktatet dhe direktivat evropiane për kontratat publike. Në lidhje me këtë pretendim, për nga mënyra se*

²³ Vendim nr. 8, datë 22.02.2023 “*Shfuqizimi i ligjeve nr. 41/2022, datë 21.04.2022, nr. 7, datë 18.03.2022 dhe nr. 51/2022, datë 09.06.2022 [...] si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*” https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/vend.08_23_.pdf;

²⁴Vendim i GJK-së, nr.8, datë 22.2.2023, cituar.

²⁵ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 18.04.2023.

²⁶ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 18.04.2023 “*Shfuqizimi i ligjit nr. 39/2022 “Për miratimin e aktit normativ nr. 5, datë 12.03.2022 si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë...”*” https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/vend.21_23.pdf, parag.94

²⁷Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 51 datë 21.11.2013: Baza ligjore: *Nenet 15, 18/1, 41, pika 1 dhe 5, 42, 43, 58 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Nenet 7 dhe 8 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; Neni 73 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.*

si është parashtruar ai, Gjykata vlerëson se, në thelb, ka të bëjë me mënyrën e arsyetimit të vendimit të kundërshtuar, për rrjedhojë do të trajtohet në vijim në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit”.²⁸ Pra, në këtë rast, këtë pretendim Gjykata e kanalizoi në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe aksesit në drejtësi, pa marrë përsipër të trajtojë natyrën dhe bazueshmërinë e tyre në lidhje me zbatimin e vetë MSA-së.

Një shembull tjetër qasjeje është vlerësimi i Gjykatës mbi nenin 71 të MSA-së, që ka të bëjë me parimet e konkurrencës. Në vendimin e saj nr. 21/2023, Gjykata arsyeton se rregullat e këtij neni nuk janë të aplikueshme në rastin e një organi publik, pasi nuk kemi të bëjmë me ndërmarrje tregtare që ushtrojnë veprimtari ekonomike në kuptimin e traktateve të BE-së.²⁹ Pra, Gjykata e vlerëson se nuk ka elemente të mjaftueshme që të justifikojnë zbatimin e ndalimeve të parashikuara nga MSA-ja për këtë rast.

Komente. Fillimisht, në vendimin historik nr. 24, datë 24.07.2009, Gjykata Kushtetuese veproi në mënyrë të “guximshme” për kohën, duke shfuqizuar një vendim të Këshillit të Ministrave që kufizonte importin e lëndëve djegëse nga Bashkimi Evropian. Gjykata e interpretoi drejtpërdrejt MSA-në si një akt me fuqi më të lartë, duke theksuar se kufizimi i importit përbënte shkelje të tregut të lirë, që synohej të krijohet midis Shqipërisë dhe BE-së, sipas neneve 33 dhe 42 të Marrëveshjes. Kjo ishte hera e parë kur MSA-ja u trajtua si një burim normativ i detyrueshëm, me efekt të drejtpërdrejtë për të vlerësuar kushtetutshmërinë e një akti të brendshëm. Rëndësia e këtij vendimi qëndronte jo vetëm në përmbajtjen, por edhe në ndërtimin e një precedenti, ku Gjykata mbante qëndrimin se autoritetet shtetërore kishin detyrimin për të justifikuar çdo kufizim që mund të prekte liritë e parashikuara nga MSA-ja. Mbajmë parasysh se, kjo Marrëveshje kishte hyrë në fuqi më 1 prill 2009, ndërsa vendimi i Gjykatës Kushtetuese, mban datën 27 korrik 2009. Pra, rreth 4 muaj mbasi MSA-ja kishte hyrë në fuqi, ajo gjente zbatim të drejtpërdrejtë në jurisprudencën kushtetuese të vendit. Të njëjtin qëndrim mbajti kjo Gjykatë edhe në vendimin e saj nr.3 të vitit 2010, kur gjykoi kërkesën e Organizatës Profesionale të Ekonomistëve.³⁰

Por, qasja e Gjykatës Kushtetuese filloi të ndryshojë me kohën. Kështu, në vendimin nr. 8, të vitit 2013, Gjykata u përball me pretendimin e Këshillit të Ministrave se shfuqizimi përmes referendumit, i disa dispozitave të ligjit për menaxhimin e mbetjeve, binte në kundërshtim me detyrimet e Shqipërisë me MSA-në. Gjykata zgjodhi të mos hynte në një vlerësim substancial të përputhshmërisë së normave ligjore me MSA-në, me argumentin se gjykimi kushtetues që vlerësonte çështjet e shtruara për referendum, kishte një natyrë paraprake dhe formale. Kështu, Gjykata nuk e kreu analizën përmbajtësore të pajtueshmërisë së aktit me MSA-në, por sidoqoftë, i hapi rrugë kryerjes së Referendumit.

Një shembull i tillë evidentohet edhe në vendimin nr. 43/2023,³¹ në të cilin një individ kërkoi kontrollin e përputhshmërisë së një vendimi të Gjykatës së Lartë me MSA-në, duke pretenduar moszbatimin e standardeve evropiane për kontratat publike. Por edhe në këtë rast, Gjykata Kushtetuese nuk zhvilloi një analizë të mirëfilltë për kontrollin e aktit në lidhje me MSA-në, duke e kanalizuar çështjen në kuadrin e standardeve të procesit të rregullt ligjor dhe të arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

Më tej, në vendimet e sipërpërmendura nr. 30/2022³² dhe nr. 21/2023, duket se Gjykata ka konfirmuar karakterin kuadër të MSA-së. Ajo e paraqet marrëveshjen si një mekanizëm bashkëpunimi dhe jo si një instrument që prodhon efekt të menjëhershëm e të drejtpërdrejtë juridik për të verifikuar kushtetutshmërinë e legjislacionit kombëtar.

²⁸ Vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr.43, datë 19.9.2023, parag. 27.

²⁹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 21, dt. 18.04.2023.

³⁰ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 05.02.2010.

³¹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 19.09.2023 “Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1201 (246), datë 16.06.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.”

https://www.gjykatatushtetuese.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/Vend.43_23.pdf

³² Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 30, datë 02.11.2022 “Shfuqizimi i shprehjes “gjykata duhet të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare” në shkronjën “d” të paragrafit të pestë të nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile.”

https://www.gjykatatushtetuese.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/Vend.30_22.docx

Sipas këtyre vendimeve, MSA-ja, nuk ka natyrën e një standardi absolut, por përmban objektiva të përbashkëta, të cilat synohen të realizohen në mënyrë graduale dhe në bashkëpunim të ndërsjellë me BE-në. Ky qëndrim rezulton më i rezervuar se sa ai i mbajtur në jurisprudencën e mëparshme dhe reflekton një lloj tërheqjeje nga kontrolli aktiv i përputhshmërisë së ligjeve të brendshme, me këtë Marrëveshje.

Në përfundim, mund të themi se, përdorimi i MSA-së nga Gjykata Kushtetuese shqiptare ka kaluar nga një fazë fillestare më aktive dhe me ndikim konkret në kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve të brendshme, në një fazë më të matur dhe të përmbajtur, ku MSA-ja trajtohet si një marrëveshje strategjike, me natyrë orientuese dhe afatgjatë e jo medoemos, si një standard juridik absolut, që mund të përdoret drejtpërdrejt, për të sfiduar normat e brendshme ligjore. Ky ndryshim qasjeje mund të jetë i lidhur me kompleksitetin e rasteve e të burimeve, por edhe me vlerësimin politik të qëndrueshmërisë së sistemit të brendshëm ligjor përballë një marrëveshjeje ndërkombëtare me efekte progresive. Por, kjo qasje do të kishte si pasojë zbatueshmërinë e MSA-së të varur nga vullneti politik i dy pushteteve të tjera, legjislativ dhe ekzekutiv.

Në vështrimin tonë, raporti midis MSA-së dhe të drejtës vendase është një fushë dinamike e së drejtës kushtetuese shqiptare, që meriton vëmendje të vazhdueshme teorike dhe praktike. Ne e shohim kontributin e Gjykatës Kushtetuese si mjaft të rëndësishëm për procesin e integritetit të vendit, përmes zbatimit të drejtpërdrejtë të dispozitave të MSA-së. Një pikëpamje e tillë është shprehur hershëm nga studiuesit e së drejtës. Zbatimi i drejtpërdrejtë është bazuar jo vetëm në pozicionin e saj kushtetues si një marrëveshje klasike e të drejtës ndërkombëtare publike (122/1,2),³³ por edhe në kuadrin e “klauzolës së epërsisë” mbi të drejtën e vendit e parashikuar në nenin 122/3 të Kushtetutës së Shqipërisë.³⁴

4. Jurisprudenca e gjykatës evropiane të drejtësisë në jurisprudencën kushtetuese

Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED) është Gjykata e Lartë e BE-së, për çështjet e të drejtës së BE-së. Meqenëse Shqipëria nuk është ende një shtet anëtar i BE-së, nuk përfshihet ende në juridiksionin e saj. Sidoqoftë, zhvillimi i “dialogut gjyqësor” në konstitucionalizmin global, si dhe qasja indirekte ndaj saj në kuadrin e zbatimit të MSA-së, i hap rrugën referimeve e citimeve të vendimeve të kësaj gjykate nga gjykatat shqiptare. Nga studimi u identifikua se Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë e referoi për herë të parë jurisprudencën e GJED-së në vitin 2008, kur ajo shqyrtoi pretendimet e kërkuases³⁵ se një akt legjislativ³⁶ kishte cenuar veprimtarinë e lirë ekonomike, parashikuar nga neni 11 i Kushtetutës.³⁷ Theksojmë se në këtë kohë, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, megjithëse ishte nënshkruar dhe ratifikuar nga Shqipëria, ende nuk kishte hyrë në fuqi, pasi nuk kishte përfunduar procesi i ratifikimit të të gjitha vendeve të Bashkimit Evropian. Nga analiza e vendimit gjyqësor, vërejmë se pretendimet e kërkuases dhe palëve të tjera nuk i janë referuar jurisprudencës së GJED-së, apo ndonjë traktati të BE-së ose MSA-së. Ato i janë referuar vetëm parashikimeve kushtetuese për lirinë ekonomike. Por, Gjykata, për t’i dhënë një kuptim rregullimit mbi lirinë ekonomike që parashikon ligji themelor i vendit, si dhe duke ecur mbi bazën e perspektivës evropiane të vendit, iu referua jurisprudencës së GJED-së. Në vendimin e saj, nr.10/2008, “Gjykata Kushtetuese çmon se, për rastin konkret, shtimi i kriterëve nga ana e ligjvënësit me qëllim ushtrimin e një veprimtarie të caktuar, është brenda hapësirës së tij të veprimit dhe vlerësimit. Është e drejtë e ligjvënësit të vlerësojë rast pas rasti nevojën e ndërhyrjes me anë të një rregullimi të ri. ...Në respektim të interesit publik, pranohen si kufizime të arsyeshme të lirisë së veprimtarisë ekonomike iniciativat e ligjvënësit, të cilat

³³ Shih: Anastasi, A., *Zbatimi i drejtpërdrejtë i akteve ndërkombëtare të ratifikuara dhe epërsia e tyre mbi ligjet e vendit në rast përplasjeje*, në Omari L., Anastasi A., “E drejta Kushtetuese”, Tiranë, 2017, f. 55-57

³⁴ Shih: Kellerman A., *Efektet Ligjore të Marrëveshjeve të Asociimit me BE-në, për shtetasit e vendeve joanëtare*, në “E drejta Parlamentare dhe Politikë Ligjore”, Nr.41, Viti 2008 dhe Zaganjori Xh., Anastasi A., Çani E., Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e RSh-së, Tiranë, 2011, f. 66-71.

³⁵ Shoqata “Lidhja e biznesmenëve të lojrave elektronike”.

³⁶ Ligji nr.9744, datë 28.05.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8701, datë 01.12.2000 “Për lojrat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, i ndryshuar.

³⁷ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 19.3.2008.

shërbejnë për një rregullim të tregut apo interesave të një shteti social”. Këto dhe pasazhe të tjera shoqërohen me shënimet fundore, në të cilin pasqyrohen vendimet vijuese të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.³⁸

Në vitin 2014, Gjykata Kushtetuese u vendos përsëri në lëvizje për çështje të lirisë ekonomike nga një organizatë tjetër³⁹. Në këtë rast u ngrit pretendimi se, dhënia me koncesion e mënyrës së markimit të karburantëve cenonte ndër të tjera edhe lirinë e veprimtarisë ekonomike. Kërkesja ngriti pretendime për cenim të marrëveshjes së OBT-GATT (Marrëveshje e Përgjithshme për Tregtinë dhe Tarifat e Organizatës Botërore të Tregtisë) dhe Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese, me nismën e saj, arsyetoi se, “...në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit, praktikat në kundërshtim me nenin 71 (konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike) vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës së aplikueshme në Komunitet, sidomos të neneve 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian, dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit. Në këto kushte, ashtu si edhe në gjykime të mëparshme, Gjykata e sheh me vend t’i referohet jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED), lidhur me zbatimin e rregullave të konkurrencës në respektim të kësaj marrëveshjeje.”⁴⁰ Në këtë rast, për arsyetimin e vendimit, Gjykata Kushtetuese u referua në disa vendime të GJED-së. Konkretisht, kjo e fundit, mbikëqyrjen e aktivitetit kundër ndotjes në portin e Gjenovës, e kishte konsideruar si aktivitet të natyrës joekonomike, për të cilin justifikohet përjashtimi nga rregullat e konkurrencës C-343/95, *Cali v. Servizi ecologici porto di Genova SpA*, (perifrazim nga Gjykata Kushtetuese parag.16-23). Po kështu, në një çështje tjetër, GJED-ja kishte mbajtur qëndrimin se aktivitetet e kontrollit dhe mbikëqyrjes ajrore janë aktivitete tipike të ushtrimit të autoritetit publik dhe si të tilla, ato nuk ishin të natyrës ekonomike që të detyronin zbatimin e rregullave të konkurrencës (C-364/92, *SAT Fluggesellschaft mbH v Eurocontrol*, prg.30). GJED-ja u shpreh se, dispozita e nenit 90/2 të Traktatit u lejon shteteve që sipërmarrjeve që u ngarkojnë realizimin e shërbimeve të interesit të përgjithshëm ekonomik, t’u akordojnë të drejta ekskluzive, të cilat mund të pengojnë zbatimin e rregullave të Traktatit për konkurrencën, “... për sa kufizimet e konkurrencës, ose edhe përjashtimi i gjithë konkurrencës, nga operatorët e tjerë ekonomikë, janë të nevojshme për të siguruar kryerjen e detyrave specifike që u janë ngarkuar sipërmarrjeve të pajisura me të drejtat ekskluzive (C-320/91, *Paul CORBEAU*, prg.14)”⁴¹.

Nga arsyetimi i mësipërm, konstatojmë se përmes referimit të GJED-së, Gjykata Kushtetuese bëri lidhjen e parashikimeve të normave të MSA-së me normat respektive të traktatit të BE-së. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese nuk mund të bënte një interpretim të vetin, përse interpretimi i akteve të BE-së është kompetencë e GJED-së. Ajo u kujdes që të mos krijonte një jurisprudencë paralele. Prandaj, iu referua jurisprudencës së GJED-së, në çështjet që lidheshin me Traktatin e BE-së.

Në një rast vijues, Gjykata Kushtetuese u vendos në lëvizje nga Presidenti i Republikës për një çështje që kishte të bënte me natyrën e një ligji të veçantë, i cili rregullonte ndërtimin e një teatri të ri kombëtar.⁴² Edhe në këtë rast, kërkesi ngriti pretendime për lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe pajtueshmërinë e ligjit me MSA-në. Gjykata Kushtetuese, iu referua vendimit të sipër cituar dhe arsyetoi: “Gjykata në lidhje me lirinë ekonomike i është referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED), për zbatimin e rregullave të konkurrencës, duke theksuar se ashtu sikundër vepron edhe GJED-ja, duhet bërë dallimi mes faktit nëse shteti mund të veprojë duke ushtruar autoritet publik ose duke ndërmarrë kryerjen e aktiviteteve ekonomike të natyrës tregtare, industriale, për të prodhuar dhe ofruar mallra e shërbime në treg. Me qëllim që të arrihet të bëhet ky dallim, është e nevojshme që në çdo çështje të vlerësohet veprimtaria e ushtruar nga shteti dhe të përcaktohet se

³⁸ Po aty, shënimet fundore nr.1, 2 dhe 5: “Shih praktikën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në Luksemburg: çështja 8/74 *Procureur du Roi kundër Dassonville* (1974) ECR 837 ; çështja *Saeger kundër Dennemeyer* (1991) ECR i-4221 ... Vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në Luksemburg i 4 korrik 2000, çështja *Haim*, C-424/97, Rec p.I-5123 ... Vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në Luksemburg i 21 shtator 1999, *Laara dhe të tjerë* C-124/97, Rec.p.I-6067”.

³⁹ Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve.

⁴⁰ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. nr.14, datë 21.3.2014.

⁴¹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. nr.14, datë 21.3.2014, parag. 32.

⁴² Ligji nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”

*cilës kategori i përkasin këto aktivitete....*⁴³ Në arsyetim, Gjykata Kushtetuese shtjellon referencat në vendimin e GJED-së, duke arsyetuar parimin e barazisë, si një bazë të rëndësishme për çështjet e konkurrencës dhe të lirisë ekonomike. “...GJED-ja është shprehur se nëse një masë e ndërmarrë nga shteti passjell pabarazi mundësisht midis operatorëve ekonomikë dhe, për rrjedhojë, shtrembëron konkurrencën, atëherë një masë e tillë përbën një shkelje të ligjit të BE-së për konkurrencën (C-462/99, *Connect Austria Gesellschaft für Telekommunikation GmbH kundër Telekom-Control-Kommission*, 22 maj 2003, § 84). Edhe kur objekt i shqyrtimit kanë qenë prokurimet publike, GJED-ja ka arritur në përfundimin se sipas parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, qëllimi i të cilit është të promovojë zhvillimin e një konkurrence të shëndetshme dhe efektive midis operatorëve që marrin pjesë në një procedurë prokurimi publik, këtyre të fundit duhet t'u jepen mundësi të barabarta në formulimin e ofertave të tyre, çka nënkupton që operatorët duhet t'i nënshtrohen të njëjtave kushteve (T 292/15, *Vakakis kai Synergates — Symvouloi gia Agrotiki Anaptixi AE Meleton kundër European Commission*, 12 shkurt 2019, §§ 97 dhe 100).⁴⁴

Nga sa më lart, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në vendimin e saj vlerësoi se: “...liria e veprimtarisë ekonomike në një ekonomi tregu të shëndoshë është e lidhur ngushtë me konkurrencën. Një sistem efikas ekonomik duhet të evidentojë dhe t'i hapë rrugë promovimit të konkurrencës së lirë të operatorëve të tij, me qëllim që të maksimalizojë mirëqenien ekonomike-sociale”.⁴⁵ E veçanta në këtë vendim është se, referimi është bërë edhe në çështjet e Gjykatës së Përgjithshme, e cila është gjykata e shkallës së parë të Bashkimit Evropian. Konstatohet gjithashtu se, në këtë rast, referimi në jurisprudencën e GJED-së ka pasur një ndikim të rëndësishëm për zgjidhjen e çështjes dhe arsyetimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Në rastin më të ri, gjykuar në vitin 2024, Gjykata Kushtetuese u vendos në lëvizje nga tre organizata,⁴⁶ të cilat kundërshtonin dhënien me koncesion të ndërtimit të një dige të re në lumin e Skavicës. Kërkueset kanë ngritur pretendime duke u bazuar në jurisprudencën e GJED-së, por ato nuk morën përgjigje për këtë, pasi Gjykata Kushtetuese e zgjidhi çështjen duke iu referuar Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës për çështje që lidhen me mjedisin” (Konventa e Aarhusit), ratifikuar me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000 nga Shqipëria.⁴⁷ Kjo çështje të bën të reflektosh edhe për konkurrencën e akteve ndërkombëtare që zbaton gjykata. Sidoqoftë, ne mendojmë se, kur jep përgjigje për të gjitha pretendimet e palëve, Gjykata Kushtetuese duhet të arsyetojë se përse hedh poshtë bazën normative të pretenduar nga palët. Pra, në këtë rast duhet të kishte arsyetuar se përse nuk po e merr në konsideratë jurisprudencën e GJED-së.

Komente. Sa më sipër, rezulton se Gjykata Kushtetuese i ka referuar vendimet të GJED-së si burim interpretimi për parimet kushtetuese, kryesisht në fushën e lirisë ekonomike dhe të tregut të lirë. Një nga shfaqjet e para të këtij ndikimi është vendimi nr. 10, datë 19.03.2008, kur në mungesë të një referimi të drejtpërdrejtë ndaj MSA-së apo traktateve të BE-së nga palët në proces, Gjykata vetw ndërtoi një analizë mbi nocionin e lirisë ekonomike duke u mbështetur në konceptet e zhvilluara nga GJED-ja në çështjet *Dassonville*, *Saeger*, *Haim* dhe *Laara*. Kjo qasje përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt integritimit të parimeve evropiane në të drejtën kushtetuese shqiptare, për më tepër në një kohë kur MSA-ja ende nuk kishte hyrë në fuqi.

Përjasja ndaj jurisprudencës së GJED-së ishte e dukshme në vendimin nr. 14, datë 21.03.2014, ku Gjykata Kushtetuese trajtoi çështjen që kishte të bënte me një koncesion për markimin e karburanteve. Në këtë rast, kërkuesja ngriti pretendime mbi cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe mosrespektimin e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja. Gjykata, duke e konsideruar Marrëveshjen si pjesë të rendit juridik të brendshëm, iu referua neneve të Traktatit të Komunitetit Evropian dhe jurisprudencës së GJED-së për të vlerësuar nëse masat e ndërmarra nga shteti shqiptar përbënin pengesë për konkurrencën. Ajo risolli në vëmendje çështje të rëndësishme si *Cali*, *Eurocontrol* dhe *Corbeau*, duke vënë në dukje nevojën për të dalluar aktivitetet ekonomike nga aktivitetet që

⁴³ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 29 datë 02.07.2021, parag.59.

⁴⁴ Po aty, parag. 60.

⁴⁵ Po aty, parag. 61.

⁴⁶ Shoqata “Kundërshtimi ndaj Digës së Skavicës”, Shoqata “Për mbrojtjen e pronave dhe mjedisit të pellgut të Drinit të Zi” dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

⁴⁷ Vendimi nr. 3 datë 30.1.2024 i Gjykatës Kushtetuese.

rrjedhin nga ushtrimi i autoritetit publik. Kjo çështje, dëshmoi një qasje metodologjike që synonte të harmonizonte interpretimin e së drejtës kombëtare me standardet evropiane të vendosura nga GJED-ja.

Ky harmonizim u thellua më tej me vendimin nr. 29, datë 02.07.2021, në të cilin Gjykata përforcoi përdorimin e jurisprudencës së GJED-së për të vlerësuar nëse shteti kishte ndërhyrë në mënyrë të arsyeshme në treg dhe nëse kishim të bënim me një aktivitet të natyrës publike dhe ekonomike. Ajo përmendi qartësisht çështje si *Connect Austria* dhe *Vakakis*, duke e vendosur analizën e saj në përputhje me interpretimin e GJED-së, për rregullat e konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë në prokurimet publike. Në këtë mënyrë, Gjykata Kushtetuese shqiptare konfirmoi rëndësinë e ruajtjes së një mjedisi të ndershëm ekonomik dhe të konkurrencës së lirë, duke konsoliduar lidhjen mes Kushtetutës dhe parimeve të së drejtës evropiane.

Në përfundim mund të themi se, praktika e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë tregon një evolucion të qartë drejt një integrimi substancial të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në analizën kushtetuese. Kjo qasje është e theksuar vetëm përse i përket lirisë ekonomike, pasi jurisprudenca jonë kushtetuese e njehson kuptimin kushtetues të saj me atë të Bashkimit Evropian. Ky është një zhvillim thelbësor për përgatitjen e vendit në procesin e integritimit dhe për forcimin e shtetit të së drejtës, në përputhje me vlerat dhe standardet që mishëron Bashkimi Evropian.

Nga studimi rezulton se citimi i vendimeve të kësaj gjykate, ka qenë në fillim në një formë “akademike” me shënime fundore, por më vonë ka evoluar duke u përfshirë në vetë përmbajtjen e arsytimit gjyqësor. Fakti që Gjykata Kushtetuese nuk përcakton qartë nëse i është referuar Gjykatës së Përgjithshme të BE-së (që vepron si gjykatë e shkallës së parë) apo Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (që vepron si gjykatë e shkallës së dytë dhe gjykata më e lartë e BE-së), mendojmë se përbën mangësi në referim. Megjithatë, dallimi mund të kuptohet nga numri i çështjes, pasi çështjet pranë Gjykatës së Përgjithshme fillojnë me germën “T”, ndërsa çështjet pranë GJED-së fillojnë me germën “C”. Meqenëse këto dy gjykata gjykojnë në “dhoma” dhe në “dhomën e madhe”, do të ishte e udhës që Gjykata Kushtetuese të referonte edhe këtë fakt.

5. Traktati për funksionimin e bashkimit evropian në jurisprudencën kushtetuese

Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE)⁴⁸ është akti themelor i së drejtës të Bashkimit Evropian dhe një prej dokumenteve më të rëndësishme në historinë e integritimit evropian. Ai, jo vetëm rregullon funksionimin e zakonshëm të institucioneve të BE-së, por është themel për zhvillimin e së drejtës së brendshme të shteteve anëtare. TFBE nuk është një akt i detyrueshëm drejtpërdrejt për zbatim nga gjykatat shqiptare. Megjithatë, nga studimi rezulton se TFBE është referuar drejtpërdrejt në të paktën dy raste, nga pretendimet e kërkuessve. Objekti i gjykimit drejtohej në kundërshtimin e dy akteve normative me fuqinë e ligjit (nr. 5, datë 12.3.2022 dhe nr. 7, datë 18.3.2022) të miratuara nga Këshilli i Ministrave, si dhe të ligjeve të tyre miratuese (nr.39/2022 dhe nr.41/2022). Ndër pretendimet e ngritura nga kërkuessit shtrohej se aktet objekt gjykimi cenonin lirinë ekonomike, siç është parashikuar nga neni 101 i TFBE-së.⁴⁹ Gjykata Kushtetuese u përball edhe me

⁴⁸ Ky traktat u nënshkrua më 13 dhjetor të vitit 2007 në Lisbonë dhe kishte për qëllim të thjeshtonte e forconte strukturën institucionale të Bashkimit Evropian. Traktati i Lisbonës shënoi një moment vendimtar në historinë e BE-së, pasi ai zëvendësoi Traktatin e Komunitetit Evropian (TEC) dhe e ristrukturoi të gjithë rendin juridik të Bashkimit. Pas ratifikimit nga të gjitha shtetet anëtare, TFBE hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009, duke vendosur një sistem të ri të qartë, të qëndrueshëm dhe më transparent të të drejtës evropiane.

⁴⁹ TFBE, neni 101: 1. Janë të ndaluara, si të papajtueshme me tregun e brendshëm: të gjitha marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve, vendimet e shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikat e bashkërenduara që mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare dhe që kanë për objekt ose efekt parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës brenda tregut të brendshëm, dhe në veçanti ato që:

(a) përcaktojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi çmimet e blerjes apo shitjes ose çdo kusht tjetër tregtar;

(b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;

(c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;

Emri i Autorit

pretendime të kërkuarve që mbështeteshin në nenin 101 të TFBE-së, për rregullat e konkurrencës dhe ndalimin e marrëveshjeve që mund të dëmtojnë konkurrencën në tregun e përbashkët. Logjika e kërkuarve mëshonte në faktin se Shqipëria është në procesin e integritimit të saj në Bashkimin Evropian, prandaj nuk mund të miratojë ligje që bien në kundërshtim me traktatet e kësaj organizate. Sipas kërkuarve, kjo qasje ishte një detyrim që buronte nga Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit (MSA).

Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj i konsideroi këto pretendime jashtë juridiksionit kushtetues, me argumentin se, *“Gjykata vlerëson, gjithashtu, se në kushtet kur Republika e Shqipërisë nuk i ka përmbyllur ende procedurat për integritimin në Bashkimin Evropian, edhe pretendimet e kërkuarve se aktet e kundërshtuara cenojnë TFBE-në qëndrojnë jashtë juridiksionit të saj, pasi ky akt nuk është pjesë e rendit juridik shqiptar. Këtë qëndrim Gjykata e ka mbajtur edhe në çështje të tjera, ku janë ngritur pretendime të ngjashme (shih vendimin nr. 30, datë 2.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese)”*.⁵⁰

I njëjti qëndrim u mbajt edhe në një vendim të mëvonshëm, ku Gjykata Kushtetuese u shpreh ngjashëm se: *“Po kështu, kërkuarve pretendon se aktet normative janë në kundërshtim me nenin 101 të TFBE-së. Për pretendimet që lidhen me cenimin e parimeve të traktateve evropiane, Gjykata ka vlerësuar se në kushtet kur Republika e Shqipërisë nuk i ka përmbyllur ende procedurat për integritimin në Bashkimin Evropian, ato qëndrojnë jashtë juridiksionit të saj (shih vendimin nr. 30, datë 2.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese). Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuarve nuk mund të jetë objekt i kontrollit kushtetues në rastin konkret”*.⁵¹

Për sa më sipër, duket se Gjykata Kushtetuese është rezervuar të trajtojë këtë dokument dhe ta interpretojë ligjin në këndvështrimin e tij, për shkak të statusit juridik të Shqipërisë si vend kandidat për Bashkimin Evropian. Megjithatë TFBE-ja është akti themelor i së drejtës së BE-së, i cili përcakton funksionimin institucional të këtij bashkimi, ai nuk është pjesë formale e rendit juridik shqiptar pa ratifikimin përkatës nga Kuvendi, sipas kërkesave të neneve 121 dhe 122 të Kushtetutës së Shqipërisë. Gjykata, në të dyja rastet, i konsideroi këto pretendime jashtë juridiksionit të saj, me arsyetimin se Shqipëria nuk ka përfunduar ende procedurat e integritimit në BE dhe se TFBE-ja, nuk është pjesë e rendit juridik të brendshëm. Ky qëndrim u mbështet në argumentin se pa një ratifikim të plotë sipas nenit 121 të Kushtetutës dhe pa u bërë pjesë e detyrimeve të brendshme përmes nenit 122, TFBE-ja nuk mund të krijojë të drejta apo detyrime për palët në një proces kushtetues.

Duhet vënë në dukje se edhe në momentin e integritimit të Shqipërisë në BE, neni 267 i Traktit të TFBE-së⁵² kërkon që gjykatat vendase, kur vërejnë se një akt i legjislacionit të brendshëm bie në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, madje edhe me vetë traktatin, ato duhet ta pezullojnë çështjen dhe t’ia dërgojnë GJED-së, e cila vendos përfundimisht. Megjithatë, përdorimi i metodave të interpretimit krahasimor me legjislacionin e BE-

(d) zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të barasvlershme me palë të tjera tregtare, duke i vendosur ato në një pozicion të pafavorshëm konkurrues;

(e) kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga pala tjetër të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose sipas zakonit tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e kontratës.

2. Çdo marrëveshje ose vendim i ndaluar sipas këtij neni është automatikisht i pavlefshëm.3...

⁵⁰ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 8, datë 22.2.2023, parag.25.

⁵¹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr.21, datë 18.4.2023, parag.25

⁵² TFBE, neni 267: Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka kompetencë të japë vendime paraprake mbi:

- interpretimin e traktateve,

- vlefshmërinë dhe interpretimin e akteve të miratuara nga institucionet, organet ose agjencitë e Bashkimit.

Kur një çështje e tillë ngrihet përpara një gjykate të një shteti anëtar, kjo gjykatë mund, nëse e konsideron të nevojshme për të dhënë vendimin, t’i drejtohet Gjykatës për një vendim mbi këtë çështje. Nëse një çështje e tillë ngrihet përpara një gjykate të një shteti anëtar, vendimet e së cilës nuk mund të apelojnë sipas legjislacionit të brendshëm, ajo është e detyruar t’i drejtohet Gjykatës. Nëse një çështje që ngrihet në një procedurë gjyqësore përpara një gjykate kombëtare ka të bëjë me vlefshmërinë e një akti të miratuar nga institucionet, organet apo agjencitë e Bashkimit, ajo gjykatë nuk ka kompetencë të shpallë aktin të pavlefshëm vetë, por duhet t’ia paraqesë çështjen Gjykatës së Drejtësisë.

së, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe i referimit të GJED-së, do ta rriste mundësinë e zgjidhjes së çështjes në këndvështrimin e përafrimit me legjislacionin e BE-së. Në këtë mënyrë, do të rritej edhe kontributi i Gjykimit Kushtetues për institucionet e tjera në lidhje me përafrimin e legjislacionit.

6. Konkluzione

Nga studimi dhe monitorimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese rezulton se Gjykata Kushtetuese kontribuon në përafrimin e legjislacionit të vendit me atë të Bashkimit Evropian në kuadrin e ushtrimit të kontrollit të pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Gjetjet e studimit dëshmojnë se kjo bëhet e mundur përmes interpretimit krahasimor, veçanërisht të ashtuquajturit “dialogu gjyqësor kushtetues”. Ky dialog është fokusuar në mënyrë të veçantë në vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Ky interpretim gjyqësor rezulton një metodologji mjaft e dobishme për të nxitur dhe mbështetur harmonizimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian. Prandaj, ka nevojë të mbështetet edhe nga teoria e së drejtës, përmes studimeve të çështjeve e rezultateve të kësaj metode. Përmes këtij dialogu janë siguruar interpretime e zbërthime të të drejtave dhe lirive themelore, veçanërisht të iniciativës së lirë ekonomike. Gjithashtu, janë interpretuar akte që lidhen me respektimin e rregullave evropiane të konkurrencës, ndalimit të situatës së monopoleve, garantimit të sigurisë juridike në fushën ekonomike, etj. Nga ana tjetër, studimi ka gjetur se përafrimi i legjislacionit shqiptar mbështetet nga Gjykata Kushtetuese në rastet kur ajo zbaton Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit të Shqipërisë me BE-në, për zgjidhjen e çështjeve që shqyrton. MSA-ja është një burim i përbashkët, si për legjislacionin e BE-së, edhe për legjislacionin shqiptar. Interpretimi që ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese në këtë rast, është i detyrueshëm për këtë shkak. Prandaj, referimi i MSA-së vetëm si një akt me karakter orientues mendojmë se është i pamjaftueshëm. Zbatimi i drejtpërdrejtë i dispozitave të saj është një bazë e mirë për të mbështetur përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së. Shohim se Gjykata Kushtetuese nuk ka zhvilluar referencat në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian, pasi ajo nuk ka diskrecion të interpretojë këtë akt. Sidoqoftë, interpretimi krahasimor me aktet e BE-së, kur është rasti, mbetet një mundësi e mirë që procesi kushtetues të kontribuojë në harmonizimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së. Studimi evidentoi edhe disa dallime midis jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe studiuesve, që e kanë interpretuar nenin 122/3 të Kushtetutës së Shqipërisë si një mundësi për gjyqësorin që të referohet drejtpërdrejt në të drejtën e BE-së. Në këtë aspekt, Gjykata tregohet “më e matur” se sa studiuesit e së drejtës.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Alimehmeti, Evis, Caka, Fjoralba, *The Relationship between International and Domestic Law in the Albanian Legal System*, në *International Constitutional Law*, editor Luca Mezzetti, et al. G. Giappichelli Editore Publishing House, 2014, Turin, Italy.
2. Anastasi, Aurela, *Using Foreign Precedents to Meet the European Standards: The case of the Constitutional Court of Albania*, në “Judicial Bricolage. The Use of Foreign Precedents by Constitutional Judges in the 21st Century”, (eds. Tania Groppi, Marie-Claire Ponthoreau, Irene Spigno), *Hart Studies in Comparative Public Law*, 2025, Vol.32.
3. Beqiraj, Pranvera & Dorina Gjipali, ‘Stabilization and Association Agreement in the Jurisprudence of the Albanian Constitutional Court’, *Juridical Tribune – Review of Comparative and International Law* 14, no. 3 (October 2024): 452-464
4. “Judicial Bricolage. The Use of Foreign Precedents by Constitutional Judges in the 21st Century”, (eds. Tania Groppi, Marie-Claire Ponthoreau, Irene Spigno), *Hart Studies in Comparative Public Law*, 2025, Vol.32.

Emri i Autorit

5. Kellerman A., *Efektet Ligjore të Marrëveshjeve të Asociimit me BE-në, për shtetasit e vendeve joanëtare*, në “E drejta Parlamentare dhe Politikat Ligjore”, Nr.41, Viti 2008.
6. Rado, Klodian, *Rëndësia dhe roli i pushtetit gjyqësor në integrimin European të Shqipërisë*, në “Shteti i së drejtës në proceset integruese të Shqipërisë, ASHSH, Tiranë, 2023
7. Omari L., Anastasi A., “E drejta Kushtetuese”, Tiranë, 2017.
8. “The use of foreign precedents by constitutional judges”, Edited by Tania Groppi and Marie-Claire Ponthoreau, Hart Publishing, Oxford and Portland, Oregon 2013
9. Zaganjori Xhezair, Anastasi Anastasi, Methasani Eralda, “Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, Tiranë, 2011
10. Zagrebelsky G., “Cinquanta anni di attivita della Corte Costituzionale”, Campidoglio, (2006), 5, available at https://www.cortecostituzionale.it/documenti/filesDoc/Zagrebelsky_22_aprile_2006_2.pdf

Legjislacion

1. Konventa e Aarhusit ratifikuar me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000 nga Shqipëria.
2. Ligj nr. 15, datë 05.03.2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.
3. Ligj nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar””.
4. Ligj nr. 8577, datë 10.02.2000 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”;
5. Ligj nr. 9590, datë 27.07.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare.” Fletorja Zyrtare, 87.
6. Ligj nr.9744, datë 28.05.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8701, datë 01.12.2000 “Për lojrat e fatit, kazinotë dhe hipodromet””, i ndryshuar.
7. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), nënshkruar nga Shqipëria në 12 qershor 2006 dhe ratifikuar me ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006, hyrë në fuqi më 1 prill 2009.
8. Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian, nënshkruar më 13 dhjetor të vitit 2007 në Lisbonë dhe hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009.

Jurisprudencë

1. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 19.3.2008.
2. Vendim Gjykatës Kushtetuese nr. 24, datë 24.07.2009.
3. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 24, datë 24.7.2009.
4. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.8, datë 8.03.2013.
5. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 51 datë 21.11.201
6. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 14 datë 21.03.2014 (V-14/14
7. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 21.03.2014.
8. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 29 datë 02.07.2021.
9. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 30, datë 02.11.2022.
10. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 88, datë 22.02.2023.
11. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.8, datë 22.02.2023.
12. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.21, datë 18.04.2023.
13. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 18.4.2023.
14. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.43, datë 19.9.2023.
15. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 3 datë 30.1.2024.
16. C-343/95, *Cali v. Servizi ecologici porto di Genova SpA*, (perifrazim nga Gjykata Kushtetuese parag.16-23).

17. C-364/92, *SAT Fluggesellschaft mbH v Eurocontrol*, prg.30.
18. C-462/99, *Connect Austria Gesellschaft für Telekommunikation GmbH kundër Telekom-Control-Kommission*, 22 maj 2003, § 84.
19. T 292/15, *Vakakis kai Synergates - Symvouloi gia Agrotiki Anaptixi AE Meleton kundër European Commission*, 12 shkurt 2019, §§ 97 dhe 100.

Web faqe

1. https://www.qbz.gov.al/share/ZTJ1_Xi1SEKgzF5TDkeeMQ
2. <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/02/22/88>
3. <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/03/05/15>
4. https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/wpcontent/uploads/2024/12/vend.24_date_24.07.2009.dochttps://www.gjykatakushtetuese.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/vend_0813.doc
5. https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/vend.08_23_.pdf
6. https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/vend.21_23.pdf
7. https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/Vend.30_22.docx
8. https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/Vend.43_23.pdf

TENDENCAT E REJA DHE LLOJET E PËRGJEGJËSISË CIVILE NË EPOKËN E DIGJITALIZIMIT

Doktorante Elena FILIP*
Prof. Dr. Kestrin KATRO**

NEW TRENDS AND FORMS OF CIVIL LIABILITY IN THE DIGITALIZATION ERA

Abstract

This article explores the evolving forms and emerging trends of civil liability in the digital era. Traditionally understood as a legal institution requiring individuals to compensate for harm caused to others, civil liability has undergone significant transformations due to rapid technological advancements. Innovations such as artificial intelligence, blockchain, and the internet of things have challenged traditional fault-based liability, shifting the focus towards objective liability models. This shift is especially prominent in the face of new risks introduced by digital technologies, where the boundaries of fault and responsibility are increasingly blurred.

As society, technology, and legal theory evolve, the limitations of fault as the sole criterion for liability have become apparent. Consequently, civil liability is being reconceptualized in a global context to address not just interpersonal relationships but also broader societal and technological impacts. This paper examines both subjective and objective liability, with a focus on the growing importance of victim protection and the need for legal systems to adapt to technological changes. By analyzing these shifts, the article highlights how civil liability must evolve to ensure fair compensation while adapting to the new technological reality.

Keywords: *civil liability, damage, technological systems, objective liability, artificial intelligence*

1. Hyrje

Përgjegjësia civile është një koncept juridik që lidhet me detyrimin e subjekteve për të kompensuar dëmet që i shkaktojnë një pale tjetër¹, duke mundësuar kështu që pasojat e një dëmi të padrejtë të mos mbahen nga pala që i vuan, por nga ajo që i shkakton ato². Përgjegjësia civile është një nga rregullimet e shkencës juridike që për shkak të fleksibilitetit që gëzon, ka evoluar më së shumti, duke njohur një zhvillim që i përshtatet kërkesave të kohëve

* Doktorante Elena Filip është pedagoge e brendshme në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

** Prof. Dr. Kestrin Katro është pedagoge e brendshme në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

¹ Kastrati, Gani. *E Drejta Civile*. Prishtinë: Shtëpia Botuese Dukagjini, 2018.

² Shina, Fernando. *Las nuevas tendencias en materia de responsabilidad*. Argjentinë: Sistema argentino de información jurídica, 2018, i disponueshëm në:

<https://www.saij.gob.ar/fernando-shina-nuevas-tendencias-materia-responsabilidad-dacf180271-2018-12-18/1234567890abcdefg172081fcanirtcod?&o=7&f=Total%7CFecha%7CEstado%20de%20Vigencia%5B%2C1%5D%7C>

Tema/Derecho%20penal/delitos%20contra%20la%20propiedad%7COrganismo%5B%2C1%5D%7CAutor%5B%2C1%5D%7CJurisdicci%F3n%5B%2C1%5D%7CTribunal%5B%2C1%5D%7CPublicaci%F3n%5B%2C1%5D%7CColecci%F3n%20tem%El tica%5B%2C1%5D%7CTipo%20de%20Documento/Doctrina&t=98#

të reja dhe që përlligj më së miri faktorët shoqërorë që strukturojnë dhe dimensionojnë shoqërinë moderne sot³. Ndikim në ndryshimin e saj ka ndërgjegjësimi më i madh i qytetarëve ndaj ekzistencës së të drejtave dhe mbrojtjes ligjore që gëzojnë, ashtu si dhe incidenca e shkencës dhe teknologjisë që krahas benefiteve, shtoi dhe rreziqet ndaj shkeljes ose cënimit të këtyre të drejtave përmes përdorimit masiv të forcës dhe energjisë, shtimit të ushtrimit të veprimtarive të rrezikshme, rritjes së fuqisë prodhuese dhe konsumatore si dhe ndërmarrjes së aktiviteteve të reja me risk të lartë⁴.

Faktorët që ndryshuan fushën e përgjegjesisë civile, kanë ndikuar që sot të rishikohen disa nga postulatet klasike dhe parimet bazë të saj duke sjellë eventualisht të ashtuquajturën "*kriza aktuale e përgjegjesisë civile*".⁵ Kështu, në shoqërinë e shekullit të XXI, shqetësimet e ndryshme që i referohen vetë personit, si viktimit e dëmit, kanë ndikuar në forcimin e të drejtave dhe pozitave të tij në aspektin e përgjegjesisë civile, duke zhvendosur fokusin nga elementi i fajit tek elementi i dëmit.⁶

Në të drejtën moderne të dëmit, fokusi është kthyer tek mbrojtja e të dëmtuarit, duke riformuluar parakushtet e vjetra të institutit të përgjegjesisë civile, përmes rielaborimit të mënyrës të dëmshpërblimit, në një strukturë të re, më funksionale dhe elastike që i përgjigjet zhvillimeve të kohës ku po jetojmë.⁷ Kjo përjasje e re ka bërë që përgjegjësia civile të kthehet në një mjet të rregullimit shoqëror, që edukon dhe ndihmon të mos dëmtojmë dhe të mos dëmtohem; parandalon sjellje të dëmshme e antishoqërore; garanton të drejtat e palëve për moscënim të tyre si dhe shpërblen gjithë dëmet e mundshme që vijnë nga veprimet e padrejta që iu shkaktohen atyre apo të tretëve.⁸ Ky këndvështrim ka ndihmuar që palët ti rikthehen gjendjes së mëparshme, pa dëm, duke i dhënë fushës së përgjegjesisë civile gjithë karakteristikat restauruese, riparuese, kompensuese, rintegruese e balancuese që i takojnë⁹. Këto karakteristika përballë përparimeve të jashtëzakonshme teknologjike, i shërbejnë asaj të përballojë gjithë dëmtimet, risqet dhe transformimet teknologjike që po shfaqen, duke mundësuar që viktimat e dëmit të mos mbeten pa kompensim dhe të dëmshpërblehen në kushte të barabarta dhe të drejta, pavarësisht ngjarjes së prodhuar apo teknologjisë së përdorur¹⁰.

Në këtë punim, tendencat e kalimit nga përgjegjësia subjektive në atë objektive, nga elementi i fajit te elementi i dëmit, si dhe gjithë llojet e reja të përgjegjesisë civile që kanë dalë nga zhvillimet e fundit teknologjike dhe shoqërore do të pasqyrohen në kuadrin e realitetit shqiptar që shkon përtej parashikimeve të Kodit aktual Civil dhe i bashkohet në sfida dhe problematika të ngjashme shumë sistemeve të tjera ligjore në botë.

2. Vështrimi historik i konceptit të përgjegjesisë civile

³ Torres Kirmser, Raul. *La responsabilidad civil: una materia en constante revolución. La responsabilidad sin culpa*, i disponueshëm në: <https://www.pj.gov.py/ebook/monografias/nacional/civil/Jos%C3%A9-Ra%C3%BAI-Torres-Kirmser-La-Responsabilidad.pdf>

⁴ Për më shumë shiko Ruy Barroso de Mello, Sergio. *A responsabilidade civil e seu seguro*. Revista Opinião.Seg nr.12,2016, fq.1, i disponueshëm në: <https://www.editoraroncarati.com.br/v2/Artigos-e-Noticias/Artigos-e-Noticias/A-responsabilidade-civil-e-seu-seguro.html>.

⁵ Besalú Parkinson, Aurora. *La responsabilidad civil: Tendencias actuales. La experiencia argentina y su posible proyección al derecho mexicano*. Boletín Mexicano de Derecho Comparado, Volumen 1, No.91, 1998, i aksesueshëm në: <https://doi.org/10.22201/ij.24484873e.1998.91.3525>

⁶ Fernández Muñoz, Mónica Lucia. *Nuevas tendencias de la responsabilidad civil*. Politécnico Grancolombiano, 2019, i disponueshëm në: <https://revistas.poligran.edu.co/index.php/libros/article/view/2247/2129>

⁷ Besalú Parkinson, Aurora. *La responsabilidad civil: Tendencias actuales. La experiencia argentina y su posible proyección al derecho mexicano*. Boletín Mexicano de Derecho Comparado, Volumen 1, No. 91, 1998, f. 56.

⁸ Për më shumë shih: Moreno, Valeria. *Evolución y actualidad de la responsabilidad civil*. Revista Anales de la Facultad de Ciencias Jurídicas y Sociales. Universidad Nacional de la Planta, No.48, 2018, f. 12.

⁹ *Ibid*, f. 14.

¹⁰ Koch, Bernhard, Borghetti, Jean- Sébastien, Machnikowski, Piotr, Pichonnaz, Pascal, Ballell de las Heras, Rodriguez Teresa, Twigg-Flesner, Christian & Wendehorst Christiane. *Response of the European Law Institute to the Public Consultation on Civil Liability- Adapting Liability Rules to the Digital Age and Artificial Intelligence*. De Gruyter, Volume 13, No.1, 2022, f. 4.

Emri i Autorit

Përgjegjësia civile është një shprehje e cila përgjithësisht, por jo ekskluzivisht përdoret për të treguar detyrimin për shpërblim të dëmit¹¹. Është ky detyrim për shpërblimin e dëmit që passjell lindjen e përgjegjësisë juridiko civile, qëllimi i së cilës është mbrojtja e subjektit dhe pasurisë së tij nga pasojat që vijnë prej veprimeve të paligjshme e të dëmshme të personave që i shkaktojnë ato¹². Në këtë prizëm, qëllimi i institutit juridik të përgjegjësisë civile është të vendosë rregulla për të disiplinuar rrethanat në të cilat personat që shkaktojnë një dëm duhet ta riparojnë atë, si në rastin e një detyrimi që rrjedh nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor, ashtu dhe në rastin e përgjegjësisë që rrjedh nga mospërbushja apo shkelja e detyrimeve kontraktore¹³.

Në vetvete origjina e fjalës përgjegjësi rrjedh nga latinishtja e vonë, ku me *respondere* prezumohej humbja e një gjendjeje ekuilibri që sillte lindjen e një premtimi, e një zotimi për tu shfaqur si debitor dhe për të shpërblyer dëmin¹⁴. Sipas studuesve, kjo fjalë nënkuptonte reagimin ndaj një urdhri të shkelur duke dhënë idenë e një përgjegjësie që e lidhte dëmtuesin me dëmshpërblimin¹⁵. Për këtë arsye, kur në Romë premtimi ose zotimi ishte shkelur, ose kur borxhi nuk ishte shlyer *spondere* rridhte nga *respondere*, e cila nga ana tjetër rridhte nga *responsus*, *resposum* që të çonte etimologjikisht në idenë e një përgjegjësie të lidhur me një marrëdhënie juridike para-ekzistuese¹⁶. Passhoqërimi i kësaj përgjegjësie me mbiemrin emëror ‘civil’ e lidh atë me të drejtën civile që rregullon marrëdhëniet private mes individëve¹⁷ dhe e diferencon automatikisht nga përgjegjësia penale apo ajo administrative.

Nëse përtej kuptimit etimologjik, do të ndalemi të analizojmë zhvillimin e përgjegjësisë civile në kontekstin historik, do të shohim se në gjenezat e njerëzimit, ‘oreksi’ për hakmarrje dhe shpagim ishte sinonimi i vetëm i dëmshpërblimit. Në shoqëritë e hershme nuk ekzistonin ndarjet mes sanksioneve penale dhe atyre civile, e madje këto sanksione nuk ishin prerogativë vetëm e shtetit, por në të shumtën e rasteve ndëshkimin për dëmin e bërë e jepte vetë personi i dëmtuar ose familjarët e tij¹⁸. Në këto kushte, ligji si entitet ndërhyrës, mbetej ende larg vëmendjes dhe zbatueshmërisë përse i përket shpërblimit të dëmeve të shkaktuara mes individëve, duke i lënë rrugë të lirë hakmarrjes personale si të vetmen formë dëmshpërblimi për dëmin e pësuar¹⁹.

Gradualisht, shteti i së drejtës filloi të fitojë pushtet dhe të kontrollojë kështu përjasjen e qytetarëve ndaj dëmeve. Në Babiloni, sipas ligjit të Hamurabit, maksima “*sy për sy e dhëmb për dhëmb*” e njohur ndryshe si parimi i Talionit, sanksiononte se autorit të një veprimi të kundërligjshëm duhej ti shkaktohej po ai dëm dhe po ajo plagë që ky i fundit i kishte shkaktuar viktimës. Megjithatë sot një “ndëshkim” i tillë ndaj dëmtuesit konsiderohet si një mënyrë çnjerëzore dhe e përgjakshme për të kërkuar shpërblimin e dëmit, për kohën e vetë ky parim imponoi për herë të parë kufijtë në shpërblimin e dëmit pasi pati si qëllim kryesor dhe origjinal të pakësonte dënimet mizore të dhëna privatisht²⁰. Përmes një regjimi kompensues ky ligj i jepte ‘fajtorit’ një dënim ekuivalent, identik ose analog me atë që kishte pësuar viktimja duke bërë që hakmarrja të ishte që nga ajo kohë në proporcion të njëjtë me formën, llojin dhe ashpërsinë e dëmit të pësuar²¹.

¹¹ Mamuti, Afet. *Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit në Maqedoni*, Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, Tiranë 2013, f. 64.

¹² Nuni, Ardian & Mustafaj, Illir. *E drejta e detyrimeve*, Tiranë 2012, f. 94.

¹³ Sherifi, Velisjana. *Përgjegjësia civile që rrjedh nga dëmi ekzistencial. Vështrim në legjislacionin shqiptar*. Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, Tiranë 2015, f. 24.

¹⁴ Rangel-Sanchez, Diana. *El ‘daño a la persona’ en material de responsabilidad civil extracontractual. Especial referencia a los daños derivados de la responsabilidad civil familiar*. Tesis para optar el título de abogado, Universidad de Piura 2015, f. 30.

¹⁵ Franzoni, Massimo. *Trattato della responsabilita civile, L’illecito*. Seconda edizione, Giufre, Milano 2010, f. 5.

¹⁶ Për më shumë shiko Vidal Ramirez, Fernando. *La responsabilidad civil*. Dialet, No.54, 2001, f. 390.

¹⁷ Shiko Rangel-Sanchez, Diana. *El ‘daño a la persona’ en material de responsabilidad civil extracontractual. Especial referencia a los daños derivados de la responsabilidad civil familiar*, 2015, f. 30.

¹⁸ Bardhi, Anita. *Përgjegjësia civile për dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar nga të tretët në legjislacionin shqiptar*. Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, Tiranë 2016, f. 16.

¹⁹ Almodovar Maldonado, José. *Evolución de la responsabilidad civil: Una aproximación*. Ceiba: Año 12, Num.1, UPR-Ponce, 2013, f. 10.

²⁰ *Ibid.*

²¹ Fish, Morris. *An Eye for an eye: Proportionality as a Moral Principle of Punishment*. Oxford Journal of Legal Studies, Vol.28, Nr.1, 2008, f. 1.

Nga ana tjetër, në të drejtën e lashtë romake dhe para miratimit të Ligjit të 12 Tabelave, viktima kishte mundësinë të evitonte hakmarrjen e përgjakshme dhe të kërkonte nga dëmtuesi shpërblimin e dëmit të shumëfishtë ose jo, përmes një sër mënyrash si psh: dëmshpërblimin në natyrë me bagëti ose të mira të tjera materiale ose me dëmshpërblim në para sipas një shumë të rënë dakord midis tyre²². Kjo gjë na dëshmon se kompensimi në shoqërinë e lashtë romake më shumë se sa ka patur qëllim shpërblimin e dëmit, ka patur për synim pajtimin e palëve me qëllim që pala e dëmtuar mos hakmerrej personalisht ndaj dëmtuesit²³. Në të Drejtën Romake do të ishte *delicta*, në përshkrimin e saj si një *iniuria*²⁴, ajo që do të gjeneronte detyrimin për riparim të dëmit. Në këtë aspekt, në këtë kohë ky koncept nuk u zhvillua si një koncept i përgjithshëm dhe abstrakt siç ishte *delictumi*, por pati kuptimin e vetë të mëvetësishëm që solli më vonë dhe në krijimin e *delict-eve*²⁵ dhe *quasidelict-eve*²⁶.

Me ligjin e XII tabelave, megjithëse në thelb vazhdonte të ruhej parimi i Talionit²⁷, u inkorporua pranimi i një kompensimi monetar për shlyerjen e dëmit të shkaktuar. Megjithatë ajo që duhet theksuar është se në një skenar të tillë pranimi, shpërblimi monetar mbetet kurdoherë në vullnetin e të dëmtuarit dhe ndërhyrja e gjyqtarit ishte e kufizuar vetëm në sqarimin e fakteve, pa qenë në gjendje të përcaktonte shumën apo llojin e shpërblimit. Mundësia për të ndjekur civilisht dëmtuesin i korrespondonte vetëm të dëmtuarit dhe jo shtetit duke e matur shpërblimin me parametrat e inatit dhe frustrimit të grumbulluar të palës së dëmtuar²⁸.

Shteti filloi të ndërhyjë në çështjet me natyrë private duke vendosur vlera të dëmit dhe duke e detyruar viktimën të pranojë kompensimin dhe të heqë dorë nga hakmarrja vetëm me miratimin e *Lex Aquilia* në Romë e cila shënon dhe momentin më të rëndësishëm historik të rregullimit të përgjegjësisë civile dhe shpërblimit të dëmit²⁹. Përmes *Lex Aquilia*³⁰, romakët përcaktuan për herë të parë strukturën bazë të një delikti civil të njohur si *damnum iniuria datum*- dëm i shkaktuar tjetrit përmes sjelljes së gabuar. Këto dispozita përmbanin parashikime për gjithë elementet e shpërblimit të një dëmi modern siç janë: dëmi; sjellja e paligjshme; lidhja shkakësore dhe *iniuria*³¹. Nga prespektiva e së drejtës së sotme, duket sikur faji është i vetmi element që i mungonte përgjegjësisë civile romake, duke e bërë atë të ngajë në dukje si një përgjegjësi civile pa faj.

²² Almodovar Maldonado, José. *Evolución de la responsabilidad civil: Una aproximación*. Ceiba: Año 12, Num.1, UPR-Ponce, 2013, f. 10.

²³ Bardhi, Anita. *Përgjegjësia civile për dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar nga të tretët në legjislacionin shqiptar*. Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, Tiranë 2016, f. 17.

²⁴ *Ibid*, fq.28. Me termin *injuria* do të kuptojmë çdo cënim të vlerave material dhe personale të personit tjetër, duke mos patur kurrëfarë dobie material për shkaktuesin e dëmit. Kjo formë, së bashku me *furtum* (vjedhja), *rapina* (grabitja) dhe *damnum iniuria datum* (dëmtimi i pasurisë së huaj pa përfitimë personale për shkaktuesin e dëmit) përbëjnë katër veprimet e paligjshme që sillni si pasojë shpërblimin e dëmit civil sipas *Gaius*.

²⁵ Sipas studiuesve, dallimi ndërmjet delikteve dhe quasideliteve qëndronte në fakën se deliktet nuk ekzistonin pa ardhjen e pasojës së dëmshme dhe pa u vërtetuar fajësia e shkaktuesit të dëmit, kurse kuazidelitek ekzistonin dhe pa shfaqjen e pasojës apo dhe pa fajin e dëmtuesit.

²⁶ Vidal Ramirez, Fernando. *La responsabilidad civil*. Dialect, f. 390.

²⁷ Dëmet dhe deliktet rregulloheshin nga Tabela e VII, ku në pikën e dytë të saj sanksionohet dhe ‘parimi i Talionit’ si dhe përjashtimi nga ky parim. Për më shumë shiko përmbledhjen e Ligjit të 12 Tabelave në linkun: <http://www.csun.edu/~hcfll004/12tables.html?fbclid=IwAR1iaHR6XKjAfZXMJTVQDocGMfOaaAm-oHP69pjHspK7A6aQthqB09KYUNY>

²⁸ Almodovar Maldonado, José. *Evolución de la responsabilidad civil: Una aproximación*. Ceiba: Año 12, Num.1, UPR-Ponce, 2013, f. 11.

²⁹ Dos Santos, Sergio, Mauro. *A responsabilidade civil extracontratual no direito romano: Analise comparativa entre os requisitos exigidos pelos romanos e os elementos de responsabilidade civil atualmente existentes*. Direito em Ação, Vol.10, N.1, Brasília 2013, f. 15.

³⁰ Në këtë pikë mund të shtojmë se *Lex Aquilia* përbëhej nga 3 kapituj kryesorë ku: Në kapitullin e parë trajtohej vrasja e padrejtë e kafshëve dhe skllëverve; në Kapitullin e dytë trajtohej dënimi për dorëzanin që mashtronte kreditorin kryesor kuurse në Kapitullin e tretë trajtohet ajo që më lart e kemi cilësuar si *damnum iniuria datum*, *Ibid*.

³¹ Bruggemeier, Gert. *The Civilian Law of Delict: A Comparative and Historical Analysis*. European Journal of Comparative Law and Governance, Volume 7, Issue 4, 2020, f. 341.

Pavarësisht qendrimeve të ndryshme mbi interpretimin konkret të dispozitave të *Lex Aquilia*, të gjithë studiuesit bien në një mendje kur pohojnë se ky ligj ka qënë embrioni për përfshirjen e fajit në kushtet që duhen plotësuar për të kërkuar shpërblimin e dëmit³². Megjithëse përkufizimi i shprehur i fajit do të përfshihej në sistemin romak vetëm në fund të Republikës me respektimin e parimit “*impunitur est qui sine culpa et dolo malo casu quodam damnum committit*”³³, në përfundim mund të konkludojmë se Ligji i Akuilisë do të njihet botërisht si burim i drejtpërdrejtë i konceptit modern të fajit duke parashikuar rastet kur dëmi është shkaktuar me dashje apo nga pakujdesia.

3. Llojet e përgjegjësisë civile. Dallimet dhe ngjashmëritë

Përgjegjësia civile njihet si një institut që përbëhet nga tërësia e rregullave që detyrojnë përgjegjësien e dëmit të shpërblejë dëmet që u ka shkaktuar të tretëve³⁴. Ky përkufizim është në fakt shumë i ngjashëm me atë të autorit francez Doyer René Savatier i cili e përkufizon përgjegjësinë civile si: “*detyrimi që bie mbi një person për të riparuar dëmin e shkaktuar një tjetri nga veprimi/mosveprimi i tij ose nga veprimi i një personi tjetër a sendeve të varura prej tij*”³⁵. Nga ky përkufizim kuptojmë se përgjegjësia juridike civile lind me rastin e shkaktimit të dëmit, duke krijuar një marrëdhënieje që nuk ekzistonte përpara tij³⁶. Prandaj themi se në parim, rregullat e përgjegjësisë civile ndërhyjnë kryesisht *ex post*, pasi dëmi të jetë materializuar³⁷. Përgjegjësia civile lind në rastin e mospërbushjes së detyrimit të debitorit në detyrimet që lindin nga kontrata ose lind në momentin e shkaktimit të dëmit në rastet e një detyrimi jashtëkontraktor. Në bazë të këtij momenti, përgjegjësia juridike civile ndahet në dy grupime të mëdha që ndryshe njihen si³⁸:

- përgjegjësia civile kontraktore dhe;
- përgjegjësia civile jashtëkontraktore ose deliktore.

Për shumë kohë është besuar se përgjegjësia civile në rastin e mospërbushjes së detyrimit kontraktor ose në detyrimet që lindin nga shkaktimi i dëmit ka vend të zbatohet kur ekziston jo vetëm lidhja shkakësore midis sjelljes së paligjshme të një personi dhe pasojës së ardhur, por dhe kur ekziston faji. Një kusht i tillë bën që përgjegjësia civile të kualifikohet si rregull si përgjegjësi me faj, megjithëse ka dhe raste përjashtimore e të veçanta kur kjo përgjegjësi shfaqet dhe në formën e përgjegjësisë civile pa faj. Kjo e fundit ekziston vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht në ligj e në asnjë rrethanë tjetër³⁹. Prezenca ose jo e fajit si kusht për të patur përgjegjësi civile, bën që të krijohen dy lloje themelore të kësaj përgjegjësie:

- përgjegjësi subjektive (përgjegjësia me faj);
- përgjegjësi objektive (përgjegjësia pa faj);

Para së gjithash, është e rëndësishme të theksojmë se këto ndarje të përgjegjësisë civile dalin dhe gjejnë zbatim dhe nga vetë normat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Kështu, nëse fillimisht do marrim përgjegjësinë kontraktore do të shohim se kjo e fundit rregullohet nga Kodi Civil kur parashikohet se:

³²Da Cunha, Bozzi, Paula. *Aspectos gerais da responsabilidade civil*, 2017, i disponueshëm në:

<https://jus.com.br/artigos/58301/aspectos-gerais-da-responsabilidade-civil>

³³ Ai që shkaktori dëm ndaj të tjerëve pa faj ose dashje nuk do të dënohet.

³⁴ Për më shumë shiko: *Definition de la responsabilité civile*, i aksesueshëm në: <https://cours-de-droit.net/definition-de-la-responsabilite-civile-a121605924/>

³⁵ Përkufizimi i marrë nga Savatier, René. *Traité de la responsabilité civile en droit français civil, administrative, professionnelle, procédural*. Revue international de droit comparé, 1950.

³⁶ Muharremi, Merita. *Përgjegjësia civile nga dëmet e shkaktuara nga automjetet në Kosovë dhe Shqipëri*. Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’ Tiranë, 2018, f. 36.

³⁷ BEUC, The Consumer Voice in Europe. *Adapting civil liability rules to the new digital technologies. Accompanying paper to BEUC’s response to the European Commission’s public consultation on Civil liability- adapting liability rules to the digital age and artificial intelligence*, 2022, f. 9.

³⁸ Mamuti, Afet. *Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit në Maqedoni*. Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, Tiranë 2013, f. 65.

³⁹ Semini, Mariana. *E drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave*. Skanderbeg Books, Tiranë 2016, f. 153.

“Cdo mangësi në ekzekutimin e detyrimeve e detyron debitorin të shpërblejë dëmin që ka pësuar kreditori, përveç kur ai provon se mospërmbushja nuk ka ndodhur për faj të tij”⁴⁰.

Ndryshe nga përgjegjësia kontraktore që lind nga çdo shkelje e dispozitave të kontratës, përgjegjësia jashtëkontraktore lind nga shkelja e normave ligjore që ndalojnë subjektin t’i shkaktojë dëme personave të tretë apo pasurisë së tyre⁴¹. Nisur nga kjo, Kodi Civil parashikon se:

“Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në person ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj...”⁴²

Përmes këtij parashikimi sanksionohet në Kod parimi i njohur ‘*neminem laedere*’ që i jep çdo subjekti të drejtën të kryejë çdo veprim në masën që nuk i shkakton dëme të padrejta palëve të treta. Në shoqërinë shqiptare, ndalimi për t’i shkaktuar dëm tjetrit gjen rregullim të veçantë nga nenet 608 e vijues të Kodit Civil. Në bazë të kësaj përgjegjësie, e njohur dhe si “përgjegjësia akuiliane” (*lex Aquilia de damno*), cilido që shkel të drejtat dhe interesat e ligjshme të një tjetri detyrohet ta dëmshpërblejë atë. Nëpërmjet dëmshpërblimit synohet rivendosja e plotë e të dëmtuarit (*restitutio in integrum*) në gjendjen e mëparshme (*status quo ante*), ku ai do të gjendej nëse nuk do të ndodhte fakti i paligjshëm⁴³.

3.1 Dallimet dhe ngjashmëritë mes përgjegjësive civile kontraktore dhe jashtëkontraktore

Në praktikë jo rrallë herë ngatërrohen rastet kur kemi të bëjmë me përgjegjësi kontraktore apo jashtëkontraktore, pasi megjithëse në pamje të parë ato duken lehtësisht të identifikueshme, shpesh rrethanat sjellin që në një ngjarje të caktuar të përfshihen si elementë të përgjegjësive kontraktore ashtu dhe asaj jashtëkontraktore. Në kushte të tilla, studiuesit e së drejtës kanë mbajtur tashmë një qëndrim të konsoliduar se aty ku ka vend të ngrihet padia që rrjedh nga kontrata duhet të ngrihet ajo dhe subjektet nuk duhet të mbështeten në një padë që kërkon përmbushjen e detyrimit që ka lindur nga shkaktimi i dëmit. Nëse dëmi ka lindur si rezultat i mospërmbushjes së një detyrimi që ka rrjedhur nga kontrata, përgjegjësia për dëmin duhet të bazohet në kushtet e kësaj kontrate dhe jo të përgjegjësive civile jashtëkontraktore.⁴⁴

Duke lënë mënjatë çështjen e konkurrencës mes dy përgjegjësive, pavarësisht ndryshimeve që ngjajnë të dukshme, paraqitet me rëndësi të theksojmë se mes tyre ka dhe ngjashmëri. Kështu për shembull, vlen të theksohet se si te detyrimet kontraktore ashtu dhe ato jashtëkontraktore, me rastin e shkakimit të dëmit lind përgjegjësia civile dhe subjekti përgjegjës ngarkohet për shpërblimin dhe kompensimin e dëmit bazuar në shkallën e dëmit dhe fajësisë⁴⁵. Në të dy rastet, individëve ju lind një detyrim për të kompensuar dëmin e shkaktuar, duke u kthyer ky shpërblim në synimin e palës së dëmtuar përmes ngritjes së padisë.

Nëse do të flisnim për dallimet, duhet thënë se tradicionalisht përgjegjësia kontraktore ka dalluar nga ajo jashtëkontraktore si në hipoteza ashtu dhe në mjete juridike që vendosen në dispozicion të secilës⁴⁶, pasi ato dallojnë qartazi nga çasti i krijimit dhe të drejtat e detyrimit që ju garantojnë palëve. Në këtë pikë, dallimi kryesor qëndron në faktin se përgjegjësia jashtëkontraktore lind me rastin e shkakimit të dëmit duke e bërë detyrimin për

⁴⁰ Për më shumë shiko Nenin 476 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Efektet e mospërmbushjes së detyrimeve”.

⁴¹ Sherifi, Velisjana. *Përgjegjësia civile që rrjedh nga dëmi ekzistencial. Vështrim në legjislacionin shqiptar*. Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, Tiranë 2015, f. 24.

⁴² Neni 608 i Kodit Civil.

⁴³ Shiko interpretimi që i ka bërë këtyre dispozitave Vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr.12, datë 14.09.2007.

⁴⁴ Semini, Mariana. *E drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave*. Skanderbeg Books, Tiranë 2016, f. 160.

⁴⁵ Morina, Sevdai. *Kriteret dhe kushtet që duhet të plotësohen për caktimin e përgjegjësive civile për dëmin jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës*. Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, Tiranë 2017, f. 34.

⁴⁶ Rosello, Carlo. *Responsabilita contrattuale ed aquiliana; il punto sulla giurisprudenza*. Itali 1996.

zhdëmtim detyrimin primar dhe të vetëm të dëmtuesit, kurse përgjegjësia kontraktore lind me rastin e mospërbushjes së kontratës apo përbushjes jo të rregullt të saj. Kjo sjell si rrjedhojë faktin që në rastin e përgjegjësive kontraktore, debitori përveçse duhet të përbushë kontratën si detyrim kryesor të tij, duhet gjithashtu dhe të zhdëmtojë dëmin që ka ardhur nga mospërbushja e rregullt e kontratës, si një detyrim sekondar që lind në këtë marrëdhënie juridike⁴⁷.

Përveç këtij dallimi thelbësor, duhet thënë se në përgjithësi kushtet e përgjegjësive jashtëkontraktore gjejnë një zbatim më të gjërë në praktikë pasi dëmi praktikisht mund të shkaktohet në çfarëdo rrethanash dhe situatash, kurse tek përgjegjësia kontraktore ky dëm mund të lindë vetëm në rast se cënohen detyrimet kontraktore⁴⁸. Duhet shtuar gjithashtu, se në rastin e përgjegjësive jashtëkontraktore përgjegjës i dëmit mund të jetë më shumë se një person në varësi të shkallës së përgjegjësive që ka, prandaj bazuar pikërisht në numrin e papërcaktuar të personave përgjegjës, mund të thuhet se përgjegjësia jashtëkontraktore, ndryshe nga ajo kontraktore ku përgjegjës për dëmin është vetëm pala debitore e kontratës ose eventualisht trashëgimtarët e saj, vepron *erga omnes*⁴⁹.

Më tej, një dallim tjetër qëndron në fuqinë urdhëruese që kanë dispozitat që rregullojnë secilën prej përgjegjësive. Kështu, rregullat e përgjegjësive kontraktore janë dispositive (*ius dispositivum*), pasi janë vetë palët që vendosin kushtet e kontratës duke patur mundësi t'i përjashtojnë, t'i kufizojnë ose t'i zgjerojnë ato, kurse tek përgjegjësia jashtëkontraktore rregullat janë imperative (*ius imperativum*) pasi përcaktohen shprehimisht nga ligji⁵⁰. Përsa i përket fajit si kusht për lindjen e përgjegjësive civile, duhet thënë se në përgjegjësinë kontraktore, debitori ka raste kur ngarkohet me përgjegjësi edhe për fajin e personave të tjerë⁵¹, kurse në përgjegjësinë nga shkaktimi i dëmit nuk vepron një rregull i tillë⁵². Gjithashtu, në përgjegjësinë kontraktore çdo faj i kreditorit përfshirë dhe pakujdesinë e lehtë mund të shërbejë si shkak për shkarkimin ose zëvendësimin e përgjegjësive së palës⁵³, kurse tek përgjegjësia jashtëkontraktore në shkarkimin nga shpërblimi i dëmit mund të ndikojnë vetëm rastet kur kemi dashje ose pakujdesi të rëndë të të dëmtuarit⁵⁴.

3.2 Ndarjet kryesore të përgjegjësive civile

Kodi Civil trajton shprehimisht disa lloje përgjegjësish jashtëkontraktore të cilat për efekt studimi mund të ndahen në kategoritë si më poshtë⁵⁵:

- Po të marrim si kriter të parë faktin nëse subjekti e kryen veprën vetë ose mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga të tjerët, dalin dy forma të shkakimit të dëmit që është ajo, *personale* ose *prejardhur*⁵⁶;

⁴⁷ Mamuti, Afet. *Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit në Maqedoni*. Disertacion për marrjen e gradës shkencore 'Doktor', Tiranë 2013, f. 66.

⁴⁸ *Ibid*.

⁴⁹ Gojani, Skënder. *Contractual and Civil Delict Liability*. European Academic Research, Vol.II, Issue 11, 2015, f. 3.

⁵⁰ Dauti, Nerxhivane. *E drejta e Detyrimeve, Pjesa e përgjithshme*. Prishtinë, 2016, f. 148.

⁵¹ Rastet që parashikon Kodi Civil mbi përgjegjësinë pa faj në detyrimet kontraktore mund të kategorizohen si:

- Përgjegjësia në detyrimet për dorëzimin e sendeve gjenerikisht të përcaktuara;
- Përgjegjësia për fajin e një personi tjetër;
- Përgjegjësia për 'dëmin e rastit'.

⁵² Semini, Mariana. *E drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave*. Skanderbeg Books, Tiranë 2016, f. 161.

⁵³ Ky rast njihet nga doktrina si "përgjegjësia e përzierë" dhe trajton rastet kur përgjegjësia e debitorit konkurren me atë të kreditorit në ardhjen e pasojës. Fajësia e kreditorit mund të qëndrojë jo vetëm në faktin se ai së bashku me debitorin ka kontribuar në shkaktimin e dëmit, por dhe në rastin kur kreditor nuk është treguar i kujdesshëm dhe nuk ka marrë masat e duhura që do të sillnin pakësimin maksimal të dëmit. *Ibid*, f. 160.

⁵⁴ *Ibid*, f. 161.

⁵⁵ Kjo ndarje është bazuar në librin Semini, Mariana. *E drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave*. Skanderbeg Books, Tiranë 2016, f. 203.

⁵⁶ Përgjegjësia është *e prejardhur* kur nuk rrjedh nga dëmi i shkaktuar direkt nga personi që përgjigjet për të, por nga një dëm i shkaktuar nga një i tretë. Përgjegjësia e prejardhur është *e kushtëzuar* kur personat që kanë shkaktuar dëmin janë nën mbikqyrjen e personit që mban përgjegjësi. *Ibid*, f. 204.

- Nëse marrim parasysh numrin e personave që kanë marrë pjesë në shkaktimin e dëmit, kemi dy lloj përgjegjësish: *përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga një person dhe përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga shumë persona së bashku*;
- Së fundmi nëse kriter do të ishte lloji i dëmit, kemi detyrime për *shpërblimin e dëmit pasuror dhe shpërblim për dëmin jopasuror*.

Krahas kategorive të analizuara më sipër, doktrina dhe jurisprudenca ka mbajtur qendrimin se faktorët atributivë të përgjegjësive janë dy. Njëri është subjektiv dhe tjetri objektiv⁵⁷. Për të kuptuar siç duhet ndryshimin mes këtyre dy përgjegjësive, është e nevojshme të kthejmë vëmendjen në fillimet e shek. XIX, në një kohë kur faji konceptohej si faktori i vetëm dhe më i rëndësishëm për ngarkimin e shkaktarit të dëmit me përgjegjësive civile⁵⁸. Me zhvillimin e shoqërisë, teknologjisë dhe kërkimit u bë e pamjaftueshme të konsiderohej faji si element i vetëm i përgjegjësive, duke qenë se paraqitej e nevojshme të konceptohej sistemi i përgjegjësive civile brenda një perspektive globale që përfshinte jo vetëm marrëdhëniet midis subjekteve por dhe më gjerë. Kjo përjasje bëri që të përflitej krahas përgjegjësive subjektive dhe për përgjegjësinë objektive, sipas së cilës përgjegjësi i dëmit duhej të përgjigjej për dëmin që faktikisht kishte shkaktuar, pavarësisht nëse me sjelljen e vet kishte pasur apo jo faj në shkaktimin e tij⁵⁹. Në këtë kuptim, tashmë në përcaktimin e përgjegjësive filluan të integrohen faktorë të tjerë siç janë rreziku ose rreziku i ardhur nga ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme⁶⁰.

Ky ndryshim i kushtëzuar nga realiteti i ri ekonomik, solli në shoqërinë perëndimore një evolucion nga sistemi subjektivist - kulpabilist - në një sistem të ri përgjegjësive objektive.⁶¹ Megjithatë gjatë periudhës së kodifikimit dominonte qartësisht përgjegjësia subjektive, sot, ekziston një krizë e sistemit të bazuar në faj, duke pasur një tendencë të qartë për objektivizimin e përgjegjësive, e cila lidhet kryesisht me ushtrimin e aktiviteteve të rrezikshme ose që përmbajnë rrezik potencial.

3.2.1 Përgjegjësia subjektive

Përgjegjësia subjektive është një nga llojet e veçanta të përgjegjësive civile për shkaktimin e dëmit. Në mënyrë që të lindë kjo lloj përgjegjësie, përveçse duhet të përmbushen kushtet e përgjithshme për shkaktimin e dëmit, kërkohet të jetë i pranishëm faji i autorit të dëmit⁶². Në këtë formë përgjegjësie karakteristika kryesore është sjellja, duke qenë se është vetë faji i autorit faktori përcaktues për lindjen e përgjegjësive jashtëkontraktore⁶³. Sipas Parimeve Europiane të së Drejtës së Dëmeve, një person është përgjegjës në bazë të fajit për shkelje me dashje

⁵⁷Shina, Fernando. *Las nuevas tendencias en materia de responsabilidad*. Argjentinë: Sistema argentino de información jurídica, 2018, f. 3.

⁵⁸ Garcilopez, de Miguel Adolfo. *La responsabilidad sin culpa*. Revista Critica de Derecho Inmobiliario, i aksesueshëm në: <https://vlex.es/vid/responsabilidad-culpa-352456?fbclid=IwAR0q7nnuZbWkOnH58GkWmwVtC1OoARzbdZ4m3oZgsI0p2c0Ft1vHHxdVU2E>

⁵⁹ Torres Kirmser, Raul. *La responsabilidad civil: una materia en constante evolución. La responsabilidad sin culpa*. Paraguay 2008, f. 12.

⁶⁰ Paredes, Miranda, Javier Brando. *Cual es la diferencia entre responsabilidad civil subjetiva y objetiva?*. i disponueshëm në: <https://lpderecho.pe/diferencia-responsabilidad-civil-subjetiva-objetiva/>

⁶¹ Bello Janeiro, Domingo, Gallego Dominguez, Ignacio, Gázquez, Laura, Herrera de las Heras, Ramón, Mingorance Gosálvez, Maria del Carmen & Talma Charles, Javier. *Cuestiones actuales de responsabilidad Civil. Colección derecho de daños*. Editorial Reus S.A, 2009, f. 15.

⁶² Mamuti, Afet. *Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit në Maqedoni*. Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, Tiranë, 2013, f. 72.

⁶³ Fernandez, Fernandez, Antonio. *La responsabilidad civil subjetiva*. Instituto de Investigaciones Juridicas de la UNAM, 2017, f. 176.

ose pakujdesi⁶⁴ të standardeve të kërkuara të sjelljes⁶⁵. Standard i kërkuar i sjelljes⁶⁶ është ai i një personi të arsyeshëm, në rrethana të ndryshme dhe varet në veçanti nga natyra dhe vlera e interesit të mbrojtur që preket, nga rrezikshmëria e aktivitetit, nga ekspertiza që pritet të ketë personi që mban përgjegjësinë, nga parashikueshmëria e dëmit, nga marrëdhënia e afrimitetit ose lidhjes së veçantë mes palëve të përfshira si dhe nga disponueshmëria dhe kostot e metodave alternative ose parandaluese⁶⁷.

Përsa i përket barrës së provës duhet thënë se autorët janë të ndarë. Kështu ka nga ata që mendojnë se faji i dëmtuesit duhet të provohet nga ana e të dëmtuarit pasi ai ka paraqitur kërkesën për dëmshpërblim. Kjo gjë bën që tek përgjegjësia subjektive ose përgjegjësia sipas fajit roli i të dëmtuarit të jetë aktiv, kurse roli i dëmtuesit pasiv, gjë që rëndon pozitën e të dëmtuarit dhe e vë atë para vështirësisë së të provuarit ‘vërtetimin e gjendjes së pësuar’⁶⁸. Ka autorë të tjerë që janë të mendimit se pavarësisht se roli i të dëmtuarit është i vështirë, pasi ky i fundit rrezikon të mbetet pa dëmshpërblim, gjatë procesit gjyqësor, kualifikimi i përgjegjësive dhe të provuarit e fajit bën që roli i të dy palëve të jetë aktiv dhe i përfshirë⁶⁹. Një grup i tretë autorësh besojnë se në të drejtën civile kurdoherë prezumohet parimi i fajësisë, prandaj në rastin e shkakimit të dëmit, personi që me sjelljen e tij të kundraligjshme i ka shkaktuar një tjetri një dëm pasuror apo jopasuror konsiderohet se është fajtor dhe duhet të përgjigjet për këtë dëm, përveçse kur provon se nuk ka pasur faj⁷⁰. Konkretisht, parimi i fajësisë është i formuluar në mënyrë negative, prandaj i takon shkaktesit të dëmit të provojë se dëmi është shkaktuar jo për faj të tij, pasi vetëm në këtë rast ai përjashtohet nga përgjegjësia⁷¹.

3.2.2 Përgjegjësia objektive

Ndryshe nga përgjegjësia subjektive që njihet qysh në të drejtën e lashtë romake, përgjegjësia objektive, e njohur nga doktrina dhe si ‘përgjegjësia për riskun e krijuar’ mendohet se e ka patur zanafillën e vet gjatë Revolucionit Industrial kur njohu një hov tjetër industrializimi, puna me substancat shpërthyes dhe të rrezikshme, zhvillimi i teknologjisë, mjeteve të prodhimit dhe infrastrukturës⁷². Përgjegjësia objektive, është e njohur ndryshe dhe si përgjegjësi për shkak të riskut, pasi për të përcaktuar se kush është përgjegjësi nuk është e nevojshme të analizohet sjellja e subjektit dhe as shkalla e fajit. Ky i fundit vetëm për faktin e thjeshtë e tu gjendurit në këtë risk të supozuar, është përgjegjës dhe duhet të kompensojë dëmin e ardhur dhe pasojat e tjera të shkaktuara⁷³. Në këtë prizëm, ngjarje të tilla si transporti ajror, energjia bërthamore, aksidentet me automjete, trena ose me armë zjarri, janë të njohura prej vitesh ndërkombëtarisht si raste të përgjegjësive pa faj ose raste me përgjegjësi objektive.⁷⁴

⁶⁴ Sa i përket dispozitave të K.C duhet të nën se nuk jepet as kuptimi i fajit dhe as format e tij, Megjithatë doktrina është munduar të japë përcaktimet e veta nisur nga format e fajit që njihen në disiplinat e tjera juridike.

⁶⁵ Për më shumë shiko Nenin 4:101. Të Kapitullit 4 “Përgjegjësia mbi bazë të fajit” të Parimeve Europiane të së Drejtës së Dëmit, të cilat janë të disponueshme në linkun më poshtë:

<http://www.egtl.org/PETLEnglish.html>

⁶⁶ Përveç këtij parashikimi, në pikën 2 bëhet një përjashtim tolerues kur thuhet se standard i mësipërm mund të rregullohet kur për shkak të moshës, paaftësisë mendore ose fizike ose për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme nuk mund të pritet që personi të pajtohet me të.

⁶⁷ *Ibid*, Neni4:102.

⁶⁸ Morina, Sevdai. *Kriteret dhe kushtet që duhet të plotësohen për caktimin e përgjegjësive civile për dëmin jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës*. Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, Tiranë 2017, f. 53.

⁶⁹ Mamuti, Afet. *Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit në Maqedoni*. Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, Tiranë, 2013, f. 72.

⁷⁰ Semini, Mariana. *E drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave*. Skanderbeg Books, Tiranë 2016, f. 154.

⁷¹ *Ibid*.

⁷² Martinez, Mendoza & Alejandra, Lucia. *La accion civil del daño moral*. Universidad Nacional Autonoma de Mexico, 2014, f. 3.

⁷³ Fernandez, Fernandez, Antonio. *La responsabilidad civil subjetiva*. Instituto de Investigaciones Juridicas de la UNAM, f. 175.

⁷⁴ Fernández Muñoz, Mónica Lucia. *Nuevas tendencias de la responsabilidad civil*. Politécnico Grancolombiano, 2019.

Përgjegjësia objektive është përgjegjësi pa faj, pasi në rastin e shpërblimit të dëmit, nuk merret parasysh ana subjektive e shkaktuesit të dëmit dhe atij i lind detyrimi për zhdëmtim pa patur nevojë që të vërtetohet prezenca e fajit. Në rastin e shkaktimit të dëmit nga sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme ekziston prezumimi i fajësisë së palës, prandaj nuk ka nevojë të provohet fajësia e tij si subjekt përgjegjës, pasi përgjegjësia bazohet në idenë e krijimit të rrezikut⁷⁵. Si një përgjegjësi e kohërave moderne, që është zhvilluar paralelisht me nevojat e jetës për mjete prodhimi më të sofistikuar, teknologji më të përparuar, shërbime dixhitale dhe mjete telekomunikacioni më të shpejta dhe efikase, përgjegjësia objektive përmban një sër rastesh ku përgjegjësia lind nga përdorimi i sendeve të rrezikshme a ushtrimi i veprimtarive të rrezikshme.

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë e klasifikon përgjegjësinë civile nga ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme si përgjegjësi të kushtëzuar⁷⁶, pasi parashikon se dëmtuesi mund të përjashtohet nga përgjegjësia n.q.s provon se i ka përdorur të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për mënjanimin e dëmit të ardhur, pavarësisht nga rezultati që ka sjellë marrja e tyre. Kurse nga ana tjetër, Parimet Europiane për të Drejtën e Dëmit bëjnë disa parashikime shtesë që lidhen kryesisht me përcaktimin e ‘ushtrimit të veprimtarive anormalisht të rrezikshme’⁷⁷. Që një veprimtari të klasifikohet si anormalisht e rrezikshme duket që ajo të krijojë një risk për dëm⁷⁸ të parashikueshëm dhe madhor edhe në rastet kur është ndërmarrë gjithë kujdesi i duhur për menaxhimin e saj apo kur kjo veprimtari nuk është çështje e përdorimit të zakonshëm⁷⁹.

Në analizë të fundit, duhet thënë se përveç përgjegjësive subjektive dhe objektive, legjislacioni ynë e jo vetëm, rregullon dhe një përgjegjësi të tretë, të njohur ndryshe si *përgjegjësia për të tjerët*⁸⁰, ose përgjegjësia zëvendësuese (*vicarious liability*).⁸¹ Kjo lloj përgjegjësie është krijuar me qëllim që në asnjë rrethanë palët e prekura të ngelen pa u zhdëmtuar dhe ka si bazë të saj fajin e supozuar. Me fjalë të tjera, do ndodhemi para përgjegjësive për të tjerët, kur nuk përgjigjet shkaktuesi i dëmit, por një person tjetër që nuk e ka shkaktuar dëmin ama ka një raport specifik ligjor me të⁸². Këta persona që kanë një raport të posaçëm me shkaktuesin e dëmit dhe ngarkohen të dëmshpërblejnë në vend të tij mund të dalin në cilësinë dhe rolin e prindërve, të mësuesit, të kujdestarit apo dhe të personit juridik si punëdhënës në një marrëdhënie pune. Arsyeja pse lind përgjegjësia për të tjerët/ të tretët mbështetet kryesisht në varësi të rasteve në mungesën e mbikqyrjes së nevojshme të subjekteve (*culpa in in spiciendo*), në zgjedhjen e gabuar të personit tjetër (*culpa in eligendo*) ose dhe në mungesën e instruksioneve të nevojshme (*culpa in instruendo*)⁸³. Sidoqoftë, shumë studiues mendojnë se koncepti i kësaj lloj përgjegjësie është tashmë i vjetëruar dhe i shton kosto ekonomike sidomos punëdhënësve, të cilët në fund të ditës për të shmangur

⁷⁵ Mamuti, Afet. *Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit në Maqedoni*. Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, Tiranë 2013, f. 82.

⁷⁶ Për më shumë shiko Nenin 622 të K.C.

⁷⁷ Në nenin 5:101. të PETL parashikohet se: “Një person që ndërmerr veprimtari anormalisht të rrezikshme është ngushtësisht përgjegjës për dëmin e karakterizuar nga risku i aktivitetit ose i ardhur si rezultat i tij”.

⁷⁸ Një risk për dëmtim mund të jetë domethënëse nëse do të mbahen parasysh serioziteti i dëmit dhe gjasat që ai të ndodhë.

⁷⁹ Ky përkufizim jepet në pikat 2 dhe 3 të nenit 5:101.

⁸⁰ Sa i përket kësaj lloj përgjegjësie, Parimet Europiane të Dëmit parashikojnë vetëm rastin e Përgjegjësive për të miturit dhe personat me zotësi të kufizuar për të vepruar si dhe Përgjegjësinë për asistentët/ndihmësit. Këto parashikime bëhen konkretisht në nenin 6:101. dhe nenin 6:102.

⁸¹ Për më shumë shiko:

<https://www.irmi.com/articles/expert-commentary/contractual-confusion-assuming-the-liability-of-others>

⁸² Bardhi, Anita. *Përgjegjësia civile për dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar nga të tretët në legjislacionin shqiptar*. Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, Tiranë 2016, f. 57.

⁸³ *Ibid*, f. 59.

pagimin e dëmeve të mëdha mund të preferojnë të sigurohen me kontrata sigurimi për përgjegjësinë civile⁸⁴ njësoj siç do siguroheshin nga zjarri, përmytjet,⁸⁵ etj.

3.3 Ndikimi i inteligjencës artificiale (IA) në përcaktimin e përgjegjësisë civile

Në kohërat ku jetojmë bota po përballë me një mori fenomenesh që lidhen me teknologjinë e informacionit, siç janë inteligjenca artificiale, interneti i gjërave (IoT), rrjetet blockchain, metaversi dhe teknologji të tjera, të cilat ndikojnë thellë në jetën e individëve, duke e bërë rregullimin dhe parandalimin e dëmeve që mund të shkaktohen nga to, një sfidë të paprecedentë e të vështirë për shkencën e së drejtës⁸⁶.

Nga çfarë është analizuar deri më tani, mund të biem dakord se rregullat e përgjegjësisë civile merren me pasojat e një veprimi të shkaktuar nga një aktivitet që rezultojnë të jetë i dëmshëm, pavarësisht nëse ky aktivitet ishte në parim i lejuar apo jo. Në këtë mënyrë, ato sigurojnë një balancë ekonomike efektive të interesave që konkurrojnë, duke lejuar një aktivitet që ka disa shkallë rreziku përse kohë që nuk ka një ndalim të drejtpërdrejtë, dhe sigurohen se në rast dëmi, i dëmtuari do të kompensohen siç duhet.⁸⁷

Sa i takon IA, duhet theksuar se sistemet e inteligjencës artificiale rrallë zhvillohen me qëllimin për të shkaktuar dëm, por ato mund të përdoren ose përshtaten qëllimisht për të tilla qëllime dëmtuese.⁸⁸ Dëmi ose humbjet specifike që rezultojnë nga përdorimi i IA mund të jenë të lidhura ngushtësisht me cilësinë e softuerit ("defekte të prodhimit" ose "defekte të dizajnit"), por ato mund të vijnë gjithashtu si rezultat i ndërlikohjes me të dhënat e disponueshme nëpër botë, të cilat, kur grumbullohen së bashku ose përdoren në një mënyrë specifike, mund të prodhojnë një rezultat të padëshiruar dhe të shkaktojnë humbje. Në këtë rast, këto humbje konsiderohen si "defekte të ndërlikohjes", duke qenë se ato rezultojnë nga ndërlikohja e softuerit të një sistemi IA me një ose më shumë sisteme të tjera paralele të IA.⁸⁹

Një sistem inteligjence artificiale nuk mund të kompensojë dikë që i është shkaktuar dëm. Ai nuk ka mjete për të siguruar dëmshpërblime dhe as asetë që mund të sekuestrohen dhe likuidohen për të përmbushur një detyrim. Ndryshe nga individët dhe personat juridikë, softueri nuk është një person i krijuar dhe njohur nga ligji, mbi të cilin një gjykatë mund të ketë juridiksion. Si i tillë, nuk mund të urdhërohet nga një gjykatë të paguajë dëmshpërblim për dëmin që mund të shkaktojë.⁹⁰ Duke marrë parasysh mungesën e identitetit ligjor (ose e personalitetit), një regjim përgjegjësie i bazuar në faj mund të duket iluzionar në raste që përfshijnë aplikime të caktuara të IA, pasi mund të lërë të dëmtuarit pa kompensim ose me kompensim minimal, pavarësisht të drejtave të tij për të kërkuar shpërblimin e dëmit.⁹¹

⁸⁴ Sot për sot disa nga policat më popullore të përgjegjësisë së përgjithshme civile janë: Sigurimi i përgjegjësive publike; Sigurimi i përgjegjësive profesionale; dhe Sigurimi i përgjegjësive të produkteve. Për më shumë shiko: Botimin e AMF-së; "Sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile", i aksesueshëm në:

https://amf.gov.al/pdf/publikime2/edukimi/Sigurimiipergjegjesisecivile_1.pdf

⁸⁵ Williams, Glanville. *The vicarious liability and the Master's indemnity*. The Modern Law Review, Vol.20, Nr.5, 1957, f. 440.

⁸⁶ Schenk Duque, Marcelo & Da Silva Versiani, Luiz Rodrigo. *The preventive function of civil liability in light of the States' duties of protection in the context of the digital world*. Brazilian Journal of Law Technology and Innovation, Vol.1, No.2, 2023, f. 23, DOI:10.59224/bjlti.v1i2.21-41

⁸⁷ Për më shumë shih: European Parliament. *Artificial Intelligence and Civil Liability*. Study requested by the JURI committee, 2020, fq.52 i disponueshëm në:

[https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/621926/IPOL_STU\(2020\)621926_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/621926/IPOL_STU(2020)621926_EN.pdf)

⁸⁸ Shiko: British Columbia Law Institute. *Report on Artificial Intelligence and Civil Liability*, 2024, f. 54.

⁸⁹ Koch, Bernhard, Borghetti, Jean- Sébastien, Machnikowski, Piotr, Pichonnaz, Pascal, Ballell de las Heras, Rodriguez Teresa, Twigg-Flesner, Christian & Wendehorst Christiane. *Response of the European Law Institute to the Public Consultation on Civil Liability- Adapting Liability Rules to the Digital Age and Artificial Intelligence*. De Gruyter, Volume 13, No.1, 2022, f. 56.

⁹⁰ British Columbia Law Institute. *Report on Artificial Intelligence and Civil Liability*, 2024, f. 54.

⁹¹ Koch, Bernhard, Borghetti, Jean- Sébastien, Machnikowski, Piotr, Pichonnaz, Pascal, Ballell de las Heras, Rodriguez Teresa, Twigg-Flesner, Christian & Wendehorst Christiane. *Response of the European Law Institute to the Public Consultation on Civil Liability- Adapting Liability Rules to the Digital Age and Artificial Intelligence*. De Gruyter, Volume 13, No.1, 2022, f. 58.

Në këtë aspekt, rregullat “tradicionale” të përgjegjësisë civile mund të përbënin një ndikues negativ ndaj evolucionit të inteligjencës artificiale, pasi mund të impononin detyrimin për të paguar kompensim mbi prodhuesit dhe programuesit e pajisjeve të inteligjencës artificiale, pavarësisht se nuk ka mangësi në dizajn ose implementim. Në këto raste, përgjegjësia civile nuk do të përmbushte qëllimin e saj, por thjesht do të nxiste pengimin e progresit teknologjik.⁹² Prandaj, inteligjenca artificiale ka krijuar sfida të reja në lidhje me përgjegjësinë civile, të cilat lindin nga domosdoshmëria për balancim mes dëmshpërblimit të përshtatshëm ndaj të dëmtuarve përkundrejt nevojës për të mos penguar inovacionin teknologjik.⁹³

Nga ana tjetër, në rast dëmi të shkaktuar nga inteligjenca artificiale, zbatueshmëria e rregullave të përgjegjësisë civile është sfiduar gjithashtu për shkak të faktit se shpesh herë vendimi i marrë brenda kornizës së funksionimit autonom të tyre sistemeve dhe lidhja shkakësore mund të jetë e pagjurmueshme, duke kufizuar kështu mundësinë e përcaktimit të shkakut.⁹⁴ Aplikimi i përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar nga inteligjenca artificiale krijon probleme, sepse në modelin e përgjegjësisë bazuar në faj, është, fillimisht e nevojshme identifikimi i veprimit me faj të një personi të caktuar, i cili, më pas, duhet të provohet të ketë lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore me dëmin e shkaktuar ndaj një pale të tretë.

Në këto kushte, skemat e kompensimit pa faj mund të jenë një ide rregullatore interesante dhe e përshtatshme për këtë qëllim, duke lejuar shndërrimin e këtij diskutimi nga një problem të përgjegjësisë civile në një çështje të menaxhimit financiar të humbjeve. Sigurisht, këto skema duhet të aplikohen vetëm në rastet kur nuk ka prova se prodhuesit dhe programuesit kanë vepruar në kushte faji, neglizhence, pamaturie ose paafësie dhe aktiviteti i tyre ka qenë në përputhje të plotë me standardet e verifikuara shkencërisht. Në raste të tjera, rregullat tradicionale të përgjegjësisë civile do të kishin një funksion më të vlefshëm parandalues.⁹⁵

4. Tendencat e reja të përgjegjësisë civile në vendet e civil law

Zgjerimi i konceptit të përgjegjësisë rrjedh kryesisht nga pranimi i një sër idesh nga jurisprudenca, një pjesë e mirë e tyre me natyrë ekonomike, që kulmojnë në qendrimin se zgjerimi i përgjegjësisë civile do të ulte shkallën e përgjithshme të aksidenteve dhe do të forconte pozitën e të dëmtuarëve. Zgjerimi i përgjegjësisë civile gjeti në vitet e para të implementimit të saj hapësirë dhe nxitje më të madhe në sigurinë e ofruar në lidhje me përdorimin e produkteve dhe shërbimeve. Kjo solli zhvillimin e një sër tendencash të fundit në evoluimin dhe zgjerimin e konceptit të përgjegjësisë civile në sistemet e civil law, të analizuar si më poshtë:

a. Përpjekja për unifikimin e përgjegjësisë civile⁹⁶;

Një nga aspektet që ka patur një modifikim të dukshëm në konceptin tradicional të përgjegjësisë civile, është unifikimi i përgjegjësisë kontraktore me atë jashtëkontraktore. Tendenca po shkon drejt një njohjeje të përgjithshme të teorisë së përgjegjësisë civile, pa dy ndarjet klasike, pasi sipas doktrinës ekzistojnë një sër

⁹² Marchisio, Emiliano. *In support of “no-fault” civil liability rules for artificial intelligence*. SN Soc Sci, Vol.1, No.54, 2021, doi: 10.1007/s43545-020-00043-z.

⁹³ EU Commission. *Report from the Commission to the European Parliament, the Council and the European Economic and Social Committee, Report on the safety and liability implications of Artificial Intelligence, the Internet of Things and robotics*, 2020,

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020DC0064>

⁹⁴ Kārklīņš, Jānis. *Artificial Intelligence and Civil Liability*. Journal of the University of Latvia Law, No.13, 2020, fq.179, DOI:10.22364/jull.13.10

⁹⁵ Marchisio, Emiliano. *In support of “no-fault” civil liability rules for artificial intelligence*. SN Soc Sci, Vol.1, No.54, 2021.

⁹⁶ Contreras Strauch, Osvaldo. *Civil liability and insurance (An analysis of civil liability and its insurance, under the legal viewpoint of the ‘common law’ and ‘civil or continental law’ systems)*. AIDA International Insurance Law Association, f. 24.

elementësh të përbashkët⁹⁷ që zbehin diferencat mes këtyre dy lloj përgjegjësish. Megjithëse bihet dakord se të dy përgjegjësitë krijojnë një detyrim, studiuesit duket se janë ende të paqartë në përqafimin e kësaj teze pikërisht duke u nisur nga momenti kur ky detyrim fillon për palët dhe nga marrëdhënia juridike që ka ekzistuar mes tyre përpara këtij detyrimi⁹⁸.

Pioner në përqafimin e kësaj tendence është bërë Kodi Civil dhe Tregtar argjentin, i cili ka konkretizuar një qendrim të gjatë të doktrinës kombëtare dhe është vënë në krye të kodeve të tjera bashkëkohore⁹⁹ lidhur me këtë çështje. Sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe legjislacioneve të tjera të ngjashme në këtë drejtim, lidhja dhe ekzekutimi i kontratës, qëndron në krijimin e detyrimeve dhe të drejtave midis palëve që shkojnë përtej parashikimeve të shprehura ligjore, dhe kjo specifikë e marrëdhënies kontraktuale do të shuhej plotësisht nëse këto të drejta e detyrime të personalizuar do të zëvendësoheshin me detyrimet e përgjithshme që ligji imponon në rast marrëdhëniesh jokontraktore midis palëve të treta¹⁰⁰. Megjithatë sipas mbështetësve të unifikimit të përgjegjësive civile, në momentin që janë shkelur detyrimet, nuk ka arsye për të bërë dallime, sa i përket riparimit dhe shpërblimit të dëmit, midis pasojave të kësaj shkeljeje dhe atyre që lindin nga kryerja e një veprimi të paligjshëm akilian¹⁰¹.

Me fjalë të tjera, unifikimi i dy llojeve të përgjegjësive nuk e tjetërson karakterin specifik të kontratës në lidhje me detyrimet mes palëve, por thjesht synon të unifikojë pasojat e përgjegjësive në rast dëmi, duke i nënshtuar ato, përveç rasteve përjashtimore, ndaj të njëjtave rregulla si për përgjegjësinë kontraktore ashtu dhe për atë jashtëkontraktore¹⁰².

b. Përqëndrimi i vëmendjes në shpërblimin e dëmit;

Tendencat moderne të ligjit po ndryshojnë aksin e vëmendjes ligjore, duke vendosur në qendër të saj kompensimin e dëmit. Sot është më e rëndësishme shpërblimi i dëmit sesa ndëshkimi i sjelljes që e ka shkaktuar atë, sepse sytë e drejtësisë janë vendosur në anën e të dëmtuarit¹⁰³. Kjo gjë ka bërë që të fitojnë përparësi faktorët objektivë që i atribuohen përgjegjësive, duke lënë mënjanë aforizmin e vjetër se nuk ka përgjegjësi civile pa faj. Aktualisht ajo çka ka vërtet rëndësi është se nuk ka përgjegjësi civile pa dëm¹⁰⁴.

Përgjegjësia civile është riformuluar, si një reagim kundër dëmshpërblimit të padrejtë, sipas postulatit të ri se "baza e dëmshpërblimit nuk është akti i paligjshëm, por fakti dëmtues"¹⁰⁵. Përballë pamundësisë së eliminimit të dëmit, problem paraqitet transferimi i tij nga një palë (i dëmtuari) tek një tjetër (shkaktari). Sipas këtij qendrimi, përgjegjësia civile nuk është një mjet për të ndëshkuar fajtorin, por për të transferuar pasojat dëmtuese tek një subjekt tjetër nga ai që i ka pësuar ato, kur ekziston një arsye e mjaftueshme që justifikon këtë gjë¹⁰⁶. Me fjalë të tjera, nuk është më e nevojshme të analizohet sjellja e atij që ka shkaktuar dëmin, pasi ai përgjigjet për të thjesht për shkak të shkaktimit të tij ose, thjesht për shkak të kryerjes së një akti që mund të prodhojë rrezik¹⁰⁷.

⁹⁷ Disa nga këto elementë janë: (Veprimi/mosveprimi; Ekzistenca e dëmit; Paligjshmëria e këtij veprimi/mosveprimi; Ekzistenca e fajit; Lidhja shkakësore mes veprimit/mosveprimit dhe dëmit).

⁹⁸ *Ibid.*

⁹⁹ Shiko nenin 1737 e në vijim të Kodit Civil dhe Tregtar argjentin.

¹⁰⁰ Vivas, Luis Mario. *Unificación de la responsabilidad civil contractual y extracontractual en el Nuevo Código Civil y Comercial Argentino*. Revista Iberoamericana de Derecho Privado, No.4, 2016.

¹⁰¹ *Ibid.*

¹⁰² Picasso, Sebastian. *La unificación de la responsabilidad contractual y extracontractual en el Código Civil y Comercial de la Nación*. Sup.Especial Nuevo Código Civil y Comercial, No.151, 2014, f. 1.

¹⁰³ Torres Kirmser, Raul. *La responsabilidad civil: una materia en constante evolución. La responsabilidad sin culpa*. Paraguay 2008, f. 7.

¹⁰⁴ Contreras Strauch, Osvaldo. *Civil liability and insurance (An analysis of civil liability and its Insurance, under the legal viewpoint of the 'common law' and 'civil or continental law' systems)*. AIDA International Insurance Law Association, f. 26.

¹⁰⁵ Almodóvar Maldonado, José. *Evolución de la responsabilidad civil: Una aproximación*. Ceiba, No.12, 2012, f. 1.

¹⁰⁶ Besalú Parkinson, Aurora. *La responsabilidad civil: Tendencias actuales. La experiencia argentina y su posible proyección al derecho mexicano*. Boletín Mexicano de Derecho Comparado, Volumen 1, No. 91, 1998.

¹⁰⁷ Almodóvar Maldonado, José. *Evolución de la responsabilidad civil: Una aproximación*. Ceiba, No.12, 2012, f. 11.

c. Përhapja dhe zgjerimi i përgjegjësisë civile objektive;

Siç e përmendëm më herët, nga gjysma e dytë e shekullit të XIX, kryesisht si pasojë e teknologjisë dhe zhvillimit industrial, sistemi klasik i përgjegjësisë civile filloi të pësojë ndryshime të thella dhe substanciale, të lidhura me përparimin e procesit objektiv të saj¹⁰⁸. Sistemi juridik tradicional i përgjegjësisë civile filloi të pësojë një krizë si pasojë e transformimit radikal që pësuan themelet e tij nisur nga një sër faktorësh ekonomikë e shoqërorë të kohës si: revolucioni industrial; përdorimi i substancave të reja të rrezikshme; derdhjet e hidrokarbureve në det; makinat dhe pajisjet e reja që rrisin rreziqet; e të tjera aktivitete për kohën të panjohura e të rrezikshme që çuan në një shumëfishim të dëmeve dhe prishje të ekuilibrave rregullues të tyre¹⁰⁹.

Me kalimin e kohëve, përgjegjësia civile objektive filloi të marrë pozita dominuese në shoqëri pavarësisht konsolidimit të hershëm të parimit subjektiv të saj¹¹⁰. Kjo përgjegjësi, e njohur gjerësisht dhe si 'përgjegjësia e rrezikut të krijuar', është e bazuar mbi drejtësinë distributive, qëllimi i së cilës nuk arrihet teknikisht dhe në mënyrë perfekte, përmes koncepteve të barazisë dhe pabarazisë, por arrihet përmes formulimit dhe llogaritjes së socializimit të risqeve¹¹¹. Sipas teorisë për riskun e krijuar, përgjegjësia bazohet në faktin se çdo aktivitet që krijon një rrezik për kolektivin dhe shoqërinë në përgjithësi, e detyron shkaktarin e dëmeve të përgjigjet për to¹¹², pa marrë parasysh fajin si element të përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit, por vetëm duke u bazuar në faktin e krijimit të një rreziku si pasojë e vënies në funksionim ose përdorim të gjërave të rrezikshme¹¹³. Me fjalë të tjera, burimi i detyrimit bëhet përdorimi i ligjshëm ose jo i sendeve, mjeteve apo aktiviteteve të rrezikshme që e detyron personin që përfiton nga to të riparojë dëmin e shkaktuar.¹¹⁴

Si përfundim duhet thënë se përgjegjësia objektive është një përgjegjësi që nuk buron nga analiza e fajit që i takon përgjegjësit, por që buron thjesht nga krijimi i një rreziku që vjen nga veprimet e personit që i bën gjërat të funksionojnë dhe lëvizin¹¹⁵. Në këtë prizëm, faktorët më të rëndësishëm të atribuimit të përgjegjësisë civile objektive janë rreziku dhe marrja përsipër e garancisë për mbulimin e tij¹¹⁶. Nga kjo qasje, konkludojmë se përhapja gjithnjë e më e madhe e saj në sistemet ligjore të shumë vendeve në botë, duke lënë mbrapa dhe përgjegjësinë civile subjektive nuk është thjesht rezultat i zhvillimeve të disa viteve të fundit, por i tendencës afatgjatë të së drejtës së dëmeve për të garantuar një shpërndarje të drejtë të rreziqeve dhe një mbrojtje më të qëndrueshme të palëve të dëmtuara¹¹⁷.

d. Zgjerimi i gamës së dëmeve. Shtimi i padive për dëme kolektive;

¹⁰⁸ Rosso, Elorriaga, Franco, Gian. *El principio de la responsabilidad civil objetiva limitada: un elemento de equilibrio sistémico que no contradice al denominado principio de la reparación integral del daño*. Revista de Derecho Privado, Bogota, 2014, i disponueshëm në:

http://www.scielo.org.co/scielo.php?script=sci_arttext&pid=S0123-43662014000100015

¹⁰⁹ Për më shumë shih: Díaz Barriga, Campos Mercedes. *La responsabilidad civil por daños al medio ambiente*. Illustrated, 2000, f. 51.

¹¹⁰ Elischer, David. *On objective liability of legal entities- several considerations on the imputability of harmful consequences*. Jurisprudence, Journal of the Charles University Law Faculty, No. 4, 2018, f. 1.

¹¹¹ Rosso Elorriaga, Franco Gian. *El principio de la responsabilidad civil objetiva limitada: un elemento de equilibrio sistémico que no contradice al denominado principio de la reparación integral del daño*. Revista de Derecho Privado, Bogota, 2014.

¹¹² Díaz Barriga, Campos Mercedes. *La responsabilidad civil por daños al medio ambiente*. Illustrated, 2000, f. 51.

¹¹³ Gonzalez Molina, Oswaldo Osnar. *La responsabilidad civil objetiva*. Revista electrónica trimestral de la facultad de derecho de la universidad de la Salle Bajío, Vol.3, No.18, 2013, i disponueshëm në:

https://www.lasallebajio.edu.mx/delasalle/contenidos/revistas/derecho2013/numero_18/a_laresponsabilidad.php

¹¹⁴ Díaz, Barriga, Campos, Mercedes. *La responsabilidad civil por daños al medio ambiente*. Illustrated, 2000, fq.54.

¹¹⁵ Rodríguez Puentes, Marcos. *Concepto y alcance de la responsabilidad objetiva*. Revista de Derecho Privado, No.56, 2016, f. 13.

¹¹⁶ *Ibid.*

¹¹⁷ Elischer, David. *On objective liability of legal entities- several considerations on the imputability of harmful consequences*. Jurisprudence, Journal of the Charles University Law Faculty, No. 4, 2018, f. 1.

Shoqëria aktuale po karakterizohet gjithnjë e më shumë si një shoqëri e prodhimit, shkëmbimeve dhe konsumit në masë, ku mediat e komunikimit dhe zhvillimi teknologjik kanë marrë një rëndësi tejet të madhe¹¹⁸. Si pasojë e kësaj, edhe konfliktet gjithnjë e më shumë janë shndërruar në çështje kolektive, duke bërë që të përballemi rrjedhimisht dhe me një lloj socializimi të rreziqeve dhe një objektivizim më të madh të përgjegjësive civile¹¹⁹. Mekanizmat e socializimit të rreziqeve kanë stimuluar zhvillimin dhe transformimin e të drejtës së dëmeve, thajse tërësisht duke bërë kalimin nga një përgjegjësi civile individualiste në një tjetër më gjithëpërfshirëse.¹²⁰ Në këto raste, rendi juridik duket se largohet nga sistemi i përgjegjësive civile dhe i përafrohet një metode sigurie shoqërore ose të shlyerjes kolektive të dëmit, duke sjellë atë fenomen që shumë autorë e kanë klasifikuar si socializim të së drejtës së dëmeve¹²¹.

Përgjegjësia civile ka zgjeruar orbitën e saj të aplikimit dhe përfshin, përveç funksionit tradicional të dëmshpërblimit dhe kompensimit të dëmit, funksione parandaluese, duke përfshirë mbrojtjen e pasurive kolektive¹²² dhe për disa raste të veçanta si mbrojtja e konsumatorit dhe funksione ndëshkuese ose sanksionuese.¹²³ Nisur nga ky zgjerim i funksioneve të përgjegjësive civile, në shoqëritë industriale e kapitaliste tashmë nuk mund të flasim më vetëm për dëme që prekin karakterin personal të individëve, por duhen trajtuar dhe ato dëme që prekin në të njëjtën kohë shumë individë¹²⁴, të grupuara në atë që prej kohësh njihet si dëmi social.

Dëmi social është përkufizuar si një dëmtim a shkëlqje shoqërore, i ardhur si produkt i një sjelljeje njerëzore që është kundër rregullimit ligjor ose në përputhje me të, që i drejtohet padrejtësisht një shumice individësh (të cilët mund të përbëjnë nga një grup i caktuar deri te kolektiviteti shoqëror në tërësi), duke u shkaktuar një çënim pasuror ose jopasuror të interesave të tyre dhe ndaj të cilëve lind detyrimi për riparim.¹²⁵ Nga kjo kuptojmë se dëmi social është një figurë dëmi që vjen nga veprime dhe/ose mosveprime të personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, si të ligjshme edhe të paligjshme, për sa kohë që dëmtohet mirëqenia e përgjithshme nga akte të padrejta mbi interesa ose të drejta me ndikim kolektiv¹²⁶.

Nga ky përkufizim konstatohet se dëmi social ka një fushë më të shtrirë veprimi se dëmet kolektive¹²⁷, pasi nga natyra e vet ai nuk ndodh vetëm për shkak të ngjarjeve që prekin interesa të përbashkëta shoqërore; por shkalla e

¹¹⁸ Aguirre, Garabito, Ana Lucía & Sibaja, López, Irina. *El daño social: su conceptualización y posibles aplicaciones*. Revista Judicial, No.101, Costa Rica, 2011, f. 133.

¹¹⁹ Shina, Fernando. *Las nuevas tendencias en materia de responsabilidad*. Argjentinë: Sistema argentino de información jurídica, 2018, f. 4.

¹²⁰ Duhet thënë se përgjegjësia civile si rregull i përgjithshëm ka qenë individuale. Kjo sepse si parim dëmi shkaktohet nga një person i caktuar, ose nga disa persona individualisht të caktuar, ose prodhohet nga aktivitetet që kryhen nga një ose disa subjekteve gjithashtu individualisht të përcaktuar, për më shumë shih: Moreno, Valeria. *Evolución y actualidad de la responsabilidad civil*. Revista Anales de la Facultad de Ciencias Jurídicas y Sociales. Universidad Nacional de la Planta, No.48, 2018, f. 21.

¹²¹ Shina, Fernando. *Las nuevas tendencias en materia de responsabilidad*. Argjentinë: Sistema argentino de información jurídica, 2018, f. 6.

¹²² Pjesë e të drejtave me ndikim kolektiv, si interesa të shpërndara, interesa strikte kolektive dhe interesat individuale homogjene, është e mundur të integrohet ndër të tjera dhe mbrojtja e mjedisit, si dhe shëndeti, të drejtat e konsumatorëve dhe përdoruesve, konkurrenca e lirë, çështjet elektorale, buxhetore, pasuria historike, kulturore, arkeologjike dhe arkitekturore, planifikimi urban, pasuritë dhe zonat publike, identiteti kulturor, për më shumë shiko: Peña Chacón, Mario. *Daño social, daño moral colectivo y daños punitivos. Delimitaciones y alcances en materia ambiental*, fq.194, i disponueshëm në: <https://www.corteidh.or.cr/tablas/r32680.pdf>

¹²³ Moreno, Valeria. *Evolución y actualidad de la responsabilidad civil*. Revista Anales de la Facultad de Ciencias Jurídicas y Sociales. Universidad Nacional de la Planta, No.48, 2018, f. 23.

¹²⁴ Aguirre Garabito, Ana Lucía & Sibaja, López, Irina. *El daño social: su conceptualización y posibles aplicaciones*. Revista Judicial, No.101, Costa Rica, 2011, f. 132.

¹²⁵ Peña Chacón, Mario. *Daño social, daño moral colectivo y daños punitivos. Delimitaciones y alcances en materia ambiental*, f. 192.

¹²⁶ *Ibid.*

¹²⁷ Paralelisht dëmit social ose kolektiv, në kohët ku jetojmë po shihet një përhapje gjithnjë e më e madhe e përgjegjësive kolektive si pasojë e rritjes së ngjarjeve të dëmshme që burojnë nga sjellje anonime që vijnë nga veprimet e dëmshme të grupeve spontane ose të organizuara. Në këto raste grupi që realizon aktivitetet të rrezikshme mban përgjegjësi objektive, sepse po kryhen një veprimtari të rrezikshme për natyrën e tij qoftë përmes mjeteve të përdorura; ose përmes rrethanave e

tij është aq e gjerë sa mund të përfshijë çdo lloj ngjarjeje që shkakton një dëm të padrejtë ndaj mirëqenies së shoqërisë, duke përfshirë aspekte më të thella dhe të ndjeshme të jetës shoqërore dhe ekonomike në tërësi¹²⁸.

Duhet thënë gjithashtu se dhe në Shqipëri koncepti i dëmit ka rreshtur së qeni individual, dhe po bëhet gjithnjë e më social. Shembuj tipikë të këtyre interesave kolektivë që po mbrohen gjithnjë e më shumë në vendin tonë janë dhe mbrojtja e mjedisit¹²⁹, mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve etj¹³⁰.

e. Siguria shoqërore dhe përhapja e sigurimeve të detyrueshme;

Përhapja dhe zhvillimi i shpejtë i teknologjisë dhe shkencës ka bërë që numri i rreziqeve që duhen shmangur të rritet gjithmonë e më shumë, si në rastin e riskut direkt ashtu dhe atij indirekt¹³¹, fakt që ka sjellë përhapjen progresive të detyrimit ligjor për sigurimin e përgjegjësive civile por jo vetëm. Të gjitha këto tendenca të reja, që fokusojnë vëmendjen tek viktima e dëmit, e bëjnë më aktuale se kurrë thënien e një studiuesi latinoamerikan që shprehet se: “*Sot përgjegjësia civile ka evoluar nga një detyrim për përgjegjësi në një meritë për tu shpërblyer*”¹³².

Nga sigurimi i përgjegjësive civile përfiton si personi që kryen një akt të paligjshëm, ashtu edhe personi që ka pësuar dëmin për shkak të këtij akti. Nga njëra anë, ky lloj sigurimi shërben si një garanci për mbrojtjen e pasurisë së personit që shkakton dëmin, ndërsa nga ana tjetër, mbrojtja financiare i ofrohet palës së dëmtuar.¹³³ Kjo policë na lejon të mbrohemi nga të gjitha ato situata të cilat, për shkak të dëmeve të shkaktuara palëve të treta, ndikojnë në pasurinë e individit që sigurohet¹³⁴. Pra kjo policë mbron pasurinë e të siguarit kur ai gjendet në kushtet e detyrimit për dëmshpërblyer si pasojë e një dëmi të pavullnetshëm shkakuar një personi të tretë.¹³⁵

Nga ana tjetër, pala e dëmtuar është gjithashtu e mbrojtur kur personi që shkakton dëmin nuk është në gjendje të kompensojë për shkak të mungesës së pasurive. Këtu pasqyrohet rëndësia e madhe shoqërore e sigurimit të përgjegjësive si mekanizëm mbrojtës ndaj të dy palëve të përfshira në marrëdhënie.¹³⁶

5. Konkluzione

mënyrës së realizimit të tij. Sidoqoftë, duhet theksuar se grup i rrezikshëm do të quhet vetëm ai që "krijon një rrezik të jashtëzakonshëm mbi personin ose pasuritë e të tjerëve". Në raste të tjera do ishte e vështirë që veprimtaria e organizuar e këtyre grupeve të rëndohej me përgjegjësi kolektive, për më shumë shih: Moreno, Valeria. *Evolución y actualidad de la responsabilidad civil*. Revista Anales de la Facultad de Ciencias Jurídicas y Sociales. Universidad Nacional de la Planta, No.48, 2018, f. 23.

¹²⁸ Aguirre, Garabito, Ana Lucía & Sibaja, López, Irina. *El daño social: su conceptualización y posibles aplicaciones*. Revista Judicial, No.101, Costa Rica, 2011, fq.139.

¹²⁹Përgjegjësia për mjedisin si dhe përgjegjësia që rrjedh nga produktet janë rregulluar të dyja në Kodin Civil shqiptar, përkatësisht në nenin 624 dhe nenin 628 e në vijim. Kështu për shembull në nenin 624 KC parashikon se: “*Personi që me faj ka cënuar mjedisin duke e keqësuar, ndryshuar ose dëmtuar atë, tërësisht apo pjesërisht, detyrohet të dëmshpërblejë dëmin e shkakuar*”.

¹³⁰ Nevoja për të mbrojtur dëmet kolektive ka bërë që në Shqipëri, organizata të ndryshme jofitimprurëse ti propozojnë Kuvendit një projektligj “*Për paditë kolektive*”. Versionin online të projektligjit e gjeni të pasqyruar në: https://www.osfa.al/sites/default/files/projektligji_per_padite_kolektive.pdf

¹³¹ Mignault. *The modern conception of civil responsibility, A study of comparative law*. Journal of the Society of Comparative Legislation, Vol.11, No.1, 1910, f. 1.

¹³² Torres Kirmser, Raul. *La responsabilidad civil: una materia en constante evolución. La responsabilidad sin culpa*. Paraguay 2008, f. 46.

¹³³ Khutsushvili, Marine. *The role and prospects of liability insurance development in Georgia's insurance industry*. Proceedings of Azerbaijan High Technical Educational Institutions Journal, 2025, f. 1.

¹³⁴ Për më shumë shih: AMF. Sigurimi i përgjegjësive të Përgjithshme Civile, f. 25, i disponueshëm në: https://amf.gov.al/pdf/publikime2/edukimi/Sigurimiipergjegjesisecivile_1.pdf.

¹³⁵ *Ibid*.

¹³⁶ Khutsushvili, Marine. *The role and prospects of liability insurance development in Georgia's insurance industry*. Proceedings of Azerbaijan High Technical Educational Institutions Journal, 2025, f. 1.

Përgjegjësia civile në shoqërinë bashkëkohore po bëhet objekt i debateve të mëdha në jurisprudencën dhe doktrinën juridike, përballë ndryshimeve të vazhdueshme të marrëdhënieve ndërnjerëzore, si pasojë e transformimeve të ardhura në sektorët ekonomikë e socialë¹³⁷. Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë digjitale dhe integrimi i mallrave fizike në mjedisin digjital përmes përmbajtjes digjitale të integruar, së bashku me rritjen e tregut të produkteve inteligjente dhe Internetit të Gjërave (IoT), kanë pasur një ndikim të dukshëm në transformimet e koncepteve klasike të përgjegjësisë dhe prezantimit të formave të reja të saj.¹³⁸ Inteligjenca artificiale dhe arritjet e tjera teknologjike kanë filluar të krijojnë sfida të reja lidhur me përcaktimin e përgjegjësinë civile si pasojë e përpjekjeve për balancim mes dëmshpërblimit të përshtatshëm ndaj të dëmtuarve përkundrejt nevojës për të mos penguar inovacionin teknologjik.

Duke ditur se çdo një sistem ligjor duhet të ketë si qëllim parandalimin e ndodhjes ose përsëritjes së dëmeve¹³⁹, zhvillimi i industrisë, veprimtarive me risk të lartë e së fundmi sistemeve të avancuara të teknologjisë së informacionit kanë bërë që të fitojnë përparësi faktorët objektivë që i atribuohen përgjegjësisë, duke lënë mënjanë aforizmin e vjetër se nuk ka përgjegjësi civile pa faj. Aktualisht ajo çka ka vërtet rëndësi është se nuk ka përgjegjësi civile pa dëm. Kjo gjë është afirmuar dhe nga doktrina e fundit italiane që pohon se kualifikimi i veprimit si i fajshëm ose i paligjshëm, nuk është objekti i gjykimit të përgjegjësisë, duke nënkuptuar kështu se baza e dëmshpërblimit nuk është akti i paligjshëm, por fakti dëmtues¹⁴⁰.

Nga kjo qasje, konkludojmë se përhapja gjithnjë e më e madhe e formave të përgjegjësisë objektive, duke lënë mbrapa përgjegjësinë civile subjektive nuk është thjesht rezultat i zhvillimeve të disa viteve të fundit, por i një tendence afatgjatë të së drejtës së dëmeve për të garantuar një shpërndarje të barabartë të rreziqeve dhe një mbrojtje më të qëndrueshme të palëve të dëmtuara. Kjo tendencë ka bërë që krahas zhvillimit të përgjegjësisë objektive, të ridimensionohen qendrimet e vjetra mbi ndarjen kontraktuale dhe jashtëkontraktuale të përgjegjësisë civile, si dhe të dalin në pah lloje të reja të figurave të dëmit që i përgjigjen ndryshimeve socialo-teknologjike që po jetojmë. Në Shqipëri, disa nga ndryshime janë reflektuar shumë përciptazi në Kodin Civil të 1994, megjithatë ato po shihen gjithnjë e më të përfshira në legjislacionin specifik për produktet, kosumatorët, mjedisin, sigurinë kibernetike e pronësinë industriale, si dhe në jurisprudencën vendase që bazuar në modelet e vendeve fshqinjë është përpjekur që gjatë viteve të zhvillojë lloje të reja të dëmit apo dhe të përqafojë tendencat e gjithëpranuara mbi përgjegjësinë civile.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Aguirre, Garabito, A. L., & Sibaja López, I., *El daño social: su conceptualización y posibles aplicaciones*. Revista Judicial, No.101, Costa Rica, 2011.
2. Almodovar Maldonado, José. *Evolución de la responsabilidad civil: Una aproximación*. Ceiba: Año 12, Num.1, UPR-Ponce, 2013.
3. Bardhi, A., *Përgjegjësia civile për dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar nga të tretët në legjislacionin shqiptar*. Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, Tiranë 2016.

¹³⁷ Da Gama, Calmon Guilherme & Leite, De Maria Conceição. *El deber de no causar daño a otro desde la perspectiva de la reparación integral de la víctima*. Revista internacional consinter de direito.

DOI: 10.19135/revista.consinter.00008.27

¹³⁸ Koch, Bernhard, Borghetti, Jean- Sébastien, Machnikowski, Piotr, Pichonnaz, Pascal, Ballell de las Heras, Rodriguez Teresa, Twigg-Flesner, Christian & Wendehorst Christiane. *Response of the European Law Institute to the Public Consultation on Civil Liability- Adapting Liability Rules to the Digital Age and Artificial Intelligence*. De Gruyter, Volume 13, No.1, 2022, f. 28.

¹³⁹ Shina, Fernando. *Las nuevas tendencias en materia de responsabilidad*. Argentinë: Sistema argentino de información jurídica, 2018.

¹⁴⁰ Besalú Parkinson, Aurora. *La responsabilidad civil: Tendencias actuales. La experiencia argentina y su posible proyección al derecho mexicano*. Boletín Mexicano de Derecho Comparado, Volumen 1, No. 91, 1998.

4. Bello Janeiro, D., Gallego Dominguez, I., Gázquez, L., Herrera de las Heras, R., Mingorance Gosálvez, M., C., & Talma Charles, J., *Cuestiones actuales de responsabilidad Civil. Colección derecho de daños*. Editorial Reus S.A, 2009.
5. Besalú Parkinson, A., *La responsabilidad civil: Tendencias actuales. La experiencia argentina y su posible proyección al derecho mexicano*. Boletín Mexicano de Derecho Comparado, Volumen 1, No. 91, 1998, <https://doi.org/10.22201/ij.24484873e.1998.91.3525>
6. BEUC, The Consumer Voice in Europe. *Adapting civil liability rules to the new digital technologies. Accompanying paper to BEUC's response to the European Commission's public consultation on Civil liability- adapting liability rules to the digital age and artificial intelligence*, 2022.
7. British Columbia Law Institute. *Report on Artificial Intelligence and Civil Liability*, 2024.
8. Bruggemeier, G., *The Civilian Law of Delict: A Comparative and Historical Analysis*. European Journal of Comparative Law and Governance, Volume 7, Issue 4, 2020.
9. Contreras Strauch, O., *Civil liability and insurance (An analysis of civil liability and its Insurance, under the legal viewpoint of the 'common law' and 'civil or continental law'systems)*. AIDA International Insurance Law Association.
10. Da Gama, C. G., & Leite, M., C., *El deber de no causar daño a otro desde la perspectiva de la reparación integral de la víctima*. Revista internacional consinter de direito, <https://revistaconsinter.com/index.php/ojs/0827>
11. Dauti, N., *E drejta e Detyrimeve, Pjesa e përgjithshme*. Prishtinë, 2016.
12. Díaz Barriga, C. M., *La responsabilidad civil por daños al medio ambiente*. Illustrated, 2000.
13. Dos Santos, S., M., *A responsabilidade civil extracontratual no direito romano: Analise comparativa entre os requisitos exigidos pelos romanos e os elementos de responsabilidade civil atualmente existentes*. Direito em Ação, Vol.10, N.1, Brasília 2013.
14. Elischer, D., *On objective liability of legal entities- several considerations on the imputability of harmful consequences*. Jurisprudence, Journal of the Charles University Law Faculty, No. 4, 2018.
15. Fernandez Fernandez, A., *La responsabilidad civil subjetiva*. Instituto de Investigaciones Juridicas de la UNAM, 2017.
16. Fernández Muñoz, M. L., *Nuevas tendencias de la responsabilidad civil*. Politécnico Grancolombiano, 2019, <https://revistas.poligran.edu.co/index.php/libros/article/view/2247/2129>
17. Fish, M., *An Eye for an eye: Proportionality as a Moral Principle of Punishment*. Oxford Journal of Legal Studies, Vol.28, Nr.1, 2008.
18. Franzoni, M., *Trattato della responsabilita civile, L'illecito*. Seconda edizione, Giufre, Milano 2010.
19. Garcilopez, M., A., *La responsabilidad sin culpa*. Revista Critica de Derecho Inmobiliario, <https://vlex.es/vid/responsabilidad-culpa-352456?fbclid=IwAR0q7nnuZbWKOnH58GkWmwVtC1OoARzbdZ4m3oZgsI0p2c0Ft1vHHxdVU2E>
20. Gojani, S., *Contractual and Civil Delict Liability*. European Academic Research, Vol.II, Issue 11, 2015.
21. Gonzalez Molina, O. O., *La responsabilidad civil objetiva*. Revista electrónica trimestral de la facultad de derecho de la universidad de la Salle Bajío, Vol.3, No.18, 2013.
22. Kārklīņš, J., *Artificial Intelligence and Civil Liability*. Journal of the University of Latvia Law, No.13, 2020, DOI:10.22364/jull.13.10
23. Kastrati, G., *E Drejta Civile*. Prishtinë: Shtëpia Botuese Dukagjini, 2018.
24. Khutsushvili, M., *The role, and prospects of liability insurance development in Georgia's insurance industry*. Proceedings of Azerbaijan High Technical Educational Institutions Journal, 2025.
25. Koch, B., Borghetti, J- S., Machnikowski, P., Pichonnaz, P., Ballell de las Heras, R. T., Twigg-Flesner, Ch. & Wendehorst Ch., *Response of the European Law Institute to the Public Consultation on Civil Liability- Adapting Liability Rules to the Digital Age and Artificial Intelligence*. De Gruyter, Volume 13, No.1, 2022.
26. Mamuti, Afet. *Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit në Maqedoni*, Disertacion për marrjen e gradës shkencore 'Doktor', Tiranë 2013.

27. Marchisio, E., *In support of “no-fault” civil liability rules for artificial intelligence*. SN Soc Sci, Vol.1, No.54, 2021.
28. Martinez, M. & Alejandra, L., *La accion civil del daño moral*. Universidad Nacional Autonoma de Mexico, 2014.
29. Mignault, P. B., *The modern conception of civil responsibility, A study of comparative law*. Journal of the Society of Comparative Legislation, Vol.11, No.1, 1910.
30. Moreno, V., *Evolución y actualidad de la responsabilidad civil*. Revista Anales de la Facultad de Ciencias Juridicas y Sociales. Universidad Nacional de la Planta, No.48, 2018.
31. Muharremi, M., *Përgjegjësia civile nga dëmet e shkaktuara nga automjetet në Kosovë dhe Shqipëri*. Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’ Tiranë, 2018.
32. Nuni, A. & Mustafaj, I., *E drejta e detyrimeve*, Tiranë 2012.
33. Paredes, M. & Javier B., *Cual es la diferencia entre responsabilidad civil subjetiva y objetiva?* <https://lpderecho.pe/diferencia-responsabilidad-civil-subjetiva-objetiva/>
34. Peña Chacón, M., *Daño social, daño moral colectivo y daños punitivos. Delimitaciones y alcances en materia ambiental*.
35. Picasso, S., *La unificación de la responsabilidad contractual y extracontractual en el Código Civil y Comercial de la Nación*. Sup.Especial Nuevo Código Civil y Comercial, No.151, 2014.
36. Rangel-Sanchez, D., *El ‘daño a la persona’ en material de responsabilidad civil extracontractual. Especial referencia a los daños derivados de la responsabilidad civil familiar*. Tesis para optar el título de abogado, Universidad de Piura 2015.
37. Rodríguez Puentes, M., *Concepto y alcance de la responsabilidad objetiva*. Revista de Derecho Privado, No.56, 2016.
38. Rosello, C., *Responsabilita contrattuale ed aquiliana; il punto sulla giurisprudenza*. Itali 1996.
39. Rosso Elorriaga, Franco Gian. *El principio de la responsabilidad civil objetiva limitada: un elemento de equilibrio sistémico que no contradice al denominado principio de la reparación integral del daño*. Revista de Derecho Privado, Bogota, 2014.
40. Ruy Barroso de Mello, S., *A responsabilidade civil e seu seguro*. Revista Opinião.Seg nr.12,2016, <https://www.editoraroncarati.com.br/v2/Artigos-e-Noticias/Artigos-e-Noticias/A-responsabilidade-civil-e-seu-seguro.html>
41. Savatier, R., *Traité de la responsabilité civile en droit français civil, administrative, professional, procédural*. Revue internationale de droit comparé, 1950.
42. Schenk Duque, M., & Da Silva Versiani, L. R., *The preventive function of civil liability in light of the States’ duties of protection in the context of the digital world*. Brazilian Journal of Law Technology and Innovation, Vol.1, No.2, 2023.
43. Semini, M., *E drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave*. Skanderbeg Books, Tiranë 2016.
44. Sherifi, V., *Përgjegjësia civile që rrjedh nga dëmi ekzistencial. Vështrim në legjislacionin shqiptar*. Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, Tiranë 2015.
45. Shina, F., *Las nuevas tendencias en materia de responsabilidad*. Argentinë: Sistema argentino de información jurídica,2018,<https://www.saij.gob.ar/fernando-shina-nuevas-tendencias-materia-responsabilidad-dacf18027120181218/1234567890abcdefg172081fcanirtcod?&o=7&f=Total%7CFecha%7CEstado%20de%20Vigencia%5B5%2C1%5D%7CTema/Derecho%20penal/delitos%20contra%20la%20propiedad%7COrganismo%5B5%2C1%5D%7CAutor%5B5%2C1%5D%7CJurisdicci%F3n%5B5%2C1%5D%7CTribunal%5B5%2C1%5D%7CPublicaci%F3n%5B5%2C1%5D%7CColecci%F3n%20tem%Etica%5B5%2C1%5D%7CTipo%20de%20Documento/Doctrina&t=98#>
46. Torres Kirmser, R., *La responsabilidad civil: una materia en constante revolución. La responsabilidad sin culpa*,<https://www.pj.gov.py/ebook/monografias/nacional/civil/Jos%C3%A9-Ra%C3%BAI-Torres-Kirmser-La-Responsabilidad.pdf>
47. Vidal Ramirez, F., *La responsabilidad civil*. Dialet, No.54, 2001.
48. Vivas, L. M., *Unificación de la responsabilidad civil contractual y extracontractual en en Nuevo Código Civil y Comercial Argentino*. Revista Iberoamericana de Derecho Privado, No.4, 2016.

49. Williams, G., *The vicarious liability and the Master's indemnity*. The Modern Law Review, Vol.20, Nr.5, 1957.

Legjislacion

1. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 1994.
2. Parimeve Europiane të së Drejtës së Dëmit, 1992.
3. Kodit Civil dhe Tregtar i Kombit, Republika e Argjentinës, 2016.

Web faqe

1. <http://www.csun.edu/~hcfl1004/12tables.html?fbclid=IwAR1iaHR6XKjAfZXMJTVQDocGMfOaaAm-oHP69pjHspK7A6aQthqB09KYUNY>
2. <https://jus.com.br/artigos/58301/aspectos-gerais-da-responsabilidade-civil>
3. <https://cours-de-droit.net/definition-de-la-responsabilite-civile-a121605924/>
4. <http://www.egtl.org/PETLEnglish.htm>
5. <https://www.irmi.com/articles/expert-commentary/contractual-confusion-assuming-the-liability-of-others>
6. https://amf.gov.al/pdf/publikime2/dukimi/Sigurimiipergjegjesisecivile_1.pdf
7. [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/621926/IPOL_STU\(2020\)621926_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/621926/IPOL_STU(2020)621926_EN.pdf)
8. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020DC0064>
9. https://www.osfa.al/sites/default/files/projektligji_per_padite_kolektive.pdf

NGRITJA E PADISË DIREKTE NË KONTRATAT E SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISË. PROBLEME TË PRAKTIKËS GJYQËSORE SHQIPTARE

MSc. Etien ISAK*
MSc. Elidjana BREGU**

DIRECT ACTION LAWSUITS IN LIABILITY INSURANCE CONTRACTS: ISSUES IN ALBANIAN JUDICIAL PRACTICE

Abstract

This article focuses on analysing direct lawsuits as one of the alternative legal instruments available to persons injured by accidental events that generate civil liability for the insured parties. The purpose of this paper is to reflect the essential elements and object of the civil liability insurance contract, the legal nature of the direct lawsuit and the filing of this lawsuit by the damaged party as an alternative lawsuit in addition to the filing of the torts lawsuit. Further, this paper will focus on the case law of the Civil College of the Supreme Court, which has defined the lawsuits filed by the damaged party against the insurers as torts lawsuits where the three-year statute of limitation applies according to Article 115, letter dh) of the Civil Code. Despite this recent consolidated interpretation of the Supreme Court on the legal nature of these claims and the applicable statute of limitation period, in such cases, we are faced with the filing of a direct lawsuit arising from the contractual relationship of securing civil liability. The qualification of these lawsuits as such would also entail the application of a different statute of limitation period for them, precisely two years under Article 115, letter ç) of the Civil Code.

Keywords: *direct lawsuit, tort lawsuit, third party liability insurance, transfer of risk, statute of limitation*

1. Hyrje

Sigurimi i përgjegjësive jashtëkontraktore përbën një nga llojet më të përhapura të kontratave të sigurimit në një ekonomi tregu përfshirë vendin tonë, edhe pse doktrina jonë e së drejtës civile nuk e ka përpunuar mjaftueshëm këtë lloj të marrëdhënieve kontraktore. Kontrata e sigurimit të përgjegjësive jashtëkontraktore përbën një lloj të veçantë të sigurimit të pasurisë, i cili synon të mbulojë humbjet pasurore të të siguruarit që mund të vijnë prej lindjes së përgjegjësive civile jashtëkontraktore kundrejt të tretëve.

Ky punim ka për qëllim të pasqyrojë një analizë të shkurtër të kontratës së sigurimit të përgjegjësive civile kundrejt të tretëve si dhe të natyrës së marrëdhënieve juridike që krijohen ndërmjet siguruarit, të siguruarit dhe personit të tretë të dëmtuar. Gjithashtu do të ndalemi në praktikën e tanishme gjyqësore të Gjykatës së Lartë në drejtim të natyrës së padisë së ngritur nga i tretë kundrejt siguruarit si dhe afatit të parashkrimit të padisë të zbatueshëm për këto padi. Ashtu siç do të shtjellohet në vijim të këtij punimi, duket se paditë e ngritura nga të tretët kundrejt siguruarëve bazohen në kontratën e lidhur mbi sigurimin e përgjegjësive civile të njohura si *paditë direkte* nga doktrina civile, padi për të cilat neni 115, germa ç) i Kodit Civil përcakton një afat parashkrimi dy

* Kandidat për gjyqtar në Shkollën e Magjistraturës dhe aktualisht student doktorant pranë Departamentit të së Drejtës Civile në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Email: etien.isak@yahoo.co.uk.

** Kandidate për gjyqtare në Shkollën e Magjistraturës. Email: elidjanabregu@gmail.com.

vjeçar. Kjo, në dallim nga praktika e tanishme gjyqësore e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që i ka cilësuar si padi të kërimit të dëmit jashtëkontraktor, të cilat parashkruhen brenda një afati tri vjeçar.

2. Kontrata e sigurimit, ajo e sigurimit të përgjegjësive dhe padia direkte e të tretit kundrejt sigurvearit

2.1 Kontrata e sigurimit në përgjithësi

Kontrata e sigurimit përbën një kontratë të dyanshme, palë të së cilës janë tipikisht sigurveari dhe i siguruari. Në raste të veçanta ajo mund të lidhet edhe në dobi të personit të tretë¹ i cili tërheq vetëm të drejta nga aktivizimi i përgjegjësive të sigurvearit. Kjo kontratë ka për qëllim sigurimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme nga fatkeqësi të ndryshme natyrore apo edhe ngjarje të tjera të papritura si vjedhja etj.²

Referuar mënyrës së rregullimit të saj nga Kodi Civil aktual, sigurimi përbën një *kontratë formale (solemne)*. Kjo, pasi kontrata duhet të lidhet ndërmjet palëve në mënyrë të shkruar duke përcaktuar përmbajtjen e saj në dëshminë e sigurimit të njohur ndryshe si polica e sigurimit, përndryshe ajo është e pavlefshme.³

Kjo kontratë karakterizohet nga *pacaktueshmëria*. Kjo do të thotë se me lidhjen e kësaj kontrate nga palët nuk dihet me siguri nëse do të ndodhë ose jo ngjarja e sigurimit e marrë përsipër nga sigurveari.⁴ Pacaktueshmëria e kontratës së sigurimit lidhet me konceptin e *transferimit të rrezikut*. Me rrezik kuptohet mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje të dëmshme ose të një gjendjeje nevojë, ku ka një shkallë matëse të intensitetit dhe probabilitetit që operon në terma të sigurueshmërisë së rrezikut dhe vlerës së primit. Sa më i lartë të vlerësohet rreziku i sigurimit, aq më i lartë do të jetë dhe primi i sigurimit.⁵ Ekzistenca e rrezikut të sigurimit është thelbësore për ekzistencën juridike dhe vlefshmërinë e kontratës së sigurimit, pasi në rastin kur vërtetohet se rreziku i sigurimit nuk ka ekzistuar apo ka pushuar së qeni para lidhjes së kontratës, ajo do të jetë e pavlefshme.⁶

Përsa më sipër, objekt kryesor i kësaj kontrate është kalimi apo transferimi i një rreziku të tillë mbi pasurinë e siguruar në kontratë nga i siguruari ose i treti tek sigurveari kundrejt pagimit të çmimi, i referuar si primi. Pagimi i primit përbën detyrimin kryesor të palës së siguruar dhe mund të paguhet si një i tërë apo i ndarë në këste.⁷ Ekzekutimi i këtij detyrimi nga i siguruari kundrejt sigurvearit ka efekte shumë të rëndësishme, pasi vetëm pas pagimit të primit nga i siguruari do të aktivizohet përgjegjësia e sigurvearit për të ofruar mbulimin e rrezikut të sigurimit mbi pasurinë objekt kontrate.⁸ Domosdoshmëria e pagimit të primit nga i siguruari me qëllim mbulimin me sigurim nuk sjell cilësimin e kësaj kontrate si një kontratë reale, pasi kontrata e sigurimit quhet e lidhur dhe

¹ Neni 1113 i Kodit Civil: “Me kontratën e sigurimit, njëra palë (sigurveari), në qoftë se vërtetohet ngjarja e parashikuar në kontratë, detyrohet: a) në rastin e sigurimit të pasurisë t’i shpërblejë palës tjetër ose një personi të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, dëmin e pësuar brenda kufijve të shumës që është parashikuar në kontratë;...”.

² Edhe pse kontrata e sigurimit ndahet në dy lloje kryesore të saj siç janë sigurimi i pasurisë dhe i personit, në këtë punim fokusi është në analizën e kontratës së sigurimit të pasurisë dhe sigurimit të përgjegjësive si një nënloj i sigurimit të pasurisë. *Shënim i autorëve*.

³ Neni 1114 i Kodit Civil: “Kontrata e sigurimit duhet të bëhet me shkresë, me anë të dëshmisë të sigurimit (policës së sigurimit) që sigurveari i lëshon të siguruarit, përndryshe është e pavlefshme.”.

⁴ Tutulani-Semini, Mariana. *E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Pjesa e Përgjithshme dhe Pjesa e Posaçme*. Skanderbeg Books, 2016, f. 349.

⁵ Farenga, Luigi. *Manuale di Diritto delle Assicurazioni Private*. Sesta Edizione, G. Giappichelli Editore, 2019, f. 150.

⁶ Shih nenin 1121 të Kodit Civil.

⁷ Tutulani-Semini, Mariana. *E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Pjesa e Përgjithshme dhe Pjesa e Posaçme*. Skanderbeg Books, 2016, f. 354.

⁸ Neni 1125 i Kodit Civil: “Kontraktuesi detyrohet t’i paguajë sigurvearit primin e sigurimit në afatet e caktuara në kontratë. Në qoftë se primi ose kësti i parë i tij nuk paguhet në afat, sigurimi pezullohet deri në orën 24.00 të ditës që kontraktuesi paguan shumën që detyrohet. Kur kontraktuesi nuk paguan primet në vazhdim, sipas afateve të caktuara, sigurimi pezullohet nga ora 24.00 e ditës së pesëmbëdhjetë pas mbarimit të afatit të pagimit dhe sigurveari ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës.”.

perfeksionohet përmes përputhjes reciproke të vullnetit të palëve kontraktuese çka e klasifikon atë si një *kontratë konsensuale*.⁹

Në rastin e vërtetimit të ngjarjes së sigurimit i siguruari ose i treti detyrohen të njoftojnë siguruuesin për ngjarjen brenda afatit të caktuar në kontratë, pasi në rast të shkeljes së këtij afati siguruuesi gëzon të drejtën e mospagimit të shpërblimit të sigurimit. Gjithashtu i siguruari detyrohet që gjatë fazës së bisedimeve për lidhjen e kontratës të informojë saktësisht siguruuesin mbi rrethanat që ndikojnë në përcaktimin e rrezikut të siguroshëm sipas kërkesave të siguruuesit, si dhe të njoftojë përgjatë kohëzgjatjes së kontratës ndryshimet eventuale të rrethanave që passjellin shtimin e rrezikut. Në rastin e shkeljes së këtyre detyrimeve, siguruuesi sipas rastit mundet që të zgjidhë kontratën, të heqë dorë nga kontrata apo të vendosë ndryshimin e vlerës së primit, afatit të sigurimit apo të shumës së sigurimit.¹⁰

Në sigurimin e pasurisë mbetet thelbësore për vlefshmërinë e kontratës që i siguruari ose personi i tretë të ketë një *interes pasuror* mbi pasurinë e siguar.¹¹ Kjo nënkupton se i siguruari duhet të jetë pronar i sendit të siguar. Nocioni i interesit pasuror si kusht për vlefshmërinë e kontratës së sigurimit nuk kufizohet vetëm në të drejtën e pronësisë së të siguarit ndaj sendit objekt kontrate, por edhe me ekzistencë të interesit pasuror bazuar në të drejta të tjera reale si për shembull hipoteka e vendosur mbi sendin e paluajtshëm të siguar prej kreditorit hipotekar. Ky mund të jetë rasti i kontratave të sigurimit në favor të personit të tretë (banka në rolin e kreditorit hipotekar) që mbart interes pasuror mbi sendin e siguar për shkak se i shërben si garanci për realizimin e të drejtave që rrjedhin nga veprimtaria kredidhënëse. Në të tilla raste të sigurimit në favor të të tretit, sipas jurisprudencës së Gjykatës së Lartë,¹² legjitimimi aktiv për të kërkuar shpërblimin e sigurimit i përket të tretit dhe jo të siguarit/kontraktuesit. Një përcaktim të tillë për saktësimin e legjitimitetit aktiv në kontratat e sigurimit në favor të të tretit e bënte në mënyrë të shprehur Kodi Tregtar i vitit 1932.¹³ Kurse në rast të pushimit të interesit pasuror të të siguarit ose të të tretit pas lidhjes së kontratës, kontrata do të quhet e zgjidhur ipso jure që nga ai moment.¹⁴

Në rastin e dëmtimit të pasurisë së siguar siguruuesi do të detyrohet të paguajë shpërblimin e sigurimit si rregull përmes *sistemit proporcional* të zhdëmtimit.¹⁵ Kjo nënkupton se nëse shuma e sigurimit, e cila përfaqëson shumën maksimale që mund të paguajë siguruuesi, është më e ulët se vlera e përcaktuar e pasurisë së siguar, atëherë raporti përpjesëtimor i krijuar ndërmjet shumës së sigurimit dhe vlerës së pasurisë do të zbatohet në përcaktimin e shpërblimit të sigurimit. Në dallim nga ky rregull i përgjithshëm i caktuar në kod në policat e sigurimit mund të parashikohet edhe zbatimi i *sistemit të rrezikut të parë*, sipas të cilit dëmi do të shpërblehet plotësisht nga siguruuesi pavarësisht raportit përpjesëtimor ndërmjet vlerës së dëmit të pësuar dhe vlerës së pasurisë së siguar.¹⁶ Si rregull, siguruuesi do të përgjigjet për dëmin efektiv të pësuar dhe jo për fitimin e munguar që mund të gjenerohet si pasojë e vërtetimit të ngjarjes së sigurimit.¹⁷

2.2 Kontrata e sigurimit të përgjegjësisë civile dhe natyra juridike e saj

⁹ Farenga, Luigi. *Manuale di Diritto delle Assicurazioni Private*. Sesta Edizione, G. Giappichelli Editore, 2019, f. 169.

¹⁰ Tutulani-Semini, Mariana. *E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Pjesa e Përgjithshme dhe Pjesa e Posaçme*. Skanderbeg Books, 2016, f. 354.

¹¹ Neni 1134 i Kodit Civil: “Personi që lidh kontratën e sigurimit të pasurisë ose personi i tretë, në dobi të të cilit lidhet kontrata, duhet të ketë interes pasuror në objektin e siguar përndryshe kontrata e sigurimit është e pavlefshme.”.

¹² Vendimi nr.608, datë 31.10.2013 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, www.gjykataelarte.gov.al.

¹³ Neni 592 i Kodit Tregtar i Mbretërisë Shqiptare parashikonte se: “Mund të lidhi kontratë sigurtimi vetëm ai që ka një interes në mos ngjamjen e aksidentit. Në sigurtimin për llogari të një tjetri ose për llogari të atij, të cilit i përket, vetëm i interesuemi i vërtetë dhe përfaqësuesit e tij mund t’ushtrjnë kundra sigurtuesit të drejtat që lejnë prej aksidentit.”.

¹⁴ Shih nenin 1135 të Kodit Civil.

¹⁵ Neni 1139 i Kodit Civil: “Kur shuma e sigurimit është më e vogël nga vlefja e pasurisë së siguar, shpërblimi i dëmit caktohet në përpjesëtim me raportin midis shumës së sigurimit dhe vlefës së pasurisë të siguar, përveç kur në kontratë parashikohen ndryshe.”.

¹⁶ Tutulani-Semini, Mariana. *E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Pjesa e Përgjithshme dhe Pjesa e Posaçme*. Skanderbeg Books, 2016, f. 353.

¹⁷ Neni 1137, paragrafi i dytë i Kodit Civil: “Siguruuesi përgjigjet për fitimin e munguar, vetëm në qoftë se është parashikuar shprehimisht në kontratë.”.

Doktrina jonë e së drejtës civile nuk e ka përpunuar në detaje sigurimin e përgjegjësive civile¹⁸ si një nga llojet e veçanta të kontratave të sigurimit. Kjo, pavarësisht se praktika gjyqësore shqiptare është tejet e pasur me raste të shumta që burojnë prej ngjarjeve aksidentale të qarkullimit të mjeteve motorike. Sigurimi i përgjegjësive së mjeteve motorike gjatë qarkullimit të tyre përbën në rendin tonë juridik rastin ku sigurimi shfaqet si i detyrueshëm.¹⁹

Edhe pse në dispozitat e Kodit tonë Civil ky lloj sigurimi nuk gjendet i parashikuar, sigurimi i përgjegjësive klasifikohet si një nga llojet e sigurimit të pasurisë në legjisllacione të tjera të së drejtës civile. Këtu përmendim ligjin “Për marrëdhëniet e detyrimeve” të Kosovës,²⁰ ku sigurimi nga përgjegjësia përbën një nga llojet e sigurimit të pasurisë, i parashikuar në dy dispozita të tij (nenet 961 dhe 962). Gjithashtu në Kodin Civil Italian²¹ ky lloj sigurimi parashikohet në nenin 1917 të tij i inkorporuar në dispozitat që rregullojnë sigurimin nga dëmet. Me lidhjen e kontratës së sigurimit të përgjegjësive siguruasi, kundrejt primit të paguar nga i siguruari, merr përsipër që në kufijtë e shumës së sigurimit të shpërblejë shumën apo shumat që i siguruari është i detyruar t’ia paguajë personave të tretë për shkak të lindjes së përgjegjësive jashtëkontraktore apo kontraktore të tij. Sigurimi i përgjegjësive, në raport me zhvillimin në tërësi të sigurimeve, ka filluar të zbatohet relativisht vonë me sigurimin e përgjegjësive nga mjetet motorike ose përgjegjësive që gjenerohej nga përplasjet e anijeve. Sigurimi i përgjegjësive të mjeteve është përcaktuar si detyrues në gjysmën e parë të shekullit XIX, ndërsa deri në atë kohë sigurimi i përgjegjësive konsiderohej si në kundërshtim me parimet morale.²²

Rreziku i mbuluar në këtë lloj sigurimi buron nga përgjegjësia civile e mundshme e palës së siguruar, ndërsa përgjegjësia penale nuk është objekt sigurimi. Objekt sigurimi është eventualisht detyrimi i të siguruarit, në cilësinë e debitorit prej një marrëdhënieje juridiko-civile jashtëkontraktore,²³ që nga pasuria e tij të dëmshpërblejë personin e tretë të dëmtuar. Kështu, i siguruari mbulon me sigurim rrezikun për pakësimin e të ardhurave të tij që mund të cenohen si rrjedhojë e lindjes së përgjegjësive kundrejt të tretëve. Dëmi i ardhur në këto raste do të përlllogaritet sipas rregullave të përgjegjësive deliktore, ku përfshihen jo vetëm dëmet e natyrës materiale/pasurore por edhe dëme jopasurore.²⁴

Sa i takon momentit në të cilin do të aktivizohet përgjegjësia e siguruasit për të shpërblyer të siguruarin, nëse më parë shihej si kusht që i siguruari të kishte paguar personin e tretë të dëmtuar, qëndrimi bashkëkohor nga legjisllacionet është se detyrimi i siguruasit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të përgjegjësive lind që në momentin e ndodhjes së ngjarjes (shkaktimit të dëmit). Megjithatë në kontratat e sigurimit të përgjegjësive të llojit vullnetar, mundet që palët të kushtëzojnë ofrimin e shpërblimit nga siguruasi vetëm kur më parë i siguruari t’i ketë paguar të tretit dëmin e shkaktuar. Kuptohet se në raste të tilla duhet të vërtetohet ekzistenca juridike e përgjegjësive së të siguruarit kundrejt të tretit, pra kryerja me faj e veprimit të paligjshëm, pasoja e ardhur si dhe lidhja shkakësore ndërmjet veprimeve të paligjshme dhe dëmit të ardhur kundrejt të tretit. Gjithashtu duhet të ekzistojë edhe kërkesa e të dëmtuarit për shpërblimin e dëmit.²⁵

¹⁸ Në vijim i referohemi si “sigurimi i përgjegjësive”. *Shënim i autorëve*.

¹⁹ Këtu përmendim ligjin aktual nr.32/2021, datë 16.3.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, ligjin e mëparshëm nr.10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, i ndryshuar”, si dhe ligjin nr.7641, datë 1.12.1992 “Për miratimin me disa ndryshime të dekretit nr.295, datë 15.9.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësive ndaj personave të tretë”.

²⁰ Ligj nr.04/L-077 “Për marrëdhëniet e detyrimeve”, www.gzk.rks-gov.net.

²¹ Kodi Civil i Italisë, i miratuar me Dekretin Mbretëror nr.262, datë 16.3.1942, botuar në Fletoren Zyrtare nr.79, datë 4.4.1942; referuar përkthimit në shqip në botimin *Kodi Civil Italian*. Dudaj, përkthim i Av.Lisenko Moçka.

²² Dauti, Nerxhivane. Berisha, Ruzhdi. Vokshi, Adem. Aliu, Abdulla. Blakaj, Sefadin. *Komentar, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Libri II*. 2013, f. 667-668.

²³ Edhe pse fokusi në këtë punim është tek sigurimi i përgjegjësive jashtëkontraktore, mund të sigurohet edhe përgjegjësia që rrjedh nga një marrëdhënie kontraktore. Për shembull profesionistë të lirë që sigurojnë përgjegjësive të tyre gjatë që mund të lindë gjatë ushtrimit të profesionit të tyre siç mund të jenë avokatët etj. *Shënim i autorëve*.

²⁴ Dauti, Nerxhivane. Berisha, Ruzhdi. Vokshi, Adem. Aliu, Abdulla. Blakaj, Sefadin. *Komentar, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Libri II*. 2013, f. 668-669.

²⁵ Po aty, f. 670.

Në sigurimin e përgjegjësishë synohet të mbulohet me sigurim pala e siguruar për çdo shumë që ai ose ajo do t'i paguajë palëve të treta si kompensim për dëmet për shkak të shkeljeve të kryera gjatë kohëzgjatjes së kontratës së sigurimit, të cilat passjellin përgjegjësi civile, me përjashtim të atyre që rrjedhin nga veprime të një *natyre ekskluzivisht keqdashëse*. Kështu, do të mbulohet me sigurim vetëm *sjellja e pakujdesshme* e të siguruarit. Përjashtimi i mbulesës siguroese për kryerjen e sjelljeve të qëllimshme ka në *ratio-n* e saj tutelën e mbrojtjes së rendit publik, ku siguroesi nuk mund të ofrojë mbulim me sigurim edhe për të tilla sjellje të të siguruarit.²⁶ Një kufizim i tillë i mbulesës siguroese të përgjegjësishë është reflektuar edhe në ligjin tonë të tanishëm nr.32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, ku në nenin 13 të tij përcaktohet se për ato raste ku siguroesi ka dëmshpërblyer të tretin e dëmtuar, por nuk ka qenë përgjegjës sipas këtij ligji, atëherë siguroesi gëzon të drejtën e rimbursimit nga personi përgjegjës për dëmin e plotë që është paguar. Rastet në të cilat mund të gjejë zbatim rimbursimi i siguroesit janë ato të përcaktuara nga neni 23 i ligjit nr.32/2021 i titulluar “Humbja e së drejtës së mbulimit në sigurim”. Për shembull, nëse drejtuesi i automjetit nuk ka pasur leje të vlefshme drejtimi, ka pasur leje të pezulluar drejtimi, ka drejtuar automjetin nën efektin e alkoolit apo lëndëve narkotike apo psikoaktive, ka shkaktuar dëmin qëllimisht, palët e treta mund të kërkojnë zhdëmtimin e tyre prej siguroesit përgjegjës. Megjithatë, meqenëse kemi të bëjmë me sjellje që shkelin rendin publik,²⁷ i siguroari e humb të drejtën e mbulimit me sigurim dhe për rrjedhojë siguroesi ka të drejtën që të rimbursohet totalisht prej shkaktarit të dëmit. Nga ana tjetër, për aksidente që kanë ardhur si pasojë e sjelljes së pakujdesshme të të siguruarit, siguroesi mbulon dëmin deri në kufijtë e parashikuar në kontratë.²⁸

Edhe pse prej zbatimit të institutit të shkaktimit të dëmit pala shkaktare mund të detyrohet të zhdëmtojë disa lloje të dëmit të pësura që mund të vërtetohen si jo vetëm dëmi efektiv por edhe fitimi i munguar, apo krahas dëmit pasuror edhe lloje të tjera të dëmit jopasuror siç mund të jenë dëmet morale, shëndetësore etj, sigururimi i përgjegjësishë mbetet i kufizuar në vlerat e parashikuara në kontratë.²⁹ Në rastet kur dëmi i shkaktuar është në një vlerë më të lartë se kufiri i mbulimit me sigurim, personi i tretë i dëmtuar vijon të gëzojë të drejtën për të kërkuar me padi kundrejt shkaktarit të dëmit pjesën e mbetur të pashlyer të dëmit të pësuar.

2.3 Padia direkte e të tretit kundrejt siguroesit

Nga shkaktimi i dëmit prej të siguruarit kundrejt të tretit, që përbën dhe vetë rastin e sigurimit në kontratat e sigurimit nga përgjegjësia, shtrohet për diskutim çështja e *legjitimitit aktiv dhe pasiv për kërkimin e shpërblimit të dëmit*. Në kuadër të zbatimit të institutit të shkaktimit të dëmit mbetet e qartë se legjitimitimin aktiv e gëzon pala e dëmtuar kundrejt shkaktarit të dëmit i cili gëzon legjitimitim pasiv në padinë e ngritur në bazë të këtij instituti.³⁰

Në rastet kur gjendemi përpara lidhjes së kontratave të sigurimit të përgjegjësishë, të cilat mund të jenë vullnetare apo të detyrueshme, evidentohet se personi i dëmtuar nuk është palë e kontratës së lidhur. Kësisoj, pala e dëmtuar

²⁶Gorgoni, Marilena. Greco, Fernando. *Diritto delle Assicurazioni, Attività, Contratti, Responsabilità e Mercato*. Pacini Giuridica, 2024, f. 216.

²⁷Të gjitha këto sjellje përbëjnë veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë që kryhen me dashje të drejtpërdrejtë; përkatësisht “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” i parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal ose përdorimi i automjetit për të shkaktuar dëme të qëllimshme ndaj jetës apo shëndetit të personave dhe që mund të konfigurojnë përgjegjësinë penale për veprat penale “Vrasja me dashje” e parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, “Plagosja e rëndë me dashje” e parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal ose “Shkatërrimi i pronës” i parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal. *Shënim i autorëve*.

²⁸Për këtë qëllim Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.32/2021, ka miratuar dhe publikuar policën tip të sigurimit të detyrueshëm, ku në pikën 9 të saj përcakton rastet se kur siguroesi nuk përgjigjet për dëmin dhe rrjedhimisht gëzon të drejtën e rimbursimit të tij prej shkaktarit të dëmit. Shih për më tepër linkun: www.amf.gov.al/pdf/fokus/policatpl.pdf.

²⁹Dauti, Nerxhivane. Berisha, Ruzhdi. Vokshi, Adem. Aliu, Abdulla. Blakaj, Sefadin. *Komentar, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Libri II*. 2013, f. 670.

³⁰Neni 608, paragrafi i parë i Kodit Civil: “Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkaktonte tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.”.

nuk ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit drejtpërdrejt nga siguruesi i përgjegjës, dëm të cilin e ka pësuar prej palës së siguruar.³¹

Mungesa e legjitimit aktiv të palës së dëmtuar për të paditur drejtpërdrejt siguruesin si rrjedhojë e mosqenies palë në kontratën e sigurimit të përgjegjës ka përbërë qasjen e reflektuar në zhvillimet e mëparshme të së drejtës civile. Për këtë mund t'i referohemi rregullimit që parashikon Kodi Civil Italian në nenin 1917³² të tij për sigurimin e përgjegjës. Në këtë dispozitë përcaktohet se siguruesi detyrohet të dëmshpërblejë të siguarin për aq sa ky i fundit, si pasojë e ngjarjes së ndodhur gjatë kohës së sigurimit, duhet t'i paguajë një të treti, në varësi të përgjegjës së parashikuar në kontratë (paragrafi i parë). Siguruesi ka fakultetin, që duke njoftuar më parë të siguarin, t'i paguajë drejtpërdrejt të tredit dëmshpërblimin përkatës, dhe detyrohet për pagimin e drejtpërdrejtë nëse i siguruari e kërkon këtë (paragrafi i dytë). Shpenzimet që mund të gjenerohen nga padia e të dëmtuarit kundrejt të siguarit, janë në ngarkim të siguruesit, në kufijtë e një të katërtës së shumës së siguruar (paragrafi i tretë). I siguruari, i paditur nga i dëmtuari, mund të thërrasë në gjykim siguruesin (paragrafi i katërt).

Nga vështrimi i dispozitës së mësipërme, e pandryshuar prej disa dekadash, konstatohet se sipas të drejtës civile italiane personi i tretë i dëmtuar nuk gëzon legjitimit aktiv për të paditur drejtpërdrejt siguruesin për kërkimin e dëmshpërblimit. Detyrimi i siguruesit rëndon kundrejt të siguarit dhe vetëm nëse ky i fundit e kërkon, siguruesi mund t'ia paguajë shumën palës së dëmtuar. Gjithashtu bazuar në paragrafin e katërt të nenit 1917 të Kodit Civil Italian, personi i tretë i dëmtuar mund të ngrejë padi kundrejt të siguarit, ndërsa siguruesi mund të thirret si person i tretë në gjykim nga i siguruari sipas nenit 106 të Kodit të Procedurës Civile.³³ Pra, mënyra e përfundimit të gjykimit ndërmjet të dëmtuarit dhe të siguarit do të afektonte përgjegjësinë e siguruesit, në pozitën procedurale të personit të tretë në gjykim.

Një konkluzion i tillë mbështetet edhe nga Gjykata e Kasacionit e Italisë, e cila në një vendim të saj është shprehur në thelb se në marrëdhëniet e sigurimit të përgjegjës civile, pala e dëmtuar nuk mund të ndërmarrë veprime dhe të kërkojë dëmshpërblim drejtpërdrejt kundrejt siguruesit, *përveçse në raste të posaçme të parashikuara me ligj specifik*. Kjo për shkakun se i dëmtuari nuk është i përfshirë në marrëdhënien ndërmjet shkaktarit të dëmit dhe siguruesit dhe as nuk mund të përfitojë ndonjë avantazh në dobi të tij prej një vendimi gjyqësor që shtrin efekte në lidhje me përgjegjësinë e siguruesit. Kërkesat kundrejt siguruesit mund të drejtohen nga i siguruari, pasi i tretë i dëmtuar nuk është i lidhur me siguruesin as në marrëdhënie kontraktore dhe as prej përgjegjës deliktore.³⁴

Në vijim të arsyetimit të mësipërm për mungesën e legjitimit aktiv të personit të tretë të dëmtuar për të paditur siguruesin, në zhvillimet bashkëkohore të së drejtës civile është vendosur përjashtimi nga ky rregull i përgjithshëm duke i njohur të drejtën e palës së tretë të dëmtuar që të kërkojë dëmshpërblimin ndaj siguruesit dhe të padisë drejtpërdrejt këtë të fundit. Kjo shfaqet sidomos në ligjet specifike që rregullojnë sigurimin e përgjegjës, ku një qasje të tillë ofron edhe ligji ynë nr.32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" si dhe ligjet pararendëse të tij.³⁵

Në të drejtën italiane, e drejta e palës së tretë të dëmtuar për të ndërmarrë veprime dhe ngritur padi drejtpërdrejt kundrejt siguruesit gjen parashikim në nenin 144 të Kodit të Sigurimeve Private.³⁶ Në këtë dispozitë të titulluar

³¹ Dauti, Nerxhivane. Berisha, Ruzhdi. Vokshi, Adem. Aliu, Abdulla. Blakaj, Sefadin. *Komentar, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Libri II*. 2013, f. 671.

³² Tekst i mbetur në fuqi prej 19.4.1942, www.normattiva.it.

³³ Neni 106 i Kodit të Procedurës Civile të Italisë: "*Secila palë mund të thërrasë në proces një palë të tretë me të cilën ai beson se ka një shkak të përbashkët ose nga i cili mund të kërkojë garanci*". www.normattiva.it.

³⁴ Vendimi nr.5259, datë 25.2.2021 i Seksionit III Civil të Gjykatës së Kasacionit të Italisë.

³⁵ Neni 9, pika 1 i ligjit nr.32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit": "*Pala e dëmtuar ka të drejtë që të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim te siguruesi përgjegjës i pronarit të mjetit shkaktar aksidenti. Kërkesa për dëmshpërblim mund të paraqitet me shkrim ose në rrugë elektronike*".

³⁶ Kodi i Sigurimeve Private i Italisë, i miratuar me dekretin legjislativ nr.209, datë 07.09.2005. Ky kod përbën legjislacionin specifik në raport me Kodin Civil Italian, ku parashikohen dispozitat e posaçme për mënyrën e themelimit dhe administrimit të shoqërive që operojnë në tregun e sigurimeve private, si dhe përmban rregullime të posaçme për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjës civile që lind prej drejtimit të mjeteve motorike tokësore dhe navale. *Shënim i autorëve*.

“Padia e drejtpërdrejtë e të dëmtuarit”, si një parashikim specifik, përcaktohet se i dëmtuari nga një aksident i shkaktuar prej një mjeti motorik tokësor apo mjeti lundrues, për të cilin ekziston detyrimi për të qenë i siguruar, ka të drejtën e kërimit të kompensimit të dëmit drejtpërdrejt nga siguruksi i palës përgjegjëse brenda kufirit të shumës së sigurimit të përcaktuar në kontratë.

Gjithashtu në të drejtën franceze gjen parashikim të shprehur e drejta e të tretit të dëmtuar për të paditur drejtpërdrejt siguruksin. Një e drejtë e tillë parashikohet në nenin L124-3 të Kodit të Sigurimit të Francës.³⁷ Kjo dispozitë parashikon se i treti i dëmtuar ka të drejtën e veprimit të drejtpërdrejtë kundrejt siguruksit që garanton përgjegjësinë civile të të siguarit. Siguruksi nuk mund t’i paguajë askujt përveç palës së dëmtuar asnjë pjesë të shumës që i detyrohet, përderisa kjo palë nuk është dëmshpërbllyer deri në vlerën e asaj shume për pasojat financiare të ngjarjes dëmtuese që ka çuar në përgjegjësinë e të siguarit. Madje, jurisprudenca franceze ka përpunuar që në fillim të shekullit XX konceptin e padisë direkte si dhe i ka njohur të drejtën palës së tretë për të ndërmarrë veprime të drejtpërdrejta kundrejt siguruksit.³⁸

Edhe në të drejtën kosovare, në nenin 962 të ligjit “Për marrëdhëniet e detyrimeve” të titulluar “E drejta personale e të dëmtuarit dhe padia direkte”, parashikohet e drejta e personit të dëmtuar që të kërkojë drejtpërdrejt nga siguruksi shpërblimin e dëmit që ka pësuar nga ngjarja për të cilën përgjigjet siguruksi, por jo më tepër se deri në shumën e detyrimit të siguruksit sipas kontratës. Ndryshimet që mund të pësojë kontrata mbi të drejtat e të siguarit pas rastit të sigurimit nuk do të ketë ndikim në të drejtat e të tretit kundrejt siguruksit.³⁹

Sipas interpretimit doktrinor, në këtë mënyrë, personi i dëmtuar fiton të drejtën personale subjektive të shpërblimit nga sigurimi dhe kësaj të drejte siguruksi nuk mund t’i kundërvihet. Kjo nënkupton se i dëmtuari në pikëpamje procedurale bëhet me legjitimitet aktiv, çka do të thotë se fiton të drejtën subjektive për të ngritur padi kundrejt siguruksit të përgjegjësishë (*padia direkte*). Në këtë rast, në bazë të ligjit themelohet marrëdhënia juridike-detyruese mes të dëmtuarit dhe siguruksit, në të cilën i dëmtuari ka pozitën juridike të kreditorit për kërkesën e pagesës së shpërblimit të dëmit. Personi i tretë bëhet kështu *subjekt i marrëdhënies kontraktore*. Nga kjo rrjedh që autorizimi juridik-procedural në padinë direkte mbështetet në ligj, por baza juridike e kërkesës, përmes shfrytëzimit të padisë direkte, rrjedh nga veprimi i paligjshëm i të siguarit, domethënë bëhet fjalë për përgjegjësinë e tij për dëmin e shkaktuar personit të tretë.⁴⁰

Thënë ndryshe, eventualisht vërtetimi i ngjarjes së sigurimit që nënkupton shkaktimin e dëmit nga i siguruksi kundrejt të tretit, e bën të tretin subjekt kreditor që mbart të drejta subjektive relative kundrejt siguruksit. Kjo përbën thelbin e padisë direkte, e cila buron prej kontratës së sigurimit të përgjegjësishë së lidhur midis siguruksit dhe të siguarit. Padia direkte përbën një mjet alternativ në dobi të personit të tretë të dëmtuar krahas të drejtës së këtij të fundit për të paditur të siguarin/shkaktar të dëmit. Nga kjo rrjedh se i treti i dëmtuar ka në dispozicion të tij *dy mjete ligjore*, që mund të jenë *ngritja e padisë së shkaktimit të dëmit kundrejt të siguarit ose ngritja e padisë direkte kundrejt siguruksit*.

Në rastin e gjykimit dhe eventualisht pranimit të padisë direkte të ngritur nga i treti i dëmtuar kundrejt siguruksit, debati gjyqësor i palëve si dhe çmuarja e elementëve të çështjes si verifikimi i rastit të sigurimit, ekzistenca ose jo e shkaqeve përjashtuese për dhënien e shpërblimit të sigurimit, si dhe masa e shpërblimit që mund të detyrohet siguruksi të paguajë, kushtëzohen nga përmbajtja e kushteve të kontratës së sigurimit të

³⁷ Kodi i Sigurimit të Francës u miratua për herë të parë përmes dekretit nr.76-667, datë 16.07.1976. Ky kod normon aspekte të ndryshme të kontratës së sigurimit në përgjithësi dhe sigurimit të përgjegjësishë civile në veçanti. Gjatë shekullit XX disiplina të shumta të së drejtës civile franceze u shkëputën nga Kodi Civil Francez duke u rregulluar me ligje të veçanta. *Shënim i autorëve*.

³⁸ Shih për më tepër në linkun: www.dalloz-actualite.fr/flash/action-directe-et-competence-territoriale-victime-n-est-pas-l-assure.

³⁹ Neni 962 i ligjit nr.04/L-077 “Për marrëdhëniet e detyrimeve”: “1. Në rastin e sigurimit nga përgjegjësia, personi i dëmtuar mund të kërkojë drejtpërdrejt nga siguruksi shpërblimin e dëmit që ka pësuar nga ngjarja për të cilën përgjigjet siguruksi, por jo më tepër se deri në shumën e detyrimit të siguruksit. 2. Personi i dëmtuar ka të drejtën personale në shpërblimin nga sigurimi që nga momenti kur ka ndodhur rasti i siguarit, kështu që çdo ndryshim i mëvonshëm për të drejtat e të siguarit ndaj siguruksit nuk ka ndikim në të drejtën e personit të dëmtuar në shpërblim.”

⁴⁰ Dauti, Nerxhivane. Berisha, Ruzhdi. Vokshi, Adem. Aliu, Abdulla. Blakaj, Sefadin. *Komentar, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Libri II*. 2013, f. 672.

përgjegjësish të lidhur midis siguruesit dhe të siguruarit. Në mungesë të kontratës së sigurimit të përgjegjësish, i vetmi mjet ligjor në dispozicion të palës së dëmtuar do të ishte ngritja e padisë së dëmit jashtëkontraktor kundrejt shkaktarit të dëmit.⁴¹

Ndërsa për rastet kur dëmi i gjeneruar prej veprimeve të paligjshme të të siguruarit është më i lartë se sa shuma e sigurimit e përcaktuar në kontratë, i treti ruan të drejtën që diferencën e dëmit që nuk mbulohet përmes sigurimit t'ia kërkojë me padi të siguruarit në cilësinë e shkaktarit të dëmit. Për shembull, nëse sipas kontratës së sigurimit të përgjegjësish kufiri monetar i mbulimit është në vlerën 1.000.000 lekë dhe dëmi i pësuar nga i treti pretendohet apo verifikohet se arrin një vlerë më të lartë prej 1.200.000 lekësh, atëherë siguruesi do të zhdëmtojë të tretin deri në shumën 1.000.000 lekë. Pjesa e mbetur e dëmit të pësuar nga i treti prej 200.000 lekësh vijon të gëzojë mbrojtje nga legjislacioni civil, por duke qenë e pambuluar nga kontrata e sigurimit, i vetmi mjet ligjor në dispozicion të të tretit do të ishte ngritja e padisë së shkaktimit të dëmit kundrejt shkaktarit të dëmit – të siguruarit në bazë të nenit 608 të Kodit Civil.⁴²

Legjislacioni ynë aktual i sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit parashikon qartë të drejtën subjektive të të tretit të dëmtuar për të kërkuar drejtpërdrejt shpërblimin e dëmit kundrejt siguruesit të përgjegjësish së shkaktarit të dëmit. Në këtë rast paditë e ngritura nga të dëmtuarit kundrejt siguruesve janë në thelb *padi direkte*, ku detyrimi i siguruesit kundrejt të tretit buron nga kontrata e lidhur dhe e rregulluar posaçërisht me ligj specifik. Në të kundërt, në mungesë të një kontrate dhe rregullimi specifik ligjor, i dëmtuari mund të shfrytëzonte vetëm ngritjen e padisë së shkaktimit të dëmit jashtëkontraktor. Parashikimi i padisë direkte për realizimin e të drejtave të të tretit të dëmtuar përbën një mjet efektiv, pasi thjeshton procedurën ligjore për të dëmtuarin, ofron më shumë siguri në pagesë, si dhe synon të shmangë mundësinë e marrëveshjeve në keqbesim midis të dëmtuarit dhe të siguruarit që mund të ndikojnë në një detyrim të padrejtë të siguruesit.⁴³

3. Praktika gjyqësore dhe interpretimi i Gjykatës së Lartë për paditë e shpërblimit të dëmit të ngritura nga të tretët kundrejt siguruesve

3.1 Trajtimi i padive të shpërblimit të dëmit nga të tretët kundrejt siguruesve sipas Vendimit Unifikues nr.12/2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

Siç u përmend edhe më sipër në këtë punim, praktika gjyqësore shqiptare është tejet e pasur me raste që lidhen me shqyrtimin e padive të kërimit të shpërblimit të dëmit të ngritura nga personat e tretë të dëmtuar duke paditur drejtpërdrejt siguruesit ose Byronë Shqiptare të Sigurimeve.⁴⁴ Interpretimet e ndryshme të gjykatave të faktit të të dy shkallëve mbi elemente të caktuara të marrëdhënies juridiko-civile që krijohet në këto raste kanë sjellë nevojën për unifikimin e praktikës gjyqësore, përkatësisht me Vendimin Unifikues nr.12/2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.⁴⁵

⁴¹ Në rastin e dëmeve që shkaktohen nga qarkullimi i mjeteve motorike, ligji nr.32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” e ka zgjidhur këtë situatë duke parashikuar në nenin 9, pika 3 të tij mundësinë që dëmi të paguhet edhe nga siguruesi i palës së dëmtuar apo mundësinë e zhdëmtimit nga Byroja Shqiptare e Sigurimit sipas nenit 41 të këtij ligji. Megjithatë, në mungesë të një rregullimi ligjor specifik për raste të tjera, siç mund të jetë shkaktimi i dëmeve kontraktore nga profesionistët e lirë, kur këta të fundit nuk kanë siguruar përgjegjësinë e tyre, palët e dëmtuara mund të ngrejnjë vetëm padinë për shpërblimin e dëmit kontraktor/jashtëkontraktor kundrejt tyre. *Shënim i autorëve.*

⁴² Vlerat janë dhënë thjesht për ilustrim, ndërsa shumat monetare të kufirit të përgjegjësish përcaktohen sipas zërave të dëmeve nga neni 25 i ligjit nr.32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. *Shënim i autorëve.*

⁴³ Dauti, Nerxhivane. Berisha, Ruzhdi. Vokshi, Adem. Aliu, Abdulla. Blakaj, Sefadin. *Komentari, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Libri II.* 2013, f. 673.

⁴⁴ Sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore që kanë rregulluar përgjegjësinë që rrjedh nga dëmet e shkaktuara nga mjetet në qarkullimin rrugor, në mungesë të lidhjes së kontratës së sigurimit të përgjegjësish, Byroja Shqiptare e Sigurimeve përgjigjet *ex lege* kundrejt të dëmtuarve. *Shënim i autorëve.*

⁴⁵ Vendimi Unifikues nr.12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vijim Vendimi Unifikues nr.12/2007. www.gjykataelarte.gov.al

Edhe pse Vendimi Unifikues nr.12/2007 mbart një rëndësi specifike sidomos në drejtim të analizimit dhe përcaktimit të mëvetësishëm të figurave të ndryshme të dëmeve pasurore apo jopasurore⁴⁶ që mund të gjenerohen prej kryerjes së një veprimi të paligjshëm në kuptim të përcaktimit të përgjegjësive për shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë ndalur edhe në elemente të tjera të kësaj marrëdhënieje juridike. Përveç përcaktimeve shteruese të kryera në drejtim të legjitimitimit aktiv të subjekteve rast pas rasti, si dhe figurave të posaçme të dëmit që mund të pretendohen në gjykim, Vendimi Unifikues nr.12/2007 na shërben, edhe pse tërthorazi, për të kuptuar më drejt natyrën e marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palës së dëmtuar dhe siguruesit sipas legjislacionit specifik të zbatueshëm.

Konkretisht, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur mbi rastet e sigurimit në bazë të dekretit nr.295/1992⁴⁷ se: *“Në këtë kuptim, “vdekja”, sipas dispozitës së nenit 18/b të Dekretit, është vetë fakti i paligjshëm që shkakton dëmin “në personin” e të dëmtuarit (neni 608 i K.Civil). Në këtë rast, sikurse janë edhe rrethanat e çështjes objekt i këtij gjykimi, krahas dhunimit të së drejtës themelore të viktimës për jetën, cenohen sipas rastit edhe të drejta themelore të personave të tjerë të lidhur me të, ku bëjnë pjesë edhe paditësit si prindër të viktimave. Këto cenime shkaktohen në të drejtat e personalitetit apo të pasurisë së tyre, përkatesisht në forma të ndryshme të dëmit jopasuror apo pasuror. Injēti interpretim vlen edhe për “dëmtimin e shëndetit” sipas nenit 18/b të Dekretit. Në këtë rast, i dëmtuari në shëndetin e tij mund të cenohet njëkohësisht si në të drejta pasurore (neni 641 i K.Civil), ashtu edhe jopasurore (dëmtimi i shëndetit dhe ai i personalitetit, neni 625/a i K.Civil). Por, krahas “dëmtimit të shëndetit” të këtij personi, sipas rrethanave të faktit, mund të cenohen në të drejtat personale e pasurore edhe persona të tjerë të lidhur me të.”*⁴⁸

Përsa më sipër, konstatohet se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë pranuar ekzistencën e përgjegjësive eventuale të siguruesve apo Byrosë Shqiptare të Sigurimit edhe për figurat e tjera të dëmit jopasuror duke u bazuar në vetë përcaktimin e nenit 18/b të Dekretit nr.295/1992, duke interpretuar se *dëmtimi i shëndetit* në kuptim të kësaj dispozite përfshin edhe të drejta jopasurore. Thënë ndryshe, pranohet se përgjegjësia e siguruesve dhe e Byrosë Shqiptare të Sigurimit rrjedh dhe ka shkak ligjor prej rregullimit ligjor specifik. Në një interpretim *a contrario*, nëse Gjykata e Lartë do të vlerësonte se dëmtimi i shëndetit sipas Dekretit nr.295/1992 nuk përfshinte edhe figurat e dëmit jopasuror, një përgjegjësi e tillë për këto figura të dëmeve nga siguruesit apo Byroja Shqiptare e Sigurimit nuk do të lindte kundrejt të dëmtuarve. Pra, premisa për themelimin e përgjegjësive së siguruesit apo Byrosë Shqiptare të Sigurimit drejtpërdrejt ndaj të dëmtuarve rrjedh prej kontratës së sigurimit të përgjegjësive dhe rregullimit ligjor specifik të saj.

Edhe pse Vendimi Unifikues nr.12/2007 nuk shprehet në mënyrë eksplicite mbi krijimin e një marrëdhënieje juridike të drejtpërdrejtë midis siguruesve dhe palëve të dëmtuara, në mendimin tonë mbetet e qartë se legjislacioni ynë specifik mbi sigurimin e përgjegjësive ndër vite ka njohur *padinë direkte*, duke legjitimuar aktivisht të dëmtuarit që të ngrenë padi drejtpërdrejt kundrejt siguruesve apo Byrosë Shqiptare të Sigurimit (*shih nenin 13 të Dekretit nr.295/1992*).⁴⁹ Po njëjtë është parashikuar edhe në nenin 11 të ligjit nr.10076/2009 dhe nenin 9 të ligjit nr.32/2021.

3.2 Praktika e tanishme gjyqësore e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për trajtimin e padive të ngritura nga të tretët kundrejt siguruesve

⁴⁶ Shih f. 12 e vijuese të Vendimit Unifikues nr.12/2007.

⁴⁷ *Nënkupt.* Dekreti nr.295, datë 15.9.1992 *“Për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësini ndaj personave të tretë”*. Edhe pse ky dekret është shfuqizuar tashmë dhe ligji i zbatueshëm sot është ligji nr.32/2021 *“Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”*, sqarojmë se kjo praktikë unifikuese edhe pse është bazuar tek dekreti nr.295 si ligji i zbatueshëm i kohës, vlen për arsyetimin në vijim të këtij punimi pasi nocioni i padisë direkte është parashikuar për herë të parë me miratimin e këtij dekreti dhe është ruajtur në vijimësi i njëjtë edhe në dy ligjet pasardhëse për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit (ligji nr.10076/2009 dhe ligji nr.32/2021). *Shënim i autorëve.*

⁴⁸ Shih f. 8 të Vendimit Unifikues nr.12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁴⁹ Neni 13 i Dekretit nr.295, datë 15.9.1992 *“Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësini ndaj personave të tretë”*, sipas të cilit: *“Personi i dëmtuar ka të drejtë të kërkojë drejtpërdrejt nga siguruesi, brenda kufijve të përgjegjësive së tij sipas kontratës së sigurimit, shpërbllimin e dëmit.”*

Në vijim të shqyrtimit të rekurseve të parashtruara para Gjykatës së Lartë që lidhen me çështje të shqyrtuara më parë nga gjykatat e faktit mbi padi të ngritura nga palët e treta të dëmtuara kundrejt siguruesve në bazë të sigurimit të përgjegjësive në sektorin e transportit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në bazë të funksionit të tij kushtetues⁵⁰ për zhvillimin e praktikës gjyqësore, ka interpretuar natyrën juridike të këtyre padive. Interpretimi i natyrës juridike të padive të ngritura nga palët e treta të dëmtuara kundrejt siguruesve ka ndikuar edhe në përcaktimin e afateve të zbatueshme për parashkrimin e këtyre padive.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në një nga vendimet e tij aktuale ka interpretuar se:⁵¹ “30. Kolegji vlerëson se në çështjen objekt gjykimi, duke patur në vëmendje dhe trajtimin e bërë në vendimin unifikues nr.12/2007, jemi përpara një padie që rrjedh nga shpërblimi i dëmit jashtëkontraktor, padi e cila i nënshtrohet afatit 3 (tre) vjeçar të parashkrimit sipas nenit 115/dh të Kodit Civil që parashikon se “Parashkruhen brenda afateve prej tre vjetësh paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor”. Në parashikimin e afatit 2 (dy) vjeçar, neni 115/ç rregullon afatin e rivendosjes së të drejtës në rrugë gjyqësore për padinë e kërimit të shpërblimit të dëmeve kontraktore. Kështu kjo dispozitë parashikon se paditë për pagimin e shpërblimit sipas kontratës së sigurimit dhe risigurimit, si dhe shumës përkatëse të rrjedhur nga sigurimi i detyrueshëm parashkruhen brenda 2 vjetëve. Ky nen gjen zbatim për paditë që kanë të bëjnë me përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve që kanë palët pjesëmarrëse në kontratën e sigurimit e risigurimit dhe jo për paditë e ngritura nga personat e tretë që kanë pësuar dëm jashtë kontraktor nga ngjarja aksidentale e qarkullimit rrugor”.

Një interpretim i tillë është hasur edhe në vendime të tjera të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë,⁵² të cilat kanë përcaktuar natyrën juridike të këtyre padive të ngritura nga palët e treta të dëmtuara kundrejt siguruesve si padi të shkaktimit të dëmit jashtëkontraktor. Kjo ka sjellë për rrjedhojë edhe zbatimin e afatit të parashkrimit tri vjeçar për këto padi sipas nenit 115, germa dh) të Kodit Civil.⁵³

Ky qëndrim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë bazohet në analizën e natyrës juridike të faktit të paligjshëm që kryhet nga i siguruari, pra shkaktari i dëmit, dhe raportit juridik që krijohet midis këtij të fundit dhe palës së tretë të dëmtuar. Mbetet e padiskutueshme se marrëdhënia juridiko-civile që krijohet ndërmjet palës së siguruar dhe të tretit identifikohet me institutin e shkaktimit të dëmit jashtëkontraktor sipas nenit 608 të Kodit Civil. Ndërsa identifikimi i natyrës juridike të marrëdhënies që lind ndërmjet të tretit të dëmtuar dhe siguruesit në këto raste duke u përcaktuar përsëri si një marrëdhënie juridiko-civile jashtëkontraktore, duket i pabazuar në mendimin tonë për shkaqet të cilat do të parashtrohen në pjesën vijuese të këtij punimi.

4. Përcaktimi i padisë së ngritur nga i tretë kundrejt siguruesit si një padi direkte dhe jo një padi e shkaktimit të dëmit jashtëkontraktor

4.1 Padia direkte në legjislacionin tonë të sigurimit të detyrueshëm dhe afati i parashkrimit të saj

Qëndrimi i mbajtur nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i cili i përcakton paditë e ngritura nga të tretët kundrejt siguruesve si padi të shkaktimit të dëmit jashtëkontraktor, duket se konfondon dy mjetet ligjore alternative që ka në dispozicion pala e dëmtuar në rastet e pësimit të një dëmi gjatë qarkullimit rrugor, por edhe në sigurimin e përgjegjësive të tjera prej lidhjes së kontratave vullnetare për sigurimin e përgjegjësive profesionale etj. Mendojmë se ekzistojnë disa argumente që na çojnë në një përfundim të ndryshëm.

⁵⁰ Neni 141, pika 1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku me ndryshimet e ligjit nr.76/2016 përcaktohet se: “1. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.”.

⁵¹ Vendimi nr.392, datë 26.06.2024 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, botuar në Buletinin Informativ Elektronik nr.7 – 2024. <https://www.gjykataelarte.gov.al/sq/lajme/buletini/buletini-informativ-elektronik-nr.-7-2024>.

⁵² Vendimi nr.30, datë 28.06.2021 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; vendimi nr.1722, datë 20.07.2022 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

⁵³ Neni 115, germa dh) i Kodit Civil: “Parashkruhen brenda afateve prej: ... dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë.”.

Emri i Autorit

Së pari, në ngritjen e padisë së dëmit jashtëkontraktor sipas nenit 608 të Kodit Civil legjitimimin aktiv e gëzon pala e dëmtuar, ndërsa legjitimimin pasiv e gëzon pala shkaktare e dëmit që në këtë rast përfaqësohet nga i siguruari dhe jo siguresi. Kjo, pasi lindja e detyrimit të të paditurit vjen prej parimit të lashtë të së drejtës romake që sanksiononte përgjegjësinë deliktore të delikuentit duke zhdëmtuar në të holla personin e dëmtuar.⁵⁴ Në të tilla raste pala shkaktare e dëmit është i siguruari dhe jo siguresi.

Së dyti, për t'u gjendur para padisë së shkaktit të dëmit jashtëkontraktor dhe eventualisht pranimit të kësaj padie, duhet të verifikohet lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë dhe e domosdoshme ndërmjet veprimeve të paligjshme të palës së paditur dhe ardhjes së pasojës – dëmit. Mbetet e qartë se janë veprimet e të siguarit që shkaktojnë ardhjen e pasojës dhe jo ato të siguresit.

Së treti, edhe pse Vendimi Unifikues nr.12/2007 ndalet në analizimin e marrëdhënies së dëmit jashtëkontraktor të krijuar duke u përqendruar në llojet e ndryshme të figurave të dëmeve që gjenerohen nga kryerja e faktit të paligjshëm, përgjegjësia e siguresit buron nga Dekreti nr.295/1992 (sot i zëvendësuar nga ligji nr.32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”) dhe nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive e bazuar në këtë dekret apo ligjin e tanishëm nr.32/2021. Kështu, marrëdhënia juridike jashtëkontraktore e shkaktit të dëmit midis të siguarit dhe të tretit përbën vetë ngjarjen e siguar në kontratë si një ngjarje e pasigurt që mund të cenohet eventualisht të ardhurat e të siguarit – shkaktarit të dëmit.

Së katërti, në vijim të argumentit të mësipërm, duke qenë se përgjegjësia e siguresit buron prej rregullimit ligjor specifik të kontratës së sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive kundrejt të tretëve, atëherë të drejtat e të tretit të dëmtuar do të përmbushen nga i padituri – sigures gjithnjë brenda shumës së sigurimit të caktuar në kontratë sipas ligjit specifik. Kështu, sipas edhe përcaktimit të bërë nga doktrina kosovare e së drejtës civile, në rast të vërtetimit të ngjarjes së siguar – shkaktit të dëmit pala e dëmtuar do të bëhet subjekt i marrëdhënies kontraktore duke fituar të drejtën subjektive relative ndaj siguresit. Kuptohet se pavarësisht pretendimit të paditësit – të tretit, siguresi do të detyrohet vetëm për aq sa përcakton kontrata e sigurimit të përgjegjësive. Ndërsa në padinë e shkaktit të dëmit jashtëkontraktor sipas nenit 608 të Kodit Civil nuk ekziston një limit i shumës që shkaktri i dëmit mund t'i detyrohet eventualisht palës së dëmtuar.

Së pesti, vetë Dekreti nr.295/1992 përmes nenit 7 të tij i ndalonte shkaktarit të dëmit – të siguarit që të kërkonte shpërblimin e sigurimit ndaj siguresit.⁵⁵ Pra, në Dekretin e vitit 1992 por edhe në legjislacionin vijues të sotshëm (ligjin nr.32/2021), siguresi e ekzekuton detyrimin e tij kontraktor drejtpërdrejt ndaj të tretit dhe ky i fundit mund të kërkojë drejtpërdrejt nga siguresi pagimin e një detyrimi të tillë duke qëndruar brenda termave të kontratës të sigurimit të përgjegjësive. Thënë sa më sipër, Dekreti nr.295/1992 dhe legjislacioni vijues i sotshëm (ligji nr.32/2021) njohin padinë direkte si mjetin ligjor që mund të shfrytëzohet nga i dëmtuari në të tilla raste.

Për shkaqet e mësipërme, mendojmë se paditë e ngritura nga palët e treta të dëmtuara kundrejt siguresve përbëjnë padi që rrjedhin nga efektet juridike që prodhon kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive, të njohura si paditë direkte. Objekti i këtyre padive është kërkimi i shpërblimit të sigurimit që përbën një detyrim kontraktor të siguresit – palë e paditur në gjykim. Ndërsa shkaku ligjor i këtyre padive lidhet me gjendjen e faktit, shkaktit të dëmit ndaj palës së tretë e cila përbën në vetvete vërtetimin e ngjarjes së sigurimit.

Sa i takon afatit të parashkrimit të padisë së shkaktit të dëmit dhe të padisë direkte, ligjvënësi kosovar ka parashikuar një afat të njëjtë parashkrimi për to. Konkretisht, sipas nenit 362 të ligjit nr.04/L-077 “Për marrëdhëniet e detyrimeve” parashikon se: “4. Nëse i dëmtuari në rastin e sigurimit nga përgjegjësia kërkon shpërblim nga i siguruari, ose shpërblimin e ka marrë prej tij, parashkrimi i kërkesës të të siguarit ndaj siguresit fillon që nga dita kur personi i dëmtuar ka kërkuar në rrugë gjyqësore shpërblimin nga i siguruari, respektivisht kur i siguruari t'ia ketë shpërblyer dëmin. 5. Kërkesa e drejtpërdrejtë e personit të tretë të dëmtuar ndaj siguresit parashkruhet për të njëjtën kohë për të cilën parashkruhet kërkesa e tij ndaj të siguarit përgjegjës për dëmin.”. Sipas kësaj dispozite ligjore, në të drejtën civile kosovare diferencohen qartë dy mjetet ligjore që ka në dispozicion i dëmtuari, respektivisht *padia për shkaktimin e dëmit e ngritur kundrejt shkaktarit të dëmit – të*

⁵⁴ Mandro, Arta. *E Drejta Romake*. Emal, 2011, f. 393.

⁵⁵ Neni 7 i Dekretit nr.295/1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë” sipas të cilit: “Personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit nuk ka të drejtë të paraqesë kërkesë për shpërblimin e dëmit sipas dispozitave të këtij dekreti.”.

siguruarit dhe padia direkte e ngritur kundrejt siguruesit. Ndërsa për afatin e parashkrimit të secilës padi, ligjvënësi kosovar ka zgjedhur që ky afat të jetë i njëjtë.

Po ashtu, edhe ligjvënësi italian ka zgjedhur një afat të njëjtë parashkrimi për të dy paditë që pala e dëmtuar mund të ngrëjë. Përkatësisht në nenin 144, pika 4 të Kodit të Sigurimeve Private, ku parashikohet se: “*Padia e drejtpërdrejtë e të dëmtuarit kundrejt siguruesit i nënshtrohet afatit të parashkrimit që do të gjente zbatim edhe për padinë e ngritur kundrejt palës përgjegjëse.*”.

Ligjvënësi ynë ka përcaktuar në nenin 115, germa ç) të Kodit Civil se: “*Parashkruhen brenda afateve prej: ... ç) dy vjetëve paditë për pagimin e shpërblimit sipas kontratës së sigurimit dhe risigurimit, si edhe të shumës përkatëse të rrjedhur nga sigurimi i detyrueshëm.*”. Mendojmë se me “*shumë përkatëse të rrjedhur nga sigurimi i detyrueshëm*” mund t’i referohemi vlerës së shpërblimit të sigurimit që siguruasi detyrohet t’i paguajë në bazë të kontratës palëve të treta të dëmtuara. Kjo, edhe për faktin e thjeshtë se referuar aspektit kronologjik nga miratimi i Kodit Civil në vitin 1994 dhe deri më sot, i vetmi lloj i sigurimit të detyrueshëm i përcaktuar me ligj ka qenë pikërisht sigurimi i përgjegjësishë nga mjetet motorike. Siç u përmend më sipër, Dekreti nr.295/1992 i njëjti të drejtën e kërimit të shumave të rrjedhura nga sigurimi i detyrueshëm vetëm të tretit, ashtu si dhe legjislacioni i tanishëm (*ligji nr.32/2021*). Nga kjo arrihet në përfundimin se ligjvënësi ynë ka zgjedhur që për padinë direkte të ngritur nga i treti i dëmtuar kundrejt siguruesit të zbatohet një afat parashkrimi dy vjeçar, të ndryshëm nga afati tri vjeçar i parashikuar për paditë e shkaktimit të dëmit të ngritura nga palët e dëmtuara kundrejt shkaktarëve të dëmit. Madje, vetë policia tip e sigurimit të përgjegjësishë ndaj palëve të treta e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në pikën 8 të saj ka përcaktuar se afati i parashkrimit të palës së tretë të dëmtuar për kërkimin e dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit është dy vjet nga dita e ndodhjes të aksidentit në bazë të nenit 115, shkronja ç) të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.⁵⁶

5. Konkluzione

Paditë e ngritura nga palët e treta të dëmtuara kundrejt siguruesve burojnë prej detyrimit kontraktor të siguruesve për të shpërblyer shumën e sigurimit ndaj të dëmtuarve, të cilët eventualisht bëhen subjekt i kontratës së sigurimit të përgjegjësishë. Padi të tilla njihen nga doktrina e së drejtës civile si *paditë direkte*. Në legjislacionin tonë për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësishë një padi e tillë është njohur dhe ka gjetur vazhdimisht zbatim. Ofrimi i një mjeti të tillë ligjor në dispozicion të palës së dëmtuar sjell avantazhe në procedurën e zhdëmtimit si dhe synon të shmangë praktika abuzive e të pandershme që mund të kryhen në keqbesim nga i siguruari dhe i treti. Konfondimi i të tilla padive me padinë e shkaktimit të dëmit jashtëkontraktor mendojmë se nuk qëndron, pasi padia e shkaktimit të dëmit jashtëkontraktor ngrihet nga pala e dëmtuar kundrejt palës shkaktare dhe jo kundrejt siguruesit.

Në lidhje me afatin e parashkrimit të padive të ngritura nga të tretët kundrejt siguruesve, Kodi Civil ka parashikuar një afat parashkrimi të posaçëm dy vjeçar për ngritjen e tyre sipas nenit 115, germa ç) të tij. Kjo, në dallim nga afati i parashkrimit tri vjeçar i parashikuar për paditë e shkaktimit të dëmit jashtëkontraktor. Duke qenë se ligjvënësi ka zgjedhur një afat të ndryshëm parashkrimi për secilën nga këto padi, mendojmë se kjo zgjedhje legjislative duhet të vihet në zbatim. Gjithashtu, jemi të mendimit se ky punim mund të shërbejë për të zhvilluar më tej debate të shëndetshme juridike në rrethin e juristëve në përgjithësi, sidomos midis magjistratëve, akademikëve dhe avokatëve.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Dauti, Nerxhivane. Berisha, Ruzhdi. Vokshi, Adem. Aliu, Abdulla. Blakaj, Sefadin. Komentari, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Libri II. 2013.

⁵⁶ Për më tepër shih linkun: www.amf.gov.al/pdf/fokus/policatpl.pdf.

Emri i Autorit

2. Farenga, Luigi. *Manuale di Diritto delle Assicurazioni Private*, Sesta Edizione, G. Giappichelli Editore, 2019, ISBN: 978-88-921-0349-8.
3. Gorgoni, Marilena. Greco, Fernando. *Diritto delle Assicurazioni, Attività, Contratti, Responsabilità e Mercato*. Pacini Giuridica, 2024, ISBN: 978-88-3379-696-3.
4. *Kodi Civil Italian*, përkthyer nga Av.Lisenko Moçka, Dudaj dhe Marin Barleti Press, 2014, ISBN: 978-99943-0-371-7.
5. Mandro, Arta. *E Drejta Romake*. Emal, 2011, ISBN: 99956-05-00-1.
6. Tutulani-Semini, Mariana. *E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Pjesa e Përgjithshme dhe Pjesa e Posaçme*, Skanderbeg Books, 2016, ISBN: 978-9928-4279-5-3.

Legjislacion

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar.
2. Ligj nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”.
3. Kodi Tregtar i Mbretërisë Shqiptare, i botuar prej Ministrisë së Punëve të Brendshme në Fletoren Zyrtare nr.10, datë 05.03.1932.
4. Ligj nr.7641, datë 1.12.1992 “Për miratimin me disa ndryshime të dekretit nr.295, datë 15.9.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”.
5. Ligj nr.10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, i ndryshuar”.
6. Ligj nr.32/2021, datë 16.3.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.
7. Ligj nr.04/L-077 “Për marrëdhëniet e detyrimeve”.
8. Ligj nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”.
9. Kodi i Procedurës Civile i Italisë, i miratuar me Dekretin Mbretëror, datë 28.10.1940.
10. Kodi i Sigurimeve Private i Italisë, i miratuar me Dekretin legjislativ nr.209, datë 07.09.2005.
11. Kodi i Sigurimit të Francës, i miratuar me dekretin nr.76-667, datë 16.07.1976.

Jurisprudencë

1. Vendimi Unifikues nr.12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
2. Vendimi nr.608, datë 31.10.2013 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
3. Vendimi nr.30, datë 28.06.2021 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
4. Vendimi nr.1722, datë 20.07.2022 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
5. Vendimi nr.392, datë 26.06.2024 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
6. Vendimi nr.5259, datë 25.2.2021 i Seksionit III Civil të Gjykatës së Kasacionit të Italisë.

Web faqe

1. www.qbz.gov.al.
2. www.gjykataelarte.gov.al.
3. www.amf.gov.al.
4. www.gzk.rks-gov.net.
5. www.normattiva.it.
6. www.ivass.it.
7. www.legifrance.gouv.fr.
8. www.dalloz-actualite.fr

DIMENSIONI DIGJITAL I DHUNËS ME BAZË GJINORE*

Dr. Eniana QARRI**

DIGITAL DIMENSION OF GENDER BASED VIOLENCE

Absrtact

This paper aims to contribute to the study of gender-based violence in the digital space in Albania, with the aim of identifying the problems and addressing them legally. Through the analysis of the Albanian, European and international legal framework, the study aims to identify the shortcomings and problems of Albanian legislation.

The increased use of information and communication technology tools has led to the emergence of a new form of violence, violence in the digital space, which includes stalking, harassment, hate speech, distribution of intimate images that occur through technology and the internet. Although specific data on digital violence in Albania are limited, studies and reports show that digital violence is a growing phenomenon in Albania, with a particular impact on women and young people. They also point to a wide spread of online harassment and threats, with many cases unreported or insufficiently addressed.

The paper provides some recommendations for legal initiatives to address the above-mentioned issues, with the aim of promoting women's rights and safety in the digital space. Legal initiatives should be proportionate to the protection and guarantee of freedom of expression.

In order to analyse the issues raised above and to draft recommendations for legal initiatives, the study used a multi-method approach, combining data collection, legal analysis, comparative study and consultations with interested parties.

Key words: *dhuna digjitale, dhuna me bazë gjinore, teknologjia e informacionit dhe komunikimit, ngacimi digjital, përndjekja digjitale, keqpërdorimi i pamjeve intime, gjuha e urrejtjes*

1. Vështrim i përgjithshëm mbi dhunën me bazë gjinore në hapësirën digjitale

Dhunë gjinore kundër grave nënkupton dhunën që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale¹. Dhuna kundër grave përbën shkelje të të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private².

Shqipëria në 20 vitet e fundit ka pasur një rritje të konsiderueshme të përdorimit të internetit. Të dhënat për vitin 2021 tregojnë që rreth 79.3% e personave janë përdorues interneti, krahasuar me 72.2% që kanë qenë në vitin

* Ky artikull bazohet në studimin "Addressing gender-based violence in digital space in Albania (2024)", i cili është financuar nga NDI Albania.

** Dr. Eniana Qarri është lektore e të Drejtës Familjare në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Adresa e email-it: eniana.qarri@fdut.edu.al.

¹ Konventa e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", 2011, neni 3(d). Shkurtime në vijim do t'i referohemi si Konventa e Stambollit.

² Përkufizim i dhunës gjinore sipas Konventës së Stambollit, neni 3(a).

2020³. Studimet për vitin 2023 tregojnë që, përsa i përket ndarjes gjinore, ka një rritje të përdorimit të internetit nga gratë/vajzat, por burrat janë përdorues më të shumtë të internetit me rreth 80.3%, pasuar nga gratë/vajzat me 78.3%⁴.

Krahas efekteve pozitive, rritja e përdorimit të internetit sjell edhe ekspozimin e përdoruesve ndaj rreziqeve të hapësirës digjitale. Rritja e qasjes në internet dhe përhapja e përdorimit të mejeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) ka sjellë një formë të re të dhunës me bazë gjinore (DHBGJ), atë të zhvilluar në hapësirën digjitale.

Studimet tregojnë që pavarësisht se të gjithë individët, burra, gra dhe fëmijë mund të jenë target i dhunës në hapësirën digjitale, gratë dhe vajzat janë më të prekuara nga dhuna digjitale, dhe ato gjithashtu vuajnë pasoja më të rënda në aspektin fizik, seksual, psikologjik dhe ekonomik, si dhe shpeshherë përfundojnë me tërheqjen nga hapësira digjitale, duke humbur në këtë mënyrë mundësi në planin e arsimimit dhe karrierës profesionale⁵. Pavarësisht se mungojnë të dhëna të sakta, një studim i bërë në planin botëror tregon që 38% e grave kanë eksperiencë personale të DHBGJ në hapësirën digjitale, ndërsa 85% e tyre kanë qenë dëshmitare të DHBGJ të drejtuar grave të tjera, gjatë qëndrimit të tyre në hapësirën digjitale⁶. Një studim i UN Women me gra të moshës 18-55 vjeç në Danimarkë, Itali, Zelandë të Re, Poloni, Spanjë, Suedi, MB dhe SHBA gjeti se pothuajse një e katërta (23 për qind) e grave të anketuara kishin përjetuar abuzim ose ngacmim online të paktën një herë⁷. DHBGJ është përshkallëzuar me shpejtësi, gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, për shkak se jeta grave u zhvendos në internet, për punë, arsim, akses në shërbime dhe aktivitete sociale⁸.

Këshilli i të Drejtave të Njeriut të OKB-së (UN Human Rights Council) në Rezolutën “Mbi promovimin, mbrojtjen dhe gëzimin e të drejtave të njeriut në internet”⁹ (2016), shprehet që “të drejtat që njerëzit kanë në botën fizike (offline) duhet të gëzohen dhe mbrohen edhe në atë online (në hapësirën digjitale). Kjo nënkupton të drejtën e grave për tu mbrojtur nga dhuna me bazë gjinore në hapësirën digjitale.”¹⁰

Gratë janë më të ekspozuara ndaj ngacmimeve kibernetike bazuar në arsimin e tyre, moshën, prejardhjen etnike, orientimin seksual, statusin e marrëdhënies, etninë, racën, identitetin gjinor, besimin fetar etj¹¹. Në studimin e realizuar nga UN Women (Accelerating efforts to tackle online and technology-facilitated violence against women and girls, 2022) rezulton që kategoritë më të ekspozuara ndaj DHBGJ në hapësirën digjitale janë vajzat e reja, gratë e angazhuara në jetën publike, gratë gazetare, gratë aktiviste të të drejtave të njeriut, si dhe ato emigrante, gratë e minoriteteve etnike, gratë e komunitetit LGBT¹².

DHBGJ në hapësirën digjitale, duke qenë se është një formë e re e dhunës ka disa karakteristika që e dallojnë atë nga DHBGJ në botën reale, dhe për rrjedhojë kërkon adresim të posaçëm ligjor, pasi masat aktuale ligjore, ato institucionale dhe politikat shtetërore mund të mos jenë efektive në hapësirën digjitale.

2. Dimensioni digjital i dhunës me bazë gjinore

³ Borjana Dine dhe Altin Hazizaj, *Siguria në internet e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri*, Raport i 4-t Kombëtar, CRCA/ECPT Shqipëri (Tiranë, 2023), 7.

⁴ Dine dhe Hazizaj, *Siguria në internet e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri*, 7 (n 3).

⁵ European Institute for Gender Equality, *Combating Cyber Violence against Women and Girls*, 2022, 10. Marrë nga: https://eige.europa.eu/publications-resources/publications/combating-cyber-violence-against-women-and-girls?language_content_entity=en (Aksesi në datë 19.5.2024).

⁶ Për këto shifra shih: UN Women, *Accelerating efforts to tackle online and technology-facilitated violence against Women and girls*, 2022. Marrë nga: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2022/10/accelerating-efforts-to-tackle-online-and-technology-facilitated-violence-against-women-and-girls> (Aksesi në datë 21.5.2024).

⁷ *Ibid*, 4 (n 5).

⁸ *Ibid*, 1 (n 5).

⁹ UN Human Rights Council Resolution On the Promotion, Protection, and Enjoyment of Human Rights on the Internet, 2016.

¹⁰ Sabrina Lannazzone, Laura Clough dhe Lucille Griffin, *Online violence against women and girls. The scenario in the MENA Region*, (Euromed Rights, 2021), 3. Marrë nga: www.euromenrights.org, (Aksesi në datë 21.5.2024).

¹¹ European Institute for Gender Equality, *Combating Cyber Violence against Women and Girls*, 58 (n 5).

¹² UN Women, *Accelerating efforts to tackle online and technology-facilitated violence against women and girls*, 2, (n 8); Lannazzone, Clough dhe Griffin, *Online violence against women and girls. The scenario in the MENA Region*, 4, (n 6).

2.1 Kuptimi i DHBGJ në hapësirën digjitale

Aktualisht nuk ka një përkufizim të pranuar ndërkombëtarisht për dhunën ndaj grave dhe vajzave në hapësirën digjitale. Gjithashtu, duke qenë një fushë e re terminologjia, përkufizimet dhe metodologjia e matjes së saj nuk janë të unifikuara.

Sipas doktrinës, dhuna me bazë gjinore në hapësirën digjitale përfshin veprime të kryera nga një ose disa persona, të cilat u sjellin dëme personave të tjerë për shkak të identitetit të tyre gjinor ose seksual, veprime të cilat kryhen duke përdorur internetin ose mjete të tjera të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, dhe përfshijnë përndjekjen, ngacmimin seksual, shpifjen, gjuhën e urrejtjes, etj¹³. Këto veprime cenojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore nga gratë në hapësirën digjitale dhe të drejtën e tyre themelore për tu angazhuar në debatin publik.¹⁴

European Institute for Gender Equality në raportin e tij “Combating Cyber Violence against Women and Girls”, të vitit 2022 propozon këtë përkufizim për dhunën digjtale me bazë gjinore:

“DHBGJ në hapësirën digjitale përfshin forma të ndryshme të dhunës të kryera nëpërmjet mjeteve TIK, mbi bazën e gjinisë ose një kombinimi të gjinisë me faktorë të tjerë si raca, mosha, paafësia, seksualiteti, profesioni ose besimi personal. Dhuna digjitale mund të nisë online dhe të vazhdojë offline, ose të fillojë offline dhe të vazhdojë online, si dhe mund të kryhet nga persona të njohur ose të panjohur për viktimën.”¹⁵

Ndërsa, UN Women në studimin e fundit “The dark side of digitalization: Technology-facilitated violence against women in Eastern Europe and Central Asia”, të vitit 2023, jep këtë përkufizim për dhunën ndaj grave të lehtësuar nga teknologjia:

“Çdo veprim që kryhet, ndihmohet, përkeqësohet ose përforcohet nga përdorimi i mjeteve të TIK ose mjeteve të tjera digjitale, që rezultojnë ose ka gjasa të rezultojnë në dëm fizik, seksual, psikologjik, social, politik ose ekonomik, ose shkelje të tjera të të drejtave dhe lirive.”¹⁶

Në raporte dhe studime të ndryshme, për t’iu referuar DHBGJ në hapësirën digjitale përdoren terma të ndryshëm si: dhuna kibernetike, dhuna virtuale, dhuna digjitale apo dhuna online, dhuna e lehtësuar nga teknologjia etj¹⁷. Studimet kanë treguar që format e ndryshme të dhunës ndaj grave dhe vajzave në hapësirën digjitale, ndodhin përmes përdorimit të platformave të mediave sociale, platformave të realitetit virtual, platformave të punës, lojërave online, faqeve të takimeve, dhomave të bisedave dhe platformave të tjera digjitale, si dhe kjo dhunë lehtësohet nga teknologjia, përmes mjeteve të ndryshme digjitale, p.sh. teknologjitë GPS /bazuara në vendndodhje, inteligjenca artificiale, aplikacionet e transportit, mjetet e komunikimit si telefonat celularë, etj.¹⁸

Sipas studimeve ekziston një lidhje ndërmjet dhunës në botën fizike (dhuna offline) me dhunën në hapësirën digjitale (dhuna online). Dhuna me bazë gjinore mund të nisë fillimisht online dhe më pas mund të pasohet nga dhuna fizike, ose mund të fillojë në botën fizike dhe më pas të vazhdojë në hapësirën digjitale¹⁹.

¹³ Laura Hinson, Jennifer Mueller, Lila O’Brien-Milne dhe Naome Wandera, *Technology-facilitated gender-based violence: what is, and how do we measure it?*, International Center for Research on Women, 2018, 1. Marrë nga: https://www.svri.org/sites/default/files/attachments/2018-07-24/ICRW_TFGBVMarketing_Brief_v8-Web.pdf (Aksesi në datë 25.5.2024).

¹⁴ Lannazzone, Clough dhe Griffin, *Online violence against women and girls. The scenario in the MENA Region*, 4, (n 10).

¹⁵ *Ibid*, 39 (n 7).

¹⁶ UN Women, *Accelerating efforts to tackle online and technology-facilitated violence against women and girls*, 9 (n 6).

¹⁷ *Ibid*, 3 (n 6); Lannazzone, Clough dhe Griffin, *Online violence against women and girls. The scenario in the MENA Region*, 4 (n 10).

¹⁸ UN Women, *Accelerating efforts to tackle online and technology-facilitated violence against women and girls*, 3 (n 6).

¹⁹ Të dhënat në Mbretërinë e Bashkuar tregojnë që 54% e rasteve të dhunës në hapësirën digjitale kanë filluar më një takim të parë fizik të viktimës me autorin. Shih: Lannazzone, Clough dhe Griffin, *Online violence against women and girls. The scenario in the MENA Region*, 4 (n 10).

Emri i Autorit

DHBGJ në hapësirën digjitale mund të kryhet si nga persona anonimë apo të panjohur për viktimën, ashtu edhe nga persona të njohur për të, përfshirë partnerët ose ish-partnerët (të afërm apo të njohur)²⁰. Dhunuesi dhe viktima mund të gjenden edhe në shtete të ndryshme, faktor që e bën edhe më të vështirë luftën ndaj dhunës digjitale.

Pasojat negative që sjell DHBGJ në hapësirën digjitale për viktimën shfaqen në formën e dëmit fizik, të shëndetit mendor, statusit shoqëror, mundësive ekonomike, dhe në disa raste mund të sjellin edhe vdekjen e viktimës.²¹

Ekzistojnë disa karakteristika specifike të hapësirës digjitale që krijojnë një mjedis të favorshëm për dhunën ndaj grave dhe vajzave²². Kjo formë e re e dhunës me bazë gjinore karakterizohet nga këto elemente²³:

- (i) Anonimiteti: Autori (dhunuesi) mund të jetë dhe të mbetet i panjohur për viktimën. Shpeshherë autori është anonim, por nuk përjashtohet rasti kur autori është një person i njohur për viktimën, si psh. bashkëshorti/bashkëjetuesi, ish-bashkëshorti/bashkëjetuesi, fqinj, shok, koleg pune, i afërm etj.
- (ii) Distanca e veprimt: Abuzimi/dhuna mund të drejtohet nga çdo distancë nga çdo vend i botës, pa kontakt fizik të autorit me viktimën.
- (iii) Automatizimi: Veprimet abuzive që kryhen duke përdorur mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit kërkojnë më pak kohë dhe më pak përpjekje.
- (iv) Aksesueshmëria (Qasja): Larmia e mjeteve të komunikimit dhe informacionit dhe përballueshmëria ekonomike i bëjnë ato të lehtësisht të aksesueshme për dhunuesit.
- (v) Shpërndarja dhe vazhdueshmëria: Tekstet dhe fotot e kopjuara në internet mund të shumëfishohen dhe shpërndahen pa kufij ose të qëndrojnë në hapësirat digjitale për një kohë të gjatë.
- (vi) Pandëshkueshmëria: Shpesh autorët kanë mundësi t'i shmangen përgjegjësisë dhe dënimit.

2.2 Format kryesore të DHBGJ në hapësirën digjitale

Ekziston një gamë e gjerë formash të dhunës ndaj grave dhe vajzave në hapësirën digjitale, si psh. ngacmimi seksual, përndjekja, zoom bombing, abuzim me imazhe intime, trolling, doxing, gjuha e urrejtjes apo misogjene ose gjinore, etj²⁴. Zakonisht këto sjellje janë të përsëritura.

Në vijim parashtrihen shkurtimisht format e ndryshme të DHBGJ në hapësirat digjitale dhe mënyrat e realizimit të tyre.

(1) Përndjekja digjitale (cyber stalking) përkufizohet si një formë përndjekjeje që kryhet me mjete elektronike ose digjitale. Ajo përfshin sjellje të përsëritura të autorit mbi viktimën, të tilla si: dërgimi i email-eve, mesazheve telefonike (SMS) ose mesazheve në rrjetet sociale që janë fyese ose kërcënuese; shpërndarja në internet ose nëpërmjet celularit e fotografive ose videove intime²⁵. Ajo kryhet përmes mjeteve të TIK me qëllim ngacmimin, frikësimin, persekutimin, përgjimin ose vendosjen e kontakteve ose komunikimeve të padëshiruara, përfshin sjellje të dëmshme që e bëjnë viktimën të ndjehet e kërcënuar, stresuar ose e pasigurt. Veprimet mund (a) të fillojnë online dhe vazhdojnë offline; (b) të fillojnë offline dhe të vazhdojnë online²⁶; (c) të kryhen nga një person i njohur për viktimë ose (d) autori mund të jetë në person që ka njohje me viktimën ose një person i përfshirë në marrëdhënie intime me viktimën ose person me të cilin viktima ka pasur marrëdhënie intime.²⁷

²⁰ Hinson, Mueller, O'Brien-Milne dhe Wandera, *Technology-facilitated gender-based violence: what is, and how do we measure it?*, 3 (n 13); European Institute for Gender Equality, *Combating Cyber Violence against Women and Girls*, 13 (n 5).

²¹ *Ibid*, (n 5).

²² UN Women, *Accelerating efforts to tackle online and technology-facilitated violence against women and girls*, 7 (n 6).

²³ Toplumsal Bilgi ve İletişim Derneği, *How to fight digital gender-based violence: a guide*, 2022, 6. Marrë nga: https://alternatifbilisim.org/content/files/2023/04/HOW_TO_FIGHT_DIGITAL_GENDER-BASED_VIOLENCE-A-GUIDE_2022--1---2-.pdf (Aksesi në datë 30.5.2024).

²⁴ UN Women, *Accelerating efforts to tackle online and technology-facilitated violence against women and girls*, 3 (n 6); European Institute for Gender Equality, *Combating Cyber Violence against Women and Girls*, 13 (n 5).

²⁵ European Institute for Gender Equality, *Combating Cyber Violence against Women and Girls*, 43 (n 5).

²⁶ Shpeshherë përndjekja digjitale fillon offline dhe më pas vazhdon në hapësirën digjitale.

²⁷ European Institute for Gender Equality, *Combating Cyber Violence against Women and Girls*, 43 (n 5).

(2) Ngacmimi ose bullizimi digjital (duke përfshirë edhe ngacmimin seksual) është një seri e vazhdueshme dhe e përsëritur sjelljesh që drejtohen ndaj një personi të caktuar, me qëllim për t'i shkaktuar atij parehati emocionale dhe shpeshherë frikën për dhunë fizike²⁸. Mund të përfshijë edhe kërkesa për favore seksuale ndaj viktimave, kërcënime për dhunë fizike ose seksuale dhe gjuhë urrejtjeje ose ngacmimi të papërshtatshme në platformat mediatike ose në chat room²⁹. Kjo mund të përfshijë edhe ngacmimin seksual.

(3) Gjuha e urrejtjes/thirrja ose nxitja për dhunë i referohet të gjitha formave të sjelljes të cilat publikisht kanë për qëllim të nxisin dhunë ose urrejtje ndaj një grupi njerëzish ose anëtarëve të tyre, për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, besimit fetar, origjinës etnike.³⁰ E kryer në hapësirën digjitale, kjo vepër penale paraqet disa veçori që shfaqen në mënyrën e kryerjes së saj, anonimatit e dhunuesit/ve dhe karakterin ndërjuridiksional. Shpeshherë, e njejta viktimë apo grup viktimash targetohen njëkohësisht nga disa autorë³¹. Kur kjo formë dhune drejtohet ndaj grave përfshin seksualizimin e tyre, objektifikimin, komente denigruese për tiparet fizike (body-shaming), komente denigruese dhe kërcënime për abuzim seksual³².

(4) Abuzimi me imazhet/pamjet intime nënkupton krijimin dhe/ose shpërndarjen publike apo kanosjen për shpërndarje, kryesisht nëpërmjet rrjeteve sociale, të pamjeve me përmbajtje seksuale të një ose disa njerëzve pa pëlqimin e tyre, ku zakonisht shumica e viktimave janë gra dhe abuzimi kryhet kryesisht nga ish-partnerët, për qëllime të këqija ose për hakmarrje.³³ Dhunuesi mund të përdorë imazhet edhe për kanosje me qëllim përfitimin e shumave monetare, imazheve të tjera intime apo favoreve seksuale.

Gjithashtu, një tjetër formë e abuzimit me imazhet/pamjet intime është edhe shantazhi seksual ose përfshirja në akte seksuale të padëshiruara nëpërmjet videove dhe fotografive seksuale.

Të tjera forma të DHBGJ në hapësirën digjitale përfshijnë: (i) keqinformimi dhe shpifja nënkupton përhapjen e lajmeve të rreme ose të ekzagjeruara me qëllim cenimin e dinjitetit të grave dhe veçanërisht të personazheve publike (zyrtarë shtetërorë, deputete, gazetarë, aktivistë etj); (ii) trolling, që është një formë e ngacmimit digjital, që nënkupton një veprim të qëllimshëm që synon përfshirjen e të tjerëve në diskutime “rreth vicioz”, me rezultat ndërhyrjen në shkëmbimin pozitiv dhe të dobishëm të ideve në platformat online të diskutimit; (iii) doxing, që nënkupton kërkimin, mbledhjen dhe shpërndarjen e informacioneve personale identifikuese kundër vullnetit të një personi, duke përfshirë por pa u kufizuar informacione personale dhe sensitive si adresa e shtëpisë, fotografi, emri dhe mbiemri i viktimës apo familjarëve të saj, numri i telefonit, adresa e emailit dhe të dhëna financiare.³⁴

3. Përhapja e dhunës me bazë gjinore në hapësirën digjitale në Shqipëri dhe nevoja për ndërhyrje ligjore

Megjithëse nuk ka studime të mirëfillta për matjen e formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore në hapësirën digjitale në Shqipëri, disa të dhëna mund të nxirren nga raporte, studime dhe statistika të ndryshme të organeve shtetërore si INSTAT dhe organizatave joqeveritare si AWEN, UN Women dhe CRCA.

Zyra e UN Women për Evropën dhe Azinë Qendrore (ECA) ka realizuar një studim gjithëpërfshirës mbi dhunën ndaj grave përmes teknologjisë në 13 vende të rajonit të ECA-së: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Gjeorgji, Kazakistan, Kosovë, Kirgistan, Moldavi, Mal i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi, Taxhikistan, Turqi dhe Ukrainë.³⁵

²⁸ Përkufizim i dhënë nga Komiteti i KiE-së Për Konventën mbi Krimin në Fushën Kibernetike (Cybercrime Convention). Me shënim të: European Institute for Gender Equality, *Combating Cyber Violence against Women and Girls*, 44 (n 5).

²⁹ *Ibid*, 46 (n 5).

³⁰ *Ibid*, 54 (n 5).

³¹ *Ibid*, 54 (n 5).

³² *Ibid*, 54 (n 7).

³³ *Ibid*, 57 (n 5).

³⁴ European Institute for Gender Equality, *Combating Cyber Violence against Women and Girls*, 15-16 (n 5).

³⁵ UN Women. *The dark side of digitalization: Technology-facilitated violence against women in Eastern Europe and Central Asia*, 2023, 17. Marrë nga: <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2023/11/the-dark-side-of-digitalization-technology-facilitated-violence-against-women-in-eastern-europe-and-central-asia>, (Aksesi i fundit në datë 28.5.2024).

Emri i Autorit

Studimi tregon që më shumë se gjysma e grave në të gjitha shtetet e marra në studim dhe 41.1% e grave shqiptare kanë përjetuar një nga format e dhunës ndaj grave përmes teknologjisë dhe nga këto rreth 80.6% janë ekspozuar ndaj disa (më shumë se një) formave të dhunës përmes teknologjisë³⁶.

Të dhënat për Shqipërinë tregojnë që 42.4% e grave të cilat kanë përjetuar të paktën një nga format e dhunës përmes teknologjisë kanë pasur vetëm një episod të vetëm dhune; 30.5% kanë përjetuar dhunë në mënyrë të përsëritur; ndërsa 27.1% nuk kanë qenë në gjendje të përcaktojnë frekuencën e dhunës³⁷.

Facebook dhe Instagram janë platformat ku pjesa më e madhe e grave kanë përjetuar dhunë, nërsa në Shqipëri dhe Turqi, Instagrami është shpesh vendi ku gratë kanë përjetuar dhunë dhe ngacmime në internet³⁸.

Të dhënat për të gjitha shtetet e marra në studim tregojnë që, shumica e dhunës përmes teknologjisë është kryer nga persona të panjohur për viktimën (50.3%) ose nga persona të njohur vetëm në internet (17.5%), ndërsa pothuajse një e treta (32.1%) e dhunës përmes teknologjisë është kryer nga persona të njohur prej grave, si partnerët, anëtarët e familjes, miqtë, të njohurit, kolegët, shefat apo studentët dhe për rrjedhojë mund të përfaqësojë vazhdim të dhunës në botën fizike (offline)³⁹.

Në të gjitha shtetet e marra në studim, dy të treta e grave raportuan pasoja emocionale, ndjesi të pashpresë, ose turp nga dhuna përmes teknologjisë.⁴⁰ Gratë raportuan dëme psikologjike në përqindje më të lartë në Turqi, Maqedoni Veriore dhe Shqipëri (27.2%, 24.1% dhe 23.4% respektivisht), ndërsa turpi ishte reagimi më i shpeshtë ndër gratë në Moldavi (42.2%). Ndjenjat e papërshtatshmërisë ishin më të larta te gratë në Shqipëri, Maqedoni Veriore dhe Ukrainë.⁴¹

Një tjetër studim që na jep të dhëna mbi disa forma të dhunës me bazë gjinore në hapësirën digjitale, është studimi “Violence against women and girls in Albania” realizuar nga Instituti Shqiptar i Statistikave (ISTAT), në vitin 2018⁴². Studimi përdor nocionet “përndjekje kibernetike” dhe “ngacmim seksual kibernetik”. Ky studim përkufizon ngacmimin seksual kibernetik si sjellje dhe veprime që përfshijnë marrjen e email-eve ose mesazheve SMS të padëshiruara, fyese, me përmbajtje të qartë seksuale; afrimin e papërshtatshëm dhe ofendues në faqet e rrjeteve sociale ose në dhomat e bisedave në internet⁴³. Në studim tregohet që shumë pak gra raportuan se u janë dërguar emaile fyese dhe/ose të padëshiruara me përmbajtje të qartë seksuale, mesazhe tekstuale dhe/ose afrime të papërshtatshme në faqet e rrjeteve sociale (1.9%); megjithatë, 1.2% e grave përjetuan këtë lloj ngacmimi seksual në 12 muajt e mëparshëm përpara anketimit (periudha 2017-2018)⁴⁴. Gratë shpesh e kanë përjetuar këtë formë ngacmimi seksual në shtëpi (53.1%), në vendin e punës (19.7%), në shkollë (16.2%), dhe në bar, restorant dhe disko klub (10.7%)⁴⁵. Së fundmi, gratë më shpesh e kanë identifikuar autorin si të panjohur (85.6%), por disa gra gjithashtu i kanë identifikuar autorët si shokë klase/shkolle (14.3%)⁴⁶.

Në një studim të realizuar në vitin 2018 nga Instituti Shqiptar i Medias për dhunën në hapësirën digjitale ndaj gazetarëve tregon që, gjinia shpesh përdoret si bazë diskriminimi dhe sulmi ndaj personalitetit të gazetarit. Në hapësirën online fillohet me fyerje që kanë të bëjnë me pamjen fizike për të përfunduar në kërcënime eksplicite që bëhen publikisht (komente, statuse) dhe privatisht (e-mail, mesazhe në rrjetet sociale) që bazohen te gjinia.⁴⁷

Format kryesore të dhunës që janë përfshirë në studim janë: sextortion, doxing, trolling, ngacmimi online, përndjekja online, përndjekja seksuale online, përdorimi/abuzimi i paautorizuar me pamjet seksuale.

³⁶ *Ibid*, 11 (n 35).

³⁷ *Ibid*, 44 (n 35).

³⁸ *Ibid*, 48 (n 35).

³⁹ *Ibid*, 49 (n 35).

⁴⁰ *Ibid*, 55 (n 35).

⁴¹ *Ibid*, 55-56 (n 35).

⁴² INSTAT, *Violence against women and girls in Albania*, Marrë nga: <https://www.instat.gov.al/media/5751/findings.pdf> (Aksesi në date 8.6.2024), 2019.

⁴³ *Ibid*, 109 (n 42).

⁴⁴ INSTAT, *Violence against women and girls in Albania*, 111 (n 42).

⁴⁵ *Ibid*, 113 (n 42).

⁴⁶ *Ibid*, 114 (n 42).

⁴⁷ Lejla Gaçanica, Marija Arnautoviç, *Mekanizma mbrojtës nga dhuna online. Manual për gazetarë*. Instituti Shqiptar i Medias, 2018, 5.

Platforma Kombëtare për Internet të Sigurt në Shqipëri (iSigurt.al), një shërbim kombëtar i ngritur nga CRCA/ECPAT Shqipëri në vitin 2015, ka botuar Raportin e 4-ët Kombëtar për sigurinë në internet të fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri, në vitin 2023.⁴⁸ Studimi tregon që, në vitin 2022 ka një rritje të konsiderueshme të gjuhës së urrejtjes online ndaj fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve, ku mesatarisht çdo dy ditë një fëmijë/adoleshent/i rritur raporton internet të pasigurt në Shqipëri, duke ju referuar kështu 150 rasteve të raportuara pranë Platformës iSIGURT.al.⁴⁹ Në vitin 2022 rastet e raportimeve të vajzave dhe djemve ishin thuhet të barabarta (47 % e raportimeve janë nga djemtë krahasuar me 43% e raportimeve të ardhura nga vajzat), krahasuar me vitin 2021, ku djemtë kishin konsiderueshëm më shumë raportime sesa vajzat. Ndërsa grupmosha më e prekur nga interneti i pasigurt është 18-30 vjeç, e ndjekur nga grup mosha 15-17 vjeç.

Gjatë vitit 2022, ndër kategoritë kryesore të incidenteve të raportuara lidhen me gjuhën e urrejtjes, vjedhjen dhe postimin e fotove personale dhe zënë rreth 38% të rasteve, materialet me përmbajtje të dhunës seksuale për fëmijë zënë vendin e dytë të raportimeve me 29% të rasteve. Në vend të tretë janë rastet e kategorizuara si gjuha e urrejtjes (përndjekje/kërcënim/shantazh), me rreth 15% të rasteve, e ndjekur nga raportimet ku në qendër janë bullizmi, profili i rremë, i vjedhur etj., me rreth 14%, vjedhje të të dhënave personale dhe sexting me 4%.⁵⁰

Sipas studimit, gjinia e personit, ndonëse në dukje nuk përbën ndonjë shkak specifik për dhunë, bullizëm apo pornografi në internet, në të vërtetë paraqet disa karakteristika që duhen marrë në konsideratë. Gjuha e urrejtjes dhe thirrjet për dhunë seksuale në shumicën e rasteve janë të drejtuara ndaj vajzave dhe shumë më rrallë kundër djemve.⁵¹

Nga raportimet e kryera mbi bullizmin online, shantazhet, kërcënimet, incidentet janë raportuar nga 58% e vajzave, krahasuar me djemtë, të cilët përbëjnë rreth 42% të rasteve. Edhe në rastet e gjuhës së urrejtjes, vajzat sërish raportojnë një numër më të lartë incidentesh, me rreth 57% të rasteve, ndërsa djemtë rreth 43% të rasteve.⁵²

Në vitet 2018-2019 UNICEF Albania ka realizuar një studim mbi sigurinë e fëmijëve në internet në Shqipëri.⁵³ Nga studimi rezultoi se gjatë kohës së lundrimit të tyre në internet fëmijët janë hasur me situata të padëshiruara, konkretisht 14% e fëmijëve të anketuar kanë përjetuar online diçka që i ka mërzitur, (veçanërisht mosha 15–17 vjeç) dhe 1 në 10 fëmijë (9%) ka pasur një përvojë seksuale të padëshiruara në internet.⁵⁴ Studimi tregon se fëmijët janë të ekspozuar nga përmbajtje të dëmshme online si imazhet e dhunës apo abuzimit (1 në 5 fëmijë), përmbajtje që flasin për dhunë fizike (17% e fëmijëve) apo përmbajtje që flasin për vetëvrasje (1 në 10 fëmijë), 1 në 5 fëmijë kanë qenë subjekt i mesazheve denigruese dhe të urrejtjes drejt tyre, që është, gjithashtu, një tregues i situatave të mundshme të bullizmit online.⁵⁵

Këto studime tregojnë që dhuna në hapësirën digjitale është një fenomen i përhapur, me pasoja të rënda social, ekonomike dhe psikologjike dhe prek veçanërisht gratë dhe vajzat. Gjithashtu, studimet tregojnë që nuk ka parashikime të përshtatshme ligjore dhe politika shtetërore për të adresuar dhunën ndaj grave përmes teknologjisë, ndërsa mekanizmat ekzistues nuk janë të mjaftueshme, për shkak të karakteristikave që paraqet dhuna digjitale⁵⁶.

4. Kuadri ligjor ndërkombëtar mbi dhunën me bazë gjinore në hapësirën digjitale

⁴⁸ Dine dhe Hazizaj, *Siguria në internet e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri*, (n 3).

⁴⁹ *Ibid*, 20 (n 3).

⁵⁰ *Ibid*, 17 (n 3).

⁵¹ *Ibid*, 20 (n 3).

⁵² *Ibid*, 18 (n 3).

⁵³ UNICEF, *Eksperiencat e fëmijëve në përdorimin e Internetit në Shqipëri*, 2019. Të dhënat janë marrë nga Strategjia Kombëtare Për Sigurinë Kibernetike, 2020-2025, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1084, datë 24.12.2020, FZ. Nr. 7/2021, 1489-90.

⁵⁴ Strategjia Kombëtare Për Sigurinë Kibernetike, 2020-2025, 1490 (n 53).

⁵⁵ *Ibid*, 1490 (n 53).

⁵⁶ UN Women. *The dark side of digitalization: Technology-facilitated violence against women in Eastern Europe and Central Asia*, 10 (n 35).

Në nivelin ndërkombëtar dhe rajonal Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), Këshilli i Evropës (KiE) dhe Bashkimi Evropian (BE) kanë disa instrumente ligjore që adresojnë dhunën me bazë gjinore në hapësirën digjitale. Këto instrumente janë ende në fazat fillestare të adresimit të dhunës me bazë gjinore në hapësirën digjitale. Vitet e fundit është intensifikuar puna e OKB-së, kryesisht përmes veprimtarisë së ndërmarrë nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Sekretari i Përgjithshëm, Raportuesi i Posaçëm i OKB-së për Dhunën kundër Grave (UNSRVAW) dhe Komisioni për Statusin e Grave (CSW), të cilat janë mbështetur nga puna e Komisionit Statistikor të OKB-së, Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) dhe UN Women.⁵⁷

Në kuadrin evropian, kemi iniciativa të ndryshme të Këshillit të Evropës dhe BE-së. Një ndër hapat më të rëndësishëm është afirmimi i zbatimit të Konventës së Stambollit mbi dhunën me bazë gjinore në hapësirën digjitale, përmes Rekomandimit nr. 1 të GREVIO-s.

4.1 Organizata e Kombeve të Bashkuara

Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe ato që adresojnë në mënyrë të posaçme mbrojtjen e grave, përcaktojnë detyrimet e shteteve për të luftuar të gjitha format e diskriminimit ndaj grave, përfshirë dhunën. Ashtu siç theksohet edhe në Studimin e UN Women “The dark side of digitalization: Technology-facilitated violence against women in Eastern Europe and Central Asia”, duke qenë se instrumentet kryesore të të drejtave të njeriut për gratë, siç janë Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Deklarata për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave dhe Deklarata dhe Platforma e Veprimit të Pekinit, i kanë paraparirë zhvillimit të internetit dhe mjeteve TIK, ato nuk kanë parashikime për dhunën me bazë gjinore në hapësirën digjitale⁵⁸.

Dy instrumente ligjore të rëndësishme të OKB-së janë Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948) dhe Pakti Ndërkombëtar Për të Drejtat Civile dhe Politike (1996). Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) garanton barazinë e të gjithë njerëzve para ligjit dhe të drejtën për t’u mbrojtur kundër çdo diskriminimi, si dhe kundër çdo nxitje për diskriminim (neni 7), si dhe të drejtën për privatësi, mbrojtje kundër ndërhyrjeve arbitrare në jetën private, dhe mbrojtjen kundër sulmeve ndaj nderit dhe prestigjit personal (neni 12). Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP)⁵⁹ përfshin dispozita të ngjashme me ato të DUDNJ-së për trajtimin e barabartë (neni 26), ndalimin e diskriminimit (neni 26) dhe mbrojtjen e privatësisë (neni 17). Pavarësisht se, si neni 12 i DUDNJ-së ashtu edhe neni 17 i Paktit nuk kanë parashikime të drejtpërdrejta për hapësirën digjitale, ato janë të zbatueshme në kontekstin e dhunës digjitale siç janë sulmet ndaj privatësisë online dhe abuzimet në internet.

Një instrument ligjor i rëndësishëm i OKB-së është Konventa Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). Konventa është një traktat ndërkombëtar i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 18 dhjetor 1979 dhe është ratifikuar nga mbi 185 shtete⁶⁰. CEDAW ka is objektiv eliminimi e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe sigurimi i barazisë gjinore në të gjitha sferat e jetës; garantimi i të drejtave të barabarta në fusha si arsimi, punësimi, shëndetësia dhe pjesëmarrja politike; dhe zhvillimin dhe përparimin e grave përfshirë masa për përparimin e tyre në fusha ku janë të nënpërfaqësuar.

Sipas Konventës, diskriminimi ndaj grave përfshin çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e seksit, e që ka për pasojë ose për qëllim të kompromentojë ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër (neni 1). Kjo dispozitë përcakton bazën për të identifikuar dhe luftuar çdo formë të diskriminimit ndaj grave.

Konventa parashikon detyrimin e shteteve Palë të marrin masa efektive për të siguruar barazinë gjinore dhe për të eliminuar diskriminimin ndaj grave (neni 2(b)). Këto masa duhen marrë në të gjitha fushat, sidomos në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, duke përfshirë edhe legjisllacionin, për të siguruar zhvillimin e plotë

⁵⁷ *Ibid*, 27 (n 35).

⁵⁸ *Ibid*, 29 (n 35).

⁵⁹ Pakti Ndërkombëtar Për të Drejtat Civile dhe Politike është ratifikuar nga Shqipëria në datë 4.9.1991.

⁶⁰ Konventa CEDAW është ratifikuar nga RSH në 11.05.1994.

dhe përparimin e grave me qëllim që t'u garantojnë atyre ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut mbi bazën e barazisë me burrat (neni 3).

Konventa parashikon mekanizma për monitorimin e zbatimit të saj. Organi që siguron mbikëqyrjen për zbatimin e Konventës është Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (neni 17), i cili shqyrton raportet e shteteve lidhur me masat legjislativë, gjyqësore, administrative dhe me masat e tjera që kanë miratuar për t'u dhënë efekt dispozitivave të kësaj Konvente (neni 18). Shtetet palë duhet të paraqesin raporte për masat e marra për të zbatuar dispozitat e CEDAW çdo 4 vjet.

Duke qenë që CEDAW është hartuar në vitin 1979 (para zhvillimit të internetit dhe TIK), ajo nuk e adreson në mënyrë specifike dhunën digjitale në tekstin e saj origjinal. Megjithatë, interpretimet dhe rekomandimet e Komitetit të CEDAW-t kanë zgjeruar zbatimin e saj edhe në sferën digjitale. Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 35 (2017) thekson se dhuna digjitale është një formë e dhunës me bazë gjinore dhe kërkon që shtetet të miratojnë ligje dhe politika që mbrojnë gratë nga këto forma të reja të dhunës. Shtetet kanë detyrimin të miratojnë legjisllacion që ndalon të gjitha format e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave, duke harmonizuar ligjin kombëtar me Konventën⁶¹.

Këshilli i të Drejtave të Njeriut të OKB-së ka miratuar Rezolutën Nr. 38/5 (2018), e cila është fokusuar në përshpejtimin e përpjekjeve për të eliminuar dhunën ndaj grave dhe vajzave dhe për të parandaluar dhe reaguar ndaj dhunës ndaj grave dhe vajzave në hapësirën digjitale.⁶²

4.2 Këshilli i Evropës (KiE)

Disa nga Konventat e KiE-së janë drejtpërdrejt të zbatueshme në kontekstin e dhunës digjitale, ndërsa të tjera Konventa janë tërthorazi të zbatueshme.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore duke qenë se i paraprin zhvillimit të internetit dhe mjeteve TIK, nuk ka parashikime për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në hapësirën digjitale. Megjithatë, me interpretim të zgjeruar të fushës së zbatimit, normat e saj mund të shtrijnë veprimin edhe në hapësirën digjitale, aq më tepër duke pasur parasysh që ka një lidhje apo vazhdimësi ndërmjet dhunës offline dhe asaj online. Nenet relevante të KEDNJ-së për dhunën me bazë gjinore në hapësirën digjitale janë: neni 3 (ndalimi i torturës); neni 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe neni 14 (ndalimi i diskriminimit). Konventa është ratifikuar nga RSH në vitin 1996⁶³.

Një rol të rëndësishëm në interpretimin e zgjeruar të nenit 8 të KEDNJ-së, në drejtim të shtrirjes së fushës së veprimit të tij edhe në kontekstin e dhunës me bazë gjinore në hapësirën digjitale, ka luajtur jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në çështjet *Volodina kundër Rusisë* (2021)⁶⁴, *Buturuga kundër Rumanisë* (2021)⁶⁵ dhe *K.U. kundër Finlandës* (2008)⁶⁶. Në çështjen *Buturanga kundër Rumanisë*, GJEDNJ ka theksuar që ngacmimi kibernetik aktualisht njihet si një aspekt i dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe mund të marrë forma të ndryshme, duke përfshirë shkeljet kibernetike të privatësisë, hakerimin e kompjuterit të viktimit dhe vjedhjen, shpërndarjen dhe manipulimin e të dhënave dhe imazheve, duke përfshirë detaje intime.

Konventa Për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës Ndaj Grave dhe Dhunës në Familje e njohur si Konventa e Stambollit synon mbrojtjen e grave nga të gjitha format e dhunës. Ajo është miratuar në vitin 2011 dhe ka hyrë në në fuqi në vitin 2014. Konventa vendos standarde ligjore të detyrueshme për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e

⁶¹ UN Women. *The dark side of digitalization: Technology-facilitated violence against women in Eastern Europe and Central Asia*, 30 (n 35).

⁶² *Ibid*, 30 (n 35).

⁶³ KEDNJ është ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 "Për ratifikimin e konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore".

⁶⁴ Çështja *Volodina v. Russia*, nr. aplikimi 40419/19, datë 14.9.2021.

⁶⁵ Çështja *Buturunga v. Romania*, nr. aplikimi 56867/15, datë 11.02.2020.

⁶⁶ Çështja *K.U. v. Finland*, nr. aplikimi 2872/02, datë 2.12.2008.

viktimave, ndjekjen penale të autorëve dhe politikat e integruara lidhur me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje⁶⁷. Konventa është ratifikuar nga RSH në vitin 2013⁶⁸.

Neni 2, para. 1 i Konventës së Stambollit, i cili rregullon fushën e zbatimit të saj, parashikon që Konventa zbatohet për të gjitha format e dhunës kundër grave, duke përfshirë dhunën në familje, e cila prek gratë në mënyrë disproporcionale. Pavarësisht se neni 2, para. 1 nuk bën referim të shprehur në dhunën digjitale, terminologjia e përdorur “të gjitha format e dhunës” duhet të interpretohet në kuptimin që përfshin edhe dhunën në hapësirën digjitale.⁶⁹

Sipas nenit 3(a) të Konventës, “dhuna kundër grave” kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private. Neni 3(a), i cili parashikon “të gjitha aktet e dhunës gjinore”, mund të interpretohet në kuptimin që përfshin edhe dhunën në hapësirën digjitale. Gjithashtu, Konventa jep kuptimin e “dhunës gjinore kundër grave”, si dhunë që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale (neni 3(d)).

Konventa e Stambollit përmban parashikime që mund të përdoren për të adresuar dhunën digjitale ndaj grave dhe dhunën në familje, edhe pse nuk i përmend në mënyrë eksplicite këto forma të dhunës. Neni 3(a) që jep kuptimin e dhunës me bazë gjinore, neni 34 që mbulon përndjekjen (stalking), nenet 33 dhe 40 që mbulojnë dhunën psikologjike dhe ngacmimin seksual, të cilat mund të përfshijnë aspekte të dhunës digjitale, janë të zbatueshme edhe në kontekstin digjital.⁷⁰ Zbatimi i nenit 34 në hapësirën digjitale konfirmohet në tekstin shpjegues të Konventës, që klasifikon në mënyrë të shprehur “ndjekjen e çdo kontakti aktiv me viktimën përmes çdo mjeti të disponueshëm komunikimi, përfshirë mjetet moderne të komunikimit dhe mejtet e TIK” si kontakt të padëshiruar.⁷¹

Gjithashtu, parashikimet e Konventës lidhur me detyrimin e shteteve për marrjen e masave për të garantuar: hetimin dhe ndjekje penale efektive të veprave penale duke marrë parasysh perspektivën gjinore (neni 49); parandalimin dhe mbrojtjen e menjëhershme të viktimave nga organet ligjzbatuese (neni 50); vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut (neni 51); lëshimin e urdhrave të ndalimit dhe urdhrave mbrojtës (nenet 51 dhe 52); janë të zbatueshme edhe në kontekstin e dhunës digjitale.

Konventa ka krijuar Grupin e Ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), një organ monitorimi që vlerëson zbatimin e Konventës nga shtetet palë. GREVIO kryen rishikime periodike, jep rekomandime dhe angazhohet në dialog me qeveritë. Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 1 i GREVIO-s, i miratuar më 20 tetor 2023, për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje të lehtësuar nga teknologjia rekomandon interpretimin dhe zbatimin e zgjeruar të dispozitave të Konventës së Stambollit për të përfshirë dhunën digjitale.

Sipas Rekomandimit, shpërndarja e pamjeve apo videove pa pëlqim, shtrëngimi dhe kërcënimet, përfshirë kërcënimet për përdhunim, ngacmimi seksual dhe forma të tjera të intimidimit, ngacmimi seksual online, imitimi, përndjekja online, si dhe abuzimi psikologjik dhe dëmtimi ekonomik i kryer përmes mjeteve digjitale ndaj grave dhe vajzave përfshihen në përkufizimin e “dhunës ndaj grave”, sipas nenit 3(a) të Konventës⁷².

⁶⁷ Për një analizë më të hollësishme të shtyllave të Konventës së Stambollit shih: Material Shpjegues i KiE-së “Konventa e Stambollit bazohet në 4 shtylla”, marrë nga: <https://rm.coe.int/coe-istanbulconvention-brochure-sqi-r03-v01/1680a135ff>, (Aksesi në datë 20.6.2024).

⁶⁸ Republika e Shqipërisë ka nënshkruar më datë 19 dhjetor 2011, Konventën e KE-së “Për parandalimin dhe luftën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, e miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave në 20 tetor 2011. Konventa është ratifikuar nga RSH në vitin 2013.

⁶⁹ Për këtë interpretim shih edhe: UN Women. *The dark side of digitalization: Technology-facilitated violence against women in Eastern Europe and Central Asia*, 31 (n 35).

⁷⁰ European Institute for Gender Equality, *Combating Cyber Violence against Women and Girls*, 22 (n 5).

⁷¹ Për këtë interpretim shih edhe: UN Women. *The dark side of digitalization: Technology-facilitated violence against women in Eastern Europe and Central Asia*, 31 (n 35).

⁷² GREVIO General Recommendation No. 1 on the Digital Dimension of Violence against Women, parag. 33. Marrë nga <https://rm.coe.int/grevio-rec-no-on-digital-violence-against-women/1680a49147>. (Aksesi në datë 18.6.2024).

Rekomandimi parashikon që sjellet e mëposhtme të kryera online ose përmes mjeteve digjitale përfshihen në përkufizimin që neni 40 i Konventës i bën “ngacmimit seksual”: (a) shpërndarja e pamjeve ose videove pa pëlqim; (b) fotografimi, prodhimi ose sigurimi pa pëlqim i pamjeve ose videove intime; (c) shfrytëzimi, shtrëngimi dhe kërcënimet; (d) ngacmimi seksual; (e) dërgimi i paautorizuar i pamjeve të ekspozimit seksual (cyberflashing).⁷³

Lidhur me interpretimin e zbatimit të nenit 34 të Konventës në hapësirën digjitale, Rekomandimi parashikon që praktikatat e përndjekjes të kryera në hapësirën digjitale përfshijnë kërcënimet (me natyrë seksuale, ekonomike, fizike ose psikologjike), dëmtimin e reputacionit, monitorimin dhe mbledhjen e informacionit privat mbi viktimën, vjedhjen e identitetit, kërkimin për seks, imitimin e viktimës dhe ngacmimin me bashkëpunëtorë për të izoluar viktimën.⁷⁴

Sa i përket interpretimit të nenit 33 të Konventës, Rekomandimi parashikon që të gjitha format e dhunës ndaj grave të kryera në hapësirën digjitale kanë pasoja psikologjike dhe mund të kategorizohen si dhunë psikologjike e ushtruar online dhe përmes përdorimit të teknologjisë. Karakteristikat specifike të kësaj dhune ndaj grave rrisin ndikimin e dhunës mbi viktimat.⁷⁵

Pikat kryesore të Rekomandimit janë⁷⁶: (1) rritja e ndërgjegjësimit për dhunën digjitale; (2) përmirësimi i legjislacionit; (3) mbështetje dhe mbrojtje për viktimat; (4) përmirësimi i kapacitetit të aktorëve përkatës; (5) përgjegjësia e platformave digjitale; (5) mbledhja e të dhënave dhe kërkimi.

Konventa për Krimin në Fushën e Kibernetikës e njohur si Konventa e Budapestit, është miratuar nga Këshilli i Evropës më 23 nëntor 2001 dhe hyri në fuqi më 1 korrik 2004. Konventa është ratifikuar nga RSH në 2002.⁷⁷

Konventa ka si objektiv kryesor harmonizimin e legjislacioneve kombëtare përmes vendosjes së një kornize të përbashkët ligjore për të trajtuar krimin kibernetik në nivel ndërkombëtar; bashkëpunimi ndërkombëtar për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve kibernetike; dhe standardizimin e teknikave dhe procedurave të hetimit për të kapërcyer sfidat e krimit në botën digjitale.

Protokolli Shtesë i Konventës Për Racizmin dhe Ksenofobinë (2003) zgjeron dispozitat me qëllim përfshirjen e veprave penale që lidhen me aktet e racizmit dhe ksenofobisë që kryhen përmes sistemeve kompjuterike.

Konventa e Budapestit ka dispozita që, edhe pse nuk përmendin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhunën digjitale, përfshijnë veprime të paligjshme të lehtësuara nga teknologjia që shpesh përdoren për të kryer forma të ndryshme të dhunës digjitale. Këto përfshijnë përndjekjen në internet, keqpërdorimin e të dhënave dhe ngacmimet në internet. Konventa ofron një kornizë për trajtimin e veprave penale të lidhura me teknologjinë, të cilat mund të aplikohen në kontekstin e dhunës digjitale.

Një akt tjetër i rëndësishëm është edhe Rekomandimi i Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën Kundër Seksizmit, i miratuar në vitin 2019. Ky dokument përmban përkufizimin e parë të dakordësuar rajonal të seksizmit. Ai e përkufizon seksizmin si “çdo akt, gjest, përfaqësim vizual, fjalë të folura ose të shkruara, praktikë ose sjellje të bazuara në idenë se një person ose një grup personash është inferior për shkak të seksit të tyre, i cili ndodh në sferën publike ose private, qoftë online ose offline, me qëllim ose efekt të shkeljes së dinjitetit ose të drejtave të personit, duke shkaktuar dëm ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose socio-ekonomike, duke krijuar një mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtërues ose fyes, duke përbërë një pengesë për autonominë, duke mbajtur dhe forcuar stereotipet gjinore.”⁷⁸ Ky përkufizim përfshin si seksizmin në botën materiale ashtu edhe në hapësirën digjitale.

⁷³ GREVIO General Recommendation No. 1 on the Digital Dimension of Violence against Women, parag. 38 (n 72).

⁷⁴ *Ibid* (n 72).

⁷⁵ *Ibid* (n 72).

⁷⁶ *Ibid* (n 72).

⁷⁷ Konventa është ratifikuar nga RSH me ligjin nr. 8888, datë 25.4.2002 “Për ratifikimin e Konventës për krimin në fushën e kibernetikës”.

⁷⁸ UN Women. *The dark side of digitalization: Technology-facilitated violence against women in Eastern Europe and Central Asia*, 32 (n 35).

4.3 Bashkimi Evropian

Bashkimi Evropian (BE) ka disa direktiva dhe rregullore që janë drejtpërdrejt ose tërthorazi të zbatueshme për dhunën me bazë gjinore në hapësirën digjitale.

Akti më i rëndësishëm i BE-së në këtë drejtim është Direktivën 2024/1385 e 14 majit 2024 “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”⁷⁹. Direktiva përcakton rregulla minimale që lidhen me (neni 1):

- a) përkufizimin e veprave penale dhe dënimeve në fushën e shfrytëzimit seksual të grave dhe fëmijëve, si dhe krimet kompjuterik;
- b) të drejtat e viktimave të të gjitha formave të dhunës kundër grave ose dhunës në familje përpara, gjatë dhe për një kohë të përshtatshme pas procedurave penale;
- c) mbrojtjen dhe mbështetjen për viktimat, parandalimin dhe ndërhyrjen e hershme.

Direktiva përkufizon dhunën ndaj grave si “të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që drejtohen kundër një gruaje apo vajze për shkak se ajo është grua apo vajzë, ose që ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek gratë apo vajzat. Këto akte rezultojnë, ose janë të mundshme të rezultojnë, në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike, duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla, shtrëngimin ose privimin arbitrar të lirisë, pavarësisht nëse ndodhin në jetën publike apo private” (neni 2(a)). Direktiva përdor terminologjinë “të gjitha aktet”, që duhet interpretuar në kuptimin që përfshin edhe dhunën në hapësirën digjitale.

Kjo Direktivë parashikon detyrimin e Shteteve Anëtare për të parashikuar si vepra penale të dënueshme me ligj, në sistemet e tyre të brendshme ligjore, disa forma të dhunës digjitale si: abuzimi me imazhet/pamjet intime⁸⁰, përndjekja digjitale⁸¹, ngacmimi digjital⁸² dhe gjuha e urrejtjes/nxitja për dhunë⁸³.

Këto masa synojnë të mbrojnë individët nga forma të ndryshme të abuzimit dhe kërcënimit të shkaktuar përmes teknologjive të informacionit dhe komunikimit. Ato synojnë të ndalojnë dhe ndëshkojnë sjelljet që shkaktojnë frikë, shqetësim psikologjik dhe dëm fizik ose emocional për viktimat. Masat janë pjesë e përpjekjeve për të siguruar një ambient më të sigurt dhe të drejtë në epokën digjitale.

Këto sjellje, të parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8 të Direktivës duhet të ndëshkohen si krime (neni 9 i Direktivës). Neni 10 i Direktivës parashikon masën e dënimit me burgim, ndërsa neni 11 parashikon rrethanat rënduese.

Sipas nenit 12(3), Shtetet Anëtare kanë juridiksion mbi veprat penale të përmendura në nenet 5 deri 9, kur vepra penale kryhet me anë të teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) të aksesueshme nga territori i tyre, pavarësisht nëse ofruesi i shërbimit ndërmjetës është i vendosur në territorin e tyre apo jo. Ky parashikim synon të sigurojnë që veprat penale të kryera përmes teknologjive të informacionit dhe komunikimit të mos mbeten pa ndëshkim për shkak të kufizimeve të juridiksionit territorial. Duke përfshirë aksesin nga territori i tyre si kriter për juridiksion, Shtetet Anëtare mund të trajtojnë dhe ndëshkojnë më efektivisht krimet digjitale, duke përmirësuar sigurinë dhe drejtësinë në hapësirën digjitale.

Direktiva parashikon edhe masa për të garantuar mbrojtjen dhe aksesin e viktimave në drejtësi si dhe masa që lidhen me hetimin dhe marrjen e provave në rastet e dhunës digjitale.

Neni 23 i Direktivës parashikon detyrimin e Shteteve Anëtare për marrjen e masave për heqjen e materialeve të caktuara online.

Në lidhje me masat e specializuara të mbështetjes për viktimat, neni 25.1(b) i Direktivës parashikon “mbështetje për viktimat e krimeve të dhunës digjitale sipas neneve 5 deri në 8, duke përfshirë se si të dokumentohet krimin digjital dhe informacion mbi mjete gjyqësore dhe mjete për heqjen e përmbajtjes online të lidhur me krimin”.

⁷⁹ Directive (EU) 2024/1385 of the European Parliament and of the Council of 14 May 2024 on combating violence against women and domestic violence, *OJ L*, 2024/1385, 24.5.2024.

⁸⁰ Neni 5 i Direktivës 2024/1385 e 14 majit 2024 “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.

⁸¹ Neni 6 i Direktivës 2024/1385 e 14 majit 2024 “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.

⁸² Neni 7 i Direktivës 2024/1385 e 14 majit 2024 “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.

⁸³ Neni 8 i Direktivës 2024/1385 e 14 majit 2024 “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.

Neni 34 i Direktivës parashikon detyrimin e Shteteve Anëtare për marrjen e masave të përshtatshme për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Masat parandaluese duhet të adresojnë në mënyrë specifike krimet kibernetike të përmendura në nenet 5 deri në 8. Në veçanti, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që këto masat parandaluese të përfshijnë zhvillimin e aftësive të alfabetizimit digjital, përfshirë angazhimin kritik me botën digjitale dhe mendimin kritik për të mundësuar përdoruesit të identifikojnë dhe adresojnë rastet e dhunës digjitale, të kërkojnë mbështetje dhe të parandalojnë shpërdorimin e saj (neni 34.8).

Gjithashtu, në kuadrin e legjislacionit të BE-së gjenden edhe disa Direktiva dhe Rregullore të cilat janë të zbatueshme drejtpërdrejtë ose tërthorazi në kontekstin e dhunës digjitale, të tilla si: Direktiva nr. 2011/99/EU, dhjetor 2011 “Për Urdhrin Evropian të Mbrojtjes”⁸⁴; Direktiva nr. 2012/29/EU “Për të drejtat e viktimave”⁸⁵; Direktiva nr. 2011/93/EU “Për luftën kundër abuzimit seksual të fëmijëve”⁸⁶; Rregullorja nr. 2016/679 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”⁸⁷; Direktiva nr. 2000/31/EC “Për e-tregtinë (tregtinë elektronike)”⁸⁸. Gjithashtu, duhen përmendur edhe Strategjia e BE-së Për të Drejtat e Viktimave dhe Startegjia e BE-së Për Barazinë Gjinore, 2020-2025.

5. Mungesa e adresimit të dimensionit digjital të dhunës me bazë gjinore në legjislacionin shqiptar

Lidhur me çështjet e barazisë gjinore, dhunës në bazë gjinore dhe dhunës në familje, kuadri ligjor dhe ai institucional në Shqipëri vitet e fundit është përmirësuar dukshëm. Legjislacioni shqiptar është harmonizuar me standardet ndërkombëtare dhe ato evropiane që rrjedhin nga Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH, të tilla si Konventa e OKB-së “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” dhe Protokolli i saj shtesë, si dhe Konventa e KiE-së “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”. Megjithatë, legjislacioni shqiptar nuk ka parashikime të përshtatshme dhe të drejtpërdrejta ligjore për të adresuar dhunën me bazë gjinore në hapësirën digjitale. Ligjet ekzistuese, veçanërisht ato që rregullojnë barazinë gjinore, mbrojtjen nga dhuna, si edhe disa norma të Kodit Penal mund të përshtaten në kontekstin e dhunës digjitale. Megjithatë, këto norma nuk janë të mjaftueshme. Sfidat e reja që sjell teknologjia sjellin nevojën e përmirësimit të kuadrit ligjor, në drejtim të miratimit të normave që adresojnë në mënyrë specifike mbrojtjen nga dhuna në hapësirën digjitale, me qëllim për të siguruar mbrojtje më të mirë për viktimat dhe ndëshkime më të forta për autorët. Përveçse përmirësimi të kuadrit ligjor, kjo formë e re dhune mund të luftohet edhe nëpërmjet interpretimit të normave ligjore ekzistuese për t’i përshtatur ato, për aq sa është e mundur, me realitetin digjital.

Në vijim gjendet analiza e legjislacionit shqiptar në fushën e të drejtës penale, barazisë gjinore, mbrojtjes nga dhuna dhe komunikimeve elektronike e sigurisë kibernetike.

Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”⁸⁹ rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore (neni 1). Ligji është harmonizuar me Konventën e OKB-së “Për eliminimin e të gjitha formave

⁸⁴ Directive 2011/99/EU of the European Parliament and of the Council of 13 December 2011 on the European protection order, *OJ L 338*, 21.12.2011, f. 2–18

⁸⁵ Directive 2012/29/EU of the European Parliament and of the Council of 25 October 2012 establishing minimum standards on the rights, support and protection of victims of crime, and replacing Council Framework Decision 2001/220/JHA, *OJ L 315*, 14.11.2012, p. 57–73.

⁸⁶ Directive 2011/93/EU of the European Parliament and of the Council of 13 December 2011 on combating the sexual abuse and sexual exploitation of children and child pornography, and replacing Council Framework Decision 2004/68/JHA, *OJ L 335*, 17.12.2011, p. 1–14

⁸⁷ Regulation (EU) 2016/679 of the European Parliament and of the Council of 27 April 2016 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data and on the free movement of such data, and repealing Directive 95/46/EC (General Data Protection Regulation), *OJ L 119*, 4.5.2016, p. 1–88

⁸⁸ Directive 2000/31/EC of the European Parliament and of the Council of 8 June 2000 on certain legal aspects of information society services, in particular electronic commerce, in the Internal Market.

⁸⁹ Ndryshuar me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, nr.10 329, datë 30.9.2010, 47/2018, datë 23.7.2018.

Emri i Autorit

të diskriminimit ndaj grave” dhe aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH. Ligji nuk ka referenca të drejtpërdrejta për dhunën me bazë gjinore në hapësirën digjitale, por disa parashikime të tij mund të zbatohen edhe në këtë kontekst.

Ligji jep kuptimin e nocioneve të “ngacmimit për shkak të përkatësisë gjinore” dhe “ngacmimit seksual”. Sipas ligjit “ngacmim për shkak të përkatësisë gjinore” është çdo formë sjelljeje e padëshiruar, që lidhet me gjininë e një personi dhe ka për qëllim dhe/ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal ose krijimin e një mjedisi kërcënues, armiqësor, poshtërues, përçmues apo fyes⁹⁰. Ndërsa me “shqetësim seksual” do të kuptojmë çdo formë të padëshiruar sjelljeje, e shprehur me fjalë ose veprime fizike dhe simbolike, me natyrë seksuale, e cila ka për qëllim ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal, në mënyrë të veçantë kur krijon një mjedis kërcënues, armiqësor, poshtërues, përçmues apo fyes⁹¹. Këto përkufizime janë të vlefshme dhe mund të përdoren edhe kur ngacmimi për shkak të përkatësisë gjinore ose ngacmimi seksual ndodhin në hapësirën digjitale.

Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁹² rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër⁹³. Ndër të tjera, një nga shkaqet e diskriminimit të parashikuar nga ligji është edhe gjinia.

Ligji jep përkufizimin e “gjuhës së urrejtjes”, “shqetësimit” dhe “shqetësimit seksual”. Sipas ligjit, “gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji⁹⁴. Ndërsa me nocionin “shqetësim” kuptohet ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë⁹⁵. “Shqetësim seksual” përkufizohet si ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, verbale ose joverbale, e natyrës seksuale, e cila ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për të⁹⁶.

Këto përkufizime janë të vlefshme dhe mund të përdoren edhe kur gjuha e urrejtjes, shqetësimi dhe shqetësimi seksual ndodhin në hapësirën digjitale.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë⁹⁷ (KP) nuk ka norma të posaçme për të adresuar format e ndryshme të DHBGJ në hapësirën digjitale. Megjithatë, me interpretim ligjor, normat ekzistuese të KP, për aq sa janë të

⁹⁰ Neni 4.9 i Ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

⁹¹ Neni 4.10 i Ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

⁹² Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ndryshuar me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020. Ligji është përafuar plotësisht me: 32000L0043, Direktivën e Këshillit 2004/43/KE të 29 qershorit 2000 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”; 32000L0078, Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”; 32004L0113, Direktivën e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”; 32006L0054, Direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”.

⁹³ Neni 1 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

⁹⁴ Neni 3.8 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

⁹⁵ Neni 3.13 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

⁹⁶ Neni 3.14 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

⁹⁷ Kodi Penal i Republikës Së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995; ndryshuar me: ligjet nr. 8175, datë 23.12.1996; nr. 8204, datë 10.4.1997; nr. 8279, datë 15.1.1998; nr. 8733, datë 24.1.2001; nr. 9017, datë 6.3.2003; nr. 9030, datë 13.3.2003; nr. 9086, datë 19.6.2003; nr. 9188, datë 12.2.2004; nr. 9275, datë 16.9.2004; nr. 9686, datë 26.2.2007; nr.

zbatueshme, duhet të përdoren për të ndjekur penalisht dhe dënuar këtë lloj të ri dhune. Zbatimi i normave penale ekzistuese varet nga interpretimi dhe përshtatja e tyre nëse dhe për aq sa është e mundur me veçoritë e hapësirës digjitale.

Veçanërisht të rëndësishme janë ndryshimet ligjore të vitit 2020 të KP⁹⁸, të cilat kanë sjellë si risi kriminalizimin e dhunës psikologjike, mbrojtjen e personave në lidhje ose ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, harmonizim me nenin 3 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, si dhe ashpërsimin e dënimeve për disa figura të veprave penale.

Disa nga veprat penale të prashikuara nga KP që mund të përdoren në kontekstin e dhunës në hapësirën digjitale janë: neni 108/a i KP që parashikon veprën penale të ngacmimit seksual; neni 119 i KP që parashikon veprën penale të fyerjes; nenet 119/a dhe 119/b të KP që parashikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dy vepra penale të kryera në hapësirën digjitale, nëpërmjet përdorimit të mjeteve kompjuterike, konkretisht; (1) shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobe nëpërmjet sistemit kompjuterik; (2) fyerja me motive racizmi ose ksenofobie, nëpërmjet sistemit kompjuterik; neni 120 i KP që parashikon veprën penale të shpifjes; neni 121 i KP që parashikon veprën penale të ndërhyrjes së padrejtë në jetën private; neni 121/a i KP që parashikon veprën penale të përndjekjes; neni 122 i KP që parashikon veprën penale të përhapjes së sekreteve vetjake; neni 123 i KP që parashikon veprën penale të pengimit ose shkeljes së fshehtësisë së korrespondencës; neni 84 i KP që parashikon veprën penale të kanosjes; neni 130/a i KP që parashikon veprën penale të dhunës në familje; Nenet 293/a, 293/b dhe 293/c që parashikojnë veprat penale të përgjimit të paligjshëm të të dhënave kompjuterike, ndërhyrjes në të dhënat kompjuterike dhe në sistemet kompjuterike; neni 50 i KP që parashikon rrethana që rëndojnë dënimin; etj.

Në rastet e veprave penale të kryera në hapësirën digjitale, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të TIK, mbetet problematikë të provuarit të tyre. Mbledhja e provave gjatë hetimit të krimeve në hapësirën digjitale është një sfidë e madhe për shkak të natyrës së paqëndrueshme të këtyre provave⁹⁹. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë¹⁰⁰ (KPP) me ndryshimet ligjore të vitit 2008¹⁰¹, ka disa parashikime mbi marrjen e provave që lidhen me të dhëna kompjuterike, konkretisht nenet 119/a, 208/a, 299/a dhe 299/b. Këto ndryshime ligjore të vitit 2008 janë realizuar në përputhje me Konventën e Budapestit. Për të provuar dhunën me bazë gjinore në hapësirën digjitale, mund të jetë e nevojshme marrja e provave që nuk janë parashikuar nga KPP, aq më tepër duke pasur parasysh faktin që zhvillimet teknologjike janë më të shpejta dhe të vullshme se ato ligjore. Për këtë qëllim shërben neni 149, para. 2 i KPP sipas të cilit, kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë nëse prova vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnetit të personit. Gjykata vendos për marrjen e provës pasi dëgjon palët mbi mënyrën e marrjes së saj.

9859, datë 21.1.2008; nr. 10 023, datë 27.11.2008; nr. 23/2012, datë 1.3.2012; nr. 144, datë 2.5.2013; nr. 98, datë 31.7.2014; nr. 176/2014, datë 18.12.2014; nr. 135/2015, datë 5.12.2015; nr. 82/2016, datë 25.7.2016; nr. 36/2017, datë 30.3.2017; nr. 89/2017, datë 22.5.2017; nr. 44/2019, datë 18.7.2019, nr. 35/2020, datë 16.4.2020, nr. 146/2020, datë 17.12.2020; nr. 43/2021, datë 23.3.2021; vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 13, datë 29.5.1997; nr. 46, datë 28.8.1997; nr. 58, datë 5.12.1997; nr. 65, datë 10.12.1999; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 19, datë 1.6.2011; nr. 47, datë 26.7.2012; nr. 9, datë 26.2.2016; nr. 24, datë 4.5.2021; nr. 20, datë 3.4.2024.

⁹⁸ Ligji nr. 35/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7885, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

⁹⁹ Web Factor, *Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe gatishmërisë institucionale për trajtimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në hapësirën kibernetike në Shqipëri*, 2019, 44. Marrë nga: <https://www.unicef.org/albania/sq/deklarata-shtypi/faktori-web-vler%C3%ABsimi-i-kuadrit-ligjor-dhe-gatishm%C3%ABris%C3%AB-institucionale-p%C3%ABr> (Aksesi i fundit në datë 23.6.2024).

¹⁰⁰ Kodi i Procedurës Penale, miratuar me ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 ndryshuar me ligjet nr. 7977, datë 26.7.1995, 8027, datë 15.11.1995, nr. 8180, datë 23.12.1996, nr. 8460, datë 11.2.1999, nr. 8570, datë 20.1.2000, nr.8602, datë 10.4.2000, nr. 8813, datë 13.6.2002, nr.9085, datë 19.6.2003, nr. 9187, datë 12.2.2004, nr. 9276, datë 16.9.2004, nr. 9911, datë 5.5.2008, nr. 10 054, datë 29.12.2008, nr. 145/2013, datë 2.5.2013, nr. 21/2014, datë 10.3.2014, nr.99/2014, datë 31.7.2014, nr. 35/2017, datë 30.3.2017; nr. 147/2020, datë 17.12.2020; nr. 41/2021, datë 23.3.2021, vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 55, datë 21.11.1997, nr. 15, datë 17.4.2003; nr.5, datë 6.3.2009 dhe nr. 31, datë 17.5.2012.

¹⁰¹ Shtuar me ligjin nr. 10 054, datë 29.12.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”.

Emri i Autorit

Përveç ndjekjes penale të autorëve, viktimat e dhunës me bazë gjinorë në hapësirën digjitale mund të gjejnë mbrojtje edhe në normat e Kodit Civil (KC)¹⁰². Personat e dëmtuar në nderin dhe reputacionin e tyre apo nëse i është cenuar e drejta për respektimin e jetës private kanë të drejtën të kërkojnë shpërblimin e dëmit të shkaktuar sipas parashikimeve të nenit 625 të KC, si dhe nëse është rasti mund të kërkojnë edhe përgënjështimin e publikimeve mashtruese, jo të plota apo të pasakta (neni 617 i KC).

Viktima mund të kërkojë shpërblimin e dëmit jopasuror nëpërmjet padisë civile (në gjykatën civile) ose nëpërmjet paraqitjes së një padi civile në procesin penal, sipas nenit 61 të KPP¹⁰³.

Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë¹⁰⁴ (KPC) nuk ka parashikime të posaçme për marrjen dhe pranimin e provave digjitale. Aktualisht vetëm ligji nr. 10 273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”¹⁰⁵ parashikon kriteret për marrjen dhe përdorimin si provë të dokumentit elektronik. Neni 278 i KPC parashikon që filmat fotografikë ose filmat kinematografikë, kasetat e çdo lloji, si dhe çdo lloj tjetër regjistrimi, mund të përbëjnë provë për ngjarjet e sendet që janë regjistruar, kur gjykata bindet për saktësinë e vërtetësinë e tyre. Për këtë qëllim gjykata mund të thërrasë edhe ekspertë kompetentë. Ky parashikim mund të përdoret edhe në kuadrin e të provuarit të fakteve juridike që ndodhin në hapësirën digjtale. Megjithatë, përdorimi i nenit 278 është i kufizuar për shkak të objektit të rregullimit të tij. Neni 292 i KPC është i rëndësishëm për provat që mund të merren në hapësirën digjitale, kur këto prova kanë rëndësi të zhdruken ose të vështirësohet marrja e tyre. Sipas nenit 292 të KPC “*Kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e mosmarrëveshjes ose që ndikon në sqarimin e saj, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet marrja e saj, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërohet marrja më përpara.*”

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (i ndryshuar)¹⁰⁶ ka pë qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme¹⁰⁷. Ligji i kushton vëmendje të veçantë grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar, të cilët janë subjekt i këtij ligji. Ligji e përkufizon “dhunën” si çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik. Pavarësisht se ligji nuk ka asnjë parashikim të drejtpërdrejtë për dhunën në hapësirën digjitale, togfjalëshi “në të gjitha format e saj” si dhe “çdo veprim” duhen interpretuar në kuptimin që përfshijnë edhe format e ndryshme të dhunës digjitale në familje¹⁰⁸. Fusha e zbatimit të ligjit është e kufizuar vetëm në aktet e dhunës në familje dhe pjesëtarëve të saj¹⁰⁹. Dhuna në familje përkufizohet si çdo akt dhune, i përcaktuar sipas këtij ligji, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën¹¹⁰. Në ligj mungon adresimi i dimensionit digjital të dhunës me bazë gjinore në marrëdhëniet familjare.

¹⁰² Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, ndryshuar me ligjet nr. 8536, datë 18.10.1999, nr. 8781, datë 3.5.2001, nr. 17/2012, datë 16.2.2012, nr.121/2013, datë 18.4.2013, nr.113/2016, datë 3.11.2016; VGJK nr. 69, datë 27.12.2023.

¹⁰³ Sipas nenit 61 të KPP, ai që ka pësuar dëm nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrejnë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë ose shpërblimin e dëmit.

¹⁰⁴ Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 dhe ndryshuar me ligjet nr.8431, datë 14.12.1998; nr.8491, datë 27.5.1999; nr.8535, datë 18.10.1999; nr.8812, datë 17.5.2001; nr.9953, datë 14.7.2008, nr.10 052, datë 29.12.2008, nr.49/2012; 122/2013; 160/2013

¹⁰⁵ Sipas nenit 10 të ligjit, vërtetimi i kopjes në letër të dokumentit elektronik nga institucionet publike kryhet nga personat e autorizuar nga titullari i institucionit. Ndërsa, në të gjitha rastet e tjera, vërtetimi i kopjes në letër të dokumentit elektronik kryhet nga noteri publik. Rregullat dhe procedurat për vërtetimin nga noteri publik përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë.

¹⁰⁶ Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr.10 329, datë 30.9.2010, 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020.

¹⁰⁷Neni 1 i Ligjit “Për masa ndaj dhunës së marrëdhëniet familjare”.

¹⁰⁸ Neni 3.1 i Ligjit “Për masa ndaj dhunës së marrëdhëniet familjare”.

¹⁰⁹ Pjesëtarët e familjes janë parashikuar në nenin 3.7 të Ligjit.

¹¹⁰ Neni 3.2 i Ligjit “Për masa ndaj dhunës së marrëdhëniet familjare”.

Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive” ka pësuar ndryshime në vitin 2023, por nuk janë parashikuar masa konkrete për platformat dhe rrjetet sociale, ku është evidentuar gjuhë seksiste dhe gjuhë urrejtjeje e shtuar ndaj komuniteteve dhe personave të ndryshëm.

Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”¹¹¹ ka si qëllim që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë efçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë (neni 1). Pavarësisht se ligji nuk ka parashikime specifike për dhunën në hapësirën digjitale, ai përmban dispozita të qarta që janë relevante për adresimin e dhunës digjitale. Neni 101 i ligjit parashikon rregulla mbi detyrimin dhe ruajtjen e të dhënave për qëllim të ndjekjes penale. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike detyrohen të ruajnë dhe të administrojnë, për një afat 2- vjeçar, skedarët e të dhënave për pajtimtarët e tyre (neni 101.1). Parag. 2 dhe 3 të nenit 101 parashikojnë të dhënat që duhet të përmbajnë skedarët në lidhje me komunikimet zanore dhe me SMS/MMS dhe në lidhje me komunikimet në internet. Këta skedarë duhet t’u vihen në dispozicion pa vonesë, edhe në formë elektronike, autoriteteve që përcakton Kodi i Procedurës Penale, në bazë të kërkesës së tyre (neni 101.6). Ligji përmban rregulla për mbrojtjen e fshehtësisë (neni 121) dhe të konfidencialitetit të komunikimeve elektronike (neni 123) dhe për përgjimin e ligjshëm të tyre (neni 132). Sipas nenit 121.1 të ligjit, sipërmarrësit duhet të marrin masa ndaj sistemeve të komunikimeve elektronike dhe të përpunimit të të dhënave, për të mbrojtur sekretin e komunikimeve elektronike dhe të të dhënave vetjake, si dhe për të ndaluar aksesin e paautorizuar në sistemet e komunikimeve elektronike dhe të përpunimit të të dhënave.

Gjithashtu, ligji parashikon që janë të ndaluara të gjitha format e mbikëqyrjes, përgjimit, ndërprerjes, regjistrimit, ruajtjes, transferimit dhe devijimit të komunikimeve, përveç rasteve kur kjo është e nevojshme për përcjelljen e mesazheve, të faksit, të postës elektronike, të sekretarisë telefonike, mesazheve zanore, mesazheve të shkurtra apo për rastet e parashikuara me ligj (neni 123.2). Ndërsa neni 132, parashikon ligjshmërinë e përgjimit të komunikimeve elektronike.

Ligji nr. 25/2024, datë 21.3.2024 “Për sigurinë kibernetike”¹¹² parashikon të drejta dhe detyrime për subjektet publike dhe private, të cilat administrojnë infrastruktura të informacionit, rrjetet e komunikimit dhe sistemet e tyre, cenimi apo shkatërrimi i të cilave do të kishte impakt në shëndetin, sigurinë, mirëqenien ekonomike të qytetarëve dhe funksionimin efektiv të ekonomisë në Republikën e Shqipërisë (neni 1). Ligji përmban detyrime për subjektet publike dhe private, që administrojnë sisteme dhe rrjete të informacionit. Ligji e përkufizon “hapësirën kibernetike” si mjedisin digjital të aftë të krijojë, të procesojë dhe të shkëmbejë komunikimin elektronik të informacionit të krijuar nga rrjetet dhe sistemet e informacionit edhe pa qenë të lidhur në internet (neni 5.12). Neni 9, pika (j) e ligjit përmban parashikime për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve në mjedisin online. Konkretisht, parashikohet detyra e Autoritetit përgjegjës për sigurinë kibernetike për ndërmarrjen e masave të nevojshme, bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me institucionet përgjegjëse për sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve për krijimin e një mjedisi online të sigurt kibernetik në Republikën e Shqipërisë. Këto detyrime mund të shtrihen edhe për mbrojtjen e grupeve të tjera të cënueshme në hapësirë të cënueshme në hapësirën digjitale.

Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”¹¹³ rregullon përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë përdorimin dhe publikimin pa leje të të dhënave (neni 1 i ligjit). Si parim i përgjithshëm ligji parashikon që përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private (neni 2 i ligjit). Pavarësisht se ligji nuk ka parashikime specifike për hapësirën digjitale, ai përmban dispozita të qarta për

¹¹¹ Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republike e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 102, datë 24.10.2012, FZ nr.145; ndryshuar me ligjin nr. 107/2018, datë 20.12.2018, FZ nr.197.

¹¹² Ligji nr. 25/2024, datë 21.3.2024 “Për sigurinë kibernetike” është përafuar pjesërisht me Direktivën (BE) nr. 2022/2555, të Parlamentit dhe Këshillit, datë 14 dhjetor 2022, “Mbi masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë kibernetike në të gjithë Bashkimin Evropian, e cila ka ndryshuar rregulloren (BE) nr. 910/2014 dhe direktivën (BE) nr. 2018/1972, si dhe ka shfuqizuar direktivën (BE) nr. 2016/1148.

¹¹³ Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ndryshuar me ligjin nr.48/2012, datë 26.4.2012; me ligjin nr.120/2014, datë 18.9.2014; me ligjin nr.78/2023, datë 21.9.2023.

mbrojtjen e të dhënave personale, që janë relevante për adresimin e dhunës digjitale. Sipas nenit 13 të ligjit, çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, pa pagesë, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e bllokimit, korrigjimit apo të fshirjes. Kur kontrolluesi nuk bën bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të kërkuara prej tij, subjekti i të dhënave ka të drejtë të ankohet te komisioneri.

Neni 16 i ligjit garanton të drejtën e çdo personi, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, të ankohet ose të njoftojë komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Gjithashtu, sipas parashikimeve të KC, çdo individ ka të drejtën e shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga përpunimi i paligjshëm i të dhënave personale (neni 17 i ligjit).

Analiza e legjislationit shqiptar tregon që mungojnë masat e përshtatshme ligjore për luftën e dimensionit digjital të dhunë me baze gjinore. Për këtë qëllim është e nevojshme miratimi i normave të posaçme ligjore për adresimin e dimensionit digjital të dhunës me bazë gjinore.

6. Përfundime dhe sugjerime për iniciativa ligjore

Në dekadat e fundit, zhvillimi i mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe zhvillimi dhe përhapja e internetit, kanë ndryshuar rrënjësisht shoqërinë në mbarë botën. Këto zhvillime përveç përfitimeve të mëdha, kanë sjellë edhe rreziqe dhe sfida të reja për shoqërinë dhe shtetet, siç është ekspozimi i individëve me dhunën digjitale.

Studime dhe raporte të ndryshme (UNICEF, UN Women, INSTAT etj) tregojnë që dhuna në hapësirën digjitale është një fenomen shqetësues në rritje. Kjo dhunë prek në mënyrë disproporcionale gratë dhe vajzat në raport me meshkujt dhe kryesisht gratë dhe vajzat e angazhuara në jetën publikë, si gratë gazetare, politikane, aktivistet e të drejtave të njeriut etj.

Raportet e organizatave ndërkombëtare dhe evropiane sugjerojnë që, dhuna në hapësirën digjitale duhet njohur si një formë e dhunës me bazë gjinore¹¹⁴. Ato gjithashtu sugjerojnë, që për ta luftuar atë normat ligjore ekzistuese janë të pamjaftueshme, dhe për rrjedhojë nevojiten parashikime ligjore të posaçme që ti përshtaten hapësirës digjitale.

Analiza e kuadrit ligjor shqiptar tregon që nuk ka një kuadër ligjor dhe institucional të posaçëm për të adresuar DHBGJ në hapësirën digjitale. Gjithashtu, vihet re mungesa e kapaciteteve të duhura të organeve të rendit dhe drejtësisë për të trajtuar rastet e dhunës digjitale; mungesa e ndërgjegjësimit dhe edukimit të shoqërisë mbi dhunën digjitale dhe pasojat e saj; mungesa e mbështetjes së duhur për viktimat, të cilat shpesh nuk kanë informacionin e nevojshëm se si dhe ku duhet të drejtohen për ndihmë.

Me qëllim adresimin e problematikave të analizuar në këtë punim, sugjerohen ndërhyrje ligjore në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Procedurës Civile, Ligjin “Për marrjen e masave kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”. Konkretisht:

- Sugjerohet ndërhyrje në Kodi Penal në drejtim të: (i) parashikimit të përkufizimit të qartë se çfarë do të konsiderohet dhunë digjitale/kibernetike/dhunë e lehtësuar nga teknologjia; dhe (ii) kriminalizimit të formave kryesore të dhunës me bazë gjinore në hapësirën digjitale, konkretisht: ngacmimi digjital, përndjekja digjitale, keqpërdorimi i pamjeve intime pa pëlqim dhe gjuha e urrejtjes në internet. Sugjerohet të merret si model nenet 5, 6, 7 dhe 8 të Direktivës nr. 2024/1385 të BE-së.
- Ndryshime ligjore janë të nevojshme edhe në Kodin e Procedurës Penale. Sugjerohet parashikimi i normave të posaçme ligjore për me qëllim mbledhjen, analizimin dhe përdorimin e provave digjitale. Gjithashtu, duhen parashikuar urdhra të posaçëm mbrojtje për viktimat e dhunës digjitale/kibernetike. Gjithashtu, ka nevojë për rregulla të posaçme lidhur me juridiksionin e gjykatave shqiptare për rastet kur dhuna digjitale ka dimension ndërkufitar.

¹¹⁴ European Institute for Gender Equality, 58 (n 5).

- Sugjerohet ndërhyrja në Kodin e Procedurës Civile me qëllim parashikimin e dispozitave të posaçme për marrjen, ruajtjen dhe pranimin në gjykim të provave digjitale.
- Sugjerohet ndërhyrje edhe në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, me qëllim parashikimin e dimensionit digjital të dhunës në marrëdhëniet familjare. Ligji duhet të parashikojë përkufizimin e dhunës digjitale/kibernetike në marrëdhëniet familjare. Në këtë drejtim ligji duhet të standardizohet me Rekomandimin Nr. 1 të GREVIO-s si dhe me rekomandimet e fundit për shtetin Shqiptar të Grevios për dhunën digjitale. Gjithashtu, ligji duhet të parashikojë masa të përshtatura mbrojtjeje për viktimat e dhunës digjitale duke parashikuar një mjet të ri specifik për mbrojtjen nga dimensionit digjital i dhunës, si dhe masa për heqjen e përmbajtjeve të papërshtatshme online. Për këtë mund të merret si model neni 25.1(b) i Direktivës nr. 2024/1385 të BE-së.
- Është e nevojshme edhe ndërhyrja në Ligjin “Për mediat audiovizive” me qëllim parashikimin e masa konkrete për platformat dhe rrjetet sociale, ku është evidentuar gjuhë seksiste dhe gjuhë urrejtjeje e shtuar ndaj komuniteteve dhe personave të ndryshëm.
- Gjithashtu, sugjerohet që të parashikohen masa të qarta ligjore që materialet e aksesueshme publikisht online të parashikuara si vepra penale të hiqen me shpejtësi ose që qasja në to të bllokohet. Këto masa mund të jenë me natyrë penale, civile dhe administrative. Për këtë qëllim mund të transpozohet neni 23 i Direktivës nr. 2024/1385 të BE-së.

Ndërhyrjet ligjore të sugjeruara duhet të jenë të kujdeshme dhe të ruajnë balancën ndërmjet interesave konkurrues: së pari, mbrojtjen dhe promovimin e zhvillimit të hapësirës digjitale; së dyti, mbrojtjen e individit nga pasojat negative që sjell ndërveprimi i tij në hapësirën digjitale; dhe së fundi, duke treguar kujdes në garantimin e lirisë së shprehjes, si një e drejtë themelore kushtetuese.

Bibliografi

Doktrinë, raporte dhe studime

1. Dine B, Hazizaj A. *Raporti i 4-ët Kombëtar për sigurinë në internet të fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri*, CRCA Shqipëri, 2023.
2. Hinson L, Mueller J, O’Brien-Milne L, Wandera N. *Technology-facilitated gender-based violence: what is, and how do we measure it?*, International Center for Research on Women, Washington D.C, 2018.
3. Euromed Rights. *Online violence against women and girls. The scenario in the MENA Region, (An executive summary)*, 2021. Marrë nga: www.euromenrights.org (Aksesi i fundit në datë 15.6.2024).
4. European Institute for Gender Equality. *Combating Cyber Violence against Women and Girls*, 2022, Marrë nga: https://eige.europa.eu/publications-resources/publications/combating-cyber-violence-against-women-and-girls?language_content_entity=en (Aksesi i fundit në datë 19.5.2024).
5. UN Women. *Accelerating efforts to tackle online and technology-facilitated violence against Women and girls*, 2022. Marrë nga: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2022/10/accelerating-efforts-to-tackle-online-and-technology-facilitated-violence-against-women-and-girls> (Aksesi i fundit në datë 21.5.2024).
6. Toplumsal Bilgi dhe İletişim Derneği. *Türkiye’de Dijital Şiddet Araştırması*. Marrë nga: <https://dijitalsiddet.org/dijital-siddet-raporu/>, 2021, (Aksesi i fundit në datë 23.5.2024).
7. The Economist Intelligence Unit. *Methodology: measuring the prevalence of online violence against women*, 2021, Marrë nga: <https://onlineviolencewomen.eiu.com/> (Aksesi i fundit në datë 24.5.2024).
8. UN Women. *The dark side of digitalization: Technology-facilitated violence against women in Eastern Europe and Central Asia*, 2023, Marrë nga: <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2023/11/the-dark-side-of-digitalization-technology-facilitated-violence-against-women-in-eastern-europe-and-central-asia>, (Aksesi i fundit në datë 28.5.2024).
9. INSTAT. *Violence against women and girls in Albania*, 2018.

Emri i Autorit

10. Gaçanica L, Arnautoviç M. *Mekanizma mbrojtës nga dhuna online. Manual për gazetarë*. Instituti Shqiptar i Medias, 2018.
11. UNICEF. *Eksperiencat e fëmijëve në përdorimin e Internetit në Shqipëri*, 2019.
12. Material Shpjegues i Këshillit të Evropës “Konventa e Stambollit bazohet në 4 shtylla”. Marrë nga: <https://rm.coe.int/coe-istanbulconvention-brochure-sqi-r03-v01/1680a135ff>, (Aksesi i fundit në datë 20.6.2024).
13. Raport i Avokatit të Popullit “Mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën janar 2020-shtator 2021”, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, dhjetor 2021.
14. Van der Wilk, A. *Protecting women and girls from violence in the digital age: the relevance of the Istanbul Convention and the Budapest Convention on Cybercrime in addressing online and technology-facilitated violence against women*, 2021.
15. Web Factor. *Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe gatishmërisë institucionale për trajtimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në hapësirën kibernetike në Shqipëri*, 2019, Marrë nga: <https://www.unicef.org/albania/sq/deklarata-shtypi/faktori-web-vler%C3%ABsimi-i-kuadrit-ligjor-dhe-gatishm%C3%ABris%C3%AB-institucionale-p%C3%ABr> (Aksesi i fundit në datë 23.6.2024)
16. Policy Department for Citizens’ Rights and Constitutional Affairs Directorate-General for Internal Policies. *The legislative frameworks for victims of gender-based violence (including children) in the 27 Member States*, 2022. Marrë nga: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2022/738126/IPOL_STU\(2022\)738126_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2022/738126/IPOL_STU(2022)738126_EN.pdf). (Aksesi i fundit në datë 25.6.2024).
17. T. Popa, G. *Study on the national situation of cyberbullying in Romania, Universitatea de Medicină și Farmacie*. Marrë nga: https://tecpc.grant.umfiasi.ro/wp-content/uploads/2022/11/IO1_Country-Report_RO_final.pdf (Aksesi i fundit në datë 15.6.2024).
18. OSBE. *Sondazhi për dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut, “Mirëqenia dhe siguria e grave”*, 2019.

Legjislacion

Legjislacion i Republikës së Shqipërisë

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, FZ nr. 28/1998; ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007, FZ nr. 2/2007; ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008, FZ nr. 61/2008; ligjin nr. 88/2012, FZ nr. 132/2012; ligjin nr. 137/2015, FZ nr. 219/2015; dhe ligjin nr. 76/2016, FZ nr. 138/2016.
2. Kodi Penal i Republikës Së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995; ndryshuar me: ligjet nr. 8175, datë 23.12.1996; nr. 8204, datë 10.4.1997; nr. 8279, datë 15.1.1998; nr. 8733, datë 24.1.2001; nr. 9017, datë 6.3.2003; nr. 9030, datë 13.3.2003; nr. 9086, datë 19.6.2003; nr. 9188, datë 12.2.2004; nr. 9275, datë 16.9.2004; nr. 9686, datë 26.2.2007; nr. 9859, datë 21.1.2008; nr. 10 023, datë 27.11.2008; nr. 23/2012, datë 1.3.2012; nr. 144, datë 2.5.2013; nr. 98, datë 31.7.2014; nr. 176/2014, datë 18.12.2014; nr. 135/2015, datë 5.12.2015; nr. 82/2016, datë 25.7.2016; nr. 36/2017, datë 30.3.2017; nr. 89/2017, datë 22.5.2017; nr. 44/2019, datë 18.7.2019, nr. 35/2020, datë 16.4.2020, nr. 146/2020, datë 17.12.2020; nr. 43/2021, datë 23.3.2021; vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 13, datë 29.5.1997; nr. 46, datë 28.8.1997; nr. 58, datë 5.12.1997; nr. 65, datë 10.12.1999; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 19, datë 1.6.2011; nr. 47, datë 26.7.2012; nr. 9, datë 26.2.2016; nr. 24, datë 4.5.2021; nr. 20, datë 3.4.2024.
3. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, ndryshuar me ligjet nr. 8536, datë 18.10.1999, nr. 8781, datë 3.5.2001, nr. 17/2012, datë 16.2.2012, nr.121/2013, datë 18.4.2013, nr.113/2016, datë 3.11.2016; VGJK nr. 69, datë 27.12.2023.
4. Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, ndryshuar me ligjet nr. 8085, datë 13.3.1996; nr.9125, datë 29.7.2003; nr. 10 053, datë 29.12.2008; nr. 136/2015, datë 5.12.2015.
5. Kodi i Procedurës Penale, miratuar me ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 ndryshuar me ligjet nr. 7977, datë 26.7.1995, 8027, datë 15.11.1995, nr. 8180, datë 23.12.1996, nr. 8460, datë 11.2.1999, nr. 8570, datë

- 20.1.2000, nr.8602, datë 10.4.2000, nr. 8813, datë 13.6.2002, nr.9085, datë 19.6.2003, nr. 9187, datë 12.2.2004, nr. 9276, datë 16.9.2004, nr. 9911, datë 5.5.2008, nr. 10 054, datë 29.12.2008, nr. 145/2013, datë 2.5.2013, nr. 21/2014, datë 10.3.2014, nr.99/2014, datë 31.7.2014, nr. 35/2017, datë 30.3.2017; nr. 147/2020, datë 17.12.2020; nr. 41/2021, datë 23.3.2021, vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 55, datë 21.11.1997, nr. 15, datë 17.4.2003; nr.5, datë 6.3.2009 dhe nr. 31, datë 17.5.2012.
6. Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, ndryshuar me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, nr.10 329, datë 30.9.2010, 47/2018, datë 23.7.2018.
 7. Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ndryshuar me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020.
 8. Ligji nr. 9669, datë 18.12. 2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr.10 329, datë 30.9.2010, 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020.
 9. Ligji nr. 18/2017, datë 23.2.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”.
 10. Ligji nr. 29/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.
 11. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republike e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 102, datë 24.10.2012, FZ nr.145; ndryshuar me ligjin nr. 107/2018, datë 20.12.2018, FZ nr.197.
 12. Ligji nr. 25/2024, datë 21.3.2024 “Për sigurinë kibernetike”.
 13. Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ndryshuar me ligjin nr.48/2012, datë 26.4.2012; me ligjin nr.120/2014, datë 18.9.2014; me ligjin nr.78/2023, datë 21.9.2023.
 14. Ligji nr. 111/2017, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
 15. Strategjia Kombëtare Për Sigurinë Kibernetike, 2020-2025, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1084, datë 24.12.2020, FZ. Nr. 7/2021.
 16. Strategjia Kombëtare Për Barazinë Gjinore 2021-2030, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 30.6.2021.
 17. Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 14/2024, datë 8.2.2024 “Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë”,

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB)

1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948.
2. Pakti Ndërkombëtar Për të Drejtat Civile dhe Politike është ratifikuar nga Shqipëria në datë 4.9.1991.
3. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, ratifikuar nga RSH 11.05.1994.
4. UN Human Rights Council Resolution On the Promotion, Protection, and Enjoyment of Human Rights on the Internet, 2016.

Këshilli i Evropës

1. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.
2. Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit).
3. GREVIO General Recommendation No. 1 On the Digital Dimension of Violence Against Women.
4. Konventa e Këshillit të Evropës “Për krimin në fushën e kibernetikës”, ratifikuar me ligjin nr. 8888, datë 25.4.2002 “Për ratifikimin e Konventës për krimin në fushën e kibernetikës”.
5. Strategjia e Barazisë Gjinore e Këshilli të Evropës, 2018-2023.

Bashkimi Evropian

1. Regulation (EU) 2016/679 of the European Parliament and of the Council of 27 April 2016 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data and on the free movement of

Emri i Autorit

- such data, and repealing Directive 95/46/EC (General Data Protection Regulation), *OJ L 119*, 4.5.2016, p. 1–88
2. Directive (EU) 2024/1385 of the European Parliament and of the Council of 14 May 2024 on combating violence against women and domestic violence, *OJ L*, 2024/1385, 24.5.2024.
 3. Directive 2011/99/EU of the European Parliament and of the Council of 13 December 2011 on the European protection order, *OJ L 338*, 21.12.2011, f. 2–18
 4. Directive 2012/29/EU of the European Parliament and of the Council of 25 October 2012 establishing minimum standards on the rights, support and protection of victims of crime, and replacing Council Framework Decision 2001/220/JHA, *OJ L 315*, 14.11.2012, p. 57–73.
 5. Directive 2011/93/EU of the European Parliament and of the Council of 13 December 2011 on combating the sexual abuse and sexual exploitation of children and child pornography, and replacing Council Framework Decision 2004/68/JHA, *OJ L 335*, 17.12.2011, p. 1–14
 6. Directive 2000/31/EC of the European Parliament and of the Council of 8 June 2000 on certain legal aspects of information society services, in particular electronic commerce, in the Internal Market ('Directive on electronic commerce'), *OJ L 178*, 17.7.2000, p. 1–16
 7. Startegjia e BE-së Për Barazinë Gjimore, 2020-2025.

Jurisprudencë e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

2. Çështja Volodina v. Russia, nr. aplikimi 40419/19, datë 14.9.2021.
3. Çështja Buturunga v. Romania, nr. aplikimi 56867/15, datë 11.02.2020.
4. Çështja K.U. v. Finland, nr. aplikimi 2872/02, datë 2.12.2008.

VENDIMET E GJYQTARIT TË HETIMEVE PARAPRAKE, TË GJYQTARIT TË SEANCËS PARAPRAKE DHE TË GJYQTARIT TË THEMELIT

Olti SKRAME*

COURT DECISIONS DURING THE PRELIMINARY INVESTIGATION PHASE, DURING THE PRELIMINARY HEARING PHASE AND DURING THE TRIAL PHASE

Abstract

The principle of due process includes, among other elements, the right to a reasoned judicial decision. The function of a reasoned decision is to show the parties that they have been heard, as well as to give them the opportunity to challenge the decision, through means of appeal.

The judicial decision must be in accordance with the law, as well as with the rules of logic and common sense. Therefore, its reasoning is a decisive mean to verify the fulfillment of these requirements.

Decisions during the preliminary investigation phase, during the preliminary hearing phase and during the trial phase, must adhere to the general criteria applicable to all decisions. In addition to these, each type of decision is characterized by specific features defined by the criminal procedural law, but also by interpretations made over the years by the Supreme Court, the Constitutional Court and the High Judicial Council.

In relation to the reasoning regarding the individualization of security measures in each specific case, Article 229 of the Criminal Procedure Code lists three criteria. The first is the criterion of suitability, which is related to the degree of security needed. The second is the criterion of the fair ratio (proportionality criterion) between the measure, the importance of the fact and the punishment foreseen for the specific criminal offense. The third is the criterion of individuality, as it takes into account several elements related to the subject and its dangerousness.

Further to these, the level of proofs varies according to the stages of the criminal process. The level of reasoning that must be carried out by the court, in its decisions, varies according to the same stages.

In the preliminary investigation stage, which also includes decisions regarding security measures, the law requires reasonable doubt based on evidence. In the preliminary hearing stage, sufficiency of evidence in support of the charge is required. In the trial stage (in the court hearing), certainty regarding the charge is required, which must be beyond any reasonable doubt, as to allow the court to declare the defendant guilty.

Keywords: *Principle of due process; reasoned judicial decision; criterion of suitability; criterion of the fair ratio (proportionality criterion); criterion of individuality; doubt based on evidence; sufficiency of evidence in support of the charge; certainty regarding the charge*

1. Hyrje

Parimi i procesit të rregullt gjyqësor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore, nuk është element fakultativ, apo diskrecional i gjykatave. Detyrimi për arsyetim është i parashikuar në Kushtetutë dhe në K.P.Penale (*neni 112, pika 3*). Funkzioni i një vendimi të

* Gjyqtar, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Emri i Autorit

arsyetuar është t'u tregojë palëve që janë dëgjuar, si dhe t'u japë mundësi për të kundërshtuar vendimin, nëpërmjet mjeteve të ankimit.

Pavlefshmëria e vendimit për shkak të mosarsyetimit të tij, është rrethanë që sjell prishjen e vendimit të paarsyetuar dhe dërgimin e çështjes sërish për rigjykim, në gjykatën ku është konstatuar shkelja procedurale¹.

Vendimi gjyqësor duhet të jetë në përputhje me ligjin, si dhe me rregullat e logjikës dhe të mendimit të shëndoshë. Ndaj, arsyetimi i tij është mjet vendimtar për të verifikuar plotësimin e këtyre kërkesave².

Vendimet e gjyqtarit gjatë fazës së hetimeve paraprake, gjatë fazës së seancës paraprake dhe gjatë fazës së seancës gjyqësore, duhet t'u përmbahen kriterëve të përgjithshme të zbatueshme për të gjitha vendimet. Tejtë, secili lloj vendimi karakterizohet nga veçanti të cilat parashikohet nga ligji procedural penal, por edhe nga interpretimet e bëra ndër vite nga Gjykata e Lartë, nga Gjykata Kushtetuese dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Në vijim të këtij materiali paraqiten shkurtime të disa nga veçoritë e tri llojeve të vendimeve të sipërpërmendura, duke u përqëndruar te praktikata e mira, në lidhje me arsyetimin e vendimeve. Të tilla praktika tejkalojnë kërkesat minimale që parashikon ligji, e kanë për synim përmirësimin e nivelit të hartimit të vendimeve gjatë hetimeve paraprake, gjatë seancës paraprake dhe gjatë seancës gjyqësore. Ato kanë për qëllim hartimin e vendimeve që janë jo vetëm të sakta në aspektin teknik, por edhe të lehta për t'u kuptuar dhe zbatuar.

2. Karakteristika të vendimeve gjyqësore gjatë fazës së hetimeve paraprake.

2.1 Vendimet për caktimin e masave të sigurimit

Numrin më të lartë të vendimeve gjyqësore gjatë fazës së hetimeve paraprake e përbëjnë vendimet për caktimin e masave të sigurimit. Referuar nenit 245 të K.P.Penale, vendimi që cakton masën e sigurimit duhet të përmbajë detyruesisht, me pasojë pavlefshmërie, elementet vijues:

a) gjeneralitetet e personit ndaj të cilit merret masa, ose çdo të dhënë tjetër që vlen për ta identifikuar dhe kur është e mundur, edhe tregimin e vendit ku ky person ndodhet;

b) parashkrimin përmbledhës së fakteve të rastit, si dhe nenet që konsiderohen të shkelura nga gjykata;

c) parashkrimin e shkaqeve të posaçme dhe të të dhënave që përlligjin masën e sigurimit të caktuar;

ç) parashkrimin e shkaqeve përse nuk janë marrë parasysh nga gjykata pretendimet e parashtruara nga mbrojtja, si dhe kur caktohen masat e sigurimit shtrënguese të parashikuara nga nenet 237, 238 dhe 239 të K.P.Penale³, shkaqet e papërshtatshmërisë së masave të tjera të sigurimit;

d) kohëzgjatjen e masës, kur kjo është caktuar për të garantuar marrjen, ose vërtetësinë e provës, në kuptim të nenit 228, pika 3, shkronja "a", të K.P.Penale;

dh) datën, nënshkrimin e gjyqtarit, nënshkrimin e sekretarit gjyqësor dhe vulën e gjykatës;

e) kur vendimi jepet për disa persona, gjykata disponon me një vendim të vetëm, por duke arsyetuar kushtet dhe kriteret për secilin prej tyre.

Në çdo fazë të procedimit, kërkesa e paraqitur nga ana e prokurorit dhe vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, duhet të motivohen dhe të argumentojnë konkretisht nevojën e sigurimit, ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme të rrezikut, pra të mundësisë reale që të ndodhë (*id quod plerumque accidit*) vënia në rrezik e procesit të të provuarit, nga ana e të pandehurit.

Përfundimi i gjykatës lidhur me gjendjen e rrezikut, arrihet bazuar në tërësinë e rrethanave të faktit e të ligjit, që e sjellin në përfundimin mbi ekzistencën e kësaj gjendje, e cila pengon, ngadalëson, apo devijon në mënyrë të parregullt, procesin e të provuarit dhe vërtetimin e rrethanave të faktit, të lidhura me procedimin, në kuadër të garantimit të procesit të dhënies së drejtësisë, e që justifikon caktimin dhe zbatimin e masës së sigurimit⁴.

¹ Vendimi nr. 533 (17), datë 15.07.2021, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

² Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 55, datë 18.12.2012; nr. 33, datë 08.06.2016; nr. 57, datë 27.07.2016; nr. 16, datë 01.03.2017; nr. 60, datë 31.07.2017 etj.

³ Këto dispozita parashikojnë masat e sigurimit personal "arresti në shtëpi", "arresti në burg" dhe "shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik".

⁴ Vendimi nr. 360, datë 23.12.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Këto vlerësime i përkasin dhe janë detyrë ekskluzive e gjyqtarit të cilit i është kërkuar caktimi i masës shtrënguese. Vendimi duhet të plotësojë dy kërkesa: *së pari*, paraqitjen e arsyeve të rëndësishme, që kanë ndikuar në marrjen e tij; *së dyti*, përputhshmërinë e argumenteve, me justifikimin e caktimit të masës shtrënguese⁵.

Sipas vendimit unifikues nr. 1, datë 08.01.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjykata duhet të shqyrtojë në seancë gjyqësore dhe mandej të parashikojë në vendim, të gjitha rrethanat e lidhura me ekzistencën ose jo të interesit publik real, që justifikon zbatimin e një mase sigurimi. Për çdo periudhë paraburgimi, pavarësisht sa e shkurtër, gjykata duhet të parashtrijë motive të besueshme që ta justifikojnë⁶.

Gjithashtu, gjykata nuk mund të mjaftohet në arsyetimin e vendimit për caktimin e masës, thjesht e vetëm në perifrazime standarde, referuese mbi dispozitat e K.P.Penale, që parashikojnë kushtet e kriteret për caktimin e masave të sigurimit, pa arsyetuar në mënyrë ezauruese se si e përse ato gjejnë zbatim, në çështjen konkrete⁷. Në arsyetimin e vendimit të gjykatës, duhet të analizohen në mënyrë shtrënguese e reale, motivet konkrete të pranimit ose jo, të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit dhe jo të bëhet përkthim formal i shkaqeve e kriterëve të parashikuara nga ligji⁸.

Në dhënien e vendimit, gjykata duhet të mbajë parasysh rrethanat e çështjes konkrete, të lidhura me kushtet e kriteret e parashikuara në ligj, mbi caktimin e masave të sigurimit⁹.

Gjykata duhet të hetojë, në gjendjen që është procedimi, në drejtim të personalitetit të të pandehurit, nëse ka precedentë penalë, mënyrën e jetesës së tij, vendin dhe rrethanat të cilat e kanë sjellje në kryerjen e veprës, rrethanat lidhur me natyrën, llojin, mjetet, kohën, vendin e mënyrën e kryerjes së veprës penale, llojin dhe shkallën e pasojave të ardhura nga kryerja e veprës, llojin e shkallën e fajësisë dhe motivet për kryerjen e veprës, sjelljen e autorit si para ashtu dhe pas kryerjes së veprës, si dhe rrethanat e tjera të jetës individuale, familjare e sociale të tij¹⁰.

Kur shqyrton kërkesat për caktim mase sigurimi, gjykata nuk ka detyrim që të analizojë përse llojet e tjera të masave të sigurimit nuk janë të përshtatshme. Mjafton që të argumentojë se masa e caktuar prej saj në rastin konkret, është e përshtatshme. Në çdo rast, mbetet detyrim i gjykatës që, të argumentojë se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, në ngarkim të të gjykuarit, për kryerjen nga ana e tij të veprës penale.

Edhe kur vendos caktimin e masës së sigurimit “arresti në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.P.Penale, gjykata nuk ka detyrim të analizojë në hollësi, përse llojet e masave të tjera nuk janë të përshtatshme në rastin konkret.

Në lidhje me arsyetimin në drejtim të individualizimit të masave të sigurimit në çdo rast konkret, duhet mbajtur parasysh se, neni 229 i K.P.Penale rendit tri kriteret.

I pari është kriteri i përshtatshmërisë, që lidhet me shkallën e nevojave të sigurimit (*pika 1, e nenit 229 të K.P.Penale*). Ky kriter ka të bëjë sidomos me numrin dhe volumin e provave, për sigurimin e të cilave kërkohet caktimi i masës së sigurimit, ose me shfaqjen nga ana e subjektit, të tendencave negative ndikuese, në hetim apo gjykim.

I dyti është kriteri i raportit të drejtë (kriteri i proporcionalitetit) mes masës, rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete. Ky kriter ka të bëjë me kualifikimin e saktë të faktit penal dhe me nxitjen për largim që i jep subjektit, vepra për të cilën hetohet ose akuzohet, në referim të masës dhe llojit të dënimit që mund të caktohet ndaj tij.

I treti është kriteri i veçantisë individuale, pasi merren parasysh disa elemente që lidhen me subjektin dhe me rrezikshmërinë e tij. Ky kriter zbatohet duke pasur parasysh vazhdimësinë në kryerjen e pretenduar të veprës, përsëritjen eventuale të saj, si dhe rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese (*pika 2, e nenit 229 të K.P.Penale*).

⁵ Vendimet nr. 164 (3), datë 11.01.2022 dhe nr. 1751, datë 23.12.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

⁶ *Neumeister kundër Austrisë*, datë 27.06.1968 dhe *Belchev kundër Bullgarisë*, datë 06.02.2003.

⁷ *Sarban kundër Moldavisë*, datë 04.10.2005.

⁸ *Mansur kundër Turqisë*, datë 08.06.1995 dhe *Smirnov kundër Rusisë*, datë 07.06.2007.

⁹ *Garcia Alva kundër Gjermanisë*, datë 13.02.2001.

¹⁰ Vendimi unifikues nr. 7, datë 14.10.2011, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Emri i Autorit

Duke vijuar më tej, duhet mbajtur parasysh edhe se, niveli i provueshmërisë ndryshon sipas fazave të procesit penal. Për pasojë, edhe niveli i arsyetimit që duhet të kryhet nga gjykata, në vendimet e saj, ndryshon sipas së njëjtave faza.

Në fazën e hetimeve paraprake, ku përfshihen edhe vendimarrjet për caktim masash sigurimi, ligji mjaftohet me dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova, pra niveli i kërkuar është ai i arsyeshmërisë. Në fazën e seancës paraprake, nuk kërkohet bindje mbi fajësinë e të pandehurit, por mjaftueshmëri e provave në mbështetje të akuzës. Mandej, në fazën e gjykimit në themel (në seancën gjyqësore) kërkohet detyrimisht siguri sa i takon akuzës, e cila duhet të jetë tej çdo dyshimi të arsyeshëm, për të mundësuar deklarinimin fajtor të të pandehurit.

2.2 Vendimi për lejimin e marrjes së provave

Lloj tjetër vendimesh që haset rëndom në fazën e hetimeve paraprake, është ai për lejimin e marrjes së provave, përmes zbatimit të mjeteve të kërkimit të tyre. Në mënyrë të posaçme rëndësi kanë vendimet lidhur me lejimin e përgjimeve, si dhe vendimet për lejimin ose miratimin e sekuestrimeve.

Për lejimin e përgjimeve në procedimin penal, janë të nevojshme disa kushte themelore, mosrespektimi i të cilave, sjell papërdorshmërinë e rezultateve të përfuara nga përgjimet. Këto kushte, që përbëjnë njëherazi edhe kërkesa të domosdoshme për arsyetimin e vendimit të gjykatës, janë:

- a) përcaktimi i qartë i kufirit të dënimit të veprës penale për të cilën procedohet, pra nëse bëhet fjalë për një vepër penale për të cilën ligji lejon përgjimin, si mjet kërkimi prove;
- b) subjekti i legjitimuar për të kërkuar disponimin e përgjimeve;
- c) subjekti që disponon përgjimet;
- ç) subjekti i interesuar;
- d) akti i motivuar që disponon mbi përgjimet;
- dh) përcaktimi i llojit të përgjimeve dhe i objektit të tyre;
- e) parashtrimi i arsyeve të domosdoshmërisë së përgjimit për vazhdimin e hetimeve;
- ë) procedura e përgjimit, kohëzgjatja dhe ekzekutimi i vendimit;
- f) dokumentimi i veprimeve interceptive;
- g) përcaktimi i së drejtës së ankimit dhe i të drejtës së palëve për t'u konsultuar me rezultatet e përgjimeve, brenda hapësirës që lejon ligji¹¹.

Në lidhje me sekuestrimet, rëndësi të veçantë për temën e këtij punimi, ka sekuestrimi i të dhënave kompjuterike. Parimet e domosdoshmërisë, të përshtatshmërisë dhe të proporcionalitetit duhet të udhëheqin gjykatën, në marrjen e vendimit për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike dhe në parashikimin e modaliteteve për këtë sekuestrim¹².

Lidhur me parimin e domosdoshmërisë, është e nevojshme të arsyetohet se, përse të dhënat e lejuara të sekuestrohen, janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve penale. Duhet të tregohet gjithmonë ekzistenca e një vepre që dyshohet se është kryer, duke qenë se, vetëm në këtë mënyrë mund të verifikohet nevoja e sekuestrimit dhe përkatësia provuese e të dhënave me veprën penale.

Duhet arsyetuar nga ana e gjykatës se, përse për vërtetimin e kësaj vepre penale është e domosdoshme vendosja e sekuestros mbi të dhënat kompjuterike. Në nenin 208 të K.P.Penale, ligji ka përdorur termin “domosdoshmëri” dhe jo “nevojë”. Kjo do të thotë se, arsyetimi i gjykatës duhet të shtrihet në drejtim të vërtetimit të lidhjes së të dhënave kompjuterike për të cilat kërkohet sekuestrimi, me vërtetimin e faktit penal, si dhe se, ky vërtetim mund të bëhet vetëm nëpërmjet sekuestrimit të të dhënave kompjuterike, pa të cilat nuk mund të arrihet në njoftimin mbi ekzistencën e faktit.

Pasi të përmbushet ky kriter, gjykata duhet të përcaktojë cilat janë të dhënat, ose sistemet kompjuterike, që do t'i nënshtrohen sekuestrimit dhe çfarë synohet të provohet nëpërmjet vendosjes së sekuestros mbi këto. Lejimi i sekuestrimit të të dhënave jo të domosdoshme, konsiderohet shkelje ligjore.

¹¹ Vendimi nr. 329, datë 09.12.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹² Vendimi njëses nr. 1135 (147), datë 23.12.2021, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe atë të përshtatshmërisë, jo vetëm që duhet të përzgjidhen ato sisteme kompjuterike në të cilat përmbahen të dhënat e veçuara si të domosdoshme, por ndër këto sisteme kompjuterike, nëse ekziston mundësia, do të përzgjidhen ato, sekuestrimi i të cilave cenon më pak të drejtat e personit të cilit i përkasin sistemet. Gjithashtu, sekuestrimi i të dhënave dhe në mënyrë të veçantë i sistemeve kompjuterike, do të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme në vërtetimin e fakteve, duke u parashikuar se, proporcionaliteti lidhet me kohëzgjatjen e kufizimit, e cila vlerësohet sipas një kriteri kohor të arsyeshëm¹³. Në vendimin e gjykatës nuk duhet të mungojë as parashikimi mbi modalitetet për sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike¹⁴.

Në sintezë, së pari, gjykata duhet të argumentojë se, cila është vepra penale që në mënyrë të arsyeshme dyshohet se është kryer. Së dyti, duhet të arsyetojë përse sekuestrimi i të dhënave ose sistemeve kompjuterike është i domosdoshëm për zgjidhjen e çështjes.

Së treti, duhet të përcaktojë se, cilat janë të dhënat ose sistemet kompjuterike që do t'i nënshtrohen sekuestrimit dhe çfarë synohet të provohet nëpërmjet vendosjes së sekuestros mbi to. Së katërti, duhet të përcaktojë modalitetet për sekuestrimin e të dhënave, ose të sistemeve kompjuterike¹⁵.

3. Karakteristika të vendimeve gjyqësore gjatë fazës së seancës paraprake

Sipas nenit 332/e të K.P.Penale, vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq, i cili jepet në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë paraprake, duhet të përmbajë:

- a) gjeneralitetet e të pandehurit dhe të dhëna të tjera që vlejné për identifikimin e tij, si dhe gjenealitetet e palëve private dhe të mbrojtësve të tyre;
- b) gjeneralitetet e viktimës;
- c) parashtrimin e faktit penal, duke treguar dispozitat përkatëse të ligjit penal material;
- ç) burimet e provës dhe faktet të cilave ato iu referohen;
- d) dispozitivin, duke treguar edhe gjykatën kompetente për gjykimin e çështjes;
- dh) adresën e të pandehurit, të viktimës, ose të trashëgimtarëve të saj, si dhe të palëve të tjera;
- e) datën dhe nënshkrimin e gjyqtarit dhe të sekretarit gjyqësor.

Vendimi është i pavlefshëm kur i pandehuri nuk identifikohet me saktësi, ose kur mungojnë, ose janë të pamjaftueshme, parashtrimi i faktit penal dhe i rrethanave të tij, përfshirë dispozitat përkatëse.

Detyrë e gjyqtarit të seancës paraprake është të verifikojë nëse çështja është gati për gjykim, pra nëse hetimet janë të plota dhe nëse akuza është ngritur drejtë. Provueshmëria e kësaj akuze, nga ana tjetër, është çështje që i përket gjyqtarit të themelit. Fajësia ose jo e të pandehurit provohet vetëm në fund të shqyrtimit gjyqësor, pasi janë debatuar provat në bazë të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, debat dhe shqyrtim gjyqësor që i mungon gjyqtarit të seancës paraprake¹⁶.

4. Karakteristika të vendimeve gjyqësore gjatë fazës së seancës gjyqësore

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata jep vendimin, në arsyetimin e së cilit duhet të përcaktohen:

- a) gjykata që e ka dhënë;
- b) gjeneralitetet e të pandehurit, ose të dhëna të tjera personale që vlejné për ta identifikuar, si dhe gjenealitetet e palëve private;
- c) akuza;

¹³ *Smirnov kundër Ruisë*, datë 07.06.2007 dhe *Draghici kundër Portugalisë*, datë 19.06.2014.

¹⁴ *Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 27.03.1996 dhe *Roemen dhe Schmit kundër Luksemburgut*, datë 25.05.2003.

¹⁵ Vendimi njësuës nr. 1135 (147), datë 23.12.2021, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹⁶ Vendimet nr. 77, datë 08.03.2022 dhe nr. 641, datë 12.05.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Emri i Autorit

- ç) parashtrimi i përmbledhur i rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta;
- d) dispozitivi, përfshirë nenet e zbatuara të ligjit penal material dhe procedural;
- dh) data dhe nënshkrimi i anëtarëve të trupit gjykues.

Vendimi është i pavlefshëm kur mungon dispozitivi, ose nënshkrimi i anëtarëve të trupit gjykues, si dhe kur ka haptazi kontradiktë mes arsytimit dhe dispozitivit (*nenet 382 dhe 383 të K.P.Penale*).

Një nga elementet vendimtare të vendimit, është përcaktimi i provave mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe i vërtetësisë së tyre. Për të patur proces ligjor çmuarje të tyre duhet së pari, verifikimi nga ana i gjykatës i faktit nëse rrethana apo objekti material që paraqitet nga pjesëmarrësit e procesit penal si provë, është administruar konform kërkesave të ligjit dhe së dyti, verifikimi se ku konsiston lidhja e rrethanës apo e objektit material, me objektin e të provuarit.

Kjo lidhje përbëhet nga përgjigjet që duhet t'u japë gjykata shtatë pyetjeve: çfarë ka ndodhur?, ku ka ndodhur?, kur ka ndodhur?, me ç'mjet është kryer?, si ka ndodhur?, kush e ka kryer? dhe pse e ka kryer veprën?, përgjigje të cilat duhet të përbëjnë shtratin mbi të cilin duhet ndërtuar pjesa përshkruese - arsyetuese e çdo vendimi gjyqësor penal¹⁷.

Dhënia e dënimit nga gjykata udhëhiqet nga parimi i individualizimit të dënimit, sipas nenit 47 të Kodit Penal që parashikon se, *“në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”*. Sipas kësaj dispozite, gjykata në caktimin e dënimit merr në konsideratë dhe arsyetën rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, formën dhe shkallën e fajit me të cilën është konsumuar vepra penale, si dhe ekzistencën e rrethanave lehtësuese dhe rënduese. Marzhi i dënimit i lihet në diskrecion gjykatës, por ajo ka detyrimin të argumentojë dhënien e dënimit referuar kritereve të nenit 47 të Kodit Penal. Parimi i individualizimit, në thelb, përmban proporcionalitetin mes veprës penale dhe dënimit që caktohet ndaj autorit të saj.

Që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën¹⁸. Dhënia e një dënimi joproporcional ndaj të gjykuarit nuk mundëson realizimin e funksionit rehalibilitues të përgjithshëm dhe të posaçëm që ka dënimi penal¹⁹.

5. Praktikrat e mira në hartimin e vendimeve gjyqësore, sipas KLGJ-së

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar dy vendime, përmes së cilave ka detajuar elementet që duhet të mbahen parasysh nga gjyqtarët, në hartimin e vendimeve gjyqësore: I) vendimin nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe II) vendimin nr. 264, datë 21.11.2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”.

Sipas tyre, në vendim duhet të identifikohet qartë natyra e çështjes, faktet e çështjes, ligji i zbatueshëm dhe eventualisht, konflikti i normave. Rëndësi vendimtare ka interpretimi i ligjit, si dhe identifikimi dhe arsyetimi lidhur me zbatimin e ligjit mbi faktet objekt gjykimi. Referimi formal i ligjit, i pashoqëruar me analizë të dispozitave, i raportit midis tyre dhe i zbatimit mbi rrethanat e faktit, është tregues i mungesës së aftësive për të interpretuar ligjin.

Rëndësi ka gjithashtu, aftësia e gjyqtarit për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale, që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes, pavarësisht përmendjes së tyre shprehimisht në vendim. Mandej, në vendim duhet të ketë analizë të jurisprudencës, në formën e kërkimit, identifikimit, organizimit dhe përdorimit të saj.

Vlerë të shtuar merr mënyra si gjyqtari identifikon praktikën gjyqësore vendase dhe ndërkombëtare, në mbështetje të një interpretimi të caktuar, si dhe si përdor dhe krahason burimet jurisprudenciale nga sistemi ligjor vendas dhe nga sistemet e tjera. Në veçanti, nëse gjyqtari i referohet dhe menaxhon me efikasitet praktikën e konsoliduar gjyqësore; praktikën e unifikuar apo të njësuar të Gjykatës së Lartë; praktikën e Gjykatës Kushtetuese;

¹⁷ Vendimi nr. 25, datë 15.01.2003, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹⁸ Vendimi nr. 3, datë 02.11.2015, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

¹⁹ Vendimi nr. 642 (19), datë 26.07.2021, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

atë të GJEDNJ-së; si dhe “të gjithë jurisprudencën, edhe në rastet kur ajo nuk përbën burim të së drejtës [?], por i shërben interpretimit të ligjit në kuadër të përafrimit të legjislacionit” (citim).

Vendimi duhet të jetë i qartë, konciz dhe i kuptueshëm. Si i tillë vlerësohet vendimi që ka lehtësi në kuptueshmëri dhe lexueshmëri. Vlerë ka përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës; shprehja e mendimit qartë dhe me sa më pak fjalë; zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe i atyre të sintaksës; përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip, sidomos i shkronjave “ë” dhe “ç”; përdorimi i paragrafëve; qartësia e strukturës së fjalisë; si dhe përdorimi në mënyrë korrekte i termave teknike.

Vendimi duhet të përmbajë strukturë të qartë, të qëndrueshme, të mirëorganizuar, të cilës gjyqtari i përmbahet gjatë prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura prej tij. Në veçanti, vlerësohet zbatimi i një strukture me pjesë përbërëse të vendimit, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit.

Vendimi duhet të shfaqë analizë dhe argumentim logjik. Në këtë drejtim vlerësohet cilësia e analizës mbi bazën e zhvillimit logjik të koncepteve ligjore.

Argumentimi logjik nënkupton aftësinë e gjyqtarit për të identifikuar marrëdhëniet shkak - pasojë, si dhe për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen mes tyre, si dhe si zbatohen në një situatë të caktuar. Vendimi duhet të ketë përmbajtje gjithëpërfshirëse, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve

Në sintezë, përmes vendimeve, gjykata duhet të tregojë se është në gjendje të komunikojë në mënyrë efektive. Komunikimi efektiv shfaqet në shprehjen në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe koncize, me palët dhe me publikun.

BIBLIOGRAFI

Legjislacion

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (*ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, i ndryshuar*).
2. KEDNJ-ja dhe protokollet e saj nr. 1 deri nr. 16, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, të ndryshuar.
3. Kodi i Procedurës Penale (*ligji nr. 7905, datë 21.03.1995, i ndryshuar*).
4. Kodi Penal (*ligji nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar*).

Jurisprudencë

1. Vendimi nr. 38, datë 30.12.2010, i Gjykatës Kushtetuese.
2. Vendimi nr. 52, datë 05.12.2012, i Gjykatës Kushtetuese.
3. Vendimi nr. 55, datë 18.12.2012, i Gjykatës Kushtetuese.
4. Vendimi nr. 1, datë 06.02.2013, i Gjykatës Kushtetuese.
5. Vendimi nr. 33, datë 08.06.2016, i Gjykatës Kushtetuese.
6. Vendimi nr. 57, datë 27.07.2016, i Gjykatës Kushtetuese.
7. Vendimi nr. 16, datë 01.03.2017, i Gjykatës Kushtetuese.
8. Vendimi nr. 60, datë 31.07.2017, i Gjykatës Kushtetuese.
9. *Neumeister kundër Austrisë*, datë 27.06.1968.
10. *Agosi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 24.10.1986.
11. *Mansur kundër Turqisë*, datë 08.06.1995.
12. *Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 27.03.1996.
13. *Garcia Alva kundër Gjermanisë*, datë 13.02.2001.
14. *Belchev kundër Bullgarisë*, datë 06.02.2003.
15. *Roemen dhe Schmit kundër Luksemburgut*, datë 25.05.2003.
16. *Sarban kundër Moldavisë*, datë 04.10.2005.

Emri i Autorit

17. *Smirnov kundër Ruisisë*, datë 07.06.2007.
18. *Draghici kundër Portugalisë*, datë 19.06.2014.
19. *S.C. "Fiercolect Impex" S.R.L. kundër Rumanisë*, datë 13.12.2016.
20. Vendimi unifikues nr. 1, datë 08.01.2009, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
21. Vendimi unifikues nr. 3, datë 27.09.2002, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
22. Vendimi unifikues nr. 7, datë 14.10.2011, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
23. Vendimi njësues nr. 1135 (147), datë 23.12.2021, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
24. Vendimi nr. 25, datë 15.01.2003, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
25. Vendimi nr. 370, datë 21.04.2010, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
26. Vendimi nr. 533 (17), datë 15.07.2021, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
27. Vendimi nr. 642 (19), datë 26.07.2021, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
28. Vendimi nr. 769 (80), datë 09.11.2021, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
29. Vendimi nr. 164 (3), datë 11.01.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
30. Vendimi nr. 76, datë 08.03.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
31. Vendimi nr. 77, datë 08.03.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
32. Vendimi nr. 641, datë 12.05.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
33. Vendimi nr. 329, datë 09.12.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
34. Vendimi nr. 1805 (351), datë 22.12.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
35. Vendimi nr. 360, datë 23.12.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
36. Vendimi nr. 1751, datë 23.12.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
37. Vendimi nr. 263, datë 21.11.2019 "Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve", i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
38. Vendimi nr. 264, datë 21.11.2019 "Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit", i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

SI PO PËRSHTATET SHQIPËRIA ME STANDARDET E BASHKIMIT EVROPIAN PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE?

Doktorant. Xhei ÇELIKU*

MSc. Eni BELLO**

MSc. Ornela NIKOLLI***

HOW IS ALBANIA ALIGNING WITH EUROPEAN UNION ANTI-MONEY LAUNDERING STANDARDS?

Abstract

In order to meet European standards in the battle against money laundering, the Republic of Albania has implemented many key legislative measures, which this paper will briefly discuss. This study discusses the creation of new institutions and the primary obstacles they encounter in attaining the desired outcomes in halting the flow of unofficial funds into the economy. Another topic covered in the study is the legal analysis of the normative foundation and the function of both new and established institutions. Albania's difficulties in fully implementing EU directives and suggestions from global institutions like MONEYVAL and the Financial Action Task Force (FATF) are handled synthetically. This effort also includes the EU Progress Report for 2024, the National Strategy for the Prevention of Money Laundering and Terrorism Financing (2024-2030), and several other international actions that will be difficult to implement in Albania. In the final section, various actions in the form of recommendations have been proposed that legislative bodies can consider to provide a legal framework that is consistent with the standards of international acts.

Keywords: *money laundering, legislation, monitoring, prevention, *acquis communautai**

1. Hyrje

Pastrimi i parave është një fenomen botëror që ka pasoja të rrezikshme për qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare të çdo shteti. Ky proces kriminal përfshin ndërhyrjen në sistemet financiare dhe mbështetjen e aktiviteteve të paligjshme, duke dobësuar besimin në institucionet financiare dhe duke ndikuar negativisht në rendin dhe sigurinë publike. Në këtë kuadër, vendet që synojnë integrimin në Bashkimin Evropian janë të detyruara të adoptojnë masa të rrepta për të luftuar këtë fenomen dhe për të garantuar përputhshmërinë me standardet evropiane të parandalimit të pastrimit të parave.

Për Shqipërinë, si një vend që është në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, përputhja e legjislacionit të saj me direktivat e Bashkimit Evropian për pastrimin e parave është një nga prioritetet kryesore të reformave të saj ligjore. Si pjesë e angazhimit të saj për të plotësuar kërkesat e integritimit në BE, Shqipëria ka bërë ndryshime të rëndësishme në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, për të siguruar që korniza e saj ligjore të jetë në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian dhe standardet evropiane. Ndërsa

* Lektor pranë Departamentit të së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. email: xhei.celiku@fdut.edu.al.

** Ministria e Financave, Specialiste në Drejtorinë e Përgjithshme të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Raportimit Financiar, email: eni.bello@financa.gov.al.

*** Specialiste mësimore në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, email: ornela.nikolli@fdut.edu.al.

Shqipëria ka bërë përparime të konsiderueshme në forcimin e legjislacionit të saj, ka ende sfida të vazhdueshme në zbatimin e plotë të këtyre rregulloreve dhe në krijimin e një infrastrukture të suksesshme që mund të luftojë pastrimin e parave në nivelin e duhur. Sfida këto që kanë një rendësi specifike në luftën kundër pastrimit të parave janë të domosdoshme për të siguruar një sistem financiar të qëndrueshëm dhe të besueshëm.

Qëllimi i këtij punimi është të shqyrtojë përputhshmërinë e legjislacionit shqiptar për parandalimin e pastrimit të parave me standardet e Bashkimit Evropian, duke analizuar reformat e realizuara, masat e ndërmarra dhe pengesat që Shqipëria ka hasur gjatë implementimit të këtyre standardeve. Në një mënyrë më të detajuar, do të shqyrtohen përpjekjet e Shqipërisë për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për të përmirësuar mekanizmat e zbatimit, si dhe ndikimi i këtyre përpjekjeve në procesin e integritetit të Shqipërisë në BE. Në përfundim të punimit do të jepen disa sugjerime në formë rekomandimesh ligjore që mund të mbahen parasysh në këto momente të përafritimit të legjislacionit me Acquis Communautaire.

2. Kuadri ligjor në Republikën e Shqipërisë për parandalimin e pastrimit të parave.

2.1 Ligji nr. 9917/2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit"

Ky ligj është ndër aktet e para të miratuara në Republikën e Shqipërisë dhe ka si qëllim të parandalojë dhe të luftojë pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në Shqipëri. Është miratuar në vitin 2008 dhe qëllimi i ndryshimeve ka qënë përqasja me standardet e Bashkimit Evropian. Ky ligj është një pjesë e rëndësishme e përpjekjeve të Shqipërisë për të mbrojtur sistemin financiar dhe për të përafuar me standartet europiane legjislacionin në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të aktiviteteve terroriste¹. Kryesisht, ky ligj parashikon marrjen e masave të rrepta për parandalimin e pastrimit të parave, duke kërkuar që individët dhe institucionet financiare të zbatojnë procedura të njohjes së klientëve dhe të raportojnë transaksionet e dyshimta. Organizatat financiare janë po ashtu të detyruara të implementojnë mekanizma dhe politika të brendshme për të parandaluar aktivitete të pastrimit të parave.

Njohja dhe identifikimi i klientëve, është një komponent i rëndësishëm i këtij ligji, nëpërmjet të cilit i kërkohet institucioneve financiare të verifikojnë identitetin e klientëve të tyre dhe të mbledhin informacion mbi burimin e pasurisë së tyre.

Ky proces quhet "*Procedura njihe klientin tënd*"². Ai nënkupton një sërë rregullash, të përdorura nga institucionet financiare, që kanë të bëjnë me politikat e pranimet e të identifikimit të klientit dhe administrimin e riskut të tyre. Është një masë kyçe për të parandaluar përdorimin e sistemit financiar për aktivitete të paligjshme.

Lidhur me raportimin e transaksioneve të dyshimta, institucionet financiare dhe profesionistët e tjerë të autorizuar janë të detyruar të raportojnë çdo transaksion të dyshimtë që mund të lidhet me pastrimin e parave³. Raportimi duhet të bëhet në Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF) në Shqipëri, si autoriteti kryesor për analizën e këtyre raporteve dhe marrjen e masave të nevojshme. Për kontrollin dhe mbikëqyrjen, ligji i jep autoritetit AIF-së dhe institucioneve të tjera kompetente të monitorojnë dhe të kontrollojnë zbatimin e tij. Ligji parashikon krijimin e një sistemi të fortë për mbikëqyrjen e aktiviteteve financiare, përfshirë inspektimet dhe hetimet që synojnë identifikimin dhe ndalimin e pastrimit të parave⁴.

Së fundmi, ligji parashikon detyrime për individët dhe kompanitë për marrjen e masave administrative ndaj shkelësve. Përcaktohet se individët dhe kompanitë, përfshirë bankat dhe bizneset financiare, duhet të zbatojnë një sërë masash për të identifikuar transaksionet e dyshimta dhe për të pasur sistemet e nevojshme të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, duhet të mbajnë regjistra të detajuar për transaksionet dhe të sigurojnë që informacioni të jetë i arritshëm për autoritetet kompetente⁵.

¹ Ligji nr. 9917 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", datë 19.05.2008.

² Shih: Neni 2, pika 21 e Ligjit nr. 9917 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", datë 19.05.2008.

³ Shih: Neni 28, pika 3/ç e Ligjit nr. 9917 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", datë 19.05.2008.

⁴ Ligji nr. 9917 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", datë 19.05.2008.

⁵ Shih: Neni 16 i Ligjit nr. 9917 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", datë 19.05.2008

Institucionet që hasin problematika për transaksione të dyshimta, të cilat lidhen me pastrimin e parave⁶, kanë detyrimin për ta referuar çështjen pranë AIF, si organi administrativ përgjegjës. Më pas ky i fundit e referon në prokurori nëse konstatohen elemente të një veprë penale.

2.2 Përqasja e legjislacionit shqiptar me standardet evropiane

2.2.1 Lidhur me përditësimin e Ligjit nr. 9917/2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", është përmirësuar me qëllim rritjen e efikasitetit në parandalimin e pastrimit të parave dhe për të përforcuar masat kundër financimit të terrorizmit.

Në përputhje me Direktivën e Katërt të Bashkimit Evropian (2015/849) për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, Ligji nr. 9917/2008 i Shqipërisë ka pësuar disa ndryshime dhe përmirësime për të siguruar përputhshmërinë me këtë akt ligjor. Direktiva e Katërt e BE-së ka si qëllim të forcojë masat për luftimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe të rrisë transparencën për të parandaluar përdorimin e sistemit financiar për aktivitete të paligjshme⁷.

Disa nga ndryshimet kryesore që janë bërë në ligjin shqiptar pas miratimit të Direktives së Katërt të BE-së janë lidhur me përmirësimin e kërkesave për njohjen e klientëve (KYC – Know Your Customer). Më specifikisht njohja e klientëve është një kërkesë kyçe e Direktives së Katërt. Kuadri legjislativ shqiptar i është nënshtruar shpesh ndryshimeve me qëllim unifikimin dhe përshtatjen me vendet evropiane në procedurat e identifikimit të klientëve, njohjen e klientëve të një rreziku më të lartë, si dhe thellimin e informacioneve mbi burimin e pasurisë së klientëve. Aktualisht, ligji kërkon që institucionet financiare të bëjnë verifikim të detajuar për klientët e rinj, përfshirë individët dhe entitetet juridike. Kërkohet që informacioni i paraqitur të jetë i verifikuar nga burime të sigurta zyrtare si dhe të paraqesë saktësi në analizen financiare që kryen institucioni⁸.

Një tjetër kërkesë e rëndësishme e Direktives së Katërt është identifikimi dhe regjistrimi i pronarëve të vërtetë të entiteteve juridike, siç janë kompanitë dhe organizatat. Sot, ligji shqiptar kërkon që çdo subjekt juridik të identifikojë dhe të regjistrojë pronarët e vërtetë dhe të mbajë në mënyrë të saktë të dhëna për ta. Ndryshimi është bërë për të siguruar më shumë transparencë dhe për të parandaluar kompanitë në aktivitete të paligjshme, si dhe përdorimin e tyre si mjet për pastrimin e parave⁹.

Sipas direktives së BE-së, institucioneve financiare dhe profesionistëve të tjerë u kërkohet të analizojnë transaksionet dhe të raportojnë çdo aktivitet që krijon dyshime mbi burimin e të ardhurave ose financimin e terrorizmit.¹⁰ Direktiva e Katërt nënvizon rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për luftën kundër pastrimit të parave. Ligji i Shqipërisë ka përfshirë masa që i mundësojnë autoriteteve të vendit të bashkëpunojnë më mirë me autoritetet ndërkombëtare, përfshirë këtu ndihmën juridike dhe shkëmbimin e informacionit për hetimet ndërkombëtare¹¹.

2.2.2 Shqipëria, jo më pjesë e procesit të monitorimit të shtuar nga Grupi i Veprimit Financiar Ndërkombëtar (FATF)

Një reflektim pozitiv sa i përket masave legjislative të marra është materializuar në faktin që Shqipëria nuk është më subjekt i monitorimit të shtuar nga FATF. Shqipëria ka forcuar efektivitetin e këtij sistemi në kuadër edhe të

⁶ Ligji nr. 9917 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", datë 19.05.2008.

⁷ Banka e Shqipërisë, Rregullore Nr.44 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", 10.06.2009;

⁸ Po aty;

⁹ Po aty;

¹⁰ Po aty;

¹¹ Shih: Neni 22 i Ligjit nr. 9917 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", datë 19.05.2008;

angazhimeve të marra në planin e veprimit për adresimin e mangësive strategjike të identifikuara nga FATF në shkurt të vitit 2020¹².

Disa prej ndërhyrjeve në legjislacion me synim evidentimin dhe goditjen e rasteve të pastrimit të parave përfshijnë ndër të tjera, kryerjen e analizave më të thelluara për të kuptuar më mirë rreziqet e pastrimit të parave dhe përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit institucional¹³. Mbahet në konsideratë formalizimi i ekonomisë dhe reduktimi i rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që lidhen me përdorimin e gjerë të parasë *cash*, si dhe regjistrimin e informacionit mbi pronësinë e pasurive në mbarë territorin e Shqipërisë. Një rëndësi e shtuar në pikëpamjen rregulluese të kuadrit ligjor por dhe të procedurës administrative është edhe përmirësimi i trajtimit të kërkesave për asistencë juridike të ndërsjellë në kohë sa më të shpejtë¹⁴.

Është parashikuar në këtë ndryshime dhe krijimi i mekanizmave efektivë për zbardhjen dhe parandalimin e infiltrimit kriminal në ekonomi nëpërmjet sigurimit që informacioni i saktë dhe i përditësuar mbi pronësinë të jetë i disponueshëm dhe i aksesueshëm në kohë. Rëndësi e shtuar I është kushtuar dhe zbatimit të sanksioneve financiare të drejtuara, përmes veprimeve të rrepta mbikëqyrëse dhe angazhimit proaktiv.¹⁵

Të gjitha ndërhyrjet e përmendura më sipër, por jo vetëm, kanë sjellë në rezultatin që Shqipëria të mos jetë më pjesë e procesit të monitorimit të shtuar nga FATF. Sfidë për orgnaet ligjvënëse dhe ligjzbatuese në Shqipëri ngelet dhe implementimi i një programi për kontrollin e transaksioneve të vlerës së lartë (VTC¹⁶) në të ardhmen.

2.3 Institucionet kryesore në luftën përparandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit

Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) është ngritur në vitin 2000 si institucion me natyrë administrative dhe “urë lidhëse” midis subjekteve raportuese dhe organeve të ndjekjes penale. Agjencia e Inteligjencës Financiare bashkëpunon me njësitë homologe jashtë vendit, në kuadër të anëtarësimit në Grupin Egmont¹⁷, duke përdorur një rrjet të koduar për shkëmbimin e informacionit të vlefshëm në ushtrimin e funksioneve dhe detyrave që ka çdo njësi/agjenci sipas legjislacionin të vendit përkatës. Në përgjithësi, të dhënat e shkëmbyera lidhen me transaksione ose të drejta pronësore të çdo lloji dhe mund të përdoren sipas rastit në gjurmimin e provave¹⁸.

Në bashkëpunimin institucional midis AIF dhe organeve të tjera kombëtare apo të huaja kërkohet që informacioni dhe të dhënat të shkëmbehen brënda një kohe sa më të shkurtër. Nuk ka një afat specifik për përgjigjet ndërmjet subjekteve si më sipër, për sa kohë që konsiderohet i arsyeshëm në varësi të llojit të informacionit të kërkuar. Rekomandohet që përgjigjet të kthehen brenda një periudhe prej 30-60 ditësh. Mund të kthehen më herët nëse informacioni i kërkuar gjendet në bazat e të dhënave të njërive, por mund të kërkojë edhe më shumë kohë nëse këto të fundit duhet të japin të dhëna shtesë¹⁹.

Për të përmbushur funksionet e saj, ajo merr dhe analizon informacionin financiar²⁰ që raportohet nga subjektet e detyruara. Nga ana e AIF realizohet analiza operacionale e cila përdor të gjitha burimet e informacionit në

¹² FATF, "Increased Monitoring of Jurisdictions under Increased Monitoring," FATF, October 2023;

¹³ FATF, "Increased Monitoring of Jurisdictions under Increased Monitoring," FATF, October 2023;

¹⁴ Shih: Neni 24, pika 4/c e Ligjit nr. 9917 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", datë 19.05.2008;

¹⁵ FATF, "Increased Monitoring of Jurisdictions under Increased Monitoring," FATF, October 2023;

¹⁶ Virtual Asset Service Providers (VASPs) and the regulation of virtual transactions or cryptocurrencies

¹⁷ Shih Kartën e Grupit Egmont të Njësive të Inteligjencës Financiare, miratuar në korrik 2013 nga Drejtuesit e Njësive të Inteligjencës Financiare të Grupit Egmont, dhe Parimet për Shkëmbimin e Informacionit ndërmjet Njësive të Inteligjencës Financiare, miratuar nga Drejtuesit e Njësive të Inteligjencës Financiare në korrik 2013. përditësuar në 2023 dhe mund të gjendet dhe konsultohet në faqen e internetit të Egmont Group (egmontgroup.org)

¹⁸ Prokuroria e Përgjithshme, “Goditja e aseteve kriminale: Manual gjithëpërfshirës mbi pastrimin e parave dhe recuperimin e aseteve. Kuadri ligjor shqiptar dhe ndërkombëtar”, Shkurt 2024;

¹⁹ Prokuroria e Përgjithshme, “Goditja e aseteve kriminale: Manual gjithëpërfshirës mbi pastrimin e parave dhe recuperimin e aseteve. Kuadri ligjor shqiptar dhe ndërkombëtar”, Shkurt 2024;

²⁰ Informacioni financiar përfshin:

1. Informacion mbi transaksione në mjete monetare fiat mbi shumën 1 milion Lekë që subjektet kryejnë për llogari të klientëve të tyre gjatë marrëdhënies së punës;

dispozicion për të prodhuar modele veprimtarie që nga ana e tyre ofrojnë metoda për hartimin e treguesve të të ardhurave të fshehura të një individi, një grupi individësh apo një organizate. Kjo metodë e tërthortë është e efektshme për mbledhjen, organizimin dhe paraqitjen e informacionit në lidhje me gjendjen financiare të subjekteve. Sidomos në rastet kur subjektet e përfshira nuk mund të paraqesin burimin legjitim për diferencën midis flukseve të parave fizike dhe të ardhurave të tyre. Gjurmimi i pasurive mund të sigurojë gjithashtu pista që lidhin subjektin me veprën penale mëmë²¹. Informacioni i marrë dhe konkluzioni i arritur pas analizave të bëra nga AIF-ja i dërgohet organeve të ndjekjes penale për të konstatuar nëse të dhënat e përfuara përbëjnë fakt penal ose jo.

Në kuadër të veprimtarisë së saj, AIF ofron gjithashtu informacion për Agjencitë e Zbatimit të Ligjit që kryejnë hetime lidhur me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, duke ofruar kështu mbështetje të vazhdueshme për të garantuar që fondet ose pasuritë gjurmohen, sekuestrohen dhe konfiskohen siç duhet. Gjithashtu, AIF jep kontributin e saj duke bashkëpunuar ngushtësisht me Ekipet e Përbashkëta Hetimore. Është e rëndësishme të theksohet se çdo informacion apo e dhënë që i shpërndahet organeve ligj zbatuese nga AIF-ja i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar si sekret shtetëror dhe nuk përbën provë sipas kuptimit në Kodin e Procedurës Penale²².

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është një tjetër institucion i cili ka një rol kyç në hartimin e politikave dhe evidentimin e rasteve të mundshme të futjes në qarkullim të parave që kanë burim jo të ligjshëm²³. AMF mbikëqyr zbatimin e ligjit dhe rregulloreve të dala në zbatim të politikave penale për parandalimin e pastrimit të parave nëpërmjet raportimit në rastet kur ekziston dyshimi lidhur me tentativa të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit. Mekanizëm tjetër vetëkontrollues është edhe Vlerësimi i Sistemit të Kontrollit të Brendshëm (VSKB) nëpërmjet të cilit AMF vlerëson mjaftueshmërinë e sistemeve dhe kontrolleve të brendshme të subjekteve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit²⁴. Informimi i autoriteteve përgjegjëse për çdo shkelje që mund të përbëjë kundravajtje administrative dhe ofrimi i dokumentacionin përkatës për të mbështetur hetimet është pjesë e veprimtarisë së AMF. Për arritjen e objektivave institucionale mund të kërkojë nga subjektet informacion dhe dokumente për të siguruar përputhshmërinë me Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave²⁵.

Përveç rolit monitorues AMF ka kompetencat ligjore që të marrë sanksione administrative ndaj subjekteve që shkelin ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, përfshirë kufizimin ose pezullimin e licencave të subjekteve.

Banka e Shqipërisë është një actor tjetër shumë i rëndësishëm në mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij ligjit dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Ajo siguron që subjektet financiare të përmbushin të gjitha kërkesat e parashikuara nga ligji, duke vëzhguar dhe inspektuar proceset dhe praktikat e përdorura nga këto subjekte. Kjo përfshin vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe të programeve të implementuara nga institucionet financiare për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.²⁶

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka përgjegjësinë të raportoje çdo informacion të dyshimtë që lidhet me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit te autoriteti përgjegjës, siç janë organet ligjzbatuese, duke u bazuar në të

2. Raportet për Veprimtaritë e Dyshimta (RVD);

3. Raportet ndërkufitare të transportit të parave fizike, instrumenteve të negociueshme si dhe metaleve dhe gurëve të çmuar.

4. Informacioni i shkëmbyer me Njësitë e Inteligjencës Financiare partnere në mbarë botën

²¹ Prokuroria e Përgjithshme, “*Goditja e aseteve kriminale: Manual gjithëpërfshirës mbi pastrimin e parave dhe rekuperimin e aseteve. Kuadri ligjor shqiptar dhe ndërkombëtar*”, Shkurt 2024.

²² Prokuroria e Përgjithshme, “*Goditja e aseteve kriminale: Manual gjithëpërfshirës mbi pastrimin e parave dhe rekuperimin e aseteve. Kuadri ligjor shqiptar dhe ndërkombëtar*”, Shkurt 2024.

²³ Bordi i Mbikëqyrjes Publike, “*Rregullore dhe Udhëzues mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit (PPPFT)*”, versioni 2, shkurt 2023.

²⁴ Bordi i Mbikëqyrjes Publike, “*Rregullore dhe Udhëzues mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit (PPPFT)*”, versioni 2, shkurt 2023.

²⁵ Po aty.

²⁶ Banka e Shqipërisë, Rregullore Nr. 44 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, 10.06.2009.

dhënat e mbledhura gjatë procesit të mbikëqyrjes. Në këtë mënyrë, ajo kontribuon aktivisht në hetimin dhe zbulimin e aktiviteteve të paligjshme që mund të ndikojnë në sistemin financiar të vendit²⁷. Vlerësimi nëse subjektet financiare kanë sisteme dhe programe të mjaftueshme kontrolli për të siguruar parandalimin e pastrimit të parave është pjesë e detyrave të BSh. Ky proces vlerësimi është thelbësor për të garantuar që ato të jenë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe të mos lejojnë aktivitete të paligjshme që mund të dëmtojnë integritetin e sistemit financiar²⁸. Në rastet kur Banka e Shqipërisë konstaton shkelje të ligjit, të cilat mund të klasifikohen si kundravajtje administrative, ajo ka përgjegjësinë të informojë autoritetin përkatës dhe t'i ofrojë dokumentacionin e plotë që ka lidhje me këto shkelje. Kjo mund të përfshijë detaje të raportuara nga institucionet financiare dhe veprime të tjera që kanë për qëllim ndihmën në hetimin dhe zgjidhjen e çështjeve të pastrimit të parave²⁹.

Nëse subjekte financiare nuk zbatojnë kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi, Banka e Shqipërisë ka mundësinë të marrë masa mbikëqyrëse dhe ndëshkimore, siç është pezullimi i disa aktiviteteve ose revokimi i licencës së subjektit. Kjo mund të ndodhë në rastet kur nuk ka përmbushje të kërkesave ligjore për mbrojtjen e sistemit financiar nga aktivitetet e paligjshme³⁰.

3. Sfidat që ka Shqipëria në implementimin e standardeve të BE-së

3.1 Sfidat në luftën kundër pastrimit të parave sipas Raportit të Progresit 2024

Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar për t'u përputhur me *acquis communautaire* në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, përkatësisht pjesë e kapitullit 24. Janë bërë disa përparime në luftën kundër krimit të organizuar duke rritur kapacitetin e Strukturave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe duke përmirësuar hetimin financiar. Nevojiten veprime të mëtejshme për të forcuar kapacitetin e forcave të zbatimit të ligjit dhe për të përmirësuar efikasitetin e hetimeve³¹.

Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet, sa i përket fushës së pastrimit të parave, të vazhdojë zhvillimin e përdorimit sistematik të hetimeve financiare paralele³². Me rritjen e kapaciteteve dhe konsolidim e SPAK-ut për hetimet financiare sipas rekomandimeve të BE është forcuar lufta kundër pastrimit të parave dhe jo vetëm. Përmirësime të dukshme janë arritur në përshtatjen me *acquis communautaire* nëpagesat (Direktiva për Llogaritë e Pagesave) dhe në veprimet që çuan në heqjen e Shqipërisë nga "lista gri" e Task Forcës Ndërkombëtare të Veprimit Financiar (FATF) në tetor 2023. Në korrik 2024, Komiteti Kombëtar i Koordinimit për luftën kundër pastrimit të parave miratoi Strategjinë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për periudhën 2024-2030. Në vitin e ardhshëm Shqipëria duhet, në veçanti të fillojë implementimin e strategjisë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për periudhën 2024-2030, si edhe të ndjekë masat për adresimin e Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar të vitit 2023³³. Pas miratimit të këtyre masave ligjore kapacitetet e Njësisë së Inteligjencës Financiare të Shqipërisë (AFIU) u forcuan, dhe u rrit trajnimi i brendshëm për teknikat e hetimeve financiare, ndjekjen e pasurive, sekuestrimin dhe konfiskimin, si dhe për teknikat e zbatimit të bazuara në rrezik dhe parandalimin e krimit kibernetik³⁴.

²⁷ Po aty.

²⁸ Po aty.

²⁹ Banka e Shqipërisë, Rregullore Nr. 44 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", 10.06.2009.

³⁰ Po aty.

³¹ Shih: Albania Report 2024 nga European Commission, Albania Report 2024, 30.10.2024, i disponueshëm në: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8ecc3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf.

³² Shih: Albania Report 2024 nga European Commission, Albania Report 2024, 30.10.2024.

³³ Po aty.

³⁴ Po aty.

Në periudhën e raportimit, entitetet kryesore që raportuan te AFIU ishin institucionet financiare si banka dhe jo-banka, të ndjekura nga zyra të noterëve. Gjatë vitit 2023, Banka e Shqipërisë inspektoi 50 zyra këmbimi valutor, duke u fokusuar në përmbushjen e kërkesave të legjislacionit kundër pastrimit të parave³⁵.

3.2 Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030

Përgjatë Strategjisë Kombëtare për PP/FT përshkruhet angazhimi dhe progresi i Shqipërisë në përpjekjet për të luftuar futjen e parave informale në ekonomi, duke përfshirë vlerësimin ndërkombëtar dhe hapat e ndërmarrë për të përmbushur standardet e kërkuara nga organizata të tilla si Moneyval³⁶ dhe FATF³⁷.

Në përfundim të vlerësimit, rezultoi se Shqipëria kishte një përputhshmëri të lartë me shumicën e rekomandimeve të FATF, por edhe disa mangësi për adresim. Rekomandimi 7 ishte plotësisht i papërputhur³⁸. Dhjetë rekomandime ku ndër to përfshihet dhe Rekomandimi 15, rezultoi se janë përputhur pjesërisht. Për pjesën tjetër prej dyzet e shtatë rekomandimesh përfundimi është se janë përputhur ose gjerësisht përputhur, duke treguar një përpjekje të konsiderueshme për të përmbushur standardet ndërkombëtare³⁹.

Si pasojë e këtij vlerësimi, Shqipëria u vendos nën një monitorim të përforcuar nga Moneyval dhe në vitin 2020, u përfshi në "listën gri" të FATF, një grup shtetesh që janë nën mbikëqyrje për shkelje të mundshme në sistemet e tyre në luftën kundër pastrimit të parave. Për të adresuar këto çështje dhe për të përmirësuar përputhshmërinë me rekomandimet ndërkombëtare, Shqipëria nisi hartimin e një sërë masash me karakter normativ dhe krijoi një plan të detajuar veprimi me 19 pika që përfshin masa ligjore dhe reforma⁴⁰.

Ky plan veprimi është i dizenuar për të rritur efikasitetin e sistemeve të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe duhet të përmbushet brenda një periudhe 3-vjeçare. Një grup ndërinstitucional pune, që drejtohet nga Zëvendëskryeministri dhe përfshin të gjitha institucionet përgjegjëse, u ngarkua me monitorimin e zbatimit të këtij plani⁴¹.

Në vitin 2023, sa i përket procesit dhe daljes nga "lista gri", Shqipëria paraqiti raporte progresi për zbatimin e këtij plani. Në mbledhjen plenare të tetorit të atij viti, FATF miratoi përmbushjen e detyrimeve të planit të veprimit nga Shqipëria. Në këtë kuadër, u vlerësua se vendi kishte ndërmarrë një sërë reformash ligjore që kishin ndikuar ndjeshëm në forcimin e efektivitetit të sistemeve të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Për këtë arsye, Shqipëria doli nga "lista gri" e FATF, duke u përgëzuar për progresin e arritur⁴². Megjithatë, FATF bëri thirrje për një angazhim të vazhdueshëm nga Shqipëria për të respektuar parimet ndërkombëtare të FATF, duke përfshirë mundësinë e një programi amnistie fiskale në të ardhmen.

Pavarësisht përmbushjes së shumicës së rekomandimeve, raporti i vlerësimit i Grupit të Përbashkët (Joint Group) i ICRG/FATF sugjeroi disa rekomandime të tjera që Shqipëria duhet të vazhdojë të përmirësojë⁴³, si në rastin e amnistisë fiskale. Nëse Shqipëria do të hartojë një program amnistie fiskale, rekomandohet që ky program të jetë në përputhje me parimet dhe praktikat më të mira të FATF për amnistitë fiskale.

³⁵ Po aty.

³⁶ Komiteti i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit;

³⁷ Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave 2024-2030 dhe Plani i Veprimit, 2024, i disponueshëm në: <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2025/01/Final-Strategjia-Kombetare-per-Parandalimin-e-Pastrimit-te-Parave-2024-2030-dhe-Plani-i-Veprimit.pdf> ;

³⁸ FATF (2012-2025), International Standards on Combating Money Laundering and the Financing of Terrorism & Proliferation, FATF, Paris, France, i disponueshëm në: www.fatf-gafi.org/en/publications/Fatfrecommendations/Fatf-recommendations.html ;

³⁹ Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave 2024-2030 dhe Plani i Veprimit, 2024;

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Po aty.

⁴² Po aty.

⁴³ Po aty.

Në rastin e përmirësimit të hetimeve penale, Shqipëria inkurajohet të vazhdojë përpjekjet për të intensifikuar hetimet dhe ngritjen e akuzave për pastrim parash, veçanërisht në lidhje me krime të rënda si korrupsioni, krimi i organizuar dhe trafikimi i narkotikëve, dhe kur këto vepra penale janë kryer në juridiksione të huaja.

Në koordinimin ndërinstytucional, për të përballuar më mirë kërcënimet e pastrimit të parave, Shqipëria duhet të vazhdojë përpjekjet për një koordinim më të gjerë ndërinstytucional dhe të zhvillojë strategji të plota për adresimin e këtyre kërcënimeve. Prokuroria e Posaçme, SPAK, duhet të jetë e përfshirë plotësisht në këtë proces⁴⁴.

1. Investimi në Teknologji dhe Burime Njerëzore: Shqipëria duhet të investojë më shumë në burime njerëzore dhe teknologjike për të luftuar kërcënimet e reja që lidhen me pastrimin e parave, si krimi kibernetik dhe përdorimi i aseteve virtuale.
2. Menaxhimi i Rasteve: Një tjetër rekomandim është krijimi i një sistemi të ri për menaxhimin e rasteve të hetimeve dhe procesimit të çështjeve të pastrimit të parave, i cili do të zëvendësojë sistemin aktual të përdorur nga prokurorët⁴⁵.

Përsa i përket përputhshmërisë ligjore të Shqipërisë me rekomandimet e FATF, në vitin 2023, Shqipëria kishte përmbushur shumicën e tyre, duke përfshirë 6 rekomandime të plota dhe 31 të tjera që ishin gjerësisht të përputhura. Megjithatë, disa rekomandime ende mbeten në nivelin e "pjesërisht të përputhura", përfshirë për masat shtrenguese ndërkombëtare dhe Rekomandimin 15 për teknologjitë e reja dhe ofruesit e mjeteve virtuale⁴⁶.

3.3 Një vështrim më i detajuar për situatën e Shqipërisë në luftën kundër pastrimit të parave

Sipas MONEYVAL, trupit të mbikëqyrjes së Këshillit të Europës, që vlerëson përputhshmërinë me standardet kyçe ndërkombëtare në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe efektivitetin e zbatimit të tyre e hartimin e rekomandimeve për autoritetet kombëtare në lidhje me përmirësimet e nevojshme, Shqipëria është pjesë e raundit të pestë të vlerësimit.

Vizita e vlerësimit të raundit të pestë të vlerësimit të përbashkët u zhvillua nga data 1 deri më 14 tetor, të vitit 2017. Raporti i vlerësimit u miratua në Seancën e 56-të Plenare (2018) dhe raporti i ndjekjes së përmirësuar u miratua në Seancën e 59-të Plenare (2019). Në maj të vitit 2021, u publikua Raporti i Dytë i Ndjekjes së Përmirësuar në Seancën e 61-të Plenare⁴⁷.

Dyzetë rekomandimet e FATF vlerësohen sipas një vlerësimi të përputhshmërisë teknike në raportin e MONEYVAL. Kështu, "C" do të thotë i përputhur, "LC" do të thotë kryesisht i përputhur, "PC" do të thotë pjesërisht i përputhur, "NC" do të thotë jo i përputhur, dhe "N/A" do të thotë nuk aplikohet⁴⁸.

Raporti më i fundit i Ndjekjes së Vlerësimit të Përbashkët, i lidhur me zbatimin e standardeve kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Shqipëri, u krye në vitin 2021. Sipas atij vlerësimi, Shqipëria u vlerësua si e përputhur për 5 dhe kryesisht e përputhur për 27 nga 40 rekomandimet e FATF. Ajo u vlerësua si shumë efektive për 0 dhe substancialisht efektive për 2 nga vlerësimet e efektivitetit dhe përputhshmërisë teknike⁴⁹.

3.3.1 Disa vështirësi në zbatimin e legjislacionit kundër pastrimit të parave nga shtetet e Bashkimit Evropian

Përgatitja dhe zbatimi i legjislacionit kundër pastrimit të parave (AML) në Bashkimin Evropian është shumë i ndryshëm nga një shtet anëtar në tjetrin. Direktivat përcaktojnë rezultate ose objektiva, por nuk specifikojnë mënyrën se si çdo shtet anëtar duhet t'i arrijë ato. Kjo nënkupton se çdo shtet ka përgjegjësinë për të zbatuar direktivën përmes masave të veta ligjore.

⁴⁴ Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave 2024-2030 dhe Plani i Veprimit, 2024;

⁴⁵ Po aty;

⁴⁶ Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave 2024-2030 dhe Plani i Veprimit, 2024;

⁴⁷ Know Your Country. (2019). Global Anti-Money Laundering Research Tool. Retrieved from: <https://www.knowyourcountry.com/>;

⁴⁸ Po aty.

⁴⁹ Po aty.

Megjithatë, ndihmësit ligjorë mund të krijojnë mospërputhje që pastruesit e parave i shfrytëzojnë për të shpëtuar nga ndjekja ligjore, duke krijuar vështirësi në bashkëpunimin ndërkombëtar. Disa aspekte harmonizimi që mungojnë janë: procedurat e konfiskimit, mjetet e zbatimit të ligjit dhe ndëshkimet. Kjo ndikon në dallimet e dënimeve dhe mundësitë për shmangien e ndjekjes ligjore për individë që kanë kryer krime si evazioni fiskal dhe pastrimi i parave⁵⁰.

Në një shembull më konkret, futbollisti gjerman Uli Hoeness, i dënuar për shmangie tatimore, mund të kishte pasur dënime të ndryshme në shtete të ndryshme të BE-së, ku në disa prej tyre ai mund të kishte shmangur dënimin me burg. Kjo tregon se nuk ka një qëndrim të përbashkët mbi dënimet për krime të tilla dhe rrjedhimisht, mundësitë për pastruesit e parave që të shfrytëzojnë këto mospërputhje janë të shumta⁵¹.

Për këtë arsye, rregulloret e BE-së, të cilat nuk kërkojnë transpozim dhe janë të aplikueshme menjëherë, mund të ndihmojnë për të arritur harmonizim më të madh, por sidoqoftë ka sfida politike dhe juridike në zbatimin e këtyre rregulloreve⁵².

4. Konkluzione

Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke krijuar përputhshmëri më të madhe me standardet ndërkombëtare, siç janë ato të FATF dhe Moneyval. Sfidë kryesore ngelet konsolidimi i institucioneve që do të aplikojnë këto standarte. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka një rol kyç në hartimin e politikave dhe monitorimin e zbatimit të ligjeve e rregulloreve për parandalimin e pastrimit të parave në identifikimin e rasteve të mundshme të futjes së parave me burim të paligjshëm në qarkullim. AMF duhet të ketë një rol sa më aktiv në zbatimin e politikave penale për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, duke raportuar raste të dyshimta dhe duke ofruar mbështetje për hetime. Po ashtu, marrja e masave administrative ku sipas ndryshimeve të fundit përfshihet dhe kufizimin ose pezullimin e licencave të subjekteve që shkelin ligjin ngelet një detyrë kryesore për AMF.

Një tjetër aktor kyç në këtë betejë është Banka e Shqipërisë, e cila duhet të mbikëqyrë institucionet financiare për të siguruar përputhshmërinë me ligjin kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Duke vlerësuar sistemet dhe praktikat e kontrollit të brendshëm të subjekteve financiare dhe raportimit të çdo informacioni të dyshimtë tek autoritetet përgjegjëse. Dhënia e një kontributi të specializuar në zbulimin dhe hetimin e aktiviteteve të paligjshme me karakter financiar duhet të jetë object I fokusit të punës.

Përputhja me standartet e Bashkimit Evropian ka qënë synim dhe një sfide për Shqipërinë e cila ka bërë progres të dukshëm në këtë drejtim. Arritje këto të evidentuara dhe në Raportin e Progresit të vitit 2024, i cili thekson përmirësimin e kapaciteteve të SPAK dhe forcimin e hetimeve financiare nga institucionet shqiptare. Një nga arritjet më të rëndësishme ishte heqja e Shqipërisë nga "lista gri" e FATF në tetor 2023. Megjithatë, Shqipëria ende ka sfida për të përmbushur plotësisht të gjitha rekomandimet ndërkombëtare, përfshirë ato që lidhen me masat shtrënguese ndërkombëtare dhe përdorimin e teknologjive të reja. Në përmbushje të ktyre synimeve hartimi i Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit (2024-2030) është një faktor kyç në luftën kundër pastrimit të parave. Nëpërmjet të cilës synohet forcimi i mëtejshëm i sistemeve të luftës kundër këtyre fenomeneve, përfshirë masat ligjore dhe reforma të nevojshme për të adresuar mangësitë e mbetura. Pjesë e kësaj strategjie është edhe intensifikimi i bashkëpunimit me Moneyval, për të mbajtur dhe thelluar përmirësimet e arritura dhe për të siguruar një përputhshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare.

Ngelet një sfida e vazhdueshme për Shqipërinë investimi në burime njerëzore dhe teknologjike për të luftuar kërcënimet e reja që lidhen me pastrimin e parave, si krimi kibernetik dhe përdorimi i aseteve virtuale. Për më tepër, një aspekt i rëndësishëm është zhvillimi i një sistemi të ri për menaxhimin e rasteve të hetimeve dhe procesimit të çështjeve të pastrimit të parave. Futja dhe përdorimi i parasë digjitale në ekonomi e cila buron nga

⁵⁰ Unger, B. (2020, June). Improving anti-money laundering policy. Directorate-General for Internal Policies, Policy Department for Economic, Scientific and Quality of Life Policies.

⁵¹ Po aty.

⁵² Po aty.

Emri i Autorit

aktivitete të paligjshme është një fenomen shumë I rrezikshëm I cili kërkon ridimensionim total të strukturës aktuale dhe kapaciteteve intelektuale njerëzore për tu perballur me të.

Së fundmi, Shqipëria duhet të vazhdojë të forcojë përpjekjet për hetime penale dhe të vazhdojë përmirësimin e koordinimit ndërinstytucional për të adresuar kërcënimet e pastrimit të parave, duke angazhuar plotësisht strukturat e specializuara hetimore si SPAK, Prokurorite e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe të gjitha autoritetet përgjegjëse për të siguruar një luftë të suksesshme kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Përmes angazhimit të vazhdueshëm dhe forcimit të institucioneve të saj, Shqipëria ka mundësinë të konsolidojë arritjet e bëra dhe të sigurojë një sistem efikas dhe të qëndrueshëm në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Alldridge, Peter. *“Forfeiture, Confiscation, Civil Recovery, Criminal Laundering and Taxation of the Proceeds of Crime”*. Money Laundering Law. Hart Publishing, Oxford - Portland, Oregon 2003;
2. Strafer, G Richard. *“Money Laundering: the crime of the ‘90s”*. American Criminal Law Review, v.27. 1989;
3. Savona, Ernesto U. *Responding to Money Laundering International Perspectives*. First edition. Taylor & Francis e-Library. 2005;
4. Unger, B. *“Blacklisting, measures against letterbox companies, AML regulations and a European executive”*. Improving anti-money laundering policy. Directorate-General for Internal Policies, Policy Department for Economic, Scientific and Quality of Life Policies. 2020
5. Vakaj, Dritan. Prroni, Daniel. *Skemat e pastrimit të parave në Shqipëri*. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe ABA. 2023;

Legjislacion

1. Banka e Shqipërisë. *“Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”*. Buletini Zyrtar. Vëllimi 11. 2009.
2. Bordi i Mbikëqyrjes Publike. *Rregullore dhe Udhëzues mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit (PPPFT)*. Versioni 2. 2023.
3. Directorate-General for Neighbourhood and Enlargement Negotiations. *Albania Report 2024*. European Commission. 2024.
4. FATF. *“International Standards on Combating Money Laundering and the Financing of Terrorism & Proliferation”*. The FATF Recommendations. FATF/ OECD. 2012-2025.
5. *“Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar”*. Konventa e Kombeve të Bashkuara. Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare. 2002.
6. Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave. *“Për ngritjen e grupit ndërinstytucional të punës për ndjekjen dhe permbushjen e rekomandimeve të grupit të posaçëm të veprimit financiar”*. Vendim nr. 1. 2020.
7. Know Your Country. *Global Anti-Money Laundering Research Tool*. 2019.
8. Ligji *“Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”*. Numër 9917. Fletore Zyrtare. 2008.
9. Ministria e Drejtësisë. *Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave 2024-2030 dhe Plani i Veprimit*. 2024.
10. Prokuroria e Përgjithshme dhe FIIAPP. *Goditja e aseteve kriminale: Manual gjithëpërfshirës mbi pastrimin e parave dhe rekuperimin e aseteve*. Kuadri ligjor shqiptar dhe ndërkombëtar. 2024.

ROLI NDIHMËS I SEKRETARIT GJYQËSOR NË PROCESIN PENAL PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT BREND A NJË KOHE TË ARSYESHME

MSc.Bora TOTOLAKU*

THE SUPPORTING ROLE OF THE JUDICIAL SECRETARY IN THE CRIMINAL PROCESS, FOR THE CONDUCT OF THE TRIAL WITHIN REASONABLE TIME

Abstract

The judicial secretary plays a very important role in the effective administration of the criminal process, directly influencing the respect of legal deadlines and the development of the trial within a reasonable time. His responsibilities help to avoid procedural delays and guarantee a fair process for all parties to the process.

One of the main functional duties of the court secretary is the timely initiation of notifications and procedural acts for court hearings, a procedure which enables the parties to be informed and prepared for the process, minimizing the risk of unnecessary postponements of court hearings or the development of ineffective court hearings. Likewise, photocopying and making available of acts/evidence to the parties is an important task that guarantees transparency and access to the acts of the file, helping in the preparation of the defense and effective legal representation.

Another important functional task is the transcription of the minutes of court hearings within a reasonable time, at the request of the trial panel, or the parties, or the summary of the court hearing notes. Delays or errors in transcription, depending on the procedural moment of the trial, may affect the process.

The auxiliary role of the judicial secretary in the criminal process is of particular importance for the progress of the trial. Through the efficient and responsible fulfillment of his duties, he contributes to the respect of the principle of trial within a reasonable time, as well as of adversarial proceedings, guaranteeing the regular functioning of the judicial system.

The professional development of judicial secretaries is essential, with a focus on expanding their roles into legal advisor positions, thereby strengthening the judicial system. Additionally, the digitalization of the court system plays a key role in enhancing the efficiency and effectiveness of judicial secretaries. By modernizing communication, documentation, and case management, digital tools help streamline the administrative and procedural tasks of judicial secretaries, enabling them to better support the trial process and improve overall court operations.

Keywords: *judicial secretary, criminal process, the conduct of a trial within a reasonable time, career development, digitalization*

1. Hyrje

* Sekretare gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tiranë.

Emri i Autorit

Një ndër parimet më të rëndësishme të së drejtës penale është zhvillimi i gjykimit brenda një kohe të arsyeshme. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)¹, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë² dhe Kodi i Procedurës Penale e sanksionojnë dhe e garantojnë këtë të drejtë, e cila në thelb, lidhet me shqyrtimin e çështjeve penale pa vonesa të pajustificuara. Në këtë kontekst, një rol kyç në administrimin dhe efikasitetin e procesit penal i përket sekretarit gjyqësor, i cili mbështet gjykatën, ndër të tjera, edhe në përmbushjen e këtij funksioni.

Sekretari gjyqësor është përgjegjës dhe ushtron një sërë detyrash funksionale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në vijimësinë e procesit penal, duke përfshirë nisjen në kohë të njoftimeve, fotokopjimin dhe vënien në dispozicion të akteve për palët si dhe transkriptimin e procesverbaleve të seancave gjyqësore. Përmbushja e këtyre detyrave në mënyrë efektive siguron një proces të drejtë dhe ndihmon në shmangien e shtyrjeve të panevojshme të seancave gjyqësore.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është ndikimi i digjitalizimit në përmirësimin e administratës gjyqësore, i cili ka për qëllim të bëjë më efektive dhe transparente proceset e gjykatave, përfshirë edhe funksionet e sekretarit gjyqësor. Implementimi i teknologjisë ka potencialin për të reduktuar vonesat dhe për të përmirësuar aksesin në dokumentacion dhe informacion, duke kontribuar kështu në një menaxhim më efikas të çështjeve dhe në përmbushjen e detyrave të sekretarit gjyqësor.

Ky punim ka për qëllim të analizojë dhe vlerësojë rolin ndihmës të sekretarit gjyqësor në procesin penal, duke u fokusuar në ndikimin e tij në zhvillimin e gjykimeve brenda një kohe të arsyeshme. Përmes një shqyrtimi të hollësishëm të detyrave kryesore të sekretarit gjyqësor, punimi synon të identifikojë sfidat dhe vështirësitë që hasen në praktikë dhe të sugjerojë masa për përmirësimin e këtij funksioni.

Punimi paraqet rëndësi sa i përket kuptueshmërisë së rolit dhe kontributit të sekretarit gjyqësor në mirëfunksionimin e drejtësisë penale. Përmirësimi i mekanizmave të administrimit gjyqësor, veçanërisht në aspektin e njoftimeve, aksesit në dokumente dhe transkriptimit të seancave, paraqitet i rëndësishëm për garantimin e një procesi penal të drejtë dhe efektiv. Gjithashtu, evidentimi dhe analizimi i sfidave të përditshme me të cilat përballen sekretarët gjyqësorë, eventualisht mund të ndihmojë në propozimin e politikave më të mira për administrimin e gjyqësorit dhe për avancimin e karrierës së tyre.

2. Rëndësia e gjykimit brenda një kohe të arsyeshme si një e drejtë themelore

Organi ekskluziv i parashikuar nga Kushtetuta dhe Ligji për dhënien e drejtësisë, është Gjykata. Gjykatat karakterizohen nga pavarësia dhe paanshmëria, duke iu nënshtruar vetëm Kushtetutës dhe Ligjeve. Për realizimin e këtij funksioni, pra dhënien e drejtësisë, gjyqtarët duhet të sigurojnë zbatimin e normave kushtetuese dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore, për të garantuar parimet e rëndësishme të shtetit të së drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në nenin 145, pika 1 e Kushtetutës parashikohet pavarësia e gjyqtarëve dhe nënshtrimi i tyre vetëm ndaj Kushtetutës dhe ligjeve. Njëherazi, kjo dispozitë ka ndaluar ndërhyrjen në veprimtarinë e gjykatave dhe të gjyqtarëve. Ky rregullim ligjor lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me funksionin e dhënies së drejtësisë nga gjykatat dhe gjyqtarët.

Në funksion të realizimit të qëllimit të mësipërm, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se edhe roli i administratës gjyqësore, pjesë e së cilës është edhe sekretari gjyqësor, nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor³.

Lidhur me rolin dhe rëndësinë e administratës gjyqësore, Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 46, datë 29.06.2015, ndër të tjera arsyeton se: “...14. Gjykata rithekson se roli dhe funksionimi i administratës gjyqësore nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor. E konsideruar nga ligjvënësi si pjesë integrale e organizimit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor dhe e interpretuar në jurisprudencën kushtetuese si pjesë organizative dhe funksionale e këtij

¹ KEDNJ, neni 6, 1950.

² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 42, 2016.

³ Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Vendimi nr. 19, datë 03.05.2007.

pushteti, administrata gjyqësore gëzon të njëjtën mbrojtje procedurale kushtetuese, në kuadër të procedurës së miratimit të ligjeve me shumicë të cilësuar, njëlloj siç parashikohet për pushtetin gjyqësor (shih vendimin nr. 10, datë 6.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese)....”.

Një ndër parimet me të rëndësishme të pushtetit gjyqësor, është ai i procesit të rregullt ligjor. Një ndër elementet thelbësore të këtij parimi është edhe aksesin në gjykim, që ndër të tjera përfshin të drejtën dhe mundësinë e shtetasve për t’iu drejtuar gjykatës. Neni 42 i Kushtetutës parashikon shprehimisht të drejtën e kujt do për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo e drejtë është e lidhur ngushtë gjithashtu me Nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Kështu së pari kjo e drejtë nënkupton të drejtën e kujt do për të ngritur padi në gjykatë. Kjo e drejtë, gjithsesi nënkupton jo vetëm të drejtën e individit për t’iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t’ia garantojë atij këtë mundësi. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesin në gjykatë është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera.

Një ndër aspektet përbërëse të procesit të rregullt ligjor, është edhe zhvillimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese, për të vlerësuar nëse ka tejzgjatje të paarsyeshme të afatit, janë përcaktuar disa kritere, të cilat në thelb lidhen me: (i) sjelljen e kërkuarit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuar⁴. Një rol shumë të rëndësishëm për zbatimin e drejtë të këtij parimi, luan vetë institucioni ligjzbatues, e në rastin konkret gjykata. Më poshtë analizohet roli i sekretarit gjyqësor, në funksion të mirëmbajtjes së këtij parimi.

3. Roli i sekretarit gjyqësor në procesin penal

3.1 Menaxhimi dhe administrimi i brendshëm në gjykata

Shpeshherë, ajo çfarë publiku njih dhe percepton mbi sistemin gjyqësor, lidhet ose me eksperiencën e tyre personale, e cila konkludon me një vendim gjyqësor apo me çështjet gjyqësore që marrin jehonë mediatike për shkak të rëndësisë së tyre apo personave të përfshirë në to, duke mos qenë kështu tërësisht të informuar dhe vetëdijësuar lidhur me gjithë menaxhimin administrativ dhe procedural që qëndron në thelb të veprimtarisë së gjyqësorit dhe që lidhet me tërësinë e burimeve njerëzore, financiare dhe teknike që shërbejnë dhe janë në funksion të kësaj veprimtarie.

Menaxhimi i brendshëm administrativ në gjykata, i cili ndonëse vepron si një sistem “i padukshëm”, të paktën për një pjesë të madhe të publikut, por edhe palëve pjesëmarrëse, përbën një element kyç i cili ndihmon për zhvillimin e proceseve gjyqësore efektive, në përputhje me çdo parim dhe standard të së drejtës. Thënë kjo, administrimi aktual por edhe ai eventual i gjykatave mund të ndryshojë dhe të rritet në dritën shekullit të XXI, duke krijuar dhe vënë në dispozicion infrastrukturën që do të mundësojë gjyqtarëve që të japin drejtësi⁵.

Gjykatat vazhdojnë të jenë të përmbytura nga një numër në rritje e sipër i çështjeve gjyqësore, ndërkohë që niveli i personelit dhe financave nuk ka ecur me të njëjtin ritëm me këtë kërkesë të publikut për shërbimet gjyqësore. Administratorët e gjykatave/kancelarët e kanë pasur shumë të vështirë për të shtuar në maksimum burimet që kanë në përdorim, tu japin udhë çështjeve në mënyrë efikase dhe të mirëmbajnë besimin e publikut në aftësinë e gjykatës për të administruar drejtësinë. Një vegël që i ndihmon gjykatat në adresimin e këtij problemi është menaxhimi i vëllimit të çështjeve gjyqësore. Menaxhimi i çështjeve gjyqësore, si një vegël shumë e rëndësishme e administrimit gjyqësor, është pranuar gjerësisht. Gjykata që kanë arritur të menaxhojnë me

⁴ Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Vendimi nr. 43, datë 04.06.2004.

⁵ Alexander, Aikman. *The Art and Practice of Court Administration*. New York: CRC Press, Auerbach Publications, 2007, f. 2.

efikasitet vëllimin e çështjeve që presin të gjykohen dhe u japin rrugë çështjeve në gjykim e sipër në një mënyrë të thjeshtë dhe të rregullt, ndihmojnë shumë administrimin e drejtësisë⁶.

Peter Drucker, i cili njihet si “babai i manaxhimit modern” është shprehur se “*Pa institucion nuk ka menaxhim. Por pa menaxhim, nuk ka institucion*”⁷. Alexander Aikman, ka përjasur menaxhimin e brendshëm të gjykatave, në nivel administrate gjyqësore por edhe në nivel teknik, me teorinë e një psikologu të njohur amerikan Abraham Maslow. Maslow ka krijuar teorinë e hierarkisë dhe nevojave⁸, sipas së cilës, njerëzit kanë nevoja të ndryshme që organizohen në një hierarki (të ndarë sipas tij në pesë nivele), ku nevojat bazë duhet të plotësohen para se të lindin ato më të larta: Nevojat fiziologjike; Nevojat për siguri; Nevojat sociale; Nevojat për vlerësim; Vetë-aktualizimi.

Në të njëjtin kontekst, Aikman ka përjasur nevojat njerëzore me ato të gjykatës si institucion, ku ka vlerësuar se gjykatat kanë nevoja të caktuara bazike të cilat duhet të plotësohen në mënyrë që misioni i gjykatës për dhënien e drejtësisë, të përmbushet me efektivitet. Pra, kur nevojat bazike plotësohen, gjykatat mund të avancojnë në aspektin e menaxhimit gjyqësor, si në kuadër të burimeve njerëzore, teknike, informatike etj. Pikërisht përcaktimi i kësaj “hierarkie të nevojave të gjykatave” do të individualizonte dhe rendiste në shkallë rëndësie të gjitha funksionet që duhet të realizohen brenda një gjykatë, për arritjen e qëllimit dhe detyrës kryesore: dhënien e drejtësisë.

Kështu, në mënyrë të ngjashme me funksionimin e psikologjisë njerëzore, në kuadër të plotësimit të nevojave në mënyrë hierarkike, gjykatat mund të përmirësojnë cilësinë e ofrimit të shërbimeve, të implementojnë programe dhe teknologji të reja, procedura më të gjëra dhe efektive për këtë qëllim. Në botën e sotme, të qënurit një gjykatë proaktive, në terma administrativë, është thelbësore për të pasur qëndrueshmëri⁹.

Në kontekstin e mësipërm, një rol të rëndësishëm në mirëadministrimin gjyqësor, luan dhe administrata gjyqësore, ku përfshihet edhe sekretari gjyqësor, roli dhe funksioni i së cilit është objekt i trajtimit të këtij punimi. Puna e sekretarit gjyqësor është e lidhur ngushtësisht me gjyqtarin/gjyqtarët pranë së cilit/ëve ai është caktuar, duke e shndërruar kështu këtë marrëdhënie profesionale, në një marrëdhënie *quasi* simbiotike e ndërvarësie.

Dhoma e një gjyqtari ndërtohet nga marrëdhënie të organizuara e strukturuara në mënyrë jo formale midis gjyqtarëve dhe stafit të tyre dhe ndërmjet anëtarëve të stafit. Pavarësisht nga burokratizimi që i karakterizon, ky mbetet një mjedis pune "në dhoma të vogla, të izoluara, me kontakte pune të limituara me jashtë", dhe këto marrëdhënie janë cilësuar si "më intensivitet dhe të ndërvarurat në mënyrë reciproke ... përveç martesës, prindërimit apo lidhjes së dashurisë"¹⁰.

Pra, në punën e tyre të përditshme, gjyqtarët ndihmohen nga sekretari gjyqësor, i cili është i përfshirë pothuajse në çdo fazë të procesit gjyqësor.

Pavarësisht dallimeve që ekzistojnë ndërmjet ofrimit të shërbimeve gjyqësore nga nëpunësit/sekretarët gjyqësore në juridiksione të vendeve të ndryshme, ato karakterizohen nga një qëllim i përbashkët i gjykatave të të gjitha shkallëve, që lidhet me uljen e ngarkesës së punës në tërësi, por edhe uljen e ngarkesës së punës për gjyqtarët, duke u mundësuar atyre të përqendrohen tek çështjet më të rëndësishme. Megjithatë, roli i nëpunësve ligjorë në rritjen e efikasitetit të shërbimeve gjyqësore, nuk është i lehtë për tu evidentuar¹¹.

3.2 Kuadri ligjor shqiptar në fuqi

Administrata gjyqësore në Republikën e Shqipërisë rregullohet dhe funksionon mbi bazën e një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore. Ligji 98/2016 “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”, i

⁶ Pamela, Ryder-LAHEY. Vangjel, Kosta. Toni, Gogu. *Administrimi i Gjykatave*, Kristalina-KH, Tirane: 2005, f. 131

⁷ Peter, Drucker. *Management: Tasks, Responsibilities, Practices*. New York: Harper & Row, 1973, f. 6.

⁸ Abraham, Maslow. “A Theory of Human Motivation”. *Psychological Review* 50, no. 4, Toronto: 1943, f. 370–396.

⁹ Alexander, Aikman. *The Art and Practice of Court Administration*. New York: CRC Press, Auerbach Publications, 2007, f. 13.

¹⁰ Stephen, Wasby. “A Judicial Secretary’s Many Roles: Working with an Appellate Judge and Clerks”, *The Journal of Appellate Practice and Process* 7, no. 1, Arkansas: 2005, f. 151.

¹¹ Gunnar, Grendstad. Lee, Epstein. Urska, Sadl. Keren, Weinshall. *The Oxford Handbook of Comparative Judicial Behavior*, Oxford: Oxford University Press, 2024, f. 442.

ndryshuar, parashikon ndër të tjera se në ushtrimin e pushtetit gjyqësor çdo gjykatë ndihmohet nga administrata gjyqësore, e cila përfshin shërbimet e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe shërbime të tjera mbështetëse. Po kështu, ky ligj parashikon se administrata gjyqësore realizon misionin e saj nëpërmjet shërbime gjyqësore, që mbështesin drejtpërdrejt veprimtaritë gjyqësore, duke përfshirë dokumentimin dhe veprimtari që kryhen nga këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, kryesekretarja dhe sekretarët gjyqësorë. Nga sa më sipër, kuptohet se administrata gjyqësore ndihmon në ushtrimin e pushtetit gjyqësor, nëpërmjet shërbimeve gjyqësore, që mbështesin në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimtarinë gjyqësore.

Gjithashtu, në Ligjin Nr. 109/2013 “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë” rregullohet statusi i nëpunësve civilë të shërbimit civil gjyqësor, si dhe kërkesat e veçanta për rekrutim në shërbimin civil gjyqësor. Neni 38 i këtij Ligji, me titull “Nëpunësit civilë të shërbimit civil gjyqësor” parashikohet se: “1. Shërbimi civil gjyqësor përbëhet nga kryesekretari gjyqësor, sekretarët gjyqësorë, nëpunësit gjyqësorë dhe nëpunësit e tjerë që ushtrojnë veprimtari administrative”

Kuadri ligjor mbi bazën e së cilit organizohet dhe funksionon administrata gjyqësore, është plotësuar dhe detajuar më tej edhe me urdhrin Nr. 1830, datë 3.4.2001 të Ministrit të Drejtësisë, me të cilin është miratuar rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore”.

Po kështu, me Vendimin nr. 150, datë 29.03.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar rregulla standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e dytë dhe e tretë, me zyra shërbimi, ku lidhur me sekretarin gjyqësor, ka përcaktuar si mision të tij që të dokumentojë saktë dhe qartë diskutimet në seancën gjyqësore dhe të ndihmojë gjyqtarin/trupën gjyqësore gjatë seancave gjyqësore deri në përfundimin e çështjes, duke përfshirë zbardhjen e vendimit, sipas rastit të përgatisë njoftimet për palët, si dhe të hedhë të dhënat në regjistrat, si dhe sistemin elektronik të gjykatës.

Lidhur me mjedisin menaxherial, rregullat e mësipërme përcaktojnë se puna e sekretarit gjyqësor ndikon në procesin e punës së gjykatës, duke filluar nga të drejtat procedurale të palëve; në punën e gjyqtarit; zyrën e regjistratit; punën e punonjësve të gjykatës të caktuar për realizimin e njoftimeve; si dhe punën e kryesekretarit dhe kancelarit, të cilët janë mbikëqyrës të punës së tij.

Pra, administrata gjyqësore në Republikën e Shqipërisë është e rregulluar dhe funksionon mbi një kuadër të gjerë ligjor dhe nënligjor, i cili ka për qëllim garantimin e një procesi të rregullt gjyqësor. Ky kuadër ligjor është i detajuar në disa akte të rëndësishme, të cilat përcaktojnë jo vetëm detyrat dhe përgjegjësitë e sekretarëve gjyqësorë, por edhe mbrojtjen e statusit të nëpunësve civilë gjyqësorë.

Aktet e mësipërme theksojnë se administrata gjyqësore është një pjesë e pandashme e procesit gjyqësor, e cila ka si mision mbështetjen e gjykatave për të siguruar dhënien e drejtësisë. Në këtë kuadër, vërehen gjithashtu kërkesat e veçanta për rekrutimin dhe përgatitjen e punonjësve të administratës gjyqësore, duke pasur si qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të administratës gjyqësore.

3.2.1 Detyrat funksionale të sekretarit gjyqësor të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale

Kodi i Procedurës Penale parashikon në mënyrë eksplicite disa nga detyrat funksionale kryesore të sekretarit gjyqësor, të cilat në tërësi lidhen me transkriptimin apo zbardhjen e shënimeve të përmbledhura të seancës gjyqësore, të parashikuara përkatësisht nga nenet 116 dhe 116 të K.Pr.Penale.

Lidhur me konceptin e “procesverbalit të seancës”, Gjykata e Lartë ka unifikuar praktikën gjyqësore me Vendimin Unifikues nr.1, datë 27.04.2015, ku ndër të tjera ka vlerësuar se mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore nëpërmjet regjistrimit audio dhe audioviziv, është jo vetëm në përputhje me nenin 115 e vijues të K.Pr.Penale, por duke u parashikuar prej tij si një nga mjetet e mbajtjes së procesverbalit, rrit efektivitetin, eficiencën dhe garanton transparencën në seancat gjyqësore duke përmbushur në mënyrë shteruese dhe autonome funksionin dokumentues të veprimeve procedurale.

Tashmë, në sistemin gjyqësor shqiptar është i instaluar sistemi i regjistrimit audio të seancave gjyqësore, mënyra e funksionimit dhe përdorimit të së cilit është e rregulluar me Vendimin nr. 353 datë 11.07.2024 të

Emri i Autorit

Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e udhëzimit “Për mënyrën e përdorimit të teknologjisë audio/audiovizive në procesin gjyqësor”, nga përmbajtja e së cilit evidentohet qartësisht roli i rëndësishëm që ka sekretari gjyqësor lidhur me regjistrimin audio gjatë procesit gjyqësor, krijimin e shënimeve të përmbledhura që shoqërojnë këtë regjistrim si dhe vënien e tyre në dispozicion të palëve.

Për sa normojnë dispozitat më sipër, evidentohet se sekretari gjyqësor luan një rol kyç në dokumentimin e saktë dhe të plotë të seancave gjyqësore, duke garantuar që procesi të zhvillohet në përputhje me ligjin dhe brenda një afati të arsyeshëm. Shpeshherë, sidomos në rastin e çështjeve penale që paraqesin kompleksitet, si në aspektin e llojit të akuzave, numrit të të pandehurve, llojit të gjykimit (i zakonshëm), nga ana e palëve pjesëmarrëse në proces kërkohet zbardhja e shënimeve të përmbledhura të seancës apo transkriptimi i saj, e cila paraqet mjaft rëndësi, në kuadër të garantimit të së drejtës së palëve për tu njohur në mënyrë të detajuar me zhvillimet e seancës, sidomos në rastet kur kemi të bëjmë me dhënie dëshmish nga ana e dëshmitarëve, diskutime e debitime aktesh ekspertimit etj. Duke marrë parasysh nivelin e ngarkesës në disa gjykata, shpeshherë sekretaria gjyqësore ka vështirësi në zbardhjen në kohë të tyre, për shkak të detyrimit për të përmbushur të tjera detyra funksionale. .

Pra, pamundësia e zbardhjes në kohë të thënieve, deklarimeve, debatit, dëshmimeve të dhëna në procesin gjyqësor penal, përbën një shkak potencial për shtyrjen e seancës gjyqësore, duke qenë se në disa raste, siç edhe u përmendën më sipër, për shkak të kompleksitetit të çështjeve gjyqësore, palëve nuk mund ti garantohet e drejta për një mbrojtje efektive, në rast se nuk njihen me transkriptin e seancës gjyqësore.

Në këtë kontekst, një ndër sfidat më të mëdha mbetet kapaciteti i kufizuar i sistemit gjyqësor për të përballuar ngarkesën e transkriptimit të materialeve audio, sidomos në rastet e proceseve gjyqësore ku pyeten shumë dëshmitarë, apo senca shumë të gjata gjyqësore. Edhe pse regjistrimi është një mjet efikas, manualiteti i kërkuar për transkriptimin e këtyre regjistrimeve mund të jetë i lodhshëm dhe mund të ndikojë në saktësinë dhe kohën e procesit. Për më tepër, mundësia e gabimeve njerëzore gjatë transkriptimit është gjithashtu një faktor tjetër që duhet marrë në konsideratë.

Ndaj, është e rëndësishme që të zhvillohen dhe të përmirësohen mjetet teknologjike për transkriptimin automatik, duke integruar sisteme të automatizuara për transkriptimin e regjistrimeve, që jo vetëm që përmirësojnë efikasitetin, por gjithashtu reduktojnë mundësinë e gabimeve njerëzore.

Në kuadër të zhvillimit të gjykimit brenda një kohë të arsyeshme, me rëndësi paraqitet zhvillimi i seancave gjyqësore efektive, ku një prej shkaqeve të mundshme të shtyrjes së seancës gjyqësore, është edhe mosnjohja e palëve me aktet/provat e gjykimit. Në rastin e çështjeve gjyqësore komplekse, të cilat shoqërohen dhe më një numër të lartë aktesh dhe provash, paraqitet sfiduese nga ana praktike, mundësia e njohjes së palëve me materialet e plota, brenda një kohe të arsyeshme, e cila passjell edhe shtyrje të seancës gjyqësore.

Kjo për shkak të pamundësisë objektive dhe logjike për të përpunuar informacionin e marrë, por edhe shkaqe objektive që lidhen me vetë funksionimin e brendshëm të gjykatës, ku sekretari gjyqësor është i angazhuar me detyra të tjera funksionale dhe në disa raste gjendet në pamundësi kohore për të realizuar edhe këtë detyrë. Në këtë kuadër, është i nevojshëm përmirësimi i cilësisë së ofrimit të këtij shërbimi gjyqësor, në mënyrë që të gjithë aktorët proceduralë, palët pjesëmarrëse në gjykim, të njihen me të gjitha aktet dhe provat mbi bazën e së cilave është inicuar dhe zhvillohet procesi gjyqësor.

Lidhur me sa më sipër, GJEDNJ ka vlerësuar se palët në proces kanë të drejtën të paraqesin vërejtjet që i çmojnë të rëndësishme për çështjen. Kjo e drejtë është efektive vetëm nëse kërkesat dhe vërejtjet e palëve dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykata. Kështu, gjykata duhet të bëjë një shqyrtim efektiv të mjeteve, argumenteve dhe provave të dhëna nga palët¹². Për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave të garantuara nga ky nen, autoritetet gjyqësore duhet të garantojnë të drejtën e palës ndërgjyqëse për tu përfaqësuar nga një avokat. Zhvillimi i një procesi efektiv penal kërkon që gjykata t'i mundësojë palëve në gjykim, që të njihen me të gjitha aktet dhe provat e depozituara dhe nuk ka rëndësi ndonjë ndonjë prej palëve ka ndonjë ankesë për këtë procedurë apo nëse ka marrë vet iniciativën për të pasur akses në dokumentacionin e dosjes¹³. Vetëm mundësia e ndërgjyqësit për të parë dosjen në sekretari dhe për të marrë një kopje të saj nuk është në vetvete një garanci e mjaftueshme. Nëse autoritetet përgjegjëse, pa ndonjë një arsye bindëse, kanë penguar kërkuesit që të kenë akses në dokumentet që ajo ka në

¹² GJEDNJ, Kraska kundër Zvicrës, nr. 13942/88, vendim i datës 4 Tetor 1990.

¹³ GJEDNJ, Kerojärvi kundër Finlandës, nr. 17506/90, vendim i datës 19 Korrik 1995.

administrim, të cilat do t'i kishin ndihmuar në përgatitjen e mbrojtjes lidhur me çështjen, kjo do të konsiderohet si një privim nga një proces i rregullt gjyqësor, në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së¹⁴.

Për sekretarin gjyqësor, kjo detyrë funksionale shpeshherë paraqitet sfiduese, sidomos në rastet kur çështjet penale përmbajnë një numër të lartë fashikujsh hetimorë, për të cilat nevojitet një kohë e gjatë që të fotokopjohen për tu vënë në dispozicion të palëve, kohë e cila është e vështirë për tu krijuar brenda orarit zyrtar të punës. Në këtë kuadër, shtimi i administratës gjyqësore me pozicione të veçanta, të cilat në kuadër të menaxhimit të brendshëm gjyqësor do të realizonin funksionin e mësipërm, do të ishte i vlefshëm për zgjidhjen e ngërçeve që krijohen nga problematika e sipërcituar. Po kështu, edhe mungesa e pajisjeve teknike eficiente dhe me rendimet të lartë, por dhe numri i vogël i tyre, bën që ky proces, pra shumëfishimi i materialeve gjyqësore për palët në proces, të vështirësohet. Ndaj, del e nevojshme investimi i mëtejshëm edhe në këtë aspekt teknik, në kuadër të mirëadministrimit gjyqësor.

3.2.2 Nisja në kohë e njoftimeve dhe efekti i tyre në gjykim

Po kështu, një ndër shkaqet e mundshme të shtyrjes së seancave gjyqësore, është mungesa e dijenisë së palëve pjesëmarrëse, apo mosekzekutimi në kohë i urdhërave të gjykatës mbi njoftimin/kërkimin e tyre për paraqitje, bazuar në rregullat mbi njoftimin e të pandehurit apo palëve të tjera që kanë cilësinë e viktimës/kallëzuesit nga vepra penale, viktimës person juridik etj, të parashikuara nga nenet 132 e vijues të K.Pr.Penale. Përpos veprimtarisë së institucioneve të tjera bashkëpunuese, si Drejtoritë Vendore të Policisë, Komisarariatet e Policisë, Njësitë Administrative, Shërbimi Postar dhe shërbimeve që ata ofrojnë në përmbushje të detyrave funksionale (përmbushja me vonesë e së cilave në shumë raste passjell shtyrjen e gjykimit), të cilat nuk janë objekt i trajtimit të këtij punimi, edhe sekretaria gjyqësore luan një rol shumë të rëndësishëm, i cili lidhet së pari me përpilimin dhe nisjen në kohë të njoftimeve respektive sipas urdhërimit të trupës gjyqësore, në mënyrë që ato të mbërrijnë në një kohë sa më shpejtë pranë institucioneve që drejtohen për zbatim. Pra, përmbushja me përpikëri e detyrave të sekretarit gjyqësor ndihmon në përshpejtimin e procesit penal duke reduktuar burokracitë dhe vonesat e panevojshme. Në të kundërt, mungesa e organizimit ose vonesat në përmbushjen e detyrave të tij mund të ndikojnë negativisht në afatet kohore të gjykimit. Njoftimi i saktë dhe në kohë është një element kyç dhe për garantimin e së drejtës për një mbrojtje efektive, ku të gjitha palët e përfshira në një proces duhet të njoftohen për seancat gjyqësore dhe për aktet procedurale në mënyrë që të kenë mundësi të përgatisin mbrojtjen e tyre.

Lidhur me sa më sipër, Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj konstante, ka përcaktuar disa standarde kushtetuese të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë, që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi, për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë, në raport me palën kundërshtare. Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet vendimeve të saj, ka vënë në dukje se pjesëmarrja e palëve në gjykim, dëgjimi i pretendimeve të tyre për provat dhe interpretimin e ligjit në çështjen konkrete garantohej nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe se kjo pjesëmarrje, i shërben palëve për të bërë një mbrojtje sa më efektive, por njëkohësisht është dhe në interes të drejtësisë.

Me Vendimin nr.34, datë 03.10.2007, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar ndër të tjera se “ *E drejta për t'u mbrojtur, e cila realizohet nëpërmjet të drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim, përbën një aspekt të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor. Realizimi i kësaj të drejte shtrihet para organeve gjyqësore detyrimin për të njoftuar palët dhe mbrojtësit e tyre për datën dhe orën e zhvillimit të seancës, për të siguruar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar padrejtësisht nga gjykimi*”.

E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, i paraprin të drejtave të tjera, pasi, nëse pala ndërgjyqësore nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar

¹⁴ GJEDNJ, Göç v. Turqisë, nr. 36590/97, vendim i datës 11 Korrik 2002.

të drejtat e sipërpërmendura, të cilat i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor.

Në vendimin e sipërcituar, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar gjithashtu se “*Rekursi që ushtrohet ndaj vendimit të gjykatës së apelit, i duhet njoftuar palës së interesuar, për t’i dhënë asaj mundësi për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë dhe për t’u mbrojtur*”. Në rastin në shqyrtim, moskomunikimi i rekursit i ka mohuar kërkesit të drejtën e pjesëmarrjes në gjykim në gjykatë dhe të mbrojtjes, çka e bëri procesin të parregullt në kuptimin kushtetues. Privimi i palës në proces nga mundësia, që nëpërmjet përfaqësimit të mbrojtje interesat e veta në gjykim, është konsideruar shkelje e standardeve të procesit të rregullt në shumë vendime të Gjykatës Kushtetuese.

E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t’i garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por përkundrazi duhet që legjislacioni procedural në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit, t’u japin mundësi të barabarta palëve, për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre.

Po kështu GJEDNJ ka një praktikë të pasur lidhur me të drejtën për të qenë i informuar për procesin gjyqësor dhe pjesëmarrjen në seancë, që është e lidhur ngushtë me rolin administrativ dhe funksional të sekretarit gjyqësor, megjithëse ky rol nuk përmendet gjithmonë në mënyrë eksplicite në vendimet e saj.

Në çështjen *Sejdovic kundër Italisë*, GJEDNJ vlerësoi se informimi për ndjekjen penale është një akt procedural me rëndësi të tillë që duhet realizuar në mënyrë të tillë që të garantojë në mënyrë efektive ushtrimin e të drejtave të mbrojtjes. Në këtë rast, dështimi i autoriteteve për të njoftuar të pandehurin për datën dhe vendin e gjykimit përbënte shkelje të të drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi ai nuk kishte pasur mundësi reale të merrte pjesë në proces dhe të mbrohej¹⁵.

Edhe pse vendimet e GJEDNJ nuk e përmendin rolin e sekretarit gjyqësor në mënyrë të drejtpërdrejtë, kuptohet se çdo mangësi në njoftim bie së pari mbi praktikatat administrative të gjykatës. Në praktikën gjyqësore, kjo përfshin përgjegjësinë e sekretarisë për përpilimin, nisjen dhe ndjekjen e njoftimeve, çka ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi respektimin e të drejtave të palëve.

4. Rëndësia e Sekretarit Gjyqësor dhe Praktika Gjyqësore e GJEDNJ

Sekretari gjyqësor luan një rol thelbësor në administrimin e drejtësisë, duke garantuar që procesi gjyqësor të zhvillohet në mënyrë të rregullt, transparente dhe brenda një afati të arsyeshëm. Ky rol është veçanërisht i rëndësishëm në kuadrin të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i cili garanton të drejtën për një gjykim të drejtë. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka trajtuar raste ku problemet në administrimin gjyqësor, përfshirë gabimet ose neglizhencën e sekretarëve gjyqësorë, kanë sjellë shkelje të kësaj të drejte.

Në çështjen *Scopelliti kundër Italisë (1993)*¹⁶, GJEDNJ ka vlerësuar se mungesa e një procesverbal të saktë dhe të plotë ndikoi në aftësinë e palës për të mbrojtur veten në apel. Gjykata ka theksuar se nëse një procesverbal nuk pasqyron qartë provat dhe argumentet e sjella në seancë, kjo mund të cenojë të drejtën për një gjykim të drejtë.

Në çështjen *H. kundër Francës (1989)*¹⁷, GJEDNJ ka konstatuar se vonimi i transkriptimit të seancave nga administrata gjyqësore, çoi në një vonesë të pajustificuar të procesit gjyqësor. Gjykata e konsideroi këtë një shkelje të afatit të arsyeshëm të gjykimit, duke theksuar se administrimi joefektiv mund të çojë në cenim të të drejtave procedurale të palëve.

Në çështjen *Kamasinski kundër Austrisë (1989)*¹⁸, GJEDNJ ka konstatuar se kur një i pandehur nuk ka mundësi të shqyrtojë procesverbalet ose transkriptimet e seancave, ai mund të jetë i privuar nga ushtrimi efektiv i të drejtave të tij mbrojtëse. Në këtë rast, mungesa e një dokumentimi të qartë nga sekretari gjyqësor ndikoi në të drejtën për t’u mbrojtur në apel.

¹⁵ GJEDNJ, *Sejdovic kundër Italisë*, nr. 56581/00, vendim i datës 1 Mars 2006.

¹⁶ GJEDNJ, *Scopelliti kundër Italisë*, nr. 15511/89, vendim i datës 23 Nëntor 1993.

¹⁷ GJEDNJ, *H. kundër Francës*, nr. 10073/82, vendim i datës 24 Tetor 1989.

¹⁸ GJEDNJ, *Kamasinski kundër Austrisë*, nr. 9783/82, vendim i datës 19 Dhjetor 1989.

Në çështjen *Frydlander kundër Francës (2000)*¹⁹, ankuesi pretendonte se gjykimi i tij zgjati përtej një afati të arsyeshëm, pjesërisht për shkak të neglizhencës së administratës gjyqësore. GJEDNJ konstatoi se: Procesi kishte zgjatur mbi 10 vjet, kryesisht për shkak të vonimit të administratës gjyqësore në përgatitjen e dokumenteve dhe organizimin e seancave. Mungesa e efikasitetit të sekretarisë gjyqësore kishte ndikuar në mosrespektimin e afatit të arsyeshëm të gjykimit, duke shkelur nenin 6 të KEDNJ.

Në çështjen *Djanzozov kundër Bullgarisë (2004)*²⁰, GJEDNJ ka konstatuar se një nga arsyet kryesore për zvarritjen e gjykimit ishte neglizhenca e administratës gjyqësore, përfshirë sekretarin gjyqësor, për të përmbushur detyrat e tij. Dokumentet gjyqësore ishin dorëzuar me vonesë tek palët, duke penguar zhvillimin e procesit; Procesverbalet nuk ishin përgatitur në kohën e duhur, duke bërë që disa seanca të shtyheshin. Këto probleme krijuan zvarritje të panevojshme, duke shkelur të drejtën për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

Praktika e mësipërme e GJEDNJ tregon qartë se roli i sekretarit gjyqësor nuk është thjesht administrativ, por thelbësor për garantimin e të drejtave procedurale të palëve.

5. Rëndësia e procesit të digjitalizimit të dosjeve dhe njoftimeve

5.1 Digjitalizimi i sistemit gjyqësor

Digjitalizimi i sistemit gjyqësor është një nga reformat kryesore që synon përmirësimin e efikasitetit, transparencës dhe aksesit në drejtësi. Në shumë vende evropiane, gjyqtarët dhe ekspertët kanë vlerësuar pozitivisht ndikimin e teknologjisë në administrimin e drejtësisë, ndërsa GJEDNJ ka theksuar përgjegjësinë e shteteve për të garantuar një proces të shpejtë dhe efektiv, sipas nenit 6 të Konventës KEDNJ.

Procesi i mësipërm do të ndikonte në disa aspekte thelbësore të mirë administrimit gjyqësor: si administrimi i dosjeve, menaxhimi i njoftimeve dhe rritja e transparencës. Të gjithë aktorëve proceduriale (gjykatës, palëve, avokatëve mbrojtës) do tu garantohej akses më i shpejtë në dosjet gjyqësore, duke shmangur burokracitë. Po kështu, ruajtja e dokumenteve në arkiva digjitale, do të reduktonte rrezikun e dëmtimit ose zhdukjes së tyre. Njëherazi, ky proces do të shkurtojte kohën e përgatitjes për shqyrtimin gjyqësor, ku si gjyqtarët, ashtu edhe administrata gjyqësore, do të mund të konsultonin dosjet elektronike, në çdo kohë që paraqitet e nevojshme.

Sa i takon procesit të digjitalizimit të njoftimeve gjyqësore, ai do të bënte të mundur që njoftimet për seancat gjyqësore, vendimet e gjykatës dhe të tjera akte proceduriale, të mund të dërgoheshin në mënyrë të automatizuar, duke garantuar në këtë mënyrë dhe provën për dërgimin dhe marrjen e tyre nga ana e personit që i adresohen. Njëherazi, ky proces do të ulte kostot operative për bazën materiale, tarifën e shërbimeve postare etj.

Në Shqipëri, sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore është përballur me disa sfida, duke përfshirë mbingarkesën e gjykatave dhe mungesën e teknologjisë së avancuar. Shembuj suksesi që vijnë nga Evropa, lidhen me sisteme teknologjike gjyqësore të përdorura në disa shtete, si: Estonia, e cila përdor një sistem të integruar të “e-Justice”, ku qytetarët mund të ndjekin zhvillimin e çështjeve dhe të dërgojnë materiale dhe dokumenta të nevojshme për gjykimin online. Estonia është një nga liderët globalë në përdorimin e teknologjisë për administratën publike, përfshirë sistemin e drejtësisë “e-Justice” i cili mundëson që qytetarët dhe përfaqësuesit ligjorë të aksesojnë dosjet, të ndjekin statusin e çështjeve, dhe të bëjnë kërkesa për vendime apo dokumente online. Në vitin 2018, Estonia u rendit si një nga vendet me sistemin më të përparuar të e-Justice në Evropë, duke u vlerësuar për eficiencën dhe shpejtësinë e procesimit të çështjeve, duke ulur vonesat dhe ngarkesën e administratës gjyqësore²¹.

Po kështu, edhe Holanda ka implementuar një sistem të avancuar për administrimin e çështjeve gjyqësore, duke përdorur një platformë të përbashkët që lidh gjykatat dhe institucionet e tjera, për të mundësuar shkëmbimin e informacionit dhe përsheptimin e procedurave. Holanda ka implementuar një sistem të njohur si “Hoge Raad

¹⁹ GJEDNJ, *Frydlander kundër Francës*, nr. 30979/96, vendim i datës 27 Qershor 2000.

²⁰ GJEDNJ, *Djanzozov kundër Bullgarisë*, nr. 45950/99, vendim i datës 8 Korrik 2004.

²¹ P, Paju. “Estonia’s e-Justice System: A Digital Revolution in Court Administration”, *Estonian Law Review* 14, no. 3, Tallin: 2018, f. 34–50

e-Justice”, i cili mundëson ndjekjen dhe menaxhimin e dosjeve elektronike në të gjitha nivelet e gjyqësorit. Ky sistem përdor një platformë të përbashkët që lidhet me sistemet e tjera të administratës publike, duke mundësuar shkëmbimin e informacionit dhe përshpejtimin e procedurave. Qytetarët, përfaqësuesit ligjorë dhe gjykatat mund të dërgojnë dhe marrin dokumente dhe njoftime elektronike, duke përmirësuar efikasitetin dhe përshpejtuar procesin gjyqësor. Në sajë të këtij sistemi, Holanda ka parë një rritje të konsiderueshme të efikasitetit në trajtimin e çështjeve, me një ulje të ndjeshme të vonesave dhe një rritje të transparencës²².

Më poshtë sillen disa shembuj nga procesi i digjitalizimit të njoftimeve në sistemin gjyqësor evropian:

Në Francë, sistemi "Télérecours" lejon shkëmbimin e dokumenteve elektronike midis palëve dhe gjykatave, duke përshpejtuar shqyrtimin e çështjeve.

Në Gjermani, përdorimi i "Elektronisches Gerichts- und Verwaltungspostfach (EGVP)" ka reduktuar ndjeshëm kohën për shqyrtimin e dosjeve.

Në Itali, sistemi "Processo Civile Telematico" ka zvogëluar ndjeshëm kohën e njoftimeve për palët.

Në Spanjë, përdorimi i platformës "LexNET" për komunikime elektronike ka ulur numrin e shtyrjeve të proceseve për shkak të mosrealizimit të njoftimeve.

Disa gjyqtarë evropianë kanë theksuar rëndësinë e digjitalizimit dhe reformës së administratës gjyqësore:

Koen Lenaerts (President i Gjykatës së Drejtësisë së BE-së): "*Digjitalizimi i drejtësisë është i pashmangshëm për të siguruar akses më të shpejtë dhe më transparent në drejtësi për qytetarët e BE-së.*"²³

Robert Spano (Ish-President i GJEDNJ-së): "*Mungesa e burimeve njerëzore dhe infrastruktura e dobët administrative mbeten faktorë kryesorë që çojnë në shkelje të së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.*"²⁴

Siç evidentohet, përdorimi i sistemeve digjitale të menaxhimit të dosjeve dhe njoftimeve në Evropë ka sjellë përfitime të mëdha për sistemet gjyqësore, duke përmirësuar efikasitetin, ulur kostot dhe rritur aksesin dhe transparencën. Edhe në Shqipëri, mund të ndiqen modele të ngjashme të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, për ta modernizuar dhe përmirësuar atë, përmes implementimit të sistemeve elektronike, me kapacitet të tillë për të mbajtur e ngarkuar elektronikisht përmbajtjen dokumentare të një dosje gjyqësore dhe njëherazi, mundësimin e palëve për të aksesuar. Krijimi i një sistemi automatik i cili do të kishte në përbërje të tij rubrika që lidhen me afatin maksimal të nisjes së njoftimeve për palët, afatin maksimal brenda të cilit duhet të përfundojë shqyrtimi i një çështje të caktuar gjyqësore (nëse ligji parashikon një të tillë), do të sillte vazhdimisht elementet e mësipërme në vëmendje të përdoruesëve të tij, sekretarit gjyqësor dhe gjyqtarit, të cilat do të shmangnin kalimin e këtyre afateve, shpeshherë për shkak të pamundësisë së verifikimit individual për gjithsecilën dosje gjyqësore.

5.2 Sfidat e sistemit elektronik të njoftimeve për palët dhe përfaqësuesit ligjorë

Ndonëse modernizimi i sistemit gjyqësor në Shqipëri, si sa i takon digjitalizimit të dosjeve gjyqësore, ashtu edhe procedurës së njoftimeve, është mjaft i rëndësishëm në kuadër të efikasitetit dhe transparencës, mundet që ai të passjellë një sërë problematikash që lidhen me luadrin ligjor dhe aksesin, sidomos për grupet vulnerabël.

5.2.1 Pabarazia në aksesin në sistemet teknologjike

Një ndër sfidat kryesore është padyshim pamundësia e përdorimit të teknologjisë nga shtetasit të cilët nuk kanë mundësinë, mjetet apo aftësitë e duhura. Këtu përfshihen shtetasit që nuk kanë njohuri në këtë fushë dhe sidomos

²² F, Van den Broek. "Integrated Court Management in the Netherlands: A Case Study", *International Journal of Court Administration* 5, no. 1, 2017, f. 43–54

²³ Koen, Lenaerts. "The Role of the Court of Justice of the European Union in the Protection of Fundamental Rights," fjalim i mbajtur në Leuven University, 12 Mars 2022, https://www.edps.europa.eu/press-publications/publications/podcasts/20-talks-koen-lenaerts-president-court-justice-european-union_en.

²⁴ Spano, Robert. "Judicial Independence and the Rule of Law," fjalim në Leuven: 2022., https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/Speech_20220312_Spano_Leuven_University_ENG

ata që jetojnë në zona rurale. Një sistem njoftimesh që supozon kompetenca të barabarta digjitale rrezikon të përjashtojë individët më të pambrojtur nga qasja efektive në drejtësi²⁵. Personat që nuk kanë mundësi ekonomike që të sigurojnë përfaqësim ligjor, të moshuarit, qytetarët me aftësi të kufizuara ose ata që nuk zotërojnë njohuri teknologjike janë në rrezik të lartë për t'u përjashtuar nga përdorimi efektiv i sistemit elektronik. Në mungesë të mekanizmave mbështetës, si ndihma ligjore, shpjegimet me gjuhë të thjeshtuar dhe trajnimet për përdorim, ata mbesin të papërfaqësuar dhe të pambrojtur²⁶.

5.2.2 Mungesa e përcaktimeve të qarta ligjore dhe sfidat në provueshmëri

Mungesa e një kuadri të qartë ligjor që të përcaktojë rregullat e vlefshmërisë, dorëzimit dhe provueshmërisë së njoftimeve elektronike, mund të shfaqet si një problem i karakterit procedural. Kjo do të passillte një lloj pasigurie për gjyqtarët, përfaqësuesit ligjorë dhe palët në lidhje me afatet dhe efektet procedurale të njoftimeve²⁷. Rrjedhimisht, palët mund të ngrenë pretendime lidhur me vlefshmërinë e njoftimeve në gjykatë, duke e zgjatur dhe ndërlikuar procesin gjyqësor. Po kështu, një sfidë praktike është të provuarit e momentit të dorëzimit të njoftimit. Në mungesë të një mekanizmi të sigurt verifikimi, siç është nënshkrimi elektronik apo sistemi i gjurmimit të dërgesës, është e vështirë të përcaktohet nëse njoftimi është marrë apo jo dhe kur. Kjo prek drejtpërdrejt llogaritjen e afateve ligjore dhe mund të sjellë humbje të të drejtave procedurale për palët.

5.2.3 Pasiguria teknologjike

Stabiliteti i platformave elektronike është thelbësor për funksionimin pa ndërprerje të sistemit të njoftimeve. Një sistem që varet nga rrjete të pasigurta, serverë jostabilë apo mungesë të mbështetjes teknike rrezikon të krijojë bllokime dhe ndërprerje në procesin gjyqësor. Kjo jo vetëm që ndikon në efikasitetin e sistemit, por rrit edhe pasiguritë për palët dhe profesionistët.

6. Konkluzione dhe rekomandime

Në përfundim, konkludojmë se zhvillimi i një procesi gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme është një e drejtë themelore e individit dhe një parim i rëndësishëm i drejtësisë penale, i garantuar dhe sanksionuar nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Kodi i Procedurës Penale. Në këtë kontekst, një rol kyç në administrimin dhe efikasitetin e procesit penal i përket sekretarit gjyqësor, i cili mbështet gjykatën në përmbushjen e procedurave brenda afateve të përcaktuara, nëpërmjet zbatimit me përgjegjësi të detyrave të tij, duke përfshirë nisjen në kohë të njoftimeve, fotokopjimin dhe vënien në dispozicion të akteve për palët si dhe transkriptimin/zbardhjen e shënimeve të përmbledhura të procesverbaleve të seancave gjyqësore. Përmbushja e këtyre detyrave në mënyrë efektive siguron një proces të drejtë dhe ndihmon në shmangien e shtyrjeve të panevojshme të gjykimeve.

Disa nga problematikat që shfaqen në këtë aspekt, në punën e përditshme të sekretarisë gjyqësore lidhen me mungesën e stafit të mjaftueshëm për shpërndarjen e njoftimeve, përdorimin e një sistemi tradicional për realizimin e njoftimeve dhe fotokopjimin e akteve, mungesën e mjeteve të duhura teknike për fotokopjimin e dokumenteve apo mungesën e teknologjisë së transkriptimit automatik.

Po ashtu, konstatohet nevoja për njohjen dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të sekretarëve gjyqësorë përmes krijimit të një mundësi të prekshme të zhvillimit të karrierës, që mundëson kalimin e tyre në role më të specializuara si ndihmës ligjor pranë gjyqtarëve, bazuar në përvojën dhe njohjen e thellë të praktikës gjyqësore. Një qasje e tillë do të sillte jo vetëm përmirësim të cilësisë së punës mbështetëse ndaj trupit gjykues, por edhe motivim dhe stabilitet në administratën gjyqësore.

²⁵ Castells, Manuel. *The Rise of the Network Society*. Oxford: Blackwell, 2000

²⁶ Creutzfeldt, Naomi. "Digitalization and Access to Justice." *Legal Studies* 40, Kent: f. 136–154

²⁷ Zouridis, Stavros. Marijn, van Eck. "Legal Uncertainty in e-Government Systems", *Information Polity* 18, Leiden: f. 227–238

Emri i Autorit

Lidhur me këto problematika të evidentuara, rekomandojmë si më poshtë:

- Digjitalizimi i dosjeve gjyqësore, për të mundësuar menaxhimin më të mirë të informacioneve dhe akses më të shpejtë për palët;
- Përdorimi i njoftimeve elektronike për të shmangur vonesat manuale dhe për të përmirësuar gjurmueshmërinë e komunikimeve;
- Digjitalizimi i dokumenteve dhe krijimi i aksesit online për palët;
- Automatizimi i procesit të shpërndarjes së akteve;
- Përdorimi i softuerëve të transkriptimit automatik për të shpejtuar procesin dhe për të garantuar saktësi në përmbajtjen e procesverbaleve;
- Shtimi i burimeve njerëzore në administratën gjyqësore për të ndarë ngarkesën e punës;
- Trajnimi i administratës gjyqësore lidhur me përdorimin efektiv të sistemeve gjyqësore digjitale;
- Miratimi i ndryshimeve ligjore për mundësinë e zhvillimit të karrierës për sekretarët gjyqësorë, në role të tilla si ndihmës ligjor, bazuar në kritere meritokracie dhe vlerësimi objektiv të aftësive teorike dhe praktike;

Përmes shtimit të burimeve njerëzore, përmirësimit të sistemit të njoftimeve, aksesit në dokumente dhe transkriptimit të procesverbaleve, mund të shmangen vonesat dhe të rritet efikasiteti i drejtësisë penale. Investimi në këto përmirësime do të ndikojë drejtpërdrejt në garantimin e një gjykimi efikas dhe të drejtë për të gjitha palët.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Aikman, Alexander. *The Art and Practice of Court Administration*. New York: CRC Press, Auerbach Publications, 2007
2. Castells, Manuel. *The Rise of the Network Society*, Oxford: Blackwell, 2000
3. Creutzfeldt, Naomi. "Digitalization and Access to Justice", *Legal Studies* 40, Kent
4. Gunnar, Grendstad. Lee, Epstein. Urska, Sadl. Keren, Weinshall. *The Oxford Handbook of Comparative Judicial Behavior*, Oxford: Oxford University Press, 2024
5. Pamela, Ryder-LAHEY. Vangjel, Kosta. Toni, Gogu. *Administrimi i Gjykatave*. Tirane: Kristalina-KH, 2005
6. Paju, P. "Estonia's e-Justice System: A Digital Revolution in Court Administration." *Estonian Law Review* 14, no. 3, 2018
7. Stephen, Wasby. "A Judicial Secretary's Many Roles: Working with an Appellate Judge and Clerks", *The Journal of Appellate Practice and Process* 7, no. 1, Arkansas: 2005
8. Van den Broek, F. "Integrated Court Management in the Netherlands: A Case Study", *International Journal of Court Administration* 5, no. 1, 2017
9. Zouridis, Stavros. Marijn, van Eck. "Legal Uncertainty in e-Government Systems" *Information Polity* 18, Leiden

Legjislacion

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. 2016
2. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. 1950
3. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë. 1995, i ndyshuar
4. Ligji Nr. 109/2013 "Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë"
5. Ligji Nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"
6. Vendimi nr. 150, datë 29.03.2023 i Këshillit të Lartë Gjyqësor
7. Vendimi nr. 353, datë 11.07.2024 i Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për miratimin e udhëzimit "Për mënyrën e përdorimit të teknologjisë audio/audiovizive në procesin gjyqësor"

Jurisprudencë

1. GJEDNJ, Kraska kundër Zvicrës, nr. 13942/88, vendim i datës 4 Tetor 1990
2. GJEDNJ, Kerojärvi kundër Finlandës, nr. 17506/90, vendim i datës 19 Korrik 1995
3. GJEDNJ, Göç v. Turqisë, nr. 36590/97, vendim i datës 11 Korrik 2002
4. GJEDNJ, Sejdocic kundër Italisë, nr. 56581/00, vendim i datës 1 Mars 2006
5. GJEDNJ, Scopelliti kundër Italisë, nr. 15511/89, vendim i datës 23 Nëntor 1993
6. GJEDNJ, H. kundër Francës, nr. 10073/82, vendim i datës 24 Tetor 1989
7. GJEDNJ, Kamasinski kundër Austrisë, nr. 9783/82, vendim i datës 19 Dhjetor 1989
8. GJEDNJ, Frydinger kundër Francës, nr. 30979/96, vendim i datës 27 Qershor 2000
9. GJEDNJ, Djangozov kundër Bullgarisë, nr. 45950/99, vendim i datës 8 Korrik 2004
10. Vendimi nr. 19, datë 03.05.2007
11. Vendimi nr. 34, datë 03.10.2007
12. Vendimi nr. 46, datë 29.06.2015
13. Vendimi nr. 43, datë 04.06.2024
14. Vendimi Unifikues nr.1, datë 27.04.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

Web faqe

1. Lenaerts, Koen. n.d. “20 Talks,” podcast nga EDPS. https://www.edps.europa.eu/press-publications/publications/podcasts/20-talks-koen-lenaerts-president-court-justice-european-union_en.
2. Spano, Robert. “Judicial Independence and the Rule of Law,” fjalim në Leuven University, 2022. https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/Speech_20220312_Spano_Leuven_University_ENG

CYBERCRIMES IN ALBANIA

Av. Eler VALISHTI*

KRIMET KIBERNETIKE NË SHQIPËRI

Abstrakt

Krimi kibernetik, një sfidë evolutive dhe komplekse, paraqet një rrjet diversitet çështjesh teknologjike, sociale dhe ligjore. Analizimi dhe kuptimi i aspekteve fenomenologjike të krimit kibernetik do të na çojë në kuptimin e zanafillës dhe evolucionit të tij në kohë dhe hapësirë. Kuptimi makro i aspekteve të ndryshme të krimeve kibernetike fatkeqësisht lidhet me arsyet se si u implementuan në territorin e Shqipërisë. "Epoka e digjitalizimit" në Shqipëri shënoi një hap të rëndësishëm në inovacionin e telekomunikacionit, sistemet e ndryshme të operimit dhe burimet/pajisjet e reja teknologjike. Kjo periudhë mundësoi zhvillimin social, duke sjell një progress pozitiv. Institucionet publike përmirësuan shërbimet si: procesimi i vërtetimeve në ueb për individë ose subjekte private dhe ofrimin e shërbimeve nëpërmjet internetit.

Integrimi i Inteligjencës Artificiale (IA) në shkolla, universitete dhe ndërmarrje private ka sjell benefite për të mësuarit, kërkimin, arkivimin e dosjeve dhe aktivitetet e tjera kreative. Inovacionet teknologjike nuk kanë shërbyer vetëm për qëllime positive gjithashtu kanë shërbyer si mjete për autorët e krimeve kibernetik për të zotëruar dhe zhvilluar metoda të reja për kryerjen e këtyre krimeve.

Pasojat e krimit kibernetik përhapen në sektorë të ndryshëm, nga institucionet financiare deri te institucionet shtetërore dhe/ose private. Problemi juridiksional i krimit kibernetik shfaqet në tri mënyra: boshllëqe legislative penale; mungesa e fuqive procedurale; dhe mungesa e dispozitave të ndihmës së ndërsjellë për zbatimin e ligjit me shtete të huaja¹. Bashkëpunimi ndërkombëtar në luftën kundër krimit kibernetik zakonisht ka qenë më shumë përjashtim sesa rregull. Këto kërkesa shpesh janë një pengesë të papërbalueshme për ndjekjen me sukses të kriminelëve kibernetikë².

Si përfundim, duke analizuar zanafillën, mënyrën se si operojnë dhe sfidat, mund të ofrojnë njohuri të vlefshme për vlerësimin e efektivitetit të sistemit ligjor shqiptar në luftën kundër këtyre veprave penale. Një perspektivë përmes analizës statistikore të krimeve kibernetike do të ndihmojë në nxjerrjen e përfundimeve dhe formulimin e rekomandimeve.

Fjalë Kyçe: *Krimi kibernetik; Siguria kibernetike; Legjislacioni Shqiptar; Ligji Penal; Kod i Procedurës; Të dhënat sensitive*

1. Methodology

To carry out this study on cybercrime in Albania, a combined methodological approach was followed,

* Av. Eler Valishti, Master Shkencor Penal, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, valishtieler7@gmail.com.

¹ Weber, Amalie "Konventa e Këshillit të Europës mbi Krimet Kibernetike: Problemi i Juridiksionit i Krimeve Kibernetike", Berkeley "Gazeta Juridike e Teknologjisë" Shtetet e Bashkuara: Kaliforni, 2003, f. 426. Për më shumë: <https://www.jstor.org/>.

² Weber, Amalie "Konventa e Këshillit të Europës mbi Krimet Kibernetike: Problemi i Juridiksionit i Krimeve Kibernetike", Berkeley "Gazeta Juridike e Teknologjisë" Shtetet e Bashkuara: Kaliforni, 2003, f. 426. Për më shumë: <https://www.jstor.org/>.

incorporating both qualitative and quantitative methods. The qualitative aspect consists of the examination of materials and legislation related to cybercrime, such as international conventions, the Albanian Criminal and Procedural Codes, as well as the adopted legal amendments.

This study compares domestic and international legislation to highlight how Albania has adapted international norms in accordance with its legal context. In this framework, a comparison was made between the provisions of the Albanian Criminal Code and the Code of Criminal Procedure with the standards established by the Council of Europe and best international practices.

In addition to the qualitative aspect, the quantitative method was also employed. Through statistical analysis, the study aimed to examine the phenomenological causes and the effectiveness of the Albanian legal system. The statistics were obtained from the annual statistical reports of the General Prosecutor's Office. For the purpose of this study, data from the years 2021 and 2023 were used, since statistics from the last three years on criminal offenses under Article 117 "Pornography," Article 143/b "Computer Fraud," and Article 192/b "Unauthorized Computer Access" are insufficient to fully identify the level of criminality and its social danger.

In conclusion, this methodology aims to provide a comprehensive, clear, and fact-based overview to understand not only the evolution of cybercrimes in Albania but also the effectiveness of the justice system in combating these crimes.

2. Cybercrime in Albania

2.1 What is Cybercrime

Let us begin with a direct examination of the issue! In the context of Albanian legislation, the precise definition of cybercrime remains elusive. Despite the absence of an exact legal delineation, multiple interpretations are plausible. It is possible to state: "All actions or omissions carried out by an individual who has reached the age of legal responsibility for offenses or crimes against socially protected relations by law particularly related with the violations of technological processing". In advance Cybercrime holds the same weight and legitimacy as traditional criminal acts. It does not exist simply in the ether³. It involves real people, real crimes and real victim⁴. The sole distinction with other crimes lies in the fact that cybercrime can occur anywhere and at any time, with the internet serving as its battlefield. Cross-national activity has become increasingly prevalent. In the early stages of the digital age, the phrase "cyberspace knows no borders" emerged⁵. The nature of digital technology enables targeting a device or system located on the other side of the world with the same ease as one in one's hometown⁶. Cyberspace is just the conceptual space where communication takes place across computer networks. It represents a vast repository of digital information that may be susceptible to exploitation by cyber offenders.

Crimes, cyberspace, personal data, data security, computer networks, and digital information are all essential elements for comprehending cybercrime. Let us progress to the next phase. Innovative technology, while beneficial for society, can also serve as a mechanism to modernize various methods employed in criminal activities. An illustrative case is "E-Albania", a free database available to all Albanian residents. This platform allows users to request various documents without the need to visit different public institution offices

³ Hynds, Len "Detective Chief Superintendent", extracted from Hacker Cracker, RSA Journal, Londër, Angli, 2002, f. 42. For More: <https://www.jstor.org/>.

⁴ Hynds, Len "Detective Chief Superintendent", extracted from Hacker Cracker, RSA Journal, Londër, Angli, 2002, f. 42. For More: <https://www.jstor.org/>.

⁵ Chang, Lennon & Grabosky, Peter "Regulatory Theory: Foundations and Applications; The Governance of Cyberspace", Australia National University Press, Australia, 2017, f. 534. For More: <https://www.jstor.org/>.

⁶ Chang, Lennon & Grabosky, Peter "Regulatory Theory: Foundations and Applications; The Governance of Cyberspace", Australia National University Press, Australia, 2017, f. 534. For More: <https://www.jstor.org/>.

and endure long queues. However, some time ago, a breach in the database led to the exposure of restricted and confidential information belonging to all individuals registered on “E-Albania”. This leaked information included sensitive details such as salary, job positions, personal ID numbers, phone numbers. This example was not intended to criticize innovation but rather to illustrate how "criminals" can utilize innovations as a means to commit various crimes, including cybercrimes.

2.1.1 The Beginning

As explored earlier, the roots of these criminal activities are not confined by borders but deeply intertwined with technological progress and the evolution of communication systems. The emergence of cybercrime in Albania becomes apparent around the early 2000s, aligning with the peak of telecommunications advancements. However, to truly understand this phenomenon, we need to look beyond the confines of the 2000s. During the 1990s, Albania underwent profound changes post-Communism. This era witnessed significant population movements and extensive political reforms, creating a pressing need for robust telecommunication infrastructure. Between 1995 and 2000, crime rates surged. Consequently, as the transition into the 2000s unfolded, criminals leveraged technological advancements to facilitate various crimes, marking the onset of cybercrimes. This progression began with breaches via telephones and evolved into hacking personal data from computers, eventually culminating in today's sophisticated digital landscape. Cybersecurity is defined very broadly by some states, and covers risks and threats such as cyberwarfare, cyberterrorism, cybercrime and cyberespionage⁷. In the early 2000s, Albania initiated preventive measures against cybercrime, signaling the initial strides toward cybersecurity. These measures included aligning legislation with European standards, establishing specialized institutions to prevent and combat cybercrime, and formulating intersectoral policies for prevention. Despite these efforts, the effectiveness of government action against organized crime remained constrained due to limited training, inadequate resources, weak police management, corruption, and the dominance of trafficking gangs, as highlighted in the 2004 Stabilization and Association Report⁸. However, based on available information, it is believed to have occurred between 1995 and the early 2000s.

2.1.2 Today's Challenges

Cybercrime is evolving every day. Modern cybercrime draws no distinction between government targets, larger corporations and individual users⁹. The primary motive behind these crimes is financial gain through cyberattacks. Another concern is the Jurisdiction problem. Cybercrimes occur in cyberspace; they can take place globally, someone from anywhere in the world could potentially hack the computer systems of the Albanian government or an individual's personal computer. Thus, the battleground is not defined by physical borders but exists within a virtual space—a realm untouchable and intangible. Consequently, addressing such criminal conduct often requires the application of extraterritorial principles or adherence to European legislation in certain cases. The greatest of these obstacles is anonymity¹⁰. There are no fingerprints, DNA or eyewitnesses to crimes committed in a virtual world. It is difficult, if not impossible, to know who operates, visit and searches

⁷Kettemann, Matthias “Ensuring Cybersecurity through international law: Towards a comprehensive concept of Cybersecurity”. *Revista Española de Derecho Internacional*, Spain, 2017, Vol. 69, No. 2. f. 282. For More: <https://www.jstor.org/>.

⁸ Center study of democracy and government & Netherland Embassy, “Evaluation Report, Intersectoral Strategy against Organised Crimes, Illegal Traffics and Terrorism”, Tirana, Albania, (2020). Center Study of Democracy and government, f. 25. For more: <https://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2020/12/Raport-vleresimi-Krimi-i-organizuar.pdf>.

⁹Jeffrey, Calum & Feaking Tobias “Underground Web: The cybercrime Challenge”, Australian Strategic Policy Institute, International Cyber Policy Center, Australia, 2015, f. 2. For More: <https://www.jstor.org/>.

¹⁰ Smith, Lamar “The New Challenges of Cybercrime”, University of California Press, California, 2008, f. 356. For More: <https://www.jstor.org/>.

specific websites¹¹.

Nowadays, hackers are employing advanced methods, utilizing various vectors to gain unauthorized access to classified or personal information, such as leveraging "Big Data" - massive volumes of information processed at higher speeds. The rapid evolution of Artificial Intelligence (AI) has introduced immense potential, yet it also presents considerable risks when it gets in wrong hands. Hackers are using AI. to create smart systems that can automate phone calls or messages. Unfortunately, this technological progress has been exploited for fraudulent purposes, resulting in scams that inflict financial harm and violate personal privacy, compromising sensitive information. In conclusion, the challenges that Albania needs to face against Cybercrimes are:

1. Swift technological advancements and Jurisdiction;
2. Hacker anonymity jeopardizing website integrity;
3. Increased cyberattacks targeting state institution servers;
4. Violations involving large volumes of information;
5. Emergence of new cybercrime methodologies and fraudulent activity.

3. Albanian Legislation against Cybercrime

3.1 Albania and the Convention on Cybercrime

Albania recognizes the necessity for bilateral and multilateral cooperation among Nations to combat cybercrime. In 2002 has ratified the European Convention on Cybercrime, with the Law Nr. 8888, date 25.04.2002¹². Global security in cyberspace is predicated on Nations coming together with like-minded will, intent and capabilities to defend on common threats¹³. The Council of Europe's Convention on Cybercrime was created to address the Jurisdictional issues posed by the evolution of the internet¹⁴. Its solution was to harmonize cybercrime laws and ensure the existence of procedural mechanisms to assist in the successful prosecution of cyber criminals¹⁵. Albania's legislation experienced substantial changes in Criminal and Procedural Criminal Law due to the implementation of the Convention on Cybercrime. Its chapters cover National Measures and International Cooperation¹⁶. "Cyber" criminal acts are sanctioned and implemented in the Criminal Code of Albania with the Law Nr. 10023, Date 27.11.2008 "For some additions and changes in the Law Nr. 7895, date 27.11.2008". The amendments in the Criminal Code were:

1. Article 74/a: Introduced "Sharing pro-genocide or human crimes materials via computers."

¹¹ The Official Publishing Center, Law Nr. 8888, Date 25.04.2002 "For the ratification of the Convention on Cybercrime, Official Paper of the Republic of Albania Nr. 18, Date 17.05.2002. Published by Decree Nr. 3322, Date 03.05.2002 of the President of Albania Republic, Meidani R.

¹² Butler, Bob & Lachow, Irwing "Multilateral Approaches for Improving Global Security in Cyberspace", Georgetown Journal of International Affairs, Washington, D.C. 2012, f. 5. For More: <https://www.jstor.org/>.

¹³ Weber, Amalie "The Council of Europe's Convention on Cybercrime: The problem of Cybercrime jurisdiction", Berkeley Technology Law Journal, United States: California, 2003, f. 1. For More: <https://www.jstor.org/>.

¹⁴ Kettmann, Matthias "Ensuring Cybersecurity through international law: Towards a comprehensive concept of Cybersecurity". Revista Española de Derecho Internacional, Spain, 2017, Vol. 69, No. 2. f. 282. Fore More: <https://www.jstor.org/>.

¹⁵ Weber, Amalie "The Council of Europe's Convention on Cybercrime: The problem of Cybercrime jurisdiction", Berkeley Technology Law Journal, United States: California, 2003, f. 1-2. For More: <https://www.jstor.org/>.

¹⁶ The Official Publishing Center, Law Nr. 8888, Date 25.04.2002 "For the ratification of the Convention on Cybercrime, Official Paper of the Republic of Albania Nr. 18, Date 17.05.2002. Published by Decree Nr. 3322, Date 03.05.2002 of the President of Albania Republic, Meidani R.

2. Article 84/a: Introduced "Threat for racist or xenophobic purpose via computer system."
3. Article 119/a/b: Introduced "Sharing racist or xenophobic materials via computer's system." And "Insults with racist or xenophobic motives via computer's system."
4. Article 137, Second Paragraph: Modified the sanction from "fine or..." to sole "imprisonment," eliminating the fine and imposing imprisonment as the sole penalty.
5. Article 143/b: Addressed "Computer fraud."
6. Article 156 Amendment: Added a new paragraph stating, "The same act, when done in cooperation, multiple times, or resulting in severe consequences, is subject to imprisonment for up to three years."
7. Article 186/a: Introduced "Computer Falsification."
8. Article 192/b: Changed from "Intervention on computer transmission" to "Unauthorized computer access."
9. Article 293/a/b/c/ç: Newly added articles defending against interception, intervention, illegal usage of computer data or information and the illegal wiretapping of computer data.

3.2 Criminal Code

After the aderation of the convee on cybercrime, the Albanian Criminal Code is up-to-date with innovative criminal disposition on "Cyber-sphere". The first Chapter of the Criminal Code is about human crimes, which with the new changes has been introduced the Article 74/a "Sharing pro- genocide or human crimes materials via computers." This crime aim Juridical relations established by law in accordance with acts of international law to ensure the protection of life, health protection and the rights and freedoms of the public protected especially with Penal Legislation against criminal acts¹⁷. This crime is committed by offering to the public or sharing to the public through computers system of materials that deny, minimize, in a sensitive way, approve or justify acts that constitute genocide or human crimes¹⁸. The sanction of this crime is from three to six years imprisonment. The Criminal Intent (Mens Rea) of this crime is defined by intention and for a purpose.

In Albanian Criminal Code, the cybercrimes have the same *Actus Rea*¹⁹, which means that these crimes are performed at the same way, using identical methods of execution. In order to commit these crimes, it is required the access and usage of computers system and then a platform or other methodes to share to the public matherials not allowed by law or for "hacking" purposes.

In advance, the Article 84/a "Threat for racist or xenophobic purpose via computer system" looks the same of the Art. 74/a but they have different Criminal Intent. The first one sanction the commitment of serious threats about life for racist or xenophobic purpose through computer system and the second sanction public offer or public sharing of pro-genocide or human crimes materials through computers. Art. 74 is classified as a human crime and the Art. 84/a is classified as "Crimes against life committed on purpose" because this crime is a life threats for the victim of the criminal actions. In the same way operates the Article 119/a "Sharing racist or xenophobic materials via computer's system." And 119/b "Insults with racist or xenophobic motives via computer's system." Article 119/a is about sharing material that promotes "racism" and/or "Xenophobia" through computer system and the article 119/b is consumed by insulting motivated by racism and/or xenophobia through computer system.

In Advance the Aricle 192/b "Unauthorized computer access" the notion is amended to be in line with the european legislation. This Crime occurs whenever an actor achieves entry into a target's files or programs

¹⁷ Elezi, Ismet "Criminal Law, Special part", updated and completed with additions and changes by legal reforms of the years 2001 – 2017, Published by "KUMI", Tirana; Albania, 2018.

¹⁸ Elezi, Ismet "Criminal Law, Special part", updated and completed with additions and changes by legal reforms of the years 2001 – 2017, Published by "KUMI", Tirana; Albania, 2018, f. 28.

¹⁹ Sullivan, Gerald Robert "Cause and the Contemporaneity of actus rea and Mens rea", The Cambridge Law Journal, Cambridge, UK. (1993), For More: <https://www.jstor.org/>.

without permission²⁰. There are several different targets for unauthorized access: Broadly speaking, they may be categorized as the individuals, government²¹ or any other entities with public interests. This article is divided in two paragraphs; the first, condemn unauthorized access to computer system. The victim of this crime can be any individuals, private entities or any other subject. The second paragraphs condemn the unauthorized access to military, national security, public order, Civil protection, healthcare, or to any other computers system of public interests.

Despite the addition and amends derived by the law Nr. 10023, Date 27.11.2008, in the year 2013 was amended the Article 117 “Pornography” of Criminal Code. This Crime is performed in several forms indicated in this article, as the production, sharing, advertising, importation, selling or publishing of articles, publishing of other materials with pornographic content in settings where children are present, possession and purposely access to child pornography and/or the recruitment, usage, abduct and/or convincing a child to take part to a pornographic show²². In advance the new contemporaneous challenge is about artificial intelligence. Producers may use their computers to “draw” images from scratch or may digitally alter photographers of children²³. We have three different sanctions for these crimes that vary from fine to two years imprisonment, three to ten years of imprisonment and from five to ten years.

3.3 Criminal Procedural Code

The Convention on Cybercrime addresses procedural legal issues²⁴. It requires states to establish a minimum set of procedural tools at the national level whereby the appropriate law enforcement authorities with state have authority to conduct certain types of investigations specific computer crime offenses²⁵. In advance the evolution of digitalization and the necessity to guarantee the rights of the litigants brought the amendments of the Criminal Procedural Code with the Law nr. 10054, date 29.12.2008.

The amendments in the Procedural code were²⁶:

- Article 191/a: Introduced “*The obligation to submit the computer data.*” This article can be executing by the Judge with the request of the prosecutor or the defendant.
- Article 208/a: Introduced “*Sequestration of computer’s data.*” This procedural moment is closely related with crimes of Information Technology. It regulates the legitimization and the methods of sequestration procedure on computers data.
- Article 299/a/b: Introduced “*Expedited storage and the maintenance of computer data*” and “*Accelerated storage and partial disclosure of computer data.*” These two articles are not applied simultaneous. First the prosecutor needs to order the expedited storage of computer data and traffic data. In advance, may be apply the article 299/b for the storage and further investigation.

4. Statistics

²⁰ Katyal K.N “Criminal Law in Cyberspace”. Philadelphia, USA, (2001), University of Pennsylvania Law Review. f. 1021. For More: <https://www.jstor.org/>

²¹ Weber, Amalie “The Council of Europe's Convention on Cybercrime: The problem of Cybercrime jurisdiction”, Berkeley Technology Law Journal, United States: California, 2003, f. 1-2, For More: <https://www.jstor.org/>.

²² Elezi, Ismet “Criminal Law, Special part”, updated and completed with additions and changes by legal reforms of the years 2001 – 2017, Published by “KUMI”, Tirana; Albania, 2018, f. 150.

²³ Katyal, Neal Kumar “Criminal Law in Cyberspace”, University of Pennsylvania Law Review, Philadelphia, USA, (2001), f. 1029. For More: <https://www.jstor.org/>.

²⁴ Weber, Amalie “The Council of Europe's Convention on Cybercrime: The problem of Cybercrime jurisdiction”, Berkeley Technology Law Journal, United States: California, 2003, f. 431. For More: <https://www.jstor.org/>.

²⁵ The Official Publishing Center, Law Nr. 7905, Date 21.03.1995 “The Code of the Penal Procedure”, Tirana, Albania.

²⁶ Elezi, Ismet “Criminal Law, Special part”, updated and completed with additions and changes by legal reforms of the years 2001 – 2017, Published by “KUMI”, Tirana; Albania, 2018, f. 28.

In this chapter, we will analyze the statistics related to Articles 117, 143/b, and 192/b of the Penal Code, focusing on the number of registered proceedings, proceedings sent to court, registered defendants, defendants sent to court, and the number of convicted defendants for the years 2021 and 2022. These data provide an overview of legal processes and outcomes for various crimes, such as pornography, computer fraud, and unauthorized computer access.

4.1 Article 117 “Pornography”

Annual statistics of the General Prosecutor's Office²⁷:

| Article 117 “Pornography” | The number of registered proceedings | The number of proceedings sent to Court | The number of registered defendants | The number of defendants sent to Court | The number of convicted defendants |
|------------------------------|--------------------------------------|---|-------------------------------------|--|------------------------------------|
| 2021 | 67 | 3 | 5 | 4 | 1 |
| 2022 | 34 | 2 | 1 | 2 | 2 |

For the years 2021 and 2022, the statistics for Article 117, which deals with pornography-related crimes, show a significant decrease in the number of registered proceedings and defendants sent to court.

2021: On this year, there were a total of 67 proceedings registered, with only 3 of these proceedings sent to court

The number of registered defendants was 5, with 4 defendants sent to court. However, only one defendant was convicted.

2022: On this year, the number of registered proceedings decreased to 34, and only 2 proceedings were sent to court. Of the 1 registered defendant, all 2 defendants were sent to court, and both were convicted. This represents an improvement in convictions considering the lower number of proceedings and defendants compared to the previous year but still a low amount of complexity.

In summary, the statistics for Article 117 suggest a decline in the number of pornography-related cases and an improvement in the convictions of defendants in 2022.

4.2 Article 143/b “Computer Fraud”

Annual statistics of the General Prosecutor's Office²⁸:

| Article 143/b “Computer Fraud” | The number of registered proceedings | The number of proceedings sent to Court | The number of registered defendants | The number of defendants sent to Court | The number of convicted defendants |
|-----------------------------------|--------------------------------------|---|-------------------------------------|--|------------------------------------|
| 2021 | 71 | 5 | 19 | 14 | 2 |
| 2022 | 88 | 5 | 22 | 8 | 3 |

²⁷ Statistics of the General Prosecutor’s office, Albania Republic 2021-2022. For more: <https://www.pp.gov.al/Dokumente/>.

²⁸ Statistics of the General Prosecutor’s office, Albania Republic 2021-2022. For more: <https://www.pp.gov.al/Dokumente/>.

For Article 143/b, which deals with computer fraud, the statistics show an increase in the number of registered proceedings in 2022 compared to 2021.

2021: On this year, 71 proceedings were registered, with 5 of them sent to court. 19 defendants were registered, and 14 were sent to court. Out of these, only 2 defendants were convicted.

2022: On this year, the number of registered proceedings increased to 88, while the number of proceedings sent to court remained the same (5). The number of registered defendants rose to 22, but only 8 defendants were sent to court, and the number of convictions increased slightly to 3.

Here, we can observe an increase in the number of computer fraud cases, but a decrease in the number of defendants sent to court. However, convictions saw a modest increase from 2 to 3 convicted defendants.

4.3 Article 192/b “Unauthorized computer access”

Annual statistics of the General Prosecutor's Office²⁹:

| Article 192/b “Unauthorized computer access” | The number of registered proceedings | The number of proceedings sent to Court | The number of registered defendants | The number of defendants sent to Court | The number of convicted defendants |
|--|--|---|---|--|--|
| 2021 | 7 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2022 | 10 | 0 | 0 | 0 | 0 |

For Article 192/b, which deals with unauthorized computer access, the statistics for both 2021 and 2022 show a small number of cases and no significant changes.

2021: In 2021, only 7 proceedings were registered, and none were sent to court. No defendants were registered or sent to court.

2022: Similarly, in 2022, 10 proceedings were registered, but none were sent to court. No defendants were registered or sent to court, and as a result, no convictions occurred.

For this article, it is evident that there has been no significant development in the prosecution of unauthorized computer access, as no cases were sent to court or resulted in convictions.

5. Conclusions and Recommendations

The emergence of cybercrime in Albania is still somewhat unclear, but it is believed to have started between 1995 and the early 2000s. In 2002, Albania ratified the European Convention on Cybercrime through Law No. 8888, dated April 25, 2002, which was followed by amendments to the national legislation to better address the growing threat of cybercrime.

Specifically, in terms of legal provisions related to cybercrime, we can look at certain articles and their developments over the years:

- Article 117 – "Pornography": Between 2021 and 2022, there was a significant decrease of 65.5% in the number of registered cases under this article, though the number of convicted defendants increased by one.
- Article 143/b – "Computer Fraud": In this area, there was an increase of 21.3% in the number of registered

²⁹ Statistics of the General Prosecutor's office, Albania Republic 2021-2022. For more: <https://www.pp.gov.al/Dokumente/>.

proceedings between 2021 and 2022, along with an additional convicted defendant.

- Article 192/b – "Unauthorized Computer Access": This article showed a minor increase of only 3 registered cases between 2021 and 2022, but the effectiveness of legal actions dropped to zero in terms of convictions or resolutions.

Despite these fluctuations, the overall number of cybercrime-related cases remains relatively low, which raises an important question: Have the preventive policies, penal sanctions, and the legal framework in Albania been truly effective in combating cybercrime? Or does this low number of cases reflect deeper issues within the policymaking process and the legislative framework that need to be addressed?

In conclusion, it is evident that Albania must take more significant steps to regenerate, reintegrate, and strengthen national security regarding cybercrime. This includes ensuring stronger data security measures, the enforcement of file encryption, the adoption of new investigation methods that make use of advanced technologies, and the introduction of more comprehensive national legislations on cybersecurity.

Furthermore, there needs to be increased cooperation between the judiciary and cybersecurity experts to improve the effectiveness of tackling cybercrimes. Lastly, there should be a focus on the number of proceedings and convictions in proportion to the number of registered cases, ensuring that the legal system can respond effectively to the evolving threats of cybercrime.

BIBLIOGRAPHY

1. Butler, Bob & Lachow, Irving "Multilateral Approaches for Improving Global Security in Cyberspace", Georgetown Journal of International Affairs, Washington, D.C. 2012, For More: <https://www.jstor.org/>.
2. Center study of democracy and government & Netherland Embassy "Evaluation Report, Intersectoral Strategy against Organised Crimes, Illegal Traffics and Terrorism", Tirana, Albania, 2020, Center Study of Democracy and government. For more: <https://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2020/12/Raport-vleresimi-Krimi-i-organizuar.pdf>.
3. Chang, Lennon & Grabosky, Peter "Regulatory Theory: Foundations and Applications; The Governance of Cyberspace", Australia National University Press, Australia, 2017, For More: <https://www.jstor.org/>.
4. Elezi, Ismet "Criminal Law, Special part", updated and completed with additions and changes by legal reforms of the years 2001 – 2017, Published by "KUMI", Tirana; Albania, 2018;.
5. Hynds, Len "Detective Chief Superintendent", extracted from Hacker Cracker, RSA Journal, Londër, Angli, 2002, For More: <https://www.jstor.org/>.
6. Jeffray, Calum & Feaking Tobias "Underground Web: The cybercrime Challenge", Australian Strategic Policy Institute, International Cyber Policy Center, Australia, 2015, For More: <https://www.jstor.org/>.
7. Katyal, Neal Kumar "Criminal Law in Cyberspace", University of Pennsylvania Law Review, Philadelphia, USA, (2001), For More: <https://www.jstor.org/>.
8. Kettemann, Matthias "Ensuring Cybersecurity through international law: Towards a comprehensive concept of Cybersecurity". Revista Española de Derecho Internacional, Spain, 2017, Vol. 69, No. 2. f. 282. Fore More: <https://www.jstor.org/>.
9. Smith, Lamar "The New Challenges of Cybercrime", University of California Press, California, 2008, f. 356. For More: <https://www.jstor.org/>.
10. Statistics of the General Prosecutor's office, Albania Republic 2021-2022. For more: <https://www.pp.gov.al/Dokumente/>.
11. Sullivan, Gerald Robert "Cause and the Contemporaneity of actus rea and Mens rea", The Cambridge Law Journal, Cambridge, UK. (1993), For More: <https://www.jstor.org/>.
12. The Official Publishing Center, Law Nr. 7905, Date 21.03.1995 "The Code of the Penal Procedure", Tirana, Albania.

13. The Official Publishing Center, Law Nr. 8888, Date 25.04.2002 “For the ratification of the Convention on Cybercrime, Official Paper of the Republic of Albania Nr. 18, Date 17.05.2002. Published by Decree Nr. 3322, Date 03.05.2002 of the President of Albania Republic, Meidani R.
14. Weber, Amalie “The Council of Europe's Convention on Cybercrime: The problem of Cybercrime jurisdiction”, Berkeley Technology Law Journal, United States: California, 2003, f. 426. For More: <https://www.jstor.org/>

SIGURIMI I DETYRUESHËM I PRONËS, STANDARTET KUSHTETUESE DHE LIGJORE

Dr. Vera SHTJEFNI*

COMPULSORY PROPERTY INSURANCE, CONSTITUTIONAL AND LEGAL STANDARDS

Abstract

This paper examines the need and usefulness of implementing compulsory property insurance in Albania. It analyses the legal framework and the constitutional challenges that compulsory property insurance poses in relation to property rights, economic freedom and social justice.

The process of drafting a compulsory insurance law in Albania should comply with constitutional standards and the European legal framework, with the principles of human rights and economic freedoms. The Constitution and legal system of Albania is influenced by European standards, especially considering the rapid accession to the EU. The decision-making on compulsory property insurance in Albania is conditioned by the role that the state will play in dealing with damages caused by natural disasters or those caused by human activity. Will the state continue to assume compensation for the injured or will compulsory property insurance be established for these cases and the damages will be covered by this compulsory insurance.

The study concludes that compulsory property insurance serves the public interest, it should guarantee the constitutional standards of proportionality, affordability and legal compliance. Compulsory property insurance should be assessed by citizens as a useful instrument for coping with the severe consequences of natural phenomena and not as a financial obligation imposed by the state. And to achieve this, it would be good for citizens to express their opinion through a referendum on the need and benefit of establishing mandatory property insurance.

Keywords: *compulsory insurance, Property rights, Contractual freedom, Public interest, proportionality principle, referendum.*

1. Hyrje

Zhvillimi i industrisë të sigurimeve në Shqipëri ka qenë një proces i ngadaltë, për shkak se ajo ka qenë një nga vendet e fundit që u shkëput nga regjimi komunist dhe rrjedhimisht kishte një rrugë e gjatë për të arritur në një ekonomi të bazuar tek tregu. Zhvillimi i tregut të sigurimeve ka shënuar rritje graduale duke ofruar produkte në të

* Pedagoge me kohë të plotë, Departamenti i të Drejtës Publike Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.
vera.shtjefni@fdut.edu.al

gjitha klasat e sigurimit (jetës dhe jo-jetës)¹. Sipas raportit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare², të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për vitin 2024 kapën vlerën 24,505 milionë lekë³, afërsisht 250 milion USD ose 1% e PBB⁴. Sigurimi i mjeteve motorrike zë rreth 68,67%⁵ të tregut dhe sigurimi i pasurisë 17.17 %⁶. Sigurimi i jetës dhe shëndetit zënë 14.14 %. Forcimi i tregut të sigurimeve është në interes të zhvillimit ekonomik të vendit.⁷

Në një vështrim të shkurtër historik mund të themi se tregu i sigurimeve në Shqipëri nisi të zhvillohet në vitet '20-'30 të shekullit të kaluar. Në qytetet kryesore Tiranë, Durrës, Sarandë, Korçë apo Shkodër, hapin filialet e tyre disa prej kompanive më të njohura të sigurimeve në botë⁸. "Generali Assicurazioni" filloi të investojë drejtpërdrejt në Shqipëri në fushën e shitjes së policave të sigurimit të jetës dhe sigurimit nga zjarri⁹. "Sun Insurance", e krijuar në Londër, në vitet 30 kishte edhe filialet e saj në Shqipëri. Me vendosjen e regjimit komunist, tregu i sigurimeve u shtetëzua, si të gjithë sektorët e tjerë ekonomikë. Sigurimet u dobësuan dhe gradualisht u ndërprehen¹⁰. Në vitin 1991, Parlamenti shqiptar krijoi Institutin i Sigurimeve,¹¹ i cili do të ushtronte veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve në Shqipëri, duke ofruar sigurime jo-jetë dhe jetë. Me liberalizimin e tregut në vitin 1999 u licencuan kompanitë e para private të sigurimeve. Aktualisht operojnë 8 shoqëri sigurimi të jo-jetës, 5 shoqëri të sigurimit të jetës dhe një shoqëri risigurimi¹².

Frekuenca në rritje e fatkeqësive natyrore, veçanërisht tërmeteve të vitit 2019 e vijim dhe përmbajtjeve periodike në shumë zona të Shqipërisë, pa përjashtuar zjarret masive në periudhën e thatësisë, ka rritur nevojën për mekanizma të mbrojtjes financiare në Shqipëri. Mbulimi me sigurim i rrezikut nga fenomenet e mësipërme është vullnetar. Ai është përfshirë në kontratat e sigurimit nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë. Shkalla e shtrirjes së tij është mjaft e ulët. Në 100 prona (banesa, objekte biznesi apo kultura bujqësore) vetëm 2 janë të siguruar. Për më tepër rreth 80% e këtyre kontratave sigurimi janë të lidhura me sistemin bankar, si një kërkesë e bankave gjatë procesit të aplikimit të kredisë. Një numër i vogël i aseteve publike janë të siguruar.

¹ Shih ligjin nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" "Klasë sigurimi" është klasifikimi i një grupi të ngjashëm rreziqesh ose operacionesh, që përcakton veprimtarinë që shoqëria e sigurimit mund të ushtrojë në bazë të licencës. Aneksi I. Klasat e sigurimit.

² Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për sigurimin dhe risigurimin krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit. Ligji nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" neni 3. Ligji nr. 9572/.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" I ndryshuar, neni 3).

³ <https://amf.gov.al/news.asp?id=53249>

⁴ Prodhimi i Brendshëm Bruto i Shqipërisë në vitin 2024 përllogaritet në 23 miliard USD.

⁵ Sigurimi i detyrueshëm motorik i përgjegjësishë për dëmet që i shkaktohen palëve të treta zë pjesën më të madhe të sigurimeve në Shqipëri. Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë vitit 2024 arritën rreth 15,058 milionë lekë. Sigurimi Vullnetar Primet e sigurimit vullnetar, gjatë viti 2024 arritën rreth 9,447 milionë lekë.. (Buletini i AMF. www.amf.gov.al)

⁶ Në portofolat e Pronës, Përgjegjësive, Garancive të cilat gjatë vitit 2024 siguruan mbi 3,908 milionë lekë të ardhura në total, vendin e parë e zunë Zjarri dhe Dëmtime të Tjera në Pronë me rreth 66.82%, të pasuara nga sigurimi i Përgjegjësishë së Përgjithshme me 21.83% të totalit. (Buletini i AMF. www.amf.gov.al)

⁷ Në rezolutën "Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2023" pika 5 miratuar nga Kuvendi në datën 4.7.2024, Kuvendi i shqiperise i nxit shoqëritë e sigurimit për zhvillimin e produkteve të reja që plotësojnë kërkesat e konsumatorit, përmirësimin e produkteve ekzistuese, formave të reja të shpërndarjes dhe marketimit të produkteve, me qëllim zgjerimin e bazës së personave të siguruar, tek kategoritë me të ardhura të ulëta dhe të mesme

⁸ Kuçaj, Kreshnik. Historiku i Kompanive të Sigurimit në Shqipëri.

https://www.academia.edu/124029446/Historiku_i_Kompanive_t%C3%AB_Sigurimit_n%C3%AB_Shqip%C3%ABri

⁹ Caltana, Diego. Krecic, Francesco. "Le Assicurazioni Generali in Albania: sedi di rappresentanza e politiche immobiliari fino al 1945". Architetti e ingegneri italiani in Albania. Edifir Edizioni Firenze 2012. fq.64; <https://core.ac.uk/reader/53289750>

¹⁰ Në vitin 1949, u krijua Instituti Shtetëror i Sigurimeve brënda Institutit të Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve. Ai ofronte sigurime të jetës dhe sigurime të tjera jo të jetës për ndërtesat, mallrat dhe shërbimet e ndryshme publike. Në vitin 1976, Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë mënjanoi sigurimet pas eliminimit të pronës private

¹¹ INSSIG u themeluar si shoqëri sigurimi me kapital shtetëror. Ligj nr. 7506/1991 "Për Institutin e Sigurimeve"

¹² https://amf.gov.al/ts_shoqeri_sigurimi.asp

Pasojat e ardhura nga përmbytjet, zjarret, termetet, rrëshqitjet e tokës, moti ekstrem dhe, në ndonjë rast, aksidentet teknologjike apo epidemitë, kanë qenë të mëdha. Burimi i vetëm i përballimit të tyre ka qenë ndihma shtetërore financiare, materiale dhe format e tjera, si dhe përballimi nga vetë subjektet e dëmtuara. Shteti, me ligj ka marrë përsipër të përgjigjet për dëmet që shkaktohen nga pasojat e një fatkeqësie¹³, por kjo zgjidhje është një barrë e rëndë për buxhetin dhe ekonominë e vendit, e cila po rëndohet vazhdimisht vit pas viti¹⁴.

Përvoja e shteteve të zhvilluara ka treguar se sigurimi i pasurisë është një instrument i fuqishëm dhe efikas për përballimin e dëmeve të pasurisë nga zjarri dhe rreziqet e tjera (fenomene natyrore, tërmete, përmbytje, stuhi, rrëshqitje, etj), por sigurimi i këtyre rreziqeve në tregun e sigurimeve është i kufizuar¹⁵. Shumë shtete kanë përdorur sigurimin e detyrueshëm të pasurisë për përballimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore. Në vendin tonë ka patur diskutime sporadike në nivel teknik mbi këtë temë, por asnjëherë një proces të vërtetë institucional që do të finalizohet me miratimin e një ligji për sigurimin e detyrueshëm të pronës.

Vendosja e sigurimit të detyrueshëm të pronës është diskutuar në raste sporadike ose si pjesë e projekteve të mbështetjes teknike¹⁶. Diskutimi është rikthyer kur duhej të përballoheshin dëmet nga faktkeqësi natyrore. Më datë 07.08.2023 është publikuar në portalin qeveritar Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike projektligji “Për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet”¹⁷. Në fillim ky draft ngjalli interes dhe debat nga grupe të interesit¹⁸, por nuk u finalizua në një proces institucional të hartimit të një projektligji nga qeveria për ta vijuar diskutimin dhe miratimin e tij. Kuvendi i Shqipërisë ka nxitur AMF të mbështesë më tej Ministrinë e Financave për përfundimin e procesit të hartimit të projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet”, duke përfshirë në të komentet e sugjerimet e ardhura nga grupet e interesit¹⁹. Gjatë vitit 2024 e vijim nuk ka ndonjë zhvillim në këtë rekomandim.

Një ligj i sigurimit të detyrueshëm të pronës mund të rrisë stabilitetin ekonomik dhe qëndrueshmërinë ndaj fatkeqësive. Megjithatë, një ligj i tillë duhet të jetë në harmoni me parimet kushtetuese për të garantuar ligjshmërinë dhe drejtësinë e tij.

2. Sigurimi vullnetar dhe sigurimi i detyrueshëm

¹³ Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” Neni 41, E drejta e kompensimit.

¹⁴ Të dhëna zyrtare të Qeverisë shqiptare dëshmojnë se fatura e dëmeve të tërmetit të 26 nëntorit 2019 është 985.070 milion euro. Janë shkatërruar apo dëmtuar 95 235 banesa me vlerë 696.3 milion euro, 321 ndërtesa arsimore me vlerë 72.350 milion euro, 36 ndërtesa shëndetësore me vlerë 9.93 milion euro, 714 ndërtesa biznesi me vlerë 150,48 milion euro, 60 struktura akomoduese (hotele restaurante). Sektori prodhues ka pësuar rreth 150 mln euro dëme. 86% e efekteve (dëme dhe humbje) janë private dhe 14% publike. Fondet e nevojshme për rindërtimin shkojnë gati 1.1 miliard euro. Pavarësisht nga burimet e financimit, është e qartë se shumica e këtyre fondeve duhet të financohen nga taksapaguesit e sotëm dhe të nëserm. Një pjesë e vogël e pasurive të shkatërruara/dëmtuara nga tërmeti kanë qenë të siguruar pranë shoqërive të sigurimit. Sipas të dhënave të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (AMF) në periudhën janar-nëntor 2019 sigurimi nga zjarri dhe dëmtimet në pronë zunë 7.4% të numrit të kontratave dhe 13% të totalit të primeve të sigurimit jo-jetë (*shënim i autores*).

Shih: https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_510_VKRF%20Shqiperi_Raporti%20i%20konsoliduar%20-%20draft%20final_SQ_%202.9.2022.pdf

¹⁵ Greqia ka përqindja e ulët e banesave të siguruar, e cila sipas vlerësimeve të tregut të sigurimeve është nga 16% në 20%. Kostoja mesatare për sigurimin e shtëpive në Greqi varion ndërmjet 1.4-1.80 për qind për ndërtimet e pas vitit 2000 dhe rritet në 1.65-2.1 për qind për ndërtimet e vjetra nga viti 1970 e në vazhdim. (*shënim i autores*)

¹⁶ Shih Projekti “Shqipëria: Reforma e tregut të sigurimeve”, componenti 3. https://amf.gov.al/pdf/projekte/10_Insurance%20Market%20Reform.pdf

¹⁷ www.konsultimipublik.gov.al <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/649>

¹⁸ Me përjashtim të disa komenteve dhe opinionëve mediatike në dy tre javët e para, nuk ka patur deri tani ndonjë diskutim publik mbi përmbajtjen e këtij projektligji. Proceduralisht presupozohet se Ministria e Ekonomisë dhe Financave pret mendimet dhe opinionet e qytetarëve për projektin, por pas shumë kohësh nuk rezulton të ketë komente në portalin e mësipërm. (*shënim i autores*).

¹⁹ Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare për vitin 2023” pika 4 miratuar nga Kuvendi në datën 4.7.2024.

<https://kuvendiwefiles.blob.core.windows.net/webfiles/202407151713250973rezoluta%20e%20AMF-se%2C%20dt.%204.7.2024.pdf>

Sigurimi është transferimi i një rreziku të mundshëm²⁰, të një humbjeje pasurore dhe/ose jo pasurore nga i siguruari tek siguruesi, sipas një kontrate sigurimi. I siguruari (mbajtësi i policës) pranon një humbje të caktuar (pagesën e primit) në këmbim të marrjes së mbrojtjes nëse përjeton një humbje të paparashikueshme. Përkufizime të ndryshme të sigurimit identifikojnë elementët bazë në terma të përputhshëm me modelin 'relativ' ose 'transferimi i rrezikut', domethënë, një e drejtë kontraktuale e rikuperimit të dëmëve në ndodhjen e një ngjarje të pasigurt e cila është e pafavorshme për të siguruarin në këmbim të pagesës së një primi²¹. Sigurimi i pronës klasifikohet si sigurim "palë e parë" për të ofruar mbulim për humbjen e pronës së vetë zotëruesit të policës së sigurimit. Palët në kontratë dhe në kërkesë janë mbajtësi i policës (pala e parë) dhe siguruesi (pala e dytë)²².

Sigurimi vullnetar ka në themel vullnetin e lirë të të siguruarit, i cili udhëhiqet nga interesi për të siguruar pasurinë dhe nuk është i detyruar nga ndonjë ligj apo akt i ndonjë autoriteti shtetëror qendror apo vendor për të siguruar jetën, shëndetin apo pasurinë²³, por nga interesi i tij për të siguruar. I siguruari në këtë rast ka autonomi të plotë kontraktore për të hyrë në një marrëdhënie kontraktore sigurimi me një sigurues të përzgjedhur prej tij.

Kontratat e sigurimit të pronës janë përgjithësisht kontrata sigurimi vullnetar. Sigurimi i pasurisë në Shqipëri është sigurim vullnetar dhe rregullohet nga dispozitat e Kodit Civil²⁴. Merret në sigurim prona e luajtshme dhe e paluajtshme nga rreziqet që përzgjedh i siguruari (zjarri, goditja e rrufesë, eksplozimi, stuhia, breshëri, rrëshqitja e tokës dhe shembja, vërshimi dhe rrëkeja, tërmeti, vjedhja). Humbjet e mbuluara nga një policë sigurimi mund të mos ndodhin²⁵. Sigurimi nuk është mundësi përfitim, por siguri ekonomike në rast të një ngjarje të paparashikueshme që mund të godasë shëndetin, pronën dhe jetën tonë. I siguruari duhet të ketë interes për pasurinë, objekt sigurimi. Interes sigurimi do të thotë që i siguruarja ka një të drejtë ligjore mbi pronën që po sigurohet²⁶ Nëse nuk ka interes, sigurimi nuk mund të zbatohet.²⁷

Sigurimi i detyrueshëm përkufizohet duke iu referuar një detyrimi për të kryer një sigurim të tillë që i imponohet të siguruarit (mbajtësit të policës). Një detyrim i tillë për t'u siguruar mund të lindë nga ligji, ai mund të lindë edhe nga entitete publike me fuqi rregullatore si, bashkitë ose organet profesionale.²⁸ Sigurimi i detyrueshëm (privat) nuk bazohet në një detyrim nga ligji (aktet e tjera normative), por në një marrëdhënie kontraktuale midis mbajtësit të policës dhe siguruesit. Parimet e përgjithshme të së drejtës kontraktore zbatohen për kontratën e sigurimit të detyrueshëm në lidhje me formimin e saj. Nuk ka ndonjë kufizim se cilat rreziqe mund të jenë objekt i sigurimit të detyrueshëm (jeta, paaftësia, shëndeti, aksidenti, dëmtimi i pronës, katastrofat natyrore/të shkaktuara nga njeriu).²⁹

Nëse sigurimi bëhet për shkak të një marrëdhënije kontraktore, kjo nuk konsiderohet si sigurim i detyrueshëm. Në vendet perëndimore nuk konsiderohet sigurim i detyrueshëm kur mbajtësi i policës ka lidhur kontratën e sigurimit me kërkesë të autoriteteve ose rregullave etike të organeve profesionale ose për shkak të marrëveshjeve kolektive.³⁰ Sigurimi i pronës të vendosur si kolateral nga kredimarrësi në favor të kredidhënësit për shkak të

²⁰ Rreziku përkufizohet si pasiguri e ndodhjes se një ngjarje të caktuar e cila sjell humbje. Dy koncepte kryesore të cilat lidhen me rrezikun kanë rëndësi të veçantë në sigurime: pasiguria dhe humbjet e papritura.

²¹ Merkin, Rob. Steele, Jenny. Insurance and the Law of Obligations. Oxford University Press 2013. f. 46; ISBN 978-0-19-964574-9.

²² Stempel, Jeffrey W. Knutsen, Erik S. and Swisher, Peter N. Principles of Insurance Law. LexisNexis 2012. f. 56; ISBN: 978-1-4224-7261-3 (print), ISBN: 978-1-5791-1650-7 (eBook).

²³ Clarke, Malcolm. English Insurance Contract Law. Bookboon. 1st edition 2016, f.13; ISBN 978-87-403-1209-6.

²⁴ Ligj nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. "Sigurimi i pasurisë", nenet 1134-1149.

²⁵ Clarke, Malcolm. English Insurance Contract Law. Bookboon. 1st edition 2016, f.13; ISBN 978-87-403-1209-6.

²⁶ Cooper, Simon. & Patel, Mona. The Insurance and Reinsurance Law Review, Ninth Edition Editor Peter Rogan 2021. fq.153; ISBN 978-1-83862-787-4.

²⁷ Clarke, Malcolm. English Insurance Contract Law. Bookboon. 1st edition 2016, f. 13; ISBN 978-87-403-1209-6.

²⁸ Basedow, Jürgen. Birds, John. Clarke, Malcolm. Cousy, Herman. Heiss, Helmut. Loacker, Leander. Principles of European Insurance Contract Law. European Parliament, Brussels, 2010. f. 84; ISBN (print) 978-3-504-08002-0 ISBN (eBook) 978-3-504-38475-3.

²⁹ Koch, Robert. Compulsory Insurance https://max-eup2012.mpipriv.de/index.php/Compulsory_Insurance

³⁰ Po aty.

kontratës së kredisë është një shembull i një sigurimi “të detyrueshëm” për kredimarrësin, por kjo nuk mund të konsiderohet si një sigurim i detyrueshëm përsa kohë është rrjedhojë e një marrëdhënieje kontraktore të kredisë në të cilën kredimarrësi ka liri vullneti dhe autonomi të plotë kontraktore. Qëllimi i zbatimit të sigurimit të detyrueshëm është të mbulojë të gjithë personat përkatës dhe/ose rrezikun³¹, është mbrojtja e të dëmtuarit nga ngjarja e sigurimit duke i garantuar dëmshpërblimin, të siguruarit³² Ai mbron grupet e cenueshme dhe dëmtimin e pronës, 'humbje e pastër ekonomike'.³³

3. Standartet kushtetuese të ligjit për sigurimin e detyrueshëm të pasurisë

3.1 Liria kontraktore, kufizimi për një interes publik dhe parimi i proporcionalitetit

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë³⁴ garanton të drejtat e pronës private³⁵. Megjithatë, ajo lejon kufizime kur justifikohet nga interesi publik³⁶. Neni 11 i Kushtetutës garanton lirinë ekonomike³⁷, e cila përfshin të drejtën për të lidhur kontrata vullnetarisht. Jurisprudenca kushtetuese i ka dhënë një kuptim të zgjeruar lirisë së veprimtarisë ekonomike, duke e përkufizuar atë: si e drejta për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal³⁸. Liria e veprimtarisë ekonomike është një liri negative për atë që sa lidhet me vullnetin e individit për të zgjedhur fushën e ushtrimit të kësaj veprimtarie, duke hyrë lirisht në marrëdhënie ekonomike me subjekte të tjera. Përveç kësaj, liria e veprimtarisë ekonomike ka dhe aspektin e saj pozitiv që, nëpërmjet ligjvënësisë, shteti të ndërhyjë në rregullimin e kësaj lirie me qëllim që krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i të mirës së përbashkët.³⁹ Ruajtja e balancës ndërmjet lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe parimit të shtetit social e të mirës së përbashkët nuk është një ushtrim i lehtë në kontrollin kushtetues, veçanërisht lidhur me vlerësimin e racionalitetit të ndërhyrjes.⁴⁰ Në doktrinën kushtetuese ky kusht konsiderohet si parim i proporcionalitetit. Krahas testit të proporcionalitetit, në gjykimin kushtetues përdoret dhe ai i balancës⁴¹.

³¹ Chen, Bill Y. “Insurance Markets and Companies: Analyses and Actuarial Computations”. The Review and Analysis of Compulsory Insurance Conference. Paper July 2012. Volume 4, Issue 1, 2013 f. 8. DOI: 10.13140/2.1.3751.2964.. TheReviewandAnalysisofCompulsoryInsurance-IMCversion.pdf

³² Basedow, Jürgen. Birds, John. Clarke, Malcolm. Cousy, Herman. Heiss, Helmut. Loacker, Leander. Principles of European Insurance Contract Law. European Parliament, Brussels, 2010. f.304; ISBN (print) 978-3-504-08002-0 ISBN (eBook) 978-3-504-38475-3.

³³ Merkin, Rob. Steele, Jenny. Insurance and the Law of Obligations. Oxford University Press 2013. f. 260; ISBN 978-0-19-964574-9.

³⁴ Ligji nr.8417/1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar.

³⁵ Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 41 1. E drejta e pronës private është e garantuar. 2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil. 3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë. 4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë. 5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

³⁶ Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 17, Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

³⁷ Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 11 “1. Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. 2. Prona private dhe publike mbrohen njëjloj me ligj. 3. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike”.

³⁸ Berberi, Sokol. “Ndikimi i kontrollit kushtetues në racionalizimin e legjislationit”. Konferencë shkencore “Roli i Gjykatës Kushtetuese në zhvillimin e së drejtës”, Procsdings Book. Shtëpia Botuese FLESH 2023. f. 28; ISBN 9789928346308.

³⁹ VGJK nr.17, viti 2008

⁴⁰ Berberi, Sokol. “Ndikimi i kontrollit kushtetues në racionalizimin e legjislationit”. Konferencë shkencore “Roli i Gjykatës Kushtetuese në zhvillimin e së drejtës”, Procsdings Book. Shtëpia Botuese FLESH 2023. f. 30; ISBN 9789928346308.

⁴¹ Po aty, f. 32.

Lidhur me faktin e të drejtave që mund të çenohen dhe shkallën e cënimit të tyre nga ndërhyrja shtetërore për interes publik, për të përcaktuar më saktë kërkesat për justifikimin kushtetues, Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane përdor kryesisht të ashtuquajturën “Teoria e Sferës” kur përfshihet mbrojtja për sferat private, konfidenciale dhe intime. Ky koncept klasifikimi me tre hapa në përgjithësi synon të përcaktojë kërkesat e parimit të proporcionalitetit për ndërhyrjet në të drejtat themelore: në sferën sociale, ndërhyrjet mund të ndodhin në kushte më pak të rrepta, në sferën private në kushte më të rrepta. Asnjë ndërhyrje nuk lejohet në sferën intime⁴². Detyrimi i një qytetari për të lidhur një kontratë (sigurimi) është konsideruar si cënim i lirisë kontraktore, lirisë ekonomike dhe të drejtave pronësore. Detyrimi i individëve për të lidhur kontrata në të cilat ata mund të mos dëshirojnë të angazhohen, veçanërisht në fusha si,.... prona, cenon parimin thelbësor të lirisë kontraktuale - të drejtën për të lidhur ose refuzuar lirisht lidhjen e kontratës. Individët duhet të kenë autonominë për të vendosur nëse do të përfshihen në kontrata të tilla dhe ndërhyrja e shtetit në këto zgjedhje duhet të justifikohet me arsye të forta të interesit publik. Nga ana tjetër shteti është i detyruar të ndërmarrë masa në interes publik, të cilat mund të çenojnë lirinë e veprimtarisë ekonomike. Këto situata shpesh krijojnë tension në të drejtën kushtetuese, pasi prioritetet publike dhe të drejtat e Liria ekonomike futën në një konflikt kushtetues specifik për shkak të ndërhyrjeve shtetërore në të drejtat e individëve për interesa publike. Balancimi i interesave të nevojshëm për zgjidhjen e konfliktit kërkon një gjykim për pasojat për secilën palë, një peshim të situatës specifike të prioriteteve kushtetuese të prekura. Vlerësimi i pasojave kërkon përcaktimin e avantazheve dhe disavantazheve që do të rezultojnë nga veprimi i shtetit⁴³.

Në të drejtën kushtetuese pranohet që parimi i proporcionalitetit kërkon që ligji kufizues të miratohet për një qëllim të duhur. Kjo kërkesë është një shprehje e të kuptuarit se kufizimi i një të drejte kushtetuese nuk merret si i mirëqenë. Jo çdo konsideratë e interesit publik mund të shërbejë si një justifikim legjitim për kufizimin e një të drejte të njeriut. Përkundrazi, shqyrtimi i interesit publik duhet të jetë mjaftueshëm unik për të justifikuar një kufizim të tillë.⁴⁴

Sipas doktrinës dhe jurisprudencës kushtetuese gjermane: “Në interpretimin dhe zbatimin e këtyre të drejtave, gjykatat kanë zhvilluar kritere praktike, të njohura përgjithësisht – si parimi i proporcionalitetit – për vlerësimin e ndërhyrjeve shtetërore. Ekzistojnë shumë zgjidhje të ndryshme të mundshme, në varësi të vlerësimit të kushteve aktuale, qëllimit specifik dhe prioritetit të tij, si dhe mënyrave dhe mjeteve që mund të përdoren”⁴⁵.

Edhe jurisprudenca kushtetuese shqiptare ka vlerësuar proporcionalitetin e një kufizimi rast pas rasti, duke analizuar nëse: (i) objektivi i ligjvënësimit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; (ii) masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin – ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; (iii) mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhen për të arritur objektivin e kërkuar – sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t’u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme.⁴⁶

Jurisprudenca kushtetuese gjermane thekson se sipas parimit të ndarjes së pushteteve dhe parimit demokratik, zgjedhja e qasjes së ndërhyrjes, është përgjegjësi e legjislativit që gëzon legjitimitet të drejtpërdrejtë të dhënë nga populli.⁴⁷ E njëjta gjë theksohet edhe në jurisprudencën tonë kushtetuese. Megjithatë standarti kushtetues (neni

⁴² Bumke, Christian & Voßkuhle, Andreas. German Constitutional Law Introduction, Cases, and Principles. Oxford University Press USA 2019. f. 115; ISBN 978-0-19-880809-1. 9780192535627.

⁴³ Po aty, f. 64.

⁴⁴ Vorpsi, Arta. “The impact of proportionality test in protecting individual rights Some reflection on the case law of Albanian Constitutional Court”. Constitutional Justice and Evolution of Individual Rights. Arnold, Rainer. Alexandru Tănase (Eds.). International Conference Chişinău 2018. f. 43; ISBN 978-9975-0-1https://constcourt.md/public/files/file/Publicatii/2018/Constitutional_Justice_Conference.pdf

⁴⁵ Bumke, Christian & Voßkuhle, Andreas. German Constitutional Law Introduction, Cases, and Principles. Oxford University Press USA 2019. fq.75; ISBN 978-0-19-880809-1. 9780192535627.

⁴⁶ Berberi, Sokol. “Ndikimi i kontrollit kushtetues në racionalizimin e legjislacionit”. Konferencë shkencore “Roli i Gjykatës Kushtetuese në zhvillimin e së drejtës, Procsdings Book. Shtëpia Botuese FLESH 2023. fq.32; ISBN 9789928346308.

⁴⁷ Bumke, Christian & Voßkuhle, Andreas. German Constitutional Law Introduction, Cases, and Principles. Oxford University Press USA 2019. f. 75; ISBN 978-0-19-880809-1. 9780192535627.

17) kërkon që kjo qasje (ndërhyrje) të bëhet me ligj. Kushtetuta e Shqipërisë nuk parashikon në mënyrë të shprehur detyrimin kushtetues për ligjvënësin për të dhënë arsye për ligjin e miratuar⁴⁸, por duhet të respektojë kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës, që kufizimet e të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Jurisprudenca kushtetuese është shprehur se ligjvënësi duhet të zbatohet mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, d.m.th. të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, gjë që do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë, gjithashtu, edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimin të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar, konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, dobishmërisë dhe proporcionalitetit, në kuptimin strikt të kufizimeve të imponuara. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton kufizimin me ato të drejta që si rezultat i tij i nënshtrohen kufizimit, si dhe duke vlerësuar edhe mënyrën e kufizimit (shih vendimet nr.16, datë 25.07.2008; nr.52, datë 05.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese).⁴⁹

Vendosja e sigurimit të detyrueshëm pa cenuar të drejtat dhe liritë kushtetuese është një çështje komplekse që kërkon balancim të kujdesshëm midis lirive individuale dhe interesit publik. Në demokracitë kushtetuese, ky ekuilibër arrihet përmes respektimit të parimit të proporcionalitetit dhe garancive të tjera kushtetuese. Këtu gjenden mënyrat kryesore, përmes të cilave ligjet e sigurimit të detyrueshëm mund të strukturohen, për të shmangur shkeljen e të drejtave kushtetuese duke arritur njëkohësisht objektivat e synuara publike.

3.2 Sigurimi i detyrueshëm i pronës si një rast i cënimit të lirisë ekonomike për të mbrojtur interesin dhe mirëqenien publike

Sipas nenit 59 të Kushtetutës, shteti ka për detyrë të sigurojë mbrojtjen sociale. Sigurimi i detyrueshëm i pronës mund të shihet si një angazhim për përmbushje të kësaj përgjegjësie, duke siguruar që të gjithë qytetarët të kenë siguri financiare ndaj humbjeve të pronës, veçanërisht në rast fatkeqësish. Ligji i sigurimit të detyrueshëm është i justifikueshëm kur i shërben mirëqenies publike, veçanërisht në fusha si menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë. Rreziqet kolektive (fatkeqësitë natyrore) kërkojnë zgjidhje kolektive, të cilat shpesh kërkojnë sisteme sigurimesh të detyrueshme. Është standart kushtetues që ndërhyrja e shtetit duhet të bëhet me ligj. Zbatimi i këtij standarti pasqyrohet në ligjin nr.52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” (neni 8), i cili parashikon që veprimtaria e sigurimeve të detyrueshme rregullohet duke hartuar një ligj të veçantë.

Një nga parimet kryesore që vlerëson nëse ligji i sigurimit të detyrueshëm përmbush standartet kushtetuese është parimi i proporcionalitetit. Sipas këtij parimi çdo kufizim i lirisë kontraktore duhet të jetë i nevojshëm për të arritur interesin e dëshiruar publik dhe nuk duhet të shkojë përtej asaj që kërkohet. Shteti duhet të tregojë se masa është e përshtatshme⁵⁰, e nevojshme⁵¹ dhe proporcionale. Ligji nuk duhet të vendosë barrë të tepruar mbi individët. Kjo barrë duhet të jetë e nevojshme, e përshtatshme dhe proporcionale me qëllimin e mirëqenies publike. Sigurimi i detyrueshëm është në përputhje me kushtetutën dhe etikisht i pranueshëm kur është i nevojshëm për mirëqenien publike – veçanërisht në fusha si fatkeqësitë natyrore. Kjo do të nënkuptonte që sigurimi i detyrueshëm të përputhet me parimet e lirisë kontraktore, ai duhet të plotësojë kritere strikte, të tilla si adresimi i një nevojë sociale dhe të jetë proporcional me rreziqet e përfshira.

⁴⁸ Berberi, Sokol. “Ndikimi i kontrollit kushtetues në racionalizimin e legjisllacionit”. Konferencë shkencore “Roli i Gjykatës Kushtetuese në zhvillimin e së drejtës, Proceedings Book. Shtëpia Botuese FLESH 2023. f. 17; ISBN 9789928346308.

⁴⁹ VGJK nr.33/2016 paragrafi.33.

⁵⁰ Ligji i sigurimit të detyrueshëm duhet të kontribuojë efektivisht në arritjen e qëllimeve të mirëqenies publike, të tilla si mbrojtja e individëve nga dëmtimi financiar në rast rreziqesh të tjera.

⁵¹ Vendosja e sigurimit të detyrueshëm duhet të jetë metoda më e përshtatshme për arritjen e qëllimit. Nëse masat më pak kufizuese (p.sh., stimujt, subvencionet ose programet vullnetare) mund të arrijnë të njëjtin qëllim, natyra e detyrueshme e ligjit mund të kundërshtohet.

Ndërhyrja e shtetit justifikohet për mirëqenien publike. Megjithatë, duhet të ketë një ekuilibër midis sigurimit të drejtësisë sociale nëpërmjet sigurimit të detyrueshëm dhe ruajtjes së respektit për liritë individuale. Nërhyrja e shtetit në detyrimin e sigurimit duhet të kufizohet në rastet ku është absolutisht e nevojshme për të siguruar mirëqenien publike dhe duhet të projektohet për të pasur ndikim minimal në të drejtat individuale. Një test proporcionaliteti për të vlerësuar nëse ndërhyrja e shtetit është e arsyeshme, e drejtë dhe në përputhje me parimet kushtetuese. Një shëmbull do të ishte orientimi për zgjidhje të drejtuara nga tregu, ku shteti ofron udhëzime ose rregullore, por ia lë vendimmarrjen individëve në vend që të imponojë skema të detyrueshme. Në këtë rast, individët mund të zgjidhnin të mos marrin pjesë në skemat e detyrueshme në kushte të caktuara, ose krijimin e partneriteteve publiko-private që u ofrojnë individëve më shumë zgjedhje, subvencionimin e sigurimit vullnetar, krijimin e stimujve për individët që të blejnë vetë sigurimet, ose zbatimin e incentivave ku njerëzit inkurajohen të marrin pjesë në skemat e sigurimit. Në skemat e sigurimeve publike-private, qeveritë rrallë veprojnë si sigures të drejtpërdrejtë, por mbështeten tek siguresit privatë. Format më tipike të mbështetjes së qeverisë për skema të tilla përfshijnë legjislacionin që e bën të detyrueshëm sigurimin e katastrofave, kërkesat për rezervat e detyrueshme të katastrofës për siguresit dhe risiguresit, ose objektet e risigurimit për skemat e drejtuara nga industria e sigurimeve.⁵² Përvoja në disa shtete ka treguar se politikëbërësit mund të vendosin shumë lehtë detyrimin për mbulim sigurimi, por një çështje tjetër është nëse tregjet konkurruese të sigurimeve janë në gjendje dhe të gatshëm të ofrojnë mbulimin e nevojshëm të kërkuar nga ligji.⁵³ Më shumë se të miratohet me ligj sigurimi i detyrueshëm, me rëndësi është të ndërtohet një skemë sigurimi efikase dhe e drejtë, e cila kuptohet, pranohet dhe vlerësohet nga qytetarët.

4. Vendosja e sigurimit të detyrueshëm të pasurisë në Shqipëri

Futja e sigurimit të detyrueshëm të pronës në Shqipëri është një proces kompleks që kërkon angazhimin e institucioneve shtetërore, faktorëve relevant politik e social, ekspertizë të gjerë teknike, përfshirjen e tregut të sigurimeve dhe një ekspertizë juridike për të siguruar bazueshmërinë kushtetuese të kuadrit ligjor që do të rregullojë këtë sigurim. Autoritetet shtetërore⁵⁴, operatorët e tregut të sigurimeve⁵⁵, institucionet ndërkombëtare⁵⁶, dhe ekspertët e fushës⁵⁷ janë shprehur për nevojën dhe dobinë e vendosjes së sigurimit të detyrueshëm të pronës, por procesi nuk ka avancuar pas publikimit të projektligjit për sigurimin e banesave nga tërmetet. Nuk ka ndonjë ide për përfshirjen në sigurimin e detyrueshëm edhe të rreziqeve të tjera të fatkeqësive natyrore.

⁵² Gurenko, Eugene N. “Climate change and insurance-Disaster risk financing in developing countries”. London: Earthscan 2007. f. 652; ISSN: 1469-3062 ISBN-13: 978-1-84407-483-9

⁵³ Faure, Michael G. “Economic Criteria for Compulsory Insurance”. The Geneva Papers, 2006, 31, (149–168) f. 150. https://cris.maastrichtuniversity.nl/ws/portalfiles/portal/72381498/faure_2006_economic_criteria_for_compulsory_insurance.pdf

⁵⁴ Shih <https://www.kryeministria.al/newsroom/takimi-i-dyte-i-komitetit-te-rindertimit/>

⁵⁵ <https://shoqatasiguresve.al/2023/10/27/shteti-eshte-mbikeqyres-dhe-rregullator-jo-aktor-sigurimi-i-detyrueshem-i-banesave-shoqata-e-siguresve-5-arsyet-themelore-pse-projektligji-duhet-ripare/>

<https://shoqatasiguresve.al/2023/10/19/sigurimi-i-baneses-nga-termeti-me-detyrim-siguresit-kundershtojne-skemen-e-qeverise/>

⁵⁶ Sipas OECD për ekonominë në tranzicion futja e sigurimit të detyrueshëm justifikohet vetëm në fusha të tilla ku rreziqet e mbuluara janë veçanërisht serioze, ose (3) ku pagesat e primeve duhet të ndahen mbi një bazë të barabartë midis grupit të njerëzve në shqyrtim. Aty ku mbulimi nuk është i disponueshëm në treg sepse siguresi (ri) i konsideron rreziqet si të pasigurueshme ose ku mbulimi nuk është i përballeshëm, nuk mund të futet sigurim i detyrueshëm privat, por vetëm skema publike të sigurimeve shoqërore. OECD Guidelines on Insurer Governance | OECD .

⁵⁷ Shih Nazinyan, Ara. Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në Shqipëri. Raport i Konsoliduar, f. 33, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Gusht 2022.

Emri i Autorit

Vendosja e sigurimit të detyrueshëm të pronës dhe lista e rreziqeve që do të përfshihen në këtë sigurim, është e lidhur me rolin që do të luajë shteti në përballimin e dëmeve nga këto rreziqe⁵⁸. Konkretisht, nëse shteti do të vijojë të marrë përsipër dëmshpërblimin e të dëmtuarve në rastet kur, si rezultat i fatkeqësisë natyrore ose fatkeqësive të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, kanë pësuar dëme në njerëz dhe dëme materiale⁵⁹, apo do të vendoset sigurimi i detyrueshëm i pronës për këto raste dhe dëmet do të përballohen nga këto sigurime? Më pas do të duhej të përcaktohej se cilët rreziqe duhet të mbulohen nga sigurimi i detyrueshëm dhe elementët e tjerë të ndërtimit të një skeme të sigurimit të detyrueshëm. Të gjitha këto do të duhej të përfshihen në përmbajtjen e një ligji të posaçëm.⁶⁰

Mbështetja e shtresave në nevojë dhe në zonat me risk të lartë është një aspekt i rëndësishëm i përmbajtjes së këtij ligji. Kjo mund të realizohet me subvencionimin e primeve të sigurimit të pasurisë për shtresat e popullsisë në nevojë dhe, nëse është e mundur pjesërisht për shtesat me të ardhura të vogla⁶¹ si dhe subvencionimi i primit të sigurimit në zonat me risk të lartë (ekspozimit ndaj rrezikut).

Këto propozime shërbejnë si instrumente efikasë për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore nga qytetarët, operatorët ekonomikë, buxheti i shtetit, duke eliminuar ndikimet negative të tyre në zhvillimin ekonomik të vendit. Propozime të tilla rrisin vëmendjen e qytetarëve, biznesit dhe agjencive shtetërore për të mos kërkuar gjithmonë ndërhyrjen nga shteti për përballimin e fatkeqësive pasi ato kanë ndodhur, sidomos në zonat më të ekspozuara, por ndërtimin e instrumenteve alternativë për menaxhimin dhe përballimin e këtyre rreziqeve natyrore. Një model i mirë për hartimin e këtij ligji do të ishte ligji francez⁶² dhe përvoja e vendeve të tjera⁶³. Do të duhej të bëhej sigurimi i detyrueshëm i pasurisë publike (aseteve publike) që administrohen nga organet e pushtetit qendror, Qeverisjes Vendore dhe operatorët ekonomikë me kapital shtetëror.

Sigurimi i banesave në pronësi private apo publike dhe sigurimi për bizneset⁶⁴ duhet të jetë pjesë e përmbajtjes së këtij ligji.

Në ligj duhet të parashikohen rreziqet që do të mbulohen nga sigurimi i detyrueshëm, nëse do të jenë të gjitha rreziqet që përfshihen në fatkeqësitë natyre, sigurimi i detyrueshëm për rreziqet e fatkeqësive natyrore, (termetet, përmytjet) apo edhe rreziqe të tjera si rrëshqitjet e tokës, moti ekstrem aksidentet teknologjike apo epidemitë. Do

⁵⁸ Ligji nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM nr. 329/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”

⁵⁹ Ka mendime se kjo politikë shtetërore dekurajon sigurimin vullnetar të pronës nga qytetarët pasi presin që dëmet në raste të tilla të mbulohen nga buxheti i shtetit.” Askush nuk ka interes tw blejw njw policw sigurimi nwse do tw dwmshpwrblesh nga shteti. (*shënim i autores*).

⁶⁰ Sipas ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” (neni 8), kjo veprimtari sigurimi e detyrueshme rregullohet duke hartuar një ligj të veçantë.

⁶¹ Mbulimi i plotë i sigurimit do të reduktonte presionin politik mbi shtetin për të ofruar ndihmë nga qeveria për viktimat e pasiguruara të një "fatkeqësie natyrore". Megjithatë, nëse primet e sigurimit janë të bazuara në rrezik, disa pronarë shtëpish, veçanërisht ata në vende me rrezik të lartë, mund të mos jenë në gjendje të përballojnë sigurimin. Për të shmangur vështirësitë sociale, shteti mund të ketë ende nevojë të ndërhyjë me mbështetje financiare (*shënim i autores*).

⁶² Konsiderohet si eksperiencia më e mirë në BE. Ky ligj parashikon parimet, kushtet dhe fushën e zbatimit të ligjit, rreziqet që mbulohen, pronën (pasurinë) që sigurohet, franchise-n (pagesën nga i siguruari të një pjesë të kompensimit të pagueshëm), procedurën e konstatimit të ngjarjes së sigurimit, kërkesën dhe dokumentacionin për dëmshpërblim, rregullat e shqyrtimit të kërkesës për dëmshpërblim dhe pagesën e dëmshpërblimit të të siguruarit (*shënim i autores*).

⁶³ Ligji do të përcaktonte edhe përgjegjësinë e shoqërisë së sigurimit dhe shumën e siguruar (Kufiri i mbulimit) duke përcaktuar se deri në çfarë mase mund të përballohen këto dëme nga shoqëritë e sigurimit dhe aplikimin e instrumenteve të tjerë. Gjithësesi shtrirja e këtyre sigurimeve dhe përdorimi i instrumentit të risigurimit, së bashku me instrumentet e tjera do të mundësonte, që shoqëritë e sigurimit të mbanin një peshë të konsiderueshme për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga këto fatkeqësi natyrore (*shënim i autores*).

⁶⁴ Deri më 31 mars 2025, kompanive italiane u kërkohet të bëjnë sigurime të detyrueshme ndaj dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe ngjarjet katastrofike.

https://www.gazzettaufficiale.it/atto/serie_generale/caricaDettaglioAtto/originario?atto.dataPubblicazioneGazzetta=2025-02-24&atto.codiceRedazionale=25A01250&elenco30giorni=true

të ishte një arritje e madhe nëse do të përfshihej edhe mbulimi nga zjarri si rreziku kryesor i pasurisë. Kjo do të ishte në vlerësimin e ekspertëve të fushave përkatëse.

Duhet të jenë pjesë e ligjit elementët thelbësorë të kontrata e sigurimit të detyrueshëm. Kushtet dhe tarifat e sigurimit të detyrueshëm, rregullat e dëmshpërblimit, procedura dhe afate për rregullimin e shpërblimit të dëmeve dhe përgjegjësia e shoqërisë së sigurimit dhe shuma e siguruar (Kufiri i mbulimit).⁶⁵

Ligji duhet të parashikojë krijimin e fondit të dëmshpërblimit për rastet e sigurimit, ku shoqëritë duhet të kenë rolin përcaktues në administrimin e tij dhe AMF e organet e tjera rol të fortë mbikqyrës.

Do të ishte efikase të parashikohej ne projektligj edhe subvencionimi i plotë i primeve të sigurimit të pasurisë për shtresat e popullsisë në nevojë, dhe pjesërisht edhe për shtresa të tjera të popullsisë si instrument nxitës për përballimin e pasojave të këtyre rreziqeve. Subvencionimi i sigurimit në zonat me risk të lartë (ekspozimit ndaj rrezikut) për të përballuar primet e sigurimit shumë të larta për këto zona. Kjo do sillte efekte pozitive për të vendosur nga njëra anë, prime sigurimi reale, të cilat mundësojnë përballimin e dëmeve të rreziqeve, dhe, nga ana tjetër, do të nxisnin shtrirjen e sigurimit në këto zona me përfitime të mëdha për subjektet e siguruar, buxhetin e shtetit dhe ekonominë e vendit.

4.1 Sfidat e mundshme kushtetuese në Shqipëri

Në vendet e Evropës dhe Shteteve të Bashkuara, sfidat kushtetuese (kërkesat për shfuqizim) kundër ligjeve të sigurimit të detyrueshëm kanë qenë të pasuksesshme, sepse këto ligje janë hartuar nga nevoja për të mbrojtur shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien publike. Përfitimet kolektive që rrjedhin nga skemat e sigurimit të detyrueshëm shihen si interesa legjitime që justifikojnë kufizimet e vendosura në autonominë individuale dhe lirinë ekonomike.

Ligjet e sigurimit të detyrueshëm pas miratimit e hyrjes në fuqi mund të përballen me sfida kushtetuese, kërkesë në Gjykatë Kushtetuese me pretendimin e cënimit të lirive individuale nga pushtetit shtetëror dhe mosrespektim të parimit të proporcionalitetit. Gjatë hartimit dhe diskutimit të tij duhet marrë në konsideratë respektimi i parimeve të mësipërme, i cili në vetvete është një shqyrtim kushtetues paraprak i përmbajtjes së ligjit, përpara se ai të hyjë në fuqi. Në doktrinën dhe jurisprudencën kushtetuese njihet kontrolli ex ante dhe ex post i ligjeve. Shqyrtimi kushtetues i ligjeve para hyrjes së tyre në fuqi është një proces i njohur si shqyrtim kushtetues ex ante, kurse shqyrtimi kushtetues ex post kryhet pas hyrjes në fuqi të ligjeve. Aspekti pozitiv i shqyrtimit ex ante është se, në parim asnjë ligj që bie ndesh me kushtetutën nuk mund të hyjë në fuqi. Prandaj, qëllimi kryesor i një rishikimi të tillë është të sigurojë që organi ligjvënës të mos i kapërcejë kufijtë kushtetues.⁶⁶ Në Mbretërinë e Bashkuar, Gjykatat kontrollojnë ex-ante kushtetutshmërinë e projektligjit dhe bëjnë "deklarata formale të pajtueshmërisë", pas vlerësimit të të gjitha interpretimeve të mundshme në përputhje me të drejtat në fjalë dhe paralajmërojnë Parlamentin për ekzistencën e këtij konflikti, duke mundësuar të bëhen ndryshimet e kërkuara përpara zbatimit të ligjit të miratuar.⁶⁷ Në Finlandë, komisioni parlamentar i së Drejtës Kushtetuese (Perustuslakivaliokunta)⁶⁸ është përgjegjës për shqyrtimin e projektligjeve për kushtetutshmërinë e tyre si dhe për pajtueshmërinë e tyre me traktatet.⁶⁹ Në Suedi kontrolli ex-ante i projektligjeve që diskutohen në Parlament, i është dhënë Këshillit për Legjislacion.⁷⁰ Ky organ thirret të japë mendime mbi projektligjet e propozuara, kur këto kërkohen nga Qeveria

⁶⁵ Ligji nr.32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" ka parashikime të tilla, të cilat janë konsideruar të rëndësishme për funksionimin e këtij sigurimi.

⁶⁶ Po aty.

⁶⁷ Duranti, Francesco, "New Models of Constitutional Review". Comparative Law Review, Vol. V, No. 1, 2014, f. 16; <https://ssrn.com/abstract=2623684>

⁶⁸ Përbëhet vetëm nga anëtarë të Parlamentit, në rasti i vlerësimit të kushtetutshmërisë merr mendimin e studiuesve të shquar të së drejtës kushtetuese (p.sh. kryesisht akademikë/profesorë universiteti) (shënim i autores).

⁶⁹ De Visser, Maartje. "Constitutional Review in Europe, A Comparative Analysis". Hart Publishing 2014, f. 268-269; ISBN 978-1-84946-385-0 (hardback), 978-1-4725-6159-6 (online).

⁷⁰ Përbëhet nga gjyqtarë dhe ish gjyqtarë të Gjykatës së Lartë Gjykata dhe Gjykatës së Lartë Administrative (shënim i autores).

ose nga një Komisioni Parlamentar⁷¹. Për shkak se çështjet kushtetuese zgjojnë interes të gjerë publik sepse kanë të bëjnë me përdorimin e pushtetit publik dhe të drejtave themelore, interpretimet e shqyrtimit ex ante të projektligjeve kanë interes publik.⁷²

Kushtetuta e Shqipërisë⁷³ nuk parashikon shqyrtimin kushtetues të projektligjeve nga ndonjë trupë gjyqësore apo strukturë jashtë Kuvendit⁷⁴. Projektligjet shqyrtohen në komisionet parlamentare dhe në Seancë Plenare. Kushtetuta parashikon se Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë⁷⁵. Kjo kompetencë kushtetuese e Presidentit, e lidhur me kompetencën kushtetuese të shpalljes të ligjin të miratuar brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij, mund të konsiderohet si një kontroll kushtetues ex ante të projektligjit.

Në rregulloren e Kuvendit (neni 14) parashikohet “Këshilli për Legjislacionin” si organ këshillimor, që vlerëson ose jep mendim për çështje kushtetuese ose ligjore që ngrihen në lidhje me tekstin e projektligjit dhe për çështje të harmonizimit të projektligjit me aktet e tjera ligjore në fuqi ose me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe aktet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë⁷⁶. Anëtarët e Këshillit janë me profesion jurist ose duhet të kenë përvojë legjislative. Komisioni përgjegjës, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij, ose Kryetari i Kuvendit mund të kërkojë mendimin e Këshillit për Legjislacionin. Këshilli shpreh mendimin bazuar në kërkesën e Kryetarit të Kuvendit ose të komisionit përgjegjës. Në mbledhjen e Këshillit mund të marrin pjesë relatori i çështjes në komisionin përgjegjës dhe propozuesi i projektligjit. Nëse komisioni përgjegjës nuk merr parasysh mendimin e Këshillit, në raportin për seancën plenare paraqiten edhe argumentet e mospranimit. Raporti i Këshillit i bashkëlidhet raportit të komisionit. Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli i paraqet Kryetarit të Kuvendit dhe/ose komisionit përgjegjës një raport ku pasqyrohen të gjitha opinionet për çështjen.

Procesi i diskutimit të projektligjit të sigurimit të detyrueshëm të pronës ka nevojë për një shqyrtim kushtetues të kujdesëshëm ex ante duke përdorur të gjitha instrumentet ligjore dhe institucionale. Pavarësisht se Këshilli për Legjislacionin ka shqyrtuar kryesisht draftet e amendamenteve kushtetuese, është rasti që të shqyrtojë edhe këtë projektligj për shkak të arsyeve që kemi renditur më lart, sidomos respektimi i parimit të propocionalitetit. Praktika e vendeve të tjera ka treguar se një procedurë ex ante e shqyrtimit të kushtetutshmërisë të një projektligji, mënjanon shfuqizimin e tij pas hyrjes në fuqi nga Gjykata Kushtetuese (procedurë ex post).

Është një rast për t’u mbajtur në konsideratë jurisprudenca kushtetuese e kërkesave për shfuqizimin e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor në vitin 2021⁷⁷ dhe 2024⁷⁸. Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 28/2021 i vlerësoi si antikushtetuese disa nene të ligji të Kodit Zgjedhor me arsyetimin se kufizimet e vendosura me këtë dispozitë nuk janë propocionale. Pas miratimit nga Kuvendi i ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, ndryshimet u ankimuan përsëri në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata kushtetuese pasi shqyrtoi kërkesën i gjeti në përputhje me

⁷¹ Duranti, Francesco, “New Models of Constitutional Review”. *Comparative Law Review*, Vol. V, No. 1, 2014, f. 12; <https://ssrn.com/abstract=2623684>

⁷² Dahlberg, Maija. “Openness of Constitutional Review: A Comparative Analysis of How Transparency is Ensured in Ex Ante Constitutional Review”. J. de Poorter et al. (eds.), *European Yearbook of Constitutional Law 3*. *European Yearbook of Constitutional Law 2021*, Springer. f. 157. ISBN 978-94-6265-534-8 ISBN 978-94-6265-535-5 (eBook) https://doi.org/10.1007/978-94-6265-535-5_8

⁷³ Shih nenet 75 pika 2, 77, 78,81-85 të Kushtetutës.

⁷⁴ Bën përjashtim raste të veçanta kur kërkohet një opinion nga Komisioni i Venecias (*shënim i autores*).

⁷⁵ Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (neni 85 pika 2 e Kushtetutës)

⁷⁶ Këshilli për Legjislacionin përbëhet nga 10 deputetë, të emëruar nga Kryetari i Kuvendi, pasi ka marrë më parë mendimin e kryetarëve të grupeve parlamentare. Këshilli siguron përfaqësim të barabartë mes shumicës dhe opozitës parlamentare. (*shënim i autores*).

⁷⁷ Shfuqizimi i nenit 163 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me nenin 21 të ligjit nr. 118/2020, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë

⁷⁸ Shfuqizimi i neneve 67 dhe 163, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të Vendim i Gjykatës Kushtetuese Kërkuar: partitë “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, “Nisma Thurje”, “Aleanca Demokracia e Re”, “Lëvizja Demokratike për Ndryshim”, “Kombëtare Konservatore Albania”, “Bashkimi Demokristian Shqiptar”, “Ora e Shqipërisë”, organizata “Shqipëria bëhet”, Lulzim Basha, Orjola Pampuri, Merita Baku dhe Gëzim Ademaj. Faqe 2 ndryshuar me nenet 5 dhe 9 të ligjit nr. 81/2024, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kushtetutën ne rrezoi kërkesën⁷⁹. Procedura e shqyrtimit kushtetues të këtyre ndryshimeve ishte ex-post, por vendimi i Gjykatës nr. 28/2021 i shërbeu Kuvendit si një model për të riparuar “defektet” kushtetuese për hartimin e ndryshimeve vijuese. Një shqyrtim ex ante do të manjanonte problemet kushtetuese të projektligjit.

Pavarësisht nga roli thelbësor që ka qeveria në hartimin e projektligjit, do të ishte e dobishme që në kuvend të ngrihej një komision i posaçëm parlamentar⁸⁰ i cili do të mund të shqyrtonte edhe aspekte të tjera të këtij projektligji që lidhen me fusha të tjera.

5. Referendumi i përgjithshëm për sigurimin e detyrueshëm të pronës

Suksesi i një sigurimi të detyrueshëm, varet nga fakti se sa ai do të pranohet gjerësisht nga publiku. Pranimi i publikut varet nëse ai mendon se do të përfitojë nga ky sigurim pasi ka shpenzuar para për të blerë një policë sigurimi. Publiku mund të jetë entuziast në fillim, por opinionet e publikut mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Edukimi dhe promovimi i mirë dhe komunikimi me publikun për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e një sigurimi të detyrueshëm të propozuar janë vendimtare.⁸¹

Mbajtja e një referendumi⁸² për ligjin e sigurimeve të detyrueshme të pronës mund të ishte një ndihmë e madhe pasi siguron legjitimitet demokratik dhe mbështetje publike për një skemë sigurimi e cila do të funksionojë për një kohë shumë të gjatë. Megjithatë, referendumi paraqet disa sfida për shkak të kompleksitetit të ligjit, rreziku i politizimit⁸³, kostot financiare, vonesa kohore si dhe rrezikun që të mos jetë i suksesshëm, sidomos përsa i përket shumicës së kërkuar për pjesëmarrje⁸⁴. Mbështetja publike e ligjit nëpërmjet një referendumi mund të rrisë besueshmërinë e politikës, duke siguruar që ligji të mos perceptohet si i imponuar nga qeveria, por të miratohet nga njerëzit. Refuzimi i tij do të ishte një orientim për qeverinë për të gjetur alternativa të tjera më të pranueshme.

6. Konkluzione

Një ligj për sigurimin e detyrueshëm të pronës në Shqipëri është potencialisht kushtetues, me kusht që të përputhet me interesin publik, proporcionalitetin dhe drejtësinë ekonomike. Shqipëria duhet të adoptojë një qasje të ekuilibruar që kombinon sigurimin e detyrueshëm me masat e përbalueshmërisë të mbështetura nga shteti. Hartimi i kujdeshëm ligjor dhe zbatimi transparent do të jenë thelbësore për të shmangur sfidat kushtetuese dhe për të siguruar pranimin nga shoqëria.

Projektligji duhet të jetë në harmoni me kormizën ligjore të rregullimit të tregut të sigurimeve të parashikuar nga ligji nr.52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

⁷⁹ VGJM nr.85/2024.

⁸⁰Neni 24 pika 1 e Rregullores së Kuvendit parashikon që: Kuvendi mund të vendosë krijimin e një komisioni të pos Shfuqizimi i nenit 163 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me nenin 21 të ligjit nr. 118/2020, si të pajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë për shqyrtimin dhe përgatitjen e nismave ligjvënëse, si dhe për çështje të një rëndësie të veçantë (*shënim i autores*).

⁸¹ Chen, Bill Y. “Insurance Markets and Companies: Analyses and Actuarial Computations”. The Review and Analysis of Compulsory Insurance Conference. Paper July 2012. Volume 4, Issue 1, 2013 f. 12. DOI: 10.13140/2.1.3751.2964. file:///C:/Users/35568/Downloads/TheReviewandAnalysisofCompulsoryInsurance-IMCversion%20(3).pdf

⁸² Referendumi është një formë e drejtpërdrejtë e pjesëmarrjes demokratike, duke i lejuar qytetarët të votojnë për çështje të rëndësishme

⁸³ Partitë politike ose grupet e interesit mund të kërkojnë të ndikojnë në procesin e referendumit duke hartuar ligjin e sigurimit të detyrueshëm në një mënyrë që të përputhet me axhendat e tyre. Kjo mund të çojë në polarizim rreth një çështjeje që mund të jetë komplekse dhe e shumëanshme (*shënim i autores*).

⁸⁴ Ligji nr.9087/2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 118 Kuptimi i referendumit 1. Referendumi është ushtrimi i drejtpërdrejtë i sovranitetit të popullit, nëpërmjet votimit, për një çështje ose një ligj të caktuar, sipas neneve 108 pika 4, 150, 151, 152 dhe 177 të Kushtetutës.3. Në referendum konsiderohet fituese alternativa që ka fituar shumicën e votave të vlefshme, por jo më pak se një të tretën e numrit të zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë kre.

Emri i Autorit

Projektligji duhet të përfshijë këtë produkt sigurimi brenda tregut të sigurimeve, për të mos lejuar krijimin e një monopoli shtetëror.

Projektligji duhet të ketë përputhshmëri me kornizën ligjore evropiane dhe me legjislacionin e shteteve të Bashkimit Evropian.

Projektligji duhet të jetë brenda kuadrit ligjor dhe rregullator të sigurimeve. AMF duhet të jetë organ rregullator dhe mbikqyrës i tregut të sigurimeve.

Projektligji duhet të garantojë dëmshpërblimin e policëmbajtësve përmes mekanizmave garatues që parashikon tregu i sigurimeve për siguresit (provigjonet, niveli i aftësisë paguese, kufizimi i investimeve, nivelet e vlerësimit të riskut) si dhe të parashikojë periudhë sa më të shkurtër për dëmshpërblimin. Projektligji duhet të inkurajojë tregun e sigurimeve të pronës dhe të motivojë qytetarët për sigurimin e pronës nga zjarri dhe rreziqet shtesë. Qytetarët duhet të shohin sigurimin si një alternativë parësore dhe kryesore për dëmshpërblim në vend të kompensim nga buxheti i shtetit.

Diskutimi dhe miratimi i tij duhet të jetë gjithëpërfshirës - institucionet shtetërore, grupet e interesit, biznesin dhe ekspertët e fushave që prek.

Projektligji ka nevojë për një shqyrtim paraprak kushtetues ex ante përmes mekanizmave që ofrohen në Shqipëri për të garantuar bazueshmerinë kushtetuese kundrejt sfidave që mund t'i bëhen pas miratimit të tij.

BIBLIOGRAFI

Literatura

1. Basedow, Jürgen. Birds, John. Clarke, Malcolm. Cousy, Herman. Heiss, Helmut. Loacker, Leander. *Principles of European Insurance Contract Law*. European Parliament, Brussels, 2010. ISBN (print) 978-3-504-08002-0 ISBN (eBook) 978-3-504-38475-3.
2. Berberi, Sokol. "Ndikimi i kontrollit kushtetues në racionalizimin e legjislacionit". Konferencë shkencore "Roli i Gjykatës Kushtetuese në zhvillimin e së drejtës", Proceedings Book. Shtëpia Botuese FLESH 2023. ISBN 9789928346308.
3. Bumke, Christian & Voßkuhle, Andreas. *German Constitutional Law Introduction, Cases, and Principles*. Oxford University Press USA 2019; ISBN 978-0-19-880809-1. 9780192535627.
4. Clarke, Malcolm. *English Insurance Contract Law*. Bookboon. 1st edition 2016, ISBN 978-87-403-1209-6.
5. Cooper, Simon. & Patel, Mona. *The Insurance and Reinsurance Law Review, Ninth Edition* Editor Peter Rogan 2021. ISBN 978-1-83862-787-4.
6. Caltana, Diego. Krecic, Francesco. "Le Assicurazioni Generali in Albania: sedi di rappresentanza e politiche immobiliari fino al 1945". *Architetti e ingegneri italiani in Albania*. Edifir Edizioni Firenze 2012. <https://core.ac.uk/reader/53289750>
7. Chen, Bill Y. "Insurance Markets and Companies: Analyses and Actuarial Computations". The Review and Analysis of Compulsory Insurance Conference. Paper July 2012. Volume 4, Issue 1, 2013 DOI: 10.13140/2.1.3751.2964. [TheReviewandAnalysisofCompulsoryInsurance-IMCversion.pdf](https://www.researchgate.net/publication/312512964)
8. Duranti, Francesco, "New Models of Constitutional Review". *Comparative Law Review*, Vol. V, No. 1, 2014,; <https://ssrn.com/abstract=2623684>
9. De Visser, Maartje. "Constitutional Review in Europe, A Comparative Analysis". Hart Publishing 2014, ISBN 978-1-84946-385-0 (hardback). 978-1-4725-6159-6 (online).
10. Faure, Michael G. "Economic Criteria for Compulsory Insurance". *The Geneva Papers*, 2006, 31, (149–168) https://cris.maastrichtuniversity.nl/ès/portalfiles/portal/72381498/faure_2006_economic_criteria_for_compulsory_insurance.pdf
11. Gurenko, Eugene N. "Climate change and insurance-Disaster risk financing in developing countries". London: Earthscan 2007. ISSN: 1469-3062 ISBN-13: 978-1-84407-483-9
12. Koch, Robert. *Compulsory Insurance*. https://max-eup2012.mpipriv.de/index.php/Compulsory_Insurance

13. Kuçaj, Kreshnik. Historiku i Kompanive të Sigurimit në Shqipëri. https://www.academia.edu/124029446/Historiku_i_Kompanive_t%C3%AB_Sigurimit_n%C3%AB_Shqip%C3%ABri
14. Maija Dahlberg. Openness of Constitutional Review: A Comparative Analysis of How Transparency is Ensured in Ex Ante Constitutional Review Contents. J. de Poorter et al. (eds.), European Yearbook of Constitutional Law 2021, European Yearbook of Constitutional Law 3, ISBN 978-94-6265-534-8 ISBN 978-94-6265-535-5 (eBook) https://doi.org/10.1007/978-94-6265-535-5_8
15. Merkin, Rob. Steele, Jenny. Insurance and the Law of Obligations. Oxford University Press 2013. ISBN 978-0-19-964574-9.
16. Nazinyan Ara, Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në Shqipëri. Raport i Konsoliduar, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Gusht 2022.
17. Stempel, Jeffrey W. Knutsen, Erik S. and Swisher, Peter N. Principles of Insurance Law. LexisNexis 2012. ISBN: 978-1-4224-7261-3 (print), ISBN: 978-1-5791-1650-7 (eBook).
18. Vorpsi, Arta. "The impact of proportionality test in protecting individual rights Some reflection on the case law of Albanian Constitutional Court". Constitutional Justice and Evolution of Individual Rights. Arnold, Rainer. Alexandru Tănase (Eds.). International Conference Chişinău 2018. ISBN 978-9975-00https://constcourt.md/public/files/file/Publicatii/2018/Constitutional_Justice_Conference.pdf

Legjilacion

1. Ligji nr.8417/1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" e ndryshuar.
2. Ligj nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
3. projektligjit "Për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet" dhe Relacioni.
4. Ligji nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile".
5. Ligj nr.7506/1991 "Për Institutin e Sigurimeve".
6. Ligji nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".
7. Ligji nr. 9572/.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" i ndryshuar.
8. Ligji nr.32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".
9. ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".
10. Ligji nr.9087/2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë.
11. Rezoluta e Kuvendit "Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2023" miratuar në datën 4.7.2024.
12. Rregullorja e Kuvendit .
13. Decreto-legge 27 dicembre 2024, n. 202-rinviato la scadenza per la stipula delle polizze catastrofali.

Jurisprudencë

1. VGJK nr.85/2024.
2. VGJK nr.28/2021.
3. VGJK nr.33/2016.
4. VGJK nr.17, viti 2008.

Web Faqe

1. Projekti "Shqipëria: Reforma e tregut të sigurimeve", Komponenti 3. https://amf.gov.al/pdf/projekte/10_Insurance%20Market%20Reform.pdf.[www.konsultimipublik.gov.al](https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/649)
<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/649>
2. OECD Guidelines on Insurer Governance | OECD. <https://legalinstruments.oecd.org/public/doc/102/102.en.pdf>

E DREJTA PËR TË “MOS MIGRUAR”

LLM Aldi KASMI*

THE RIGHT “NOT TO MIGRATE”

Abstract

Migration is one of the main challenges that Albania is facing, significantly affecting the demographic structure, economic development and social stability of the country. While the right to migrate is recognized as a fundamental human right, less has been addressed the right not to migrate, that is the right of individuals to live and prosper in their country without being forced to leave due to difficult economic, social or political conditions. This paper analyzes the legal and political basis of this right, focusing on the responsibilities of Albania and international actors to guarantee appropriate conditions that enable citizens to choose their residence.

Albania is facing a significant outflow of skilled labor and young people due to high unemployment, low wages, lack of professional prospects and inadequate public services. These factors transform migration from an individual choice into a social and economic necessity. In this context, the paper examines the obligations of the state to ensure equal and fair conditions for its citizens, in accordance with international human rights treaties and the Albanian Constitution.

Through a legal and socio-economic analysis, this study proposes policies that aim to reduce the push factors of migration, including increasing investment in strategic sectors, strengthening the rule of law, improving public services and creating a more sustainable labor market. The article argues that guaranteeing the right not to migrate should be a key objective of state and international policies, ensuring that individuals have real opportunities for a dignified life in their country.

Keywords: *migration, politics, rights, perspective, reforms, cooperation, international law.*

1. Hyrje

Migrimi ka qenë një fenomen i vazhdueshëm përgjatë historisë së njerëzimit, por në dekadat e fundit, flukset migratore janë rritur ndjeshëm për shkak të faktorëve ekonomikë, politikë, socialë dhe mjedisorë. Globalizimi, konfliktet e armatosura, ndryshimet klimatike dhe pabarazitë ekonomike janë ndër faktorët kryesorë që nxisin lëvizjen e popullsisë në shkallë ndërkombëtare¹. Në këtë kontekst, e drejta për të migruar është pranuar si një e

* Aldi Kasmi është jurist dhe punon aktualisht si Specialist në Drejtorinë e Organizatave Ndërkombëtare në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Ai ka një eksperiencë të gjatë në fushën e së Drejtës Ndërkombëtare dhe është diplomuar në LLM E Drejtë Ndërkombëtare në Universitetin e Westminster në Mbretërinë e Bashkuar, gjithashtu ka kryer një master në të Drejtë Penale në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës. Ka eksperiencë si ekspert ligjor për të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe refugjatët në Mbretërinë e Bashkuar dhe së fundmi ka mbajtur postin e Delegatit Rinor të Shqipërisë në OKB gjatë mandatit 2023-2025, aty ku ka përfaqësuar të rinjtë shqiptarë në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. kasmialdi@gmail.com.

¹ Castles, Stephen, Hein de Haas, and Mark J. Miller. *The Age of Migration: International Population Movements in the Modern World*. 6th ed. New York: Guilford Press, 2020, f. 13.

drejtë themelore e njeriut, e mbrojtur nga instrumente ndërkombëtare si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut² dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.³

Megjithatë, diskutimi mbi migracionin shpesh anashkalon një aspekt thelbësor: e drejta për të “mos migruar”. Kjo nënkupton krijimin e kushteve të duhura që u mundësojnë qytetarëve të qëndrojnë në vendin e tyre pa qenë të detyruar të emigrojnë për shkak të varfërisë, mungesës së mundësive ose pasigurisë. Për Shqipërinë, ky debat është veçanërisht i rëndësishëm, duke marrë parasysh nivelet e larta të emigracionit dhe efektet e tij në zhvillimin kombëtar. Ky punim synon të analizojë bazën ligjore dhe implikimet politike të së drejtës për të “mos migruar”, duke shqyrtuar detyrimet e shtetit shqiptar dhe aktorëve ndërkombëtarë për të siguruar një mjedis ku qytetarët të mund të zgjedhin të qëndrojnë në vendin e tyre.

2. Pasqyra e trendeve globale të migrimit

Migrimi ndërkombëtar është një fenomen i përhapur që ka pësuar ndryshime të ndjeshme gjatë dekadave të fundit. Sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), në vitin 2022, numri i emigrantëve ndërkombëtarë arriti në 281 milionë, që përbënte rreth 3.6% të popullsisë botërore⁴. Ky numër është dyfishuar në krahasim me vitin 1990, duke reflektuar shtimin e krizave globale, luftërave, ndryshimeve klimatike dhe faktorëve ekonomikë që nxisin lëvizjen e popullsisë.

Migrimi shpesh perceptohet si një e drejtë dhe mundësi, veçanërisht për ata që kërkojnë siguri ekonomike ose mbrojtje nga persekutimi. Për shembull, Bashkimi Evropian ka promovuar lëvizjen e lirë të qytetarëve brenda kufijve të tij për të rritur integrimin dhe zhvillimin ekonomik. Po ashtu, Konventa e OKB-së për Refugjatët e vitit 1951 i njehtë drejtën individëve për të kërkuar azil në rastet e persekutimit.⁵

Megjithatë, për një pjesë të madhe të popullsisë globale, migrimi nuk është një zgjedhje, por një domosdoshmëri. Faktorët shtytës, si konfliktet e armatosura në Siri, Afganistan dhe Ukrainë, rritja e pabarazisë ekonomike në Afrikën Sub-Sahariane dhe ndryshimet klimatike që dëmtojnë jetesën në vendet bregdetare dhe ishullore, kanë detyruar miliona njerëz të largohen nga vendet e tyre⁶. Sipas Raportit Global të Migracionit, mbi 60% e emigrantëve lëvizin për arsye ekonomike, ndërsa të tjerët për shkak të krizave humanitare dhe mjedisore.⁷

Në këtë kontekst, bëhet e domosdoshme që debati mbi migrimin të mos fokusohet vetëm në të drejtën për të lëvizur, por edhe në të drejtën për të qëndruar në vendin e origjinës në kushte të denja. Politikat publike duhet të synojnë zvogëlimin e faktorëve shtytës të migracionit, duke siguruar që njerëzit të mos detyrohen të emigrojnë për shkak të mungesës së mundësive, por të kenë një zgjedhje reale për të qëndruar dhe zhvilluar jetën e tyre në vendin e tyre.

Diskursi mbi migracionin shpesh fokusohet në të drejtën për të lëvizur, duke e paraqitur atë si një liri themelore të individit dhe një faktor të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik dhe social. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut garanton të drejtën e çdo personi për të dalë nga vendi i tij dhe për t'u rikthyer.⁸ Megjithatë, migrimi nuk është gjithmonë rezultat i një zgjedhjeje të lirë, por shpesh është i detyruar nga faktorë që kufizojnë mundësitë për një jetë të qëndrueshme në vendin e origjinës. E drejta për të “mos migruar”, si një koncept që thekson rëndësinë e krijimit të kushteve që mundësojnë qëndrimin, ka marrë shumë më pak vëmendje në debatet ligjore dhe politike.

Në shumë vende, përfshirë Shqipërinë, emigrimi nuk është një zgjedhje e mirëfilltë, por një reaksion ndaj kushteve të pafavorshme të jetesës. Sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin, rreth 60% e emigrantëve

² Kombet e Bashkuara, *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*, 10 dhjetor 1948, neni 13.

³ Kombet e Bashkuara, *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike*, 16 dhjetor 1966.

⁴ Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), *Raporti Botëror i Migracionit 2022*, Gjenevë: IOM 2022, f.3, <https://publications.iom.int/system/files/pdf/WMR-2022.pdf>

⁵ Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), *Konventa në lidhje me statusin e refugjatëve*, 28 korrik 1951, Seria e Traktatit të Kombeve të Bashkuara, vëll. 189, f. 137.

⁶ Banka Botërore. *Groundswell Pjesa 2: Veprimi mbi Migrimin e Brendshëm Klimatik*. Uashington, D.C.: Publikimet e Bankës Botërore, 2021, f. 3. <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/36248>

⁷ IOM, *Raporti Botëror i Migracionit 2022*, f. 3.

⁸ Kombet e Bashkuara. *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*. 10 dhjetor 1948, neni 13.

në mbarë botën lëvizin për arsye ekonomike, duke përfshirë mungesën e punës dhe pagat e ulëta.⁹ Në Shqipëri, këto faktorë janë të shoqëruar me pasigurinë sociale dhe korrupsionin, duke e kthyer migracionin në një strategji mbijetese më shumë sesa në një mundësi zgjedhjeje. Për këtë arsye, është thelbësore që politikat kombëtare dhe ndërkombëtare të synojnë jo vetëm rregullimin e flukseve migratore, por edhe zhvillimin e kushteve që parandalojnë detyrimin e njerëzve për të migruar.

Të drejtat ndërkombëtare të njeriut vendosin përgjegjësi të qarta mbi shtetet për të garantuar një jetë të denjë për qytetarët e tyre, ashtu sikurse Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore thekson se qeveritë duhet të sigurojnë një standard jetese të përshtatshëm, duke përfshirë qasjen në ushqim, strehim dhe punë.¹⁰ Nëse këto kushte nuk janë të përmbushura, atëherë e drejta për të “mos migruar” nuk është thjeshtë një e drejtë, por një privim nga mundësia për të kërkuar një jetë më të mirë.

Përveç faktorëve ekonomikë, shumë qytetarë largohen për shkak të pasigurisë dhe mungesës së stabilitetit politik. Konventa e OKB-së për Refugjatët e vitit 1951 njeh të drejtën e azilit për ata që përballen me persekutim politik, fetar apo etnik.¹¹ Megjithatë, shumica e emigrantëve shqiptarë nuk largohen për arsye persekutimi, por për shkak të mungesës së besimit në sistemin politik dhe ekonomik të vendit. Kjo tregon se për të garantuar të drejtën për të “mos migruar”, është e nevojshme të forcohet qeverisja e mirë, drejtësia dhe mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm.

Në vend që të shihet si një proces i pashmangshëm, migracioni duhet të analizohet në dritën e faktorëve që e detyrojnë. Për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë, shtetet duhet të hartojnë politika që krijojnë mundësi reale për qytetarët e tyre, duke investuar në zhvillimin ekonomik, arsimin dhe shërbimet sociale. Vetëm në këtë mënyrë migrimi mund të mbetet një zgjedhje personale dhe jo një rrugëdalje e domosdoshme për të mbijetuar.

3. Kuadri teorik dhe ligjor i së drejtës për të “mos migruar”

3.1 Të drejtat ndërkombëtare të njeriut

Një nga parimet themelore të të drejtave ndërkombëtare të njeriut është garantimi i një standardi jetese që i mundëson individit një jetë dinjitoze në vendin e tij të origjinës. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut në nenin 25 përcakton se çdo person ka të drejtën për një standard jetese të mjaftueshëm, duke përfshirë ushqimin, veshjen, strehimin dhe kujdesin shëndetësor, si dhe të drejtën për siguri sociale në rastet e papunësisë, sëmundjes ose rrethanave të tjera që e privojnë nga mjetet e jetesës.¹² Kjo dispozitë krijon një bazë të fortë për të mbështetur të drejtën për të “mos migruar”, pasi një individ që përfiton nga këto kushte nuk ka nevojë të largohet për të siguruar mbijetesën e tij. Megjithatë, realiteti është se shumë shtete nuk arrijnë të garantojnë këtë standard, duke e bërë migrimin një domosdoshmëri për ata që kërkojnë kushte më të mira jetese. Në këtë kontekst, përmbushja e këtij neni nuk është vetëm një obligim moral, por edhe një përgjegjësi ligjore për shtetet që kanë ratifikuar traktatet e të drejtave të njeriut.

Një tjetër instrument kyç në mbështetje të së drejtës për të “mos migruar” është Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore¹³ i cili thekson rëndësinë e krijimit të një tregu pune të drejtë dhe gjithëpërfshirës. Nenet 6 dhe 7 të këtij pakti mbrojnë të drejtën për punë të denjë dhe kushte të drejta pune, duke përfshirë pagat e mjaftueshme, sigurinë në punë dhe mundësitë për zhvillim profesional.¹⁴ Nëse një shtet nuk arrin të ofrojë këto kushte, atëherë qytetarët e tij janë të detyruar të kërkojnë këto mundësi diku tjetër, duke nxitur migrimin e detyruar për arsye ekonomike. Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) ka vendosur gjithashtu standarde globale për mbrojtjen e punëtorëve, të cilat synojnë të reduktojnë migrimin e detyruar duke siguruar

⁹ IOM, *Raporti Botëror i Migracionit 2022*, f. 45.

¹⁰ Kombet e Bashkuara, *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike*, neni 11.

¹¹ UNHCR, *Konventa në lidhje me statusin e refugjatëve*, neni 1A, 2.

¹² Kombet e Bashkuara, *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*, neni 25.

¹³ Kombet e Bashkuara, *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike*.

¹⁴ Kombet e Bashkuara, *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike*, neni 6 dhe 7.

mbështetje për sindikatat, rregulla kundër shfrytëzimit të punës dhe politika për barazinë në tregun e punës.¹⁵ Implementimi i këtyre standardeve nga shtetet do të siguronte një mjedis të qëndrueshëm ekonomik dhe social, duke u dhënë qytetarëve mundësinë të qëndrojnë në vendin e tyre pa pasur nevojë të emigrojnë për të siguruar një të ardhme më të mirë.

3.2 Perspektivat rajonale dhe kombëtare ligjore

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian përfshin dispozita që mbrojnë të drejtat e punësimit dhe lirinë e lëvizjes për qytetarët e saj. Në veçanti, neni 15¹⁶ garanton të drejtën e çdo individi për të punuar dhe për të ushtruar një profesion të zgjedhur lirisht në çdo shtet anëtar. Kjo kornizë ligjore synon të sigurojë që migrimi brenda BE-së të jetë rezultat i një zgjedhjeje personale dhe jo i detyrimeve ekonomike apo sociale. Për më tepër, neni 34¹⁷ i Kartës thekson të drejtën për ndihmë sociale dhe strehim, duke synuar të parandalojë kushtet që mund të detyrojnë individët të migrojnë për arsye mbijetese. Këto dispozita krijojnë një standard të përbashkët për shtetet anëtare, duke ndikuar në politikat e tyre të brendshme për të siguruar kushte jetese të denja që reduktojnë nevojën për migrim të detyruar.

Në kontekstin shqiptar, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ofron një bazë ligjore për të drejtat e qytetarëve të saj, duke përfshirë të drejtën për një jetë të denjë brenda vendit. Neni 49¹⁸ garanton të drejtën e zgjedhjes së lirë të profesionit dhe vendit të punës, ndërsa Neni 59¹⁹ përcakton se shteti, brenda mundësive kushtetuese dhe burimeve që disponon, synon një nivel të përshtatshëm jetese për të gjithë qytetarët. Megjithatë, sfidat ekonomike dhe sociale kanë çuar në nivele të larta emigracioni, duke sugjeruar se zbatimi efektiv i këtyre dispozitave mbetet një çështje kyçe. Marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, përfshirë marrëveshjet bilaterale dhe procesin e integritimit, ndikojnë gjithashtu në aftësinë e vendit për të mbajtur popullsinë e tij. Politikat e BE-së, që synojnë zhvillimin ekonomik dhe forcimin e institucioneve, mund të kontribuojnë në krijimin e kushteve që reduktojnë migrimin e detyruar, duke e bërë qëndrimin në vend një zgjedhje tërheqëse për qytetarët shqiptarë.

Studiues të ndryshëm kanë analizuar ndikimin e Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së në politikat e punësimit dhe migracionit. Sipas një studimi të publikuar nga Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, zbatimi efektiv i Kartës ka përmirësuar mbrojtjen e të drejtave sociale dhe ekonomike të qytetarëve, duke reduktuar pabarazitë dhe duke promovuar kushte të drejta pune.²⁰ Ky studim thekson se respektimi i të drejtave të përcaktuara në Kartë është thelbësor për të parandaluar migrimin e detyruar për arsye ekonomike.

Në kontekstin shqiptar, studime të ndryshme kanë adresuar sfidat që lidhen me zbatimin e dispozitave kushtetuese që synojnë garantimin e një niveli të përshtatshëm jetese. Një raport i Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin evidenton se, pavarësisht përpjekjeve legjislative, mungesa e mundësive të punësimit dhe pagave të ulëta vazhdojnë të jenë faktorë kryesorë që shtyjnë qytetarët shqiptarë drejt emigrimit.²¹ Raporti sugjeron se për

¹⁵ Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO). *Zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Punës 2021: Raporti III/Shtojca (Pjesa A), Shtesa në Raportin 2020 të Komitetit të Ekspertëve për Zbatimin e Konventave dhe Rekomandimeve*. Konferenca Ndërkombëtare e Punës, Sesioni i 109-të, 2021, f. 312.

https://www.ilo.org/sites/default/files/wcmsp5/groups/public/@ed_norm/@relconf/documents/meetingdocument/wcms_771042.pdf

¹⁶ Bashkimi Evropian. *Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian*. 2012/C 326/02, 26 tetor 2012, neni 15.

¹⁷ Ibid, neni 34.

¹⁸ Republika e Shqipërisë, *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*. Miratuar më 28 nëntor 1998. Ndryshuar më 13 maj 2020, neni 49.

¹⁹ Ibid, neni 59.

²⁰ Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore. *Manual i së Drejtës Evropiane në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave, 2014 f. 20*

https://idp.al/wp-content/uploads/2024/04/Manual_i_se_Drejtës_Evropiane_ne_Fushen_e_Mbrojtjes_se_te_Dhenave.pdf

²¹ Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), *Manual mbi Krijimin e Politikave Efektive të Migracionit për Motive Punësimi në Vendet e Origjinës e të Destinacionit*, f. 191.

të adresuar këto sfida, është e nevojshme që qeveria shqiptare të forcojë politikat e zhvillimit ekonomik dhe të krijojë mundësi reale punësimi brenda vendit.²²

Marrëveshjet bilaterale ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve anëtare të BE-së luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e flukseve migratore dhe në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë. Këto marrëveshje synojnë të sigurojnë kushte të drejta pune për migrantët shqiptarë dhe të promovojnë kthimin e tyre të qëndrueshëm në atdhe. Megjithatë, për të reduktuar nevojën për migrim të detyruar, është thelbësore që Shqipëria të përmirësojë kushtet socio-ekonomike brenda vendit, duke zbatuar në mënyrë efektive dispozitat kushtetuese dhe duke përfutur nga mbështetja e ofruar nga politikat dhe fondet e BE-së.

4. Faktorët që ndikojnë tek migrimi në Shqipëri

Migrimi i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit ka qenë një fenomen i vazhdueshëm që prej viteve '90. Ky proces ka ndikuar ndjeshëm në dinamikat demografike, ekonomike dhe sociale të vendit. Shqipëria, si një vend me ekonomi në zhvillim, përballet me sfida të shumta që nxisin largimin e qytetarëve të saj, përfshirë mungesën e mundësive për punësim, cilësinë e ulët të shërbimeve publike dhe faktorët politikë. Për më tepër, politikat e Bashkimit Evropian dhe organizatave ndërkombëtare ndikojnë në vendimmarrjen për migrim, duke e bërë këtë fenomen një ndër më të rëndësishmit për t'u analizuar nga perspektiva socio-ekonomike dhe ligjore.

4.1 Faktorët ekonomikë

Një nga arsyet kryesore të emigracionit shqiptar është papunësia e lartë dhe pagat e ulëta. Pavarësisht rritjes ekonomike të raportuar nga institucionet shtetërore, tregu i punës në Shqipëri vazhdon të jetë i pasigurt dhe me pak mundësi për zhvillim profesional. Sipas Institutit të Statistikave të Shqipërisë, norma e papunësisë mbetet e lartë, veçanërisht te të rinjtë, ku përqindja e papunësisë ka tejkaluar 20% në vitin 2022.²³ Kjo situatë detyron shumë të rinj të kërkojnë mundësi punësimi jashtë vendit, kryesisht në vendet e BE-së.

Një tjetër fenomen shqetësues është ikja e trurit (braindrain), që prek kryesisht profesionistët e kualifikuar si mjekët, inxhinierët dhe ekspertët e teknologjisë, etj. Një raport i Organizatës Ndërkombëtare të Punës tregon se mungesa e një tregu pune të qëndrueshëm dhe pagat e ulëta janë faktorët kryesorë që nxisin largimin e profesionistëve nga Shqipëria.²⁴

Një faktor tjetër ekonomik që ndikon në migrimin është mungesa e politikave efektive për zhvillimin ekonomik të brendshëm. Shqipëria vuan nga mungesa e investimeve strategjike, të cilat do të krijonin mundësi të qëndrueshme punësimi. Një raport i Bankës Botërore thekson se për të frenuar emigracionin, qeveria shqiptare duhet të përqendrohet në zhvillimin e sektorëve produktivë dhe të reduktojë varësinë nga remitancat.²⁵

4.2 Faktorët socialë dhe politikë

Një ndër arsyet kryesore që i shtyn qytetarët drejt emigrimit është korrupsioni dhe qeverisja e dobët. Sipas Transparency International, Shqipëria mbetet një nga vendet më të korruptuara në Evropë, me perceptimin publik

<https://albania.iom.int/sites/g/files/tmzbd11401/files/documents/18.%2520Establishing%2520effective%2520labour%2520migration%2520policies%2520in%2520Countries%2520of%2520Origin%2520and%2520Destination.pdf>

²² Ibid.

²³ Institutit i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), *Tregu i Punës 2022* Tiranë: 2022, f. 17, <https://www.instat.gov.al/media/11851/tregu-i-punes-2022.pdf>

²⁴ Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO). *Programi Vendor i Punës së Denjë 2023–26*, Shqipëri. Gjenevë: ILO, 2022. f. 7. <https://www.ilo.org/resource/policy/albania-decent-work-country-programme-2023-26>

²⁵ Grupi i Bankës Botërore. *Kuadri i Partneritetit Vendor për Republikën e Shqipërisë për periudhën VF23–FY27*. Nr Raporti 177135-AL. Uashington, D.C.: Grupi i Bankës Botërore, 2023. f. 47. <https://documents1.worldbank.org/curated/en/099150002222322770/pdf/BOSIB086c3ab510fa0a5380a0666ba92b08.pdf>

për korrupsionin që është në nivele alarmante.²⁶ Mungesa e transparencës në institucionet shtetërore ka krijuar mosbesim te qytetarët, duke i detyruar ata të kërkojnë një jetë më të mirë jashtë vendit.

Një tjetër faktor i rëndësishëm është cilësia e ulët e shërbimeve publike, kryesisht në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe infrastrukturës. Pavarësisht përpjekjeve për reformim, shërbimet publike vazhdojnë të jenë të paefektshme dhe të pamjaftueshme. Për shembull, shumë qytetarë zgjedhin të largohen për të siguruar një arsim më cilësor për fëmijët e tyre ose për të pasur akses në kujdes më të mirë shëndetësor.²⁷

Një tjetër faktor thelbësor është paqëndrueshmëria politike, e cila ndikon në perceptimin e qytetarëve mbi stabilitetin ekonomik dhe social të vendit. Krizat e shpeshta politike, mungesa e reformave të qëndrueshme dhe polarizimi i skajshëm kanë krijuar një klimë pasigurie, duke nxitur largimin masiv të popullsisë.

4.3 Faktorët e jashtëm

Një nga faktorët kryesorë të jashtëm që ndikon në migrimin shqiptar është politika e BE-së mbi migracionin, e cila selekton fuqinë punëtore sipas nevojave të vendeve pritëse. Për shembull, Gjermania ka zbatuar politika që lehtësojnë hyrjen e profesionistëve të kualifikuar shqiptarë në tregun e saj të punës, duke nxitur emigrimin e tyre.²⁸ Një faktor i lidhur me këtë është modeli i azilkërkimit të qytetarëve shqiptarë në vendet e BE-së. Shumë shqiptarë kërkojnë azil politik, megjithatë, shumica e kërkesave refuzohen pasi nuk përmbushin kriteret ligjore për azil. Sipas Agjencisë Evropiane për Azilin, Shqipëria është një nga vendet me numrin më të lartë të aplikimeve për azil në BE, pavarësisht se konsiderohet një vend i sigurt i origjinës.²⁹

Një rol të rëndësishëm në menaxhimin e migracionit luajnë organizatat ndërkombëtare si OKB, OIM dhe ILO, të cilat ndikojnë në hartimin e politikave dhe në menaxhimin e flukseve migratore. Këto organizata synojnë të reduktojnë emigrimin e detyruar dhe të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm në vendet e origjinës.

5. E Drejta për të “Mos Migruar” si detyrim ligjor i shtetit

Migrimi nuk duhet të jetë një domosdoshmëri e imponuar nga faktorë ekonomikë dhe socialë, por një zgjedhje e lirë e individëve. Për këtë arsye, shteti shqiptar ka një detyrim ligjor dhe moral për të krijuar kushte të favorshme që mundësojnë një jetë të denjë për qytetarët e tij. Siç u përmend më sipër, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, përcakton se shteti duhet të garantojë një standard jetese të përshtatshëm për qytetarët, duke përfshirë arsimin, shëndetësinë dhe zhvillimin ekonomik.³⁰ Përveç kësaj, detyrimet e Shqipërisë burojnë edhe nga angazhimet e saj ndërkombëtare, si Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PIDESK), i cili garanton të drejtën për një nivel të përshtatshëm jetese.³¹ Kjo pjesë e punimit do të shqyrtojë masat që qeveria shqiptare mund të ndërmarrë për të reduktuar migrimin e detyruar, si dhe rolin e institucioneve ndërkombëtare dhe përvojat nga vende të tjera në menaxhimin e këtij fenomeni.

5.1 Roli i Qeverisë Shqiptare

²⁶ Transparency International. *Corruption Perceptions Index*, 2022. <https://www.transparency.org/en/countries/albania>

²⁷ Komisioni Evropian. *Raporti i Shqipërisë 2021*. Strasburg: Komisioni Evropian, 2021. f. 47. <https://enlargement.ec.europa.eu/system/files/2021-10/Albania-Report-2021.pdf>.

²⁸ Zyra Federale për Migracionin dhe Refugjatët. *Raporti i Migracionit 2020*. Nuremberg: Zyra Federale për Migracionin dhe Refugjatët, 2020.

https://www.bamf.de/SharedDocs/Anlagen/EN/Forschung/Migrationsberichte/migrationsbericht-2020-zentrale-ergebnisse.pdf?__blob=publicationFile&v=9

²⁹ Rrjeti Evropian i Migracionit. *Raporti i Shqipërisë 2021*. Bruksel: Rrjeti Evropian i Migracionit, 2021. f. 103. <https://enlargement.ec.europa.eu/system/files/2021-10/Albania-Report-2021.pdf>.

³⁰ Republika e Shqipërisë, *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*, neni 59.

³¹ Kombet e Bashkuara, *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike*, neni 11.

Një strategji efektive për mbajtjen e popullsisë në Shqipëri duhet të përfshijë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social. Një nga masat kyçe është krijimi i politikave që stimulojnë punësimin dhe që u ofrojnë qytetarëve një alternativë të qëndrueshme ndaj emigrimit. Për shembull, politikat fiskale që favorizojnë bizneset lokale dhe start-up-et mund të ndihmojnë në rritjen e vendeve të punës dhe në zvogëlimin e nevojës për të emigruar.

Për më tepër, investimet në zhvillimin rural janë të rëndësishme për të zvogëluar zhvendosjen e popullsisë nga zonat e largëta në qendrat urbane ose jashtë vendit. Shtetet që kanë aplikuar strategji të suksesshme në këtë drejtim, si Polonia, kanë parë përmirësime të ndjeshme në mbajtjen e popullsisë së tyre përmes politika të subvencionimit të fermave dhe zhvillimit rural³². Shqipëria mund të mësojë nga këto shembuj duke ofruar lehtësi tatimore për fermerët dhe mbështetje teknike për modernizimin e bujqësisë.

Një tjetër aspekt thelbësor është forcimi i shtetit të së drejtës dhe lufta kundër korrupsionit. Korrupsioni dhe mungesa e besimit tek institucionet janë faktorë që nxisin emigrimin. Raporte të Transparency International tregojnë se vendet me një nivel të lartë korrupsioni kanë gjithashtu një nivel të lartë emigrimi të detyruar.³³ Për këtë arsye, Shqipëria duhet të intensifikojë përpjekjet për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien në sektorin publik. Një strategji e suksesshme do të ishte digjitalizimi i administratës publike dhe forcimi i institucioneve të pavarura që mbikëqyrin qeverisjen. Së fundmi, në Shqipëri ka filluar përdorimi i platformave si e-Albania, si pjesë e rrjetit të digjitalizimit të shërbimeve publike, por një zgjerim i këtyre shërbimeve do të ishte një faktor pozitiv sa i përket efikasitetit të qeverisjes dhe uljes së nivelit të korrupsionit.

Së fundmi, përmirësimi i infrastrukturës publike është një faktor kyç për të ulur presionin e migracionit. Qytetarët shpesh largohen për shkak të mungesës së mundësive për një jetë të denjë brenda vendit. Investimi në transportin publik, rrjetet rrugore dhe energjinë e rinovueshme mund të krijojë një klimë më të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik dhe të rrisë cilësinë e jetesës.

5.2 Roli i institucioneve ndërkombëtare

Institucionet ndërkombëtare, veçanërisht Bashkimi Evropian, kanë një përgjegjësi të madhe për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm në Shqipëri. Politikat e BE-së për zgjerimin përfshijnë mekanizma financimi për vendet kandidatë, por efektiviteti i këtyre politikave varet nga zbatimi i tyre në nivel kombëtar. Programet e financimit të BE-së për punësimin dhe inovacionin mund të ndihmojnë në krijimin e mundësive për të rinjtë shqiptarë dhe të zvogëlojnë shtysat për migrim.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm janë marrëveshjet mbi migracionin. Për shembull, Marrëveshja e Mobilitetit të Punës Shqipëri-Italia ka ndihmuar në sigurimin e punësimit sezonal për shqiptarët, por një qasje më e ekuilibruar duhet të përfshijë stimuj për kthimin dhe riintegrimin e migrantëve në vendin e tyre të origjinës (European Migration Network 2021, 94). BE-ja duhet të mbështesë më shumë programe që sigurojnë jo vetëm mundësi migrimi të rregullt, por edhe politika për mbajtjen e trurit në vendet e origjinës, ashtu sikurse duhet të krijohen politika që bëjnë të mundur krijimin e lehtësive të riintegritit të shqiptarëve që kthehen në vendin e tyre, duke rishikuar detyrimet e tyre ligjore kundrejt shtetit, uljen e mundshme të detyrimeve financiare apo ndihmë specifike që mund tu ofrohet nga shteti kryesisht në fushën e biznesit.

5.3 Analizë krahasuese ligjore

Disa vende kanë zbatuar politika të suksesshme për të reduktuar emigrimin e detyruar. Për shembull, Meksika, e cila ka përjetuar një nivel të lartë emigrimi drejt SHBA-së, ka aplikuar politika të rikthimit dhe reintegritit të migrantëve, duke ofruar lehtësi tatimore për ata që investojnë në bizneset e tyre pas kthimit.³⁴ Kjo mund të shërbejë

³² Banka Botërore. *Raporti Ekonomik i Polonisë 2020*. Uashington, D.C.: Grupi i Bankës Botërore, 2020. <https://documents1.worldbank.org/curated/en/209111528428654498/pdf/125670-REVISED-CPFPLweb.pdf>.

³³ Transparency International. *Corruption Perceptions Index*.

³⁴ Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). *Politikat e Migracionit dhe Zhvillimi në Amerikën Latine*. Paris: Botim i OECD, 2021. f. 286.

si model për Shqipërinë, duke krijuar mekanizma të ngjashëm për ata që dëshirojnë të kthehen dhe të investojnë në vend.

Irlanda ka qenë një shembull i suksesit në menaxhimin e migracionit të kualifikuar. Në vitet 1990, Irlanda po përjetonte një largim të madh të trurit, por përmes politikave të fuqishme për zhvillimin e sektorit të teknologjisë dhe përmirësimin e kushteve të punës, ajo arriti të tërhiqte mbrapsht një pjesë të madhe të emigrantëve të saj.³⁵ Shqipëria mund të ndjekë këtë model duke zhvilluar sektorin e teknologjisë dhe duke krijuar lehtësi për profesionistët e kualifikuar që dëshirojnë të punojnë në vendin e tyre.

Një tjetër shembull vjen nga Gjermania, e cila ka zbatuar politikën e tërheqjes së fuqisë punëtore të kualifikuar nga vendet e Evropës Lindore dhe Ballkanit Perëndimor përmes programit të lehtësimit të vizave për punëtorët e kualifikuar. Për të reduktuar largimin e profesionistëve të saj, Gjermania ka zbatuar politika që ofrojnë incentiva financiare për kthimin e të diplomuarve në vend dhe investime në zhvillimin e kapaciteteve të brendshme akademike dhe profesionale.³⁶ Kjo praktikë mund të shërbejë si model për Shqipërinë, e cila mund të krijojë një mekanizëm që të ofrojë mbështetje për profesionistët që dëshirojnë të rikthehen dhe të kontribuojnë në zhvillimin kombëtar.

Koreja e Jugut është një tjetër shembull i një vendi që ka pësuar një transformim të suksesshëm në trajtimin e emigrimit të trurit. Në vitet 1970 dhe 1980, shumë koreanë emigruan në Shtetet e Bashkuara dhe Evropë për mundësi më të mira ekonomike dhe akademike. Për të tërhequr kthimin e tyre, Koreja e Jugut zbatoi politika të subvencionimit të start-up-ëve teknologjike dhe krijoi parqe industriale të orientuara drejt inovacionit. Për më tepër, qeveria koreane ofroi lehtësime fiskale dhe stimuj të lartë financiarë për ata që ktheheshin për të kontribuar në zhvillimin e vendit.³⁷ Shqipëria mund të ndjekë këtë shembull duke krijuar qendra inovacioni dhe mbështetje financiare për të rinjtë që dëshirojnë të hapin biznese teknologjike në vend.

Portugalia ka zhvilluar një strategji të suksesshme për të përballuar emigracionin e detyruar duke aplikuar politika që stimulojnë kthimin e diasporës dhe integrimin e tyre në tregun e punës. Në vitin 2019, qeveria portugeze prezantoi programin “Regressar”, i cili ofron ndihma financiare, mbështetje në punësim dhe lehtësi tatimore për qytetarët portugezë që dëshirojnë të rikthehen në vend.³⁸ Shqipëria mund të zbatojë një politikë të ngjashme duke krijuar një program kombëtar për mbështetjen e rikthimit të emigrantëve përmes lehtësirave fiskale dhe ndihmës për hapjen e bizneseve.

Një tjetër model i rëndësishëm është ai i Indisë, e cila ka përjetuar një emigrim të madh të fuqisë punëtore të kualifikuar, por ka arritur të tërheqë një pjesë të konsiderueshme të saj përmes politikave për zhvillimin e sektorit të teknologjisë dhe inovacionit. India ka krijuar parqe teknologjike dhe qendra hulumtimi për të mbështetur kthimin e profesionistëve nga diaspora, si dhe ka ofruar skema financimi për startup-et e teknologjisë dhe inxhinierisë.³⁹ Shqipëria mund të ndjekë këtë model duke krijuar zona të lira ekonomike të specializuara për sektorët me vlerë të lartë të shtuar, si teknologjia dhe zhvillimi i softuerëve.

Për të adresuar emigracionin e detyruar dhe për të siguruar mbajtjen e trurit brenda vendit, Shqipëria mund të mësojë nga këto vende duke kombinuar masa fiskale, investime strategjike dhe politika të drejtuara për kthimin e diasporës. Në këtë mënyrë, vendi mund të krijojë një ekosistem të favorshëm për zhvillimin e brendshëm dhe të reduktojë nevojën për emigracion të detyruar

6. Rekomandime politike dhe zgjidhje ligjore

https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2021/10/international-migration-outlook-2021_ea4f9277/29f23e9d-en.pdf

³⁵ Castles, de Haas, Miller. *The Age of Migration: International Population Movements in the Modern World*. f. 208.

³⁶ Zyra Federale për Migracionin dhe Refugjatët. *Raporti i Migracionit 2020*, f.84.

³⁷ Shin, Gi-Wook. *South Korea's Reverse Brain Drain: Policies and Impact*. Stanford: Stanford University Press. 2019, f. 102.

³⁸ Pereira, Rui, and João Azevedo. *Returning Home: Portugal's Policy for Diaspora Reintegration*. Lisbon: Instituto Universitário de Lisboa. 2021, f. 87.

³⁹ Khadria, Binod. *Skilled Migration and Development: India's Growth Model*. Oxford: Oxford University Press, 2018, f. 54.

Migrimi i detyruar për shkak të faktorëve ekonomikë, socialë dhe politikë është një sfidë që kërkon një strategji të gjerë ndërhyrjeje. Për të siguruar të drejtën për të “mos migruar” dhe për të ndërtuar një shoqëri të qëndrueshme, Shqipëria duhet të zbatojë politika që adresojnë jo vetëm shkaqet e brendshme të migracionit, por edhe ndikimet e faktorëve të jashtëm. Ky seksion propozon reforma të ndryshme në ekonomi, forcimin e qeverisjes dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për të ndërtuar një të ardhme më të qëndrueshme për qytetarët shqiptarë.

6.1 Reforma ekonomike dhe sociale

Një nga faktorët kryesorë që nxit emigrimin është mungesa e një tregu pune tërheqës dhe pagave konkurruese. Për të reduktuar këtë tendencë, duhet të zbatohet një strategji gjithëpërfshirëse që përfshin rritjen e pagës minimale në përputhje me koston e jetesës, si dhe garantimin e kontratave të qëndrueshme të punës.⁴⁰ Studimet tregojnë se vendet që kanë lidhur pagën minimale me rritjen ekonomike dhe produktivitetin, siç ka bërë Gjermania, kanë pasur më pak largime të fuqisë punëtore.⁴¹

Një tjetër politikë e rëndësishme është zhvillimi i një ekosistemi mbështetës për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Një raport i OECD thekson se vendet që krijojnë politika për subvencionimin e bizneseve që punësojnë profesionistë vendas arrijnë të ruajnë talentin e tyre.⁴² Shqipëria mund të adoptojë një model të ngjashëm me atë të Estonisë, e cila ka stimuluar sipërmarrjet teknologjike dhe digjitale, duke tërhequr të rinjtë për të qëndruar në vendin e tyre.⁴³

Në nivel më të gjerë, strategjitë ekonomike duhet të përfshijnë zhvillimin e zonave të lira ekonomike, të cilat mund të krijojnë qendra të industrisë prodhuese dhe inovacionit. Për shembull, modeli i Singaporit për zhvillimin e hub-eve teknologjike ka ndihmuar në rritjen e punësimit dhe të ardhurave, duke zvogëluar nevojën për emigrim.⁴⁴ Shqipëria mund të zbatojë këtë model duke krijuar zona industriale me incentiva fiskale për investitorët e huaj dhe vendorë, të cilat do të ofronin punësim të qëndrueshëm dhe do të reduktonin presionin për migracionin ekonomik.

6.2 Forcimi i qeverisjes dhe shërbimeve publike

Përveç faktorëve ekonomikë, forcimi i institucioneve dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve publike janë thelbësore për të frenuar emigracionin. Studimet tregojnë se vendet me sisteme të qeverisjes transparente dhe të përgjegjshme kanë tendencë më të ulëta të emigrimit.⁴⁵ Shqipëria duhet të forcojë institucionet e drejtësisë dhe të rrisë transparencën në sektorin publik, duke ndjekur modelet e vendeve si Finlanda dhe Danimarka, të cilat kanë reduktuar ndjeshëm korrupsionin përmes digjitalizimit të administratës publike dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje.⁴⁶

Një tjetër faktor kyç është përmirësimi i sistemit të arsimit dhe shëndetësisë. Kërkimet tregojnë se mungesa e aksesit në arsim cilësor dhe kujdes shëndetësor të mirëfilltë është një nga arsytet kryesorë të emigrimit të të rinjve dhe profesionistëve.⁴⁷ Shqipëria duhet të investojë në arsimin profesional dhe të lartë, duke krijuar bashkëpunime

⁴⁰ Rodrik, Dani. *Straight Talk on Trade: Ideas for a Sane World Economy*. Princeton: Princeton University Press, 2017, f. 154.

⁴¹ Dustmann, Christian, Uta Schönberg, and Jan Stuhler. “Labor Supply Shocks, Native Wages, and the Adjustment of Local Employment.” *The Quarterly Journal of Economics* 132 (1) 2017, 275–316, f. 315.

⁴² OECD. *Politikat e Migracionit dhe Zhvillimi në Amerikën Latine*, f. 92.

⁴³ Mazzucato, Mariana. *The Entrepreneurial State: Debunking Public vs. Private Sector Myths*. London: Penguin Books, 2018, f. 210.

⁴⁴ Yeung, Henry Wai-Chung. *Strategic Coupling: East Asian Industrial Transformation in the New Global Economy*. Ithaca: Cornell University Press, 2020, f. 188.

⁴⁵ Acemoglu, Daron, and James A. Robinson. *The Narrow Corridor: States, Societies, and the Fate of Liberty*. New York: Penguin Press, 2019, f. 176.

⁴⁶ Rothstein, Bo. *The Quality of Government: Corruption, Social Trust, and Inequality in International Perspective*. Chicago: University of Chicago Press, 2020, f. 135.

⁴⁷ Goldin, Ian. *The Age of Discovery: Navigating the Risks and Rewards of Our New Renaissance*. London: Bloomsbury Publishing, 2018, f. 221.

me universitetet ndërkombëtare për të ofruar diploma të njohura globalisht. Në sektorin e shëndetësisë, qeveria mund të adoptojë modelin kanadez të modernizimit të spitaleve dhe tërheqjes së mjekëve përmes kushteve më të mira të punës dhe pagave konkurruese.⁴⁸

6.3 Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

Shqipëria nuk mund të adresojë emigracionin vetëm me masa të brendshme, bashkëpunimi ndërkombëtar është thelbësor për të krijuar një ekosistem të qëndrueshëm zhvillimi. Një strategji kyç është avokimi për politika të drejta të BE-së mbi migracionin, të cilat të mos e shndërrojnë Shqipërinë në një burim eksklusiv fuqie punëtore për tregun evropian. Aktualisht, politika të tilla si “Blue Card Scheme” e BE-së lehtësojnë punësimin e profesionistëve të kualifikuar nga vendet e Ballkanit Perëndimor, duke krijuar një deficit të madh të trurit në vendet e origjinës.⁴⁹ Shqipëria duhet të kërkojë mekanizma kompensimi nga BE-ja për humbjen e talentëve dhe të avokojë për skema që lehtësojnë rikthimin dhe integrimin e diasporës.

Një tjetër aspekt kyç është fuqizimi i partneriteteve me organizatat ndërkombëtare, të cilat mund të ndihmojnë në zhvillimin e politikave për mbajtjen e fuqisë punëtore të kualifikuar. Për shembull, ILO dhe UNDP kanë zbatuar programe që mbështesin krijimin e mundësive të punësimit në vendet e origjinës, duke zvogëluar presionin për migracionin ekonomik.⁵⁰ Shqipëria mund të forcojë bashkëpunimin me këto organizata për të hartuar politika që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbajnë kapitalin human brenda vendit.

7. Konkluzione

Migrimi është një fenomen i ndërlikuar, i nxitur nga faktorë ekonomikë, socialë dhe politikë, por që nuk duhet të shihet thjesht si një mundësi, por edhe si një domosdoshmëri për ata që nuk arrijnë të sigurojnë një jetë të denjë në vendin e tyre të origjinës. Ky punim ka argumentuar se e drejta për të “mos migruar” është një aspekt thelbësor i të drejtave të njeriut dhe duhet të konsiderohet si pjesë integrale e politikave kombëtare dhe ndërkombëtare mbi migracionin. Ndërsa shumë diskutime mbi migracionin fokusohen në të drejtën për të lëvizur lirshëm, shumë më pak vëmendje i është kushtuar detyrimit të shteteve për të krijuar kushte të tilla që migrimi të jetë një zgjedhje dhe jo një domosdoshmëri.

Nga një këndvështrim ligjor, Shqipëria dhe vende të tjera me nivele të larta emigrimi duhet të rishikojnë kornizat e tyre ligjore dhe të garantojnë të drejtat ekonomike dhe sociale të qytetarëve të tyre. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, së bashku me instrumentet ndërkombëtare si Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PIDESK) dhe Karta e të Drejtave Themelore të BE-së, theksojnë të drejtën për një nivel të mjaftueshëm jetese, por këto dispozita duhet të përkthehen në politika konkrete që e bëjnë qëndrimin në vend një opsion realist dhe tërheqës. Për shembull, vendosja e pagave minimale në nivel dinjitoz, garantimi i kushteve të punës sipas standardeve ndërkombëtare dhe zhvillimi i zonave ekonomike janë disa nga hapat që mund të ndihmojnë në përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Implikimet politike të njohjes së kësaj të drejte janë të rëndësishme jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për vende të tjera me nivele të larta të emigracionit të detyruar. Qeveritë duhet të angazhohen në reforma të thella që përmirësojnë qeverisjen, transparencën dhe zhvillimin ekonomik. Lufta kundër korrupsionit, përmirësimi i infrastrukturës publike dhe krijimi i mundësive të qëndrueshme për të rinjtë janë elementë thelbësorë për të

⁴⁸ Hall, Peter A., and Rosemary C. R. Taylor. *Explaining Institutional Change: Ambiguity, Agency, and Power*. Cambridge: Cambridge University Press, 2019, f. 109.

⁴⁹ Hollifield, James F., Philip L. Martin, and Pia M. Orreniu. *Controlling Immigration: A Global Perspective*. Stanford: Stanford University Press, 2022, f. 245.

⁵⁰ Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO). *Politikat dhe tendencat globale të punësimit: Raporti 2022*. Gjenevë: ILO, 2022. https://www.ilo.org/sites/default/files/wcmsp5/groups/public/@dgreports/@ddg_p/documents/publication/wcms_829943.pdf

adresuar shkaqet rrënjësore të migrimit. Vendet e BE-së dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat përfitojnë nga migrimi i fuqisë punëtore shqiptare, duhet gjithashtu të marrin përgjegjësinë për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë përmes fondeve dhe politikave që reduktojnë nevojën për emigrim.

Një qasje e re ligjore dhe politike duhet të sigurojë që njerëzit të kenë të drejtën për të jetuar në vendin e tyre pa qenë të detyruar të largohen për shkak të kushteve të vështira ekonomike dhe sociale. Politikat kombëtare dhe ndërkombëtare duhet të bashkërendojnë përpjekjet për të krijuar ekosisteme të qëndrueshme të zhvillimit, duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare. Në këtë drejtim, programe si incentivat fiskale për investitorët vendas dhe ata që kthehen, zhvillimi i politikave të mbështetjes së bizneseve të vogla dhe të mesme dhe investimi në arsim dhe trajnim profesional mund të ndihmojnë në ndërtimin e një ekonomie të fortë që redukton presionin për migracion.

Në përfundim, ky punim argumenton se migrimi nuk duhet të jetë një rrugë e detyruar, por një zgjedhje e lirë. Për ta arritur këtë, është e nevojshme një strategji gjithëpërfshirëse, e cila kombinon masa ekonomike, politika sociale dhe reforma ligjore, në mënyrë që Shqipëria të jetë një vend ku qytetarët kanë mundësi të jetojnë dhe të përparojnë pa ndërë nevojën për të emigruar. Rikonceptimi i migracionit jo vetëm si një çështje lëvizjeje, por edhe si një çështje e të drejtave të njeriut, do të mundësojë një politikë më të balancuar dhe të qëndrueshme për të ardhmen.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Acemoglu, Daron, and James A. Robinson. *The Narrow Corridor: States, Societies, and the Fate of Liberty*. New York: Penguin Press, 2019.
2. Castles, Stephen, Hein de Haas, and Mark J. Miller. *The Age of Migration: International Population Movements in the Modern World*. 6th ed. New York: Guilford Press, 2020.
3. Dustmann, Christian, Uta Schönberg, and Jan Stuhler. "Labor Supply Shocks, Native Wages, and the Adjustment of Local Employment." *The Quarterly Journal of Economics* 132, no. 1 (2017): 275–316.
4. Goldin, Ian. *The Age of Discovery: Navigating the Risks and Rewards of Our New Renaissance*. London: Bloomsbury Publishing, 2018.
5. Hall, Peter A., and Rosemary C. R. Taylor. *Explaining Institutional Change: Ambiguity, Agency, and Power*. Cambridge: Cambridge University Press, 2019.
6. Hollifield, James F., Philip L. Martin, and Pia M. Orrenius. *Controlling Immigration: A Global Perspective*. Stanford: Stanford University Press, 2022.
7. Khadria, Binod. *Skilled Migration and Development: India's Growth Model*. Oxford: Oxford University Press, 2018.
8. Mazzucato, Mariana. *The Entrepreneurial State: Debunking Public vs. Private Sector Myths*. London: Penguin Books, 2018.
9. Pereira, Rui, and João Azevedo. *Returning Home: Portugal's Policy for Diaspora Reintegration*. Lisbon: Instituto Universitário de Lisboa, 2021.
10. Rodrik, Dani. *Straight Talk on Trade: Ideas for a Sane World Economy*. Princeton: Princeton University Press, 2017.
11. Rothstein, Bo. *The Quality of Government: Corruption, Social Trust, and Inequality in International Perspective*. Chicago: University of Chicago Press, 2020.
12. Shin, Gi-Wook. *South Korea's Reverse Brain Drain: Policies and Impact*. Stanford: Stanford University Press, 2019.
13. Yeung, Henry Wai-Chung. *Strategic Coupling: East Asian Industrial Transformation in the New Global Economy*. Ithaca: Cornell University Press, 2020.

Legjislacion

1. Bashkimi Evropian. *Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian*. 2012/C 326/02, 26 tetor 2012.
2. Kombet e Bashkuara. *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*. 10 dhjetor 1948.
3. Kombet e Bashkuara. *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike*. 16 dhjetor 1966.
4. Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR). *Konventa në Lidhje me Statusin e Refugjatëve*. 28 korrik 1951. Seria e Traktateve të Kombeve të Bashkuara, vëll. 189, f. 137.
5. Republika e Shqipërisë. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*. Miratuar më 28 nëntor 1998, ndryshuar më 13 maj 2020.

Web faqe

1. Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore. *Manual i së Drejtës Evropiane në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave*. 2014. https://idp.al/wp-content/uploads/2024/04/Manual_i_se_Drejtës_Evropiane_ne_Fushen_e_Mbrojtjes_se_te_Dhenave.pdf.
2. Banka Botërore. *Groundswell Pjesa 2: Veprimi mbi Migrimin e Brendshëm Klimatik*. Uashington, D.C.: Publikimet e Bankës Botërore, 2021. <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/36248>.
3. Banka Botërore. *Raporti Ekonomik i Polonisë 2020*. Uashington, D.C.: Grupi i Bankës Botërore, 2020. <https://documents1.worldbank.org/curated/en/209111528428654498/pdf/125670-REVISED-CPFPLweb.pdf>.
4. Grupi i Bankës Botërore. *Kuadri i Partneritetit Vendor për Republikën e Shqipërisë për periudhën VF23–FY27*. Nr Raporti 177135-AL. Uashington, D.C.: Grupi i Bankës Botërore, 2023. <https://documents1.worldbank.org/curated/en/09915000222322770/pdf/BOSIB086c3ab510fa0a5380a0666ba92b08.pdf>.
5. Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT). *Tregu i Punës 2022*. Tiranë: INSTAT, 2022. <https://www.instat.gov.al/media/11851/tregu-i-punes-2022.pdf>.
6. Komisioni Evropian. *Raporti i Shqipërisë 2021*. Strasburg: Komisioni Evropian, 2021. <https://enlargement.ec.europa.eu/system/files/2021-10/Albania-Report-2021.pdf>.
7. Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO). *Programi Vendor i Punës së Denjë 2023–26, Shqipëri*. Gjenevë: ILO, 2022. <https://www.ilo.org/resource/policy/albania-decent-work-country-programme-2023-26>.
8. Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). *Politikat e Migracionit dhe Zhvillimi në Amerikën Latine*. Paris: Botim i OECD, 2021. https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2021/10/international-migration-outlook-2021_ea4f9277/29f23e9d-en.pdf
9. Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). *Raporti Botëror i Migracionit 2022*. Gjenevë: IOM, 2022. <https://publications.iom.int/system/files/pdf/WMR-2022.pdf>.
10. Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO). *Zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Punës 2021: Raporti III/Shtojca (Pjesa A), Shtesa në Raportin 2020 të Komitetit të Ekspertëve për Zbatimin e Konventave dhe Rekomandimeve*. Konferenca Ndërkombëtare e Punës, Sesioni i 109-të, 2021. https://www.ilo.org/sites/default/files/wcmsp5/groups/public/@ed_norm/@relconf/documents/meetingdocument/wcms_771042.pdf.
11. Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO). *Politikat dhe tendencat globale të punësimit: Raporti 2022*. Gjenevë: ILO, 2022. https://www.ilo.org/sites/default/files/wcmsp5/groups/public/@dgreports/@ddg_p/documents/publication/wcms_829943.pdf.
12. Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). *Manual mbi Krijimin e Politikave Efektive të Migracionit për Motive Punësimi në Vendet e Origjinës e të Destinacionit*. Gjenevë: IOM, 2022. <https://albania.iom.int/sites/g/files/tmzbd11401/files/documents/18.%2520Establishing%2520effective%2520labour%2520migration%2520policies%2520in%2520Countries%2520of%2520Origin%2520and%2520Destination.pdf>.
13. Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). *International Migration Outlook 2021*. Paris: OECD Publishing, 2021.

Emri i Autorit

- https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2021/10/international-migration-outlook-2021_ea4f9277/29f23e9d-en.pdf.
14. Rrjeti Evropian i Migracionit. *Raporti i Shqipërisë 2021*. Bruksel: Rrjeti Evropian i Migracionit, 2021.
<https://enlargement.ec.europa.eu/system/files/2021-10/Albania-Report-2021.pdf>.
15. Transparency International. *Corruption Perceptions Index 2022*. 2022.
<https://www.transparency.org/en/countries/albania>.
16. Zyra Federale për Migracionin dhe Refugjatët. *Raporti i Migracionit 2020*. Nuremberg: Zyra Federale për Migracionin dhe Refugjatët, 2020.
https://www.bamf.de/SharedDocs/Anlagen/EN/Forschung/Migrationsberichte/migrationsbericht-2020-zentrale-ergebnisse.pdf?__blob=publicationFile&v=9.

ORGANIZIMI GJYQËSOR SIPAS TË DREJTËS ZAKONORE NË KRAHINËN E LABËRISË

Doktorant Klei KAÇUPI*
Prof. Asoc.Dr.Engjell LIKMETA **

THE JUDICIAL ORGANIZATION ACCORDING TO CUSTOMARY LAW IN THE REGION OF LABERIA

Abstract

The selected topic of this paper aims to initiate a genuine scholarly debate in the field of legal history, attracting the deserved attention of professionals in the criminal justice system.

This article seeks to examine the organization of the judicial system in the Laberia region according to customary law, shedding light on its structures, functions, and distinctive features.

The authors have endeavored to address several fundamental issues with due seriousness, focusing on questions such as: Was judicial power formally sanctioned in this renowned region of the country? How was the judicial system organized? What were the main decision-making bodies under customary law? What specific characteristics defined this judicial organization model? Can we genuinely speak of an established judicial authority in pre-state Albanian formations? And what is the stance of legal doctrine and scholars on this stage of the development of Albanian legislation and statehood?

Keywords: *Law, Judiciary, Custom, System, Criminal*

1. Hyrje

Pozita gjeografike e krahinës së Labërisë në Shqipërinë jugperëndimore ka njohur si kufij territorial të saj tri urat: atë të Tepelenës, Drashovicës, si dhe urës të Kalasës në afërsi të qytetit të Delvinës.¹

Treva atdhedashëse e Labërisë, si çdo krahinë tjetër e vendit tonë, ka patur variantin e saj të normave kanunore që udhëhiqnin jetën dhe veprimtarinë shoqërore.²Zanafilla për hartimin e Kanunit të Labërisë daton herët.³ Afro një shekull më parë, Profesori dhe etnografi i shquar z. Rrok Zojsi filloi të qëmtojë këto visare të kulturës sonë juridike dhe entitete të çmuara të trashëgimisë popullore.⁴

* Doktorant, Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. E-mail: kacupikle@gmail.com.

** Profesor, Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. E-mail: engjell.likmeta@fdut.edu.al.

¹ Treska, Katrin; Likmeta, Engjëll. *Një vështrim historiko-juridik mbi institutin e familjes sipas së drejtës zakonore – rasti i Kanunit të Labërisë*. Revista “Studime juridike”, numër 1, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2015, f. 61-73.

² Likmeta, Engjëll. Treska, Katrin. *Crimes against person viewed under the light of the Canon of Laberia*, “European Scientific Journal”, May, 2014, edition vol.10, No.14, f.239-248.

³ Elezi, Ismet. *E drejta zakonore e Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë 2002, f. 5-14.

⁴ Basholli, Arbër. Likmeta, Engjëll. *Kundërvajtja, një përjasje midis normave kanunore dhe bashkëkohore - rasti i Kanunit të Labërisë*. Revista “Studime juridike”, numër 2, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2016, f. 21-36.

Kodifikimi i plotë i normave zakonore të kësaj krahine është fryt i punës së palodhur të Profesor Ismet Elezit. Padiskutim, kontributi i tij i vyer duhet përgëzuar dhe vlerësuar ndër breza. Së pari, për ndihmën e dhënë në pasurimin e mendimit juridik shqiptar në fushën e së drejtës penale⁵ dhe të historisë së shtetit dhe të së drejtës.⁶ Fusha e zbatimit të Kanunit të Labërisë ishte e gjerë.⁷ Ajo shtrihej në krahinat e Tepelenës, Kurveleshit, Himarës, si dhe lumit të Vlorës.⁸

E drejta zakonore e shqiptare, falë normave të saj, kishte rregulluar organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor, duke përcaktuar parimet, kompetencat dhe mekanizmat që mundësonin zgjidhjen e konflikteve. Pikërisht ky aspekt synohet të shqyrtohet në këtë punim, duke marrë në analizë mënyrën e funksionimit të dhënies së drejtësisë në krahinën e Labërisë, për të parë dhe nëse ky sistem ka patur ndikim në zhvillimin e mëpasshëm të strukturave të dhënies së drejtësisë në Shqipëri, apo jo.

2. Pushteti gjyqësor sipas Kanunit të Labërisë

Kanuni i Labërisë e parashikonte pushtetin gjyqësor si një ndër mekanizmat vendorë të vetëqeverisjes. Kështu, në nenin 57 të tij përcaktohej se sistemi i gjyqëve të pleqve, krahas Plakut të barkut, Këshillit të pleqve të mëhallës apo të fshatit si dhe Kuvendeve, ishin autoritet e vetme përgjegjëse të sistemit të qeverisjes vendore.⁹ Veprimtaria e institucioneve të qeverisjes vendore dhe jo vetëm e pushtetit gjyqësor mbështetej në normat kanonore por dhe në drejtësinë popullore¹⁰, duke theksuar kështu rëndësinë e parimeve të moralit shoqëror, institutin e ndërmjetësimit dhe rëndësinë e zgjidhjes paqësore të mosmarrëveshjeve. Roli i pushtetit gjyqësor ishte dhënia e drejtësisë si dhe forcimi i unitetit mes familjeve të njësisë administrative.¹¹ Duke kontribuar kështu, në parandalimin hakmarrjeve apo gjakmarrjeve¹² si dhe rritjen e mirëqënies dhe zhvillimit të bashkësisë.¹³

3. Kuvendet sipas të drejtës zakonore të krahinës së Labërisë

Kuvendet ishin organet më të larta të qeverisjes vendore.¹⁴ Ato ishin organe kolegjiale.

⁵ Së dyti, ekzistenca e një lidhje të ndërsjellë me të drejtën zakonore ishte e dukshme në fillimet e mendimit juridik shqiptar në fushën e së drejtës penale. Për më shumë shih: Likmeta, Engjëll. Muçmataj, Ilda, "Reflection on the development of the Albanian doctrine in the criminal law field" in the International Scientific Conference "Criminal law between tradition and challenges of actuality", organized by the Criminal Law Department, Faculty of Law, Tirana University & "La Sapienza" Rome University & Firenze University, 7 December 2017, f. 186-201.

⁶ Likmeta, Engjëll. Treska, Katrin. *Legal thought in the field of the history of state and justice in Albania*, in the International Scientific Conference "Developments and new approaches in public law", 17 November 2017, organized by the Public Law Department, Faculty of Law, Tirana University & Salento University, Italy, f. 424-436.

⁷ Treska, Katrin; Likmeta, Engjëll. *Një vështrim historiko-juridik mbi institutin e familjes sipas së drejtës zakonore – rasti i Kanunit të Labërisë*. Revista "Studime juridike", numër 1, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2015, f. 61-73.

⁸ Po aty.

⁹ Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*. Botimi i parë. Tiranë: Botimet Toena, 2006, f. 53.

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty, f. 67.

¹² *Gjakmarrja është vlerësuar si një rrugë alternative për zgjidhjen e konflikteve penale të shoqërisë. Madje, si e vetmja drejtësi absolute e miratuar nga shoqëria dhe që shprehte në vetvete masën shtrënguese që drejtohej ndaj çdokujt që kishte cenuar jetën apo shëndetin e njeriut*. Treska, Katrin. Kokona, Elira. *Gjakmarrja, një përjasje juridiko-penale*, Konferencë Shkencore Kombëtare "Drejtësia penale shqiptare- Mes vlerave të traditës, meritës së ndryshimeve dhe largëpamësisë së ligjit dhe shoqërisë", të organizuar nga Departamenti i së Drejtës Penale, të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë, Tiranë, 2018, f. 182-200.

¹³ Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*. Botimi i parë. Tiranë: Botimet Toena, 2006, f. 67.

¹⁴ Po aty, f. 58.

Kuvendet kategorizoheshin në tri lloje kryesore sipas të drejtës zakonore të Krahinës së Labërisë.¹⁵ Ato ishin: Kuvendi i fshatit, Kuvendi i Krahinës si dhe Kuvendi ndërkrahinor.¹⁶ Veçori themelore e kuvendeve ishte fakti se këto organizma vendorë kishin karakter të përkohshëm në të tri nivelet e tyre.¹⁷

Pjesëmarrësit e këtyre kuvendeve nuk kishin mandate të përjetëshme.¹⁸ Ato ishin të kufizuara në kohë duke i bërë anëtarët e tyre të zëvendësueshëm.¹⁹ Funkcionet dhe statutet e tyre nuk ishin të trashëgueshëm.²⁰ Juridiksioni i tyre shtrihet për aq sa ishin kufijtë territorialë të njësive administrative vendore.²¹

Në parim, Kuvendet ushtronin veprimtari legjislativë.²² Megjithëse, duhet theksuar se hera-herës ato mund të ushtronin edhe funksione gjyqësore.²³ Kështu, krahas të tjerash, gëzonin tagrin të merrnin vendime, madje, deri për dënime me vdekje për sjellje kriminale të natyrës së rëndë që binin ndesh me doket e ritet e vendit.²⁴ Kështu, Kuvendi i burrave të fshatit kishte të drejtë të vendoste dënim me vdekje për të tilla raste.²⁵

Gjithashtu, Kuvendi i burrave të krahinës kishte të drejtën të vendoste për zgjidhjen e momarrëveshjeve me natyrë civile, familjare, administrative apo penale.²⁶ Ai ishte organ autoritativ i njohur nga ligji për të shqyrtuar dhe vendosur për çështje të tilla si: hasmëritë, konfliktet, vetëgjyqësia²⁷, si dhe për zgjidhjen me drejtësi të mosmarrëveshjeve për titujt e pronësisë etj.²⁸

Kuvendi i burrave ndërkrahinorë kishte të drejtë të merrte në shqyrtim dhe të vendoste drejtësi me qëllim parandalimin e akteve kriminale që mund të cenonin jetën, shëndetin apo rregullin dhe rendin shoqëror në krahinë apo më gjerë.²⁹

Vendimet e të gjithë kuvendeve ishin të formës së prerë. Ato kishin fuqi detyruese.³⁰

Kuvendi jepte dënimin me vdekje për një kategori të caktuar të veprave penale si: tradhtia ndaj atdheut, tradhëtia bashkëshortore, cenimi i jetës së mikut apo personit në mbrojtje etj.³¹ Pra, për krime kundër jetës, moralit, si dhe bashkësisë - formacionit parashtetëror - autori dënohej me vdekje.³² Për më tepër, normat kanunore sanksiononin dënime të rënda nëse kundërshtohej zbatimi i dënimit të dhënë nga kuvendi nga autori apo familjarët e tij.³³ Kështu, dënimet kryesore që mund të jepeshin në këtë rast ishin bojkotimi për një afat të caktuar ose përgjithmonë, dëbimi i përhershëm apo i përkohshëm i tij apo me gjithë familjen, si dhe dënimi me vdekje ndaj tyre.³⁴

¹⁵ Cana, Jaho. *Institucioni i Kuvendit sipas të drejtës zakonore labe*, Disertacion për gradën shkencore “Doktor”, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Historisë, Tiranë, 2012, f. 103.

¹⁶ Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*. Botimi i parë. Tiranë: Botimet Toena, 2006, f. 58.

¹⁷ Po aty, f. 59-61.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty.

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty, f. 58-64.

²² Basholli, Arbër. Likmeta, Engjëll. *Kundërvajtja, një përfaqëse midis normave kanunore dhe bashkëkohore - rasti i Kanunit të Labërisë*. Revista “Studime juridike”, numër 2, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2016, f. 21-36.

²³ Po aty.

²⁴ Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*. Botimi i parë. Tiranë: Botimet Toena, 2006, f. 59.

²⁵ Po aty.

²⁶ Cana, Jaho. *Institucioni i Kuvendit sipas të drejtës zakonore labe*, Disertacion për gradën shkencore “Doktor”, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Historisë, Tiranë, 2012, f. 103.

²⁷ Po aty.

²⁸ Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*. Botimi i parë. Tiranë: Botimet Toena, 2006, f. 60.

²⁹ Po aty, f. 61.

³⁰ Po aty, f. 63.

³¹ Po aty, f. 64.

³² Po aty.

³³ Po aty.

³⁴ Po aty.

Në përfundim, mund të themi se kuvendet përfaqësonin ndër të tjera edhe institucionin më të lartë të drejtësisë zakonore në krahinën e Labërisë. Përmes ushtrimit të funksioneve që iu njiheshin, ato garantonin rendin dhe harmoninë shoqërore në nivel lokal dhe krahinor.

Respektimi i normave kanunore lidhej pandashmërisht me ruajtjen e ekuilibrave shoqërorë të asaj periudhe, ndaj dhe forca detyruese e vendimeve të kuvendeve, ishte në funksion të këtij qëllimi dhe misioni. Ky sistem i ndërtuar për dhënien e drejtësisë, flet shumë për një mekanizëm të mirëorganizuar në funksion të dhënies së drejtësisë zakonore, për të rregulluar jetën e përditshme në komunitet, si dhe veçanërisht ruajtjen e vlerave dhe traditave të trashëguara brez pas brezi.

4. Plaku i barkut

Plaku i barkut ishte një tjetër mikro-organizëm vendor monokratik.³⁵ Në thelb të punës së tij ishte ndërmjetësimi dhe negociimi për të zgjidhur e sheshuar çdo keqkuptim apo shqetësim të lindur mes familjarëve të tij apo parandalimi e shuarja e mosmarrëveshjeve mes tyre.³⁶

Detyra e tij ishte honorifike – pa shpërblim.³⁷ Ai ishte i barabartë në të drejta dhe detyrime sikurse të gjithë anëtarët e tjerë të familjes. Si rregull, një status të tillë shoqëror e gëzonin vetëm njerëzit e shquar për pjekuri, urtësi, dituri si dhe ndershmëri.³⁸ Pikërisht, ata të cilët udhëhiqeshin në jetën e tyre nga rregulli dhe morali i lartë shoqëror. Ai ushtronte detyrën e tij me drejtësi dhe i pavarur duke u barazlanguar nga interesat vetjake apo të kujtdo tjetër.

Plaku i barkut për plotësimin e përgjegjësisë të ngarkuara vepronte nëpërmjet dhënies së këshillave apo vendoste qortimin e familjarëve të tij kur vërente sjellje të gabuara apo të pahijshme të tyre.³⁹

Sa më sipër, lidhur me rolin e plakut të barkut në raport me organizimin gjyqësor të asaj kohe në krahinën e Labërisë, mund të themi se ai ishte figura bazë për ruajtjen e harmonisë në marrëdhëniet familjare e shoqërore, duke u kujdesur për vlerat tradicionale, që në gjenezën e shoqërisë-familjen. Kësisoj, i jepte organizimit gjyqësor të asaj periudhe, një natyrë të decentralizuar, kur kujdesi për zgjidhjen e konflikteve tregohet që brenda bërthamës familjare.

5. Këshilli i pleqve të mëhallës

Këshilli i pleqve të mëhallës ishte një autoritet tjetër vendor.⁴⁰ Ai ishte organ kolegji dhe përbëhej nga pesë deri në shtatë qytetarë të cilët gëzonin cilësi të caktuara.⁴¹ Në parim, mosha nuk ishte një kriter përcaktues. Megjithatë duhet pranuar se, për të qenë pjesë e këtij organi ajo i nevojitej individit krahas moralit të lartë, ditorisë si dhe përvojës jetësore.

Këshilli i pleqve të mëhallës vendoste me drejtësinë për të zgjidhur çdo problematikë që shtruhej për zgjidhje para tij pavarësisht natyrës familjare, civile, ekonomike, shoqërore etj.⁴²

Ai jepte drejtësi në çdo çështje me qëllim parandalimin e vetëgjyqësisë, thellimin e mosmarrëveshjeve si dhe forcimin e marrëdhënieve të vëllazërisë apo mëhallës.⁴³ Ai nuk ishte një organizëm i përhershëm dhe i qëndrueshëm.⁴⁴ Ai ngrihej sa herë e kërkonin nevojat. Dhe, nuk ishte i trashëgueshëm nga njëri brez në tjetrin.⁴⁵

³⁵ Po aty, f. 53.

³⁶ Po aty, f. 54.

³⁷ Po aty.

³⁸ Po aty, f. 53.

³⁹ Po aty, f. 54.

⁴⁰ Basholli, Arbër. Likmeta, Engjëll. *Kundërvajtja, një përjasje midis normave kanunore dhe bashkëkohore - rasti i Kamunit të Labërisë*. Revista “Studime juridike”, numër 2, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2016, f. 21-36.

⁴¹ Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*. Botimi i parë. Tiranë: Botimet Toena, 2006, f. 54.

⁴² Po aty.

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ Po aty.

Sa më sipër, Këshilli i pleqve të mëhallës përfaqësonte një hallkë kyçe në dhënien e drejtësisë zakonore në krahinën e Labërisë, për sa kohë kishte mision dhe funksion parandalimin e konflikteve dhe ruajtjen e marrëdhënieve të paqta në komunitet.

6. Këshilli i pleqve të fshatit

Pleqësia ka patur një rol aktiv në organizimin e jetës publike në Krahinën e Labërisë dhe sidomos në sistemin gjyqësor.⁴⁶

Këshilli i pleqve të fshatit apo Pleqësia siç thirrej ndryshe ishte një tjetër organ kolegjal.⁴⁷ Përbërja e saj ishte në varësi të numrit të banorëve të fshatit. Numri i tyre në çdo rast nuk mund të ishte më shumë se 12 persona.⁴⁸ Norma kanunore të Kanunit të Krahinës së Labërisë parashikonin të drejtën e zëvendësimit të anëtarëve të kësaj trupe përfaqësimi kur ata mund të dorëhiqeshin apo shkarkoheshin për arsye të ndryshme.⁴⁹

Anëtarët e Pleqësisë dallonin në bashkësi vendore për emrin e mirë, dinjitetin dhe cilësitë e larta etiko-morale.⁵⁰ Ata ushtronin detyrat përkohësisht.⁵¹ Dhe në dallim, nga organet e tjera të përmendura më lart, anëtarët e Pleqësisë shpërbleheshin për detyrat e kryera.⁵² Sasia e shpërblimit nuk ishte e caktuar në kanun.⁵³

Ky organ nuk ishte i shtrirë në kohë. Ai ngrihej sa herë paraqiteshin për zgjidhje praktika të caktuara në fushën e drejtësisë, sigurisë, rendit, bujqësisë, ekonomisë etj.⁵⁴

Pleqësia merrej gjithashtu edhe me administrimin e pronave publike si dhe të ardhurave financiare.⁵⁵

Vendimet e Pleqësisë ishin të detyrueshme për t'u zbatuar.⁵⁶ Si pasojë, ato shtrinin ndikimin e tyre ndaj të gjithë pjesëtarëve të komunitetit.⁵⁷ Në rast moszbatimi, masat e marra qëndronin në bojkotin deri në dëbim, dënimin me gjobë apo shpërblimin e dëmit.⁵⁸

Ekzekutimi i vendimeve të Pleqësisë zbatohet nga një trupë e përbërë prej dy apo tri djem – të rinj. Këta të fundit, caktoheshin nga vetë Pleqësia.⁵⁹ Kur hasej në kundërshtimin e gjobës, ajo dyfishohej dhe për zbatimin e saj forcërisht kujdeseshin tashmë ndryshe nga sa më përpara disa të rritur – burra të mëhallës apo fshatit.⁶⁰

Siç shohim, Këshilli i pleqve të fshatit, ishte gjithashtu një nga organet më të rëndësishme të drejtësisë zakonore në krahinën e Labërisë, dhe luante një rol kryesor në administrimin e drejtësisë, ashtu si dhe për normalizimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve shoqërore, si dhe menaxhimin e pronës publike. Rëndësia e tij shihet edhe në mekanizmat që i njihnin normat kanunore për të zbatuar vendimmarrjet e tij, duke u kthyer kështu në një organ me një autoritet të padiskutueshëm gjyqësor në nivel vendor.

⁴⁶ Elezi, Ismet. *E drejta zakonore e Labërisë*, Tiranë: Botimet Toena, 2002, f. 102.

⁴⁷ Basholli, Arbër. Likmeta, Engjëll. *Kundërvajtja, një përfaqje midis normave kanunore dhe bashkëkohore - rasti i Kanunit të Labërisë*. Revista "Studime juridike", numër 2, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2016, f. 21-36.

⁴⁸ Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*. Botimi i parë. Tiranë: Botimet Toena, 2006, f. 55.

⁴⁹ Po aty.

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ Po aty.

⁵² Po aty, f. 56.

⁵³ Po aty.

⁵⁴ Po aty, f. 55-56.

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Basholli, Arbër. Likmeta, Engjëll. *Kundërvajtja, një përfaqje midis normave kanunore dhe bashkëkohore - rasti i Kanunit të Labërisë*. Revista "Studime juridike", numër 2, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2016, f. 21-36.

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*. Botimi i parë. Tiranë: Botimet Toena, 2006, f. 56.

⁵⁹ Po aty, f. 57.

⁶⁰ Po aty.

7. Sistemi i gjyqeve të pleqve

Gjyqi i pleqve ishte një organ i mirëfilltë gjyqësor. Ai merrej vetëm me dhënien e drejtësisë.

Gjyqi i pleqve, si hallka e parë e sistemit gjyqësor, kishte juridiksion të përgjithshëm në të gjithë territorin tokësor të njësisë vendore të vetëqeverisjes.⁶¹ Ai ishte përgjegjës për zgjidhjen e të gjitha çështjeve, pavarësisht natyrës së tyre tregtare, civile, familjare, penale, etj.⁶²

Gjyqi i pleqve ishte një organ kolegjal. Trupa gjyqësore përbëhej nga numër çift i anëtarëve. Në varësi të dëshirës së palëve të interesuara, ajo mund të përbëhej nga dy ose katër gjyqtarë që përfaqësonin secilën prej palëve në gjykim. Pra, emërimi dhe numri i trupës gjyqësore ishte në tagrin e palëve në proces.⁶³

Mosha nuk ishte një kriter skualifikues. Me shumë rëndësi paraqiteshin cilësitë individuale të personit si: integriteti, pastërtia e figurës, aftësitë profesionale, morali, etj.⁶⁴

Gjinia ishte një kriter që përbënte shkak për përjashtim nga trupa gjyqësore.⁶⁵ Kështu, norma kanunore theksonte faktin se, të qenit gjyqtar lidhej ngushtësisht krahas të tjerash me gjininë e individit.⁶⁶ Pra, thënë ndryshe, femrat nuk mund të ishin pjesë e pushtetit gjyqësor.⁶⁷ Ato nuk mund të bënin pjesë në trupat gjyqësore apo të shërbenin në sistemin gjyqësor. Ky ishte një kriter diskriminues dhe përjashtues në të njëjtën kohë.⁶⁸ E drejta zakonore e Krahinës së Labërisë ka karakter konservator i cili reflektohet në sanksionimin e pabarazisë së gruas me burrin në pjesëmarrjen aktive në jetën shoqërore⁶⁹ dhe jo vetëm në nivelin e përfaqësimit në sistemin gjyqësor.⁷⁰

Konflikti i interesit ishte një tjetër kriter skualifikues. Kështu, çdo individ që thirrej për të qenë pjesë e trupës gjyqësore në parim ishte i detyruar të pranonte.⁷¹ Pra, kjo ishte një e drejtë por në të njëjtën kohë dhe një detyrim e garanci.⁷² Kjo pasi, anëtari duhej të deklaronte paraprakisht apo në çdo kohë pamundësinë e ushtrimit të detyrës kur ekzistonin shkaqe të përligjura si: lidhja familjare, miqësitë, armiqësitë e mosmarrëveshjet me të paktën njërin nga palët në gjykim.⁷³

Gjendja shëndetësore dhe rasti fat keq në rrethin familjar të kandidatit për gjyqtar ishin dy momentet e tjera që shërbenin për përjashtim nga trupa gjyqësore.⁷⁴

Sistemi i gjyqeve të pleqve paraqiste rëndësi të madhe për vënien e drejtësisë sipas Kanunit të Labërisë. Dhe kjo evidentohet nga rregullat e kujdesshme që parashikoheshin për të përzgjedhur anëtarët e tij me kujdes, në ruajtje të integritetit dhe besueshmërisë së tyre. Vetëm kështu mund të garantohej besimi i njerëzve për zgjidhjen e konflikteve dhe dhënien e drejtësisë prej këtij organi. Kjo hallkë gjyqësore tradicionale e kohës, tregon për një model të qëndrueshëm dhe funksional të drejtësisë vendore në Labëri.

7.1 Gjyqi i pleqve të mëhallës

⁶¹ Po aty, f. 65.

⁶² Po aty.

⁶³ Po aty.

⁶⁴ Po aty.

⁶⁵ Po aty.

⁶⁶ Po aty.

⁶⁷ Treska, Katrin. Likmeta, Engjëll. *Roli dhe pozita e gruas sipas normave të së drejtës zakonore shqiptare*, Konferencë Shkencore Kombëtare “Të Drejtat e Njeriut dhe Drejtësia Gjimore”, organizuar nga Departamenti i së Drejtës Publike, i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 6 Korrik 2018, f. 1-11.

⁶⁸ Po aty.

⁶⁹ Balla, Alfred, *Female position on the right of Inheritance. A comparative overview between the Canon of Lekë Dukagjini and the Canon of Labëria*, “European Journal of Economics, Law and Social Sciences”, Vol. 4 No. 1 January, Graz-Austria, 2020, f. 76-80.

⁷⁰ Elezi, Ismet. *E drejta zakonore e Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 28.

⁷¹ Po aty, f. 65.

⁷² Likmeta, Engjëll, *Etika Profesionale në Drejtësinë Penale*. Botimi i parë. Tiranë: Botues “ASD-Studio”, 2016, f. 83-207.

⁷³ Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*. Botimi i parë. Tiranë: Botimet Toena, 2006, f. 65.

⁷⁴ Po aty.

Gjyqi i pleqve të mëhallës, si një tjetër organ gjyqësor vendor, shtrinte përgjegjësitë e brenda kufijve të mëhallës – kësaj mikro-organizimi të njësisë së qeverisjes vendore.⁷⁵ Dhe, ai kishte të drejtë për të shqyrtuar dhe zgjidhur çdo çështje të natyrës civile, të të drejtave dhe detyrimeve, marrëdhënieve të pronësisë, familjare apo penale etj.⁷⁶

Gjyqi i pleqve të mëhallës vihej në lëvizje vetëm për mosmarrëveshjet për të cilat nuk ishte gjetur një zgjidhje apo marrë një vendim përfundimtar nga plaku i barkut.⁷⁷ Shpërblimi i dëmit dhe gjoba ishin sanksione për dëmet në fushën civile⁷⁸ apo ato të krimeve kundër pasurisë.⁷⁹

Dënimet që zbatoheshin nga kjo gjykatë e së drejtës zakonore për çështjet penale ishin të ndryshme. Kanuni i Labërisë në varësi të llojit apo natyrës së veprës penale krahas dënimit me gjobë kishte sanksionuar edhe dënime të tjera si veçimi nga komuniteti, dëbimi nga bashkësia, të hipurit në gomar me fytyrë të nxirë, vendosja e pllakës së zezë apo dërrasës së turp, dëmtimi i përhershëm i organeve të fytyrës, djegia e shtëpisë, dënimi me vdekje apo dhënia e një shpërblimi në natyrë për viktimat e veprave penale.⁸⁰

Në këtë rast, gjyqi i pleqve të mëhallës shfaqet si një hallkë ndërmjetëse mes autoritetit familjar dhe sistemit më të gjerë gjyqësor. Në çdo rast, ai ishte një strukturë që synonte zgjidhjen e mosmarrëveshjeve brenda komunitetit përmes dënimeve të ndryshme, nga masat simbolike e deri te ndëshkimet më të ashpra, duke reflektuar një sistem rregullator të bazuar në traditë, moral dhe rend shoqëror.

7.2 Gjyqi i pleqve të fshatit

Gjyqi i pleqve të fshatit merrte jetë si organ gjyqësor vetëm për raste specifike. Ai nuk ishte një organ i qëndrueshëm në kohë.⁸¹ Po ashtu, duhet theksuar se, vetëm për çështje me rëndësi të madhe trupa gjyqësore e tij mund të përbëhëj nga tri anëtar përfaqësues për secilën palë të interesuar.⁸² Si rregull, trupa gjyqësore e pleqve të fshatit përbëhëj nga një apo dy përfaqësues të caktuar nga secila prej palëve në proces.⁸³

Zgjidhja e çështjeve realizohej sipas një rendi të caktuar. Kështu, përparësi në dhënien e drejtësisë kishin mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të pronësisë, mospërmbyshja e detyrimeve civile, mos respektimi dhe zbatimi me përpikëri i kontratave dhe detyrimeve të tjera të marra përsipër, mosmarrëveshjet për pjesëtimin e pasurisë apo të trashëgimisë, si dhe shpërblimi i dëmit në fushën civile etj.⁸⁴

Gjyqi i pleqve të fshatit vendoste drejtësi në fushën familjare lidhur me çështje të zgjidhjes së fejesës, martesës, mosmarrëveshje të prindërve me fëmijët etj.⁸⁵

⁷⁵ Po aty, f. 66.

⁷⁶ Po aty.

⁷⁷ Po aty.

⁷⁸ Po aty.

⁷⁹ Elezi, Ismet. *Mbrojtja juridike penale e pasurisë*. Tiranë: albin, 2002, f. 17-30.

⁸⁰ Likmeta, Engjëll. Kaçupi, Skënder. *Mbrojtja e viktimave të veprave penale sipas të drejtës zakonore shqiptare*, Konferencë Shkencore Kombëtare “Çështje të teorisë dhe praktikës mbi mbrojtjen e të drejtave të viktimave në procesin penal”, organizuar nga Departamenti i së Drejtës Penale, i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 2019, f. 738-757.

⁸¹ Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*. Botimi i parë. Tiranë: Botimet Toena, 2006, f. 66.

⁸² Po aty.

⁸³ Po aty.

⁸⁴ Po aty.

⁸⁵ Po aty.

Në fushën penale në vëmendje të shtuar të gjyqit të pleqve ishin veprat penale kundër shëndetit, moralit dhe dinjitetit njerëzor,⁸⁶ sjelljet kriminale që cenonin pasurinë nga dëmtimet apo shkatërrimet, si dhe aktet kundrejt institucioneve të qeverisjes vendore.⁸⁷

Vendimi gjyqësor si rregull ishte i formës së prerë. Ai mund të prishej dhe mos pranohej nga palët si i njëanshëm vetëm kur ekzistonte dyshimi i aryeshëm apo faktohej se vendimi ishte marrë nën ndikimin e interesave të paligjshme si mitëmarrja aktive apo pasive e anëtarëve të trupës.⁸⁸

Gjyqtarët e përzgjedhur në këtë trupë gjyqësore nuk merrnin shpërblim në të holla.⁸⁹ Ata kishin të drejtën e shpërblimit në natyrë apo të pranonin dhurata që mund t'u jepeshin nga palët në varësi të dëshirës apo aftësisë të tyre ekonomike.⁹⁰

Sa më sipër, gjyqi i pleqve të fshatit përfaqësonte një nivel më të lartë të sistemit gjyqësor zakonor në krahinën e Labërisë, duke u thirrur për çështje me rëndësi të veçantë si në fushën civile, ashtu dhe në atë familjare dhe penale. Baza për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga ana e këtij organi ishin normat kanunore, udhëhequr nga parimet e ndershmërisë dhe moralit. Pavarësisht se vendimet e këtij organi kishin fuqi të formës së prerë, vendimet e tij mund të prisheshin nëse faktohej ndikimi i paligjshëm, duke dhënë kështu një mekanizëm që ruante dhe mbante gjallë besimin e komunitetit në këtë organ.

7.3 Gjyqi i pleqve të krahinës

Gjyqi i pleqve të krahinës së Labërisë ishte hallka e tretë në të cilën ushtrohej pushteti gjyqësor. Ky ishte një forum gjyqësor me vendimmarrje kolegjiale.⁹¹ Ai ishte i përbërë prej dy ose katër gjyqtarëve që përfaqësonin secilën palë në gjykim.⁹²

Sikurse çdo organ tjetër gjyqësor i kësaj periudhe kohore, ai nuk ishte një organizëm që ushtronte veprimtarinë e tij në mënyrë të vijueshme.⁹³ Në përgjithësi, ai mund të ngrihej vetëm për të vendosur me drejtësi në lidhje me mosmarrëveshje thelbësore midis njësive administrative të kësaj krahine.⁹⁴

Në kompetencë të tij ishin zgjidhja e konflikteve penale apo civile. Pra, Gjykata e Krahinës së Labërisë nëse lejohet të shprehemi kështu, si një hallkë e nivelit të tretë, kishte “juridiksion” eksplicit në çështje të tilla si: dhënia e drejtësisë me synim pajtimin e viktimave të krimeve të jetës, shëndetit, apo nderit e moralit me autorët dhe mes familjarëve të tyre, si dhe caktimi i kufijve tokësorë mes njësive të ndryshme të krahinës kur ekzistonin mosmarrëveshje.⁹⁵

Procesi gjyqësor i zhvilluar nuk ishte i hapur për publikun.⁹⁶ Pra, thënë ndryshe, ai ishte një proces i kujdesshëm. Ai nuk ishte i mbyllur për të kufizuar apo cenuar të drejtat dhe liritë e palëve në gjykim por për të mos ekspozuar apo thënë asgjë që mund të shkaktonte shqetësime në shoqëri.

Vendimi i Gjyqit të Pleqve të krahinës ishte i formës së prerë dhe i detyrueshëm për zbatim.⁹⁷

⁸⁶ Kanuni i Labërisë i rezervonte një trajtim të hollësishëm akteve kriminale që cenonin shëndetin, moralin si dhe dinjitetin njerëzor. Megjithëse, ajo që shohim, përmes analizës historike dhe juridike të normave penale të Kanunit të Labërisë, është fakti se ndryshe nga sot, kur të drejtat themelore të njeriut garantohej nga forca shtrënguese shtetërore e ligjit, në atë periudhë kur vepronin normat e së drejtës zakonore, shëndeti, morali dhe vlerat konsideroheshin si çështje private. Për më shumë shih: Likmeta, Engjëll. *Historical overview on offenses against health, morals, & dignity in the Canon of Laberia*, revista shkencore ndërkombëtare “Diskutime”, viti iv. no.16, 2015, f. 153-160.

⁸⁷ Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*. Botimi i parë. Tiranë: Botimet Toena, 2006, f. 67.

⁸⁸ Po aty.

⁸⁹ Po aty, f. 68.

⁹⁰ Po aty.

⁹¹ Po aty.

⁹² Po aty.

⁹³ Po aty.

⁹⁴ Po aty.

⁹⁵ Po aty.

⁹⁶ Po aty.

⁹⁷ Po aty.

Në këtë rast, Gjyqi i pleqve të krahinës shfaqej si instanca më e lartë e pushtetit gjyqësor sipas të drejtës zakonore në krahinën e Labërisë, që zgjidhte konflikte dhe jepte drejtësi për çështje të një rëndësie të veçantë që lidheshin me ruajtjen e marrëdhënieve mes komunitetit dhe mes njësive administrative. Normat kanunore tregojnë për një vëmendje të veçantë në trajtimin e çështjeve nga ky organ, për një proces të kujdesshëm, që synonte shmangien e thellimit të konflikteve, pikërisht për nga rëndësia e çështjeve që trajtonte, çështje këto të lidhura ngushtë me stabilitetin shoqëror dhe harmoninë ndërmjet palëve në zonë.

7.4 Gjyqi i pleqve ndërkrainorë

Gjyqi i pleqve ndërkrainorë ishte një gjykatë e jashtëzakonshme.⁹⁸ Ajo ngrihej vetëm për raste të ngutshme⁹⁹ dhe tepër të rëndësishme.

Objekt i veprimtarisë së kësaj trupe gjyqësore ishin vetëm çështjet e karakterit penal.¹⁰⁰ Më saktësisht, për ato raste që shkaktonin rrethana shumë të vështira për funksionimin normal të jetës shoqërore mes bashkësive të krahinave të ndryshme në formacionet parashtetërore shqiptare.

Kjo gjykatë përbëhej nga një apo dy përfaqësues të njësive vendore të krahinave që ishin në mosmarrëveshje mes tyre.¹⁰¹

Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për të qenë gjyqtar ishin të njëjta me ato të gjykatave pararendëse. Pra, ata qytetarë – meshkuj që njiheshin në publik për cilësitë e tyre të larta morale dhe profesionale. Nga ana tjetër, edhe në këtë gjykatë, femrat nuk gëzonin të drejtën të punonin apo të merrnin pjesë si gjyqtare.

Gjyqi i pleqve ndërkrainorë vendoste drejtësi por nga ana tjetër ai kujdesej për të pajtuar palët në konflikt.¹⁰² Ai kërkonte nga palët dhe jo vetëm, respektimin e marrëveshjeve dhe detyrimeve të arritura falë këtij procesi.¹⁰³

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore mund të bëhej edhe forcërisht kur nuk realizohej në mënyrë vullnetare.¹⁰⁴ Kësisoj, Gjyqi i pleqve ndërkrainorë, si hallka më e lartë për dhënien e drejtësisë zakonore, për raste të jashtëzakonshme, urgjente, të natyrës penale, kishte një mision edhe më të fortë në raport me nevojën për ruajtjen e marrëdhënieve të qeta mes krahinave. Kështu, ky organ shfaqet jo vetëm si një organ që jepte drejtësi, por edhe me një rol pajtues, për sa kohë merrte përsipër çështje të vështira dhe urgjente. Ai ishte edhe garantues për respektimin e marrëveshjeve dhe vendimeve që merreshin. Ekzistenca e një organi të tillë, patjetër që është tregues për një sistem gjyqësor zakonor të avancuar, të ngritur me kujdes dhe me shkallë e të specializuar sipas çështjeve apo natyrës së konflikteve (nëse do të bënim një krahasim me sistemin e sotëm gjyqësor), që ofronte mekanizma rregullatorë për të ruajtur ekuilibrat në shoqërinë e krahinës, edhe pse mbi baza zakonore.

8. Procedura e gjykimit

Gjykatat ishin të barazlanguara nga institucionet e tjera të qeverisjes vendore. Sipas të drejtës zakonore të krahinës së Labërisë por jo vetëm, e gjithë veprimtaria gjyqësore ishte e mbështetur në kanun.¹⁰⁵

Procedura gjyqësore sipas Kanunit të Labërisë, nëse shqyrtohet me kujdes, tregon e përfaqësonte një sistem të mirëorganizuar të drejtësisë zakonore, që në themel të tij kishte parimet e forta të ndershmërisë, paanshmërisë dhe respektimit të traditave e zakoneve. Gjykatat konceptoheshin dhe krijoheshin si të pavarura; vendimet e tyre njiheshin si përfundimtare e të detyrueshme; dhe përmes tyre garantohej zgjidhja efektive e

⁹⁸ Po aty, f.69.

⁹⁹ Po aty.

¹⁰⁰ Po aty.

¹⁰¹ Po aty.

¹⁰² Po aty.

¹⁰³ Po aty.

¹⁰⁴ Po aty.

¹⁰⁵ Po aty, f. 66.

mosmarrëveshjeve. Ky sistem funksionoi për shekuj me radhë si një mekanizëm thelbësor për ruajtjen e rendit dhe stabilitetit shoqëror në krahinën e Labërisë.

Gjyqtarët i nënshtroheshin një procedure solemne – betimi, përpara ushtrimin të detyrës, ku zotoheshin për gjykimin e çështjeve me drejtësi dhe paanësi. Vendimi gjyqësor ishte i bazuar në kanun dhe drejtësinë popullore.¹⁰⁶ Parimet kryesore që udhëhiqnin veprimtarinë e pushtetit gjyqësor ishin ndershmëria, pavarësia, paanshmëria, drejtësia.¹⁰⁷

Juridiksioni i hallkave të pushtetit gjyqësor sikurse kompetenca e tyre ishte e rregulluar nga norma kanunore.¹⁰⁸ Kështu, kompetenca tokësore e gjyqit të pleqve caktohej nga vendi ku akti kriminal ishte kryer apo tentuar të kryhej, apo nga vendi i ardhjes së pasojës së kundërligjshme.¹⁰⁹ Nëse për këto të fundit nuk kishte një dijeni të plotë dhe të qartë, gjyqi i pleqve realizonte gjykimin në vendbanimin ose vendqëndrimin e personit të akuzuar si pjesëmarrës apo autor i veprës penale.¹¹⁰ Ky rregullim i juridiksionit sipas normave kanunore tregonte për një sistem të strukturuar dhe funksional, i cili synonte të garantonte gjykime të drejta dhe të bazuara në parimin e afërsisë me vendin e ngjarjes apo të palëve të përfshira, duke ruajtur kështu autoritetin dhe efektivitetin e drejtësisë zakonore.

Përgjegjësia penale nuk lindte për kryerjen e një krimi për fëmijën e mitur nën 14-15 vjeç. Në vend të tij, akuzohej i ati apo kujdestari i tij.¹¹¹

Gjendja shëndetësore e palëve në proces ose e të pandehurit përbëntë shkak për pezullimin e shtyrjen e afateve të gjykimit.¹¹² Ndërsa, në çështjet penale ndërrimi i jetës së të pandehurit ishte shkak që përligjte pushimin e hetimeve apo mbylljen e vetë procesit gjyqësor.¹¹³

Njëkohësisht, pranimi i fajësisë nëpërmjet pohimit të plotë ose të pjesshëm ndihmonte në dhënien fund të procesit.¹¹⁴ Megjithatë, duhet theksuar se, kur dyshohej për vërtetësinë e pohimit në rastin e pranimit të fajësisë, kërkimi dhe mbledhja e provave të reja nga vetë gjykata ishte një kusht *sin e qua non* për legjitimitetin e procesit të gjykimit.¹¹⁵ Ky parim procedural hedh dritë mbi rëndësinë që i jepej nevojës për të kryer verifikimin e fakteve dhe tregon se normat kanunore ofronin një mekanizëm për të garantuar drejtësi të vërtetë dhe jo thjesht një pranim formal të fajësisë, duke synuar njëkohësisht dhe shmangien e gjykimeve të padrejta.

Barra e provës i takonte të dëmtuarit apo personit të ngarkuar për të drejtuar hetimet me qëllim zbulimin e së vërtetës.¹¹⁶

Beja ishte një mjet që që shërbente për zbulimin dhe hetimin e autorëve të veprave penale.¹¹⁷

Dëshmitari luante një rol të madh në dhënien e drejtësisë penale sipas normave të së drejtës zakonore procedurale penale.¹¹⁸ Dëshmia e tij administrohej dhe vlerësohej nga gjykata së bashku me provat e tjera.¹¹⁹ Dëshmitar mund të ishin vetëm meshkuj e rritur dhe të përgjegjshëm mendërisht. Gruaja dhe fëmijët bënin pjesë në kategorinë e personave që nuk mund të thirreshin si dëshmitarë në proceset gjyqësore, qofshin këta civile apo penale.¹²⁰ Në

¹⁰⁶ Po aty.

¹⁰⁷ Po aty, f. 253.

¹⁰⁸ Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*. Botimi i parë. Tiranë: Botimet Toena, 2006, f. 253.

¹⁰⁹ Po aty.

¹¹⁰ Po aty.

¹¹¹ Po aty, f. 254.

¹¹² Po aty.

¹¹³ Po aty.

¹¹⁴ Po aty.

¹¹⁵ Po aty.

¹¹⁶ Po aty.

¹¹⁷ Po aty, f. 255.

¹¹⁸ Likmeta, Engjëll. Kaçupi, Skënder. *Dëshmitari në procesin penal*, Konferencë Shkencore Kombëtare “Drejtësia penale shqiptare- Mes vlerave të traditës, meritës së ndryshimeve dhe largëpamësisë së ligjit dhe shoqërisë”, të organizuar nga Departamenti i së Drejtës Penale, të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë, më 7 Dhjetor 2018, f. 445-465.

¹¹⁹ Elezi, Ferdinand. *Provat penale dhe procesi i të provuarit*, Disertacion për gradën shkencore “Doktor”, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Departamenti i së Drejtës Penale, Tiranë, 2012, f. 5.

¹²⁰ Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*. Botimi i parë. Tiranë: Botimet Toena, 2006, f. 259.

cilësinë e dëshmitarit gjykata thërriste çdo person që paraqitej vetë për të treguar opsionin e tij mbi ngjarjen apo ata të cilët i ajo i vlerësonte si të tillë.¹²¹ Detyra e dëshmitarit ishte të tregonte të vërtetën pa shtuar apo mohuar diçka.¹²² Dëshmitarët mund të thërriteshin edhe nga palët në proces, viktimë e dëmtuar, si dhe nga personi i akuzuar.¹²³

Dëshimtari kishte një rol qendror në procesin gjyqësor sipas së drejtës zakonore. Nga ana tjetër, tregon edhe për një sistem që po kaq rëndësi i jepte edhe provave verbale dhe besueshmërisë së njerëzve të zgjedhur për të dëshmuar. Por edhe në këtë rast, reflektohet qasja konservatore e shoqërisë së kohës, që përjashtonte gratë e fëmijët nga procesi gjyqësor, duke pasqyruar ndarjen e detyrave në shoqërinë e asaj kohe.

Gjykata vihej në lëvizje në rradhë të parë me kërkesë të palëve në mosmarrëveshje, të dëmtuarit akuzues, si dhe kryesisht me vetë - inisiativë.¹²⁴ Ajo ishte përgjegjëse për vlerësimin e provave.¹²⁵

Tradita procedurale e gjykimit¹²⁶ ishte e tipit akuzator, nuk mbështetej kryesisht në parimin e taksativitetit të provave sikurse dhe sot.¹²⁷ Procesi ishte publik dhe verbal. Fillimisht, gjykata dëgjonte viktimën akuzuese, më pas personin e dyshuar si autor i veprës penale. Parimi i ndalimit të gjykimit dy herë për të njëjtën veprë penale pranohej gjerësisht në procedurë. Në përgjithësi, nuk njihej e zbatohej instituti i ankimit ndaj vendimit të pleqësisë si dhe mbi provat indirekte, dëshminë indirekte dhe vlerësimin e saj.¹²⁸

Gjyqtarët e të gjithë hallkave të sistemit gjyqësor zgjidheshin me miratimin dhe pëlqimin paraprak të të vetë personave në konflikt.¹²⁹ Paraprakisht, ata kishin detyrim për t'iu shprehur lidhur me dakordësinë e miratimit të tyre si dhe vendimit që ato do të merrnin.¹³⁰ Ata mund të hiqnin dorë nga gjykimi kur nuk ishin në sintoni të plotë me njëri-tjetrin lidhur me vendimin e gjykimit. Në këtë rast, kanuni kishte parashikuar zëvendësimin e tyre.¹³¹ Gjyqtarët nuk shpërbleheshin si rregull për punën e bërë. Megjithëse, praktika kishte treguar se pala fituese gjithnjë jepte një shpërblim sipas dëshirës dhe mundësive ekonomike.¹³²

Gjinia ishte kriter për të qënurit gjyqtar. Gratë nuk mund të ishin gjyqtare.¹³³ Por ky fakt përputhej plotësisht me rolin që kishte gruaja shqiptare në atë periudhë.

Vendimet merreshin në fshehtësi.¹³⁴ Ato u njoftoheshin palëve të interesuara me gojë.¹³⁵ Pra, forma e vendimit gjyqësor ishte verbale.¹³⁶ Sipas të drejtës zakonore të Krahinës së Labërisë, procedura e shpalljes së vendimit me gojë realizohej nga një përfaqësues i moshuar që caktohej nga trupa gjyqësore.¹³⁷

¹²¹ Po aty, f. 258.

¹²² Po aty.

¹²³ Po aty.

¹²⁴ Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*. Botimi i parë. Tiranë: Botimet Toena, 2006, f. 260.

¹²⁵ Po aty.

¹²⁶ Kombet e Bashkuara. *Udhëzues për zbatimin e metodave të posaçme hetimore. Korniza ligjore, praktika dhe sfidat në Republikën e Shqipërisë*. Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin, 2024, f. 1-54.

¹²⁷ Po aty.

¹²⁸ Elezi, Ferdinand. "Provat penale dhe procesi i të provuarit", Disertacion për gradën shkencore "Doktor", Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Departamenti i së Drejtës Penale, Tiranë, 2013, f. 32. Për më shumë shih: <https://unitir.edu.al/doktoratura-ferdiinand-elezi-fakulteti-i-drejtësisë-departamenti-i-te-drejtës-penale/>, marrë online, datë 23.2.2024.

¹²⁹ Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*. Botimi i parë. Tiranë: Botimet Toena, 2006, f. 260.

¹³⁰ Po aty.

¹³¹ Po aty, f. 261.

¹³² Po aty.

¹³³ Po aty, f. 260.

¹³⁴ Po aty, f. 103.

¹³⁵ Po aty.

¹³⁶ Po aty, f. 263.

¹³⁷ Po aty.

Masa këshillimore, qortuese dhe ndëshkuese ishin sanksionet që mund të merreshin nga organet gjyqësore.¹³⁸ Ato ishin më së shumti të karakterit administrativ, civil si dhe penal në varësi të mosmarrëveshjeve të lindura.¹³⁹ Masat shtrënguese si: kërkimi i faljes, gjoja apo detyrimi për shpërblimin e dëmit, dëbimi, shmangia nga jeta e komunitetit, veçimi apo dënimi me vdekje ishin të sanksionuara në të drejtën zakonore të Labërisë si dhe kanunet e tjera shqiptare.¹⁴⁰

Gjykatat shqiptare sipas të drejtës zakonore ishin trupa *ad hoc* të ngritura me pëlqimin dhe miratimin e palëve të interesuara për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.¹⁴¹

Kryesisht, në proceset civile palët linin peng sasi të mallrave apo të të hollave me vlerë sa dyfishi i sendit objekt shqyrtimi gjyqësor.¹⁴² Praktikë kjo që ndiqej për të bërë të mundur ekzekutimin vullnetar të vendimit gjyqësor.¹⁴³ Vendimi i dënimit me vdekje ekzekutohej nga përfaqësues të të gjithë familjeve të komunitet në përpjestim të drejtë me numrin e tyre. Kjo përfaqësi e barabartë në ekzekutim kishte për qëllim shmangien e pasojave të dëmshme mes anëtarëve të shoqërisë.¹⁴⁴ Ekzekutimi i vendimit me dëmtim të përhershëm të gjymtyrëve kryhej nga viktimat apo familjarët e tij për vepra penale kundër personit apo moralit dhe dinjitetit.¹⁴⁵ Ekzekutimi i dënimeve të tjera si: dëbim, bojkot, djetë, si dhe djegie shtëpie bëhej nga i gjithë komuniteti me pjesëmarrjen e organeve gjyqësore si dhe atyre të tjera të njësisë administrative vendore.¹⁴⁶

Normat kanunore reflektojnë mekanizma për zbatimin e vendimeve, duke u mbështetur në shtrëngimin e komunitetit. Pengu nga njëra anë në proceset civile garantonte përmbushjen e detyrimeve, ndërsa përfshirja kolektive në ekzekutimin e dënimeve penale synonte të shmangte hakmarrjen dhe konfliktet e mëvonshme, duke ruajtur ekuilibrin në marrëdhëniet mes anëtarëve të komunitetit.

9. Konkluzione

E drejta zakonore shqiptare, si një element i veçantë i kulturës juridike shqiptare,¹⁴⁷ ka shërbyer për një kohë të gjatë si rregullatori themelor i jetës shoqërore në vend.¹⁴⁸ Institutet kryesore të së drejtës kanë qënë të parashikuara në të.¹⁴⁹

Kanuni i Labërisë, krahas ngritjes së akuzës, i njihte viktimës apo familjarëve të tij të drejtën për të kërkuar kthimin e pasurisë apo shpërblimin e dëmit civil nga autori i veprës penale. Sistemi gjyqësor njihte dhe zbatonte institutin e pajtimit.¹⁵⁰ Ai ishte një tjetër mekanizëm me vlera të mëdha shoqërore që zbatoheshin nga gjykatat e të gjitha niveleve në krahinën e Labërisë.¹⁵¹ Tipar dallues i këtij instituti ishte efekti pozitiv në parandalimin e sjelljeve të gabuara apo kriminale.¹⁵² Ky institut i së drejtës zakonore luante një rol të rëndësishëm në funksion të forcimit të marrëdhënieve shoqërore si dhe zhvillimit normal të jetës në këtë

¹³⁸ Elezi, Ismet. *E drejta zakonore e Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 103.

¹³⁹ Po aty, f. 104.

¹⁴⁰ Elezi, Ismet. *Zhvillimi historik i legjisllacionit penal në Shqipëri*, albin, Tiranë, 1997, f. 19-30.

¹⁴¹ Elezi, Ismet. *E drejta zakonore e Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 197.

¹⁴² Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*. Botimi i parë. Tiranë: Botimet Toena, 2006, f. 261.

¹⁴³ Po aty, f. 261.

¹⁴⁴ Po aty, f. 263.

¹⁴⁵ Po aty.

¹⁴⁶ Po aty.

¹⁴⁷ Sinani, Shaban. *Canon, "a closed world"*, Gazeta Telegraf. Për më shumë shih: <https://telegrafi.com/en/today-the-canon-is-a-closed-world/> marrë online date 27.02.2025.

¹⁴⁸ Treska, Katrin. Likmeta, Engjëll. *Roli dhe pozita e gruas sipas normave të së drejtës zakonore shqiptare*, Konferencë Shkencore Kombëtare "Të Drejtat e Njeriut dhe Drejtësia Gjimore", organizuar nga Departamenti i së Drejtës Publike, i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 6 Korrik 2018, f. 1-11.

¹⁴⁹ Po aty.

¹⁵⁰ Likmeta, Engjëll. Treska, Katrin. *Crimes against person viewed under the light of the Canon of Laberia*, "European Scientific Journal", May, 2014, edition vol.10, No.14, f. 239-248.

¹⁵¹ Po aty.

¹⁵² Po aty.

trevë dhe jo vetëm.¹⁵³ Efektet parandaluese të këtij instituti ishin të qarta.¹⁵⁴ Madje, në këtë kuptim, ai zbatohet edhe në kushte të veçanta si në rastin e fatkeqësive të natyrës, po ashtu edhe në kohë lufte.¹⁵⁵

Kanuni i Krahinës së Labërisë i njihte prerazi Këshillat e Pleqve si institucione të vetëqeverisjes vendore të cilat kishin edhe profil gjyqësor. Ato kualifikoheshin në dy lloje kryesore: Këshilli i Pleqve të mëhallës dhe Këshilli i Pleqve të fshatit.¹⁵⁶

Sistemi i drejtësisë dhe pushteti gjyqësor nuk mund të ishin “domen” i gruas.¹⁵⁷ Ajo nuk mund të të ushtronte detyra publike e aq më pak funksione gjyqësore.¹⁵⁸ Një fushë e tillë ishte një “mollë e ndaluar” për të.¹⁵⁹ Kjo “arenë” mbetej ekskluzivitet vetëm i të rriturve madhorë, që, padyshim, krahas së gjithash duhet të përmbushnin kriteret e duhura si: morali i lartë, urtësia dhe dituria, cilësi këto që për botëkuptimin e asaj bashkësie ishin të pa imagjinueshme që t’i kishte një grua.¹⁶⁰

Kanuni i Labërisë, ashtu si e drejta zakonore në përgjithësi në vendin tonë, ka patur një rol të qenësishëm në rregullimin e jetës shoqërore, ashtu siç ka rregulluar edhe funksionimin e sistemit gjyqësor në nivel krahinor. Sipas Kanunit të Labërisë, organizimi gjyqësor kishte në themel të tij parime që lidheshin me normat që grantonin normalitetin e marrëdhënieve në komunitet.

Sistemi gjyqësor sipas së drejtës zakonore praktikisht ishte i decentralizuar dhe nën ndikimin e normave morale që ndiqte shoqëria e asaj kohe. Por në tërësi, Kanuni i Labërisë është dëshmi e një sistemi vetëqeverisës të organizuar të popullsisë së asaj krahine, që pavarësisht kufizimeve, apo jo pak herë dhe ashpërsisë së tij, garantoi rend dhe drejtësi në komunitet.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Balla, Alfred. *Female position on the right of Inheritance. A comparative overview between the Canon of Lekë Dukagjini and the Canon of Labëria*, “European Journal of Economics, Law and Social Sciences”, Vol. 4 No. 1, January, Graz-Austria, 2020.
2. Basholli, Arbër. Likmeta, Engjëll. *Kundërvajtja, një përjasje midis normave kanunore dhe bashkëkohore - rasti i Kanunit të Labërisë*, Revista “Studime juridike”, numër 2, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2016.
3. Cana, Jaho. *Institucioni i Kuvendit sipas të drejtës zakonore labe*, Disertacion për gradën shkencore “Doktor”, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Historisë, Tiranë, 2012.
4. Elezi, Ferdinand. *Provat penale dhe procesi i të provuarit*, Disertacion për gradën shkencore “Doktor”, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Departamenti i së Drejtës Penale, Tiranë, 2012.
5. Elezi, Ismet. *Kanuni i Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë 2006.
6. Elezi, Ismet. *E drejta zakonore e Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë 2002.
7. Elezi, Ismet. *Mbrojtja juridike penale e pasurisë*. Tiranë: albin, 2002.
8. Elezi, Ismet. *Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri*, albin, Tiranë, 1997.
9. Likmeta, Engjëll. *Etika Profesionale në Drejtësinë Penale*. Botimi i parë. Tiranë: Botues “ASD-Studio”, 2016.

¹⁵³ Po aty.

¹⁵⁴ Po aty.

¹⁵⁵ Po aty.

¹⁵⁶ Basholli, Arbër. Likmeta, Engjëll. *Kundërvajtja, një përjasje midis normave kanunore dhe bashkëkohore - rasti i Kanunit të Labërisë*. Revista “Studime juridike”, numër 2, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2016, f. 21-36.

¹⁵⁷ Treska, Katrin. Likmeta, Engjëll. *Roli dhe pozita e gruas sipas normave të së drejtës zakonore shqiptare*, Konferencë Shkencore Kombëtare “Të Drejtat e Njeriut dhe Drejtësia Gjimore”, organizuar nga Departamenti i së Drejtës Publike, i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 6 Korrik 2018, f. 1-11.

¹⁵⁸ Po aty.

¹⁵⁹ Po aty.

¹⁶⁰ Po aty.

Emri i Autorit

10. Likmeta, Engjëll. *Historical overview on offenses against health, morals, & dignity in the Canon of Laberia*, revista shkencore ndërkombëtare “Diskutime”, viti iv. no.16, 2015.
11. Likmeta, Engjëll. Muçmataj, Ilda, “Reflection on the development of the Albanian doctrine in the criminal law field” in the International Scientific Conference “Criminal law between tradition and challenges of actuality”, organized by the Criminal Law Department, Faculty of Law, Tirana University & “La Sapienza” Rome University & Firenze University, 7 December 2017.
12. Likmeta, Engjëll. Kaçupi, Skënder. *Mbrojtja e viktimave të veprave penale sipas të drejtës zakonore shqiptare*, Konferencë Shkencore Kombëtare “Çështje të teorisë dhe praktikës mbi mbrojtjen e të drejtave të viktimave në procesin penal”, organizuar nga Departamenti i së Drejtës Penale, i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 2019.
13. Likmeta, Engjëll. Treska, Katrin. *Crimes against person viewed under the light of the Canon of Laberia*, “European Scientific Journal”, May, 2014, edition vol.10, No.14.
14. Likmeta, Engjëll. Treska, Katrin. *Legal thought in the field of the history of state and justice in Albania* in the International Scientific Conference “Developments and new approaches in public law”, organized by the Public Law Department, Faculty of Law, Tirana University & Salento University, Italy, 17 November 2017.
15. Likmeta, Engjëll. Kaçupi, Skënder. *Dëshmitari në procesin penal*, Konferencë Shkencore Kombëtare “Drejtësia penale shqiptare- Mes vlerave të traditës, meritës së ndryshimeve dhe largëpamësisë së ligjit dhe shoqërisë”, të organizuar nga Departamenti i së Drejtës Penale, të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë, më 7 Dhjetor 2018.
16. Treska, Katrin. Likmeta, Engjëll. *Roli dhe pozita e gruas sipas normave të së drejtës zakonore shqiptare*, Konferencë Shkencore Kombëtare “Të Drejtat e Njeriut dhe Drejtësia Gjimore”, organizuar nga Departamenti i së Drejtës Publike, i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 6 Korrik 2018.
17. Treska, Katrin. Likmeta, Engjëll. *Një vështrim historiko-juridik mbi institutin e familjes sipas së drejtës zakonore – rasti i Kanunit të Labërisë*. Revista “Studime juridike”, numër 1, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 2015.
18. Treska, Katrin. Kokona, Elira. *Gjakmarrja, një përqsje juridiko-penale*, Konferencë Shkencore Kombëtare “Drejtësia penale shqiptare- Mes vlerave të traditës, meritës së ndryshimeve dhe largëpamësisë së ligjit dhe shoqërisë”, të organizuar nga Departamenti i së Drejtës Penale, të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë, Tiranë, 2018.
19. Sinani, Shaban, *Canon, "a closed world"*, Gazeta Telegraf. Për më shumë shih: <https://telegrafi.com/en/today-the-canon-is-a-closed-world/> marrë online date 27.02.2025.

SFIDAT E BIZNESEVE SHQIPTARE NË KONTEKSTIN E NDRYSHIMEVE TË LEGJISLACIONIT TATIMOR DHE STRATEGJITË PËR PËRSHTATJE

Doktorante. Klaudia REKA*
Dr.Enkeleida SHYLE(PETANAJ)**

CHALLENGES OF ALBANIAN BUSINESSES IN THE CONTEXT OF CHANGES TO THE TAX LEGISLATION AND STRATEGIES FOR ADAPTATION

Abstract

The new tax law in Albania has brought about significant changes in the way businesses operate and meet their fiscal obligations. These reforms aim to align the tax system with European Union standards, increasing transparency and improving the collection of public revenues. However, their impact has been different in different business categories, creating both benefits and challenges for Albanian enterprises. This essay will analyze the main effects of the new tax law, focusing on the concrete changes in the legal framework, the decision of the Constitutional Court to repeal several articles of Law No. 29/2023, "On Income Tax" and its impact on small and medium-sized businesses, on fiscal transparency and the overall investment climate in the country, and on the strategies that businesses are pursuing to adapt to the new business environment.

Keywords: *New Tax Law, fiscal reforms, constitutional changes, business challenges, strategies for adaptation*

1. Hyrje

Paul Krugman¹, fitues i Çmimit Nobel në Ekonomi, ka një pikëpamje të qartë dhe të argumentuar rreth politikave tatimore dhe ndikimit të tyre në ekonomi duke mbështetur idenë që sistemet tatimore duhet të jenë progresive, që do të thotë se ata që kanë më shumë të ardhura duhet të paguajnë një pjesë më të madhe të të ardhurave të tyre në formën e taksave. Ai argumenton se kjo ndihmon në reduktimin e pabarazisë ekonomike dhe krijon mundësi më të barabarta për të gjithë. Ndryshimet politike, ekonomike dhe fiskale që ndodhën në vendin tonë në fund të viteve 90', krijuan nevojën e rishikimit total të politikave dhe praktikave në fushën e buxhetit. Në këtë kuadër, si pjesë e rëndësishme e buxhetit të shtetit, kërkohej një përmbyse e madhe në praktikën legjislative dhe administrimin praktik të të ardhurave të këtij buxheti, ku pjesën kryesore do ta zinin tatimet dhe taksat, pra kërkohej zbatimi i një politike të re fiskale, krejt ndryshe nga ajo që ishte zbatuar deri në atë periudhë.² Sistemi tatimor shqiptar ka kaluar nëpër disa faza të rëndësishme që reflektojnë zhvillimet politike, ekonomike dhe sociale

* Lektore, Departamenti i të Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, *email:klaudia.reka@fdut.edu.al*.

** Lektore, Departamenti i të Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, *email:enkeleida.petanaj@fdut.edu.al*.

¹ Paul Krugman është një ekonomist amerikan, shkrimtar, dhe fitues i Çmimit Nobel në Ekonomikë në vitin 2008. Ai është i njohur për punën e tij në teorinë e tregtisë ndërkombëtare, ekonominë makroekonomike, dhe politikën fiskale. Është një kolumnist i njohur në "The New York Times", ku shkruan rreth temave të ekonomisë, politikës dhe çështjeve shoqërore. Është autor: Ai ka shkruar shumë libra dhe artikuj, duke i bërë ato të njohura për publikun e gjerë. Disa nga librat e tij më të njohur përfshijnë "The Return of Depression Economics" dhe "End This Depression Now!"

² Angjeli, Anisa, "Tatimet proporcionale apo progresive në Shqipëri", Studime Juridike 1, viti 2011, f. 148

të vendit. Gjatë periudhës socialiste, Shqipëria kishte një sistem të centralizuar tatimor, ku të gjitha bizneset dhe individët paguanin taksa të ulta. Taksat ishin të kthyera në financimin e shërbimeve publike dhe zhvillimit ekonomik, por ishin gjithashtu të ngurta dhe të kontrolluara nga shteti. Pas rënies së regjimit socialist, Shqipëria filloi të implementojë reforma të rëndësishme ekonomike dhe tatimore. Në vitin 1993, u miratua një ligj i ri për tatimin mbi të ardhurat, duke përfshirë një sistem tatimor më të ndarë për bizneset dhe individët. Në vitin 1995, Shqipëria miratoi TVSH-në, duke e bërë atë një nga komponentët kryesorë të sistemit tatimor duke mundësuar në këtë mënyrë dhe përpjekjet e para serioze për modernizimin e legjislacionit dhe sistemit tatimor Shqiptar. Përgjatë viteve 2000- 2010 vëmë re një përmirësim të administratës tatimore dhe rritjen e kapaciteteve për mbledhjen e tatimeve.

U krijuan reforma për modernizimin e sistemit tatimor dhe për rritjen e transparencës, ndërkohë, u vendosën norma të reja tatimore për të rritur të ardhurat e buxhetit, përfshirë rritjen e tarifave për TVSH-në dhe tatimet mbi të ardhurat. Njëkohësisht një rëndësi e veçantë iu kushtua punës për edukimin e tatimpaguesve, rritjes së frymës së bashkëpunimit me tatimpaguesit, duke i konsideruar ata si partnerë. Në vitin 2013, Shqipëria miratoi ligjin nr. 29/2013, i cili rregulloi sistemin tatimor me norma të reja dhe përjashtime për bizneset e vogla. Në këtë periudhë, u promovua përdorimi i shërbimeve online për deklarimin dhe pagesën e taksave, duke e bërë procesin më të lehtë dhe më të shpejtë për tatimpaguesit. Ligji nr. 29/2023, për tatimin mbi të ardhurat, është një nga reformat më të fundit që ka sjellë ndryshime të rëndësishme në normat dhe procedurat tatimore. Një nga sfidat kryesore mbetet evazioni fiskal, për të cilin qeveria ka ndërmarrë iniciativa për ta reduktuar përmes rritjes së mbikëqyrjes dhe kontrolleve. Shqipëria vazhdon të përmirësojë sistemin e saj tatimor për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe për të përballuar sfidat e reja të tregut dhe konkurrencës ndërkombëtare.

2. Sfidat Kryesore të Bizneseve nga Ndryshimet në Legjislacionin Tatimor

Ndryshimet e shpeshta në legjislacionin tatimor krijojnë një sërë sfidash për bizneset, duke ndikuar në mënyrën se si ato operojnë dhe planifikojnë të ardhmen. Reformat tatimore luajnë një rol thelbësor në zhvillimin ekonomik të një vendi, duke ndikuar drejtpërdrejt në mjedisin e biznesit, investimet dhe konkurrencën në treg. Ligji i ri tatimor në Shqipëri është një hap i rëndësishëm drejt përafrimit me standardet e Bashkimit Europian (BE), por gjithashtu ka sjellë sfida të konsiderueshme për bizneset vendase. Ndryshimet kryesore përfshijnë uljen e pragut të TVSH-së, zbatimin e fiskalizimit dhe përforcimin e masave kundër informalitetit. Ndikimi i këtyre ndryshimeve ka qenë i ndjeshëm, veçanërisht për bizneset e vogla dhe të mesme (SME), të cilat përbëjnë shumicën e ekonomisë shqiptare. Ky punim do të analizojë efektet e ligjit të ri tatimor në bizneset shqiptare, duke u fokusuar në transparencën fiskale, barrën administrative dhe ndikimin në konkurrencën ekonomike, analizohen sfidat kryesore që hasin bizneset për shkak të ndryshimeve fiskale, duke përfshirë pasigurinë ligjore, rritjen e kostove të pajtueshmërisë dhe ndikimin në konkurrueshmërinë e tregut.

2.1 Pasiguria Fiskale dhe Ndikimi në Planifikimin Afatgjatë

Ndryshimet e papritura në normat tatimore, përjashtimet fiskale apo procedurat e raportimit krijojnë pasiguri për bizneset. Kjo pasiguri e bën të vështirë planifikimin financiar dhe investimet afatgjata. Për shembull, rritja e papritur e tatimit mbi fitimin mund të ndikojë në vendimet për zgjerim të një kompanie, duke e bërë atë më pak të gatshme për të investuar në projekte të reja (OECD, 2021).³ Shqipëria ka pësuar më shumë se pesë reforma fiskale madhore në dekadën e fundit, duke krijuar një mjedis të paqëndrueshëm për bizneset. Këto ndryshime përfshijnë:

- Uljen dhe rritjen e pragut të TVSH-së.
- Modifikimin e normave të tatimit mbi fitimin.
- Futjen e politikave të reja fiskale për sektorë specifikë.

³ OECD. (2021). *Tax Policy Reforms 2021: OECD and Selected Partner Economies*. Organisation for Economic Co-operation and Development. <https://doi.org/10.1787/6e6b5a4f-en>

Një studim i OECD-së (2021)⁴ tregon se stabiliteti fiskal është një element thelbësor për tërheqjen e investimeve të huaja direkte (FDI). Investitorët kërkojnë një mjedis të parashikueshëm, ku rregullat fiskale nuk ndryshojnë shpesh, për të minimizuar rreziqet financiare. Ndryshimet e papritura në politikat fiskale ndikojnë në vendimmarrjen e investitorëve dhe sipërmarrjeve. Sipas një raporti të Fondit Monetar Ndërkombëtar (2022)⁵, paqëndrueshmëria fiskale rrit kostot e operimit për bizneset, pasi ato duhet të përshtatin planet financiare dhe strategjitë e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Një raport i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë (2022)⁶ sugjeron se rreth 45% e bizneseve shqiptare kanë pezulluar ose reduktuar planet e zgjerimit për shkak të mungesës së një politike fiskale të qëndrueshme. Pasiguria fiskale ndikon jo vetëm në investimet e biznesit, por edhe në besimin e përgjithshëm të tregut. Sipas një raporti të European Commission (2021)⁷, pasiguria fiskale mund të çojë në rritjen e normave të interesit për kreditë e biznesit, pasi bankat dhe institucionet financiare e perceptojnë mjedisin ekonomik si të rrezikshëm. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është ndikimi në konkurrencën ekonomike. OECD (2022)⁸ argumenton se paqëndrueshmëria e politikave fiskale krijon një avantazh për bizneset më të mëdha, të cilat kanë burime për të përballuar ndryshimet, ndërsa bizneset e vogla dhe të mesme mbeten më të ekspozuara ndaj rreziqeve. Pasiguria fiskale është një nga sfidat kryesore për bizneset shqiptare, duke ndikuar negativisht në planifikimin afatgjatë dhe klimën e investimeve. Për të përmirësuar situatën, qeveria duhet të krijojë një strategji fiskale më të qëndrueshme, të shmangë ndryshimet e shpeshta të politikave tatimore dhe të përfshijë komunitetin e biznesit në vendimmarrje. Një politikë fiskale e qëndrueshme do të ndihmojë në rritjen e besimit të tregut, nxitjen e investimeve dhe përmirësimin e konkurrencës ekonomike në Shqipëri.

2.2 Rritja e Kostove të Pajtueshmërisë me Ligjin

Ndryshimet në rregulloret tatimore shpesh kërkojnë që bizneset të përshtatin sistemet e tyre të kontabilitetit dhe të investojnë në trajnim për stafin që merret me përputhshmërinë fiskale. Kjo përfshin angazhimin e ekspertëve tatimorë dhe përdorimin e softuerëve të rinj të kontabilitetit, gjë që rrit ndjeshëm kostot operative për bizneset e vogla dhe të mesme (World Bank, 2022).⁹ Ndryshimet e shpeshta në legjislacionin tatimor jo vetëm që rrisin rrezikun e penalteteve dhe gjykimeve tatimore, por gjithashtu sjellin një barrë të rëndë financiare për tatimpaguesit në formën e kostove të pajtueshmërisë. Pajtueshmëria me ligjin përfshin një sërë detyrash administrative dhe financiare që bizneset dhe individët duhet të përmbushin për të siguruar se veprojnë brenda kornizës ligjore. Një nga faktorët kryesorë që çon në rritjen e kostove të pajtueshmërisë është kompleksiteti i rregullave fiskale. Sa më të ndërlikuar të bëhen procedurat tatimore, aq më shumë kohë dhe resurse financiare kërkohen për të siguruar përmbushjen e tyre në mënyrë të saktë. Kjo përfshin shpenzime për kontabilistë, këshilltarë tatimorë dhe ekspertë ligjorë, të cilët janë të nevojshëm për të interpretuar dhe zbatuar ndryshimet e reja fiskale në mënyrë korrekte (OECD, 2022).¹⁰ Për më tepër, teknologjitë e reja të deklarimit dhe raportimit tatimor shpesh kërkojnë investime të mëdha nga bizneset. Për shembull, shumë vende kanë futur sisteme të raportimit në kohë reale ose platforma të avancuara digjitale për kontrollin e transaksioneve financiare. Ndërsa këto sisteme ndihmojnë në uljen e evazionit fiskal, ato gjithashtu kërkojnë që bizneset të investojnë në softuer të ri, trajnim të stafit dhe përmirësim të proceseve të brendshme. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është rritja e frekuencës së auditimeve tatimore. Autoritetet fiskale, në përpjekje për të përmirësuar mbledhjen e të ardhurave dhe për të parandaluar shmangien tatimore, po përdorin më shumë kontrolle dhe auditime të detajuara. Kjo do të thotë që bizneset duhet të mbajnë një nivel më të lartë të dokumentacionit dhe të jenë të përgatitura për inspektime të papritura, çka përkthehet në rritje të kostove operative

⁴ OECD. (2021). The role of tax stability in attracting foreign direct investment. OECD Publishing.

⁵ Fondi Monetar Ndërkombëtar. (2022). Fiscal risks and business planning in transition economies. IMF Reports.

⁶ Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë. (2022). Impact of fiscal policy changes on business expansion in Albania.

⁷ European Commission. (2021). Economic trends and fiscal policy in Albania. EU Publications.

⁸ OECD. (2022). Financial risks and fiscal policy in small economies.

⁹ World Bank. (2022). "Doing Business 2022: Comparing Business Regulation in 190 Economies". World Bank Group. <https://doi.org/10.1596/978-1-4648-1756-4>

¹⁰ OECD. (2022). "Tax administration 2022: Comparative information on OECD and other advanced and emerging economies". OECD Publishing.

(James & Nobes, 2021).¹¹ Përveç kostove financiare, ekziston edhe një ndikim i rëndësishëm në burimet e brendshme të biznesit. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme shpesh përballen me vështirësi më të mëdha në krahasim me korporatat e mëdha, pasi ato nuk kanë të njëjtat kapacitete për të përballuar ndryshimet tatimore pa ndikuar në aktivitetin e tyre kryesor. Në disa raste, rritja e kostove të pajtueshmërisë mund të çojë në uljen e investimeve, ngadalësimin e rritjes ekonomike dhe madje edhe në mbylljen e disa bizneseve që nuk mund të përballojnë barrën e rritur tatimore (European Commission, 2021).¹² Në kontekstin e gjykimeve tatimore, rritja e kostove të pajtueshmërisë shpesh çon në më shumë mosmarrëveshje mes tatimpaguesve dhe autoriteteve fiskale. Kur bizneset ose individët nuk kanë mundësi të përmbushin kërkesat e reja për shkak të mungesës së burimeve financiare ose njohurive ligjore, ata mund të përballen me penalitete të larta, të cilat më pas mund të kundërshtohen përmes procesit gjyqësor. Megjithatë, siç u përmend më herët, procedurat gjyqësore janë të shtrenjta dhe kërkojnë kohë, duke e bërë të vështirë për shumë tatimpagues të mbrojnë të drejtat e tyre në mënyrë efektive (Richardson, 2020). Si përfundim, rritja e kostove të pajtueshmërisë me ligjin është një sfidë e madhe për tatimpaguesit, veçanërisht për bizneset e vogla dhe të mesme. Kompleksiteti i rregullave, shpenzimet për ekspertizë ligjore dhe teknologjitë e reja të raportimit tatimor rrisin barrën financiare dhe administrative. Për të minimizuar ndikimin negativ, qeveritë duhet të ofrojnë udhëzime të qarta dhe të thjeshtojnë procedurat ekzistuese, në mënyrë që bizneset të mund të përmbushin detyrimet e tyre tatimore pa rrezikuar stabilitetin financiar.

2.3 Ndikimi në Konkurrueshmërinë e Tregut, Marrëdhënies me Investitorët dhe Partnerëve

Ndryshimet ligjore tatimore luajnë një rol kyç në formësimin e mjedisit ekonomik dhe ndikojnë drejtpërdrejt në konkurrueshmërinë e tregut, marrëdhëniet me investitorët dhe partneritetet e biznesit. Çdo ndryshim në normat e taksave, përjashtimet apo rregulloret e reja mund të krijojë avantazhe ose disavantazhe për bizneset, duke ndikuar në strategjitë e tyre afatgjata. Për shembull, një rritje e taksave mund të çojë në një rritje të kostove operative, duke vështirësuar konkurrencën për bizneset e vogla, ndërsa uljet e taksave mund të tërheqin investime të reja dhe të nxisin rritjen ekonomike. Përveç ndikimit në konkurrueshmërinë e tregut, ndryshimet tatimore ndikojnë edhe në perceptimin dhe vendimet e investitorëve. Investitorët priren të favorizojnë mjedise me stabilitet tatimor, pasi paqartësitë në këtë aspekt mund të rrisin rrezikun e investimeve.¹³ Në të njëjtën kohë, partneritetet e biznesit gjithashtu mund të ndihen të prekura, pasi ndryshimet në politikën tatimore mund të kërkojnë rinegociime kontratash ose ndryshime në strategjitë e bashkëpunimit ndërmjet kompanive. Një nga mënyrat kryesore se si ndryshimet tatimore ndikojnë në konkurrencën e tregut është përmes kostove operative. Për shembull, një rritje e normës së tatimit mbi fitimin ul marzhet e fitimit për bizneset, duke i detyruar ato të rrisin çmimet ose të zvogëlojnë shpenzimet operative, të cilat mund të përfshijnë reduktimin e fuqisë punëtore ose investimeve në inovacion. Për shembull, kompanitë shumëkombëshe shpesh kanë burime të mjaftueshme për të optimizuar strukturën e tyre tatimore, ndërsa bizneset e vogla nuk kanë të njëjtat mundësi, duke i bërë ato më të ndjeshme ndaj ndryshimeve fiskale.¹⁴ Ndryshimet në politikën tatimore mund të ndikojnë edhe në tërheqjen e investimeve të huaja. Shtetet me politika tatimore të favorshme shpesh tërheqin kompani ndërkombëtare të cilat kërkojnë mjedise me taksë të ulëta dhe stimuj fiskalë. Për shembull, Irlanda ka aplikuar një politikë tatimore të favorshme për bizneset, duke tërhequr kompani të mëdha si Apple dhe Google. Megjithatë, ndryshimet e papritura në normat tatimore mund të krijojnë pasiguri dhe të dekurajojnë investimet afatgjata. Për më tepër, ndryshimet në sistemin tatimor mund të krijojnë barriera të reja ose të zvogëlojnë ato ekzistuese për hyrjen e bizneseve të reja në treg. Taksë të larta hyrëse mund të dekurajojnë sipërmarrësit e rinj, ndërsa politika që ofron lehtësime tatimore për startup-et mund të nxisë inovacionin dhe hyrjen e bizneseve të reja në treg. Në përgjithësi, ndikimi i ndryshimeve tatimore në konkurrueshmërinë e tregut varet nga mënyra se si ato implementohen dhe se cilat kategori biznesesh prekin më shumë. Ndërkohë që disa politika mund të ndihmojnë në rritjen e konkurrencës dhe inovacionit, të tjera mund të

¹¹ James, Simon & Nobes, Christopher. (2021). *“The economics of taxation: Principles, policy, and practice”*, Prentice Hall, 8 Dec 2010.

¹² European Commission. (2021). *“Alternative dispute resolution in tax matters”*. Brussels: European Union.

¹³ Robert D Lee, Johnson Ronald. Wayne, Joyce G. Philip, *“Public Budgeting Systems,”* Seventh Edition, Jones & Bartlett Publishers, 2004, f. 584

¹⁴ IMF. (2020). *Corporate Taxation in the Global Economy*. International Monetary Fund. <https://doi.org/10.5089/9781513511771.001>

krijojnë përparësi për aktorët më të mëdhenj dhe të vështirësojnë hyrjen e bizneseve të reja. Investitorët dhe partnerët e biznesit preferojnë një mjedis të qëndrueshëm fiskal për të marrë vendime afatgjata. Ndryshimet e papritura në politikat tatimore mund të zvogëlojnë besimin e investitorëve dhe të ndikojnë në vlerësimin e një kompanie në treg.¹⁵

2.4 Rreziku i Penaliteteve dhe Gjykimeve Tatimore

Ndryshimet tatimore shpesh sjellin pasiguri për tatimpaguesit, të cilët mund të përballen me penaltete si pasojë e mosnjohjes ose keqinterpretimit të rregullave të reja. Legjislacioni tatimor është kompleks dhe ndryshimet e shpeshta mund të krijojnë vështirësi për bizneset dhe individët në zbatimin korrekt të detyrimeve të tyre. Penaltetet tatimore mund të vijnë si rezultat i mosdeklarimit të saktë të të ardhurave, mospagesës në afat të taksave ose interpretimit të gabuar të normave fiskale. (Deloitte, 2022).¹⁶ Një nga rreziqet më të mëdha për tatimpaguesit është vendosja e gjobave dhe kamatëvonesave për vonesa në pagesa ose deklarime të pasakta. Në shumë raste, administrata tatimore ka diskrecion të gjerë në interpretimin e ligjit, gjë që çon në mospajtime mes tatimpaguesve dhe autoriteteve fiskale (OECD, 2022).¹⁷ Për shembull, në disa vende, ndryshimet tatimore nuk shoqërohen me udhëzime të qarta, duke i lënë bizneset në mëdyshje mbi mënyrën e aplikimit të normave të reja. Një tjetër burim i penalteteve është rishikimi retrospektiv i deklaratave tatimore nga autoritetet fiskale. Nëse një biznes ka zbatuar një normë tatimore bazuar në interpretimin e tij, por më vonë administrata tatimore e konsideron këtë interpretim të pasaktë, mund të vendosen penaltete të konsiderueshme, madje edhe ndjekje ligjore në raste të rënda (James & Nobes, 2021).¹⁸ Gjykimet tatimore janë një tjetër pasojë e mundshme për tatimpaguesit që kontestojnë penaltetet e vendosura. Procesi gjyqësor mund të jetë i gjatë dhe i kushtueshëm, duke ndikuar në stabilitetin financiar të bizneseve. Gjykatat administrative dhe gjykatat e larta shpesh shqyrtojnë raste ku tatimpaguesit argumentojnë se penaltetet janë të padrejta ose të pabazuara në ligj. Megjithatë, proceset gjyqësore tatimore kërkojnë ekspertizë ligjore dhe financiare, duke e bërë të vështirë për bizneset e vogla dhe individët të mbrojnë interesat e tyre (Richardson, 2020). Në shumë vende, ekzistojnë mekanizma alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tatimore, si arbitrazhi ose negociimi me administratën fiskale. Këto mekanizma mund të ndihmojnë në shmangien e proceseve të gjata gjyqësore dhe në gjetjen e zgjidhjeve të pranueshme për të dyja palët (European Commission, 2021).¹⁹ Në përfundim, ndryshimet tatimore mund të krijojnë rreziqe të konsiderueshme për tatimpaguesit, duke përfshirë penaltete financiare dhe procese gjyqësore të ndërlikuara. Mungesa e qartësisë ligjore dhe interpretimet e ndryshme të normave fiskale mund të çojnë në mosmarrëveshje, të cilat shpesh përfundojnë në gjykatë. Për këtë arsye, është e rëndësishme që bizneset dhe individët të jenë të informuar mbi ndryshimet tatimore dhe të kërkojnë këshilla profesionale për të shmangur pasojat negative.

3. Ndikimi i Ligjit të Ri Tatimor tek Bizneset Shqiptare

Miratimi i ligjit të ri tatimor në Shqipëri ka sjellë një epokë të re për mjedisin e biznesit, duke përfshirë një sërë ndryshimesh që kanë ndikuar direkt në operacionet e tyre të përditshme. Në thelb, ky ligj synon të luftojë informalitetin ekonomik, të rrisë të ardhurat publike dhe të sigurojë një konkurrencë më të drejtë në treg. Këto objektiva janë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit, por zbatimi i tyre ka sjellë një ndikim të ndryshëm për kategori të ndryshme biznesesh. Një prej ndryshimeve kryesore ka qenë ulja e pragut për detyrimin

¹⁵ PwC. (2021). *The Future of Tax: How Businesses Can Prepare for Uncertain Times*. PricewaterhouseCoopers. <https://www.pwc.com/gx/en/tax/publications/future-of-tax.html>

¹⁶ Deloitte. (2022). *Navigating Tax Complexity: How Businesses Can Stay Compliant with Changing Regulations*. Deloitte Insights. <https://www2.deloitte.com/global/en/pages/tax/articles/tax-complexity.html>

¹⁷ OECD. (2022). *Tax administration 2022, "Comparative information on OECD and other advanced and emerging economies."* OECD Publishing.

¹⁸ James Simon, 2002. *Taxation, "Critical Perspectives on the World Economy,"* Routledge, May 23, 2002 .

¹⁹ European Commission. (2021). *Alternative dispute resolution in tax matters*. Brussels: European Union.

e deklarimit të TVSH-së nga 5 milionë lekë në 2 milionë lekë xhiro vjetore.²⁰ Për bizneset e vogla dhe të mesme, kjo nënkupton që ato që më parë përjashtoheshin nga TVSH-ja tani duhet të përmbushin kërkesat e reja fiskale. Sipas një vlerësimi të bërë nga Ministria e Financave (2022), ky ndryshim ka përfshirë mbi 15,000 biznese shtesë në regjistrin e TVSH-së, duke zgjeruar bazën tatimore të vendit. Megjithatë, për bizneset e vogla, kjo ka rezultuar në një barrë të shtuar administrative dhe financiare. Për shembull, ato tani duhet të mbulojnë kostot e kontabilitetit profesional dhe t'u përmbahen afateve të rrepta për raportimin. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është futja e teknologjisë në sistemin fiskal, veçanërisht përdorimi i kasave fiskale të lidhura në kohë reale me administratën tatimore. Kjo risi ka përmirësuar transparencën dhe ka reduktuar mundësitë për evazion fiskal. Sipas raportit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (2021), vetëm në vitin e parë të zbatimit të kësaj mase, të ardhurat nga TVSH-ja janë rritur me 10%. Megjithatë, për bizneset që operojnë në zona rurale ose të cilat nuk kanë qasje të mjaftueshme në infrastrukturën teknologjike, përshtatja me këtë sistem ka qenë një sfidë e madhe. Në shumë raste, është raportuar se kostot e blerjes dhe mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale kanë ndikuar negativisht në fitimet e këtyre bizneseve.²¹ Përtej këtyre sfidave, ligji i ri tatimor ka krijuar disa përfitime afatgjata. Për shembull, rritja e të ardhurave publike ka mundësuar investime të rëndësishme në infrastrukturë dhe shërbime sociale, të cilat përfitojnë indirekt nga bizneset. Gjithashtu, transparencja e përmirësuar ka rritur besimin e investitorëve të huaj për të operuar në Shqipëri. Një raport i OECD-së (2022) thekson se reformat fiskale kanë ndihmuar në rritjen e vlerësimeve pozitive për mjedisin e biznesit në vend, duke e bërë atë më tërheqës për kapitalin e huaj. Një sfidë tjetër që lidhet me implementimin e këtij ligji është funksionimi i inspektorëve tatimorë dhe kontrollet e tyre. Ndërsa qëllimi është të sigurohet përputhshmëria e plotë me rregullat fiskale, disa biznese kanë raportuar praktika të panevojshme burokratike apo vlerësime subjektive gjatë kontrolleve. Për të adresuar këtë, është e rëndësishme që të përmirësohet trajnimi i stafit tatimor dhe të forcohet mbikëqyrja për të siguruar një zbatim të drejtë dhe të barabartë të ligjit. Në përmbledhje, ligji i ri tatimor ka ndikuar fuqishëm në mënyrën se si bizneset shqiptare funksionojnë, duke sjellë përfitime të qarta në transparencë dhe të ardhura shtetërore, por gjithashtu duke krijuar sfida për disa sektorë. Për të siguruar që këto reforma të kenë një ndikim pozitiv afatgjatë, është e nevojshme që qeveria të ofrojë mbështetje të vazhdueshme për bizneset, përfshirë subvencionet për teknologji, trajnimin dhe lehtësimet fiskale për ato që përballen me vështirësi në përshtatje.

4. Përmbledhje e ndryshimeve të ligjit nr. 29/2023, për tatimin mbi të ardhurat

Në zbatim të ligjit të "Tatimit mbi të Ardhurat", Administrata Tatimore ka informuar tatimpaguesit, që ofrojnë shërbime profesionale sipas përcaktimeve të VKM Nr. 753, datë 20.12.2023, që nga janari 2024 do të taten me 15%.²² Me qëllim ndërgjegjësimit të tatimpaguesve (jo penalizimit të tyre), Administrata Tatimore u ka dërguar letër të personalizuar çdo tatimpaguesi, që është pjesë e listës së shërbimeve profesionale të miratuar me vendim qeverie, që të marrë masa për saktësimin e kodit ekonomik në mënyrë që të taten në mënyrë të drejtë. Sa më lart përmendur, është shumë e rëndësishme që tatimpaguesit të vetë verifikojnë kodin ekonomik të aktivitetit në llogarinë elektronike në e-Filing, sipas listës së shërbimeve profesionale, dhe ta ndryshojnë atë në përputhje me aktivitetin që ushtrojnë për 2 qëllime:

1. Të taten drejtë, si shërbime profesionale, sipas vendimit të qeverisë.
2. Të mos taten gabimisht nëse kodi ekonomik nuk përputhet me aktivitetin e biznesit.

Në ligjin nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", janë bërë disa ndryshime dhe shtesa përmes aktesh normative të ndryshme. Disa nga ndryshimet kryesore janë:

- Shtesa e Normës Tatimore: U vendos një normë tatimore prej 15% për të ardhurat neto deri në 14 milionë lekë, me një normë më të lartë prej 23% për të ardhurat mbi këtë shumë.

²⁰ Ministria e Financave dhe Ekonomisë. (2022). Fiscal reform impact study. <https://financa.gov.al>

²¹ OECD. (2021). Tax transparency and economic development in Southeast Europe. OECD Publishing.

²²Faqja zyrtare e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, <https://www.tatime.gov.al/>

- Shfuqizimi i Lehtësirave Tatimore: Disa lehtësira tatimore që ishin parashikuar në ligjin e mëparshëm, ligji nr. 8438, janë shfuqizuar ose ndryshuar, duke ndikuar në mënyrën e tatimit për profesionet si kontabilistë dhe avokatë.
- Rregullat për Deklarimin e Tatimeve: Janë saktësuar procedurat për deklarimin e tatimeve për individët e vetëpunësuar dhe për entitetet, për të siguruar një sistem më të qartë dhe më të lehtë për administratën tatimore.
- Përkufizimi i "Individit të Vetëpunësuar": Janë bërë saktësime mbi përkufizimin e individëve të vetëpunësuar dhe kategoritë e shërbimeve që ata ofrojnë.
- Hyrja në Fuqi: Janë përcaktuar afatet e hyrjes në fuqi për dispozitat e reja dhe periudhat kalimtare për adaptim.
- Normat e Reja për Shërbimet Profesionale: Janë vendosur norma të reja tatimore për shërbimet profesionale, duke ndarë individët tregtarë nga ata që ofrojnë shërbime profesionale.

Sipas ndryshimeve në ligj, "Individ" konsiderohet çdo person fizik jotregtar. Individ tatimpagues, është personi i cili detyrohet të paguajë tatime, taksa ose kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe agjenti i mbajtjes së tatimit në burim. Mbi të ardhurat që individët rezidentë realizojnë me burim, brenda dhe jashtë territorit shqiptar, si dhe individët jorezidentë me burim në territorin shqiptar, zbatohet tatimi mbi të ardhurat personale. Individ, tatimpagues rezident është personi i cili ka një vendbanim në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 12 të Kodit Civil, ka nënshtetësi shqiptare dhe është funksionar diplomatik ose kryen një funksion të ngjashëm, në emër të Republikës së Shqipërisë, jashtë territorit të saj në mënyrë të vazhdueshme ose me ndërprerje, qëndron në Republikën e Shqipërisë më tepër se 183 ditë në një periudhë prej 365 ditësh.²³ Regjistrimi dhe identifikimi i individit rezident, bëhet me një kod fiskal dhe si i tillë, shërben Numri i Identifikimit personal në Letërnjoftimin e individit. Individ, tatimpagues jo rezident konsiderohet individ, kur nuk plotëson një nga përcaktimet e individit rezident shqiptar, përkufizuar më lart. Regjistrimi dhe identifikimi i individit jorezident, bëhet me një kod fiskal dhe si i tillë, shërben Numri i Identifikimit personal në Letërnjoftimin e individit jorezident. Çdo person, pavarësisht nga statusi ose forma ligjore e regjistrimit apo e njohjes së tij, kur është a bëhet subjekt i tatimit mbi fitimin, ka të drejtë të kërkojë çregjistrimin në çdo kohë, por jo të kalojë si subjekt, që i nënshtrohet tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël.²⁴ Tatimpaguesit rezidentë i nënshtrohen tatimit mbi fitimet e realizuara nga të gjitha burimet: brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Tatimpaguesit jorezidentë i nënshtrohen tatimit mbi fitimet e realizuara nga të gjitha të ardhurat, me burim në Republikën e Shqipërisë. Përfshihen nga tatimi mbi fitimin organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, Banka e Shqipërisë, shoqata humanitare, organizata ndërkombëtare, kur parashikohet nga marrëveshje të veçanta, sipërmarrje të parashikuara në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi, fondacionet ose institucionet financiare jo bankare të krijuara ose të transferuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, shtëpitë filmike të prodhimit kinematografik, të subvencionuara nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Fondi i pensionit vullnetar i administruar. Të gjitha subjektet e lartpërmendura, janë të detyruara të dorëzojnë në organet tatimore deklaratën tatimore dhe bilancin vjetor, në të njëjtat afate si subjektet, që i nënshtrohen tatimit mbi fitimin.

Tatimit mbi fitimin i nënshtrohen:

- Personat juridikë dhe ortakëritë me të ardhura mbi 8 000 000 lekë në vit
- Personat juridikë, si dhe ortakëritë e tjera të personave të themeluara ose të organizuara në bazë të një ligji të huaj dhe që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë;

²³ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. (2023). *Ligji nr. 29/2023, për tatimin mbi të ardhurat*. <https://www.qbz.gov.al/>

²⁴ Alprofit Consult. (2023). *Ndryshimet e ligjit nr. 29/2023 për tatimin mbi të ardhurat*. <https://www.alprofitconsult.com/ndryshimet-ligjit-29-2023>

Emri i Autorit

- Çdo person tjetër, pavarësisht nga statusi ose forma ligjore e regjistrimit apo e njohjes së tij, me përjashtim të rastit kur ky person është subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Strukturat akomoduese “Hotel apo Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtur të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”, përjashtohen nga tatimi mbi fitimin, për një periudhë 10-vjeçare për ato struktura, të cilat kanë përfituar statusin special deri në dhjetor 2024. Efektet e përjashtimit fillojnë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit special. Fitimi i tatueshëm rezulton si diferencë e të ardhurave gjithsej të realizuara gjatë periudhës tatimore (viti kalendarik), me shpenzimet e njohura.

Të ardhurat gjithsej nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to, të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme. Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore përcaktohet në bazë të bilancit dhe të anekseve të tij, që duhet të jenë hartuar në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Shkalla e tatimit mbi fitimin është:

- a) 0% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 lekë në vit.
- b) 15% për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 000 000 lekë në vit.

Shkalla e tatimit mbi fitimin është 5 % per:

- a) Personat juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitetet për prodhimin/zhvillimin e software-ve
- b) Për personat juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas ligjit nr. 38/2012, “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”
- c) Për personat juridikë, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike në industrinë automotive²⁵

4.1 Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël është një sistem tatimor që synon të lehtësojë procedurat për tatimpaguesit e vegjël, duke reduktuar ngarkesën administrative dhe duke nxitur rritjen e biznesit.²⁶ Çdo tatimpagues, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.²⁷ Të ardhurat e tatueshme janë të ardhurat gjithsej, nga veprimtaria e biznesit të vogël dhe nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, etj. Të ardhurat e tatueshme apo fitimi i tatueshëm rezulton si diferencë midis të ardhurave gjithsej të realizuar gjatë periudhës tatimore me shpenzimet e njohura. Këto ndryshime dhe shtesa kanë për qëllim rregullimin e mënyrës së tatimit mbi të ardhurat dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për bizneset dhe individët në Shqipëri.

5. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 27.06.2024 për shfuqizimin e disa neneve të ligjit nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat".

²⁵ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. (2023). Ligji nr. 29/2023 për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë. <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=14283>

²⁶ Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. (n.d.). Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. <https://www.dpt.gov.al/tatimi-i-thjeshtuar>

²⁷ Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. (2018). Dorëzimi i deklaratës vjetore të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël me qarkullim nga 0-5 dhe nga 5-8 milionë lekë. <https://www.dpt.gov.al/deklarata-vjetore>.

Një grup deputetësh dhe organizata profesionale, argumentuan se dispozitat e ligjit nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat shkelin lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe parimin e barazisë përpara ligjit. Vendimi trajton kërkesën për shfuqizimin e disa neneve të ligjit nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", si dhe të vendimit nr. 753 të Këshillit të Ministrave, të cilët kanë kërkuar të shfuqizoheshin si të papajtueshme me Kushtetutën duke pretenduar se norma tatimore prej 15% për të ardhurat deri në 14 milionë lekë ishte e padrejtë dhe e ashpër dhe se mungonte një periudhe kalimtare për adaptim e cila i dëmtonte bizneset.²⁸ Çfarë vendosi Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 52, datë 27.06.2024? Gjykata e mori vendimin e mësipërm sipas arsytimit të përmbledhur në këto pika:

- Përputhshmëria me Kushtetutën: Gjykata theksoi se ligji duhet të respektojë parimet e barazisë dhe proporcionalitetit.
- Efektet Negative: U vlerësua se zbatimi i menjëhershëm i normave tatimore do të krijonte pasoja të rënda për bizneset, duke rrezikuar aktivitetin e tyre ekonomik.
- Rëndësia e Barazisë: Vendimi thekson rëndësinë e trajtimit të barabartë për të gjitha kategoritë e tatimpaguesve.
- Nevoja për Shkallëzim: Një periudhë kalimtare është e nevojshme për të lehtësuar kalimin në një sistem të ri tatimor.
- Siguria Juridike: Rëndësia e pritshmërive legjitime për individët dhe bizneset, duke siguruar që ndryshimet ligjore të mos dëmtojnë aktivitetin ekonomik.²⁹

Shfuqizimi i neneve të ligjit nr. 29/2023 ka disa pasoja të rëndësishme sikurse:

Rivendosjen e Normave Tatimore: Norma 0% e Tatimit nënkupton që bizneset dhe individët që kishin të ardhura deri në 14 milionë lekë mund të rikthehen në një normë tatimore më të favorshme, duke shmangur tatimin prej 15% që ishte parashikuar për vitin 2024. Mbrojtjen e Veprimtarisë Ekonomike: Krijoi stabilitet për bizneset duke qenë se shfuqizimi ndihmoi në mbrojtjen e aktiviteteve të biznesit, duke evituar pasigurinë që mund të kishte sjellë zbatimi i normave të reja tatimore. Përmirësimin e Kushtetutës: Vendimi thekson rëndësinë e respektimit të parimeve kushtetuese, siç janë liria e veprimtarisë ekonomike dhe barazia përpara ligjit.

Ndikimi në Politikën Fiskale: Ligjvënësi mund të duhet të rishikojë politikën tatimore për të siguruar një sistem më të drejtë e të qëndrueshëm, duke marrë parasysh kritikët dhe shqetësimet e ngritura.

Siguria Juridike: Pritshmëritë Legjitime: Bizneset dhe individët do të kenë një mjedis më të qartë dhe më të parashikueshëm për veprimtarinë e tyre ekonomike.

Pasojat për Buxhetin e Shtetit: Shfuqizimi mund të ndikojë në të ardhurat tatimore të buxhetit të shtetit, sidomos nëse shumë subjekte që ishin në prag të kalimit në normat e reja tatimore tani do të vazhdojnë të paguajnë norma më të ulta.

Në përgjithësi, shfuqizimi i këtyre neneve është një hap drejt krijimit të një ambienti më të favorshëm për bizneset dhe individët, duke siguruar një balancë më të mirë midis kërkesave fiskale dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre. Vendimi nr. 52 i Gjykatës Kushtetuese reflekton angazhimin për mbrojtjen e të drejtave ekonomike dhe ligjore të individëve dhe bizneseve, si dhe për ruajtjen e një sistemi tatimor të drejtë dhe të barabartë. Ai nënvizon nevojën për një qasje të kujdesshme në ndryshimet ligjore që ndikojnë në fushën ekonomike. Pas shfuqizimit të neneve të ligjit nr. 29/2023, shumë biznese shprehën kënaqësi për shfuqizimin e normës tatimore prej 15% për të ardhurat deri në 14 milionë lekë, duke e parë këtë si një lehtësim të rëndësishëm për aktivitetin e tyre ekonomik.³⁰ Bizneset e vogla dhe ato të vetëpunësuarit e shohin këtë vendim si një rikthim të shpresave për të vazhduar aktivitetin e tyre, duke shmangur pasigurinë që do të kishte sjellë zbatimi i normave të reja tatimore. Disa organizata biznesi kërkuan më shumë stabilitet dhe parashikueshmëri në politikën fiskale, duke theksuar nevojën për të shmangur ndryshime të shpejta dhe të papritura që ndikojnë në planifikimin e tyre financiar. Reagimet

²⁸ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. (2024). Vendimi nr. 52, datë 27.06.2024 për shfuqizimin e disa neneve të ligjit nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat". <https://www.gjk.gov.al/vendimi-52-2024>.

²⁹ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. (2024). Vendimi nr. 52, datë 27.06.2024. <https://www.gjk.gov.al>

përfshinë edhe kritika ndaj ligjit të mëparshëm për tatimin mbi të ardhurat, duke theksuar se ndryshimet ishin të nevojshme për të krijuar një sistem më të drejtë dhe më të qëndrueshëm. Organizatat e biznesit shprehën gatishmërinë për të angazhuar dialog me institucionet për të ndihmuar në formësimin e politikave tatimore që respektojnë të drejtat e individëve dhe nevojat e sektorit privat. Bizneset e panë vendimin si një afirmim të rolit të rëndësishëm të Gjykatës Kushtetuese në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe subjekteve ekonomike. Në përgjithësi, reagimet ishin pozitive dhe treguan se shfuqizimi i këtyre neneve kishte një ndikim të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi më të favorshëm për bizneset në Shqipëri.

6. Strategjitë për Përshtatje ndaj Ndryshimeve në Legjislacionin Tatimor

Për të minimizuar ndikimin e ndryshimeve tatimore dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë operacionale, bizneset duhet të zbatojnë strategji efektive përshtatjeje. Këto strategji përfshijnë përmirësimin e planifikimit fiskal, dixhitalizimin e proceseve financiare, forcimin e transparencës dhe zhvillimin e kapaciteteve të brendshme për të menaxhuar ndryshimet rregullatore. Më poshtë janë disa strategji që mund të ndihmojnë bizneset në këtë proces:

Planifikimi Proaktiv Tatimor: Një nga strategjitë më të rëndësishme është planifikimi i avancuar i detyrimeve tatimore. Bizneset mund të përdorin analiza të rregullta të rregulloreve fiskale dhe të zhvillojnë skenarë të ndryshëm për të përgatitur strategji alternative në rast të ndryshimeve ligjore.³¹

Investimi në Teknologji dhe Dixhitalizimi i Raportimit Fiskal: Dixhitalizimi i proceseve financiare dhe tatimore ndihmon në përmirësimin e përputhshmërisë me legjislacionin. Përdorimi i softuerëve të automatizuar për raportimin fiskal zvogëlon gabimet dhe rrit efikasitetin në përmbushjen e detyrimeve tatimore.³²

Angazhimi i Ekspertëve Tatimorë dhe Konsulentëve Ligjorë: Ndryshimet e shpeshta në legjislacion kërkojnë që bizneset të kenë qasje në ekspertizë të specializuar. Konsultimi me ekspertë tatimorë ndihmon në interpretimin korrekt të rregullave të reja dhe në shmangien e rreziqeve të pajtueshmërisë.³³

Rritja e Transparencës dhe Përputhshmërisë me Rregulloret: Zbatimi i praktikave të mira të qeverisjes së brendshme dhe transparencës fiskale ndihmon bizneset të shmangin penalitetet dhe mosmarrëveshjet me autoritetet tatimore. Krijimi i mekanizmave të qartë për raportimin e të dhënave financiare redukton rrezikun e auditimeve të papritura.³⁴

Diversifikimi i Strukturës së Biznesit dhe Strategjive të Investimit: Përshtatja me ndryshimet tatimore mund të përfshijë edhe riformulimin e strukturës së biznesit. Për shembull, në disa raste, bizneset mund të riorganizojnë operacionet e tyre për të përfituar nga stimujt tatimorë ose për të zvogëluar barrën fiskale në përputhje me legjislacionin aktual (Deloitte, 2022).³⁵

7. Konkluzione

Ndryshimet në legjislacionin tatimor paraqesin sfida të konsiderueshme për bizneset, duke ndikuar në planifikimin financiar, përputhshmërinë ligjore dhe konkurrueshmërinë në treg. Pasiguria fiskale, kostot e larta administrative dhe ndikimi në investime janë disa nga aspektet kryesore që kërkojnë vëmendje të vazhdueshme

³¹ OECD (2021). *Tax Policy Reforms 2021: OECD and Selected Partner Economies*. Organisation for Economic Co-operation and Development. <https://doi.org/10.1787/6e6b5a4f-en>

³² World Bank. (2022). *Doing Business 2022: Comparing Business Regulation in 190 Economies*. World Bank Group. <https://doi.org/10.1596/978-1-4648-1756-4>

³³ PwC (2021). *The Future of Tax: How Businesses Can Prepare for Uncertain Times*. PricewaterhouseCoopers. <https://www.pwc.com/gx/en/tax/publications/future-of-tax.html>

³⁴ IMF (2020). *Corporate Taxation in the Global Economy*. International Monetary Fund.

³⁵ Deloitte. (2022). *Navigating Tax Complexity: How Businesses Can Stay Compliant with Changing Regulations*. Deloitte Insights. <https://www2.deloitte.com/global/en/pages/tax/articles/tax-complexity.html>

nga komuniteti i biznesit dhe politikëbërësit. Vlen për t'u theksuar se Vendimi nr. 52, datë 27.06.2024 i Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e disa neneve të ligjit nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat" pati një rëndësi të madhe për legjislacionin tatimor në Shqipëri, por sidomos për profesionistët e lirë. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese garantoj respektimin e të drejtave të qytetarëve profesionistë dhe të biznesit, duke siguruar që tatimet nuk mund të jenë abuzive dhe janë të arsyeshme. Një vendim i tillë forcon parimin e shtetit të së drejtës, duke siguruar që çdo ndryshim në legjislacionin tatimor është në përputhje me Kushtetutën dhe normat ndërkombëtare. Një sistem tatimor që është në përputhje me Kushtetutën nxit stabilitetin dhe parashikueshmërinë, çka është thelbësore për tërheqjen e investimeve të huaja dhe vendase. Vendimi i Gjykatës ndihmoi në edukimin e publikut mbi të drejtat e tyre dhe detyrimet që kanë ndaj shtetit, duke rritur kështu ndërgjegjësimin për çështjet tatimore. Megjithatë, përmes strategjive të përshtatjes si planifikimi proaktiv tatimor, dixhitalizimi i raporteve fiskale dhe angazhimi i ekspertëve, bizneset mund të minimizojnë rreziqet dhe të maksimizojnë përfitimet nga ndryshimet ligjore. Për më tepër, transparenca dhe fleksibiliteti në strukturën e biznesit ndihmojnë në ruajtjen e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë afatgjatë. Në të ardhmen, është e rëndësishme që qeveritë të hartojnë politika tatimore të qëndrueshme dhe të parashikueshme, duke marrë në konsideratë ndikimin e tyre në ekonominë private. Një qasje e ekuilibruar mes nevojës për të mbledhur të ardhura dhe krijimit të një mjedisi të favorshëm për bizneset do të ndihmojë në përmirësimin e klimës së investimeve dhe rritjen ekonomike. Në përfundim, klima e biznesit në Shqipëri do të varet nga mënyra se si ndryshimet tatimore do të implementohen dhe do të menaxhohen. Një qasje strategjike dhe e mirëplanifikuar mund të sjellë përfitime të mëdha për ekonominë dhe për bizneset vendase dhe të huaja. Si përfundim, vlen për t'u theksuar se reformat tatimore kanë një ndikim të rëndësishëm në afrimin e Shqipërisë me standardet e Bashkimit Europian (BE). Këto reforma tatimore ndikojnë në harmonizimin me direktivat dhe rregulloret e BE-së dhe ndihmojnë në plotësimin e kushteve për anëtarësim, duke e bërë Shqipërinë më të përshtatshme për integrimin në BE.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. James Simon, 2002. Taxation, "Critical Perspectives on the World Economy," Routledge, May 23, 2002 .
2. Robert D Lee, Johnson Ronald. Wayne, Joyce G. Philip, 2004, "Public Budgeting Systems," Seventh Edition, Jones & Bartlett Publishers.
3. Studime juridike nr.1, Tiranë 2011, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.
4. Modigliani, Franco. & Brumberg Richard, (1954). "Utility analysis and the consumption function", an interpretation of cross-section data, Rutgers University Press.
5. Banka Botërore. (2022). *Impact of tax reforms on small enterprises in developing economies*. World Bank Publications.
6. Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim. (2022). *Digital adaptation challenges for SMEs in emerging markets*. EBRD Reports.
7. Ministria e financave, Strategjia e menaxhimit financiar publik 2022
8. IMF 2022" Supporting the development of more effective tax system" hartuar nga FMN, OECD, WB
9. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë. (2022). *Reagimi i bizneseve ndaj ligjit të ri tatimor*. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Shqipërisë.
10. Fondi Monetar Ndërkombëtar. (2022). *Fiscal policy effectiveness in transition economies*. IMF Reports.
11. OECD. (2021). *Tax transparency and economic development in Southeast Europe*. OECD Publishing.

Emri i Autorit

12. Instituti i Studimeve Ekonomike. (2022). *Impacts of tax reforms on SMEs in Albania*.
13. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë. (2022). *Challenges of fiscal reforms in Albania*.

Legjislacion

1. European Commission. (2021). Albania progress report on economic policies. EU Publications.
2. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. (2023). *Ligji nr. 29/2023 për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar*. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë. <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=14283>
3. Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 për “Tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.
4. Ligj Nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar.”

Web faqe

1. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. (2024). *Vendimi nr. 52, datë 27.06.2024*. <https://www.gjk.gov.al>.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. (2021). *Raporti vjetor mbi mbledhjen e të ardhurave dhe efektet e fiskalizimit*. <https://www.tatime.gov.al>.
3. INSTAT. (2022). *Raporti mbi ndikimin e reformës fiskale në bizneset shqiptare*. Instituti i Statistikave të Shqipërisë. <https://www.instat.gov.al>.
4. Ministria e Financave dhe Ekonomisë. (2022). *Ndryshimet e reja në sistemin tatimor dhe efektet e tyre*. Qeveria e Shqipërisë. <https://financa.gov.al>
5. OECD. (2021). *Analizë e reformave fiskale në Ballkanin Perëndimor*. Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. <https://www.oecd.org>.
6. IMF Country Report No. 22/362, www.imf.org.
7. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. (2022). *Annual report on tax compliance and transparency*. <https://www.tatime.gov.al>.
8. Ministria e Financave dhe Ekonomisë. (2022). *Fiscal reform impact study*. <https://financa.gov.al>
9. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. (n.d.). *Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël*. <https://www.dpt.gov.al/tatimi-i-thjeshtuar>
10. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. (n.d.). *Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël*. <https://www.dpt.gov.al/tatimi-i-thjeshtuar>.
11. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. (2018). *Dorëzimi i deklaratës vjetore të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël me qarkullim nga 0-5 dhe nga 5-8 milionë lekë*. <https://www.dpt.gov.al/deklarata-vjetore>.
12. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. (2024). *Vendimi nr. 52, datë 27.06.2024 për shfuqizimin e disa neneve të ligjit nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat"*. <https://www.gjk.gov.al/vendimi-52-2024>.

**PËRSHTATJA DHE HARMONIZIMI I LIGJIT MBI ARBITRAZHIN NË
SHQIPËRI: KRAHASIMI ME PRAKTIKAT E VENDEVE TË BASHKIMIT
EUROPIAN DHE SFIDA TË
INTEGRIMIT NË KUADËR TË STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE**

Prof. Asoc. Dr. Saimir SHATKU*

M.Sc. Marinel PRENGA**

**ADAPTATION AND HARMONIZATION OF THE LAW ON ARBITRATION IN
ALBANIA: COMPARISON WITH THE PRACTICES OF EUROPEAN UNION
COUNTRIES AND
CHALLENGES OF INTEGRATION WITHIN THE FRAMEWORK OF
INTERNATIONAL STANDARDS**

Abstract

This study aims to provide an in-depth and critical analysis of the new law on arbitration in Albania, focusing on the main aspects of the reform and the integration of this law with legal practices and models.

Arbitration, as an external means of dispute resolution, has an important role in the administration of justice, where its use has exploded as a result of the need for efficiency and independence in resolving international and commercial issues. In this context, Albania has approved a new law that aims to modernize and improve the arbitration system, adapting it to the most advanced EU norms and practices and creating the possibility of a more favorable environment for investors and contractual parties.

The study analyzes in detail the legal changes undertaken in Albania and compares them with the most developed models. It is precisely the practices of these countries that provide a consolidated and internationally recognized framework for the management of arbitration processes, ensuring in appropriate balance between procedural efficiency, the principle of legal certainty, and the protection of the rights of the parties. Comparing these models with Albanian law offers the opportunity to assess the potentials and challenges that Albania will face in the process of harmonizing its legislation, while striving to achieve an appropriate level of transparency, independence and credibility in conflict resolution.

Finally, this study concludes that, in addition to formal approximation with European Union legislation, the Albanian legal framework for arbitration requires consolidated implementation and continuous institutional support, in order to guarantee the effective functioning, procedural impartiality and credibility of this alternative dispute resolution mechanism, in accordance with the principles of the rule of law and European standards. It also

* Lektor i jashtëm, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Email: s_shatku@yahoo.com.

** Student, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, E-mail: marinelprenga@gmail.com.

emphasizes the need for a continuous reform process that will enable an arbitration system that provides legal certainty and promotes the development of an open and sustainable economy.

Keywords: *Arbitration, Albania, dispute resolution, legal reform, internationalization.*

1. Hyrje

Arbitrazhi si mekanizëm alternativ i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ka njohur një rritje të konsiderueshme në praktikën juridike shqiptare, veçanërisht pas miratimit të ligjit të ri mbi arbitrazhin, i cili synon të përmirësojë kuadrin rregullator dhe të harmonizojë procedurat me standardet ndërkombëtare. Ky ligj është projektuar për të siguruar një proces më transparent, efikas dhe të besueshëm për palët që zgjedhin arbitrazhin si një mjet për zgjidhjen e konflikteve jashtë gjykatave “*tradicionale*” shtetërore.

Në këtë kuadër, ky studim synon të analizojë ligjin e ri mbi arbitrazhin, duke e krahasuar me bazën ligjore të mëparshme dhe me modelet e vendeve të Bashkimit Evropian (BE), të cilat janë marrë si referencë për standardizimin e praktikave të arbitrazhit. Për këtë qëllim, analiza do të shqyrtohet në disa aspekte si ndryshimet kryesore që ka sjellë legjislacioni i ri, përfshirë rregullimet mbi kompetencën e trupave të arbitrazhit, mënyrën e zgjedhjes së arbitrit, ekzekutimin e vendimeve të gjykatës së arbitrazhit dhe garantimin e pavarësisë dhe paanshmërisë në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare¹ dhe Konventën e Nju Jorkut mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit.

Analiza do të mbështetet në të dhëna dhe interpretime akademike për të identifikuar ndikimin e ndryshimeve ligjore në praktikën e arbitrazhit në Shqipëri. Në këtë drejtim, do të vlerësohet edhe sesi ky ligj ka ndikuar në lehtësimin e procedurave për palët, rritjen e besimit të investitorëve të huaj dhe përmirësimin e klimës së biznesit në vend. Duke iu referuar literaturës ndërkombëtare mbi arbitrazhin (Redfern & Hunter, 2015)², studimi do të bëjë një krahasim të aspekteve normative dhe praktike të sistemit shqiptar të arbitrazhit me ato të vendeve të BE-së, duke synuar të evidentojë përparësitë dhe mangësitë e tij. Ky krahasim do të ndihmojë në formulimin e rekomandimeve për përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar mbi arbitrazhin dhe përshtatjen e tij me standardet më të mira ndërkombëtare.

Ligji i ri është një hap i rëndësishëm drejt harmonizimit të sistemit ligjor shqiptar me standardet ndërkombëtare, duke reflektuar parimet e “*UNCITRAL Model Law on International Commercial Arbitration*”³ e cila ofron një bazë ligjore të njohur ndërkombëtare për rregullimin e arbitrazhit ndërkombëtar⁴, si dhe “*Konventës së Nju Jorkut për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj (New York Convention, 1958)*”⁵, që garanton njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të arbitrazhit të marra në shtete të ndryshme. Kjo përputhje me instrumentet ndërkombëtare jo vetëm që ndihmon në përmirësimin e kornizës ligjore shqiptare, por gjithashtu forcon besimin e komunitetit ndërkombëtar mbi arbitrazhin si një mjet efikas dhe i paanshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në Shqipëri. Për më tepër, kjo “*reformë*” krijon bazën për zhvillimin e një praktike të

¹ Paulsson, Jan. (1983), “*Delocalisation of International Commercial Arbitration: When and Why It Matters.*” *The International and Comparative Law Quarterly* 32, nr. 1: f. 53–61.

² Redfern, Alan, and Hunter, Martin. (2015), “*Law and Practice of International Commercial Arbitration*”. 5th ed. Sweet & Maxwell.

³ UNCITRAL Model Law on International Commercial Arbitration (1985), with amendments as adopted in 2006, i aksesueshëm në faqen web; https://uncitral.un.org/en/texts/arbitration/modellaw/commercial_arbitration

⁴ Sanders, Peter. (2018), “*The Work of UNCITRAL on Arbitration and Conciliation.*” *Arbitration International* 34, nr. 2; f. 265-287.

⁵ United Nations Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Arbitral Awards (New York, 10 June 1958), i aksesueshëm në faqen web; <https://www.newyorkconvention.org/english>

qëndrueshme të arbitrazhit, duke reduktuar ngarkesën e gjykatave dhe duke i dhënë një impuls pozitiv zhvillimit të një kulture juridike moderne dhe të orientuar drejt integritimit europian.

2. Arbitrazhi dhe zhvillimi i tij në Shqipëri

Historikisht, arbitrazhi në Shqipëri ka qenë i rregulluar nga Kodi i Procedurës Civile⁶ dhe disa dispozita të veçanta, të cilat nuk ofronin një kornizë të qartë dhe të standardizuar për funksionimin e tij. Rregullimet e mëparshme ligjore shpesh linin hapësira për interpretime të ndryshme dhe nuk siguronin një mekanizëm të efektshëm për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të arbitrazhit, sidomos në raport me praktikën ndërkombëtare. Kjo situatë krijonte pasiguri për bizneset dhe investitorët e huaj, të cilët shpesh preferonin zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre përmes gjykatave ndërkombëtare ose institucioneve të njohura të arbitrazhit jashtë vendit. Me miratimin e “Ligjit të Ri për Arbitrazhin” në vitin 2023⁷, u hodh një hap i rëndësishëm dhe u krijua një urë lidhëse në drejtim të modernizimit dhe harmonizimit të kuadrit ligjor shqiptar me standardet ndërkombëtare. Ky ligj synon të sigurojë një bazë më të qartë për zbatimin e arbitrazhit, duke përafuar sistemin shqiptar me “Model Law të UNCITRAL (UNCITRAL, 1985)”⁸ dhe Konventën e Nju Jorkut për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj (New York Convention, 1958)⁹.

Një nga risitë më të rëndësishme të këtij ligji është rregullimi i qartë i procedurës së arbitrazhit, duke adresuar çështje të tilla si: a) *Zgjedhja dhe kompetenca e trupave të gjykatës së arbitrazhit*, nga ku ligji i ri parashikon një proces më transparent për emërimin e arbitrit, duke ofruar më shumë fleksibilitet për palët dhe duke garantuar pavarësinë e tyre; b) *Mekanizmat për mbrojtjen e paanshmërisë*, të cilat përcaktojnë rregulla të reja që sigurojnë se arbitrat nuk kanë konflikte interesi dhe respektojnë parimet e drejtësisë procedurale; c) *Ekzekutimi i vendimeve të gjykatës së arbitrazhit*, ku vetë ligji forcon rregullat për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të arbitrazhit, duke përmirësuar efikasitetin e zbatimit të tyre në Shqipëri dhe jashtë saj; dhe së fundmi d) *Përafrimi me modelet e BE-së*, sepse përveç UNCITRAL dhe Konventës së Nju Jorkut, ligji merr në konsideratë praktikën më të mira të vendeve të BE-së për arbitrazhin, duke synuar një integrim më të shpejtë dhe efikas në “*tregun juridik*” europian.

Një tjetër aspekt thelbësor është ndikimi që ky ligj pritet të ketë në frymën dhe mjedisin e biznesit në Shqipëri, duke garantuar një kornizë ligjore më të besueshme dhe efikase për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve¹⁰, gjithashtu synohet që arbitrazhi të bëhet një mekanizëm më i preferuar nga kompanitë vendase dhe ato të huaja. Kjo “*reformë*” ka si qëllim kryesor që të rrisë besimin e investitorëve të huaj, duke u siguruar atyre një mekanizëm të qartë dhe të paanshëm për mbrojtjen e interesave të tyre në rast konflikti.

⁶ Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës Së Shqipërisë”, neni 400 i K.P.C., Qendra e Botimeve Zyrtare i aksesueshëm në faqen web; https://qzb.gov.al/share/fAENcg_oSWqEK_JWHBt2rg

⁷ Ligji Nr. 52/2023, “Për Arbitrazhin Në Republikën e Shqipërisë”, Qendra e Botimeve Zyrtare, i aksesueshëm në faqen web; <https://qzb.gov.al/share/reEmtZ7vRIeLkwpoUgrLbA>

⁸ UNCITRAL Model Law on International Commercial Arbitration (1985), i aksesueshëm në faqen web; https://uncitral.un.org/sites/uncitral.un.org/files/media-documents/uncitral/en/06-54671_ebook.pdf

⁹ United Nations Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Arbitral Awards (New York, 10 June 1958), i aksesueshëm në faqen web; <https://www.newyorkconvention.org/english>

¹⁰ Paulsson, Jan. (2015), “*Delocalization of International Commercial Arbitration: When and Why It Matters.*”, *Arbitration International* 31, nr. 3; f. 419-433.

Në këtë mënyrë, ligji i ri për arbitrazhin¹¹ përfaqëson një përmirësim të rëndësishëm në sistemin ligjor shqiptar, duke ndihmuar në zhvillimin e një mjedisi më të favorshëm për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve dhe respektivisht duke reduktuar ngarkesën e gjykatave shtetërore. Përveç kësaj, ai krijon një bazë të qëndrueshme për një integrim më të thellë të Shqipërisë në tregun evropian dhe global të arbitrazhit, duke patur qëllimin dhe përfaqjen pozitive të vendosjes së vendit në një pozicion më konkurrues në këtë fushë.

3. Analiza krahasimore e ligjit të ri të arbitrazhit

3.1 Ndryshimet kryesore nga baza ligjore e mëparshme

Ligji i ri për arbitrazhin në Shqipëri sjell përmirësime të ndjeshme në kuadrin ligjor, duke synuar rritjen e efektivitetit, pavarësisë dhe efikasitetit të procesit e arbitrazhit. Këto ndryshime kanë për qëllim përafrimin e sistemit shqiptar me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e vendeve të Bashkimit Evropian.

3.1.1 Pavarësia e trupave të gjykatës së arbitrazhit

Një nga risitë më të rëndësishme të ligjit të ri është garantimi i një autonomie më të madhe për gjykatat e arbitrazhit, duke kufizuar ndërhyrjen e gjykatave shtetërore në procesin e arbitrazhit. Sipas nenit 11 të Ligjit për Arbitrazhin (2023)¹², ndërhyrja e gjykatave është e kufizuar në raste specifike, si ndihma në caktimin e masave të përkohshme¹³, të cilat mund të jenë të nevojshme për të mbrojtur të drejtat e palëve gjatë procesit të arbitrazhit, gjithashtu edhe në rastet kur kompetenca e gjykimit është jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë¹⁴.

3.1.2 Ekzekutimi i vendimeve të gjykatës së arbitrazhit (nëse njëra palë nuk i bindet vendimit vullnetarisht)

Në kuadrin e rregullimeve të mëparshme, gjykatat kishin më shumë hapësirë për të ndërhyrë në proceset e arbitrazhit, shpesh duke krijuar vonesa dhe duke dobësuar parimin e autonomisë së vetë procesit. Me ligjin e ri, ky mekanizëm është forcuar duke e afuar Shqipërinë me parimet dhe standartet e UNCITRAL Model Law (1985)¹⁵ dhe Konventën e Nju Jorkut (1958)¹⁶.

3.2 Procesi i përzgjedhjes dhe kompetencat e arbitrave

Ligji i ri vendos një mekanizëm më të qartë dhe transparent për emërimin dhe shkarkimin e arbitrave. Ky ndryshim ka si synim të forcojë besueshmërinë dhe paanësinë e trupave të gjykatës së arbitrazhit. Sipas interpretimit të nenit 15 të Ligjit për Arbitrazhin (2023)¹⁷, janë vendosur kritere të qarta për kualifikimin e arbitrave, duke përfshirë: **a)** ekspertizën e tyre në fushën juridike dhe arbitrazhin ndërkombëtar; **b)** kufizime në

¹¹ Ligji Nr. 52/2023, “Për Arbitrazhin Në Republikën e Shqipërisë”, Qendra e Botimeve Zyrtare, i aksesueshëm në faqen web; <https://qbz.gov.al/share/reEmtZ7vRIeLkwoUgrLbA>

¹² Ibid, neni 11, f. 3.

¹³ Ibid, neni 23, f. 7.

¹⁴ Ibid, neni 11, paragrafi II (2), f. 3.

¹⁵ UNCITRAL Model Law on International Commercial Arbitration (1985), with amendments as adopted in 2006, i aksesueshëm në faqen web; https://uncitral.un.org/en/texts/arbitration/modellaw/commercial_arbitration

¹⁶ United Nations Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Arbitral Awards (New York, 10 June 1958), i aksesueshëm në faqen web; <https://www.newyorkconvention.org/english>

¹⁷ Ligji Nr. 52/2023, “Për Arbitrazhin Në Republikën e Shqipërisë”, neni 15, Qendra e Botimeve Zyrtare, i aksesueshëm në faqen web; <https://qbz.gov.al/share/reEmtZ7vRIeLkwoUgrLbA>

emërimin e arbitrave që mund të kenë konflikt interesi¹⁸ me palët; dhe së fundmi c) rregulla të qarta për përjashtimin e arbitrave, në rastet kur ata nuk plotësojnë standardet e paanësisë ose kanë shkelur parimet e procedurës¹⁹. Në ligjin e mëparshëm, këto aspekte nuk ishin të rregulluara qartë, duke lejuar situata ku një palë mund të sfidonte përbërjen e trupit arbitral pa kritere të përcaktuara qartë, por modeli i ri i ndjekur nga Shqipëria është në përputhje me nenin 12 të UNCITRAL Model Law²⁰, i cili parashikon procedura të standardizuara për shkarkimin e arbitrave²¹ nëse ata nuk janë të pavarur apo të paanshëm.

3.3 Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të gjykatës së arbitrazhit

Një nga aspektet më problematike të sistemit të mëparshëm ishte vonesa e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të arbitrazhit, veçanërisht atyre të huaja, por tashmë ligji i ri synon të adresojë këtë problem duke vendosur procedura të përsheptuara dhe duke reduktuar pengesat administrative dhe gjyqësore. Në bazë të nenit 5 të Konventës së Nju Jorkut (1958)²², vendimet e arbitrazhit të huaj mund të refuzohen nga një gjykatë kombëtare vetëm në rrethana të kufizuara, të tilla si:

- 1) Nëse vendimi bie ndesh me rendin publik të shtetit ku kërkohet ekzekutimi²³.
- 2) Nëse arbitrazhi është zhvilluar në mënyrë të padrejtë, duke shkelur parimet bazë të “*due process*”²⁴.

Ligji i ri shqiptar i reflekton këto parime²⁵ më së miri dhe gjithashtu parashikon një afat kohor më të shkurtër, si një angazhim për realizimin e detyrave dhe qëllimeve me standarde të larta profesionale, duke siguruar që proceset të zhvillohen me kujdes dhe përkushtim, duke optimizuar përdorimin e burimeve dhe arritur rezultate të dukshme dhe të matshme për shqyrtimin e kërkesave për ekzekutim, dhe e gjithë kjo suazë e ndryshimit synon të rrisë sigurinë ligjore për investitorët e huaj dhe vëndas dhe subjektet që zgjedhin Shqipërinë si vend për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përmes arbitrazhit.

Ndryshimet e sjella nga ligji i ri për arbitrazhin në Shqipëri përfaqësojnë një hap të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor, duke e bërë arbitrazhin një mekanizëm më të besueshëm dhe të efektshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Me forcimin e pavarësisë së gjykatave të arbitrazhit²⁶, rregulla më të qarta për

¹⁸ Ligji Nr. 52/2023, “Për Arbitrazhin Në Republikën e Shqipërisë”, neni 18, faqe 5, Qendra e Botimeve Zyrtare, i aksesueshëm në faqen web; <https://qbz.gov.al/share/reEmtZ7vRIeLkwpoUgrLbA>

¹⁹ Ibid, neni 17, f. 5.

²⁰ UNCITRAL Model Law on International Commercial Arbitration (1985), neni 18, i aksesueshëm në faqen web; https://uncitral.un.org/sites/uncitral.un.org/files/media-documents/uncitral/en/06-54671_ebook.pdf

²¹ Ligji Nr. 52/2023, “Për Arbitrazhin Në Republikën e Shqipërisë”, neni 18, f. 5, Qendra e Botimeve Zyrtare, i aksesueshëm në faqen web; <https://qbz.gov.al/share/reEmtZ7vRIeLkwpoUgrLbA>

²² United Nations Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Arbitral Awards (New York, 10 June 1958), neni 5, i aksesueshëm në faqen web; <https://www.newyorkconvention.org/english>

²³ Ligji Nr. 52/2023, “Për Arbitrazhin Në Republikën e Shqipërisë”, neni 40, f. 13, Qendra e Botimeve Zyrtare, i aksesueshëm në faqen web; <https://qbz.gov.al/share/reEmtZ7vRIeLkwpoUgrLbA>

²⁴ Përkufizimi i *due process* “*procesit të rregullt ligjor*” nga Cambridge Advanced Learner's Dictionary & Thesaurus © Cambridge University Press; (*trajtimi i drejtë i një qytetari brenda rregullave të sistemit ligjor të një qeverie*).

²⁵ Ligji Nr. 52/2023, “Për Arbitrazhin Në Republikën e Shqipërisë”, neni 2, Qendra e Botimeve Zyrtare, i aksesueshëm në faqen web; <https://qbz.gov.al/share/reEmtZ7vRIeLkwpoUgrLbA>

²⁶ Ligji Nr. 52/2023, “Për Arbitrazhin Në Republikën e Shqipërisë”, neni 16, faqe 5, Qendra e Botimeve Zyrtare, i aksesueshëm në faqen web; <https://qbz.gov.al/share/reEmtZ7vRIeLkwpoUgrLbA>

zgjedhjen²⁷ dhe shkarkimin e arbitrave²⁸, si dhe lehtësimin e procedurave të ekzekutimit të vendimeve²⁹, ky ligj rrit ndjeshëm cilësinë dhe sigurinë e arbitrazhit në Shqipëri. Përafrimi me standardet ndërkombëtare³⁰, si ato të UNCITRAL dhe Konventës së Nju Jorkut, jo vetëm që e përmirëson kornizën ligjore të brendshme, por gjithashtu rrit konkurrueshmërinë e Shqipërisë si një qendër e mundshme për arbitrazhin rajonal apo edhe më tej.

4. Krahasimi me modelet e vendeve të BE-së

Në Bashkimin Evropian (BE), arbitrazhi është një mekanizëm thelbësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, veçanërisht në fushën e investimeve dhe tregtisë ndërkombëtare³¹. Vendet anëtare të BE-së kanë zhvilluar sisteme të ndryshme ligjore për arbitrazhin, por shumica e tyre ndjekin standardet ndërkombëtare si UNCITRAL Model Law (1985)³² dhe Konventën e Nju Jorkut (1958)³³ për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit. Disa nga modelet më të rëndësishme në Evropë përfshijnë:

4.1 Modeli Gjerman

Gjermania ka një nga sistemet më të forta dhe të qëndrueshme të arbitrazhit në Evropë, i cili është rregulluar nga Kodi i Procedurës Civile (Zivilprozessordnung – ZPO, 1998)³⁴, pikërisht në nenin 1030³⁵ të këtij kodi ku paraqitet arbitrazhi dhe termat specifik. Ky kod është plotësisht i harmonizuar me UNCITRAL Model Law³⁶, duke siguruar një proces të pavarur dhe të mbrojtur nga ndërhyrjet gjyqësore. Karakteristikat kryesore të modelit gjerman përfshijnë: **a)** autonomi të lartë të gjykatave të arbitrazhit, duke lejuar palët të përcaktojnë procedurat e arbitrazhit sipas nevojave të tyre; **b)** ndërhyrje të kufizuar të gjykatave shtetërore, të cilat mund të përfshihen vetëm në raste të veçanta si shfuqizimi i vendimeve për shkak të shkeljeve procedurale ose ekzekutimi i vendimeve të gjykatave të arbitrazhit; dhe gjithashtu **c)** një proces të qartë dhe të përsheptuar për ekzekutimin e vendimeve, duke shmangur burokracinë dhe vonesat administrative.

²⁷ Ligji Nr. 52/2023, “Për Arbitrazhin Në Republikën e Shqipërisë”, neni 16, f. 5, Qendra e Botimeve Zyrtare, i aksesueshëm në faqen web; <https://qbz.gov.al/share/reEmtZ7vRIeLkwpoUgrLbA>.

²⁸ Ibid, neni 17, f. 5.

²⁹ Ibid, neni 46, f. 46.

³⁰ *International council for commercial arbitration guidelines on standards of practice in international arbitration*” The Icca reports nr. 9, 2021, dokument i aksesueshëm në faqen web; https://cdn.arbitration-icca.org/s3fs-public/document/media_document/ICCA_Guidelines_on_Standards_of_Practice_in_International_Arbitration.pdf

³¹ Gáspár-Szilágyi, Szilárd, Daniel Behn, and Malcolm Langford, eds. “*Adjudicating Trade and Investment Disputes: Convergence or Divergence?*” of *Studies on International Courts and Tribunals*.” Cambridge: Cambridge University Press, 2020.

³² UNCITRAL Model Law on International Commercial Arbitration (1985), i aksesueshëm në faqen web; https://uncitral.un.org/sites/uncitral.un.org/files/media-documents/uncitral/en/06-54671_ebook.pdf

³³ United Nations Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Arbitral Awards (New York, 10 June 1958), i aksesueshëm në faqen web; <https://www.newyorkconvention.org/english>

³⁴ Zivilprozessordnung ZPO Ausfertigungsdatum (Kodi i Procedurës Civile së Gjermanisë (ZPO): 12.09.1950, dokument i aksesueshëm në faqen web; <https://www.gesetze-im-internet.de/zpo/ZPO.pdf>

³⁵ Ibid § Kreu: Arbitrazhi, Neni 1030, i aksesueshëm në faqen web; https://www.gesetze-im-internet.de/zpo/_1030.html

³⁶ “*UNCITRAL Model Law on International Commercial Arbitration (1985), With Amendments as Adopted in 2006 | United Nations Commission on International Trade Law*”, n.d. https://uncitral.un.org/en/texts/arbitration/modellaw/commercial_arbitration.

Kjo qasje e bën Gjermaninë një nga vendet më të preferuara për zhvillimin e arbitrazhit ndërkombëtar, veçanërisht për mosmarrëveshjet tregtare dhe investimet ndërkufitare³⁷.

4.2 Modeli Francez

Franca është një nga juridiksionet më inovative në Evropë në fushën e arbitrazhit, dhe “Ligji Francez i Arbitrazhit” (Decree No. 2011-48 of 13 January 2011)³⁸ konsiderohet një nga ligjet më fleksibël në kontinent. Ky model ka disa veçori të rëndësishme: **a)** thekson shpejtësinë dhe efikasitetin e procesit të arbitrazhit, duke eliminuar pengesat burokratike dhe duke përshpejtuar procedurat e vendimmarrjes; **b)** gjykatat e arbitrazhit kanë kompetencë të gjerë, që do të thotë se ato mund të vendosin mbi juridiksionin e tyre pa pasur nevojë për verifikim nga një gjykatë shtetërore; dhe **c)** mekanizma të kufizuara për ankimim, duke e bërë më të vështirë për palët që të vonojnë ekzekutimin e vendimeve përmes procedurave gjyqësore.

Në thelb, arbitrazhi francez është menduar si një mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë natyrë ekonomike. Kjo metodë mbështetet kryesisht në marrëveshjet kontraktuale midis palëve, duke ofruar një procedurë më të shpejtë dhe fleksibile se gjykatat tradicionale³⁹. Sidoqoftë, për arsye të rëndësishme së interesave publike dhe mbrojtjes së të drejtave themelore, disa çështje konsiderohen si “jo të arbitrueshme” të atilla çështjet jo-ekonomike si ato të kujdestarisë dhe të divorcit; a) *Divorci dhe çështjet familjare*; Në fushën e marrëdhënieve familjare, çështje si divorci dhe kujdestaria e fëmijëve përfshijnë elemente të ndjeshme dhe personale që shpesh lidhen me interesin më të lartë të individit dhe të fëmijës. Jurisprudenca franceze thekson se këto çështje nuk mund të mbështeten në një procedurë arbitrazhi, pasi ato nuk përbushin kriterin e mos-marreveshjeve ekonomike dhe kërkojnë një vlerësim të hollësishëm nga gjykatat shtetërore, të cilat kanë misionin e mbrojtjes së rendit publik dhe të drejtave themelore; b) *Të drejtat e patjetërsueshme*; Në ligjin francez, disa të drejta konsiderohen të patjetërsueshme, domethënë ato nuk mund të dorëzohen në mënyrë të plotë përmes marrëveshjeve private. Këto përfshijnë të drejta që mbrojnë dinjitetin, lirinë personale dhe integritetin e individit. Si rezultat, çdo përpjekje për të vendosur në arbitrim çështje që lidhen me këto të drejta konsiderohet e papranueshme, duke u mbështetur në parimin se “la convention d'arbitrage ne peut déroger aux règles d'ordre public⁴⁰”; c) *Çështjet që ndikojnë rendin publik*; Një tjetër kufizim i rëndësishëm është lidhur me çështjet që kanë ndikim të gjerë në rendin publik. Këto çështje përfshijnë raste ku vendimet mund të ndikojnë në interesin e përgjithshëm të shoqërisë nga ku zbatimi i një klauzole arbitrazhi mund të shkelë parimet bazë të rendit publik, siç mund të përmenden çështjet që prekin sigurimin e të drejtave themelore dhe mbrojtjen e individit.

4.2.1 Dispozitat legjislative

Ligji francez, përmes dispozitave të Kodit të Procedurës Civile⁴¹, përcakton se arbitrazhi funksionon vetëm në mosmarrëveshjet ku interesi kryesor është ekonomik. Në rastet kur bëhet fjalë për çështje familjare, të drejta të patjetërsueshme ose rend publike, dispozitat kontraktuale nuk mund të tejkalohen. Kjo do të thotë se, edhe nëse

³⁷ BMWK - Federal Ministry for Economic Affairs and Climate Action. “Investment Protection”, <https://www.bmwk.de/Redaktion/EN/Artikel/Foreign-Trade/investment-protection.html>.

³⁸ Decree No. 2011-48 of 13 January 2011, (*Ligji Francez mbi Arbitrazhin*)* reforming the law governing arbitration, i aksesueshëm në faqen web; <https://parisarbitration.com/wp-content/uploads/2023/10/EN-French-Law-on-Arbitration-1.pdf>

³⁹ Van den Berg, Albert J. (2016) “Enforcement of Arbitral Awards Annulled in Their Country of Origin.” *Journal of International Arbitration* 33, nr. 2: 179-208.

⁴⁰ De Boissésion M., Madesclair J., Fouchard C., (March 2023), Le droit français de l'arbitrage “Section 5 - Arbitrabilité Et Ordre Public | La Base Lextenso”, i aksesueshëm në faqen web; <https://www.labase-lextenso.fr/ouvrage/9782275133676-263>. (*marrëveshja e arbitrazhit nuk mund të shmangë rregullat e rendit publik*)

⁴¹ French Code of Civil Procedure (1981) - BOOK IV - ARBITRATION IN FORCE 14 MAY 1981, i aksesueshëm në faqen web; <https://mitchellhamline.edu/wp-content/uploads/sites/18/2016/05/DOC-9-French-Code-of-Civil-Procedure.pdf>.

palët përfshihen në një marrëveshje arbitrazhi, gjykatat publike ruajnë kompetencën për t'u shprehur mbi këto këto çështje unanimisht.

4.2.2 *Jurisprudenca kryesore*

Gjatë viteve, disa vendime të Cour de Cassation⁴² kanë forcuar këtë linjë të mendimit, nga ku parashtrahet edhe në një vendim të dhënë nga gjykata e lartë Franceze nga ku thekson se: "*La convention d'arbitrage ne peut déroger aux règles d'ordre public, notamment en matière matrimoniale et familiale, afin de préserver l'intérêt supérieur de la personne et de l'enfant*"⁴³. Ky citim, megjithëse i përmbledhur, përfaqëson thelbin e argumentit ligjor që mbështet pamundësinë e arbitrazhit në çështje të tilla .

Po edhe autorët e doktrinës në fushën e arbitrazhit, siç janë analizat publikuara në *Revue de l'Arbitrage*⁴⁴ dhe në botimet e Dalloz⁴⁵, argumentojnë se përjashtimi i çështjeve jo-ekonomike nga fushat e arbitrazhit mbetet një garanci thelbësore për mbrojtjen e interesave publike dhe individuale. Këto vepra doktrimore theksojnë se arbitrazhi nuk duhet të përdoret për çështje që, për shkak të natyrës së tyre kërkojnë një vlerësim më të hollësishëm nga gjykata publike. Ky model e ka bërë Francën një nga qendrat kryesore të arbitrazhit ndërkombëtar, veçanërisht për mosmarrëveshjet që përfshijnë korporatat dhe investitorët e huaj, nga ku përmendim sesi Parisi është një nga destinacionet më të njohura për zhvillimin e arbitrazhit ndërkombëtar, përkrah Londrës dhe Zyrihut.

5. Direktivat e BE-së mbi arbitrazhin

Bashkimi Evropian ka miratuar disa direktiva dhe rregullore⁴⁶ që promovojnë një qasje të unifikuar ndaj arbitrazhit mes vendeve anëtare. Këto përfshijnë: EU ADR Directive (2013)⁴⁷; Kjo direktivë promovon zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ADR)⁴⁸ dhe kërkon që shtetet anëtare të BE-së të sigurojnë që ligjet e tyre kombëtare për arbitrazhin të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare⁴⁹. Synimi dhe qëllimi kryesor është që të sigurojë funksionimin efektiv të mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, duke kërkuar që legjislacionet kombëtare të harmonizohen me standardet ndërkombëtare të arbitrazhit, dhe pikërisht ligji më i ri shqiptar mbi arbitrazhin reflekton këtë qasje, duke përmirësuar kuadrin ligjor procedural dhe institucional në përputhje me *acquis communautaire*, dhe duke garantuar një mekanizëm të pavarur, të drejtë dhe funksional për

⁴² "*Cour de Cassation*", i aksesueshëm në faqen web; <https://www.courdecassation.fr/la-cour>.

⁴³ Diallo, Ousmane. (2010), "*Chapitre II. Le consentement à l'arbitrage, manifestation d'une volonté contenue*". In *Le consentement des parties à l'arbitrage international*. Genève: Graduate Institute Publications. <https://doi.org/10.4000/books.iheid.967>. (*Marrëveshja e arbitrazhit nuk mund të devijojë nga rregullat e rendit publik, veçanërisht në çështjet martesore dhe familjare, për të ruajtur interesat më të mira të personit dhe fëmijës.*)

⁴⁴ "*Revue De L'arbitrage*." n.d. <https://kluwerlawonline.com/Journals/Revue+de+l%E2%80%99arbitrage/745>.

⁴⁵ "*Chronique D'arbitrage : La Cour De Cassation Fait (Encore) De L'arbitrage Sans Le Savoir*." n.d. Arbitrage - Médiation - Conciliation | Dalloz Actualité. <https://www.dalloz-actualite.fr/flash/chronique-d-arbitrage-cour-de-cassation-fait-encore-de-l-arbitrage-sans-savoir>.

⁴⁶ "*Arbitration Clause - EUR-Lex*.", i aksesueshëm në faqen web; https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=LEGISSUM:arbitration_clause.

⁴⁷ "*Explanatory Memorandum to COM(2023)649 - Amendment of Directive 2013/11/EU on Alternative Dispute Resolution for Consumer Disputes, as Well as Directives (EU) 2015/2302, (EU) 2019/2161 and (EU) 2020/1828 - EU Monitor*." https://www.eumonitor.eu/9353000/1/j4nvhdffdk3hydzq_j9vvik7m1c3gyxp/vm7es0m4cdrs#:~:text=Directive%202013%2F11%2FEU%201,out%2Dof%2Dcourt%20procedures.

⁴⁸ *Alternative dispute resolution for consumers*. (2023, October 17). European Commission. https://commission.europa.eu/live-work-travel-eu/consumer-rights-and-complaints/resolve-your-consumer-complaint/alternative-dispute-resolution-consumers_en

⁴⁹ "*Arbitration Clause - EUR-Lex*", https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=legissum:arbitration_clause.

zgjdhjen e mosmarrëveshjeve. Ky përafrim përforcon shtetin e së drejtës dhe mbështet integrimin e mëtejshëm të vëndit.

- Rregullorja e Brukselit I (Recast, 2012)⁵⁰; Kjo rregullore ndihmon në harmonizimin e procedurave për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave arbitrazhit mes vendeve të BE-së, duke reduktuar pengesat ligjore dhe burokratike dhe pikërisht qasja dhe reformimi ligjor mbi arbitrazhin në vëndin tonë ka mundur që të mbajë të njëjtën suazë mbi harmonizimin e mëtejshëm dhe në përputhje me *acquis communautaire*.
- Konventa e Nju Jorkut (1958)⁵¹; Edhe pse nuk është një instrument i BE-së, të gjitha shtetet anëtare janë palë të kësaj konvente, e cila kërkon që vendimet e arbitrazhit të huaj të njihen dhe të ekzekutohen në të gjitha juridiksionet e BE-së, përveç në rastet kur bien në kundërshtim me rendin publik⁵² të shtetit përkatës.

Këto standarde sigurojnë një nivel të lartë mbrojtjeje për palët që zgjedhin arbitrazhin si mekanizëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke garantuar një zbatim të unifikuar dhe efikas të vendimeve të arbitrazhit në të gjithë BE-në por jo vetëm, sepse pasqyrimi i nismave ligjvënëse del në pah edhe me ligjin e ri të vëndit tonë.

6. Krahasimi me Shqipërinë

Ligji i ri për arbitrazhin në Shqipëri⁵³, i miratuar në vitin 2023, synon të përafrohet me modelet evropiane, duke adoptuar disa nga karakteristikat kryesore të sistemeve të BE-së dhe nga ku reflekton një integrim të menduar dhe të balancuar të parimeve ndërkombëtare që kanë qenë objekt studimi në të drejtat krahasimore dhe në analizën e sistemeve arbitruese. Ky interpretim akademik përmbledhet në disa aspekte kyçe:

6.1 *Autonomia e procedurës së arbitrazhit dhe kufizimi i ndërhyrjes*

Në linjë me modelin gjerman, ligji i ri synon të garantojë autonominë e institucioneve të arbitrazhit duke kufizuar ndërhyrjen e gjykatave në çështje që lidhen me procedurën arbitruese. Ky parim, i bazuar në ndarjen e kompetencave, siguron që vendimet e arbitrazhit të merren brenda një kornize të pavarur dhe të specializuar, duke minimizuar ndërhyrjet gjyqësore që mund të ndikojnë në shpejtësinë dhe efektivitetin e gjithë procesit.

6.2 *Shpejtësia, fleksibiliteti procedural dhe reduktimi i burokracisë*

Duke ndjekur qasjen e modelit francez, ligji i ri thekson rëndësinë e një procesi arbitrazhi të shpejtë dhe fleksibël. Në këtë kontekst, eliminohen pengesat burokratike që shpesh e ngadalësojnë procedurën gjyqësore tradicionale. Kjo qasje jo vetëm që përmirëson efikasitetin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, por gjithashtu nxit një klimë më të favorshme për aktivitetet ekonomike dhe mbi të gjitha investimet.

⁵⁰ Regulation (EU) No 1215/2012 of the European Parliament and of the Council of 12 December 2012 on jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in civil and commercial matters (recast), rregullore e aksesueshme në faqen web; <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2012/1215/oj/eng>

⁵¹ United Nations Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Arbitral Awards (New York, 10 June 1958), i aksesueshëm në faqen web; <https://www.newyorkconvention.org/english>

⁵² Ibid, neni 5.

⁵³ Ligji Nr. 52/2023, “Për Arbitrazhin Në Republikën e Shqipërisë”, Qendra e Botimeve Zyrtare, i aksesueshëm në faqen web; <https://qbz.gov.al/share/reEmtZ7vRIeLkwpouUgrLbA>

6.3 Harmonizimi me standardet ndërkombëtare dhe ekzekutimi i vendimeve të gjykatave të huaja të arbitrazhit

Përputhja me direktivat e Bashkimit Evropian është një element thelbësor në ligjin e ri, ky harmonizim siguron që vendimet e arbitrazhit, qoftë ato të brendshme apo të huaja, të njohin dhe ekzekutohen në përputhje me standardet ndërkombëtare. Për këtë arsye, Shqipëria pozicionohet si një destinacion i besueshëm për arbitrazhin tregtar, duke ofruar një kornizë ligjore që mbështet parimet e sigurisë dhe parashikueshmërisë së transaksioneve ndërkombëtare.

Qasja dhe logjika juridike midis ligjit të ri dhe modeleve ndërkombëtare të arbitrazhit është e dukshme në integrimin e tre komponentëve kryesorë:

- 1) *Autonomia dhe kufizimi i ndërhyrjes*; Sigurimi i një procesi të arbitrazhit në mënyrë të pavarur dhe specializuar, në përputhje me parimet gjermane.
- 2) *Efikasiteti procedural*; Theksimi i shpejtësisë dhe fleksibilitetit, duke reduktuar burokracinë dhe pengesat, siç ilustron në modelin francez.
- 3) *Harmonizimi ndërkombëtar*; Implementimi i direktivave të BE-së, që kontribuon në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të huaja të arbitrazhit sipas standardeve ndërkombëtare.

Ky integrim i parimeve ndërkombëtare jo vetëm që rrit efikasitetin dhe transparencën e procesit të arbitrazhit, por gjithashtu forcon pozitën e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, duke e bërë sistemin e saj të arbitrazhit më të besueshëm dhe të përputhshëm me normat moderne juridike.

Ligji i ri mbi arbitrazhin i Republikës së Shqipërisë përfaqëson një pikë kthesë strategjike në modernizimin dhe integrimin e mekanizmave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, duke u përpjekur të adresojë sfidat historike dhe të përputhet me standardet ndërkombëtare, megjithatë, ndryshe nga juridiksionet e konsoliduara evropiane⁵⁴, Shqipëria ende përballet me sfida në implementimin praktik të arbitrazhit.

Historikisht, përdorimi i arbitrazhit në Shqipëri ka qenë më i kufizuar krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian, ku arbitrazhi konsiderohet një mjet standard për investitorët dhe bizneset. Kjo mungesë e praktikës është reflektim i një tradite juridike që nuk ka përfshirë në mënyrë të gjerë këtë mekanizëm zgjidhës. Ligji i ri synon që të kapërcejë këtë mospërputhje duke adoptuar standarde ndërkombëtare, nga ku kjo do të përmirësojë besueshmërinë e vendimeve të arbitrazhit dhe do të nxisë integrimin në rrjetin ndërkombëtar juridik. Përmendim një prej sfidave më të mëdha që ka penguar zhvillimin e arbitrazhit në Shqipëri që është mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të arbitrave të kualifikuar, por ligji i ri fokusohet në rritjen e trajnimeve dhe certifikimit profesional dhe krijimin e një sistemi monitorimi cilësor, por gjithashtu krijimi i një mjedisi institucional të fortë që është thelbësor për funksionimin e suksesshëm të arbitrazhit. Krahasimi i modelit shqiptar të arbitrazhit me modelet e vendeve të BE-së tregon një përafrim të rëndësishëm me praktikën më të mira evropiane, veçanërisht në fushën e pavarësisë së gjykatave të arbitrazhit, ekzekutimit të vendimeve dhe harmonizimit me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, për të siguruar një implementim të plotë dhe të suksesshëm, Shqipëria duhet të fokusohet në zbatimin praktik të reformave, duke forcuar institucionet e arbitrazhit dhe besimin e investitorëve në këtë mekanizëm. Adaptimi i mëtejshëm i standardeve të BE-së mund ta bëjë Shqipërinë një vend më konkurrues në tregun rajonal të arbitrazhit apo edhe më gjërë.

7. Sfidat dhe rekomandimet për përmirësimin e arbitrazhit në shqipëri

⁵⁴ "Arbitration Clause - EUR-Lex," i aksesueshëm në faqen web; https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=legissum:arbitration_clause.

Pavarësisht reformave ligjore dhe përafrimit me standardet evropiane, arbitrazhi në Shqipëri përballet ende me disa sfida të rëndësishme që pengojnë funksionimin e tij si një mekanizëm efektiv për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Për të arritur një sistem arbitrazhi të qëndrueshëm dhe të besueshëm, është e nevojshme adresimi i problemeve kryesore përmes politikave të qarta dhe masave konkrete.

7.1 Pavarësia e institucioneve të arbitrazhit

Një nga sfidat kryesore në Shqipëri është garantimi i pavarësisë së institucioneve të arbitrazhit nga ndërhyrjet politike ose institucionale. Pavarësia e gjykatave të arbitrazhit është një parakusht thelbësor për sigurinë juridike dhe besimin e palëve në këtë mekanizëm të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (Born, 2021⁵⁵). Në shumë raste, ndikimi politik ose ndërhyrja e institucioneve shtetërore mund të dëmtojë integritetin e procesit të arbitrazhit. Kjo mund të ndodhë përmes presionit mbi arbitrat, ose përmes vendimeve të gjykatave kombëtare që ndërhyjnë në procesin e arbitrazhit ose refuzojnë të zbatojnë vendimet e tij.

Forcimi i autonomisë së institucioneve të arbitrazhit duke i dhënë atyre një status të qartë dhe të mbrojtur nga ligji, i cili garanton pavarësinë e arbitrave dhe i ndalon institucionet shtetërore të ushtrojnë ndikim të padrejtë. Përafrimi me praktikën më të mira ndërkombëtare, si modelet e Francës dhe Gjermanisë, ku institucionet e arbitrazhit funksionojnë me rregulla të qarta që minimizojnë ndërhyrjen e jashtme. Rritja e transparencës⁵⁶ në përzgjedhjen e arbitrave, duke siguruar që procesi i emërimit të jetë i bazuar në kritere profesionale dhe jo në interesa politike.

7.2 Zbatimi efektiv i vendimeve të arbitrazhit

Ndërsa ligji i ri për arbitrazhin në Shqipëri ka përmirësuar ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të arbitrazhit, ende ekzistojnë probleme në nivel praktik (Gaillard & Savage, 2017⁵⁷), veçanërisht sa i përket qëndrimit të gjykatave shqiptare ndaj vendimeve të marra nga këto gjykata. Vonesat në ekzekutimin e vendimeve nga gjykatat shqiptare, të cilat shpesh kërkojnë procedura të gjata burokratike ose vendosin kufizime të pajustificuara ndaj zbatimit të vendimeve të arbitrazhit. Mosnjohja ose anulimi i vendimeve të huaja të arbitrazhit nga gjykatat shqiptare në disa raste ka mundësuar dhe ka krijuar pasiguri juridike për investitorët dhe bizneset që zgjedhin arbitrazhin si mekanizëm të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Trajnimi i gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore për të kuptuar dhe zbatuar në mënyrë të saktë dhe uniforme ligjin mbi arbitrazhin dhe për të garantuar ekzekutimin pa pengesa të vendimeve të arbitrazhit, dhe krijimi i një gjykate të specializuar për çështjet e arbitrazhit, siç është rasti në Francë dhe Mbretërinë e Bashkuar, ku gjykatat që merren me vendimet e arbitrazhit kanë ekspertizë të specializuar dhe përvojë në këtë fushë. Përmendim harmonizimi i plotë me Konventën e Nju Jorkut (1958)⁵⁸, duke siguruar që vendimet e arbitrazhit të huaj të njihen dhe ekzekutohen automatikisht, përveç rasteve kur ato vendime bien ndesh me rregullat e rendit publik.

7.3 Edukimi dhe ndërgjegjësimi mbi arbitrazhin

⁵⁵ Born, Gary. (2001); "*International Arbitration: Law and Practice.*", 3rd ed. Kluwer Law International.

⁵⁶ Bantekas, Ilias. (2020) "*Transparency in International Arbitration: A Comparative Analysis.*", The International Journal of Arbitration 36, nr. 1: f. 51-78.

⁵⁷ Gaillard, Emmanuel, and Savage, Jonathan. (2017); "*Fouchard, Gaillard, Goldman on International Commercial Arbitration.*" Kluwer Law International.

⁵⁸ United Nations Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Arbitral Awards (New York, 10 June 1958), i aksesueshëm në faqen web; <https://www.newyorkconvention.org/english>

Një nga faktorët kryesorë që ndikon në efikasitetin e sistemit të arbitrazhit në Shqipëri është mungesa e edukimit dhe ndërgjegjësimit të juristëve, avokatëve dhe gjyqtarëve mbi rregullat dhe praktikat e arbitrazhit ndërkombëtar (Craig, Park & Paulsson, 2018⁵⁹), nga ku efektivisht njohuritë e kufizuara të profesionistëve të drejtësisë mbi procedurat e arbitrazhit dhe veçanërisht për sa i përket standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të vendeve të BE-së. Përdorim i kufizuar i arbitrazhit nga bizneset dhe investitorët shqiptarë të cilët shpesh zgjedhin gjykatat tradicionale për shkak të mungesës së informacionit mbi përfitimet e arbitrazhit dhe elementi fundamental është mungesa e moduleve të specializuara mbi arbitrazhin në universitetet shqiptare, ç'ka e bën të vështirë krijimin e një brezi të ri juristësh me ekspertizë në këtë fushë por jo të pamundur.

Zhvillimi i programeve të trajnimit për avokatët, gjyqtarët dhe arbitrat shqiptarë, duke bashkëpunuar me institucione ndërkombëtare si ICC (International Chamber of Commerce⁶⁰) ose LCIA (London Court of International Arbitration⁶¹), si dhe futja e moduleve të detyrueshme mbi arbitrazhin ndërkombëtar në fakultetet e drejtësisë në Shqipëri për të rritur kapacitetet akademike dhe profesionale në këtë fushë do të ishte një hap i vogël në pikëpamje të parë por thelbësor në zhvillimin e mëtejshëm, por një hap tjetër pozitiv do të ishte organizimi i fushatave informuese për bizneset dhe investitorët mbi avantazhet e arbitrazhit duke promovuar zbatimin e klauzolave përcaktimore në kontratat tregtare dhe investuese. Për të garantuar një sistem arbitrazhi efikas, të besueshëm dhe tërheqës për investitorët, Shqipëria duhet të adresojë sfidat ekzistuese përmes reformave të mëtejshme në pavarësinë e institucioneve të arbitrazhit, zbatimin e vendimeve dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi arbitrazhin por gjithashtu duke ndjekur modelet e suksesshme të vendeve të BE-së, atëherë vendi ynë mund të sigurojë një sistem të fortë arbitrazhi që përmirëson klimën e biznesit dhe kontribuon në zhvillimin ekonomik dhe juridik.

8. Konkluzione

Ligji i ri i arbitrazhit në Shqipëri përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të sistemit të drejtësisë dhe harmonizimit me standardet e Bashkimit Evropian. Kjo reformë synon të krijojë një mjedis më të favorshëm për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, duke përmirësuar sigurinë juridike për investitorët dhe bizneset që zgjedhin arbitrazhin si një mekanizëm më efikas, të shpejtë dhe të besueshëm në krahasim me gjykatat tradicionale. Megjithatë, pavarësisht këtyre përparimeve legjislative sfidat e zbatimit të ligjit mbeten të ndjeshme dhe kërkojnë angazhim të vazhdueshëm nga institucionet përgjegjëse, komuniteti i juristëve dhe palët e interesuara, por problemet kryesore lidhen me ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të arbitrazhit, pavarësinë e institucioneve të arbitrazhit dhe rritjen e besimit të komunitetit të biznesit ndaj këtij mekanizmi alternativ të drejtësisë.

8.1 Sfida e ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të arbitrazhit

Një nga problemet më të rëndësishme mbetet zbatimi efektiv i vendimeve të arbitrazhit nga gjykatat shqiptare, nga ku pavarësisht përmirësimeve në kuadrin ligjor, në praktikë vonesat procedurale, interpretimet e ndryshme të ligjit nga gjykatat dhe mungesa e ekspertizës së mjaftueshme mbi arbitrazhin krijojnë pengesa në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve, veçanërisht kur bëhet fjalë për vendime të gjykatave të huaja të arbitrazhit.

⁵⁹ Craig, William L., Park, William W., and Paulsson, Jan. *International Chamber of Commerce Arbitration*. 4th ed. Oxford University Press, 2018.

⁶⁰ ICC - International Chamber of Commerce. "ICC | International Chamber of Commerce", <https://iccwbo.org/>.

⁶¹ LCIA. "The London Court of International Arbitration (LCIA)", LCIA - the London Court of International Arbitration, i aksesueshëm në faqen web; <https://www.lcia.org/>.

Për të siguruar një zbatim më efektiv të vendimeve të arbitrazhit, nevojiten:

- Trajnime të specializuara për gjyqtarët, me fokus në standardet ndërkombëtare të arbitrazhit dhe interpretimin e drejtë të Konventës së Nju Jorkut mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të huaja të arbitrazhit.
- Krijimi i një strukture të specializuar brenda gjyqësorit shqiptar, që do të trajtonte me kompetencë të plotë dhe brenda afateve të arsyeshme çështjet që lidhen me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit.
- Minimizimi i ndërhyrjeve të panevojshme të gjykatave shqiptare, duke garantuar se kompetenca e gjykatës së arbitrazhit respektohet dhe të shmanget rihapja e çështjeve mbi bazë të shqyrtimeve të reja gjyqësore si një garanci e shtuar juridike.

•

8.2 Pavarësia e institucioneve të arbitrazhit

Një tjetër sfidë e rëndësishme është forcimi i pavarësisë së institucioneve të arbitrazhit për të shmangur çdo ndikim politik ose institucional që mund të minojë besueshmërinë e këtij mekanizmi.

Masa të domosdoshme për të forcuar pavarësinë e institucioneve të arbitrazhit përfshijnë:

- Zbatimi i standardeve ndërkombëtare të pavarësisë për arbitrat dhe institucionet e arbitrazhit, duke përcaktuar kritere të qarta për përzgjedhjen e arbitrave dhe shmangien e çdo konflikti interesi.
- Sigurimi i një autonomie financiare dhe organizative të institucioneve të arbitrazhit, duke shmangur varësitë e panevojshme nga autoritetet shtetërore.
- Forcimi i rregullave për procedurat e përzgjedhjes së arbitrave, duke synuar një sistem transparent dhe të besueshëm në përputhje me modelet e suksesshme të vendeve të BE-së.

8.3 Rritja e besimit të komunitetit të biznesit

Ndërkohë që arbitrazhi shihet si një alternativë më fleksibël dhe më e shpejtë krahasuar me sistemin tradicional të drejtësisë, përfshirja e tij në praktikën e komunitetit të biznesit në Shqipëri mbetet ende e kufizuar, ngaqë shumë kompani dhe investitorë nuk e konsiderojnë arbitrazhin si mekanizmin e parë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për shkak të pasigurisë juridike, mungesës së informimit dhe perceptimit të ndikimeve të mundshme politike.

Për të rritur përdorimin dhe besimin e biznesit në arbitrazh, nevojiten:

- Fushata informuese dhe programe ndërgjegjësimi mbi përfitimet e arbitrazhit, duke synuar bizneset vendase dhe të huaja që operojnë në Shqipëri apo edhe jashtë.
- Inkurajimi i përfshirjes së klauzolave të arbitrazhit në kontratat tregtare dhe investuese, si një praktikë standarde për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
- Rritja e transparencës dhe aksesit në informacion mbi proceset e arbitrazhit, duke siguruar që palët e interesuara të kenë besim dhe qartësi në procedurat dhe rezultatet e arbitrazhit.

Ligji i ri i arbitrazhit në Shqipëri shënon një përparim të rëndësishëm, por suksesi i tij në praktikë do të varet nga aftësia e institucioneve për të zbatuar në mënyrë adekuate dhe efektive dispozitat e reja. Forcimi i pavarësisë së institucioneve të arbitrazhit, përmirësimi i metodologjisë së ekzekutimit të vendimeve dhe promovimi i arbitrazhit si një opsion i besueshëm për komunitetin e biznesit janë hapa kyç për një sistem arbitrazhi më të fortë dhe në përputhje me standardet europiane. Nëse Shqipëria arrin të adresojë këto sfida, atëherë arbitrazhi do të

mund të shndërrohet në një mekanizëm të fuqishëm për rritjen e sigurisë juridike, tërheqjen e investimeve të huaja dhe përmirësimin e klimës së biznesit në vend.

9. Rekomandime për përmirësimin e arbitrazhit në Shqipëri

Për të siguruar një zbatim efektiv të ligjit të ri të arbitrazhit dhe për të rritur besueshmërinë e këtij mekanizmi, nevojiten disa masa konkrete dhe të mirëstrukturuara. Këto rekomandime fokusohen në përmirësimin e ekzekutimit të vendimeve, forcimin e institucioneve të arbitrazhit, zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe rritjen e transparencës.

9.1 Përmirësimi i ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të arbitrazhit

Pavarësisht ndryshimeve ligjore, zbatimi i vendimeve të gjykatave të arbitrazhit mbetet ende sfidues, veçanërisht për vendimet e huaja dhe për të siguruar një ekzekutim më efikas dhe të parashikueshëm, nevojiten masa të mëtejshme si:

Harmonizimi i praktikës gjyqësore. Gjyqtarët shqiptarë duhet të ndjekin praktika të unifikuara për zbatimin e vendimeve të gjykatave të arbitrazhit, duke u bazuar në Konventën e Nju Jorkut (1958) dhe standardet ndërkombëtare. Krijimi i një udhëzuesi praktik për ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit për gjyqtarët dhe avokatët do të reduktonte vonesat dhe interpretimet e ndryshme të ligjit.

Krijimi i trupave gjyqësore të specializuara mbi arbitrazhin. Në kuadër të gjykatave shqiptare, mund të krijohet një dhomë e specializuar për çështjet e arbitrazhit e përbërë nga gjyqtarë me ekspertizë specifike në këtë fushë. Kjo trupë do të trajtonte rastet e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit me efikasitet më të lartë, duke shmangur vonesat procedurale.

Përsheptimi i procedurave gjyqësore për arbitrazhin. Krijimi i një mekanizmi për shqyrtimin e shpejtë të kërkesave për ekzekutim, me afate të qarta kohore, do të siguronte një zbatim më të besueshëm të vendimeve, duke tejkaluar kufizimet e mundësive për bllokimin ose anulimin e vendimeve për arsye formale, përveç rasteve kur shkelet qartësisht rendi publik dhe ai juridik.

9.2 Forcimi i pavarësisë dhe besueshmërisë së institucioneve të arbitrazhit

Për të ndërtuar një mjedis të besueshëm për arbitrazhin në Shqipëri, nevojiten masa për forcimin e pavarësisë dhe funksionimit të institucioneve të arbitrazhit dhe evidentojmë;

Përmirësimi i rregulloreve të institucioneve të arbitrazhit. Institucionet shqiptare të arbitrazhit duhet të hartojnë rregullore të qarta dhe transparente, në përputhje me UNCITRAL Model Law dhe praktikat e suksesshme të vendeve të tjera, nga ku rregulloret duhet të parashikojnë kritere të rrepta për përzgjedhjen e arbitrave, duke garantuar paanshmërinë dhe profesionalizmin e tyre.

Autonomia financiare e institucioneve të arbitrazhit. Sigurimi i autonomisë financiare për institucionet e arbitrazhit është kriter i domosdoshëm për të shmangur ndikimet e jashtme, përfshirë edhe ato politike. Mund të krijohet një fond i veçantë për zhvillimin e arbitrazhit, i cili mund të financohet nga dhomat e tregtisë, organizatat ndërkombëtare dhe kontributet e biznesit privat.

Përcaktimi i standardeve etike për arbitra. Krijimi i një kodi etik për arbitrat që do të sigurojë pavarësinë dhe integritetin e tyre në proceset e arbitrazhit, rekomandojmë se vendosja e mekanizmave për mbikëqyrjen e arbitrave, duke lejuar ankesa dhe vlerësime të performancës së tyre nga palët e përfshira do të jepte një garanci dhe besim të shtuar kundrejt të gjithë aktorëve përfshirës.

9.3 Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të juristëve dhe gjyqtarëve

Një sfidë kyçe është mungesa e ekspertizës së mjaftueshme në arbitrazh brenda sistemit të drejtësisë shqiptare dhe për këtë arsye, trajnimi dhe edukimi i vazhdueshëm i profesionistëve ligjorë është jetik.

Krijimi i programeve të specializuara për arbitrazhin. Futja e kurseve të detyrueshme për arbitrazhin në fakultetet e drejtësisë, si pjesë e programeve të masterit dhe doktoraturës. Organizimi i trajnimeve të rregullta për gjyqtarët dhe avokatët me fokus në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe jurisprudencën ndërkombëtare mbi arbitrazhin, dhe përfshirja e ekspertëve ndërkombëtarë në programet e trajnimit, për të përafuar më shumë sistemin shqiptar me standardet ndërkombëtare.

Promovimi i kërkimit akademik mbi arbitrazhin. Inkurajimi i hulumtimeve akademike mbi arbitrazhin dhe publikimi i artikujve shkencorë për të ndihmuar zhvillimin e doktrinës ligjore në këtë fushë. Bashkëpunimi me universitetet dhe institutet kërkimore ndërkombëtare për të sjellë përvoja dhe modele të suksesshme nga vëndet me përvojën më të gjatë dhe domethënëse në këtë fushë.

9.4 Rritja e transparencës dhe promovimi i arbitrazhit si mekanizëm efektiv

Një nga problemet kryesore është mungesa e informimit të bizneseve dhe qytetarëve mbi arbitrazhin si një mekanizëm i besueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Krijimi i një platforme kombëtare për arbitrazhin. Një faqe zyrtare online me informacione të detajuara mbi procedurat e arbitrazhit, kostot dhe përfitimet e tij. Publikimi i vendimeve të gjykatave të arbitrazhit por edhe duke ruajtur anonimitetin e palëve, në qasjen pozitive të krijimit të një bazë të qartë precedentesh ligjore.

Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për bizneset. Seminare dhe konferenca për ndërgjegjësimin e sipërmarrësve dhe investitorëve mbi avantazhet e arbitrazhit. Përfshirja e Dhomave të Tregtisë dhe organizatave të biznesit për të promovuar arbitrazhin si një mjet standard për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Inkurajimi i përdorimit të klauzolave të arbitrazhit në kontratat tregtare. Sugjerimi i klauzolave të standardizuara të arbitrazhit për kontratat tregtare në sektorë kyç si ndërtimi, investimet e huaja dhe tregtia ndërkombëtare. Sigurimi që institucionet shtetërore dhe institucionet apo kompanitë publike të përfshijnë arbitrazhin në kontratat e tyre të biznesit, duke dhënë një shembull pozitiv për sektorin privat.

Ligji i ri mbi arbitrazhin paraqet një paradigëm modern dhe të përputhshëm me standardet ndërkombëtare duke synuar të krijojë një mjedis më të favorshëm për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve dhe domosdoshmërisht konsolidon modernizimin juridik dhe harmonizimin me normat ndërkombëtare. Ai thekson autonominë kontraktuale të palëve, garanton certifikimin e procedurave të arbitrazhit dhe ruan ekuilibrin midis fleksibilitetit procedural dhe rigozitetit ligjor. Në këtë mënyrë, forcohet siguria juridike dhe inkurajohen investimet, duke kontribuar në integrimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit juridik shqiptar. Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të ndihmojë në krijimin e një sistemi arbitrazhi më efikas, të besueshëm dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare, veçanërisht duke u fokusuar në përmirësimin e ekzekutimit të vendimeve, forcimin e institucioneve të arbitrazhit, edukimin e profesionistëve të së drejtës dhe promovimin e arbitrazhit, definitivisht Shqipëria mund të bëhet një qendër e rëndësishme për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve në rajon apo edhe më gjërë nëpërmjet instrumentit të arbitrazhit.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Bantekas, Ilias. (2020); "*Transparency in International Arbitration: A Comparative Analysis.*", *The International Journal of Arbitration* 36, nr. 1.
2. Born, Gary. (2021). "*International Commercial Arbitration.*" Kluwer Law International.
3. Born, Gary. (2021). "*International Arbitration: Law and Practice.*" 3rd ed. Kluwer Law International.
4. *Chronique D'arbitrage : La Cour De Cassation Fait (Encore) De L'arbitrage Sans Le Savoir.*" n.d. Arbitrage - Médiation - Conciliation | Dalloz Actualité.
5. Craig, W. L., Park, W. W., & Paulsson, J. (2018). "*International Chamber of Commerce Arbitration.*", 4th ed. Oxford University Press.
6. De Boissésou M., Madesclair J., Fouchard C., (March 2023), Le droit français de l'arbitrage "Section 5 - Arbitrabilité Et Ordre Public | La Base Lextenso".
7. Gaillard, Emmanuel, and Savage, Jonathan. (2017) "*Fouchard, Gaillard, Goldman on International Commercial Arbitration.*", Kluwer Law International.
8. Gáspár-Szilágyi, Szilárd, Daniel Behn, and Malcolm Langford, (2020), eds. "*Adjudicating Trade and Investment Disputes: Convergence or Divergence?* of *Studies on International Courts and Tribunals.*" Cambridge: Cambridge University Press.
9. ICCA (2023). "*International Arbitration Review.*".
10. Lew, Julian D. M., Mistelis, Loukas A., and Kröll, Stefan M. (2016), "*Comparative International Commercial Arbitration*". Kluwer Law International.
11. Moses, Margaret L. (2017), "*The Principles and Practice of International Commercial Arbitration.*", 3rd ed. Cambridge University Press.
12. Paulsson, Jan. (2015), "*Delocalization of International Commercial Arbitration: When and Why It Matters.*", *Arbitration International* 31, nr. 3; faqe: 419-433.
13. Paulsson, Jan. (1983), "*Delocalisation of International Commercial Arbitration: When and Why It Matters.*" *The International and Comparative Law Quarterly* 32, nr. 1: faqe 53–61.
14. Redfern, Alan, and Hunter, Martin. (2015), "*Law and Practice of International Commercial Arbitration.*", 5th ed. Sweet & Maxwell.
15. "*Revue De L'arbitrage.*"
16. Sanders, Peter. (2018), "*The Work of UNCITRAL on Arbitration and Conciliation.*" *Arbitration International* 34, nr. 2; faqe 265-287.
17. UNCITRAL (1985). "*Model Law on International Commercial Arbitration.*".
18. Van den Berg, Albert J. (2016) "*Enforcement of Arbitral Awards Annulled in Their Country of Origin.*" *Journal of International Arbitration* 33, nr. 2: 179-208.
19. World Bank (2023). "*Ease of Doing Business Report.*".

Legjislacion

1. "*Alternative dispute resolution for consumers.*", (2023, October 17). European Commission.
2. "*Arbitration Clause - EUR-Lex.*".
3. BMWK - Federal Ministry for Economic Affairs and Climate Action. "*Investment Protection*", n.d.
4. Decree No. 2011-48 of 13 January 2011, (*Ligji Francez mbi Arbitrazhin*)* reforming the law governing arbitration.
5. De Boissésou M., Madesclair J., Fouchard C., (March 2023), Le droit français de l'arbitrage "Section 5 - Arbitrabilité Et Ordre Public | La Base Lextenso".

6. *Explanatory Memorandum to COM(2023)649 - Amendment of Directive 2013/11/EU on Alternative Dispute Resolution for Consumer Disputes, as Well as Directives (EU) 2015/2302, (EU) 2019/2161 and (EU) 2020/1828 - EU Monitor.*”.
7. French Code of Civil Procedure (1981) - BOOK IV - ARBITRATION IN FORCE 14 MAY 1981, i aksesueshëm në faqen web; <https://mitchellhamline.edu/wp-content/uploads/sites/18/2016/05/DOC-9-French-Code-of-Civil-Procedure.pdf>.
8. “*International council for commercial arbitration guidelines on standards of practice in international arbitration*” The Icca reports nr. 9, 2021.
9. Ligji Nr. 52/2023, “*Për Arbitrazhin Në Republikën e Shqipërisë*”, Qendra e Botimeve Zyrtare.
10. Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996, “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës Së Shqipërisë*”, Qendra e Botimeve Zyrtare.
11. Regulation (EU) No 1215/2012 of the European Parliament and of the Council of 12 December 2012 on jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in civil and commercial matters (recast).
12. UNCITRAL Model Law on International Commercial Arbitration (1985), with amendments as adopted in 2006.
13. *UNCITRAL Model Law on International Commercial Arbitration (1985), With Amendments as Adopted in 2006 | United Nations Commission on International Trade Law*”.
14. United Nations Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Arbitral Awards (New York, 10 June 1958).
15. Zivilprozessordnung ZPO Ausfertigungsdatum (*Kodi i Procedurës Civile së Gjermanisë (ZPO)*): 12.09.1950.
16. Cambridge Advanced Learner's Dictionary & Thesaurus © Cambridge University Press
17. “*Cour de Cassation*”, Court of Cassation.
18. ICC - International Chamber of Commerce. “*ICC | International Chamber of Commerce*”,
19. LCIA. “*The London Court of International Arbitration (LCIA)*”, LCIA - the London Court of International Arbitration.

ENVIRONMENTAL TAXATION IN THE INTERNATIONAL LEGAL FRAMEWORK

Phd. Eda JAUPI*

TAKSIMI MJEDISOR NË KUADRIN LIGJOR NDËRKOMBËTAR

Abstrakt

Ky punim trajton temën e taksimit mjedisor në kuadrin ligjor ndërkombëtar duke përfshirë evolucionin historiko-normativ në Europë dhe Itali. Ndotja e mjedisit është, në fakt, një problem serioz për shëndetin e njeriut dhe është gjithnjë e më e rëndësishme të flitet për çështjen e ngrohjes globale. Konferencat dhe traktatet ndërkombëtare kanë kontribuar në zhvillimin ligjor të mjedisit dhe afirmimin e politikave mjedisore në vende të ndryshme. Për një kohë të gjatë, në kontekstin ndërkombëtar, taksimi mjedisor u konceptua si çdo e ardhur publike që ndotësi duhej të paguante për të parandaluar ose zvogëluar ndotjen, pavarësisht nga dallimet e aplikimit në shtete të ndryshme. Mbrojtja e mjedisit në kuadrin ligjor evropian u afirmua veçanërisht pas traktatit të Mاستrihtit.

***Fjalë kyç:** taksimi mjedisor; kuadri ligjor ndërkombëtar; ndotja mjedisore; konferencat ndërkombëtare; traktatet ndërkombëtar; ngrohja globale*

1. Introduction

The idea of developing this topic stems from an interest in the study of the legal discipline concerning the protection of the environment as a fundamental right of the individual.

The topic of environmental taxation is a very current and important topic. The intention to develop this theme arises from the fact that environmental pollution has, in fact, become a global environmental problem, which concerns all human beings.

In this sense, the question arises whether the legal system (since it is a relevant issue for all the States of the world) do they sufficiently protect the environment?

In order to be able to answer this question, the first part of the paper will focus on the legal concept of environment, in this sense the analysis will start from the definition of environment developed in the international legal system. The second part will instead carry out an analysis of the historical-normative evolution of environmental taxation in the international legal framework. The analysis of environmental taxation in the European legal framework will then proceed. Following the international and European legal framework described, the analysis of environmental taxation in the Italian legal framework will be addressed.

The methodology used for the following work is the review, collection and careful analysis of the literature. Many texts have been taken into consideration at the central national library of Rome, at the central legal library of the Supreme Court of Cassation and at the interdepartmental library of Legal Sciences of the Faculty of Law at the University of Rome La Sapienza, and at the central library of the Court of Auditors.

Environmental taxation is regulated by a three-layer framework: International level, European Union level and national level.

Fundamental in the establishment of a European policy has been the role assumed by the EU institutions and successive treaties.

* External Lecturer, Faculty of Law, University of Tirana, Albania, E-mail: eda_abi@hotmail.com

In the historical regulatory evolution of the environmental protection in the European context, three different periods can be distinguished : a first period (1957 to 1958), a second period (1986 to 1991), and a third period following the Maastricht Treaty (1992 to the present)¹.

The data on the revenue of environmental taxes in the EU in 2022, transmitted by the European Statistical Institute on 16 July 2024, with a net loss of 13 billion euros, equal to a reduction of 4% compared to the volume of 2021. The reduction in revenues in 2022 (317.2 billion euros compared to 330.2 billion euros in 2021) is mainly due to revenues from energy products.

In 2022, businesses generated the majority of the environmental tax collection volume, 52% of the total, with a contribution mainly achieved by companies in the manufacturing, mining, construction and public services sectors (26%) and the services sector (24%). Families were responsible for 45% of the total. Among the EU countries, Italy ranked third in terms of revenue volume (around 45 billion euros) after France and Germany. Statistical surveys have been prepared considering the data collected in compliance with specific EU legislation (regulation 691/2011/EU). An environmental tax is characterized by having its tax base in a physical quantity that has proven consequences on the environment. Environmental taxes are levied in the following areas: transport, energy, pollution and natural resources².

2. The legal notion of environment in the international legal framework

The environmental issues involve the international community as a whole, transcending the boundaries of individual states (so much so that among the basic rules of the World Trade Organization - also known by its acronym (WTO) - an explicit derogation to freedom of trade is established if there are reasons for environmental protection)³.

The attempt by several states to give a shared legal concept of the environment on which to establish national legislation and policies on environmental protection began in 1970⁴.

At the European level, the European Union has expounded the environment as “*the combination of elements whose complex interrelationships make up the settings, the surroundings and the conditions of life of the individual and of society, as they are or as they are felt*”. The environment therefore contains the built environment, the natural environment and altogether natural resources, comprehending air, land and water. It likewise contains the surroundings of the workplace.⁵

Until the mid-1980s, there was still no environmental discipline in the Italian legal system and no “subject” in the state apparatus with the necessary expertise to implement a serious environmental policy.

In fact, prior to the well-known 2001 reform, the Italian Constitutional Charter contained no explicit reference to the environment as an autonomous and unitary notion⁶.

It was not until the reform of the Title V of the Constitution (Const. Law. No. 3 of 2001) that the term

¹Miceli, Rossella. “*Tassazione ambientale e sistema tributario nazionale: nuove linee guida per le Regioni dalla sentenza della Corte Cost. N. 58/2015*”, in Quarterly Journal of Tax law, n. 1/2016, p. 61.

²<https://www.reteambiente.it/news/54765/eurostat-imposte-ambientali-in-calo-del-4percent/>

³Rota, Rosa. “*Lezioni di diritto dell’ambiente*”, ARACNE : Roma, 2012, p. 29.

⁴Although, as we can read in Di Lello, Marco – D’Angelo, Gianfranco – Moschiano, Eugenio. “*Legislazione ambientale urbanistica in Italia e in Campania*”, GUIDA : Napoli p. 29, international environmental law has its origins in 1941, on the occasion of a dispute that arose between Canada and the United States due to the polluting fumes emitted by the Trail foundry, located in Canadian territory on the border with United States.

⁵<https://www.eea.europa.eu/help/glossary/gemet-environmental-thesaurus/environment#:~:text=The%20European%20Union%20has%20defined,or%20as%20they%20are%20felt%22.>

⁶Grassi, Stefano. “*Problemi di diritto costituzionale dell’ambiente*”, GIUFFRÈ : Milano, 2012, p. 74.

“environment” made its way into the Constitution and, specifically, in the Article 117⁷. (Other references on the subject can also be found in Articles 2, 3, 9 and 32 of the Italian Constitution)⁸.

3. The historical-normative evolution of environmental taxation in the international legal framework

With regard to international environmental rules, the international rules distinct from Community standards (Treaties, Conventions, Agreements, etc.), are of great importance⁹. To date, more than 200 environmental treaties have been signed: most of them concern nuclear disarmament, the defense of the Antarctic, and fishing. But the first important conference to address issues related to environmental protection and the limits of development was the United Nations Conference on the Human Environment, held in Stockholm in 1972. The results achieved are important because they constitute the first example of global political reasoning on the issues of human development¹⁰.

Also of note is the Convention on International Trade in Endangered Species of Wild Fauna and Flora (CITES Convention), adopted in Washington on 3 March 1973, which constitutes the first and principal instrument of international law regulating trade in protected species of fauna and flora.¹¹

First of all, international regulations on the protection of the sea are mentioned¹². Secondly, international regulations on the protection of endangered species are mentioned¹³.

⁷where is stipulated that the “protection of the environment, ecosystem and cultural heritage” is the exclusive responsibility of the state (2nd paragraph) and that “the enhancement of cultural and environmental heritage and the promotion and organization of cultural activities” (3rd paragraph) is a matter of concurrent legislation (with Regions). Nespore, Stefano., De Cesaris, Ada Lucia. “*Codice dell’ambiente*”, GIUFFRÈ : Milano, 2011, p. 104.

⁸Further references to the topic can be also found in the Articles 2, 3, 9 e 32 of the Italian Constitution Dorigo, Stefano – Mastellone, Pietro. “*La fiscalità per l’ambiente, attualità e prospettive della tassazione ambientale*”, ARACNE : Roma, 2013, p.136.

⁹https://www.google.al/books/edition/Ambiente_2023/7Vq_EAAAQBAJ?hl=sq&gbpv=1&dq=i+trattati+ambientali&pg=PA74&printsec=frontcover

¹⁰<https://www.societabotanicaitaliana.it/SBI/IBI%2040%20S2%202008/09-013%20Mereu%20-%20I%20trattati%20internazionali%20quali%20strumenti...pdf>

¹¹https://www.google.al/books/edition/Trattato_breve_di_diritto_agrario_italia/r1HfEAAAQBAJ?hl=sq&gbpv=1&dq=cites+washington+1973+trattato&pg=PA804&printsec=frontcover

¹² United Nations Convention of Montego Bay of 10 December 1982 and Agreement for the implementation of Part XI of the New York Convention of 29 July 1994 against marine pollution. Both ratified by Law 2 December 1994, n.689. ; London Convention of 2 November 1973 and related Protocol of 17 February 1978 against marine pollution from ships. Mar/Pol Conventions - ratified by Law 29 September 1980, n.662 - of the London Protocols of 17 February 1978 and of the Convention opened for signature in Mexico City, London, Moscow and Washington on 29 December 1972, ratified by Law 2 May 1983, n. 305 (see, now, the Protocol referred to in Law 13 February 2006, n. 87) ; International Conventions signed in London, respectively, on 12 May 1954, 12-15 September 1971 and 30 November 1990; Brussels Conventions of 29 November 1969 and 18 December 1971 establishing an International Fund for the Compensation of Related Damages; Protocols adopted in London on 19 November 1976 and London Conventions of 27 November 1992 against marine pollution resulting from hydrocarbon prospecting, exploration and production activities ratified by Laws of 23 February 1961, no. 238, 19 December 1975, no. 875 and 15 December 1998, no. 464. ;The Helsinki Convention (or Water Convention) adopted on 17 March 1992, in force since 6 October 1996 on the protection and use of transboundary watercourses and international lakes ratified with Law 12 March 1996,n.171; https://www.google.al/books/edition/Ambiente_2023/7Vq_EAAAQBAJ?hl=sq&gbpv=1&dq=i+trattati+ambientali&pg=PA74&printsec=frontcover

¹³ Convention on the Conservation of Migratory Species of Wild Animals (CMS), known as the Bonn Convention, entered into force on 23 June 1979 for the protection of seal pups, whales, and areas necessary for large migratory birds for their movements, ratified by Law 25 January 1983, no. 42, in force since 1 November 1983. ; Ramsar Treaty of 2 February 1971 for the protection of wetlands implemented by Presidential Decree 13 March 1976, n. 448; see now Presidential Decree 11

Thirdly, mention is made of the rules that regulate situations of environmental damage that may occur in the territory of a State as a consequence of activities carried out in the territories of other States (international transport of waste and transboundary environmental impacts)¹⁴.

There are a significant number of international bilateral treaties and conventions between bordering and coastal nations concerning pollution or accidents with transboundary effects, such as the Rome Convention of 2 May 1995, Treaty with Switzerland¹⁵; the Rome Convention of 20 April 1972, Treaty with Switzerland; the Belgrade Agreement of 14 February 1974, the Treaty with Yugoslavia; the Alpine Convention of 1991, the international treaty signed by Italy, the Principality of Monaco, Austria, France, Germany, Switzerland, Slovenia, Liechtenstein and the EU.

At an international level, four main stages can be distinguished in which environmental matters have developed

1. The 1972 Stockholm Conference
2. The Rio de Janeiro Conference of 1992,
3. The Johannesburg Summit of 2002, which was later named “World Summit on Sustainable Development”,
4. The Conference on Sustainable Development held in Rio de Janeiro on June 20-22, 2012¹⁶.

Especially, the United Nations Conference of Human Environment (UNCHE) held in Stockholm in 1972 provided the impetus for the beginning of global institutional awareness of environment-related problems. Indeed, its final declaration stated that: “*we have reached a point in history when we must regulate our actions toward the whole world, taking into account first of all their effects on the environment.*”

The United Nations Organization (also known by the acronym UN) was the first forum to deal with the environmental matters and to initiate a policy of international cooperation for the resolution of economic, social, cultural, and humanitarian problems related to the issue. In this regard, the UN founded

February 1987, n. 184 containing the amending protocol and the revised text of the original French version of the Ramsar Convention.

https://www.google.al/books/edition/Ambiente_2023/7Vq_EAAAQBAJ?hl=sq&gbpv=1&dq=i+trattati+ambientali&pg=P A74&printsec=frontcover

¹⁴ Geneva Convention of 13 November 1979 and related Implementation Protocols on the Reduction of Emissions of Sulphur Oxide, Nitrogen Oxide, Vital Organic Compounds and Ammonia ratified by Italy with Law 27 April 1982, n. 289. ; Basel Convention of 22 March 1989 on the International Shipment of Wastes ratified by Italy with Law 18 August 1993, n. 340. ; Multilateral Treaty signed between the Governments of London, Moscow and Washington, signed on 27 January 1967, in force since 10 October 1967 on the Pollution of Outer Space ratified by Italy with Law 4 May 1972. ; Washington Convention of 2 December 1946 on Whaling ratified by Italy with Law 10 November 1997, n. 408. ;

Vienna Convention of 26 September 1986 for the protection of the atmosphere from nuclear reactions ratified by Italy with Law 31 October 1989, n. 375. ; Bonn Convention of 23 June 1979 for the conservation of migratory species ratified by Italy with Law 25 January 1983, n. 42. ; Bern Convention of 19 September 1979 for the protection of wildlife and natural habitats ratified by Italy with Law 5 August 1981, n. 503.

Washington Convention of 3 March 1973 on trade in endangered species ratified by Italy with Law 19 December 1975, n. 874.

Helsinki Convention or Water Convention of 17 March 1992 on the protection and use of transboundary watercourses and international lakes and the sustainable use of water resources ratified by Italy with Law 12 March 1996, n. 171.

Vienna Convention of 5 September 1997 on the safe disposal of spent fuel and radioactive waste ratified by Italy with Law 16 December 2005, n. 282.

¹⁵https://www.google.al/books/edition/Ambiente_2023/7Vq_EAAAQBAJ?hl=sq&gbpv=1&dq=i+trattati+ambientali&pg=P A74&printsec=frontcover

¹⁶Dorigo, Stefano – Mastellone, Pietro, “*La fiscalità per l’ambiente, attualità e prospettive della tassazione ambientale*”. cit., p.45.

intergovernmental committees aimed at a confrontation involving states on environmental issues.

Mention should also be made of the United Environment Programme (UNEP), which is at the interstate level, the only organization that possessed the general competence on the environment, which adopted international conventions¹⁷.

UNEP is established by the United Nations Conference held in Stockholm in mid-June 1972, in implementation of the decision adopted by the UN Assembly that addressed the problems and concerns for the state of the environment present in all countries. UNEP operates in many countries through regional offices and has its headquarters in Nairobi (Kenya). The organization includes the European Union member states that contribute to its activity with proposals and by carrying out initiatives for environmental sustainability at Community level. The main objective of UNEP is the control of climate change, to protect the most exposed populations from variations.

Until the 1980s, the approach to the environment had a predominantly sectoral and restorative connotation in the wake of a non-precautionary environmental policy, directed mostly at repairing the damage done. It was not until the 1990s that a new perspective was created based on precaution and reduction of eco-disasters.

In fact, at the 1992 United Nations Conference on Environment and Development, held in Rio de Janeiro, solutions were defined that could respond to the need for a new approach, more sensitive to the social dimension, and to the need to establish new instruments, through which to begin a process of sustainable development, in awareness of the close correlation between environment and development¹⁸.

In other words, in the 1992 Rio de Janeiro Conference, the participating national representations had the objective of stopping environmental deterioration and lay the foundations for the implementation of sustainable development¹⁹.

Unlike the two previous Conferences, the Conference held in Johannesburg in 2002 avoided defining new principles or encouraging the conclusion of international treaties, since the essential objective was to assess the progress made following the implementation of the Rio Conference and the application of the principle of sustainable development through the balancing of its three essential components : economic development, environmental protection and social development²⁰.

Twenty years after the first conference in Rio de Janeiro, also in Rio de Janeiro, a new United Conference on Sustainable Development²¹, also called the Rio+20 Conference, was held with the stated goal of renewing the political commitment to sustainable development by monitoring the status of implementation of international commitments made over the past two decades in a political commitment called “The future we want”²².

Also in the international arena is the Organization for Economic Cooperation and Development (OECD), which is a forum in which governments work together to solve environmental, social and economic problems²³.

For over 30 years, the OSCE has been regularly conducting national environmental reviews in all its member countries and in some partner countries²⁴.

The OECD has established five categories of economic instruments for environmental protection : taxes, subsidies, security deposits, penalties and other deterrence measures, tradable permits and other market interventions²⁵.

¹⁷D’Agostino, Paolo – Salomone, Riccardo. “*La tutela dell’ambiente, profili penali e sanzionatori*”, CEDAM : Padova, 2011, p. 15.

¹⁸Antich, Federico. “Origine ed evoluzione del diritto internazionale ambientale. Verso una governance globale dell’ambiente”, in *ambientediritto.it*.

¹⁹Dorigo, Stefano – Mastellone, Pietro. “La fiscalità per l’ambiente, attualità e prospettive della tassazione ambientale”, cit., p.50.

²⁰Dorigo, Stefano – Mastellone, Pietro. “La fiscalità per l’ambiente, attualità e prospettive della tassazione ambientale”. cit., p.53.

²¹ The 2012 Rio de Janeiro Conference on Sustainable Development.

²²Becheri, Emilio – Maggiore, Giuseppe. “Rapporto sul turismo italiano”, ROGIOSI : Milano, 2013, p. 576.

²³For a profound study see OECD. “Studi economici dell’OCSE: Italia 2019”, OECD Publishing, Paris, 2019.

²⁴ <https://www.oecd.org/en/topics/environmental-country-reviews.html>

²⁵Alfano, Roberta. “Tributi ambientali, profili interni ed europei”, GIAPPICHELLI : Torino, 2012, p. 18-19.

There are five categories of economic instruments : 1) taxes (fees or duties) and tariffs that can have a disincentive function, or a revenue function, or both; 2) subsidies, which have the function, of financial subsidy to promote measures and activities aimed at containing pollution; 3) security deposits, which consist of surcharges on the sales of polluting products that can be returned in the case of environmentally friendly collection and recycling; 4) penalties and other deterrent measures (such as the duty to provide a surety) applicable to subjects who carry out polluting activities; 5) tradable permits and other market interventions, which slow down polluting production and favor industrial processes from which a lower environmental impact derives²⁶.

4. Environmental taxation in the European legal framework

In the preceding paragraphs i have focused on the path of affirming the environment as a fundamental right in the international arena, now it is instead necessary to proceed to a historical overview of European initiatives and interventions that have contributed to the establishment of an environmental policy. Environmental protection within the European legal framework became, especially following the Maastricht Treaty, an objective of Community action. Today, environmental protection is stipulated by Title XX of the TFEU, in particular, Articles 191, 192, 193 of the TFEU²⁷.

The current EU framework, contained in the Treaty on the Functioning of the European Union, does not give a precise definition of “environment”, which is inferred, however, from Article 191 TFEU²⁸, where the objectives of EU environmental policy are set out²⁹.

In other words, in the current European legal framework, the absence of a specific definition of “environment” is compensated for by a specific definition of what are the objectives to be achieved in this area.

Article 191 of the TFEU gives the European Union a regulatory competence in tax matters aimed at ensuring a “high level of environmental protection”³⁰.

The provisions of Articles 191 et seq. TFEU apply, however, only if the objectives of the environmental action cannot be adequately achieved by the Member States or can be better achieved at the Union level³¹.

Thus, member states are free to determine the environmental fiscal interventions according to their needs, which are not assigned to the community competence.

It is well understood, however, that decisive intervention by the EU legislature in the environmental matters presupposes harmonization of the ecological taxes and fees in force in the respective EU countries.

At this point in the investigation, we must therefore ask ourselves whether individual Member States have today adopted a homogeneous tax system in terms of environmental taxation. Answering this question is not

²⁶For a profound study see Alfano, Roberta. “Tributi ambientali, profili interni ed europei”, GIAPPICHELLI : Torino, 2012, p. 18-19.

²⁷Miceli, Rossella. “*Tassazione ambientale e sistema tributario nazionale: nuove linee guida per le Regioni dalla sentenza della Corte Cost. N. 58/2015*”, cit., p. 62.

²⁸This article, as sanctioned in the Lisbon Treaty, asserts that the Union’s policy on the environment shall contribute to the following objectives : a) the preservation, protection and improvement of the quality of the environment; b)the protection of human health; c)the prudent and rational utilization of natural resources; d)the promotion at the international level of measures to solve regional or global environmental problems and, in particular, to combat climate change.

²⁹Ficari, Valerio. “*I nuovi elementi di capacità contributiva. L’ambiente*”, ARACNE : Roma, 2018, p.32-33.

³⁰Preite, Filippo – Gazzanti Pugliese Di Cotrone. Antonio, Atti notarili. “*Diritto comunitario e internazionale*”, UTET GIURIDICA : Milano, 2011, p. 1593.

³¹Article 5(3) TFEU : By virtue of the principle of subsidiarity, in the areas which do not fall within its exclusive competence, the Union shall take action only if and insofar as the objectives of the proposed action cannot be sufficiently achieved by the Member States, either at central or at regional and local level, but can, by reason of the scale or effects of the proposed action, be better achieved at the Union level.

easy.

Although, in fact, Article 113 TFEU expressly provides for it³², the process of tax harmonization – which was supposed to be divided into three phases : abolition of custom duties, harmonization of VAT and excise duties, is still ongoing today³³. In this provision of the TFEU, the objective of harmonizing the legislation of the Member States on turnover tax, excise duty and other indirect taxes is established, as harmonization is necessary to ensure the establishment and functioning of the common market. As anticipated, the principle of harmonization is identified in art. 113 of the TFEU, in relation to the indirect tax sector and therefore especially with reference to value added tax, excise duties and customs duties³⁴.

With regard to indirect taxation, internal choices regarding eco-taxes must adapt to the principle of harmonization, in compliance with the more defined intervention of the Union, with a wider margin of European action. Instead, with regard to direct environmental taxes, European intervention can only make use of the provisions of Article 114 TFEU. In this sense, it is important to specify that environmental harmonization occurs at both direct and indirect tax levels. It is important to specify that the excise duty sector is a significant example of harmonization, in which ecologically oriented levies have been implemented. Excise duties are indirect taxes that affect polluting emissions. Taxes on production or consumption³⁵, called excise duties, affect goods as : electricity, energy products, ethyl alcohol, alcoholic beverages and manufactured tobacco.

The “polluter pays” principle has its origins in OECD Recommendation C (72) 128 of 26 May 1972, according to which the costs of prevention and polluting behavior must be attributed to the party responsible for pollution, in order to safeguard the environment³⁶.

With the Lisbon Treaty of 2007, the “polluter pays” principle is provided for in Article 191 paragraph 2 of the TFEU³⁷.

The “polluter pays” principle dictates that liability to the public should be imposed on those who cause damage to the environment, legitimizing the provision of economic measures and legal instruments for environmental protection and compensation for damage caused to the environment.

Alongside the various legal instruments (fees, penalties, permits etc.), environmental levies or taxes with an environmental purpose or tax breaks directed at penalizing polluting inputs have also been used. Article 191 of the TFEU empowers member states to establish environmental policies by using the appropriate legal instruments (which include environmental levies and tax breaks); however, this provision does not include an obligation for member states to introduce legal instruments for environmental protection in their national law³⁸.

³²Article 113 TFEU : The council, acting unanimously in accordance with a special legislative procedure and after consulting the European Parliament and the Economic and Social Committee, shall adopt provisions for the harmonisation of legislation relating to turnover taxes, excise duties and other indirect taxes to the extent that such harmonisation is necessary to ensure the establishment and functioning of the internal market and to avoid distortions of the competition.

³³In the definition of harmonization, the following legal traits can be identified : the enunciation of a unitary tax model and the reduction of the differences of each national legislation regarding the unitary model. Fiscal harmonization is achieved through the regulations, directives and acts of the Community soft law. Thus Boria, Pietro. “*Diritto Tributario Europeo*”, cit., p.215-216.

³⁴Boria, Pietro. “*Diritto Tributario Europeo*”, GIUFFRÈ : Milano, 2015, p.218.

³⁵For a profound study see Alfano, Roberta. “*Tributi ambientali, profili interni ed europei*”, cit., p.152.

³⁶Ficari, Valerio – Scanu, Giovanni, “*Tourism Taxation*” *Sostenibilità ambientale e turismo fra fiscalità locale e competitività*”, GIAPPICHELLI : Torino, 2013, p. 129. However, a first formalization of the principle can probably already be found in the French law of 16.12.1964, n. 1245, on the institution of the *agences financières de bassin*, in which the formula “*who pollutes should pay and who purifies should be helped*” found its full expression.

³⁷Article 191 paragraph 2 of the TFEU : Union policy on the environment shall aim at a high level of protection, taking into account the diversity of situations in the various regions of the Union. It shall be based on the principles of precaution and preventive action, the principle of rectification, as a priority at source, of damage caused to the environment, and “the polluter pays” principle.

Ventre, Tommaso. “*I principi fondamentali e le dinamiche della tassazione ambientale nel sistema giuridico multilivello*”, EDIZIONI SCIENTIFICHE ITALIANE : Napoli, 2012, p. 63.

³⁸Boria, Pietro, “*Diritto Tributario*”, GIAPPICHELLI : Torino, 2016, p. 211.

In other words, the principle, although functional to other principles of European law on environmental matters, is mainly placed in a logic of general-preventive protection of the environment; that is, as an inspiring principle of a programmatic and not perceptive nature aimed primarily at the normative action of the European Union³⁹.

Community action in the field of the environment is currently based on four fundamental principles: the precautionary principle, preventive action and the rectification of pollution at source, as well the “polluter pays” principle.

With regard to the competences of the Member States and the constraints deriving from the Treaty, it is possible to affirm that the European Union guarantees a high level of protection for the environment (principle of the necessary high level of protection) which is expressed in the provision of a duty on the part of the Member States to adopt internal legislation which has its objective the protection of the environment⁴⁰, which takes into account the diversity of situations existing in the various Member States of the Union (principle of differentiation).

And indeed, the Constitutions of several countries⁴¹, recognize, although in different ways, the right to a healthy environment.

5. Environmental taxation in the Italian legal framework

In this paragraph i thought it appropriate to reconstruct the historical-legislative evolution of environmental protection in Italy, starting from the first attempts to anchor such protection in the Constitution up to the current situation.

Italian environmental law has a predominantly supranational derivation; in fact, the regulations that concern environmental law within the Italian legal system derive from international and EU sources, and domestic legislation has over time adapted subsequently to the action of other extra-national authorities.

In other words, the environmental good began to assume prominence as a legal asset deserving of independent protection only as a result of international and EU treaties in the face of visible effects of environmental damage.

An environmental tax can be generically defined as that coercively imposed benefit related to the damage caused to the environment by the performance of an economic activity⁴².

Basically, the environmental tax consists of a contribution against a social cost incurred by the community for pollution of the environment to be attributed to the polluter.

Concerning the category of environmental levies, a unitary notion of an ecological levy has been formulated whose qualifying element is the release into the environment of a physical unit bearing a negative effect on the ecosystem. In this perspective, the qualifying element of the environmental tax is identified in the causal relationship that must exist between the production of a pollution and the tax levy⁴³.

From the application of the “polluter pays” principle, progressively consolidated at the international and European level, has derived the legitimacy of states to impose levies on polluters to compensate for the costs of de-pollution, at first from a consideration perspective, later from a fully fiscal perspective. As a result of the studies conducted on the environmental issue and on the basis of the EU positions that urged states to apply environmental levies in the strict sense, in recent years environmental levies have also been introduced into the

³⁹AA.VV., *“Orientamento della Corte di giustizia dell’Unione europea in materia di responsabilità civile”*, edited by Guido, Alpa – Giuseppe, Conte, GIAPPICHELLI : Torino, 2018, p. 111.

⁴⁰This is a shared general principle. So, Di Pietro, Adriano. *“La fiscalità ambientale in Europa e per l’Europa”*, CACUCCI : Bari, 2016, p. 57.

⁴¹Di Pietro, Adriano. *“La fiscalità ambientale in Europa e per l’Europa”*, cit., p. 57. For example, art. 23 of the Belgian Constitution, art. 66 of the Portuguese Constitution, art. 35 of the Romanian Constitution, art. 45 of the Spanish Constitution etc.

⁴²Natoli, Luigi Ferlazzo. *“Diritto Tributario”*, GIUFFRÈ : Milano, 2010, p. 22.

⁴³Boria, Pietro. *“Diritto Tributario”*, cit., p. 212 -21.

Italian legal system⁴⁴.

The types of environmental taxes in Italy are divided into :

1) State environmental taxes. These include :

-Carbon tax (the tax of carbon) was introduced (but never really implemented) by Law No.448/1998, Art.8) which sanctions the taxation of energy products, based on the amount of carbon dioxide they can release. The goal of this tax is to reduce dioxide emissions emitted from the combustion of petroleum products and natural gas. In 2008, a new tax, “Robin Tax”, was introduced, the purpose of which was to introduce a corporate income tax surcharge for oil and fuel companies. In 2012, the Robin Tax was declared unconstitutional due to a flaw of unreasonableness⁴⁵.

According to the Constitutional Court, the rule violated Articles 3 and 53 of the Constitution in terms of reasonableness and proportionality, since the tax is defined as a rate increase that applies to the entire business income, rather than just to the excess "profits"; its temporal scope of application has not been limited in perspective, nor have mechanisms been introduced to verify the continuation of the economic situation that had legitimized its application; finally, there are no adequate assessment mechanisms to ensure that the costs deriving from the tax increase do not deciphered into increases in consumer prices⁴⁶.

The tax on emissions of sulfur dioxide (SO₂) and nitrogen oxides (NO_x), is provided for in paragraphs 29 et seq. of Article 17 of Law No. 449/1997, and applies to large combustion plants. Both taxes are environmental taxes in the strict sense, since they affect polluting emissions of carbon dioxide, sulfur dioxide and nitrogen oxides⁴⁷.

Among the types of state environmental taxes, it is also necessary to recall first, in chronological order, environmental tax, now abolished : the manufacturing tax on plastic bags, established by article 1, paragraph 8, of Decree Law No. 397 of September 9, 1998. Subsequently, Article 80 of Law No. 413 of December 30, 1991, established the application of the manufacturing tax on all plastic bags, abolishing the words “non-biodegradable”. Article 29 bis of Decree Law No. 331 of August 30, 1993, abolished the original tax, and established in its place, a recycling fee on virgin polyethylene, regulated by Article 29 bis of Law No. 427 of October 29, 1993.

However, as of January 1, 2011, a ban on the sale of non-biodegradable plastic bags came into effect. And again, as of January 1, 2018, a tax on shopping bags came into effect in Italy.

In this “new” view against the use of plastic, Italy has also distinguished itself. And indeed, in 2019, Italy became the first nation to ban the production and marketing of non-biodegradable cotton bud sticks (8 percent of waste at beaches). On april 4, 2019, the Salvamare draft law was approved by the Council of Ministers, which allows fishermen to collect plastic at sea. Italy was also the first country in Europe, starting in 2020, to ban micro-plastics in cosmetics⁴⁸.

According to the 2020 Programmatic Budget Document, from 2021 to promote environmental sustainability, a tax on plastic packaging was introduced effective June 1, 2020 (rate 1 euro per kg). And indeed, the draft law presented by the Ministry of Economy and Finance, Gualtieri, on the State budget for the financial year 2020 and multi-year budget for the three-year period 2020-2022, concerning fiscal measures to protect the environment and health introduces in Article 79 the tax on the consumption of plastic products with single use and incentives for companies producing biodegradable and compostable plastic products⁴⁹.

⁴⁴Miceli, Rossella. *“Tassazione ambientale e sistema tributario nazionale: nuove linee guida per le Regioni dalla sentenza della Corte Cost. N. 58/2015, cit., p.65.*

⁴⁵Conti, Marcelo Enrique. *“Il management ambientale. Teorie, metodi e strumenti in una prospettiva sostenibile”*, NUOVA CULTURA : Roma, 2018, p. 60.

⁴⁶ <https://www.camera.it/temiap/t/news/post-OCD15-11198>

⁴⁷Uricchio, Antonio Felice. *“L'emergenza ambientale a Taranto: le risposte del mondo scientifico e le attività del polo “Magna Grecia”*”, CACCUCI : Bari, p. 121.

⁴⁸WWF REPORT, *“Fermiamo l'inquinamento da plastica. Italia: una guida pratica per uscire dalla crisi della plastica”*, 2019.

⁴⁹Article 79, Italian 2020 Budget Law.

2) Regional environmental levies. Among these we can mention :

-Aircraft noise tax (Law No. 342/2000, Art. 90), became a regional own tax as of Jan. 1, 2013. Aircraft noise tax (IRESA) applies on landings and takeoffs of civil aircrafts at airports, except for medical, state and emergency flights⁵⁰.

-The special regional tax on the landfilling of waste was introduced by Law No. 549/1995, Art. 3, paragraphs 24 et seq., with the aim of incentivizing the reduced production of waste, and the recovery of the raw material and energy contained in it⁵¹.

3) Provincial and municipal environmental taxes. In this last category, we recall :

-Provincial tax for environmental financing, Article 19 of Legislative Decree No. 504/1992, stipulates that for the purpose of environmental protection, rates in the area of municipal solid waste disposal tax, against the exercise of administrative functions of provincial interest, concerning the organization of waste disposal, the detection, regulation, and control of discharges and emissions and the protection, defense and development of the soil, an annual tax is established, effective January 1, 1993, in favor of the provinces⁵².

-The tourist tax, also known as the tourist tax, is a purpose tax, is a tax to be paid by tourists who stay at least one night at hotel and non-hotel facilities⁵³.

6. Environmental taxation: more examples of “eco-taxes”

The ecopass of Milan, example of para-commutative tax.

The basis of “causal” or “paracommutative” taxes is the potential benefit enjoyed by the taxpayer or the need to compensate for damage caused by the taxpayer. These taxes differ from the tax, which is acausal in nature⁵⁴.

- In 2002, a feasibility study was prepared for the city of Milan; mandatory ecopass for each car driver who intends to enter in the city of Milan’s limited traffic zone⁵⁵.

The intention of the ecopass was to decrease environmental pollution and vehicular traffic but more importantly to reduce both traffic congestion and pollution, and the funds raised would allow for the implementation of environmental policy measures, including the enhancement of public transportation⁵⁶.

Ecopass has actually contributed to the improvement of air quality. In the first 11 months, there was a 12 percent reduction in traffic in the tolled zone and a 4 percent reduction in the outer zone. In fact, PM10 and Nox emissions decreased by 23 percent and 17 percent respectively⁵⁷.

It should be pointed out that the exemption from paying the entrance fee is not linked to residence within the so-called “Ecopass zone”, but rather based on the environmental quality of the vehicle owned (in other word, the

⁵⁰Uricchio, Antonio Felice. *“Imposizione di scopo e federalismo fiscale”*, MAGGIOLI EDITORE : Santarcangelo di Romagna, 2013, p.185.

⁵¹Scuffi, Massimo – Albenzio, Giuseppe – Miccinesi, Marco. *“Diritto doganale, delle accise e dei tributi ambientali”*, IPSOA : Milano, 2013.

⁵²Art. 19 d.lgs. n. 504/1992, comma 1.

⁵³Ficari, Valerio – Scanu, Giovanni. *“Tourism Taxation” Sostenibilità ambientale e turismo fra fiscalità locale e competitività*”, GIAPPICHELLI : Torino, p. 35.

⁵⁴Basilavecchia, Massimo – Del Federico, Lorenzo – Osculati, Franco. “ Il finanziamento delle Regioni a statuto ordinario mediante tributi propri e compartecipazioni: basi teoriche ed evidenza empirica nella difficile attuazione dell’art. 119 della Costituzione”, in *Institutions of Federalism: Journal of Legal and Political Studies* , 2006, p. 703.

⁵⁵Marletto, Gerardo – Musso, Enrico, *“Trasporti, Ambiente e Territorio. La ricerca di un nuovo equilibrio”*, FRANCO ANGELI : Milano, 2010, p. 41.

⁵⁶Galimberti, Alessia. *“Road pricing. Politiche di controllo del traffico e dell’inquinamento”*, MAGGIOLI : Santarcangelo di Romagna, 2008, p.162.

⁵⁷OECD (2013), *“Rapporti dell’OCSE sulle performance ambientali: Italia 2013”*, p.48-49.

owner of vehicle deemed to be polluting, even though he or she resides within the “Ecopass zone”, is subject to the entrance fee in that area).

Currently, the ecopass corresponds to Area C, and since 2019, Area B, the Low Emission Zone, has also been in force. The introduction of Area B on February 25, 2019 was the real novelty in Milan, the largest Low Emission ZTL in Europe that surrounds Area C. Area B includes 1.4 million people, equal to 96.4% of residents, and covers approximately 72% of the municipal territory. The provision regulates the ban on the circulation of the most polluting diesel vehicles, Euro 0, 1, 2 and 3 diesels, Euro 0 petrol-powered vehicles, dual-fuel diesel-LPG and diesel-methane Euro 0, 1, 2, and bulky vehicles exceeding 12 meters in length, from Monday to Friday from 7:30 to 19:30. From 1 October 2019, the circulation ban is also foreseen for Euro 4 diesel vehicles. However, the municipality has foreseen some exemptions, everyone will have 50 days of free circulation in the first year, 25 days in the second for residents, 5 for all the others⁵⁸.

The case of the luxury tax of the Sardinia Region – a purpose tax. With the Law n.296 of 2006, art. 1 paragraphs 145 et seq. the Italian municipalities had the possibility to set up a purpose tax intended for partial coverage of a maximum of 30% of the investments necessary for the realization of public works⁵⁹.

In 2006, the Sardinia Region had established with the Law of 11 May 2006, n. 4, a regional tax on aircraft and pleasure craft, a regional tax on second homes for tourist use and a regional tax on capital gains on buildings used as second homes. The approved text had fueled several doubts regarding its constitutional and community legitimacy from the beginning, and the Presidency of the Council of Ministers at the time had filed an appeal with the Constitutional Court. To save the law, however, the Council of the Sardinia Region had approved certain changes to the cases established by articles 2, 3 and 4 of Regional Law 4/2006⁶⁰ and had attempted to rationalise the aspects deemed most unconstitutional.

In 2009, the Court of Justice declared the Sardinian tax on aircraft and pleasure craft to be illegitimate and the luxury tax was repealed by art. 2 of the Regional Law of 14 May, no. 1 (2009 financial law)⁶¹.

7. Conclusion

Economic growth is generally accompanied by strong pressures on the environment, and the relationship between growth and the environment is conditioned both by environmental policies and by the framework of basic reforms under which these policies are implemented. A variety of growth-enhancing reforms, such as

⁵⁸Donati, Anna – Petracchini Francesco – Gasparini Carlotta – Tomassetti Laura, “*Rapporto MobilitAria 2019. Politiche di mobilità e qualità dell’aria nelle 14 città e aree metropolitane 2017-2018*”, p.101. https://www.kyotoclub.org/medialibrary/LibroMOB2019_digital_sm.pdf

⁵⁹If the public work is not carried out within two years from the date fixed as the deadline by the executive project, confirming the essential correlation between tax performance and achievement of the objective pursued, Taxpayers can claim reimbursement of payments made. The purpose tax is determined by applying a maximum rate of 0.5 thousand to the taxable amount of ICI. For this reason, the purpose tax can be described as an additional ICI with a restriction on its use. The current ICI rules apply to tax regulations (art. 1, paragraph 148). The list of works for which the purpose tax is allowed is indicated in the tax law (art. 1, paragraph 149) and therefore allows the integration of types of public works not indicated by the aforementioned provision. The obligation of destination must be subject to control and appropriate reporting by the municipality in the general instruments of public finance (and therefore in particular in the municipal budget). See Boria,Pietro, “*Il sistema tributario*”, UTET GIURIDICA : Torino, 2008, p.991.

⁶⁰Article 2 of the law in question affected capital gains arising from the sale of buildings used as second homes and Article 3 affected the possession of second homes located within 1.86 miles of the sea. Article 4 provided for a tax on aircraft and pleasure craft, the prerequisites for which were linked to the “stopover in ports and airfields located in the regional territory”; the amounts were calculated based on the number of passengers on the aircraft and the meters of the vessel. Articles 2 and 3 identified the taxable persons with the taxable persons with the subjects “who do not have a tax domicile in the regional territory” with the exception of those born in Sardinia and their spouses. ALFANO R., *Tributi ambientali. Profili interni ed europei*, cit., p. 185.

⁶¹ So Alfano, Roberta, , “*Tributi ambientali. Profili interni ed europei*”, cit., p. 186-187.

increasing environmental taxes, eliminating environmentally harmful subsidies and introducing road pricing, can have positive effects on the environment⁶².

Optimizing well-being for current and future generations depends not only on greater growth but also on greater environmental protection and curbing global warming in accordance with the goals of the Paris Agreement.

Compared to other EU countries, Italy continues to be significantly behind in terms of climate performance. Confirmation comes from the ranking drawn up by the annual report by Germanwatch⁶³, CAN⁶⁴ and NEWClimate Institute⁶⁵ on the climate performance of the most important countries on the planet, carried out in collaboration with Legaambiente⁶⁶ for Italy, and presented in Baku at Cop29. The report takes into account the climate performance of 63 countries, plus the European Union as a whole, which together account for over 90% of global emissions⁶⁷.

Despite the boom in renewable energy, the report specifies that a drastic reduction in global emissions by 2030 is essential, first and foremost by limiting the use of fossil fuels.

The European Union is making significant progress in reducing pollution, but a stronger commitment is essential to achieve the ambitious goals of zero pollution by 2030. Published by the European Environment Agency (EEA) and the European Commission, this is the result of the second report on monitoring and prospects for zero pollution. With a decrease in air pollution, marine plastic waste and pesticide use, EU policies have brought positive results. The general level of pollution remains high, especially due to waste, microplastics, nutrients, excessive noise⁶⁸.

One of the most powerful economic policy tools in the hands of governments is taxation and it can play a major role in rebalancing economic imbalances to promote sustainable growth and innovation, which are essential for a suitable energy transition. It can and must decisively constitute one of the pillars of climate finance⁶⁹.

Taxation has become a significant area of international cooperation since the global financial crisis of 2008. Today, in fact, taxation is a subject of discussion in all the major international economic contexts, from the G20⁷⁰ to the United Nations⁷¹.

The climate crisis and its associated costs have played a key role in pushing international tax cooperation to the top of the international agenda⁷². In developing countries (DCs), estimates of essential investments to mitigate climate change, adapt infrastructure and economies to its effects, and address the costs of loss and damage range between \$1,800 and \$2,400 per year.

Procuring these levels of resources and ensuring that they are spent fairly and effectively requires a profound

⁶²OECD, *OCSE360: Italia 2015 "Come si posiziona l'Italia?, Parigi"*, OECD Publishing, 2015, p.16.

⁶³Germanwatch is an independent development, environmental, and human rights organisation.

⁶⁴Climate Action Network (CAN) is a global network of more than 1,900 civil society organisations in over 130 countries driving collective and sustainable action to fight the climate crisis and to achieve social justice.

⁶⁵NewClimate Institute for Climate Policy and Global Sustainability brings action on climate change from ideas to implementation.

⁶⁶Legaambiente is an Italian non-profit organization founded in 1980. Legaambiente (League for the Environment) is the most widespread environmental organization in Italy, with 20 Regional branches and more than 115,000 members.

⁶⁷<https://www.legambiente.it/comunicati-stampa/climate-change-performance-index-2025/>

⁶⁸<https://www.regione.marche.it/News-ed-Eventi/Post/110914/L-UE-Avanza-Verso-l-Obiettivo-di-Inquinamento-Zero-ma-Serve-un-Azione-Pi%C3%B9-Decisa>

⁶⁹https://eccoclimate.org/wp-content/uploads/2024/10/Verso-un-sistema-di-tassazione-internazionale-per-clima-e-sviluppo_Report.pdf

⁷⁰The G20, formed in the 1999, is a group of twenty of the world's largest economies that meets regularly to coordinate global policy on trade, health, climate and other issues.

⁷¹https://eccoclimate.org/wp-content/uploads/2024/10/Verso-un-sistema-di-tassazione-internazionale-per-clima-e-sviluppo_Report.pdf

⁷²The 2030 Agenda for Sustainable Development is a blueprint for action for people, planet and prosperity.

reform of the international financial architecture and the institutions that govern it. In this sense, greater international cooperation in tax matters is essential⁷³.

In 2019, at the community level, revenues from environmental taxes amounted to 330 billion, while in Italy there were 58.7 billion euros added to the state coffers by virtue of this tax, one of the highest in Europe. Of those 58.7 billion in tax revenue, only 549 million⁷⁴ are invested in the environment and the ecosystem, and first and foremost to repair the damage caused by the taxed activities⁷⁵.

Given that environmental taxes have traditionally been used to raise revenue and as previously mentioned a very low percentage of revenue from environmental taxes has been earmarked for environmental purposes, consideration could be given to earmarking a higher percentage of revenue from environmental taxes for environmental purposes to address air pollution and climate change.

BIBLIOGRAPHY

1. Alfano, Roberta. *“Tributi ambientali, profili interni ed europei”*, GIAPPICHELLI : Torino, 2012.
2. Antich, Federico. *“Origine ed evoluzione del diritto internazionale ambientale. Verso una governance globale dell'ambiente”*, in *ambientediritto.it*.
3. Aresu, D. *“Il “caso” della Costa Concordia”*, in Law Journal. *“Diritto e Trasporti”*, Anno III - Speciale Costa Concordia.
4. Becheri, Emilio – Maggiore, Giuseppe. *“Rapporto sul turismo italiano”*, ROGIOSI : Milano, 2013.
5. Boria, Pietro. *“Diritto Tributario Europeo”*, GIUFFRÈ : Milano, 2015.
6. Boria, Pietro, *“Diritto Tributario”*, GIAPPICHELLI : Torino, 2016.
7. Conti, Marcelo Enrique. *“Il management ambientale. Teorie, metodi e strumenti in una prospettiva sostenibile”*, NUOVA CULTURA : Roma, 2018.
8. D’Agostino, Paolo – Salomone, Riccardo. *“La tutela dell’ambiente, profili penali e sanzionatori”*, CEDAM : Padova, 2011.
9. Di Lello, Marco – D’Angelo, Gianfranco – Moschiano, Eugenio. *“Legislazione ambientale urbanistica in Italia e in Campania”*, GUIDA : Napoli.
10. Di Pietro, Adriano. *“La fiscalità ambientale in Europa e per l’Europa”*, CACUCCI : Bari, 2016.
11. Dorigo, Stefano – Mastellone, Pietro. *“La fiscalità per l’ambiente,, attualità e prospettive della tassazione ambientale”*, ARACNE : Roma, 2013.
12. Fabi, David - Dell’Anna Ilarione – Aquilino, Ennio – Curcio, Fabrizio. *“Il naufragio della Costa Concordia. Sintesi di aspetti di gestione dell’emergenza”*, Dipartimento della Protezione Civile, 2012.
13. Fazioli, Roberto. *“Obiettivo sostenibilità. Il difficile cammino della transizione energetica”*, TAB EDIZIONI : Roma, 2023.
14. Ficari, Valerio – Scanu, Giovanni, *“Tourism Taxation” Sostenibilità ambientale e turismo fra fiscalità locale e competitività”*, GIAPPICHELLI : Torino, 2013.
15. Ficari, Valerio. *“I nuovi elementi di capacità contributiva. L’ambiente”*, ARACNE : Roma, 2018.
16. Grassi, Stefano. *“ Problemi di diritto costituzionale dell’ambiente”*, GIUFFRÈ : Milano, 2012.
17. Guido, Alpa – Giuseppe, Conte. *“Orientamento della Corte di giustizia dell’Unione europea in materia di responsabilità civile”*, GIAPPICHELLI : Torino, 2018.
18. <https://www.instat.gov.al/>

⁷³https://eccoclimate.org/wp-content/uploads/2024/10/Verso-un-sistema-di-tassazione-internazionale-per-clima-e-sviluppo_Report.pdf

⁷⁴ These taxes amount to less than 1% of the total (549 million euros out of over 58 billion). Which means that, of these 58.7 billion in environmental tax revenue, 57.5 are not spent on the environment. 99% of environmental tax revenue is not invested in environmental protection. <https://www.openpolis.it/come-vengono-gestite-e-impiegate-le-tasse-ambientali/>

⁷⁵<https://mondointernazionale.org/post/tasse-ambientali-in-italia-cosa-sono-e-come-non-vengono-usate>

19. Miceli, Rossella, *“Federalismo fiscale e principi europei. Spazi di autonomia, livelli di responsabilità e modelli di federalismo”*, GIUFFRÈ : Milano, 2014.
20. Miceli, Rossella. *“Tassazione ambientale e sistema tributario nazionale: nuove linee guida per le Regioni dalla sentenza della Corte Cost. N. 58/2015”*, in Quarterly Journal of Tax law, n. 1/2016.
21. Narducci, Fabio – Narducci, Riccardo, *“Guida normativa per l’amministrazione locale”*, MAGGIOLI : Santarcangelo di Romagna (Rimini), 2015.
22. Natoli, Luigi Ferlazzo. *“Diritto Tributario”*, GIUFFRÈ : Milano, 2010.
23. Nespor, Stefano - De Cesaris Ada Lucia. *“Codice dell’Ambiente”*, GIUFFRÈ : Roma, 2009.
24. OECD, *“Economic instruments for environmental protection”*, Paris, 1989.
25. OECD (2013), *“Rapporti dell’OCSE sulle performance ambientali: Italia 2013”*.
26. OECD, *OCSE360: Italia 2015 “Come si posiziona l’Italia?”*, Parigi”, OECD Publishing, 2015.
27. OECD, *“Studi Economici dell’OCSE: Italia 2019”*, Parigi, OECD Publishing.
28. Prandi, Paolo. *“Il risk management. Teoria e pratica nel rispetto della normativa”*, FRANCO ANGELI : Milano, 2012.
29. Pollifroni, Massimo. *“Public sector social responsibility. Strumenti di rendicontazione etico-sociale per l’azienda pubblica”*, GIUFFRÈ : Milano, 2007.
30. Preite, Filippo – Gazzanti Pugliese Di Cotrone. Antonio, Atti notarili. *“Diritto comunitario e internazionale”*, UTET GIURIDICA : Milano, 2011.
31. Querini, Giulio. *“La tutela dell’ambiente nell’Unione Europea”*, FRANCO ANGELI : Milano, 2007.
32. Rota, Rosa. *“Lezioni di diritto dell’ambiente”*, ARACNE : Roma, 2012.
33. Scuffi, Massimo – Albenzio, Giuseppe – Miccinesi, Marco. *“Diritto doganale, delle accise e dei tributi ambientali”*, IPSOA : Milano, 2013.
34. Spaziani, Stefania. *“Compendio di Politica Economica. Economia del benessere. Politica monetaria, fiscale, dei redditi. Fallimenti di mercato e politiche macroeconomiche. Contesto internazionale”*, MAGGIOLI : Santarcangelo di Romagna, 2012.
35. Uricchio, Antonio Felice. *“Imposizione di scopo e federalismo fiscale”*, MAGGIOLI EDITORE : Santarcangelo di Romagna, 2013.
36. Uricchio, Antonio Felice. *“L’emergenza ambientale a Taranto: le risposte del mondo scientifico e le attività del polo “Magna Grecia”*, CACCUCI : Bari.
37. Ventre, Tommaso. *“I principi fondamentali e le dinamiche della tassazione ambientale nel sistema giuridico multilivello”*, EDIZIONI SCIENTIFICHE ITALIANE : Napoli, 2012.
38. WWF REPORT, *“Fermiamo l’inquinamento da plastica. Italia: una guida pratica per uscire dalla crisi della plastica”*, 2019.
39. Zappala, Giuseppe. *“Accise e tributi ambientali – Quadro generale. Spunti per la costruzione di un sistema di vita in comune più sostenibile”*, Roma, 2016.

Emri i Autorit